Numri dhe koha e gjeneratave mund të ndryshojnë në mes të stinëve dhe është influencuar nga temperatura, reshjet dhe gjerësia gjeografike. Në sezonet e lagështa, të ngrohta, rritja është e bollshme për vezëvendosje.

Popullatat e mushkonjës rriten me shpejtësi gjatë fillimit të verës dhe dëmtimi më i madh në pemë ndodh gjatë gjeneratës së dytë, që përkon me periudhën e rritjes maksimale të lastarëve. (Todd 1959).



Fig. 7. Insekti i



Fig. 8. Vezë



Fig. 9. Larva



Fig. 10. Pupa e rritur

IV. PERFUNDIME

- Dasineura mali* është një dëmtues jo kyç i kulturës së mollës.
- Ka një përhapje të kufizuar në rajonin e Korçës.
- Për zhvillim ka nevojë për lagështi ajrore, prandaj dhe është i pranishëm në zonat gjatë rrjedhjes së lumenjve ose baseneve të tjerë ujorë.
- Në një lastar mund të dëmtohen deri në 16 gjethe.
- Insektet e rritur të breznisë së parë dalin nga mesi i majit kur temperaturat mesatare ditore arrijnë vlerat e 20⁰ C, ose pas formimit të gjetes së 9-10.
- Insektet e rritura dalin përkatësisht më 16 maj, 17 qershor, 14 korrik dhe 9 gusht.
- Larvat sipas breznive dëmtojnë përkatësisht në periudhat: Breznia I, nga 19 maj-10 qershor, Breznia II, nga 20 qershor-6 korrik, Breznia III, nga 18-30 korrik, Breznia IV, nga 12-29 gusht
- Pupëzimi fillon sipas breznive përkatësisht në 10 qershor, 6 korrik, 30 korrik dhe 29 gusht. Në rrethin e Korçës ka 4 brezni në vit.

V. REFERENCES

- [1] Carl KP 1980. Observations on the apple leaf-curling midge (*Dasineura mali* Kieffer) and a new species from apple galls, (*Macrolabis* sp.) (Dipt.: Cecidomyiidae). Anzeigerfur Schadlingskunde Pfl anzenschutz Umweltschutz 53: 99-102.
- [2] Penman DR 1984. Deciduous tree fruit pests. In: Scott RR ed. New Zealand pest and beneficial insects. Lincoln University College of Agriculture, Canterbury, New Zealand. Pp. 33-50.
- [3] Shaw PW, Wallis DR, Rogers DJ 2003. The impact of early season insecticides on biological control of apple leafcurling midge (*Dasyneura mali*). New Zealand Plant Protection 56: 164-167.
- [4] Todd DH 1956. A preliminary account of (*Dasyneura mali* Kieffer) (Cecidomyiidae: Diptera), and an associated hymenopterous parasite in New Zealand. New Zealand Journal of Science and Technology A37: 462-464.
- [5] Todd DH 1959. The apple leaf-curling midge, (*Dasyneura mali* Kieffer), seasonal history, varietal susceptibility and parasitism 1955-58. New Zealand Journal of Agricultural Research 2: 859-869.
- [6] Tomkins AR, Wilson DJ, Thomson C, Bradley S, Cole L, Shaw P, Gibb A, Suckling DM, Marshall R, Wearing CH 2000. Emergence of apple leafcurling midge (*Dasineura mali*) and its parasitoid (*Platygaster demades*). New Zealand Plant Protection 53: 179-184.
- [7] Trapman M 1988. Apple leaf gall midge population build-up and natural regulation. Fruittelt 78: 34-35.
- [8] Alford, DV, 1984, "Një Atlas Ngjyra e Fruta dëmtuesit njohja e tyre, biologji, dhe kontrollin", Wolf, Botime, Londër, Angli. (4-9)
- [9] Antonelli, PLS 18, "Apple Leaf Curling Midge", Tetor 2005, WSU Puyallup (12-16)

VLERËSIM SIMPTOMATOLOGJIK I PËRHAPJES SË FITOPLAZMËS SË MOLLËS (*Candidatus phytoplasma mali*), NË RAJONIN E KORÇËS
SYMPTOMATOLOGY ESTIMATION OF THE SPREAD OF APPLE PHYTOPLASMES (*Candidatus phytoplasma mali*), IN KORÇA REGION
BESNIK SKËNDERASI^{1*}, EDMOND SPAHIU¹, DESAREDA MERO², HEKURAN VRAPË³

1*Universiteti Fan S.Noli, Fakulteti i Bujqësisë, Korçë, Shqipëri

2 Universiteti Fan S.Noli, Fakulteti i Shkencave Natyrore & Humane, Korçë, Shqipëri

3 Universiteti Bujqësor, Fakulteti i Bujqësisë & Mjedisit, Tiranë, Shqipëri

E-mail besniksk@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Candidatus Phytoplasma mali është një sëmundje infektuese që gjendet e përhapur edhe në rajonin e Korçës. Në disa vende të botës si në Kanada dhe SH.B.A, konsiderohet sëmundje shumë e rrezikshme dhe objekt karantinor.

Nga kulturat drufrotore, molla është bima strehuese kryesore ku dëmi ekonomik mund të shkojë nga 10-80%. Dëmi ekonomik vjen si pasojë e zvogëlimit të përmasave, peshës dhe cilësisë së frytit si dhe uljes së fuqisë rritëse të pemëve.

Nga kultivarët e mollës të ndjeshëm ndaj sëmundjes janë: Golden Delicious, Red Delicious, Granny Smith, Renetta e Kanadasë, Gala, etj.

Por prek edhe kultura si kumbulla, lajthia, dardhat, lisi, murrizi, trëndafili etj. Në Evropë insektet kryesore shkaktarë të përhapjes së kësaj sëmundjeje janë pleshtat dhe kryesisht ato të gjinisë *Cacopsylla*. Këto insekte arrijnë të fusin fitoplazmat nëpërmjet rostrumit të tyre deri në floemë.

Fjalët kyç: *Fitoplazma, fitoplazmoza, kultivar, cikada, floema*

ABSTRACT

Candidatus Phytoplasma mali is an infectious disease that is widespread in the region of Korça. In some countries such as Canada and SH.BA considered very dangerous disease and quarantine object. From trees cultures, apple is the main host plant where the economic damage could range from 10-80%. Economic damage resulting from the reduction of size, weight and quality of the fruit as well as reducing the upward power of the trees. From apple cultivars, sensitive to disease are: Golden Delicious, Red Delicious, Granny Smith, Renetta Canada, Gala, etc. But also affects culture as plums, hazelnuts, pears, oak, hawthorn, rose etc. In Europe the main cause insects to the spread of this disease are fleas, mainly *Cacopsylla* sex. These insects manage to put phytoplasmes through their rostrum to phloem.

Key words: *phytoplasmes, phytoplazmoza, cultivar, cikada, phloem.*

1. HYRJE

Fitoplazma infektuese në gjuhën angleze njihet si fshesa e mollës ose Apple proliferation phytoplasma (APP).

Klasa: Mollicutes, **Rendi:** Acholeplasmatales, **Familja:** Acholeplasmataceae. **Gjinia** '*Candidatus* 2 *Phytoplasma*.

Studimet e kryera në të gjithë vendet evropiane flasin për prezencën e saj kudo. Fitoplazmat janë patogjenë intraqelizorë, që përdorin qelizën bimore për shumimin dhe mbijetesën e tyre.

Këta patogjenë shfrytëzojnë për nevojat e tyre qelizën bimore, duke shkaktuar çrregullimin e metabolizmit të qelizave si pasojë e toksinave, që ato sekretojnë, ose bllokimin e lëvizjes së lëndëve ushqyese, në indet përçuese.

Shartimi i mbishartesave të infektuara në nënshartesa të pastra, apo i mbishartesave të pastra mbi nënshartesa të sëmura do të japë një fidan të infektuar. [Myrta A].

Fitoplazmozat janë sëmundjet e shkaktuara nga fitoplazmat dhe janë zbuluar për herë të parë në vitin 1967.

Fitoplazmozat janë konsideruar si “sëmundje virusale”, sepse simptomat e shfaqura ngjasojnë shumë me to.

Fitoplazmat janë organizma njëqelizorë, që bëjnë pjesë në klasën *Mollicutes*. Janë organizma të ngjashëm me bakteret, por i mungon muri qelizor.

Fitoplazmat janë parazitë të detyruar intraqelizorë dhe vendosen në floemë. (Figura 1). Kanë forma të ndryshme, të rrumbullakëta, në formë dardhe ose të zgjatur, me diametër nga 100 deri në 1000 nm.

Fitoplazmat nuk kultivohen *in vitro*. (Anon, 2004)

Fitoplazmat përhapen në dy mënyra kryesore: Me pjesë vegjetative, me anë të shartimit dhe me anë të insekteve vektorë. Insektet vektorë, janë përfaqësues të rendit *Rincotae*, ku përfshihen cikadet dhe psillat. Ato fusin rostrumin deri në thellësinë e floemës, ku arrijnë në kontakt me fitoplazmat.

Fitoplazmat mund të shumohen edhe në trupin e insektit deri sa arrijnë në gjëndrat e pështymës.. Kjo sëmundje nuk mund të shpërndahet nëpërmjet farave, frutave dhe krasitjes.

Sëmundja e fshesës së mollës është konstatuar në Shqipëri, por akoma nuk ka studime të mirëfillta për të.

Molla është bima strehuese kryesore, por gjendet edhe në dardha, ftoi, kumbulla, qershia dhe është e përqendruar në ndajgjethëzat, bishtat dhe nervëzimet e gjetheve, lëvorja e lastarëve dhe lastarët e rinj.

Në një pemë të infektuar, disa degë mund të duken normale dhe të prodhojnë fruta normale, ndërsa në disa degë të tjera janë të prekura dhe prodhojnë fruta jo normale. Simptomat e sëmundjes mund të zhduken për një ose disa vite dhe mund të shfaqen përsëri pas ndonjë krasitje ose shartimi të rëndë. [Myrta A].




Figura 1

Temperaturat më optimale për zhvillimin e sëmundjes janë nga 21-24°C. Simptomat mund të shfaqen më tepër në pjesët e poshtme të pemës. (Lemmetty A, Soukainen M, Tuovinen T, 2013).

Kjo sëmundje është objekt karantinor për Evropën (zona EPPO, lista A2) Simptoma më karakteristike për këtë sëmundje është formimi i fshesës. (Figura 2). Gjethet përdridhen, zverdhen, mbeten të vogla e të zgjatura, me bisht të shkurtër, të dhëmbëzuara e të çrregullta. Frutat mbeten të vegjël dhe majat e lastarëve thahen.

Kur ndërnyjat e lastarit janë shumë afër me njëra-tjetrën ato marrin formën e një rozete. (Figura 3)

Në vjeshtë gjethet marrin ngjyrë të kuqe ose ngjyrë bronzi. Formimi i ndajgjethëzave shumë të mëdha, është një simptomë tjetër e kësaj sëmundje, që nuk e gjejmë në mollët e painfektuara. (Figura 4)



Figura 2



Figura 3




Figura 4

Lulet kanë më shumë se 5 petale të vendosura në 2-3 radhë dhe paraqiten me bisht të gjatë. (Figura 5, 6). Bimët që janë të infektuara mund të lulëzojnë pas lidhjes kokrrave.. Frutat e prekur janë më të vegjël, me bisht të hollë e të gjatë dhe pa shije (Figura 7). Frutat në anën e poshtme të lules janë më të shtypur se frutat normalë. (Figura 8). Pemët e sëmura preken shumë nga hiri. Kur mollët infektohen në 2-3 vitet e para të rritjes, sëmundja mund të thajë të gjithë pemën. Kultivarë të ndjeshëm ndaj sëmundjes janë: Golden Delicious, Red Delicious, Granny Smith, Renetta e Kanadasë, Gala, etj. (CABI/EPPO, 2013)

Sëmundje dimëron në rrënjët e pemëve dhe riaktivizohet gjatë pranverës. (Kunze L, 1979)



Figura 5



Figura 6



Figura 7



Figura 8

Në Evropë insektet kryesore të përhapjes së kësaj sëmundjeje insektet oligofagë të gjinisë Malus, kryesisht ato të gjinisë *Cacopsylla* (*Cacopsylla picta* dhe *Cacopsylla Melanoneura*), (Figura 10, 11). Janë insekte që dimërojnë si insekte të rritur dhe kanë një brezni në vit. Infeksionet e para të sëmundjes fillojnë në muajin maj dhe vazhdojnë gjatë gjithë stinës së verës. Në vjeshtë insektet e rritur kalojnë për dimërim në bimët e egra strehuese. (Figura 12). (Tedeschi R, Alama A, 2004).

Diagnostikimi i sëmundjes nga ana vizuale është i vështirë, prandaj për ta saktësuar përfundimisht atë, duhet përdorur metoda e ngjyimit PCR, (*Polymerase Chain Reaction*). Kjo teknikë kur kombinohet me teknikën e RFLP-së (*Restriction Fragment Polymorphism*) mund të përcaktojë edhe taksonominë e tyre. (Kirkpatrick BC, 1996).



Fig. 10. *Cacopsylla melanoneura*



Fig. 11. *Cacopsylla picta*




Figura 12

2. MATERIALI DHE METODA

U monitoruan gjithsej 15 pemtore në të gjithë rrethin e Korçës, kryesisht pemtore intensive të mbjella në fushë. U analizuan 5 kultivarë: Golden delicious, Starking, Idared, Granny Smith dhe Gala

Për çdo pemtore u analizuan nga 20 pemë për çdo kultivar. U analizuan lule, gjethë, fruta dhe lastarë. Lulet në degëzat buketore u analizuan në muajin maj, ndërsa gjethet frutat dhe lastarët u analizuan në dhjetëditëshin e parë të tetorit,

Analizat u kryen nëpërmjet vlerësimit simptomatologjik.

Viti i studimit: prill 2014-tetor 2014

3. REZULTATET DHE DISKUTIME

Tabela 1. Pemë të infektuara me fitoplazma sipas kultivarëve dhe fermave

Nr	Vendi	Pemë të analizuar për çdo kultivar	Pemë të infektuara				
			Golden	Starkig	Idared	Granny Smith	Gala
1	QTTB	20	2	-	-	-	-
2	Dvoran	20	1	-	-	1	1
3	Voskop	20	1	1	-	-	-
4	Bulgarec	20	-	-	1	1	-
5	Vloçisht	20	1	-	-	-	-
6	Sovjan	20	-	-	-	-	1
7	Pirg	20	-	-	-	1	-
8	Zvirinë	20	1	-	-	-	1
9	Vreshtas	20	1	-	-	-	-
10	Shengjergj	20	-	-	-	1	-
11	Pojan	20	-	-	-	1	-
12	Zëmlak	20	1	-	1	-	-
13	Plasë	20	1	1	-	-	-
14	Rëmbec	20	-	-	-	-	1
15	Neviçisht	20	1	-	-	1	-
	Shuma	300	10	2	2	6	4

Tabela 2. Organe bimore të infektuara sipas kultivarëve dhe fermave

Nr	Vendi	Pemë të analizuar për çdo kultivar	Organe bimore të infektuara				
			Golden	Starkig	Idared	Granny Smith	Gala
1	QTTB	20	gjethe, fruta	-	-	-	-
2	Dvoran	20	lule	-	-	gjethe	-
3	Voskop	20	gjethe	fruta	-	-	-
4	Bulgarec	20	-	-	gjethe	fruta	-
5	Vloçisht	20	gjethe	-	-	-	gjethe
6	Sovjan	20	-	--	-	-	-
7	Pirg	20	-	-	fruta	-	-
8	Zvirinë	20	lule	gjethe	-	-	-
9	Vreshtas	20	gjethe	-	-	-	-
10	Shengjergj	20	-	-	-	gjethe	-
11	Pojan	20	-	-	-	lule	-
12	Zëmbllak	20	fruta	-	fruta	-	-
13	Plasë	20	fruta	fruta	-	-	-
14	Rëmbec	20	-	-	-	-	gjethe
15	Neviçisht	20	gjethe	-	-	-	-

4. PËRFUNDIME

Kjo sëmundje është e pranishme në vendin tonë, megjithëse me përqindje të ulët.

Kultivari Golden delicious është më i prekshëm me 3.33%, më pas renditet kultivari Granny Smith me 2%, Gala me 1.33 %. Kultivarët Starking e Idared me 0.66%.

Simptomat më të qarta vihen re në gjethe, pastaj në fruta e lule.

Gjethet përdridhen, janë të dhëmbëzuara, të çrregullta dhe më të vogla, më të zgjatura se normalet. Ngjyra e tyre është e verdhë. Me afrimin e vjeshtës ato mund të marrin herët nuancë të kuqe dhe ngjyrë bronzi.

Simptomë e rëndësishme është prania e ndajgjethezave të mëdha, që nuk gjenden në mollët e painfektuara.

Ndërnyjat e lastarit janë shumë afër me njëra-tjetrën dhe marrin formën e rozetës.

Lulet janë me 12-15 petale, të vendosura në 2-3 rrathë

Frutat janë të vegjël, pa shije, pa ngjyrën karakteristike të kultivarit.

Dobësimi i përgjithshëm pemës deri në tharjen e saj.

Fitoplazmat barten në dy mënyra kryesore:

Me material shumëzues vegjetativ dhe me anë të insekteve vektorë, si cikadet (*Cacopsylla picta* dhe *C. Melanoneura*), që janë insekte të gjinisë *Malus* dhe psillat.

5. REFERENCAT

[1]Anon, 2004. 'Candidatus Phytoplasma', a taxon for the wall-less, non-helical prokaryotes that colonize plant phloem and insects. *International Journal of Systematic and Evolutionary Microbiology*, 54(4):1243-1255.

[2]Anon., 1997. Apple proliferation phytoplasma. In: *Quarantine Pests for Europe*. II ed., Smith, McNamara, Scott, Holderness, Burger eds., CABI and EPPO pub, 959-962.

- [3]Blifernich K, Krczal G, 1995. Epidemiological studies on apple proliferation disease in Southern Germany. *Acta Horticulturae*, 386:444-453.
- [4]Buntsevich LL, Zakharchenko VV, 2003. For virus-free horticulture and nurseries in the south of Russia. *Zashchita i Karantin Rastenii*, No. 7:12.
- [5]CABI/EPPO, 2013. *Candidatus Phytoplasma mali*. [Distribution map]. *Distribution Maps of Plant Diseases*, No. October. Wallingford, UK: CABI, Map 761 (Edition 2).
- [6]Casanova R, Llacer G, Sanchez-Capuchino JA, 1980. Remission of symptoms of apple proliferation, after injection of concentrated tetracycline solutions. *Acta Phytopathologica Academiae Scientiarum Hungaricp*, 15:273-277
- [7]Davies DL, Stickels JE, Adams AN, 1986. A single occurrence of apple proliferation disease in England. *Plant Pathology*, 35(3):400-402
- [8]Grando MS, Forti D, Vindimian ME, 1998. DNA sequences of the apple proliferation phytoplasma found in psyllid collected from diseased apple trees. *Journal of Plant Pathology*, 80(3):257.
- [9]Hegab AM, El-Zohairy MM, 1986. Retransmission of mycoplasma-like bodies associated with western X disease between herbaceous plants and apple seedlings. *Acta Horticulturae*, 193.
- [10]Jarausch B, Schwind N, Jarausch W, Krczal G, Dickler E, Seemüller E, 2003. First report of *Cacopsylla picta* as a vector of apple proliferation phytoplasma in Germany. *Plant Disease*, 87(1):101; 2 ref.
- [11]Kartte S, Seemüller E, 1988. Variable response within the genus *Malus* to the apple proliferation disease. *Zeitschrift für Pflanzenkrankheiten und Pflanzenschutz*, 95(1):25-34
- [12]Kison H, Schneider B, Seemüller E, 1994. Restriction fragment length polymorphisms within the apple proliferation mycoplasma-like organism. *Journal of Phytopathology*, 141(4):395-401
- [13]Krczal G, Blifernich K, 1992. Distribution of apple proliferation disease in orchards with integrated and conventional pesticide programs. *Acta Horticulturae*, 309:253-260.
- [14]Krczal G, Krczal H, Kunze L, 1988. *Fiebierella florii* (Stsl), a vector of apple proliferation agent. *Acta Horticulturae*, 235:99-106.
- [15]Kunze L, 1979. Damage of root system caused by apple proliferation. *Mitteilungen aus der Biologischen Bundesanstalt für Land-und Forstwirtschaft Berlin-Dahlem*, 191:204-205.
- [16]Lemmetty A, Soukainen M, Tuovinen T, 2013. First report of '*Candidatus Phytoplasma mali*', the causal agent of apple proliferation disease, in apple trees in Finland. *Plant Disease*, 97(10):1376. <http://apsjournals.apsnet.org/loi/pdis>
- [17]Loi N, Carraro L, Musetti R, Firrao G, Osler R, 1995. Apple proliferation epidemics detected in scab-resistant apple trees. *Journal of Phytopathology*, 143(10):581-584; 9 ref.
- [18]Osler R, Petrovič N, Ermacora P, Seljak G, Brzin J, Loi N, Carraro L, Ferrini F, Refatti E, 2001. Control strategies of apple proliferation, a serious disease occurring both in Slovenia and in Italy. *Zbornik predavanj in referatov 5. Slovensko Posvetovanje o Varstvu Rastlin, Cate ob Savi, Slovenija, 6. marec-8. marec 2001*, pp. 238-243.
- [19]Sanchez-Capuchino JA, Llacer G, Casanova R, Forner JB, Bono R, 1976. Epidemiological studies on fruit tree mycoplasma diseases in the eastern region of Spain. *Acta Horticulturae* 67:129-131.
- [20]Schmid G, 1983. Effects of tetracycline injection against apple proliferation. *Acta Horticulturae*, 130:237-241.
- [21]Seemüller E, 1990. Apple proliferation. In: *Compendium of apple and pear diseases*. St Paul, Minnesota, USA: American Phytopathological Society, 67-68.
- [22]Seidl V, 1980. Some results of several years' study on apple proliferation disease. *Acta Phytopathologica Academiae Scientiarum Hungaricp*, 15:241-245

- [23] Smart CD, Schneider B, Blomquist CL, Guerra LJ, Harrison NA, Ahrens U, Lorenz KH, Seemller E, Kirkpatrick BC, 1996. Phytoplasma-specific PCR primers based on sequences of the 16S-23S rRNA spacer region. Applied and Environmental Microbiology, 62(8):2988-2993; 33 ref.
- [24] Tedeschi R, Alama A, 2004. Transmission of apple proliferation phytoplasma by *Cacopsylla melanoneura* (Homoptera: Psyllidae). *Journal of Economic Entomology*, 97(1):8-13.
- [25] Tedeschi R, Visentin C, Alama A, Bosco D, 2003. Epidemiology of apple proliferation (AP) in northwestern Italy: evaluation of the frequency of AP-positive psyllids in naturally infected populations of *Cacopsylla melanoneura* (Homoptera: Psyllidae). *Annals of Applied Biology*, 142(3):285-290.
- [26] Weisburg WG, Tully JG, Rose DL, Petzel JP, Oyaizu H, Yang D, Mandelco L, Sechrest J, Lawrence TG, Etten Jvan, Maniloff J, Woese CR, 1989. A phylogenetic analysis of the mycoplasmas: basis for their classification. *Journal of Bacteriology*, 171 (12):6455-6467; 50 ref.
- [27] Myrta A. Bazat e virusologjisë
- [28] Latif R, Susuri G, Myrta A. Sëmundjet e pemëve frutore dhe të hardhisë

**STUDIMI I KULTIVARËVE TË RRINJ TË PATATES NË RRETHIN E KORÇËS,
ME QËLLIM RAJONIZIMI
STUDY OF NEW POTATO CULTIVARS IN KORÇA REGION, WITH GOAL
REGIONALIZATION**

BESNIK SKËNDERASI*, ROBERT NAÇI, KRISTAQ TENEQEXHI
Universiteti Fan S.Noli, Fakulteti i Bujqësisë, Korçë,
SHQIPËRI
E-mail besniksk@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Materiali trajton studimin e 10 kultivarëve të rinj të patates nga këndvështrimi i vlerave agronomike, kulinare dhe industriale.

Kultivarët e patates i janë nënshtruar të 3 tipave të provës, asaj fushore, gjysëmlaboratorike dhe laboratorike.

Është përdorur skema e bllokut të randomizuar, me 10 variante, me dy kate, në katër përsëritje. Nëpërmjet përshkrimit dhe vrojtimit fushor janë përcaktuar karakteristikat biomorfologjike të kultivarëve si: Periudha bimore e kultivarëve, dinamika e rritjes së bimëve, karakteristikat morfologjike dhe kimike të kultivarëve, numri i kërcejve dhe tuberëve për bimë, shkalla e prekjes nga sëmundjet, klasifikimi sipas madhësisë së tuberit, prodhimi i kultivarëve, cilësitë kimike dhe teknologjike të prodhimit dhe shkalla e manifestimit të sëmundjeve të konservimit. Rezultatet për kultivarët më të mirë i janë nënshtruar përpunimit statistikor. Kultivarët më prodhues dhe që rekomandohen të mbillen në rajonin e Korçës janë: Fabula, Spunta, Agria dhe Madalene.

Agroteknologjia e përdorur është gati ajo që përdoret sot prej fermerëve të motivuar për rendimente mbi mesataren në shkallë rrethi.

Fjalët kyç: *Patate, kultivar, karakteristika biomorfologjike, përpunim statistikor.*

SUMMARY

Article discusses the study of 10 new potato cultivars from agronomic, culinary and industrial values. Potato cultivars were have undergone to three types of test, the field, laboratory half and laboratory. It was used randomized block scheme, with 10 variants, with two floors, in four repetitions. Through the description and field survey are defined biomorphological and chemical characteristics of cultivars such: plant cultivars period, the dynamics of plant growth, morphological characteristics of the cultivars, the number of stalks and tubers for plants, the rate of infection from diseases, classification by size of tubers, production of the cultivars, chemical and technological qualities of production and severity of disease conservation. Results for the best cultivars were subjected to statistical analysis. The most productive cultivars and that recommended planted in Korca region are: Fabula, SPUNTA, Agria and Madalene. Agro technology used is about what is used today by farmers motivated for yielding over average at the district level

Key words: *Potatoes, cultivar, bio morphological features, statistical processing.*

I. HYRJE

Patatja në shkallë vendi kultivohet në një sipërfaqe prej 12 000 ha. Ajo ka një plasticitet të lartë ekologjik dhe kultivohet nga zonat e ultë bregdetare deri në lartësitë 1200 m mbi nivelin e detit. Rendimenti mesatar në shkallë vendi shkon 150-200 kv/ha. Rajoni i Korçës dallohet për kultivimin në patates së vonshme me një sipërfaqe prej 2000 ha dhe rendiment mesatar 250-350 kv/ha, si dhe ka kushte të favorshme për shumëzimin e farës së patates.

Në rritjen e prodhimit të patates përveç faktorëve të tjerë, një ndikim të madh ka gjetja, studimi dhe futja në prodhim e kultivarëve të rinj me cilësi të larta prodhuese dhe kimiko-teknologjike.

Prodhimi bujqësor kërkon vazhdimisht kultivarë të rinj më prodhues dhe me një gamë të gjerë përdorimi, që t'u përshtaten më mirë kushteve klimatike – tokësore të zonës dhe kërkesave gjithnjë në rritje të tregut dhe konsumatorëve.

Për këtë qëllim ngrihet dhe studimi krahasues i kultivarëve të patates për të përcaktuar kultivarët më të mirë në kushtet e zonës së Korçës dhe zonës lindore e veri-lindore të vendit.

II. MATERIALET DHE METODA

Studimi është kryer gjatë viteve 2010 - 2012 në tokat e QTTB Korçë në parcelat Nr. 7 dhe 8. Me përbërje mekanike SAM. Studimi është kryer sipas skemës të bllokut të randomizuar me 4 përsëritje. Në studim janë vendosur 10 kultivarë me riprodhime të njëjtë, klasa A me farë të marrë nga importi. Sipërfaqja e çdo varianti ka qenë 21 m² me dimensione 6 x 3.5 m. Në çdo variant u vendosën 5 reshta.

Distancat e mbjelljes janë 70 x 30 cm. Madhësia e farës së mbjellë është 35-45 mm.

Gjatë studimit janë kryer matje, numërim, peshime, vrojtime për kalimin e fazave të zhvillimit të bimëve, dinamikën e rritjes së tyre, prekjen nga sëmundjet, karakteristikat dhe cilësitë e prodhimit etj.

Skema e eksperimentit (Bllok i randomizuar)

P ₁		P ₂	
1	6	2	8
9	2	7	5
5	10	3	6
8	3	1	4
4	7	9	10
P ₃		P ₄	
3	1	6	3
10	8	2	7
2	4	4	9
7	9	8	1
5	6	10	5

Agroteknika e zbatuar.

Gjatë studimit është zbatuar agroteknika sipas metodikës së hartuar që në fillim hallkat e së cilës paraqiten më poshtë.

Nr.	Punimet e kryera	Cilësia e punimeve	Datat e punimeve sipas viteve		
			2010	2011	2012
1.	Parabima		Elb	Grurë	Grurë
2.	Plugimi i parë	26-30 cm	Vjeshtë 2009	Vjeshtë 2010	Vjeshtë 2011
3.	Plugimi i dytë	20-26 cm	27/4./09	16/4/10	20/4/11
4.	Plehërimi bazë	4 kv/ha DAP, dhe 2 kv/ha K ₂ SO ₄	25/4	14/4	17/4
5.	Frezim		29/4	20/4	20/4
6.	Hapje brazda me kultivator	Distanca 70 cm	30/4	24/4	23/4
7.	Piketimi i fushës	Sipas skicës	30/4	24/4	23/4
8.	Dezinfektimi i tokës	30 kg/ha Forate, me shpërndarje	30/4	24/4	23/4
9.	Mbjellja e fushës	Me dorë 30 cm brenda reshtit	30/4	24/4	23/4
10.	Mbulimi i tuberëve	Me shatë në thellësi 6 – 8 cm	30/4	24/4	23/4
11.	Prashitja e parë me shatë	12-15 cm	10/6	5/6	27/5
12.	Plehërim plotësues, me 2 kv/ha nitrat amoni	Me shpërndarje me dorë		5/6	27/5
13.	Mbushja e bimëve me shatë		23/6	20/6	17/6
14.	Trajtime kundër buburrecit	Kalipso 0.04 %, 500 l/ha sol.	19/6	10/6	5/6
17.	Trajtim kundër buburrecit	Kalipso 0.004 % ,Ridomil 0.2 %	26/7	15/7	9/7
18.	Ujitja e bimëve me impiant	400 m ³	13/7	10/7	6/7
19.	Ujitja e bimëve me impiant	400 m ³	24/7	22/7	19/7
20.	Ujitja e bimëve me impiant	40 mm shi	-	5/8	2/8
21.	Pastrime	Me dorë	19/7	21/7	18/7
22.	Pastrime	Me dorë	15/8	25/8	15/8
23.	Vjelja e eksperimentit	Shkulja e mbledhja me dorë	1/10	30/9	24/9

III. REZULTATET DHE DISKUTIME

Gjatë studimit janë kryer vrojtime për periudhën bimore të kultivarëve, dinamikën e rritjes së bimëve, shkallën e prekjës nga sëmundjet e ndryshme, vlerën ekonomike të prodhimit dhe rendimentin. Me interes janë gjithashtu analizat për përbërjen kimike dhe cilësitë teknologjike të tuberëve.

1. Periudha bimore e kultivarëve

Është përcaktuar duke kryer vrojtime vizuale çdo 3 ditë mbi kalimin e fazave të zhvillimit të bimëve në përsëritjen e parë.

Nr.	Kultivarët	Periudha bimore (Ditë) (Mbirje-Pjekje)			Mesatare
		2010	2011	2012	
1.	Agria	103	96	107	102
2.	Fabula	103	98	115	105
3.	Aida	98	90	107	98
4.	Spunta	97	97	107	100
5.	Alova	95	98	104	99
6.	Madalene	103	99	110	104
7.	Arnova	100	98	104	101
8.	Matador	98	98	107	101
9.	El Pais	99	92	115	102
10.	Impala	96	98	107	100

Nga të dhënat del se të gjithë kultivarët e plotësojnë ciklin e tyre jetësor në kushtet e zonës së Korçës brenda muajit shtator. Kultivarë më të hershëm paraqiten Aida, Alova, me 98-99 ditë. Pjesa më e madhe e kultivarëve sillen si gjysmë të hershëm si Spunta, Fabula, Agria, Impala, Madalen me cikël 100 – 105 ditë.

2. Dinamika e rritjes së bimëve.

Matjet janë kryer mbi 10 bimë në reshtët e mesit të parcelës, të përcaktuara me piketa, në përsëritjen e II dhe të III, që janë përsëritje të përkundrejt në eksperiment, çdo 10 ditë duke filluar nga mbarimi i mbirjes deri në përfundim të lulëzimit. Të dhënat e këtyre matjeve për lartësinë mesatare të bimëve për çdo kultivar, paraqiten në pasqyrat e mëposhtme.

Nr.	Kultivarët	Lartësia e bimëve (Cm)			Mesatare
		2010	2011	2012	
1.	Agria	53.8	70	65	63.9
2.	Fabula	65.4	72	70,4	69.3
3.	Aida	41.3	60	62,5	54.6
4.	Spunta	41.3	73	55.5	56.6
5.	Alova	68.6	54	47	56.5
6.	Madalene	48.8	60	55.3	54.7
7.	Arnova	60.5	66	57.3	61.3
8.	Matador	81.9	78	53	70.9
9.	El Pais	52.1	62	62	58.7
10.	Impala	45.2	65	53.5	54.6

Nga këto të dhëna del se kultivarët Matador, Fabula, Agria, Arnova japin bimë me zhvillim të madh me lartësi mbi 60 cm, ndërsa kultivarët e tjerë japin bimë me zhvillim mesatar, me lartësi 50 – 60 cm.

Nr.	Kultivarët	Dinamika e rritjes ditore të bimëve (Cm)			Mesatare
		2010	2011	2012	
1.	Agria	0.8	2.0	1,28	1.36
2.	Fabula	1.2	1.8	1,98	1.46
3.	Aida	0.8	1.6	1.1	1.17
4.	Spunta	0.8	1.9	1.01	1.24
5.	Alova	0.9	1.3	0.81	1.00
6.	Madalene	1.2	1.5	0.9	1.20
7.	Arnova	1.3	1.8	0.91	1.35
8.	Matador	1.5	2.0	1.02	1.51
9.	El Pais	1.2	1.4	1.25	1.28
10.	Impala	1.2	1.6	0.83	1.21

Dinamika e rritjes është llogaritur për periudhën mbirje-lulëzim. Dinamikë më të lartë të rritjes ditore ka kultivari Matador me rritje ditore prej 1.5 cm. Me përjashtim të kultivarëve Alova, Aida, Madelene dhe Impala që kanë dinamikë të vogël të rritjes ditore, kultivarët e tjerë si Agria, Fabula, Spunta, Arnova etj. kanë dinamikë mesatare të rritjes ditore të bimëve.

3. Karakteristikat morfologjike të kultivarëve.

Përshkrimet fushore janë kryer, më 5 qershor, më 5 korrik dhe në kohën e vjeljes, më 18 shtator. Të dhënat për këto vrojtime paraqiten si vijon

Nr.	Kultivarë	Karakteristikat morfologjike të bimëve të kultivarëve				
		Qëndrimi i kërcejve	Madhësia e gjetheve	Ngjyra e gjetheve	Ngjyra e lules	Ngjyra e lëvores
1.	Agria	Drejtë	Mesatare	Gjelbër,çelur	Bardhë	Verdhë
2.	Fabula	Me kënd	Mes. Të mëdha	Gjelbër-çelur	Vjollcë,çelur	Verdhë, lëmuar
3.	Aida	Drejtë	Mesatare	Gjelbër errët	Bardhë	Verdhë
4.	Alova	Drejtë	Mesatar, mëdha	Gjelbër, errët	Vjollcë	Verdhë
5.	Dita	Drejtë	Mesatare	Gjelbër çelur	Bardhë	Verdhë
6.	Modalen	Kënd	Mesatare, mëdha	Gjelbër, çelur	Bardhë	Verdhë
7.	Arnova	Drejtë	Mesatare, mëdha	Gjelbër, errët	Bardhë	Verdhë
8.	Matador	Kënd	Mesatare,mëdha	Gjelbër,çelur	Bardhë	Verdhë
9.	Le Pais	Drejtë	Mesatare,mëdha	Gjelbër,errët	Bardhë	Verdhë
10.	Impala	Drejtë	Mesatare	Gjelbër, çelur		Verdhë

4. Numri i kërcejve dhe tuberëve për bimë.

Për këtë qëllim është kryer numërimi i kërcejve në 10 bimë në dy përsëritjet e përkundrejt (përsëritja e II dhe e III), pikërisht mbi bimët ku është kryer dinamika e rritjes. Numërimi i tyre është kryer në fazën e lulëzimit të bimëve. Ndërsa numri i tuberëve është kryer po mbi këto bimë para vjeljes së eksperimentit. Të dhënat paraqiten si më poshtë :

Nr	Kultivarët	Numri mesatar i kërcejve për bimë				Numri mesatar i tuberëve për bimë				Raport i Tubera : Kërcej
		2010	2011	2012	Mes	2010	2011	2012	Mes	
1.	Agria	2.7	4.1	3,75	3.52	10.4	7.9	6,8	8.37	2.38
2.	Fabula	3.3	4.0	2,4	3.23	10.0	7.3	6,4	7.9	2.47
3.	Aida	3.7	4.1	3.5	3.77	9.6	9.4	6.1	8.37	2.22
4.	Spunta	2.8	6.5	4.2	4.5	10.7	12.2	8.1	10.33	2.29
5.	Alova	3.6	3.0	3.6	3.4	10.9	7.9	6.85	8.55	2.51
6.	Madalene	3.9	3.6	4.3	3.95	10.1	10.4	9.6	10.0	2.53
7.	Arnova	3.1	2.9	3.4	3.15	10.8	15.9	5.8	10.85	3.44
8.	Matador	5.2	6.0	5.25	5.62	10.9	10.6	11.1	10.85	1.93
9.	El Pais	3.5	2.8	3.5	3.15	10.2	10.8	9.7	10.25	3.25
10.	Impala	5.0	5.2	4.9	5.05	9.5	11.6	7.3	9.45	1.87

Për numrin e kërcejve të formuar dallohen kultivarët Matador, Impala, Spunta që kanë mbi 4 kërcej për një bimë. Kultivarët e tjerë formojnë më pak se 4 kërcej për bimë. Ndërsa për numrin e tuberëve për bimë dallohen kultivarët Arnova, Matador, El Pais, Madelene dhe Spunta me mbi 10 tuberë për bimë. Kultivarët e tjerë kanë formuar nga 7 – 10 tuberë për bimë. Kultivarët Arnova, El Pais, dallohen për numrin e tuberëve për 1 kërcell, duke e pasur

këtë tregues nga 3.1-3,5 tuberë për kërcell. Tregues më të ulët në këtë drejtim ka kultivari Matador.

5. Shkalla e prekjës nga sëmundjet.

Për këtë janë kryer vërtetime vizuale mbi të gjitha bimët e çdo kultivari, në të katër përsëritjet dhe janë shënuar bimët me prekje nga sëmundjet e ndryshme, Vërtetimi është kryer në fazën e lulëzimit të bimëve kryesisht për sëmundjet virusale dhe ato kërpudhore si vrugu, alternaria, vyshkja kërpudhore, rizoktonia etj.

Nr.	Kultivarët	Shkalla e prekjës nga Viruset në %			
		2010	2011	2012	Mes
1.	Agria	1.7	4.1	1.9	2.6
2.	Fabula	0.0	1.4	0.0	0.5
3.	Aida	5.7	1.0	0.0	2.2
4.	Spunta	0.0	3.1	0.0	1.0
5.	Alova	0.0	8.5	4.8	4.4
6.	Madalene	0.5	1.1	0.0	0.5
7.	Arnova	2.2	4.7	0.0	2.3
8.	Matador	5.9	7.9	4.1	6.0
9.	El Pais	3.0	3.8	2.5	3.1
10.	Impala	7.2	11.5	3.1	7.3

Nga këto vërtetime del se prekja nga sëmundjet virusale ka qenë e ulët, nën 10 %, gjë që vjen dhe nga fakti se fara e kultivarëve ka qenë e Klasës A, e cila ka prekje të ulët nga viruset. Nga viruset më tepër është manifestuar virusi i përdredhjes së gjetheve (PLRV), pastaj vjen virusi Y i patates (PVY) dhe më pak Mozaikët (PVX, PVM, PVS etj.). Nga kultivarët në eksperimentim më tepër janë prekur kultivarët Impala, Matador, Alova, me mbi 3 % prekje të bimëve. Kultivarët e tjerë kanë prekje shumë të ulët. Gjatë studimit janë vërtetuar prekje të lehta dhe mesatare nga vrugu dhe Alternaria, kryesisht gjatë vitit 2010. Në vitin 2011, tek kultivari Arnova ka pasur rreth 11 % prekje nga Vyshkja kërpudhore.

6. Klasifikimi sipas madhësisë së tuberit

Kjo shpreh raportin që zënë fraksionet e tuberëve në prodhimin e përgjithshëm. Për të përcaktuar këtë tregues, para vjeljes së eksperimentit, në dy përsëritjet e përkundrejt (Përsëritja e II dhe e III) është marrë prodhimi i 10 bimëve (bimëve të dinamikës së rritjes) për çdo kultivar dhe është ndarë në 3 fraksione sipas madhësisë : tuberë nën 35 mm (jashtë standardit), tuberë 35 – 55 mm (për farë) dhe tuberë mbi 55 mm (për konsum). Çdo fraksion është peshuar veçan dhe mbi këtë bazë është përcaktuar përqindja që zë secili fraksion në prodhimin e përgjithshëm. Të dhënat paraqiten si më poshtë :

Nr.	Kultivarët	Klasifikimi sipas madhësisë së tuberit në %			Pesha mesatare e 1 tuberit (Në gram)
		Tuberë nën 35 mm	Tuberë 35 – 55 mm	Tuberë mbi 55 mm	
1.	Agria	6.1	40.6	53.7	96.8
2.	Fabula	4.2	29.7	66.1	134.4
3.	Aida	8.0	37.2	54.8	88.6

4.	Spunta	7.9	36.9	55.2	95.5
5.	Alova	9.1	42.8	48.1	92.3
6.	Madalene	6.9	39.0	54.1	96.2
7.	Arnova	11.7	43.8	44.5	83.1
8.	Matador	8.6	44.6	46.8	88.6
9.	El Pais	12.6	39.8	47.6	89.5
10.	Impala	12.2	42.5	45.3	87.0

Nga këto analiza del se kultivarët Fabula, Agria, Aida, Spunta, Madalena japin mbi 50 % të prodhimit të tyre me tuberë të mëdhenj. Kultivarët El Pais, Impala, Arnova, japin prodhim me shumë tuberë të vegjël, nën 35 mm që janë jashtë standardit. Kultivarët Matador, Arnova, dhe Alova dallohen për prodhimin e tuberëve mesatarë, 35 – 55 mm, që janë të përshtatshëm për farë.

Për madhësinë e tuberëve dallohet kultivari Fabula, me tuberë me peshë mesatare mbi 100 gram.

7. Prodhimi i kultivarëve.

Vjelja e eksperimentit është kryer në pjekjen teknike të tuberëve. Vjelja dhe grumbullimi i prodhimit është bërë veçan për çdo kultivar e përsëritje dhe po kështu dhe peshimi. Mbi bazën e prodhimit dhe sipërfaqes vjelëse është llogaritur rendimenti i kultivarëve, i cili paraqitet në pasqyrën e mëposhtme

Nr.	Kultivarët	Rendimenti Kv/Ha			$\sum v$	Mesatare Kv/Ha	Në % Ndaj Dëshmuesit
		2010	2011	2012			
1.	Agria	362	377	305	1044	348	100.0
2.	Fabula	405	398	378	1181	393.6	113.0
3.	Aida	328	373	331	1032	344	98.8
4.	Spunta	343	421	300	1064	354.6	101.9
5.	Alova	291	417	263	971	323.6	93
6.	Madalene	300	411	350	1061	353.6	101.6
7.	Arnova	321	291	225	837	279	80.2
8.	Matador	331	372	277	980	326.6	93
9.	El Pais	292	405	305	1002	334	96
10.	Impala	273	361	272	906	302	86.8
	SP	3246	3826	3006	10078	-	-
	\bar{x}		-	-	-	335.9	-

Pas llogaritjes së rendimentit të kultivarëve u krye përpunimi statistikor i materialit shifër me metodën e analizës së variacionit.

Tabela e analizës dispersive (variancave)

Nr	Burimi ndryshueshmërisë	Shkallët e lirisë	Shuma kuadratike	Dispersion	Vlerat e F		
					Faktike	Teorike	
						0.95	0.99
1	Përsëritjet	2	35546.67	17 773.33	17.40	4.18	2.60
2	Variantet	9	26526.53	2947.39	2.90	2.3	2.10
3	Gabimi	18	18394.67	1021.14	-	-	-
4	Totali	29	80467.84	-	-	-	-

DMV_(0.05) = 52 DMV_(0.01) = 72.8 Cv=7.7 %.

Meqenëse vlerat e F faktike janë më të larta se vlerat e F teorike për të dy nivelet propabilitare 95% dhe 99% ato kanë ndryshime të vërtetuara statistikiisht.

Nga përlllogaritja e vlerave të DMV për të dy nivelet propabilitare si për përsëritjet ashtu edhe për variantet rezultatet paraqiten në tabelën e krahasimit. Kur vlerat e DMV për të dy nivelet propabilitare janë më të vogla se vlerat e diferencave midis varianteve dhe midis përsëritjeve, ato vërtetohen statistikiisht.

Nga përpunimi statistikor del se koeficienti i variacionit është 7.75, gjë që tregon se saktësia e provës është e kënaqshme, kur dihet se për pataten ky tregues mund të shkojnë deri në 15%.

Tabela e krahasimit ndërmjet varieteteve

Variantet		Agria		Fabula		Aida		Spunta		Alova		Madalen		Arnova		Matador		El-pais		Impala	
		1		2		3		4		5		6		7		8		9		10	
		0.95	0.99	0.95	0.99	0.95	0.99	0.95	0.99	0.95	0.99	0.95	0.99	0.95	0.99	0.95	0.99	0.95	0.99	0.95	0.99
1	Agria	x	x	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	+	-	-	-	-	-	-
2	Fabula	-	-	x	x	-	-	-	-	+	-	-	-	+	+	+	-	+	-	+	+
3	Aida	-	-	-	-	x	x	-	-	-	-	-	-	+	-	-	-	-	-	-	-
4	Spunta	-	-	-	-	-	-	x	x	-	-	-	-	+	+	-	-	-	-	-	-
5	Alova	-	-	-	-	-	-	-	-	x	x	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
6	Madalen	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	x	x	+	+	-	-	-	-	-	-
7	Arnova	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	x	x	-	-	-	-	-	-
8	Matador	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	x	x	-	-	-	-
9	El-pais	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	+	-	-	-	x	x	-	-
10	Impala	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	x	x

Sikundër shihet nga kjo tabelë rezultatit më të lartë që vërtetohet statistikiisht për të dy nivelet propabilitare e jep kultivari Fabula, krahasuar me të gjitha varietetet në studim. Pas tij rreshtohet kultivarët Spunta dhe Madalen të cilët ja kalojnë për nga produktiviteti dëshmuesit.

- Nga ky krahasim del se kultivari më i mirë paraqitet Fabula e cila i kalon për të dy nivelet 95% (52) dhe 99% (72.8), kultivarët Arnova dhe Impala dhe vetëm për nivelin 95% kultivarët Alova dhe El pais.

-Ndërkohë, të gjithë kultivarët e tjerë të radhitur pas kultivarit Fabula, janë në një nivel përsa i përket prodhimit, sepse diferencat e tyre nuk vërtetohen nga ana statistikore.

- Kultivarët, Arnova, Impala, kanë dhënë rendimente shumë të ultë, që nuk mund të merren në konsiderate.

8. Cilësitë kimike dhe teknologjike të prodhimit.

Për këtë qëllim pas vjeljes së prodhimit janë kryer analizat e tuberëve për përmbajtjen e lëndës së thatë dhe amidonit. Analiza për amidonin është kryer me aparatit e amidonit ne 3 kampione për çdo kultivar. Ndërsa lënda e thatë është përcaktuar me analiza laboratorike. Të dhënat paraqiten si më poshtë :

Nr.	Kultivarët	Përmbajtja e Lëndës së Thatë %	Përmbajtja e amidonit %
1.	Agria	18.5	11.7
2.	Fabula	19.8	13.2
3.	Aida	18.5	13.9
4.	Spunta	18.9	13.9
5.	Alova	18.6	13.2
6.	Madalene	18.5	12.6
7.	Arnova	19.2	12.3
8.	Matador	19.7	12.6
9.	El Pais	19.0	13.7
10.	Impala	19.2	12.7

Nga këto të dhëna del se kultivarët kanë përmbajtje mesatare të lëndës së thatë që luhetet nga 18 – 20 % dhe diferencat ndërmjet kultivarëve janë të vogla, 0.2 – 1.4 %. Kultivarët ne përgjithësi kanë përmbajtje të moderuar amidoni, që shkon 12 – 14 %.

9. Shkalla e manifestimit të sëmundjeve të konservimit.

Për këtë qëllim janë vendosur pas vjeljes nga 2 arka me tuberë për çdo kultivar, (100 tuberë) në magazina për konservim gjatë dimrit dhe në muajin prill të vitit pasardhës janë kryer vrojtime për manifestime të fenomenit të fijeimit, bulazhit dhe sëmundjeve të kalbëzimit. Të dhënat janë për vitet 2010 dhe 2011, mbasi për vitin 2012.

Nga këto vrojtime kanë dalë rezultatet si më poshtë :

Nr.	Kultivarët	Shkalla e manifestimit të sëmundjeve (%)		
		Fijejimi	Bulazhi	Kalbëzimi i Thatë
1.	Agria	13.6	5.4	2.6
2.	Fabula	3.3	2.1	9.3
3.	Aida	7.9	5.5	3.1
4.	Spunta	3.7	2.5	5.4
5.	Alova	4.7	0.0	1.7
6.	Madalene	13.1	0.0	3.6
7.	Arnova	18.2	0.8	9.3
8.	Matador	12.5	1.2	7.5
9.	El Pais	3.8	3.3	6.6
10.	Impala	13.3	4.3	1.3

Nga këto analiza rezulton se kultivarët Arnova, Agria, Impala, Madelene, Matador, kanë manifestim të lartë të fenomenit të fijejimit, mbi 10 % të tuberëve të vendosur për konservim. Shkallë më të ulët të këtij fenomeni manifestojnë kultivarët, Fabula, Spunta dhe El Pais, me nën 4 % të tuberëve. Kultivarët e tjerë manifestojnë shkallë mesatare të këtij fenomeni.

Bulazhi ka pasur shkallë të ulët manifestimi. Vetëm kultivarët Aida, Agria, Impala, El Pais, Spunta, Fabula dhe Matador, kanë manifestim deri 5.5 % të tij.

Kalbëzimi i thatë, gjithashtu ka pasur manifestime të ultë deri mesatare. Vetëm kultivarët Fabula, Arnova, Matador, El Pais, Spunta kanë prekje mbi 5 %, që është jashtë standardit për farën e patates. Kultivarët e tjerë kanë pasur shkallë të ulët të prekjes nga kjo sëmundje e konservimit.

IV. PËRFUNDIME

1. Të gjithë kultivarët e vënë në studim e plotësojnë periudhën e tyre bimore në kushtet e zonës së Korçës, gjatë muajit shtator dhe kanë periudhë bimore nga 98 – 107 ditë.

2. Kultivarët Matador, Fabula, Agria, Arnova japin bimë me zhvillim të madh me lartësi mbi 60 cm. Kultivarët, ndërsa kultivarët e tjerë japin bimë me zhvillim mesatar, me lartësi 50 – 60 cm.

3. Lidhur me dinamikën e rritjes ditore të bimëve vihet re që të gjithë kultivarët e kanë intensitetin e rritjes më të lartë në fazat e para të zhvillimit të tyre, ndërsa më vonë ky intensitet i rritjes së bimëve në lartësi bie. Dinamikë më të lartë të rritjes ditore ka kultivari Matador me rritje ditore prej 1.5 cm. Me përjashtim të kultivarëve Alova, Aida, Madelene dhe Impala që kanë dinamikë të vogël të rritjes ditore, kultivarët e tjerë si Agria, Fabula, Spunta, Arnova etj. kanë dinamikë mesatare të rritjes ditore të bimëve.

4. Për numrin e kërcjeve të formuar dallohen kultivarët Matador, Impala, Spunta që kanë mbi 4 kërcje për një bimë. Ndërsa për numrin e tuberëve për bimë dallohen kultivarët Arnova, Matador, El Pais, Madelene dhe Spunta me mbi 10 tuberë për bimë

5. Kultivarët Arnova, El Pais, dallohen për numrin e tuberëve për 1 kërcell, duke e pasur këtë tregues mbi 3.5 tuberë për kërcell. Tregues më të ulët në këtë drejtim ka kultivari Matador, dhe Impala nën 2 tuberë për kërcell.

6. Kultivarët që janë prekur më tepër nga sëmundjet virusale, janë kultivarët Impala, Matador, Alova, me mbi 3 % prekje të bimëve. Gjatë studimit janë vërtetuar prekje të lehta dhe mesatare nga vrugu dhe Alternaria, kryesisht gjatë vitit 2010. Në vitin 2011, tek kultivari Arnova ka pasur rreth 11 % prekje nga Vyshkja kërpudhore.

7. Kultivarët Fabula, Agria, Aida, Spunta, Madalena, japin mbi 50 % të prodhimit të tyre me

tuberë të mëdhenj, me kalibër mbi 55 mm. Kultivarët El Pais, Arnova, japin prodhim me shumë tuberë të vegjël, nën 35 mm që janë jashtë standardit. Kultivarët Matador, Arnova, Alova, dallohen për prodhimin e tuberëve mesatarë, 35 – 55 mm, që janë të përshtatshëm për farë.

8. Për madhësinë e tuberëve dallohet kultivari Fabula, me tuberë me peshë mesatare mbi 100 gram. Kultivarët Arnova, Madalena kanë dhënë tuberë me peshë të vogël, nën 85 gram, ndërsa kultivarët e tjerë japin tuberë me madhësi mesatare, 80 – 100 gram.

9. Përsa i përket rendimentit del se kultivari më i mirë paraqitet Fabula e cila i kalon të gjithë kultivarët e tjerë dhe diferencat midis tyre janë të vërtetuara në shkallën e sigurisë 95 %. Por ky kultivar formon një grup së bashku me kultivarët Spunta, Madelene, Agria, Aida, El pais sepse diferencat ndërmjet tyre nuk janë të vërtetuara nga ana statistikore. Ndërkohë, të gjithë kultivarët e tjerë të radhitur pas kultivarit Fabula, janë në një nivel përsa i përket prodhimit, sepse diferencat e tyre nuk vërtetohen nga ana statistikore. Kultivarët Arnova, Impala, kanë dhënë rendimente shumë të ultë, që nuk mund të merren në konsideratë.

10. Kultivarët kanë përmbajtje mesatare të lendes se thate që luhatet nga 18 – 20 % dhe diferencat ndërmjet kultivarëve janë të vogla, 0.2 – 1.4 %. Kanë përmbajtje të moderuar të amidonit 12-14 %.

11. Kultivarët Arnova, Agria, Impala, Madelene, Matador, kanë manifestim të lartë të fenomenit të fijeimit, mbi 10 % të tuberëve të vendosur për konservim. Shkallë më të ulët të këtij fenomeni manifestojnë kultivarët Fabula, Spunta dhe El Pais, me nën 4 % të tuberëve. Kultivarët e tjerë manifestojnë shkallë mesatare të këtij fenomeni.

12. Bulazhi ka pasur shkallë të ulët manifestimi. Vetëm kultivarët Aida, Agria, Impala, El Pais, kanë manifestim mbi 3 % të tij.

13. Kalbëzimi i thatë, gjithashtu ka pasur manifestime të ultë deri mesatare. Vetëm kultivarët Fabula, Arnova, Matador, El Pais, Spunta kanë prekje mbi 5 %, që është jashtë standardit për farën e patates. Kultivarët e tjerë kanë pasur shkallë të ulët të prekjes nga kjo sëmundje e konservimit.

Për vetë cilësitë e tyre të mira prodhuese-ekonomike, Kultivarët: Fabula, Spunta, Agria, Madalen të zënë vendin kryesor në strukturën e mbjelljeve të kësaj bime.

V. REFERENCA

1. Patatja. Eqerem Meçollari, Avni Salceni, Fadil Selaci. Viti 2002.
2. Eqerem Meçollari, Besnik Skënderasi. "Dëmtuesit dhe sëmundjet e patates". Viti 2005.
3. Teknologjia e patates. Eqerem Meçollari, Robert Naçi, Trajanka Shumka. Viti 2010.
4. Ministria e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit. Annual vjetor 2012.
5. Jablouski, K. 1990. The effect of planting depth on the yield, position of daughter tuber in the ridge and harvest parameters at inter-row spacing of 62.5 cm and 75 cm. Buletyn instytutu Zeimniaka 36: 61-72 (Field Crop Absts. 43(2): 1315, 1990).
6. Z Bánfalvi, A Molnár, Z Kostyál, L Lakatos. Attila Molnár Remove suggestion Agricultural Biotechnology Center, Gödöllő, Hungary. Acta Biologica Hungarica (Impact Factor: 0.56). 02/1997; 48(1):77-86. Source: PubMed. Comparative studies on potato tuber development using an in vitro tuber induction system.
7. M.A. Pervez¹, F.M. Tahir², M.A. Tariq³ & R. Jawad⁴. Comparative studies of some exotic potato cultivars. Department of Horticulture, University of Agriculture, Faisalabad, Ayub Agri. Res. Institute, Faisalabad. "College of Agriculture, D.G. Khan. 1999.
8. Pieterse, b.j. and Theron, d.j. (2003). Seed potato quality. in niederwiesser, j.g. (ed.) Guide to potato production in south africa. arc roodeplaat.
9. Tony winch (2006). Growing food: a guide to food production. Springer science+business media. isbn 1-4020-6624-4.

10. Lorena mancerero. February 2007. Fao.Esae-cip project with contributions from producers participating in 3 experiences in the central ecuadorian sierra region.
11. "International year of the potato 2008 – the potato". United nations food and agricultural organisation. 2009. retrieved 26 october 2011.
6. Production, processing and marketing of potato in karnataka – an economic analysis Shrinivas Bhajantri mba 925. Project report submitted to the university of agricultural sciences, bangalore in partial fulfillment of the requirements for the degree of master of business administration (agribusiness management) Bangalore july, 2011
12. He, Zhongqi, Larkin, Robert, Honeycutt, Wayne (eds.). 2012. Sustainable potato production: global case studies. Eight case studies from both developed and developing countries.

**STUDIMI I KARAKTERISTIKAVE BIO – AGRONOMIKE TË DISA GENOTIPEVE
TË RINJ TË QEPËS NË ZONËN E DEVOLLIT
STUDY OF BIOLOGICAL AND AGRONOMIC TRAITS OF SOME NEW ONION
GENOTYPES IN DEVOLL AREA**

ZENI MYRTOLLARI¹, AVNI SPAHOLLI²

¹FAN S. NOLI University of Korça, Albania, PhD Student

²FAN S. NOLI University of Korça, Albania

zenimyrtoollari@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Në grupin e bimëve me pllenim të kryqëzuar, qepa zë një vend të rëndësishëm jo vetëm për nga prodhimtaria, por edhe për nga llojshmëria në përdorim si perime në industrinë kulinare. Ajo kap vendin e katërt në prodhimin botëror të perimeve me një sipërfaqe totale prej mbi 1 milion Ha dhe një prodhim total mbi 32 milion ton. Kultivimi i kësaj bime perimore shtrihet në kufijtë rajonalë 10° – 65° të gjerësisë gjeografike. Materiali që po paraqesim pasqyron një studim të natyrës aplikative me karakter bio – agronomik të 5(pesë) genotipeve të qepës me origjinë nga rajone të përafërta pedo – klimatike me atë të Devollit, të cilët krahasohen me ekotipin kaq mirë të rajonizuar “MIRASI”, i cili zë vendin kryesor jo vetëm në Devoll, por edhe më gjerë. Faktori i vetëm i ndryshueshëm i këtij studimi, është genotipi, ndërkohë kur të gjithë elementët e tjerë të agroteknologjisë së zbatuar në këtë studim janë të pandryshueshëm. Në këtë studim, kemi marrë në konsideratë karakteristikat e bimës së qepës si: bimë allogame, me cikël vegjetativ 2 – 3 vjeçar, me fotoperiodizëm specifik, bimë me fenomen të pastër protandrie. Parametri agronomik është vlerësuar në ton/Ha për çdo përsëritje, nga ku është kryer dhe përpunimi statistikor i materialit shifër për të dy nivelet probabilitare sipas rregullave që përcakton blloku i randomizuar. Rezulton se nivelin më të lartë produktiv e ka kultivari MIRASI me 74ton/Ha. Pas tij rreshtohen CANDI me 66ton/Ha, ndërkohë RUBINO me 60,87, GOLD COIN 58,75 dhe VALENCIANO respektivisht me 58ton/Ha. Rendimenti mesatar i fushës eksperimentale, regjistrohet me 63,52ton/Ha, nivel ky më i lartë se 3 kultivarë në studim, ç’ka flet për kapacitete të larta të kultivarit MIRASI dhe CANDI. Koeficienti i variacionit Cv në këtë studim rezulton në vlerën 5,4%, ç’ka flet për një studim me nivel të lartë sigurie. Nga përpunimi statistikor i materialit shifër, pra nga vlerat e F faktike dhe teorike si dhe nga nivelet e DMV to95 dhe to0,99, konstatojmë se midis kultivarëve më të mirë në produktivitet MIRASI dhe CANDI ka diferenca të vërtetuar statistikisht kundrejt të gjithë kultivarëve të tjerë të provës krahasuese.

Fjalët kyçe: *genotipe qepe, nivel probabiliteti, përpunim statistikor, agroteknologji.*

ABSTRACT

Among cross pollinated crops common onion is considered important in relation to its productivity and multifaceted culinary uses. Common onion is ranked fourth in the world production of vegetable crops with 32 million tons, and a total acreage of one million hectares. This crop is cultivated over vast areas that extend between 10-65 degree of geographical latitude. The material introduced here represents the study of biological and agronomic traits of five common onion genotypes originated from areas that are similar to soil and climate conditions of Devoll region where “Mirasi” cultivar is well acclimatized and successfully cultivated by Devoll farmers and adjacent regions. The agronomic techniques applied during the cultivation period were identical for all the tested onion cultivars. The biological characteristics that were monitored during the trial period were the following: allogamy trait, protandry trait, length of life cycle 2-3 years, and photoperiodic reaction. The field trial was realized according to complete randomized designs. Replications made

Eksperimenti është ngritur ne laboratorin e departamentit të Hortikulturës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës gjatë vitit 2015. Në studim u morën katër nivele kripëzimi (0, 2, 4, 6 dhe 8 gr/l NaCl) në tre përsritje. Variantet përbëheshin nga një pjatë petri, në të cilat u vendosën për mbirje nga 15 fara. Farat u vendosën mbi letër filtri dhe u mbuluan me letër filtri të tipit No1 Ëatman. Para vendosjes për mbirje, farat u dizifektuan me tretësirë hipoklorit natriumi 10% dhe më pas u shpëlanë disa herë me ujë të distiluar. Në çdo pjatë u shtua rreth 6 ml tretësirë NaCl sipas përqendrimeve të sipërpërmenduar dhe më pas u mbuluan me kapakët respektivë të puthitur mirë. Pjatat e petrit të përgatitura në këtë mënyrë u vendosën në dhomën e mbirjes dhe rritjes në kushte të temperaturës 25°C dhe lagështi relative 75%. Të dhënat u morrën në ditët në vijim, ndërsa treguesit e marrë në studim ishin si më poshtë:

Përqindja e mbirjes së farave (GP): Duke filluar nga dita e dytë, u bë numërimi i farave të mbira në të njëjtën kohë çdo ditë. Farat konsideroheshin të mbira kur gjatësia e rrënjëzës embrionale kishte një gjatësi mbi 3 mm.

Numërimi i farave të mbira vazhdoi deri sa ne mundëm të numërojmë një numër të madh të farave të mbira, ndërkohë që rezultati përfundimtar u përlllogarit si përqindje e farave të mbira, duke u bazuar tek formula e mëposhtëme:

FM: Ni / N x 100

Ni: numri i farave të mbira deri p.sh. ditën e tetë; N= numri total i farave.

Numri i farave të mbira çdo ditë (FMD): Duke filluar nga dita e dytë, deri në ditën e shtatë, çdo 24 orë u bë numërimi i farave të mbira në të njëjtën orë, sipas formulës së parçaktuar nga Maguire (1962):

$$GR = \sum_{i=1}^n \frac{Si}{Di}$$

FMD: numri i farave të mbira në çdo ditë; Si: numri i farave të mbira në çdo numërim; Di: numri i ditëve deri në numërin n. n: numri i herëve të numërimit.

Indeksi Fuqisë Mbirës (IFM): Ky indeks u përcaktua duke u bazuar në formulën në vijim dhe me ndihmën e metodave të Abdul-baki dhe Anderson [1970]: **IFM** = {përqindja e mbirjes × mesataren e gjatësisë së (rrënjëzave + gjethëzave) mm}/100 .

Në përfundim të eksperimentit, u zgjodhën 10 bimëza nga çdo pjatë petri, të cilat u vendosën në letër filtri për largimin e lagështirës dhe më pas u ndanë veç rrënjëzat dhe veç gjethëzat si dhe u matën gjatësitë e tyre. U përcaktua gjithashtu pesha e njomë e tyre. Bimëzat e çdo përsëritje u bashkuan dhe u vendosën të ndara për tharje në kushte të temperaturës 75°C për 24 orë, për të përcaktuar lëndën e thatë. Të dhënat e mara ju nënshtruan analizës së variancës.

REZULTATET DHE DISKUTIMI



Rezultatet e mara tregojnë se ekzistojnë diferenca të konsiderushme në karakteristikat sasiore dhe cilësore të farave të mbira dhe bimëzave të shkaktuara nga përqëndimet e ndryshme të kripëzimit me NaCl. Bazuar në rezultatet e analizës së variancës, evidentohet fakti se si rezultat i niveleve të ndryshme të stresit kripor, ka diferenca të vërtetuara ndërmjet përqindjes së farave të mbira dhe numrit të farave të mbira çdo ditë. Edhe krahasimi i efekteve të niveleve të ndryshme të kripëzimit në numrin e farave të mbira çdo ditë dhe përqindjen e mbirjes së tyre jepet në tabelën 1.

Tabela nr. 1. Efekti përqëndrimeve të ndryshme të kripëzimit - NaCl në disa karakteristika të mbirjes dhe rritjes së hershme të fidanëve të spinaqit.

Niveli kripëzimit gr/l NaCl	FM-GP (%)	FMD-GR	GJR-RL (cm)	GJP-PL (cm)	IFM-SV	PNJ - WW (g)	PTH-DW (g)
0.0 gr/l NaCl	88.12a	12.13a	5.52a	3.15a	7.84a	0.45a	0.088a
2.0 gr/l NaCl	71.95b	9.01a	3.72b	2b	4.25b	0.31b	0.056b
4.0 gr/l NaCl	60.87c	6.14b	3.1c	1.35c	2.77c	0.19c	0.035c
6.0 gr/l NaCl	40.03	3.35	1.43	0.87	1.29	0.12	0.052
8.0 gr/l NaCl	25.45d	2.3c	1.12d	0.77d	0.45d	0.078d	0.0077d
c.v (%)	8.37	8.86	8.13	11.74	9.71%	6.25	14.85

N.B- Gërmat e njëjta në çdo kolonë, nuk tregojnë ndonjë ndryshim statistikor të vërtetuar. FM – GP: fuqia mbirjese e farave në %; FMD- GR: numri i farave të mbira në cdo ditë; GJR- RL: gjatësia e rrënjëzës; GJP – PL: Gjatësia e plumulës; IFM-SV: indeksi fuqise mbirje; PNJ-WW: pesha e njomë; PTH-DW: pesha e thatë.



Sikurse shihet nga tabela 1 dhe grafikët 1 dhe 2, përqindja e mbirjes së farave të spinaqit është më vogël (25.45%), në nivele më të larta të kripëzimit nga NaCl me stresit, ndërkohë që përqindja më e madhe e farvë vërehet në kushte të mungesës së kripëzimit (88.12%). Numri më i madh i farave të mbira (12.13) dhe më i vogël (2.3) evidentohen në respektivisht në mungesë kripëzimi dhe në përqëndim më të madh të kripëzimit. Kjo gjë mund të shkatohet jo më shumë nga prania e kationeve dhe anioneve të cilët rritin toksicitetin, por më shumë nga zvogëlimi i potencialit ujqor i cili kushtëzon tretjen e tyre në ujë. Mund të evidentohet gjithashtu se zvogëlimi i mbirjeve ditore të farave si shkak i kripëzimit, ndikon negativisht në disa procese fiziologjike, të janë të lidhura me mbirjen efektive të farave (Khan *et al.*, 2002).



Grafiku 2. Effect of different levels of NaCl


Grafiku 1. Effect of different levels of NaCl on on germination rate o Spinacia oleracia L germination percentage of Spinacia oleracia L.

Gjatësia e rrënjëzave dhe gjethtëzave: Edhe të dhënat e stresit kripor lidhur me gjatësinë e rrënjëzave dhe gjethtëzave, jepen në tabelën nr.1. dhe pasqyrohen në grafikun 3. Nga krahasimi i të dhënave për gjatësinë rrënjëzave dhe gjethtëzave në nivele të ndryshme kripëzimi, duket qartë se kur niveli i kripëzimit është i lartë, gjatësia e rrënjëzave dhe gjethtëzave zvogëlohet. Ky zvogëlim është më i madh në përqëndrimin 8 gr/l. Në këtë konkluzion kanë arritur edhe studiuesit Munns dhe Termaat (1986) të cilët konkludojnë se kripëzimi ndikon në zvogëlimin e rrënjëzave dhe gjethtëzave, prandaj me rritjen e kripëzimit do të zvogëlohet dhe rritja e tyre.



Indeksi Fuqisë Mbirëse: të dhënat e tabelës nr. 1 dhe grafikut 4, tregojnë se ka diferenca sinjifikative të nivelit ($P \leq 0.01$) ndërmjet niveleve të ndryshme të kripëzimit. Me rritjen e përqëndrimit të NaCl, indeksi i fuqisë mbirëse të farave zvogëlohet (Grafiku 4.). Indeksi më i lartë i fuqisë mbirëse është në farat e kontrollit (7.84) dhe më i vogël në kripëzimin me përqëndrim 8gr/l NaCl. Rezultatet treguan se rritja e përqëndrimit të kripëzimit redukton potencialin osmotik të mjedisit etj. Këto rezultate përputhen me perfundimet e aritura nga Kader dhe Jutzi [2004].

Pesha e njomë dhe e thatë: Ndikimi i streseve të kripore në përmbajtjen e lëndës së thatë dhe të njomë të fidanëve të spinaqit në fazat e para pas mbirjes së farës, rezulton se është sifinjikativ (Tabela 1 dhe Grafiku 5.). Nga tabela shihet se me rritjen e nivelit të kripëzimit, pesha e bimëzave zvogëlohet në mënyrë ekstreme. Në studimin tonë rezulton se në kushte të përqëndrimit kripor 8 gr/l NaCl, pesha e njomë është 0.078 gr, ndërsa në nivelet e tjera të kripëzimit, respektivisht pesha e njomë ishte 0.12, 0.19, 0.31 dhe 0.45 (Tabela 1). Edhe pesha e thatë e bimëzave rezultoi me të dhëna të ngjashme, pra me rritjen e nivelit të kripëzimit deri 8 gr/l NaCl, pesha e thatë e bimëzave zvogëlohet nga 0.088 gr në 0.0077 gr.



PËRFUNDIME

Nivelet e ndryshme të përqëndrimit kripor të shkaktuar nga NaCl, ndikojnë në mënyrë sinjifikative në përqindjen e mbirjes së farave të spinaqit. Stresi kripor ushtron efekte negative në treguesit e lëndës së njomë dhe të thatë të fidanëve të spinaqit në fazat e hershme të rritjes së tyre. Me rritjen e përqëndrimit të kripëzimit, zogëlohen në mënyrë evidente tregues të tillë si gjatësia e gjethëzave dhe rrënjëzave të fidanëve të spinaqit.

REFERENCAT

1. Akıncı, I.E., S. Akıncı, K. Yılmaz and H. Dikici. 2004. Response of eggplant varieties (*Solanum melongena*) to salinity in germination and seedling stages. *New Zealand Journal of Crop and Horticultural Science*. 32: 193–200.
2. Amirjani, M.R. (2010): Effect of NaCl on some physiological parameters of rice. *EJBS*, 3(1): 06-16.
3. El Sayed, H.S.A. (2011): Influence of salinity (NaCl and Na₂SO₄) treatments on growth development of broad bean (*Vicia faba* L.) plant. *American-Eurasian Journal of Agricultural and Environmental Sciences*, 10(4): 600-610.
4. Kaya, C., Higgs, D. and Kirnak, H. (2001): The effects of high salinity (NaCl) and supplementary phosphorus and potassium on physiology and nutrition development of spinach. *Bulgarian Journal of Plant Physiology*, 27(3-4): 47-59.
5. Jamil, M., C.C. Lee, S.U. Rehman, D.B. Lee and M. Ashraf. 2005. Salinity (NaCl) tolerance of Brassica species at germination and early seedling growth. *Electron. J. Environ. Agric. Food Chem.* 4: 970–976.
6. J.-K. Zhu, "Plant Salt Tolerance," *Trends in Plant Science*, Vol. 6, No. 2, 2001, pp. 66-71.
7. Langdale, G.W., J.R. Thomas and T.G. Littleton. 1971. Influence of soil salinity and nitrogen fertilizer on spinach growth. *J. Rio Grande Valley Hort. Soc.* 25: 61–66.

8. Li, Y. 2008. Effect of salt stress on seed germination and seedling growth of three salinity plants. *Pakistan Journal of Biological Sciences*. 11(9): 1268–1272.
9. L. W. Wang, A. M. Showalter and I. A. Ungar, “Effect of Salinity on Growth, Ion Content and Cell Wall Chemistry in *Atriplex prostrata* (Chenopodiaceae),” *American Journal of Botany*, Vol. 84, No. 9, 1997, pp. 1247-1255.
10. Munns, R. and Tester, M. (2008) Mechanisms of salinity tolerance, *Annual Review of Plant Biology*, **59**, 651-681.
11. Ozcoban, M. and I. Demir. 2006. Germination of performance of sequentially harvested tomato (*Lycopersicon esculentum* Mill.) seed lots during seed development under salt and osmotic stress. *Journal Central European Agricultural*. 1(7): 141–148.
12. Passam, H.C. and D. Kakouriotis. 1994. The effects of osmoconditioning on the germination emergence and early plant growth of cucumber under saline conditions. *Scientia Horticulturae*. 57: 233–240.
13. T. J. Flowers and T. D. Colmer, “Salinity Tolerance in Halophytes,” *New Phytologist*, Vol. 179, No. 4, 2008, pp. 945-963
14. Shannon, M.C. and C.M. Grieve. 1999. Tolerance of vegetable crops to salinity. *Scientia Horticulturae*. 78: 5–38.
15. Yokoi, S., Bressan, R.A., Hasegawa, P.M. (2002). Salt stress tolerance of plants. *JIRCAS Working Report*, 25-33.

EFEKTI I NIVELEVE TË NDRYSHME TË KRIPËZIMIT SHKAKTUAR NGA NaCl NË MBIRJEN DHE RITJEN E HERSHME TË FIDANËVE TË SALLATËS (*Lactuca Sativa L.*).

BESNIK BICI¹, THOMA NASTO², YLLI SUBASHI³

¹ Kandidat doktorant, Universiteti Bujqësor Tiranë; ²Departamenti Hortikulturës, Universiteti Bujqësor Tiranë; ³Qendra Transferimit Teknologjive Bujqësore Lushnjë.
thoma.nasto@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Studimi ka për qëllim të përcaktojë ndikimin e niveleve të ndryshme të kripëzimit (0, 2, 4, 6 dhe 8 g/l NaCl) në mbirjen dhe rritjen e hershme të tre kultivarëve të sallatës (*Lactuca Sativa L.*). Eksperimenti është ngritur pranë laboratorit të departamentit të hortikulturës në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në vitin 2015, sipas skemës së bllokut të randomizuar me tre përsëritje. Rezultatet e mara tregojnë se me rritjen e përqëndrimit të NaCl, zvogëlohet përqindja e mbirjes, gjatësia e rrënjëzës embrionale, gjatësia e hipokotilit si dhe pesha e thatë e rrënjëzës dhe gjetheve kotiledone. Mbirja e farës dhe rritja e bimëzave të reja frenohet fuqimisht në kushte të përqëndrimit 8 g/l NaCl. Edhe parametrat e tjerë të vlerësuar zvogëlohen me rritjen e kripëzimit, ku më e ndjeshme rezultojnë pjesa mbitokësore krahasuar me atë rrënjore. Të gjitha rezultatet e mara janë analizuar statistikisht.

Fjalë kyç: mbirje, *Lactuca Sativa L.*, përqëndrime të ndryshme, NaCl, stres kripor, ndikimi i kripëzimit.

ABSTRACT

This study aimed to determine the effect of different level of salinity (0, 2, 4, 6 dhe 8 g/l NaCl) on germination and early growth of three lettuce (*Lactuca Sativa L.*) cultivar. The experiment was carried out using completely randomized design in three replication, in 2015 Horticulture Department Laboratory Tirana. Results confirmed that increasing NaCl concentrations reduced germination percentage, radicle and plumule length, radicle and plumule dry weight. Germination and seedling growth were strongly inhibited by 8 g/l NaCl. Other measured parameters such as plumule length, radicle length, dry and wet weight decreased as well. Moreover, corrot shoots appear to be more sensitive than roots. All the results analyzed by statistical software and comparison of average had done by Duncan test on 5% possible level.

Key words: germination, *Lactuca Sativa L.*, NaCl, salinity stress, different concentrations, effect of salinity.

HYRJE

Më shumë se 900 milion hektar tokë në botë ose rreth 20 % e totalit të tokës bujqësore konsiderohen si toka nën ndikimin e kripëzimit dhe që përbëjnë më shumë se 6% të totalit të tokës në nivel botëror. Kripëzimi i shkaktuar nga NaCl është predominant, ndërkohë që bimët kanë zhvilluar mekanizma rregullatore të cilat kushtëzojnë akumulimin e kripërave (Munns and Tester, 2008).

Mbirja e farave konsiderohet si një moment i rëndësishëm dhe problematik në ciklin e jetës së bimëve dhe njëkohësisht përcakton bazat për një rritje dhe zhvillim të mirë të fidanëve dhe bimëve në vazhdim. Pavarësisht nga rëndësia që ka mbirja e farëve në kushte stresi (Ungar, 1995), mekanizmat e tolerancës së farave ndaj kripëzimit janë të dobta, veçanërisht kur krahasohen me tolerancën që kanë bimët në fazat e më vonëshme të rritjes dhe zhvillimit të tyre (Hester *et al.*, 2001; Hu *et al.*, 2005; Garthwaite *et al.*, 2005; Kanai *et al.*, 2007). Në fazën e vegetacionit të bimëve, stresi kripor shkakton zvogëlim të turgorit të qelizave dhe zvogëlim të rritjes së gjetheve dhe rrënjëve (Eerner and Finkelstein, 1995; Fricke *et al.*,

2006), duke ndikuar njëkohësisht edhe në sasinë e ujit që merret nga bimët. Gjithashtu, përqëndrimi ndërqelizor i Na⁺ dhe Cl₂ mund të frenojë metabolizmin e ndarjes dhe rritjes së qelizave (Neumann, 1997), duke ndikuar në vonesën e mbirjes së farave deri në dëmtimin plotësisht të tyre. Lidhur me ndikimin e kripëzimit në parametrat sasiorë dhe cilësorë të rritjes dhe zhvillimit të bimëve, evidentohen përfundime të ndryshme nga autorë të ndryshëm. Mund të përmendim faktin se rritja e stresit kripor zvogëlon pothuajse të gjithë parametrat e rritjes së *Nigella sativa*, disa parametra të rritjes dhe përmbajtjen e esencës tek kamomili etj. (Razmjoo *et al.*, 2008). Autorë të tjerë si Younis *et al.* (2008) konkludojnë se me rritjen e kripëzimit, zvogëlohet mbirja e farave, pesha e fidanëve dhe rritja e bimëve. Në të njëjtat përfundime kanë arritur edhe studiuesit Ashraf and Orooj (2006). Rritja e nivelit të kripëzimit rrit presionin osmotik, zvogëlon sasinë e ujit të absorbuar nga bimët si dhe proceset me karakter metabolik dhe fiziologjik (Kang and Saltveit, 2002). Etesami dhe Galeshi (2008) kanë evidentuar se kripëzimi është shkak i zvogëlimit të përqindjes së mbirjes, mbirjeve ditore, uniformitetit të mbirjeve dhe peshën e thatë të mbirjeve të elbit (*Hordeum vulgare*). Massai *et al.* (2004) kanë evidentuar se kripëzimi shkakton vonesë në rritjen e bimëve, zvogëlon efektet e fotosintezës, shkakton mbylljen e gojzave dhe zvogëlon hyrjen e ujit në bimë. Redman *et al.* (1994) tregojnë se ky zvogëlim i peshës së thatë të rrënjëzave dhe gjethëzave, pasojë e rritjes së përqëndrimit të kripëzimit, në mënyrë propable është rezultat i absorbimit të vogël të ujit nga farat gjatë mbirjes. Kripëzimi kripor i shkaktuar nga NaCl rezulton se ka ndikim negativ më të madh në rritjen e bimëve se faktorët e tjerë të kripëzimit (Khan and Ungar, 1997).

MATERIALI DHE METODAT

Eksperimenti është ngritur në laboratorin e departamentit të Hortikulturës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës gjatë vitit 2015. Në studim u morën katër nivele kripëzimi (0, 2, 4, 6 dhe 8 gr/l NaCl) në tre përsritje. Variantet përbëheshin nga një pjatë petri, në të cilat u vendosën për mbirje nga 15 fara. Farat u vendosën mbi letër filtri dhe u mbuluan me letër filtri të tipit No1 Watman. Para vendosjes për mbirje, farat u dizifektuan me tretësirë hipoklorit natriumi dhe më pas u shpëlanë disa herë me ujë të distiluar. Në çdo pjatë u shtua rreth 6 ml tretësirë NaCl sipas përqëndrimeve të sipërpërmenduar dhe më pas u mbuluan me kapakët respektivë të puthitur mirë. Pjatat e petrit të përgatitura në këtë mënyrë u vendosën në dhomën e mbirjes dhe rritjes në kushte të temperaturës 25°C dhe lagështi relative 75%. Të dhënat u morrën në ditët në vijim, ndërsa treguesit e marrë në studim ishin si më poshtë:

Përqindja e mbirjes së farave (GP): Duke filluar nga dita e dytë, u bë numërimi i farave të mbira në të njëjtën kohë çdo ditë. Farat konsideroheshin të mbira kur gjatësia e rrënjëzës embrionale kishte një gjatësi mbi 3 mm.

Numërimi i farave të mbira vazhdoi deri sa në mudëm të numërojmë një numër të madh të farave të mbira, ndërkohë që rezultati përfundimtar u përlllogarit si përqindje e farave të mbira, duke u bazuar tek formula e mëposhtme: FM: Ni / N x 100 ku Ni: numri i farave të mbira deri p.sh. sipas ditëve; N= numri total i farave.

Numri i farave të mbira çdo ditë (FMD): Duke filluar nga dita e dytë, deri në ditën e shtatë, çdo 24 orë u bë numërimi i farave të mbira në të njëjtën orë, sipas formulës së parçaktuar nga Maguire (1962):

$$GR = \sum_{i=1}^n \frac{Si}{Di}$$

FMD=GR: numri i farave të mbira në çdo ditë; Si: numri i farave të mbira në çdo numërim; Di: numri i ditëve deri në numërin n. n: numri i herëve të numërimit.

Në përfundim të eksperimentit, u zgjodhën 10 bimëza nga çdo pjatë petri, të cilat u vendosën në letër filtri për largimin e lagështirës dhe më pas u ndanë veç rrënjëzat dhe veç gjethëzat si dhe u matën gjatësitë e tyre. Bimëzat e çdo përsëritje u bashkuan dhe u vendosën të ndara për tharje në kushte të temperaturës 75°C për 24 orë. U përcaktua gjithashtu pesha e njomë dhe lëndës së thatë. Të dhënat e marra ju nënshtruan analizës së variancës.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Rezultatet e mara tregojnë se ekzistojnë diferenca të konsiderueshme në karakteristikat sasiore dhe cilësore të farave të mbira dhe bimëzave të shkaktuara nga përqëndimet e ndryshme të kripëzimit me NaCl. Bazuar në rezultatet e analizës së variancës, evidentohet fakti se si rezultat i niveleve të ndryshme të stresit kripor, ka diferenca të vërtetuara ndërmjet përqindjes së farave të mbira dhe numrit të farave të mbira çdo ditë. Ndërsa krahasimi i efekteve të niveleve të ndryshme të kripëzimit në numrin e farave të mbira çdo ditë dhe përqindjen e mbirjes së tyre jepet në tabelën 1.



Tabela nr. 1. Efekti përqëndrimeve të ndryshme të kripëzimit - NaCl në disa karakteristika të mbirjes dhe rritjes së hershme të fidanëve të sallatës.

Niveli kripëzimit gr/l NaCl	FM (%)	FMD	GJR (cm)	GJP (cm)	PNJ (gr)	PTH (gr)
0.0 gr/l NaCl	94a	8.57a	4.11a	2.50a	0.04a	0.0069a
2.0 gr/l NaCl	65.57b	6.07b	1.55b	2.01b	0.02b	0.004b
4.0 gr/l NaCl	25.61c	1.33c	0.303c	0.68c	0.004c	0.00025c
6.0 gr/l NaCl	13.47 d	0.75d	0.12c	0.35d	0.001c	0.000107d
8.0 gr/l NaCl	7.13d	0.39d	0.109d	0.21d	0.0008d	0.000086d
c.v (%)	10.12	12.10	18.98	8.01	13.41	16.97

Gërmat e njëjta në çdo kolonë, nuk tregojnë ndonjë ndryshim statistikor të vërtetuar. FM - përqindja e farave të mbira; FMD: numri i farave të mbira në cdo ditë; GJP - Gjatësia e plumulës; GJR - gjatësia e rrënjëzës; PNJ - pesha e njomë; PTH - pesha e thatë.

Sikurse shihet nga tabela 1 dhe grafiku 3,4, përqindja e mbirjes së farave të sallatës është më vogël (7.13%), në nivele më të larta të kripëzimit nga NaCl me stresit, ndërkohë që përqindja më e madhe e farvë vërehet në kushte të mungesës së kripëzimit (94%).



Numri më i madh i farave të mbira (8.57) dhe më i vogël (0.39) evidentohen në respektivisht në mungesë kripëzimi dhe në përqëndim më të madh të kripëzimit. Kjo gjë mund të shkaktohet jo më shumë nga prania e kationeve dhe anioneve të cilët rritin toksicitetin, por më shumë nga zvogëlimi i potencialit uxor i cili kushtëzon tretjen e tyre në ujë. Mund të evidentohet gjithashtu se zvogëlimi i mbirjeve ditore të farave si shkak i kripëzimit, ndikon negativisht në disa procese fiziologjike, të janë të lidhura me mbirjen efektive të farave (Khan *et al.*, 2002).



Grafiku 1 Ndikimi i përqendrimit të NaCl në

Grafiku 2. Ndikimi i përqendrimit të NaCl përmbajtjen e LNJ dhe të LTH në fazat e në gjatësinë e rrënjëzave dhe gjethezave hershme të fidanëve të sallatës. në fazat e hershme të fidanëve të sallatës.

Gjatësia e rrënjëzave dhe gjethezave: Edhe të dhënat e stresit kripor lidhur me gjatësinë e rrënjëzave dhe gjethezave, jepen në tabelën nr.1. dhe grafikun 2. Nga krahasimi i të dhënave për gjatësinë rrënjëzave dhe gjethezave në nivele të ndryshme kripëzimi, duket qartë se kur niveli i kripëzimit është i lartë, gjatësia e rrënjëzave dhe gjethezave zvogëlohet. Ky zvogëlim është më i madh në përqendrimin 8 gr/l. Në këtë konkluzion kanë arritur edhe studiuesit Munns dhe Termaat (1986) të cilët konkludojnë se kripëzimi ndikon në zvogëlimin e rrënjëzave dhe gjethezave, prandaj me rritjen e kripëzimit do të zvogëlohet dhe rritja e tyre. Peshë e njomë dhe e thatë: Ndikimi i streseve të kripore në përmbajtjen e lëndës së thatë dhe të njomë të fidanëve të sallatës në fazat e para pas mbirjes së farës, rezulton se është sifinjikativ (Tabela 1. Grafiku 1).



Nga tabela shihet se me rritjen e nivelit të kripëzimit, peshë e bimëzave zvogëlohet në mënyrë ekstreme. Në studimin tonë rezulton se në kushte të përqendrimit kripor 8 gr/l NaCl, peshë e njomë është 0.0008 gr, ndërsa në nivelet e tjera të kripëzimit, respektivisht peshë e njomë ishte 0.001, 0.004, 0.02 dhe 0.04 (Tabela 1, Grafiku 1). Edhe peshë e thatë e bimëzave rezultoi me të dhëna të ngjashme, pra me rritjen e nivelit të kripëzimit deri 8 gr/l NaCl, peshë e thatë e bimëzave zvogëlohet nga 0.0069 gr në 0.000086 gr.

PËRFUNDIME

Nivelet e ndryshme të përqëndrimit kripor të shkaktuar nga NaCl, ndikojnë në mënyrë sinjifikative në përqindjen e mbirjes së farave të sallatës. Stresi kripor ushtron efekte negative në treguesit e lëndës së njomë dhe të thatë të fidanëve të sallatës në fazat e hershme të rritjes së tyre. Me rritjen e përqëndrimit të kripëzimit, zogëlohen në mënyrë evidente tregues të tillë si gjatësia e gjethezave dhe rrënjëzave të fidanëve të sallatës.

REFERENCAT

1. Ashraf, M., Mcneilly, T. (1990). Responses of four *Brassica* species to sodium chloride. *Environ. Exp. Bot.* 30: 475-487.
2. Bartha Cs., Fodorpataki L., Szekely Gy., Popescu, O. (2010): Physiological diversity of lettuce varieties exposed to salinity stress, *Contrib. Bot.* 45: 47-56.
3. Bartha Cs., Martinez Ballesta, M. C., Fodorpataki L., Popescu, O., Carvajal, M.: Screening parameters for salt stress tolerance of lettuce cultivars, based on physiological and biochemical responses, *Curr. Op. Biotechnol.* 22(1): 136-137.
4. Bartha Cs., Fodorpataki L., Martinez-Ballesta, C. M., Popescu, O., Carvajal, M. (2011): Salt stress reactions of lettuce cultivars, revealed by physiological and biochemical parameters, *Sci. Horticult.*, IF 1.482.
5. Flowers, T.J., Colmer, T.D., (2008). Salinity tolerance of halophytes. *New Phytol.* 179: 945-963.
6. Jeannette, S., Craig, R.J., Iynch, P. (2002). Salinity tolerance of phaseolus species during germination and early seedling growth. *Crop Sci.* 42: 1584-1594.
7. Kang, H.M. and Saltveit, M.E. (2002) Chilling tolerance of maize, cucumber and rice seedlings leaves and roots are differently affected by salicylic acid. *Physiology Plantarum.*, 115, 571- 576.
8. Munns, R. and Tester, M. (2008) Mechanisms of salinity tolerance, *Annual Review of Plant Biology.*, 59, 651-681.
9. Nasri, N., Kaddour, R., Rabhi, M., Plassard, C., Lachaal, M. (2010). Effect of salinity on germination, phytase activity and phytate content in lettuce seedling. *Physiol. Plant.* 33(3): 935-942.
10. Neumann, P. (1997) Salinity resistance and plant growth revisited. *Plant Cell and Environment.*, 20, 1193-1198.
11. Redmann, R.E. and Belyk, M. (1994) Growth of transgenic and standard canola (*Brassica napus* L.) varieties in response to soil salinity. *Canadian Journal Plant Science.*, 74(4), 797- 799.
12. T. J. Flowers and T. D. Colmer, "Salinity Tolerance in Halophytes," *New Phytologist*, Vol. 179, No. 4, 2008, pp. 945-963
13. Turkan, I., Demiran, T. (2009). Recent development in understanding salinity tolerance. *Environ. Exp. Bot.* 67: 2-9.
14. Ungar. IA. (1995) Seed germination and seed-bank ecology of halophytes Marcel. Dekker, New York, pp: 599-627.
15. Yokoi, S., Bressan, R.A., Hassegawa, P.M. (2002). Salt stress tolerance of plants. *JIRCAS Working Report*, 25-33.
16. Younis, M.E., Hasaneen, M.N.A., Ahmed, A.R. and El-Bialy, D.M.A. (2008) Plant growth, metabolism and adaptation in relation to stress conditions. XXI. Reversal of harmful NaCl effects in lettuce plants by foliar application with urea. *Australian Journal of Crop Science.*, 2(2), 83-95.

**PARAMETRAT VEGJETATIV TE MBJELLJA E DREDHËZËS
NE PRANËVERË
THE VEGETATIVE PARAMETERS OF STRAWBERRY SOWING IN THE
SPRING TIME**

¹SYLË SYLANAJ MUHARREM BERISHA

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Bujqësisë & Veterinarisë-Prishtinë.

Rr.“Bil Klinton” Prishtine ,Kosove.

ssylanaj@hotmail.com

PËRMBLEDHJE

Njeri nga problemet e mëdha që paraqiten te kultivimi i dredhëzës është koha e mbjelljes. Varësisht nga mënyra e prodhimit të materialit fidanor dredhëzat mundën të mbillen gjatë tërë periudhës vegetative, por zakonisht ato mbjellën në vjeshtë dhe në pranverë. Janë hulumtuar tre kultivar të dredhëzave (Albion, Honeoye dhe Alba) të mbjella në pranverë. Hulumtimet e vetive morfologjike të dredhëzës janë kryer gjatë vitit 2014. Sipërfaqja me madhësi 1 ari ku është shtruar eksperimenti ishte e ngritur në lehë dy rëndeshe me sistem të ujitjes pikë-pikë dhe e mbuluar me foli PVC me ngjyrë të zezë. Distancat mbjellëse të kultivarëve të dredhëzës ishin 40 x 30 cm. Në hulumtim janë marrë 20 bimë me metodën e rastit në 4 përsëritje për secilin kultivar. Janë hulumtuar: lartësia, gjerësia e kaçubës, sipërfaqja e gjetheve, numri i stoloneve, numri i luleve dhe lulërive në kaçubën e dredhëzës. Janë konstatuar ndryshime sinjifikante ($p < 0,05$) në mes kultivarëve të hulumtuar dhe atë të sipërfaqja e gjethit, numri i lulërive, numri i luleve dhe numri i stolonëve,

Fjale kyç: *dredhëza, kultivarët, mbjellja pranverore, parametrat vegetativ.*

ABSTRACT

One of the major problems that occur in the cultivation of strawberries is the time of planting. Depending on the mode of production of planting material strawberries can be planted throughout the vegetative period, but it is usually planted in the fall and spring. There are explored three strawberry cultivars (Albion, Honeoye and Alba) planted in the spring. Research of morphological strawberry traits were performed in 2014. The area size of experiment was 100 square meters, where was set up in two rows system, with drip irrigation and covered by black PVC. Spacing of strawberry cultivars were 40 x 30 cm. The research was done in 20 plants selected randomly in 4 repetitions for each cultivar. They are explored for following traits: the height, the width of the bush, the surface of the leaves, the number of stolons, the number of flowers and inflorescence within strawberry bush. Significant changes were observed ($p < 0.05$) between cultivars researched for the surface of the leaf, the number of inflorescence, the number of flowers and number of stolons.

Key words: *strawberry, cultivars, spring planting, vegetative traits.*

1. HYRJE

Dredhëza (*Fragaria ananassa* Duch.) është njëra ndër kulturat më rentabile të pemëve. Ajo karakterizohet me hyrje të hershme në prodhim në vitin e parë pas mbjelljes, frutat janë atraktiv, me shije dhe aromë të këndshme, jep rendimente të rregullta e të larta dhe shumë mirë adaptohet në teknologjitë e ndryshme të kultivimit. Frutat e shijshme të dredhëzës, jo vetëm që arrijnë të parat në pranverë për konsum në gjendje të freskët, por janë shumë të përshatshme për përpunim shtëpiak dhe industrial.

¹Të dy autorët kanë kontribut të barabartë

Fermerët kosovar shpesh herë hasin në dilema së cili është afati më i mirë i mbjelljes së dredhëzave, pasi që ajo mund të mbillet që nga fillimi i vjetëracionit në pranverë e deri në vjeshtë. Viteve të fundit dredhëza kryesisht në Kosovë mbillet gjatë muajve të verës nga 15 korriku deri më 15 gusht. Në këtë kohë temperaturat janë të larta, lagështia relative e ultë, toka e thatë dhe shumë vështirë formohen lentat. Edhe për kundër vendosjes së sistemit të ujitjes pikë-pikë kjo vështirëson procesin e nxënies së fidanëve dhe shpesh herë një numër i konsiderueshëm i fidanëve të posa mbjella thahen. Dredhëzat e mbjella në këtë kohë pas 25 ditëve lulëzojnë dhe këto lule duhet të mënjanojnë në mënyrë që në vitin e ardhshëm të japin maksimumin e prodhimit. Nëse lulet lihen rendimenti i frutave në vitin e ardhshëm është me i vogël. Mënjanimi i luleve kërkon angazhim të fuqisë punëtore dhe me këtë ngarkohet prodhimi. (Zajmi & Efendija, 1996; Sylanaj, 2004; Avdiu, 2004; Sylanaj & Shala, 2008). Për nga aspekti teknologjik dhe ekonomik dredhëza duhet të mbjellët sa me herët në pranverë, pasi që ajo në vitin e ardhshëm e jep maksimumin e rendimentit. Qëllimi i hulumtimit të parametrave të mbjellja e dredhëzës në pranverë ka qenë që të krahasohen parametrat e mbjelljes në rritjen dhe zhvillimin e saj.

2. MATERIALI DHE METODA

Eksperimenti është vendosë në sipërfaqe prej 1 ari, në Fermën didaktike të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë. Janë mbjell tre kultivar të dredhëzës (Albion, Honeoye dhe Alba).

Mbjellja e fidanëve *virus free A+* është bërë në dekadën e parë të muajt prill të vitit 2014.

Mbjellja është bërë në lente dy rëndeshe e mbuluar me foli të zezë me distanca të mbjelljes 40 x 30 cm gjegjësisht 5 bimë/m². Sistemi i ujitjes, pikë-pikë ka qenë i vendosur nën foli, i cili ka mundur që bima vazhdimisht të furnizohet me ujë. Sipërfaqja në mes të lentave është mbuluar më kashtë e cila ka mundur kushte më të mira për kultivim dhe ka zvogëluar potencialin e mbirjes së barërave të këqija. Në hulumtim me metodën e rastit janë marrë nga 20 bimë në 4 përsëritje për secilin kultivar. Në përmirësim janë aplikuar masat e rregullta agroteknike.

Në kaqubëzat e evidentuara është bërë matja e këtyre parametrave: lartësia, gjerësia e kaqubës, sipërfaqja e gjetheve, numri i stoloneve, numri i luleve dhe lulërive në kaqubën e dredhëzës

Rezultatet e fituara janë përpunuar me analiza të variancës-ANOVA në Mini Tab-14. Rëndësia e ndryshimeve në mes të tretmanëve është vërtetuar me LSD test në nivelin 0,05 dhe 0,01. (Vukadinović, 1994) .



Foto 1. Përgatitja e tokës dhe mbjellja e dredhëzës **Foto 2.** Mirëmbajtja e sipërfaqes në mes rëndëve



Foto 3. Marrja e mostrave skaner



Foto 4. Matja e sipërfaqes së gjetheve me skaner

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Rezultatet e fituara për lartësinë e gjerësinë e kaçubës, sipërfaqen e gjethit, numrin e stolonëve numrin e lulërive dhe luleve, te tre kultivarët e dredhëzës janë paraqitur në tab 1.

Tabela.1. Mesatarja e parametrave vegetative për kaçubë të kultivarët e hulumtuar

Kultivari	Lartësia e kaçubës (cm)	Gjerësia e kaçubës (cm)	Sipërfaqja e gjethes (cm ²)	Nr. i stoloneve	Nr. i lulërive	Nr. i luleve
Albion	23.80 ^b	34.35 ^b	11.680 ^b	5.13 ^c	13.13 ^a	61.20 ^a
Honeoye	23.90 ^b	36.10 ^b	11.614 ^b	10.80 ^b	6.67 ^b	32.80 ^b
Alba	25.75 ^a	37.95 ^a	13.504 ^a	13.07 ^a	11.47 ^c	54.73 ^a
LSD						
0.05	1.25	1.81	1.67	1.56	1.24	6.83
0.01	1.64	2.38	2.34	2.05	1.63	8.97

Legjenda: Vlerat mesatare në kolona të shënuara në superskript me shkronja të ndryshme janë sinifikante në nivel $P > 0,05$.

Në bazë të analizave të paraqitura në tabelën 1 është konstatuar së lartësi dhe gjerësi mesatare të kaçubës më të lartë ka pasur kultivari Alba (25.70 x 37.95 cm). Ndërsa lartësi dhe gjerësi më të vogël kanë pasur kultivarët Albion (23.80 x 34.35 cm) dhe kultivari Honeoye (23.90 x 36.10 cm). Kjo lartësi dhe gjerësi e kultivarit Alba kanë qenë sinjifikante me kultivarët Albion dhe Honeoye. Këto të dhëna përputhen më të dhënat e Çakalli & Thomai (2005), i cili thotë se kaçubëza e dredhëzës ka zhvillim mesatarisht në lartësi 15-40 cm. Ndërsa sipas të dhënave të autorit Stančević (1990), një kurorë e zhvilluar mirë e dredhëzës mund të arrijë gjerësinë 50 cm mund të ketë 20 lulëri dhe 100-350 lule.

Për sa i përket sipërfaqes së gjethit, në bazë të analizës së variancës në mes kultivarëve janë treguar dallime sinjifikuese. Sipërfaqe më të madhe të gjethëve ka pasur kultivari Alba (13.504 cm²), ndërsa sipërfaqe më të vogël kultivari Honeoye (11.614 cm²). Në bazë të LSD-së janë konstatuar dallime sinjifikuese në mes mesatarëve të kultivarit Alba dhe kultivarit Honeoye. Ndërsa në mes kultivarit Albion dhe Honeoye nuk ka pasur dallime sinjifikante. Sipas të dhënave të Sylanaj (2010), sipërfaqja e gjethit të kultivari Elsanta është 15.774 cm² ndërsa të Sonata është 19.368 cm².


Hulumtimi i numrit të stoloneve për bimë, është parametër i cili flet po ashtu për bujshmëri të kultivarit, si dhe nga numri i madh i stoloneve varet prodhimi i një numri të madh të fidanëve. Nga të dhënat e paraqitura konstatohet se numri i stoloneve të kultivarët e hulumtuar ka qenë i ndryshëm. Numër mesatar më të madh të stoloneve ka pas kultivari Alba 13,07 stolone për kaçubë; Honeoye 10,80 dhe më se paku kultivari Albion 5,13 stolone për kaçubë. Dallimet statistike të rëndësishme ($p < 0,01$) janë konstatuar në mes të gjithë kultivarëve (Tabela 1). Në një kaçubë të dredhëzës sipas Sylanaj (2004), gjatë vegjetacionit formohen 8 deri 20 stolone, me gjatësi dhe trashësi të ndryshme.

Numri më i madh i lulërive për kaçubë është konstatuar të kultivari Albion (13,13), pastaj të kultivari Alba (11,47), ndërsa numër më të vogël të lulërive ka pasur kultivari Honeoye (6,67) lulëri për kaçubë. Sipas Shala et al. (2012) për të arritur një rendiment sa më të lartë të frutave të dredhëzës është e mundur nëse formohen numër i mjaftueshëm i luleve gjegjësisht lidhje të frutave për kaçube.

Numër më i madh mesatar i luleve për kaçubë është konstatuar të kultivari Albion 61,20 lule për kaçubë, të kultivari Alba 54,73 dhe më i vogël të kultivari Honeoye 32,80 lule për kaçubë. Në bazë të LSD-testit, janë konstatuar dallime tejet sinjifikuese vetëm në mes kultivarëve Albion e Alba më kultivarin Honeoye dhe atë në nivel ($p < 0,01$).

Në bazë të analizës së variansës (F-testit) janë konstatuar dallime sinjifikuese në mes të kultivarëve të hulumtuar në numrin e lulërive dhe luleve ($F < 0,001 = 56,01$ dhe $36,52$; $P < 0,01$).

Është konstatuar raport i ndryshëm në mes lulërive dhe luleve të kultivarët në hulumtim (Graf. 1). Është konstatuar korrelacion i lartë pozitiv në mes lulërive dhe luleve të kultivari Alba dhe Honeoye ($r = 0.89$ dhe 0.79) si dhe korrelacion i dobët pozitiv të kultivari Albion ($r = 0.34$).



Rezultatet tona për sa i përket numrit të luleve janë më të ulëta nga hulumtimet e tjerëve Stančević (1990) i cili konstaton se një kurorë e zhvilluar mirë e dredhëzës mund të arrijë të ketë 20 lulëri dhe 100-350 lule, ndërsa Sylanaj (2004) konstaton se numri i luleve për kaçubë të dredhëza, në frytdhënie të plotë arrijn 80-120 lule. Numri më i vogël i luleve në rezultatet tona mund të arsyetohet më atë që hulumtimet janë kryer në vitin e parë frutdhënës të dredhëzave.

REKOMANDIME

Në bazë të hulumtimeve të kryera të mbjellja pranverore e dredhëzës në fushë të hapur në kushte agroekologjike të objektit “Ferma didaktike e FBV ne Prishtinë” mund të nxirren këto rekomandime:

- Gjerësia e kaçubë me e madhe ka qenë të kultivari Alba (37,95 cm), ndërsa me e vogël te kultivari Albion 34.30 cm.
- Sipërfaqe me të madhe të gjetheve ka kultivari Alba (13.504 cm²), ndërsa sipërfaqe më të vogël ka pasur kultivari Honeoye 11.614 cm².
- Numër mesatar më të madh të stoloneve ka pas kultivari Alba 13,07 ndera me se paku Albioni 5,13 stolone për kaçubë.
- Lulëri dhe lule për kaçube me se shumti ka pasur kultivari Albion.

Nga këto të dhëna mund të konstatojmë së mbjellja pranverore e dredhëzave nuk ngelet mbrapa afateve tjera të mbjelljes, por përkundrazi ka shumë përparësi mbjellja pranverore për kultivimin të suksesshëm të dredhëzave.

LITERATURA

- 1, Avdiu, V. *Studimi i veçorive agrobiologjike dhe teknologjike te tre kultivarëve te luleshtrydhes ne kushte te Kosovës*. Mikrotezë. Tiranë. 2004
- 2, Çakalli, D., Thomai T. *Frutikultura speciale (Pomologjia)*. Universiteti Bujqësor i Tiranës. 2005.
- 3, Stančević, A.: *Practical Pomology*. Litopapir, Čačak. 1990.
- 4, Sylanaj S. *Dredhëza*. Qendra e Kosovës për zhvillim (KDC). Gjakovë. 2004.
- 5, Sylanaj, S., Shala, A. *Pomološke osobine novointroductory sortir jagoda*. *Pomologia Croatica*. 2008. Vol.14. br.3.:195-200.
- 6, Sylanaj, S. *Vegetative traits of strawberries cultivars cultivated in low tunnels*. *Scientific works . Jubilee Scientific Conference With International Participation*. Plovdiv. 2010. Volume LV, book 1: 285-290.
7. Shala, A., Helena Weissinger., Sylani,S., Spornberger, A. *Production of strawberries in Closed environments*. Boku. 2010.

**EFEKTI I AFATEVE TË NDRYSHME TË SHARTIMIT TE
ARRËS (*Juglans regia* L.)
EFFECT OF PERIODS TECHNIQUES ON WALNUT
(*Juglans regia* L.) GRAFTING**

¹ GAZMIR SHOSHI, SYLE SYLANAJ, REXHEP SHOSHI

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Bujqësisë & Veterinarisë-Prishtinë.

Rr. “Bil Klinton” Prishtinë, Kosovë.

gazmirshoshi@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Qëllimi i hulumtimeve të shartimit të arrës ishte përcaktimi i afatit optimal të kohës, teknikës dhe kushteve të shartimit. Në fidanishten pemëtare NPSH “Kashica” në Istog, gjatë vitit 2015 janë aplikuar dy afate të shartimit të arrës : shartimi në fillim të muajt mars dhe prill. Janë shartuar kultivarët: *Chendler*, *Fernord*, *Pedro*, *Franket* dhe *Populacioni Autokton*.

Janë hulumtuar, kushtet dhe koha e shartimit të arrës në tavolinë në dy afatet e shartimit duke vërtetuar efektin e temperaturës dhe lagështisë relative të ajrit brenda shtratit të fidaneve të shtratifikuar. Kultivari *Chendler*, ka pasur kallusim dhe përqindje më të sukseshme të shartimit në krahasim me kultivarët tjerë. Suksesi i fidanëve të arrave të shartuara në mesatare më i madh ishte të kultivari *Chendler* (55.08 %) , ndërsa më i vogël të kultivari *Franket* (45.66 %).

Shartimi në fillim të muajt mars ishte më i suksesshëm se sa shartimi në fillim të prillit.

Fjalë kyçe: *Arra, kallusimi, kultivarët, kushtet e shartimit, teknika e shartimit.*

ABSTRACT

The purpose of the grafted walnut research was determining the optimum time period, technique and conditions of grafting. In orchard nursery "Kashicë" LLC in Istog, during year 2015 are applied two time terms of walnut grafting: grafting at the beginning of March and April. Cultivars: *Chendler*, *Fernord Pedro*, *Franks* and *Native populationion*, were grafted. In this research were investigated conditions and period of walnut's grafting in working table by observing the effect of temperature and relative humidity inside the bed of seedlings stratification. *Chendler* cultivar, had greater callusing and grafting success percentages compared with other cultivars. The success of the grafted walnut seedlings was found to the cultivar *Chendler* (55.08%) with greater average while the lowest success had cultivar *Franks* (45.66%). Grafting in early March was more successful than grafting in early April.

Key words: *Walnut, callusing, cultivars, grafting conditions, grafting technique.*

HYRJE

Arra bënë pjesë në grupin e pemëve drunore ndër më të rëndësishme në botë. Përdorimi i gjerë i frutave të sajë në industrinë ushqimore, mjekësi, farmaci dhe industrinë përpunuese të drurit e bënë atë ndërë speciet më të rëndësishme. As një kulturë tjetër pemëtare nuk ka vlera aq të larta sa arra, por në të njëjtën kohë është e lënë pas dore në tërë territorin e Kosovës. Arra gjendet e mbjell dhe e mbirë spontanisht kryesisht në oborre shtëpiake, afër rrugëve, neper ara si të vetmuara dhe të pa shartuara. Edhe për kundër jetëgjatësisë qindveçare të arrës për shkak të hyrjes së saj në prodhim shumë vonë pas 15 viteve ka bërë

¹Të tre autorët kanë kontribut të barabartë

qe kjo kulturë pemëtare te mbetet pas dore. Arrat e shartuara hyjnë ne frutdhënje pas vitit te 3-4^{te}.

Shartimi i arrës (*Juglans regia* L.) është më i vështirë, në krahasim me shumicën e specieve tjera te pemëve, prandaj për këtë arsye ne shumë shtetet te botës janë duke përdorur metoda te reja për prodhimin e materialit fidanor te arrës.

Kërkesat për mbjelljen e arrave te shartuara gjithnjë e me shumë janë duke u rritur edhe ne vendin tonë duke pasur parasysh vlerën e lartë te kësaj kulture pemëtare dhe kushtet e mira agroekologjike qe posedon vendi i jonë.për kultivim.

Bugarčić & Mitrovic (1985) theksojnë kompleksitetin e teknologjisë se shartimit të arrës dhe raportojnë përqindjen 60 - 80% te suksesit te shartimit. Sipas **Ozgan & Gumus (2001)** përqindja e zënies se kalemave te shartuar te varietetet e ndryshme është ne kufit prej 33-53 %. Ndersa autori **Tsurkan (1990)** arrin rezultate te përqindjes se zënies se fidanëve te arrës prej 5- 45 %

Ne suksesin e shartimit të arrës kane ndikim shumë faktor si zgjedhja e kultivarëve, cilësia e nënshartesës, koha dhe metoda e shartim, temperatura e ajrit, lagështia relative brenda magazinimit te fidanëve te shartuara (**Karadeniz & Kazankaia, 1997; Barut, 2001; Tshering et al. 2006; Gandev 2007; Avanzato, 2009; Gandev & Arnaudov, 2011**).

Qëllimi i eksperimentit ishte të hulumtohet mënyra, koha dhe kushtet e ambientit më te përshtatshme për shartimin e arrës.

MATERIALI DHE METODA

Hulumtimet janë bërë ne NPSH- “Fidanishtja” Kashicë. Istog- Kosovë gjatë vitit 2015. Si nënshartesë është përdorur arra e zakonshme (*Juglans regia* L.). Ne ekspertimet janë përfshi kultivarët: Chendler, Fernord, Pedro, Franket dhe Populacioni Autokton.

Janë aplikuar dy afate te shartimit: me 5 mars dhe me 5 prill. Shartimi ne tavoline i arrës-shartimi anglez është bërë ne nënshartesat një-vjeçar të arrave te zakonshme. Temperatura e ajrit ne dhomë ku është bërë shartimi dhe kalusimi i fidanëve te shartuar ka qenë 25-28 °C, ndërsa lagështia e ajrit 70-80 %. Fidanët e shartuara janë vendosur ne arka te mbushura me ashkla-tallash, Ashklat e drurit te pishës janë trajtuar me preparatin Ridomil Gold 0.25 % për dezinfektim. Arkat e mbushura me tallash te pishës janë vendosur mbi tepih special për ngrohje dhe pastaj janë ujitur vazhdimisht me uji sipas nevojës. Ne eksperiment për secilin kultivar janë përfshi nga 30 fidanë-shartesa te ndara ne 3 përsëritje. Rezultatet e fituara janë analizuar me ANAOVA, ndërsa sinjifikacioni është përcaktuar sipas : LSD =0.05 dhe 0.01.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Kushtet klimatike janë faktorë që kanë rëndësi të veçantë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësi dhe në sasi të prodhimtarisë se fidaneve-shartesave.

Temperatura e ajrit (25-28°C), konsiderohet më e përshtatshme për proceset e ndryshme fiziologjike ku realizohen vetëm në prani të një intervali të caktuara temperaturash të ajrit, të tokës dhe të vetë bimës. Këto temperatura janë me te volitshme për ndarjen e qelizave meristemmatike te kambiumit, krijimin e indeve te kallusimit, ngurtësimit te komponentëve dhe elementeve tjera ne vendin e shartimit. Pas 14-20 ditësh arrat e shartuara formojnë kallusin dhe fillojnë të shpërthejnë e të rriten sythat.

Rezultatet e efektit për afatet e ndryshme te shartimit të arrave me metodën e shartimit ne tavoline janë te paraqitura në (Tabelen nr.1).

Tabela. nr. 1. Efektet në dy afatet e shartimit te kultivaret e arres

Kultivarët	Datat e shartimit dhe %		Mesatarja %	
	05.03.2015	05.04.2015		
Chendler	57.33	52.82	55.08	
Fernord	48.26	46.16	47.21	
Pedro	48.73	45.86	47.30	
Franket	46.85	44.46	45.66	
Populacioni Autokton	46.16	46.83	46.50	
LSD 0.05	AB	A	B	48.35
	0.01	1.35	0.94	
		1.96	1.35	2.87

Sipas rezultateve të prezantuara (Tabela 1.), sukses më të madhe të kalemave të zënë te arra ishte shartimi në fillim të muajt mars në krahasim me shartimin në fillim të muajt prillit. Nga te gjithë kultivarët e shartuar në mesatare, sukses më të madh të kalemave te zënë e kishte kultivari Chendler (55.08%) më pas kultivari Pedro (47.30%), Fenord (47.21%), populacioni Autokton (46.50%) dhe me së paku kalemave të zënë kishte kultivari Franket (45.66 %)



Foto 1. Kalusimi i fidanëve te shartuara

Rezultatet e prezantuara (Tabela 1,) janë me dallime të krahasuara me rezultatet e autoreve **Bugarčić & Mitrovic (1985)** te cilët theksojnë përqindjen 60 - 80% të suksesit te shartimit. Rezultatet tona përafërsisht janë për dy here me te ulëta.


Disa autor te tjere si **Ozgan & Gumus (2001)** theksoin se përqindja e zejës se kalemave te shartuar te varietetet e ndryshme është ne kufi prej 33-53 %. Rezultatet tona përafërsisht përputhen me rezultat e cituar me lartë.

Qartë është theksuar se mbajtja e lagështisë ne arkat e mbushura me tallash është një faktor shumë i rëndësishëm ne përqindjen e zënies se kalemave te arrës pasi qe krijojnë kushte anaerobe te zhvillimit dhe zvogëlojnë përqindjen e zënies se kalemave.

Ne graf. 1 është konstatuar se koha e shartimit është faktor me rendësi. Pavarësisht prej kultivarëve të shartuar është konstatuar se shartimi në fillim të muajt mars është me i suksesshëm se sa shartimi ne fillim te muajt prill. Rezultatet tona përputhen me ato te autorëve (**Gandev & Arnaudov, 2011**) sa i përket afatit te shartimit, por jo ne përqindjen e zënies se fidanëve. Sipas këtyre autoreve përqindja e zënies se fidanëve te arrës te shartuara me 25 mars është 71.2 % ndërsa me 29 prilli është 42.0 %.

Ne bazë te hulumtimeve tona përqindja e zënies se fidanëve te arrave te shartuara, mesatarisht për dy afatet e shartimit është 48.35 %.

Grafiku 1. Ndikimi i kohës se shartimit ne përqindjen e zënies se fidanëve te arrës



Zënia mesatare e fidanëve te arrës më e madhe është te kultivari *Chendler* 55.08 % , ndërsa me ultra te kultivari *Franket* 45.66%. Dallimet ne mes te këtyre kultivarëve ishin lartë sinjifikante.

Dallimet ne mes te kultivarit *Fernord* dhe *Pedro* si dhe ne mes te kultivarit *Franket* dhe populacionit Autokton te arrës nuk kanë qenë sinjifikante.

Krahasuar kultivarin *Pedro* me kultivarin *Franket* sa i përket përqindjes se zënies se kalemave ne fillim te muajt mars dallimet kanë qenë sinjifikante.

REKOMANDIME

Metoda e shartimit te arrës në tavolinë në kushte të dhomës rezulton si metodë e suksesshme e aplikimit.

1. Koha e shartimit ndikon në suksesin e zënies së arrave të shartuara.
2. Kryerja e shartimit në fillim të muajt mars ka pasur zënie më të madhe të kalemave të zëna në krahasim me shartimin në fillim të muajt prill.
3. Suksesi i zënies së kalemave të shtratifikuar te arrave të shartuara, varet prej fiksimit të kalemit, nënshartesës, si dhe sigurimi i temperaturës e lagështisë optimal të ajrit në vendin e stratifikimit.
4. Kultivimi i arrave të shartuar viteve të fundit ka zgjuar interes të madh të fermerët e Kosovës.

LITERATURA

1. Avanzato D. Training on hot callusing technique applied to walnut grafting. Walnut propagation training short course, 2009. COST Action 873, Spain, 10 p.
2. Barut E. Different whip grafting methods on walnut. Acta Horticulturae. 2001. 544:511-513.
3. Bugarcic V., Mitrovic M. The effect of phytohormones on the walnut graft take with bench grafting. YUGOSLAV POMOL. 1985. 19 (73-74): 389-395.
4. Gandev S. Budding and grafting of the walnut (*Juglans regia* L.) and their effectiveness in Bulgaria (Review). Bulgarian Journal of Agricultural Science, 13 (2007), 683-689 National Centre for Agrarian Sciences. 2007.
5. Gandev, S. & Arnaudov, V. Propagation method of epicotyl grafting in walnut (*Juglans regia* L.) under production condition. *Bulgarian Journal of Agricultural Science*, 17 (No 2) 2011, 173-176 Agricultural Academy.
6. Karadeniz T., Kazankaya A. Relations between phenolic compounds and graft success in walnut (*Juglans regia*L.). Acta Horticulturae. 1997. 442: 193-196.

7. Tshering G., Gyyeltsen T., Lhendu T., Tshering U. Effect of time of grafting on walnut graft success under different altitudes. *Acta Horticulturae*. 2006. 705: 303-307.
8. Tsurkan L.P. Production technology of English walnut plantin materialising winter table grafting. *Acta Horticulturae*, 1990. 284:65-68.

**VLERËSIMI I DISA NËNSHARTESAVE NË PRODHIMIN E SHALQIRIT DHE
DISA KOMPONENT TË TIJ
EVALUATION OF DIFFERENT ROOTSTOCKS ON YIELD AND YIELD
COMPONENTS OF WATERMELON**

SOKRAT JANI⁽¹⁾ dhe LIRI MIHO⁽²⁾

⁽¹⁾ Qendra e Resurseve Gjenetike të Bimëve, Universiteti Bujqësor i Tiranës,

⁽²⁾ Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit,
Universiteti Bujqësor i Tiranës, SHQIPËRI.

sokratjani@yahoo.com; liri-miho@hotmail.com;

PËRMBLEDHJE

Është studiuar dhe vlerësuar ndikimi i disa nënshartesave në rritjen dhe zhvillimin e bimëve, si dhe në disa tregues të prodhimit dhe cilësisë së tij në dy kultivar të shalqirit (Crimson sweet dhe Crisby F₁). Eksperimenti u ngrit në fushën eksperimentale të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Lushnje (zona e ulët bregdetare e Shqipërisë). U studiuan pesë nënshartesa: “RS-841”, “Strong Tosa”, “Shintoza” dhe “Polifemo” hibride interspecifike të kungullit (*Cucurbita maxima* x *C. moschata*) dhe “Macis” një nënshartesë *Lagenaria siceraria*, për të dy kultivarët e shalqirit të sipërcituar. Skema eksperimentale ka qenë ajo e bllokut të randomizuar me tre përsëritje. Çdo variant, në përsëritje, përfaqësohet nga 15 bimë. Bimët e pa shartuara ishin kontrolli. Rezultatet tregojnë se bimët e shartuara kanë rritje më të mirë se ato të pa shartuara të kontrollit. Bimët e shartuara të të dy kultivarëve të shalqirit, në të pesë nënshartesat e përdorura, formuan më shumë lastarë, kërcej më të gjatë, më shumë gjethë dhe masë të freskët e lëndë të thatë. Shartimi kishte efekt të dukshëm në prodhimin dhe cilësinë e frutave të vjelë. Prodhimi total dhe treguesit cilësor, sikurse madhësia e frutave, trashësia e lëkurës dhe përmbajtja e lëndës së thatë në tulin e frutave kanë patur vlera më të mira se në bimët e pa shartuara. Efektet pozitive kanë qenë të ndryshme në varësi të nënshartesave të përdorura. Këshillohet që shartimi në shalqi të përdoret si një masë teknike që shfrytëzon dobritë e fidanëve të shartuar.

Fjalët kyçe: *Nënshartesa, mbishartesa, shartimi me afrim, prodhimtari, cilësi fryti.*

ABSTRACT

The influence of using different rootstocks on the success of grafting, plant growth, fruit yield and fruit quality of two watermelon cultivars (Crimson Sweet and Crisby F₁) was studied. The experiment was conducted in open field in the Experimental Field of Agricultural Technology Transfer Center of Lushnje (Coastal zone of Albania). Watermelon plants were grafted onto five rootstocks: “RS-841”, “Strong Tosa”, “Shintoza” dhe “Polifemo” (*Cucurbita maxima* x *C. moschata*) and “Macis” *Lagenaria siceraria*. The non grafted watermelon plant was used as control. The experiment was conducted as a complete randomized block design with three replications, each consisting of fifteen plants. The results revealed that grafted plants had better vegetative growth than none grafted, control ones. Furthermore, stem length, number of lateral branches, and fresh and dry weights of stem and leaves were improved. The grafting had significant effect on fruit quality and yield. The total fruit yield and fruit quality such as fruit index, rind thickness and soluble solid contents of grafted plants was significantly higher than that of non-grafted plants. The positive effects of grafting can change according to the rootstock being used. In conclusion it is recommended that grafting in watermelons should be done as a procedure that assures the benefits of grafted seedlings.

Keywords: *Approach grafting, rootstock, scion, yield, fruit quality.*

HYRJE

Shartimi është një metodë e shumimit aseksual të bimëve, që bashkon dy kërcej të bimëve të gjenotipeve të ndryshme në mënyrë të tillë që ata më tej të rriten si një bimë.

Kultivimi i bimëve perimore të shartuara është teknikë thujse shekullore, e përdorur më parë në Kore dhe Japoni (në fund të vitit 1920), ku bimët e shalqirit u shartuan mbi nënshartesa kungulli. Kjo metodë u përhap më tej në vendet përreth. Pastaj u përhap në rajonin e Mesdheut, ku përdorimi i teknikës së shartimit është parë si një komponent i rëndësishëm i strategjisë për menaxhimin e integruar në mbrojtjen e bimëve prej sëmundjeve të tokës dhe rritjen e produktivitetit të tyre (Lee dhe Oda, 2003). Tashmë kjo metodë po përdoret edhe për bimë të tjera perimore, si në pjepër, kastravec, domate, spec, patëllxhan, etj.

Ka disa avantazhe të rëndësishme në përdorimin e fidanëve të shartuar në perime, mes të cilave mund të përmendet rritja e vitalitetit të bimëve të kulturës, rezistencë ndaj sëmundjeve të tokës (*Fusarium*, etj), temperaturës së ulët, kripëzimit, dhe nga ana tjetër rritje e intensitetit të përvetimit të lëndëve ushqyese që merren nga toka (Ruiz et al., 1997).

Shalqiri është një bimë perimore e rëndësishme, që kultivohet gjerësisht në fushë, në thujse gjithë vendet e botës. Sëmundjet tokës mund të shkaktojnë rënie të ndjeshme të sipërfaqes së mbjellë me këtë kulturë. Prodhimi dhe cilësia mund të preken rëndë në ngastrat e infektuara me sëmundje të tokës (*Fusarium ssp*, *verticilium*, etj); në mbjelljet e hershme, në kultivime në tunele të ulët plastik dhe në fushë të hapur. Ka mënyra të ndryshme për të parandaluar sëmundjet e tokës, të tilla si qarkullimet bujqësore, programet e përmirësimit gjenetik, për krijimin e kultivarëve të qëndrueshëm, dhe ato të trajtimit të tokës me pesticide (Yetisir dhe Sari, 2004; Rivero et al, 2003). Këto praktika të menaxhimit kanë edhe disavantazhe. Për rrjedhojë, përdorimi i teknikës së shartimit për prodhimin e fidanëve, e pra edhe zgjedhja e nënshartesave të qëndrueshme ndaj patogjenëve të tokës, duket se është një zgjidhje efektive. Në Shqipëri, shartimi, si teknikë për prodhimin e fidanëve dhe kultivimin e perimeve, veçanërisht në shalqi, është rritur kohët e fundit. Përdorimi i fidanëve të shartuar në shalqi, në dhjetë vitet e fundit, është rritur rreth 4,0 herë (Statistika e MBUMK, 2012).

Përveç kontrollit të sëmundjeve të tokës, bimët e shartuara, të cilat kanë sistem rrënjor më të zhvilluar e më të fortë, mund të përdoren për të rritur tolerancën e tyre ndaj temperaturës së ulët të tokës, në veçanti në muajt e parë të kultivimit në pranverë. Një teknikë e tillë rrit prodhimin dhe redukton nevojën për plehra dhe pesticide për mbrojtjen e bimëve (Yetisir et al, 2003; Rivero et al, 2003). Për këto qëllime, shalqinj të shartohen mbi nënshartesa të *C. maxima*, *C. moschata*, *Benincasa hispida* dhe lloje të *Lagenaria siceraria*. Nënshartesat mund të ndikojnë në rritjen e bimëve, në prodhimtarin e kultivarëve dhe cilësinë e frutave. Nënshartesat mund të sjellin ndikime të mëdha në kultivarë të ndryshëm shalqiri. Pajtueshmëria e shartimit, sasia dhe cilësia e frutave janë në varësi të kombinimit të zgjedhur, mes kultivarëve të shalqirit dhe nënshartesave (Lee, 1994; Edelstein, 1999, Lee dhe Oda, 2003). Pra, efektet pozitive të shartimit mund të ndryshojnë në varësi të nënshartesave që përdoren.

Materiali studimor që paraqesim, mbi ndikimin e nënshartesave në rritjen dhe zhvillimin e bimëve të shalqirit, prodhimin e frutave dhe cilësinë e tyre, është një kontribut për të orientuar fermerët në përzgjedhjen më të përshtatshme të nënshartesave që gjenden në treg.

Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësoj efektet e disa nënshartesave në rritjen e bimëve, prodhimin dhe cilësinë e frutave të dy kultivarëve të shalqirit (Crimson sweet dhe Crisby F₁).

MATERIALI DHE METODA

Ekspërimenti u krye në periudhën 2012-2014, në kushte të fushës së hapur, në ngastrat e Bazës Ekspërimentale (N-40°57'11.55"; E-019°41'01.87" dhe lartësi 11,0 m mbi nivelin e detit) të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Lushnjë (QTTB-Lushnjë).

Toka ishte e tipit *Fluvisole*, me përbërje mekanike nën-deltinore e mesme, me përmbajtje: Humus 2,1%; Azot 0,14%; P_2O_5 – 2.9 mg/100g(e pasur); K_2O -2.88 % dhe pH ujqor 7.6.

U studiuan dhe vlerësuan pesë nënshartesat: “RS-841”, “Strong Tosa”, “Shintosa” dhe “Polifemo”, hibride interspecifike të kungullit (*Cucurbita maxima* x *C. moschata*), si dhe “Macis” një nënshartesë nga (*Lagenaria siceraria*), mbi të cilat u shartuan dy kultivarë të shalqirit, përkatësisht Crimson sweet dhe Crisby F₁. Teknika e shartimit e përdorur ishte ajo me afrim(Jani, 2000). Bimët e pa shartuara të shalqirit u përdorën si kontroll.

Pas punimit bazë të tokës, para punimeve përgatitore, u bë plehërimi me 12 kg/dynum NPK(20-20-20). Pastaj u bë piketimi i rreshtave, shtrirja e impiantit ujtitës me pika dhe mulcerimi plastik me PE të zi me gjerësi 80 cm.

Mbjellja është bërë në largësitë 280 cm midis rreshtave dhe 80 cm midis bimëve në rresht, me dendësi rreth 445 bimë/dyn. Farërat e kultivarëve të shalqirit u mbollën më 1-3 mars në tava polisteroli me përmasa të folesë 4,5 x 4,5 cm. Mbirja u siguroa më datën 3-6 mars. Farërat e nënshartesave u mbollën në të njëjtat tava, pranë bimëzës së shalqirit, më 8-10 mars. Mbirja e tyre u siguroa më datën 13-16 mars. Shartimi u krye më 25 - 28 mars. Pas 10-12 ditë nga shartimi, fidanëve iu bë prerja e pjesës mbi pikën e shartimit për nënshartesën dhe nën pikën e shartimit për mbishartesën. Fidanët e shalqirit, të përgatitur si më sipër, u mbollën në fushë, pasi kishin formuar 3-4 gjethet e vërteta, më 17-20 prill.

Skema eksperimentale e zbatuar ka qenë ajo e bllokut të randomizuar me tre përsëritje. Sipërfaqja e variantit në një përsëritje ka qenë 33.6 m² dhe përfaqësohet nga 15 bimë të mbjella në një rresht me gjatësi 12,0 m.

Në vegjetacion, në përshtatje me kushtet e krijuara dhe me gjendjen e zhvillimit të bimëve, u kryen ujtitje, plehërime, trajtime kimike, etj.

Vjelja e prodhimit u bë kur frutat kishin arritur pjekjen tregtare; ajo filloi në fund të qershorit e vazhdoi deri fillim të gushtit.

Gjatë periudhës bimore janë mbajtur rregullisht shënimet fushore, për fenologjinë e bimëve, dinamikën e vjeljes, sasinë e frutave të vjelë, sasinë e frutave të tregtushëm e ato jashtë standardit, biometrinë e frutave dhe përmbajtjen e lëndës së thatë e të sheqerit në fruta në çastin e vjeljes, mbi bazën e të cilave janë bërë vlerësimet e duhura për përcaktimin e nënshartesave më të mira. Në përfundim, materiali shifër u analizua sipas ANOVA 1.

REZULTATET DHE DISKUTIMI TYRE

Në provat krahasuese të shalqinjve “Crimson sweet” dhe “Crisby F₁”, të shartuar me pesë nënshartesat, “Macis”, “RS-841”, “Polifemo”, “Strong Tosa” dhe “Shintosa”, krahasuar me bimët e kontrollit të pa shartuara, rezultatet e arritura janë tepër shprehëse dhe me interes për prodhimin. Në mënyrë të përmbledhur ato jepen në pasqyrat vijuese(1-6).

Karakteristikat e rritjes së bimëve. Rezultatet e eksperimentimit treguan se gjatësia e kërcellit kryesor dhe numri i lastarëve anësor të zhvilluar për bimë, në të dy kultivarët e shalqirit, janë ndikuar ndjeshëm nga shartimi dhe nënshartesa e përdorur (Tabela 1 dhe 4). Bimët e kontrollit kanë pasur kërcell kryesor më të shkurtër, në krahasim me bimët e shartuara. Kërcell më të gjatë kanë zhvilluar bimët e shartuara mbi nënshartesat “RS 841” dhe “Shintosa”, përkatësisht 324 -326 cm tek shalqiri Crimson sweet dhe 263-302 cm tek Crisby F₁, ose dy herë më të gjatë se në kontrollin e pa shartuar. Rezultate të ngjashme, me diferenca të vogla e të pa vërtetuara statistikisht kanë dhënë edhe nënshartesat “Strong Tosa” dhe “Polifemo”; madje kjo e fundit me shalqirin Crisby F₁ ka zhvilluar kërcell me gjatësi të barabartë me “RS 841”. Kërcell më të shkurtër, por gjithsesi 40-50 % më të gjatë se në bimët e pa shartuara, ka formuar nënshartesa Macis (*Lagenaria siceraria*). Ndikimi i nënshartesave në numrin e lastarëve anësor ka qenë i ngjashëm me atë të trajtuar për gjatësinë e kërcellit kryesor. Bimët e shartuara kanë formuar mesatarisht 5-7 lastarë anësor tek Crimson sweet

dhe 7- 9 lastarë anësor tek Crisby F₁, kurse bimët e kontrollit, për të dy kultivarët e shalqirit, kanë formuar mesatarisht nga 4,0 lastar anësor.

Nënshartesat e përdorura kanë ndikuar edhe në zhvillimin e bimëve, ndonëse në një shkallë të vogël. Përfunduar nënshartesën “Polifemo”, për të dy kultivarët e shalqirit, tek të tjerat frutat e parë kanë arritur pjekjen 3-5 ditë më vonë se në kontroll. Nënshartesa “Polifemo” nuk ka pas ndikim në gjatësinë e periudhës së pjekjes së frutave të parë.

Karakteristika të prodhimit. Efekti i shartimit mbi karakteristikat e rritjes dhe zhvillimit të bimëve, është shoqëruar me ndryshime të ndjeshme e me vlerë në treguesit e prodhimtarisë. Karakteristikat e prodhimit të bimëve të shalqirit Crimson sweet dhe Crisby F₁, të shartuar dhe të pa shartuar, jepen në tabelat 2 dhe 5.

Diferenca të mëdha e të vërtetuara ka pasur ndërmjet bimëve të shartuara e të pa shartuara, por edhe midis nënshartesave të përdorura, si për numrin e frutave të vjelë për bimë ashtu edhe për peshën mesatare të tyre (Tabela 2 dhe 5). Bimët e shartuara mbi “RS 841”, “Polifemo”, “Strong Tosa” dhe “Shintosa” kanë prodhuar më shumë fruta, rreth + 45 % më shumë tek Crimson sweet dhe + 72 % më shumë tek Crisby F₁, pas tyre vijnë bimët e shartuara mbi “Macis”, kurse varianti kontrollit (bimë të pa shartuara) ishte dukshëm më i ulët (1,32 dhe 2,1 fruta/bimë, përkatësisht për kultivarët Crimson sweet dhe Crisby F₁). Pësha mesatare e frutave të shalqirit Crimson sweet dhe Crisby F₁, gjithashtu, u ndikua ndjeshëm nga shartimi ose jo i bimëve. Fruta me peshë mesatare më të lartë janë prodhuar nga bimët e shartuara mbi nënshartesat “RS 841”, “Polifemo” dhe “Shintosa”. Këto nënshartesa kanë prodhuar fruta me peshë mesatare 5.4 – 5,7 kg për kultivarin Crisby F₁ dhe 7,4 -7,6 kg për kultivarin Crimson sweet, ndërkohë që frutat e prodhuar nga bimët e kontrollit kishin peshë mesatare përkatësisht 4,4 kg dhe 5,3 kg. Fruta më të vegjël, por gjithsesi me peshë më të lartë se kontrolli, janë prodhuar me nënshartesën “Macis”, përkatësisht 4,6 dhe 6,4 kg.

Në të njëjtat kushte kultivimi, prodhimi i shalqirit ka qenë dukshëm i ndikuar nga shartimi dhe nënshartesa e përdorur për shartim. Bimët e shalqirit Crimson sweet dhe Crisby F₁, me të pesë nënshartesat në studim, kanë dhënë prodhim deri dy herë më të lartë se kontrolli.

Rezultatet e mara, nga eksperimentet e këtij studimi, flasin për vlerat e nënshartesave dhe të shartimit në bimët e shalqirit, teknikë kjo që, duke zhvilluar dhe fuqizuar sistemin rrënjor, ndikon në rritjen dhe zhvillimin e bimëve dhe për rrjedhojë në prodhimin e tyre. Këto rritje mund të shpjegohen me avantazhet e nënshartesave dhe shartimit si teknikë, mes të cilave, toleranca ndaj sëmundjeve të tokës, temperaturës së ulët në tokë gjatë pranverës, tolerancë ndaj pranisë së kripës në tokë, përvetësimi më të mirë të ujit dhe lëndëve ushqyese në tokë, etj (Rivero et al., 2003). Nga ana tjetër, këto efekte pozitive të shartimit, të ndikuara nga nënshartesat e ndryshme, veçanërisht “RS-841”, “Polifemo” dhe “Shintosa”, kanë prodhuar bimë më të fuqishme dhe një rritje të vërtetuar të prodhimit, dukshëm më të lartë se në bimët e pa shartuara të kontrollit. Por mes nënshartesave, ajo “Macis” ka shkaktuar rritje më të dobët të bimëve dhe për rrjedhojë rendiment më të ulët. Edhe pse karakteristikat e tjera të prodhimit nuk janë ndikuar nga kushtet e rritjes, pësha mesatare e frutave ndikohet nga masa bimore dhe nga forca e sistemit rrënjor. Shalqiri si kulturë është shumë i ndjeshëm ndaj temperaturave të ulëta, që janë një faktor kryesor për reduktimin e zhvillimit të masës vegetative dhe organeve riprodhuese (luleve, frutave dhe farës). Disa nënshartesa, mes të cilave edhe RS-841, janë më të qëndrueshme ndaj temperaturave të ulëta (Rivero et al., 2003).

Cilësia e frutave. Karakteristikat e cilësisë së frutave të bimëve të shartuara dhe të pa shartuara janë dhënë në tabelat 3 dhe 6. Indeksi i frutave (raporti gjatësi-diametër) dhe trashësia e lëkurës nuk janë ndikuar nga shartimi apo lloji i nënshartesës.

Lënda e thatë e tretshme është një tregues që mat në mënyrë të tërthortë përmbajtjen e sheqerit apo “ëmbëlsinë” në fruta. Edhe për treguesin e sasisë së lëndës së thatë në tulin e frytit nuk ka diferenca të mëdha në mes të kontrollit dhe bimëve të shartuara.

Për sa i përket treguesve cilësor, në literaturë ndeshen mendime kontradiktore. Nga autorë të ndryshëm është raportuar se shartimi mund të ketë efekte negative në cilësinë e frutave, sidomos në varësi nga nënshartesat e përdorura (Lee, 1994; Traka-Mavrona et al, 2000.). Rezultatet tona, për të pesë nënshartesat në provë, nuk tregojnë për ndonjë efekt negativ të shartimit në cilësinë e frutave. Madje, nënshartesat “Polifemo” dhe “Shintosa”, të përdorura me shalqirin Crisby F₁, kanë shtuar sasinë e lëndës së thatë e të sheqerit në fruta, krahasuar me kontrollin. Rezultate të ngjashme janë raportuar edhe nga Yetisir et al. (2003) dhe Miguel et al. (2004). Përmbajtja e lëndës së thatë në tulin e frutave më shumë ndikohet nga kultivari shalqirit, kushtet klimatike e tokësore të mjedisit të rritjes dhe koha e vjeljes së prodhimit.

Tabela 1. Karakteristika të rritjes së bimëve të shalqirit Crimson sweet, nën ndikimin e nënshartesave.

Nr	Varianti	Gjatësia e kërcellit kryesor, cm	Numri i lastarëve anësor.	Pjekja e frytit(ditë pas mbjelljes në fushë),
1	C sweet/ pa shartuar	164	4	73
2	C sweet/Macis	231	6	76
3	C sweet/RS 841	324	7	78
4	C sweet/Polifemo	292	5	74
5	C sweet/Strong Tosa	287	6	76
6	C sweet/Shintosa	326	7	78
	DMV-0,05	34	1,4	2,8

Tabela 2. Karakteristika të prodhimit të shalqirit Crimson sweet, nën ndikimin e nënshartesave.

Nr	Varianti	Numri frutave/bimë	Pesha mesatare frytit, kg	Prodhimi mesatar për bimë, kg
1	C sweet/ pa shartuar	1,32	5,3	6,9
2	C sweet/Macis	1,48	6,4	9,5
3	C sweet/RS 841	1,86	7,4	13,8
4	C sweet/Polifemo	1,73	7,5	13,0
5	C sweet/Strong Tosa	1,80	7,1	12,8
6	C sweet/Shintosa	1,92	7,6	14,6
	DMV-0,05	0,32	0,43	1,54

Tabela 3. Karakteristika cilësore të frutave të shalqirit Crimson sweet, nën ndikimin e nënshartesave.

Nr	Varianti	Indeksi i frutave (Raporti H/D)	Trashësia e lëkurës, mm	Lënda e thatë e tretshme, %
1	C sweet/ pa shartuar	1,10	16	9,7
2	C sweet/Macis	1,05	18	10,2
3	C sweet/RS 841	1,13	18	10,6
5	C sweet/Polifemo	1,12	17	10,8
5	C sweet/Strong Tosa	1,10	17	9,8
6	C sweet/Shintosa	1,12	18	10,5
	DMV-0,05	NS	NS	0,34

Tabela 4. Karakteristika të rritjes së bimëve të shalqirit Crisby F₁, nën ndikimin e nënshartesave

Nr	Varianti	Gjatësia e kërcellit kryesor, cm	Numri i lastarëve anësor.	Pjekja e frytit(ditë pas mbjelljes në fushë),
1	Crisby/ pa shartuar	142	4	68
2	Crisby/Macis	219	8	73
3	Crisby/RS 841	268	8	73
4	Crisby/Polifemo	273	7	69
5	Crisby/Strong Tosa	245	8	73
6	Crisby/Shintosa	302	9	71
	DMV-0,05	37	1,1	2,1

Tabela 5. Karakteristika të prodhimit të shalqirit Crisby F₁, nën ndikimin e nënshartesave

Nr	Varianti	Numri frutave/bimë	Pesha mesatare frytit, kg	Prodhimi mesatar për bimë, kg
1	Crisby/ pa shartuar	2,1	4,4	9,3
2	Crisby/Macis	2,8	4,6	12,8
3	Crisby/RS 841	3,4	5,4	18,3
4	Crisby/Polifemo	3,2	5,6	17,9
5	Crisby/Strong Tosa	3,2	5,4	17,3
6	Crisby/Shintosa	3,6	5,7	20,5
	DMV-0,05	0,56	0,32	1,8

Tabela 6. Karakteristika cilësore të frutave të shalqirit Crisby F₁, nën ndikimin e nënshartesave

Nr	Varianti	Indeksi i frutave (Raporti H/D)	Trashësia e lëkurës, mm	Lënda e thatë e tretshme, %
1	Crisby/ pa shartuar	1,10	14	9,4
2	Crisby/Macis	1,15	15	9,7
3	Crisby/RS 841	1,23	16	9,8
5	Crisby/Polifemo	1,20	15	10,2
5	Crisby/Strong Tosa	1,20	16	9,7
6	Crisby/Shintosa	1,22	16	10,2
	DMV-0,05	NS	NS	0,28

PËRFUNDIME

1. Rezultatet e përftuara tregojnë se teknika e shartimit ka ndikuar pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin e bimëve dhe prodhimin e shalqirit, pa ulur cilësinë tregtare dhe vlerat ushqyese të frutave.
2. Këto efekte janë të ndryshme, në varësi nga nënshartesat e përdorura.
3. Bimët e shalqinjve të shartuara mbi nënshartesën “Shintosa” kanë dhënë prodhim më të lartë se nënshartesat e tjera. Rezultate të mira e me vlerë për prodhimin e shalqirit kanë dhënë edhe nënshartesat “RS 841” e “Polifemo”. Më pak fruta për bimë e prodhim më të ulët, midis nënshartesave të studiuara, ka dhënë “Macis”.

4. Bimët e pa shartuara dhanë më pak fruta dhe prodhim më të ulët se ato të shartuara mbi pesë nënshartesat e studiuara.
5. Lënda e thatë e tretshme, pra edhe sheqeri në tulin e frutave, ishin gjithashtu në mënyrë të konsiderueshme më të larta në të gjitha trajtimet e shartuara.

REFERENCAT

1. Chouka, A.S. and H. Jebari, 1999. Effect of grafting on watermelon on vegetative and root development, production and fruit quality. *Acta Hortic.*, 492: 85-93.
2. Edelstein, M., R. Chen, Y. Burger, S. Shriber and D. Shtienberg, 1999. Integrated management of sudden wilt in melons, using grafting and reduced rates of methyl bromide. *Plant Dis.*, 83: 1142-1145.
3. Jani, S. 2000. Prodhimi i fdidanëve të shartuar në bostanore. Tiranë.
4. Lee, J.M. and M. Oda, 2003. Grafting of Herbaceous Vegetable and Ornamental Crops. In: *Horticultural Reviews*, Janick, J. (Ed.). Vol. 28, John Wiley and Sons Inc., Oxford, UK., pp: 61-124.
5. Lee, J.M., 1994. Cultivation of grafted plants, I. Current status, grafting methods and benefits. *Hortic. Sci.*, 29: 235-239.
6. Miguel, A., J.V. Maroto, A. San Bautista, C. Baixauli and V. Cebolla et al., 2004. The grafting of triploid watermelon is an advantageous alternative to soil fumigation by methyl bromide for control of Fusarium wilt. *Sci. Hortic.*, 103: 9-17.
7. Rivero, M., J., M. Ruiz and L. Romero, 2003. Role of grafting in horticultural plants under stress conditions. *Food. Agric., Environ.*, 1: 70-74.
8. Traka-Mavrona, E., M. Koutsika-Sotiriou and T. Piritza, 2000. Response of squash (*Cucurbitasp.*) as rootstock for melon (*Cucumis meloL.*). *Scientia Hortic.*, 83: 353-362.
9. Yetisir, H. and N. Sari, 2004. Effect of hypocotyl morphology on survival rate and growth of watermelon seed lings grafted on rootstocks with different emergence performance at arious temperatures. *Turk. J. Agric. For.*, 28: 231-237.

**STUDIM KRAHASUES I DISA KULTIVARËVE TË PJEPRIT PËR PRODHIM NË
SERRA
COMPARATIVE STUDY ON MUSKMELON VARIETIES CULTIVATED IN
GREENHOUSE**

SOKRAT JANI⁽¹⁾ dhe LIRI MIHO⁽²⁾

⁽¹⁾ Qendra e Resurseve Gjenetike të Bimëve, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

⁽²⁾ Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit,
Universiteti Bujqësor i Tiranës, SHQIPËRI.

sokratjani@yahoo.com; liri-miho@hotmail.com;

PËRMBLEDHJE

Studimi kishte për qëllim përzgjedhjen e varieteteve të pjeprit të përshtatshëm për kultivim në serë në zonën e ulët bregdetare të vendit. Dymbëdhjetë kultivarë të rinj u vlerësuan për prodhimtarinë dhe cilësinë e frutave. Eksperimentet u kryen në periudhën 2010-2013 në serrat me plastmasë (PE) të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Lushnje. Skema eksperimentale ishte ajo e bllokut të randomizuar me tre përsëritje. Çdo kultivar në përsëritje përfaqësohet nga 15 bimë të mbjella në një rresht me gjatësi 6,0 m. Centro F₁ dha prodhim më të lartë të frutave për treg (85 kv/dyn), por cilësia e frutave nuk dallonte shumë nga të tjerët. Prodhim më të ulët dhanë kultivarët Galia F₁, Inbar F₁ dhe Super sprint F₁, 28-32% më pak se mesatarja e kultivarëve në provë (55, 3 kv/ dyn). Parnitho F₁, Galica F₁ dhe Niz 52-131 F₁ janë 7-9 ditë më të hershëm se kultivari i përhapur tashmë në prodhim, Dicty F₁. Parnitho F₁ kishte përmbajtje të lartë të sheqerit, shije të shkëlqyer, rritje të shpejtë, por rendiment më të ulët krahasuar me Centro F₁. Dicty F₁, Centro F₁, Parnitho F₁ dhe Niz 52-131 F₁, janë të përshtatshëm për kultivimin në serë në zonën e ulët e bregdetare të vendit, dhe kjo mund të konsiderohet për të demonstruar dhe promovuar më tej përhapjen e tyre.

Fjalë kyçe: *Studim krahasues, kultivar pjepr, prodhim; serra; sasi e cilësi fryti.*

ABSTRACT

A comparative study carried out with objective selecting the melon varieties which are suitable for cultivation in the greenhouse in low coastal area of the country. Twelve entries of muskmelon were evaluated for yield and fruit quality in a replicated trial during the period 2010-2013 in greenhouses at the Agricultural Technology Transfer Center in Lushnje. The experimental design was a randomized complete block with three replications. Each cultivar in plot represented by 15 plants planted in a row with a length of 6.0 m. Melons were harvested at full slip. 'Centro F₁' produced the greatest yield of marketable melons (85 kv / dyn), but fruit quality was not significantly different from the others. Only 'Galia F₁', 'Inbar F₁' and ' Super sprint F₁' produced yields significantly lower than 'Centro F₁' and 28-32% less than the average of the cultivars tested (55, 3 kv / dyn). Entries with the greatest percentage of early yield were 'Parnitho' (61 %), 'Niz 52-131' (56 %) and 'Galica' (50 %) and those with the lowest were 'Gallardo' (15 %) and 'Galia' (18 %). 'Parnitho F₁' had the character of high sugar content, excellent taste, rapid growth, but lower yield compared with 'Centro F₁'. 'Dicty F₁', 'Centro F₁', 'Parnitho F₁' and 'Niz 52-131 F₁' are suitable for cultivation in the greenhouse in low coastal area of the country, and this can be considered to further demonstrate and promote their distribution.

Key words: *Comparative study, muskmelon cultivars, cultivation, greenhouse, yield; fruit quality.*

HYRJE

Pjepri është kulturë e rëndësishme primore dhe me vlera në furnizimin e tregut. Vitet e fundit, krahas shtimit të sipërfaqes së kultivuar në fushë të hapur, po zgjerohet ajo në serra. Efektiviteti i kultivimit në serra është i ndërvarur nga dy faktorë të rëndësishëm: nga struktura e kultivarëve të shtrirë në prodhim dhe nga teknologjia e kultivimit që zbatohet. Për sa i përket strukturës së kultivarëve, vitet e fundit është bërë një progres që vlen të çohet më tej. Deri para 8-10 vjetësh, ndonëse sipërfaqja e mbjellë në serra ishte relativisht e vogël, mbillej kryesisht me kultivarët Galia, Dicty F₁ e Polycarp F₁. Më pas në strukturën e mbjelljes u futën edhe disa kultivar të tjerë, të pastudiuar më parë, të sjellë nga tregtarë dhe amatorë të kësaj bime, të cilët nuk i qëndruan tregut. Një nga kërkesat më të rëndësishme për prodhuesit është zgjedhja e kultivarit që ka tipare të dëshirueshme, mes të cilëve prodhimtari të lartë, qëndrueshmëri ndaj sëmundjeve dhe faktorëve mjedisor, cilësi të larta të tullit (të tillë si konsistencë dhe përmbajtje të lëndës së thatë të tretshme), dhe cilësi të lëkurës (të tillë si ngjyra, rrjetëzimi dhe thelëzimi). Duke parë që sipërfaqja e serrave në Shqipëri është e përqendruar kryesisht në rrethet Lushnjë, Fier e Durrës, pra në zonën mesdhetare fushore (rrethe që mbjellin edhe sipërfaqen më të madhe të pjeprit), u pa e arsyeshme që studimi krahasues i kultivarëve të rinj të pjeprit në serra diellore të kryhet në rrethin e Lushnjës. Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i kultivarëve të rinj të ofruara nga kompanitë e shumta të farës për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre në kushtet klimatike të zonës në fjalë. Një studim i tillë ka qenë e do të jetë një ndihmesë më shumë për të orientuar fermerët drejt kultivarëve më të mirë.

MATERIALI DHE METODA

Studimi u krye në periudhën 2010-2013 (në vitin 2012 nuk u krye) në një serrë të mbuluar me PE dhe ventilim pasiv, në Bazën Eksperimentale të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Lushnjë (QTTB-Lushnjë).

Toka ka qenë e tipit *Fluvisole*, me përbërje mekanike nën-deltinore e mesme, me këtë përmbajtje: Humus 1,9%; Azot 0,127%; P₂O₅ – 2.61 mg/100g; K₂O-2.65 % dhe pH ujor 7.8. U krahasuan dymbëdhjetë kultivarë pjepri (Tabela 1) dhe konkretisht Dicty F₁ (kontroll), Parnitho F₁, Galica F₁, Inbar F₁, DRG-26 69 F₁, Velos F₁, Niz 52 130 F₁, Niz 52 131 F₁, Centro F₁, Gallarda F₁, Super sprint F₁ dhe Galia F₁. Përgjatë kultivarët Centro F₁ dhe Super sprint F₁, që janë pjepri të rrjetëzuar të tipit italian, gjithë të tjerët janë të tipit Galia. Pjepri Galia është i njohur për cilësitë e tij të jashtëzakonshme. Ky pjepër i rrjetëzuar me ngjyrë lëkure të verdhë, tul të gjelbër-mente, shumë aromatik dhe i ëmbël është krijuar nga seleksioneri izraelit, Zvi Karchi dhe u hodh në prodhim në 1973 (Karchi, 2000). Që atëherë, ai është bërë një fryt popullor në të gjithë vendet e Mesdheut dhe Evropës.

Largësia e mbjelljes së bimëve midis rreshtave ka qenë 120 cm dhe midis bimëve në rresht 40 cm. Dendësia 2.08 bimë/m².

Skema eksperimentale ka qenë ajo e bllokut të randomizuar, me tre përsëritje. Sipërfaqja e variantit në një përsëritje ka qenë 7,2 m² dhe përfaqësohet nga 15 bimë të mbjella në një rresht me gjatësi 6,0 m. Fara, në vitet e studimit, u mboll në kubikë (tava polisteroli me 60 fole secila) më 9-10 shkurt; mbirja u siguroi midis 12 dhe 15 shkurt dhe fidanët në serrë u mbollën më 20-23 mars. Vjelja filloi më 2-4 qershor.

Gjatë përgatitjes së tokës, në plehërimin bazë, u përdorën 40-50 kg/dyn NPK:20-20-20.

Pjepri u kultivua në sistemin vertikal të mbështetur në spango. Deri në lartësinë 40 cm nga toka u pastruan bimët nga lastarët, degëzat frutore dhe frutat. Nga ky nivel e deri në lartësinë e telit u hoqën lastarët shterpë, kurse ata prodhues u shkurtuan 1-2 gjethe pas frytit. Dy-tre gjethe mbi nivelin e telit u pre maja e kërcellit kryesor.

Në vegjetacion, në përshtatje me kushtet e krijuara dhe me gjendjen e zhvillimit të bimëve, u kryen ujitje, prashitje, spërkatje, etj. Në dy javët e para pas mbjelljes në serrë, u bënë tre

ushqime të bimëve, me tretësirë NPK(10-40-10), me përqendrimin 0.2%, duke përdorur 200 ml për bimë. Pas kësaj, gjatë ujitjeve me sistemin me pika, u hodhën gjashtë duar Terraflex(17-7-21) me përqendrim 0.7%, llogaritur 200 ml për bimë, me interval 4-5 ditë. Më tej, u përdor ushqim i balancuar 20-20-20, me një normë prej 4-4g/bimë, çdo 3-4 ditë.

Vjelja u bë duar-duar kur frutat kishin arritur pjekjen tregtare.

Gjatë periudhës bimore janë mbajtur rregullisht shënimet fushore, për fenologjinë e bimëve, dinamikën e vjeljes, sasinë e frutave të vjelë, sasinë e frutave të tregtushëm e ato jashtë standardit, biometrinë e frutave dhe përmbajtjen e lëndës së thatë e të sheqerit në fruta në çastin e vjeljes, mbi bazën e të cilave janë bërë vlerësimet e duhura për përcaktimin e kultivarëve më të mirë. Në përfundim, materiali shifër u analizua sipas ANOVA 1.

REZULTATET DHE DISKUTIMI I TYRE.

Treguesit e prodhimit

Ndërmjet kultivarëve të studiuar ka pasur diferenca të dukshme e me interes për tu analizuar(Tabela 1). Për sa i përket hershmërisë së prodhimit, e përlllogaritur me numrin e ditëve nga mbjellja e fidanëve në serrë e deri në pjekje të frytit të parë, kultivarët kanë pasur sjellje të ndryshme. Më i hershëm ka qenë Velos F₁ (73 ditë) dhe më të vonë kultivarët Dicty F₁, Gallarda F₁ dhe Galia(82-83 ditë). Kultivarët e tjerë në provë zënë vend ndërmjetës.

Mes kultivarëve në provë ka pasur diferenca të dukshme e të vërtetuara për sa i përket numrit të frutave të vjelë për bimë e për njësi sipërfaqe. Më shumë fruta për njësi sipërfaqe janë vjelë në kultivarët Super sprint F₁, Parnitho F₁ dhe Centro F₁, përkatësisht 7.4, 7,6 dhe 8.4 fruta/m². Në kultivarët DRG-2669 F₁, Inbar F₁ dhe Galia F₁ ky tregues është më i ulët se në gjithë kultivarët e tjerë, përkatësisht 4.2, 5.1 dhe 5.2 fruta/ m².

Ndryshime ka pas midis kultivarëve në provë edhe për treguesin peshë mesatare të frytit. Fruta më të vegjël, me peshë mesatare më të ulët, ka pas kultivari Super sprint F₁, vetëm 1140 g. Më i lartë ka qenë ky tregues tek kultivarët Niz 52-130 F₁, Velos F₁, DRG-2669 F₁ dhe Niz 52-131 F₁, përkatësisht 2125, 2200, 2500 dhe 2780 g. Për këtë tregues, kultivarët e tjerë në provë zënë vend ndërmjetës.

Rezultatet e prodhimit për treg, të paraqitura në tabelën 1, tregojnë se kultivarët në provë kanë dhënë një prodhim mesatar prej 37-85.0 kv/dyn. Mes tyre, me interes për një epërsi të dukshme, bie në sy kultivari Centro F₁, i cili ka dhënë 85.01 kv/dyn, rreth 49% më shumë se Dicty F₁, kultivar ky i përhapur në prodhim ose rreth 54% më shumë se mesatarja e kultivarëve të vënë në provë. Po kështu, por në masë më të vogël(rreth 12-23% mbi mesataren e kultivarëve në provë), dallojnë ndaj të tjerëve edhe kultivarët Parnitho F₁, Niz 52-130 F₁ dhe Niz 52-131F₁. Prodhimtari më të ulët kanë pasur kultivarët Super sprint F₁, Inbar F₁ dhe Galia F₁, të cilët kanë dhënë përkatësisht 37.63, 39.00 dhe 41.0 kv/dyn, ose përafërsisht 65-70% e prodhimit të Dicty F₁ (57.05 kv/dyn).

Rezultatet e mësipërme të prodhimit të tregtueshëm, janë statistikisht të vërtetuara, gjë që i bënë ato të zbatueshme në kushte të prodhimit të gjerë.

Nga vlerësimi, në kushte kultivimi, rezulton se në tërësi kultivarët në provë dallohen për qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve të vrugut dhe hirit. Mes tyre thuajse të pa prekura nga këto sëmundje janë bimët e Dicty F₁, Centro F₁, Inbar F₁, dhe Niz 52-130 F₁. Prekje në shkallë të lehtë deri në mesatare nga hiri kanë Galia dhe Galica F₁.

Treguesit e cilësisë së frutave

Diferencat në treguesit cilësor të frutave kanë nxjerr në pah ndryshimet që ekzistojnë mes kultivarëve të studiuar për madhësinë e frutave dhe trashësinë e tultit(Tabela 2). Fruta me tregues gjatësie më të lartë kanë kultivarët Velos F₁, DRG-2669 F₁, Niz 52-130 F₁, Niz 52-131 F₁ dhe Centro F₁, nga 16.9 – 17.1 cm dhe më i ulët është ky tregues tek Super sprint F₁ (12.7 cm). Fruta me diametër(gjerësi) më të madh kanë DRG-2669 F₁ e Niz 52-131 F₁,

përkatësisht 16.8 dhe 17.4 cm; më i ulët është ky tregues tek Super sprint F₁ (12.6 cm). Raporti mes këtyre parametrave shpreh deri diku formën e frytit, një tregues me vlerë tregtare. Përjashtuar kultivarin Velos F₁, që formon fruta gati në formë cilindrike (raporti H/D=1.20) dhe Centro F₁ me formë më afër asaj eliptike (H/D=1.16), kultivarët e tjerët kanë fruta me formë thujse sferike. Për treguesin e trashësisë së tulit, pra pjesës së frytit që konsumohet, dallimet mes kultivarëve janë më se të dukshme. Ky tregues shkon nga 3.2 cm tek kultivari Super sprint F₁; 3.5-4.0 cm tek grupi kultivarëve Dicty F₁, Parnitho F₁, Inbar F₁ dhe Centro F₁; 4.1-5.0 cm tek grupi i kultivarëve Galica F₁, DRG-2669 F₁, Velos F₁, Niz 52-130 F₁ dhe Galia F₁; mbi 5.0 cm tek Niz 52-131 F₁ (tek ky i fundit tuli ka trashësi mesatare prej 5.22 cm).

Në përgjithësi, kultivarët në provë, kanë lëkurë të hollë, me trashësi 0.25-0.5 cm. Përjashtim bëjnë kultivarët DRG-2669 F₁ (0.7 cm) dhe Velos F₁ (0.1 cm), madje treguesi i ulët i trashësisë së lëkurës e ka bërë këtë të fundit të paqëndrueshëm ndaj dëmtimeve mekanike dhe kalbëzimit.

Për shkak të bashkëveprimit të shumë parametrave (për shembull, përmbajtja e sheqerit, aroma, ngjyra, tekstura) në përcaktimin e karakteristikave cilësore të shijimit të frutave, matja e një parametri të vetëm, sikurse përmbajtja e sheqerit, ndonjëherë është e mjaftueshme për të pasur një vlerësim objektiv të cilësisë së përgjithshme të shijeve të frutave (Vallone et al., 2013). Është vërejtur gjithashtu se kultivarët të ndryshëm kanë tendencë të ndjekin ndryshime të ngjashme në perceptimin shijor-shqisor gjatë pjekjes së frutave. Rezultatet shqisore, për parametrat "intensiteti i ngjyrës", "aroma e përgjithshme", "aromë me shije fryti", "aroma erë myku", "shije të ëmbël" dhe "pas shija", tregojnë se ato rriten me avancimin e procesit të pjekjes së frutit, ndërsa për parametra të tillë si "aromë kastravec", "qëndrueshmëri", "fortësi", "fibra" dhe "shije të thartë" në tul, rezultatet tregojnë se ato përgjithësisht ulen me avancimin e pjekurisë (Vallone et al., 2013).

Lënda e thatë e tretshme është një tregues që mat në mënyrë të tërthortë përmbajtjen e sheqerit apo "ëmbëlsinë" në fruta. Kultivarët në provë kanë pasur diferenca të vërtetuara për përmbajtje të lëndës së thatë dhe sheqerit në fruta. Përmbajtja mesatare e lëndës së thatë varion nga 8.2 tek Super sprint F₁ në 12.9 % tek Inbar F₁. Përmbajtja e lëndës së thatë në Inbar F₁ ishte dukshëm më e lartë se në gjithë kultivarët e tjerë, përveç Galica F₁, Niz 52-131 F₁ dhe DRG-2669 F₁. Për këtë tregues ka pasur dallime të vërtetuara edhe në mes të tre viteve të studimit; kështu në vitin e dytë, lënda e thatë, pra, sheqeriteti (ëmbëlsia), ishte më i ultë se sa në vitin e parë dhe të tretë, çka konfirmohet edhe në gjetje të autoreve të tjerë, se jo vetëm kultivari, por edhe kushtet e kultivimit kanë efekte të rëndësishme në përmbajtje të lëndës së thatë e sheqerit në frutat e pjepit (Erdinc C, et al, 2008). Madje, kultivar të veçantë kanë pasur sjellje të ndryshme nga dukuria e sipërcituar. Kështu, Velos F₁ në vitin e dytë kishte sasi të lëndës së thatë më të lartë (9,2%) se sa në vitin e parë (8,2 %) dhe të tretë (7,6%), ndërsa Super sprint F₁ e kishte këtë tregues më të lartë në vitin e parë e të tretë (përkatësisht 8,8 dhe 8,6 %). Në kultivarët e tjerë sasia e lëndës së thatë ka ruajtur diferencat në vite (Tabela 2). Dallimet në mes kultivarëve, kushtet e rritjes dhe metodat e vlerësimit të pjekurisë së frutave, në mes të studimeve të ndryshme, si dhe variacionet në përmbajtjen e lëndës së thatë në fruta (Mizuno, Kato, Harada, Miyajima, dhe Suzuki, 1971) mund të përbëjnë diferencat e konstatuara. Shkalla e pjekjes së frutave në vjelje, kultivari, data e mbjelljes dhe kushtet klimatike e të kultivimit ndikojnë në nivel sasior dhe cilësor në përbërjen kimike dhe karakteristikat fizike të frutave në pjepër, në fund të fundit ato ndikojnë në perceptimin ndijor gjatë konsumit (Vallone et al., 2013).

Fruta me tul më të qëndrueshëm, më kompakt dhe që e ruajnë më mirë fortësinë gjatë procesit të pjekjes, krahas kultivartit Dicty F₁, tashmë të njohur e të shtrirë në prodhim, kanë pasur kultivarët Galica F₁ dhe Parnitho F₁, përkatësisht 40 dhe 32 N. Tul më të butë e më pak të qëndrueshëm kanë pasur Super sprint F₁ dhe DRG-2669 F₁, përkatësisht 9 dhe 22 N.

Tabela 1. Disa tregues të prodhimit të kultivarëve të studiuar (Mesatare, 2010 -2013).

(*)Kultivarët	(**) Periudha bimore, ditë	Fruta të vjelë, (no/m ²)	Pesha mesatare e frutave, kg	(***) Prodhimi për treg, kv/dyn
Dicty F ₁	82	5,6	1,640	57,05
Parnitho F ₁	75	7,6	1,480	61,62
Galica F ₁	75	6,2	1,760	50,93
Inbar F ₁	76	5,1	1,740	39,04
DRG-26 69F ₁	77	4,2	2,500	50,91
Velos F ₁	73	6,4	2,200	52,63
Niz 52-130 F ₁	76	6,5	2,125	68,20
Niz 52-131 F ₁	75	5,9	2,780	68,39
Centro F ₁	79	8,4	1,910	85,01
Gallardo F ₁	83	5,7	1,580	50,62
Super sprint F ₁	76	7,4	1,140	37,63
Galia F ₁	83	5,2	1,600	40,98
DMV(0.05)	2,8	1.6	0.3	13.8

(*) Centro dhe Super sprint janë kultivar të tipit Italian, të tjerët tipi Galia; (**) Periudha nga mbjellja e bimëve në serrë deri në vjelje të frytit të parë (ditë); (***) 1 kv=100 kg dhe 1 dyn=1000 m² ;

Tabela 2. Karakteristikat cilësore të frutave të kultivarëve të studiuar (Mesatare, 2010-2013)

Kultivarët	Karakteristika cilësore te frutave					
	Gjatësi fryti(H), cm	Gjerësi fryti (D), cm	Trashësi tuli, cm	Trashësi lëkurës,cm	Lënda e thatë, %	Fortësia e tulit (N)
Dicty F ₁	15.1	14.5	3.64	0.44	9.8	36
Parnitho F ₁	15.1	13.8	3.92	0.28	11.3	32
Galica F ₁	15.8	14.6	4.16	0.26	11.9	40
Inbar F ₁	15.8	14.4	3.96	0.38	12.9	24
DRG-26 69F ₁	16.9	16.8	4.60	0.70	11.7	22
Velos F ₁	16.5	13.7	4.02	0.10	8.5	28
Niz 52-130 F ₁	16.9	15.5	4.38	0.50	10.7	26
Niz 52-131 F ₁	16.9	17.4	5.22	0.24	11.8	28
Centro F ₁	17.1	14.8	3.70	0.50	10.8	26
Gallardo F ₁	14.9	13.9	4.00	0.30	8.5	26
Super sprint F ₁	12.7	12.6	3.20	0.40	8.2	9
Galia F ₁	15.5	13.8	4.10	0.28	9.4	22
DMV(0.05)	1.11	0.87	0.3	0.13	1.2	6

PËRFUNDIME

Rezultatet e arritura tregojnë se ka pasur diferenca të mëdha e të vërtetuara në mes të dymbëdhjetë kultivarëve të pjeprit. Ato kontribuojnë, midis të tjerave, për të diferencuar karakteristikat morfologjike, biometrike dhe agro-ekonomike të kultivarëve të studiuar dhe për të nxjerrë në dukje më të mirët, me qellim përhapje të tyre në prodhim.

1. Kultivari Centro F₁, është i tipit italian. Dallohet për bimë të qëndrueshme ndaj sëmundjeve të hirit (*Erysiphe cichoracearum*; *Sphaerotheca fuliginea*), vrugut (*Pseudoperonospora cubensis*) dhe vyshkjes nga fuzarioza (*Fusarium oxysporum* ssp.). Ka lidhje të mirë me fruta; ata janë me formë gati eliptike, me thelëzim dhe rrjetëzim sipërfaqësor, me peshë mesatare rreth 2.0 kg. Ngjyra e frytit është e gjelbër e hapur me nuanca gri dhe të verdha. Tuli i frytit është me trashësi 3.7 cm dhe ngjyrë portokalli intensive. Jep rreth 85.0 kv/dyn prodhim për treg.

2. Kultivari Parnitho F₁, është i tipit Galia, i hershëm, me fryt të rrumbullakët, me rrjetëzim fin e uniform, me ngjyrë lëkurë të verdhë dhe ngjyrë tuli krem-mente. Frutat kanë peshë mesatare pak a shumë uniforme 1500 g. Jep mesatarisht 61.6 kv/dyn prodhim për treg. Dallohet për frytëzim në tërë gjatësinë e bimës dhe qëndrueshmëri relativisht të mirë ndaj sëmundjeve.

3. Kultivarët Niz 52-130 F₁ dhe Niz 52-131 F₁, janë të tipit Galia, të hershëm, me fryt gati të rrumbullakët, me rrjetëzim fin e uniform, me ngjyrë lëkure të verdhë dhe ngjyrë tuli krem. Frutat kanë peshë mesatare pak a shumë uniforme 2200-2500 g. Japin rreth 68.0 kv/dyn prodhim për treg. Dallohen për frytëzim në bazë të bimës dhe qëndrueshmëri relativisht të mirë ndaj sëmundjeve.

4. Kultivarët e tjerë të studiuar kanë tregues prodhimtarie dhe cilësi fryti më të ulët.

REFERENCAT

1. Erdinc, C., Turkmen, O., and Sensoy, S. (2008). Comparison of some local melon genotypes selected from Lake Van Basin with some commercial melon cultivars for some yield and quality related traits observed in field and high tunnel conditions. African Journal of Biotechnology Vol.7 (22): 4105-4110.
2. Karchi, Z. 2000. Development of melon culture and breeding in Israel. Acta Hort. 510:13-17.
3. Mizuno, T., Kato, K., Harada, M., Miyajima, Y., & Suzuki, E. (1971). Studies on the free sugars and amino acids in a fruit of muskmelon. Journal of The Japanese Society for Food Science and Technology, 18, 319-325.
4. Mitchell, J.M., Cantliffe, D.J., Sargent, S. A., Datnoff, L. E., and Stoffella, P.J. (2007). Fruit Yield, Quality Variables, and Powdery Mildew Susceptibility of Galia Melon Cultivars Grown in a Passively Ventilated Greenhouse. Proc. Fla. State Hort. Soc. 120:162-167.
5. Vallone, S., Lloyd, Sivertsen, H., Anthon, G. E., Barret, D.M., Mitcham, E.J., Ebeler, S. E., & Zakharov, F. (2013). An integrated approach for flavour quality evaluation in muskmelon (*Cucumis melo* L. *reticulatus* group) during ripening. Food Chemistry 139 (2013): 171-183.

GENETIC VARIABILITY FOR YIELD AND YIELD COMPONENTS AMONG MAIZE LANDRACES

SHUKRI FETAHU¹, SALI ALIU¹, IMER RUSINIVCI¹ AND DUKAGJIN ZEKA¹

¹University of Prishtina “Hasan Prishtina” Faculty of Agriculture and Veterinary, Str. “Bill Clinton” nn. 10000 Prishtina, KOSOVA.

(Email: shfetahu@hotmail.com & shukri.fetahu@uni-pr.edu)

ABSTRACT

In order to determine genetic variability for yield and yield components, on 21 maize landraces, it was set up a field trial on randomized complete block design (RCDB), with three replications, during the year 2013, at Experimental Didactic Farm (EDF), Faculty of Agriculture and Veterinary in Prishtina. Yield and yield components are depending from specific characteristics: genotype of maize landraces (ML), environmental condition (EC) and cropping system (CS). Information on genetic variability regarding ML for yield components will benefit growers and users, to choose ML that best fit their needs. The field trials were conducted according to the formula: (ML-21 x Replication, R-3 x Parameters, P-5) =315 results. The essential principles for improving yield, for a specific location, suitable for the agro-ecological condition is ML selection, without increasing of cost of maize production. The means for yield and yield components were: ear weight⁻¹ EW μ =99.84g, grain yield ear⁻¹, GYE μ =81.03g, weight of 1000 grain, WTG μ =296.83g, grain yield per plant⁻¹ GYP μ =108.32g and yield per unit are μ = 6.18MT ha⁻¹. The aim of study was to evaluate genetic variability for yield and yield components among different ML that are collected from rural areas in Kosova, but no appropriate data for the above-mentioned traits. The obtained results were with wide range variability and high significant differences among ML on the level P 0.01 and P 0.05. That information is useful for: planning conservation and identification the best ML as food sources for human consumption and gene donors in maize breeding program.

Key words: *Maize landraces, ear, yield components, traits, plant, variability.*

1. INTRODUCTION

Maize production in Kosova is important in both terms: for grain and silage, due to the fact of its high yield, high energy forage, produced with lower labour and machinery requirements than other crops (Fetahu et al., 2009; 2014). Maize is one of the main and most important crops in Kosovo, which is sown in 70 to 80,000 ha with an average grain yield 3 to 4 ton ha⁻¹ (MAFRD, 2012). Planted area with maize landraces in Kosova, sixties years ago were planted 100%, while currently planting area cover only 5% - 8.42% (Fetahu et al. 2005). In rural areas, the farmers cultivate ML in traditional CS, based on high ability for adaptation in different environmental condition, with various purposes, particularly for human food. These landraces were maintained by farmers as open-pollinated populations and thus each of them represent a collection of highly heterozygous and heterogeneous plants. For long time maize landraces have been exposed to the complex of environmental and human factors, and as a consequence they are characterized by genetic variability that has passed through the process of natural selection (Fetahu, 2007). Cultivation of maize landraces is important for traditional agriculture, so it contributes on conservation, cultivation and management plant resources for nutrition and food production for the local market needs, (Okumus et al. 2007). Plant are grown in the form of open pollination, and thus each group represents heterozygous and heterogeneous genotype, which are selected by the farmers, adapted in different environmental conditions with hundreds years of cultivation, and as such are valuable genetic resources (Harda et al. 2009). The genetic diversity of maize landraces is the most

immediately useful part of maize biodiversity (Lucchini et al. 2003). Despite the abundance of genetic variability within maize, the germplasm base of commercial maize inbreeding programs is relatively narrow (Tarter et al. 2004). The amount and distribution of maize landraces, is still unknown, and their value in Kosovo is not well investigated, but decrease planted areas with maize landraces consequently increases the risk of loss of genetic diversity. Increased production per plant and per unit area is primary objective of breeding programmes for selection the best maize genotype for food production. An appreciable level of variation within and between maize landraces is essential to initiate and sustain genetics improvement using plant breeding methods for food production. Assessment of existing landraces is useful in maintaining genetic diversity and preserving from genetic erosion. For this purpose they were collected, for evaluation and conservation in Gene Bank for Plant Genetic Resources in Kosova. This study was undertaken to evaluate genetic variability for yield and yield components among ML from different rural areas in Kosovo. Determination of genetic variability and identification the maize landrace with high yield components will contribute into many aspects: production, collection, conservation plant genetic resources, breeding program and food production.

2. MATERIAL AND METHODS

During 2011 and 2012, in rural areas were collected some accessions from different farmers and localities, for the needs of Gene Bank of Kosovo. Altitudes of localities were from 414 to 960 M. A. S. L, located in north-south and central-eastern parts of Kosova, where production of cereals is more concentrated (Table 1).

Code	Longitude	Latitude	Elevation (m)	Geographical origin
KS-01	20 ⁰ 44' 39''	42 ⁰ 82' 46''	520	Malishevë
KS-03	20 ⁰ 44' 07''	42 ⁰ 28' 48''	525	Malishevë
KS-05	20 ⁰ 44' 04''	42 ⁰ 28' 01''	566	Malishevë
KS-07	20 ⁰ 45' 08''	42 ⁰ 41' 35''	694	Drenas
KS-11	21 ⁰ 31' 27''	42 ⁰ 34' 05''	810	Kamenicë
KS-13	21 ⁰ 31' 34''	42 ⁰ 34' 34''	719	Kamenicë
KS-15	21 ⁰ 31' 32''	42 ⁰ 34' 04''	802	Kamenicë
KS-17	21 ⁰ 20' 20''	42 ⁰ 35' 36''	810	Prishtinë
KS-19	21 ⁰ 16' 16''	42 ⁰ 06' 55''	741	Kaçanik
KS-27	21 ⁰ 13' 20''	42 ⁰ 54' 07''	602	Podujevë
KS-29	20 ⁰ 54' 59''	42 ⁰ 34' 09''	602	Komoran
KS-31	21 ⁰ 11' 57''	42 ⁰ 38' 32''	676	Prishtinë
KS-33	21 ⁰ 11' 20''	42 ⁰ 57' 17''	608	Podujevë
KS-35	21 ⁰ 06' 00''	42 ⁰ 22' 59''	614	Ferizaj
KS-37	20 ⁰ 51' 19''	42 ⁰ 21' 50''	422	Suharekë
KS-39	21 ⁰ 16' 27''	42 ⁰ 37' 59''	656	Prishtinë
KS-41	21 ⁰ 16' 53''	42 ⁰ 37' 27''	670	Prishtinë
KS-43	20 ⁰ 48' 11''	42 ⁰ 45' 13''	625	Skenderaj
KS 45	20 ⁰ 46' 46''	42 ⁰ 45' 09''	644	Skenderaj
KS-47	20 ⁰ 47' 53''	42 ⁰ 44' 30''	602	Skenderaj
KS-49	20 ⁰ 47' 41''	42 ⁰ 45' 10''	616	Skenderaj

During 2013, a randomized complete block design trial (RCBD), with 21 different (ML), and three replications was conducted at experimental didactic farm (EDF), Faculty of Agriculture

and Veterinary in Prishtina, situated between 42°38'97'' N, latitude and 21°08'45'' E latitude, at an elevation of 571 MASL. The distance between rows was 70 cm, whereas the distance between plants within rows was 25 cm or (70 x 25 cm = 5.71 plant m⁻² or 57.100 plants ha⁻¹. Each plot consisted of 4 rows, and each row was 5m long with inter and intra row space of (0.70 m x 0.25 m =5.71 plant m², and a plot had 14 m² with a total of 80 plants which were considered for data collection. Fertilizer type NPK (15:15:15), was applied at a rate of 300 kg ha⁻¹, while during the vegetation period at a rate of 54 kg-N ha⁻¹. The investigated factors and parameters were conducted according to experimental formula: (Maize landrace, ML-21 X Replications, R-3 X Parameters, P-5) = 315 results.

Measurements: The following data were collected for yield and yield components were conducted for: Ear weight (EW), grain yield ear⁻¹ (GYE), weight of 1000 grain (WTG), grain yield per plant⁻¹ (GYP) and metric ton hectare⁻¹ (MT). All yield and yield component, were measured at field and laboratory of the 10 plants from 4 (four) rows were randomly harvested from two of the middle rows (10 plants x 3 replicates = 30 plant).

Kjo shpreh në terma praktik një numër më të madh eksplantesh të gatshëm për fazën e dytë të organogenezës gjë e cila konvertohet në numër më të lartë të fidanëve të prodhuar. Ndërsa Varieteti “Sukthi” ka një inicim relativisht të mirë të qelizave kallusore veçanërisht në variantet me 0,2mg/l 2,4D dhe 0,8 mg/l NAA që kanë një zhvillim më të mirë të qelizave kallusore.

Grafik 2. Numri i eksplanteve nga Hipokotili qe kane formuar qeliza kallusore per varietetet “Sukthi” dhe “Adona”



Ndërsa përse i përket efektit të fitohormoneve 2,4 D dhe NAA në inicimin e kallusimit në eksplantet e marra nga Hipokotili për “Sukthi” dhe “Adona” siç vërehet edhe nga grafiku kemi një zhvillim të mirë të kallusimit pothuajse në mënyrë të njëjtë si për 2,4 D edhe NAA nuk vërehen ndryshime sasiore të vërtetuara statistikiisht.

Në përfundim mund të shprehem që faza e kallusimit për eksplantet e patëllxhanit “Sukthi” dhe “Adona” të marra nga Kotiledonet dhe Hipokotili kanë një zhvillim të mirë dhe iniciojnë

qeliza kallusore në intervalin nga 75% tek Varianti 6 (për varietetin Sukthi) me përdorimin e përqëndrimit të fitohormonit 0,8mg/l NAA tek eksplantet me origjinë nga Kotiledonet deri në 100 % tek Variantet 1 dhe Varianti 2 me 0,2 mg/l dhe 0,5 mg/l të 2,4 D tek eksplantet me origjinë nga Kotiledonet dhe Hipokotili.

Qelizat kallusore janë inicuar me lehtësi dhe varieteti “Adona” ka një epërsi të lehtë veçanërisht përse i përket eksplanteve të marra nga Kotiledonet por të pa vërtetuar statistikiisht, enigma qëndron në vështirësinë e shfaqjes së organogjenezës nga këto qeliza amorfe të prodhuara.

2- Ndikimi i fitohormoneve 2,4 D dhe NAA në formimin e bisqeve dhe bimëzave të reja nga qelizat kallusore të marra nga eksplantet e Kotiledoneve dhe Koleoptilit.

Pas 8 javësh (4 javë pas kallusimit) kemi provuar formimin e organogjenezës së bisqeve të rinj që kanë zanafillën nga qelizat kallusore.


Në figurën e mëposhtme vërehen fillesat e bisqeve që diferencohen nga qelizat amorfe të kallusit që rrjellin nga eksperimenti Nr.1 i përshkruar më sipër. Për çdo grumbull qelizor kallusor që rrjellin nga ndarja e një eksplanti të vetëm krijohen me qindra bisqe.

Foto.2. Formimi i bisqeve gjate organogjenezes ne eksplantet e marre nga Kotiledonet dhe Hipokotili per varietetet “Sukthi” dhe “Adona”



Për varietetin “Sukthi”, shihet mjaft qartë nga grafiku i mëposhtem inicimi i organogjenezës nga qelizat kallusore me origjinë nga eksplantet e marra nga Kotiledonet varion nga 10% te totalit te eksplanteve tek Varianti 6 të trajtuar me 0.8 mg/l NAA , 30% tek Varianti 1 të trajtuar me 0.2 mg/l 2,4 D duke arritur rezultatin më të mirë tek Varianti 3 dhe 4 që përdoren respektivisht përqëndrimet 0,5 dhe 0,8 mg/l 2,4 D me rreth 60 % dhe maksimumin tek Varianti 4 që përdoret përqëndrimi 0,2 mg/l NAA me rreth 75 %.

Grafik.3. Numri i bisqeve gjate organogjenezes ne eksplantet e marre nga Kotiledonet per varietetet “Sukthi” dhe “Adona”




Ndërsa për varietetin “Adona”varion nga më e ulëta me 45% në Variantin 1-0,2mg/l 2.4D, maksimumi tek Varianti 4-0,2 mg/l NAA , 0,2mg/l NAA dhe 6-0,2 mg/l NAA që kanë rezultat më të mirë në organogjenezë arrin 100% për 20 eksplantet të marra për çdo variant. Bazuar në Analizën e Variancës rezulton se ka një ndryshim të vërtetuar statistikisht ndërmjet numrit të bisqeve të krijuar nga varieteti “Adona“ të krahasuar me varietetin shqiptar “Sukthi”.

Në përfundim mund të shprehemi se Varieteti shqiptar “Sukthi” ka një zhvillim më të ulët të numrit të bisqeve të krijuar gjatë organogjenezës së varietetit francez”Adona” për eksplantet e marra nga Kotiledonet.

Ndërsa përse i përket rrënjëzimit të bisqeve ajo është e lehtë dhe nuk do krijojnë problem për fazat e mëtejshme për krijim e fidanëve nga teknika e embriogjenezës somatike.

Pra iniciimi i organogjenezës (zhvillimi i bisqeve) nga qelizat kallusore që rrjellin nga Kotiledonet është relativisht i mirë dhe jep një produktivitet të kënaqshëm të bisqeve për të dy varietetet.

Grafik.4. Numri i bisqeve gjate organogjenezes ne eksplantet e marre nga Hipokotili per varietetet “Sukthi” dhe “Adona”



Nga rezultatet e marra nga trajtimi i qelizave kallusore të Hipokotilit me 6 përqëndrime të ndryshme të fitohormonit rezultoi që organogjeneza (formimi i bisqeve) është mjaft e dobët. Për varietetin "Sukthi" formimi i bisqeve varion nga 0% tek Varianti 4 ku është përdorur 0,2mg/l NAA në 15% tek Varianti 2 ku është përdorur 0,5 mg/l 2,4-D me një rezultat më maksimal tek Varianti 3 ku është përdorur 0,8mg 2,4-D dhe ka një formim të bisqeve në masën 40% por me një zhvillim mjaft të reduktuar siç vërehen qartë nga Grafiku 4.

Varieteti "Adona" ka një zhvillim mjaft të dobët të bisqeve nga qelizat kallusore të Koleoptilit Variantet 5-0,5 mg/l NAA dhe 6-0,8mg/l NAA nuk kanë asnjë inicim të bisqeve nga qelizat kallusore të koleoptilit, ndërsa varianti 2-0,4mg/l 2,4D me 30% dhe 3-0,8mg/l 2,4 D që shkon deri në 60% të zhvillimit të bisqeve.

Në përfundim mund të themi se qelizat e marra nga koleoptili të varieteteve "Sukthi" dhe "Adona" nuk kanë një zhvillim të mirë të organogjenezës, japin bisqe të pakët dhe me përmasa të reduktuara dhe nuk kanë vlerë praktike për tu përdorur kjo metodë.

Si përfundim të dhënave të organogjenezës së bisqeve të formuara nga Kotiledonet janë krahasuar me ato të formuara nga hipokotilet.

Nga analiza e variancës së të dhënave të marra në rrugë eksperimentale del që F është 8.25376 dhe F crit 3,6823.

Ngrihen hipotezat: H0 faktori eksplant nuk ndikon, H1, faktori eksplant ndikon.

Sipas testit të Fisherit me qëF (f e llogaritur) është më e madhe se Fcrit (F tabelare)

Hipoteza zero bie pra faktori eksplant ndikon

Po kështu meqë probabiliteti P-Value është më i vogël se probabiliteti 0.05 (niveli i rëndësisë, tregon se edhe një herë H0 bie dhe mbetet H1, pra faktori eksplant ndikon.

Pra si përfundim verifikohet statistikisht se eksplantet e marra nga Kotiledonet tek Patëllxhani shqipar "Sukthi" dhe "Adona" japin një numër më të madh bisqesh se sa eksplantet e marra nga hipokotilet nëpërmjet metodës së Embriogjenezës Somatike.

REKOMANDIME

Duke u bazuar në të dhënave eksperimentale mund të konkludojmë në rekomandimet e mëposhtme:

- Shumëzimi i Patëllxhanit *Solanum melongena* var. "Sukthi" dhe "Adona" nëpërmjet teknikës së embriogjenezës somatike është realizuar me sukses dhe rekomandohet të përdoret nga specialistët për qëllimi të ndryshme shkencore dhe prodhimi.
- Përfundimisht mund të shprehemi që faza e kallusimit për eksplantet e patëllxhanit "Sukthi" dhe "Adona" të marra nga Kotiledonet dhe Hipokotili kanë një zhvillim të mirë dhe iniciojnë qeliza kallusore në intervalin nga 75% deri 100%. Varieteti "Adona" ka një epërsi të lehtë veçanërisht përsa i përket eksplanteve të marra nga Kotiledonet por e pa vërtetuar statistikisht.
- Në përfundim mund të theksojmë se varieteti shqiptar "Sukthi" ka një zhvillim më të reduktuar të numrit të bisqeve të krijuar gjatë organogjenezës të vërtetuar statistikisht se varieteti francez "Adona" për eksplantet e marra nga Kotiledonet.
- Në përfundim mund të konkludojmë që qelizat e marra nga koleoptili të varieteteve "Sukthi" dhe "Adona" nuk kanë një zhvillim të mirë të organogjenezës, japin bisqe të pakët dhe me përmasa të reduktuara dhe nuk kanë vlerë praktike për tu përdorur kjo metodë.
- Ndërsa përsa i përket rrënjëzimit të bisqeve ai është i lehtë dhe nuk do krijojnë problem për fazat e mëtejshme për krijimin e fidanëve nëpërmjet teknikës së embriogjenezës somatike.

LITERATURA

1. Hutchinson M., Krishnaraj S. Morphological and physiological changes during thidiazuron-induced somatic embryogenesis in geranium (*Pelargonium x hortorum* Bailey) hypocotyl cultures. International Journal of Plant Sciences 1996 1, 57:440-446.
2. Matsuoka H., Hinata K. NAA-induced organogenesis and embryogenesis in hypocotyl callus of *Solanum melongena* L. Journal of Experimental Botany 1979, 30:363-370.
3. Rao P., Singh B. Plantlet regeneration from encapsulated somatic embryos of hybrid *Solanum melongena*L. Plant Cell Report 1991, 10:7-11.
4. Sagare A.P., Suhasini K., Krishnamurthy K.V. Histology of somatic embryo initiation and development in chickpea (*Cicer arietinum* L.). *Plant Science* 1995, 109:87-93.
5. Schmidt E.D.L., Jong J.A. Signal molecules involved in plant embryogenesis. *Plant Molecular Biology* 1994, 26:1305-1313.
6. Van Hengel A., Guzzo F., Van Kammen A. Expression pattern of the carrot EP3 endochitinase gene in suspension cultures and in developing seeds. *Plant Physiology* 1998, 117:43-53.
7. Zimmerman L.J. Somatic embryogenesis: a model for early development in higher plants. *The Plant Cell* 1993, 5:1411-1423.
8. Vuksani Gj., et al. Regeneration of eggplants *Solanum melongena* var.*Sukthi* through somatic embryogenesis. *Albanian j. agric. sci.* 2014 (Special edition) .

VIRAL STATUS OF PLUM POX VIRUS (PPV) IN REPUBLIC OF MACEDONIA

MIRJANA STANOEVSKA¹, SUZANA KRATOVALIEVA², DHURATA SHEHU³

¹State Phytosanitary Laboratory – Skopje. Ministry of Agriculture, Forestry and water
Economy

REPUBLIC OF MACEDONIA

mimist6926@gmail.com

²State Phytosanitary Laboratory – Skopje. Ministry of Agriculture, Forestry and water
Economy

REPUBLIC OF MACEDONIA

suzanakratovalieva@gmail.com

³Department of Plant Protection. Agricultural University of Tirana
ALBANIA

dhuratashehu@info.al

ABSTRACT

Within the period 2008-2015 was followed the appearance of quarantine Plum Pox Virus (PPV), its distribution and the occurrence of caused disease sharka in the Republic of Macedonia. PPV is on A2 list of European and Mediterranean plant protection organization (EPPO), which includes those diseases and pests that are present in the region of Europe. Diagnosis of PPV is conducted in State Phytosanitary Laboratory accredited according ISO17025:2006 regarding accredited EPPO protocols by DAS - ELISA test using a specific kit. An analysis of the total 127 samples are carried out at five different plant species plum, peach, apricot, cherry and sour cherry. Samples are supplied by imports from Serbia, Bulgaria, Greece, Albania, Bosnia and Herzegovina and France (62 samples) and from inside the country from different regions of the region of Gradsko, Valandovo, Kocani, Sveti Nikole, Stip, Veles Kumanovo, Kriva Palanka, Kratovo and Tetovo (65 samples). Positive finding was noted in 6 samples, from which 3 samples imported from Serbia (2 at peach and 1 at plum) and 3 samples from inside the country (at plum in the region of Kratovo - 2 and in the region of Valandovo - 1). At the remaining 121 sample is not diagnosed PPV. These studies show that PPV is present in Macedonia, but not yet widespread in large sizes.

Key words: PPV, sharka, distribution, quarantine, DAS – ELISA.

1. INTRODUCTION

Sharka is the most devastating viral disease in the world of stone fruits, including plum, peach, apricot, nectarine, almond, cherry and sweet cherry, caused by *Plum pox potyvirus*. Global costs related to the management pattern, are estimated at 10 000 million over the last 30 years (Thompson et al., 2001).

The disease was first observed in plums in Bulgaria in the period from 1915 to 1918. However, the disease was first described in 1932, when prof. D. Atanasov called "Sharka of plum". Today, the name pattern is used as the common name of the disease worldwide (Boscia et al., 1997; Gottwald et al., 1995).

Symptoms depend on the type of host, the virus strain, age, temperature and status of plant nutrients.

Often, many trees fail to show symptoms soon after infection (latent infection). The lack of symptoms (Thomas et al., 2015), however, is not proof that the tree is healthy and does not have the disease (Németh, 1994).

In some cases, symptoms can be observed only of few leaves or fruit, only of few branches, or may be expressed to the whole tree.

Symptoms may occur in the spring and early summer and disappear later in the summer (Roy and Smith, 1994). When symptoms occur, they are very easily recognizable.

The leaves appear chlorosis, yellowing and necrosis with light green spots on the stem.

By some varieties of peaches which are sensitive are notes discolorations of the leaves (Kalashyan et al., 1994).

Symptoms of the fruits of plum spots on the skin often there are discoloration of the flesh of the fruit, severe disability and premature decline 20-30 days before the normal maturity.

2. MATERIALS AND METHODS

The study was conducted in the period 2007 - 2015 in the Republic of Macedonia. Examined the presence of Plum pox potyvirus in plum, peach, apricot, cherry and sour cherry. Appropriate sample selection is critical for serological or molecular detection. The standard sample was taken of 5 shoots or 10 fully expanded leaves collected around the canopy of each individual tree from the middle of each scaffold branch, until the appearance of high temperatures at the beginning of summer. Samples were taken by border and regional inspectors placed in plastic bags and taken to a laboratory where they were stored in a refrigerator at 4 ° C until further laboratory analysis.

Peach propagating material



Plum propagating material



Source: Images of Mirjana Stanoevska

Description of the test: weighs 1g of plant material and put in plastic bags. Add about 20 vol Extraction buffer and homogenized in Homexi 6 homogenizer of Bioreba.

Method: EPP0 protocols for serological tests (PPV)

Proceedings of the ELISA method:

Stage 1. Set the solution of antibody

Prepare an appropriate dilution of rabbit-PPV polyclonal immunoglobulins in carbonate buffer pH 9.6. Add 100 μ L to each well. Incubate at 37 °C for 4 h. Wash the wells three times with PBS-Tween (washing buffer)

Stage 2. Preparation and application of samples.

Add 100 μ L per well of the plant extract (see sample preparation). Use two wells of the plate for each sample or positive controls and at least two wells for negative controls. Incubate at 4 °C for 16 h. Wash as before.

Peach extract



Plum extract




Source: Images of Mirjana Stanoevska

Stage 3. Preparation and application of conjugatit.

Add antimouse immunoglobulins conjugated with alkaline phosphatase: prepare an appropriate dilution of antimouse immunoglobulins conjugated with alkaline phosphatase in PBS plus 0.5% BSA. Add 100 μ L to each well. Incubate at 37 °C for 4 h. Wash as before.

Sample extraction



Incubation of microtiter plates




Source: Images of Mirjana Stanoevska

Stage 4. Preparation and application of the substrate.

Prepare 1 mg/mL alkaline phosphatase solution (pnitrophenylphosphate) in substrate buffer (Appendix 1). Add 100 μ L to each well. Incubate at room temperature and read at 405 nm after 30 and 60 min.

Pipetting of diluted solution



ELISA reader



Source: Images of Mirjana Stanoevska

The ELISA test is negative if the absorbance of the sample is less than three times the absorbance of the healthy control. The ELISA test is positive if the absorbance of the sample is equal or greater than three times the absorbance of the healthy control.

3. RESULTS AND DISCUSSION

7-year results obtained by analyzing 127 samples of five different kinds of fruit plants - peach, plum, apricot, cherry and cherry for Plum Pox Virus (PPV) received information about the presence of the disease caused by the PPV quarantine on the territory of the Republic of Macedonia.

Positive finding was noted in 6 samples; 3 samples imported from Serbia (2- peach, 1 - plum) and 3 samples from inside the country (plum: 2 - Kratovo region and 1 - Valandovo region). The remaining 121 sample were negative on PPV infection.

CONCLUSIONS

These studies show that PPV is present in Macedonia, but not yet widespread in large sizes. To prevent the spread of the virus is recommended:

- Use of healthy seedlings
- Use of resistant varieties and substrates
- Regular testing of nurseries for PPV
- Chemical control lice insecticide
- Control weeds
- Production of virus-free trees

LITERATURE

1. D. Boscia, H. Zeramardini, M. Cambra, O. Potere, M.T. Gorris, A. Myrta, B. Di Terlizzi, V. Savino, *European Journal of Plant Pathology*, 1997, Volume: 103, Issue 5, 477-480

Production and characterization of a monoclonal antibody specific to the M serotype of plum pox potyvirus

2. Gottwald, T. R.; Avinent, L.; Llácer, G.; Mendoza, A. H. de; Cambra, M., *Plant Disease*, 1995, Vol. 79 No. 3 pp. 266-278

Analysis of the spatial spread of sharka (plum pox virus) in apricot and peach orchards in eastern Spain

3. D. Thompson, M. McCann, M. MacLeod, D. Lye, M. Green, and D. James, Centre for Plant Health, Canadian Food Inspection Agency, 8801 East Saanich Road, Sidney, BC, Canada V8L 1H3, January 2001, Volume 85, Number 1, Page 97

First Report of Plum Pox Potyvirus in Ontario, Canada

4. D. Thomas Lowery, Patricia M. Vickers, Lori A. Bittner, Lorne W. Stobbs, Robert G. Footitt

DOI: <http://dx.doi.org/10.1093/jee/tov172> First published online: 13 July 2015

Aphid Transmission of the Ontario Isolate of Plum Pox Virus

5. Roy, A. S. and SMITH, I. M., 1994, Plum pox situation in Europe. EPPO Bulletin, 24: 515–523. doi: 10.1111/j.1365-2338.1994.tb01064.x, EPPO, 1 rue le Nôtre, 75016 Paris (France), Volume 24, Issue 3, pages 515–523, September 1994

Plum pox situation in Europe

6. Kalashyan, Yu. A., Bilkey, N. D., Verderevskaya, T. D. and Rubina, E. V., 1994, Plum pox potyvirus on sour cherry in Moldova. EPPO Bulletin, 24: 645–649. doi: 10.1111/j.1365-2338.1994.tb01078.x, Moldavian Horticultural Research Institute, Costiujeni str. 1 4, Kishinev, Moldova, 27 7072, Volume 24, Issue 3, pages 645 649, September 1994

Plum pox potyvirus on sour cherry in Moldova

7. Németh, M., 1994, History and importance of plum pox in stone-fruit production. EPPO Bulletin, 24: 525–536. doi: 10.1111/j.1365-2338.1994.tb01065.x, Plant Health and Soil Conservation Station, P.O. Box 127, Budapest (Hungary)

†Paper presented at the EPPO Conference on Plum Pox, Bordeaux (FR), 1993–10–05/08, Volume 24, Issue 3, pages 525–536, September 1994

History and importance of plum pox in stone-fruit production

**VLERËSIMI MBI PËRHAPJEN DHE INTESITETIN E FUZARIOZËS SË
KALLIRIT TË GRURIT (*Fusarium graminearum*) NË KULTIVARËT E GRURIT TË
BUTË NË PROVAT E ESHFF-VE NË QTTB-NË LUSHNJE
ESTIMATES ON THE PREVALENCE AND INTENSITY OF THE FUSARIUM
HEAD BLIGHT (FHB) OF WHEAT (*Fusarium graminearum*) IN SOFT WHEAT
CULTIVARS IN TESTS ON THE TARGET ESHFF ATTC-IN LUSHNJE
DORINA BELI*; HEKURAN VRAPI*; MAJLINDA GJACI*; SONILA DALANI*;
SKENDER VARAKU***

* Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti
Bujqësor i Tiranës SHQIPERI
Email: hvrapi@gmail.com

PERMBLEDHJE

Fuzarioza e kallirit të grurit *Fusarium graminearum* (*Gibberella zeae*) është një ndër sëmundjet më të përhapura në Shqipëri dhe në vite të veçanta me lagështi në periudhën e lulëzimit dëmi i saj është i konsiderueshëm. Në bashkëpunim me (ESHFF)-ve dhe (QTTB)-së Lushnje si zona më e përshtatshme për kultivimin e grurit u ngrit ky eksperiment në fushat e kësaj QTTB-je gjatë sezonit të mbjelljes 2014-2015. Në studim u përfshinë: 13 Kultivar gruri, (krijuar nga institucionet kërkimore shkëncore dhe të sjellë nga kompani të huaja për tu testuar në kushtet e vendit tonë) me dëshmues dy kultivaret vendas Dajti dhe LVS. Përhapja dhe intesiteti i sëmundjes është ndjekur çdo 10 ditë nga periudha e fillimit të lulëzimit deri në pjekje. Nga vërtetimet del se kemi një përhapje dhe intesitet të ndryshëm të sëmundjes në kultivarë të ndryshëm ku më mirë paraqiten kultivarët 1, 5, 9, dhe 11 në krahasim me kultivarët e tjerë dhe me dëshmuesit Dajti dhe LVS.

Fjalet Kyçe: Intesitet, grurë, kultivarë, përhapje,

ABSTRACT

Fusarium head blight (FHB) of wheat *Fusarium graminearum* (*Gibberella zeae*) is one of the most widespread diseases in Albania and in special years with humidity in the height of its damage is substantial. In cooperation with (ESHFF) and seizures (ATTC) - the Lushnje as more appropriate areas for cultivation of wheat that the experiment was set up in areas of the ATTC-art during the 2014-2015 planting season. In the study included: 13 wheat cultivars, (created by scientific research institutions and bring foreign companies to be examined in terms of our country) to witness two local cultivars DAJTI and LVS. Spread and intensity of the disease every 10 days following the start of the flowering period to haverast. From assesment appears that we have a spill and intensity different disease in different cultivars where better presented cultivars 1, 5, 9, and 11 in as compared to other cultivars and the witness DAJTI and LVS.

Key words: Intensity, wheat, cultivars, severity,

HYRJE

Gruri është kultura më e përhapur në botë dhe mbillet në të gjitha kontinentet. Kjo bën që në çdo muaj të vitit në rruzullin tokësor të ketë vënde që mbjellin ose korrin grurë. Ai rritet nga Khartumi në brezin ekuatorial, deri në gjërësinë gjeografike 66°32' të hemisferit verior në Alaskë, Kanada, Finlandë e Rusi, në pika të tilla ku temperatura mesatare e muajit janar është -19°C dhe me një minimale -40°C. (Harlan, J.R., 1981) Prodhimi botëror i grurit që nga viti 1900 deri në vitin 2010 pothuajse është gjashtëfishuar. Në vitin 1903 prodhohej 106.6 milion/ton, ndërsa sot, prodhimi botëror luhet në kufijtë e 725 milion/ton dhe konsumi vjetor, lëviz nga 152-154 kg/frymë, (FAO : 2014) ndërsa në vëndin tonë 190 kg/frymë

(**Raport vjetor 2014**). Prodhuesit më të mëdhenj në botë janë Kina me 16.9% të prodhimit botëror me 115Milion/ ton e dyta India me 11.9% me 81Milion/ton e me radhë Rusia, USA e Franca.

Gjatë ciklit jetësor bima e grurit i nënshtrohet një game të gjerë stresesh të shkaktuara nga agjente biotik ku përfshihen sëmundjet, dëmtuesit, barërat e keqia si dhe nga agjentët abiotik siç janë: temperatura, lagështia, drita, etj. (**Ruci,TH; Sulovari,H; Vrapit,H. 2007**) Padyshim këta janë faktorët kryesorë të uljes së prodhimit të grurit, por në aspektin praktik ndeshen vështirësi të mëdha për të llogaritur humbjet.

Një nga studimet më të hershme për humbjet në grurë në shkallë botërore, u bë nga (**Cramer 1967**) i cili konkludoi se 5% e humbjeve vinte prej insekteve, 9,1% nga sëmundjet dhe 9.8% nga barërat e këqija, në një total prej 23.9% në mbarë botën. (**Russell 1981**) i konsideroi këto përqindje si të nënvlerësuara për shkak të mos llogaritjes së humbjeve të pasvjeljes dhe dëmtimeve të shkaktuara nga nematodat, molusqet dhe vertebrorët

Sëmundjet kryesore gjethore, që prekin kulturën e grurit janë ndryshku i gjethëve (*Puccinia recondita*), ndryshku i verdhë (*Puccinia striiformis*), Septorioza e gjethes dhe e kallirit (*Septoria tritici* dhe *Stagonospora nodorum*), hiri (*Blumeria graminis f. spp. tritici*), helmintosporioza e gjethes (*Pyrenophora tritici-repentis*) dhe Fuzarioza e kallirit të grurit (*Fusarium graminearum*) (**Hasani, M., Ruci, TH.,2002**).

Duke parë tendencën e përgjithshme për shtimin e prodhimit të grurit, u ndërmor ky studim duke pasur si qëllim : Studimin e disa sëmundjeve kryesore që prekin kallirin e grurit dhe kryesisht Fuzariozës së kallirit të grurit (*Fusarium graminearum*) dhe ndikimi i tyre në prodhim dhe cilësinë e tij. Për realizimin e këtij qëllimi janë caktuar këto objektiva: 1- Vlerësimi i Indeksit të sëmundjes ndaj sëmundjeve kryesore që prekin kallirin e grurit dhe kryesisht Fuzariozës së kallirit të grurit (*Fusarium graminearum*) në zonën e Lushnjës. 2- Identifikimi dhe përzgjedhja e kultivarëve me prodhimtari të lartë ndaj sëmundjeve kryesore që prekin kallirin e grurit dhe kryesisht Fuzariozës së kallirit të grurit (*Fusarium graminearum*).

MATERIALI DHE METODA

Vendi i eksperimentit: Në bashkëpunim me (ESHFF)-ve dhe (QTTB)-në Lushnjë si zona më e përshtatëshme për kultivimin e grurit u ngrit ky eksperiment në fushat e kësaj QTTB-je. QTTB -ja Lushnjë Ndodhet në gjërësitë gjeografike 40° 57'06'' në Veri, 19°41'08'' në Lindje. Lartësia mbi nivelin e detit. 11m. Sasia e reshjeve vjetore prej 730- 957mm në vit. Temperaturat mesatare vjetore variojnë nga 6.1°C në Janar dhe 23.1°C në Qershor.

Skema eksperimentale: Skema ku u realizua eksperimenti u bë një skemë komplet bllok i randomizuar (RCBD) me tre përsëritje dhe në 13 variante (Skema. 1). Çdo variant u mboll në një sipërfaqe prej 20 m² dhe numri i variantëve është 13 me dëshmuar kultivarin LVS dhe Dajti. Ndërmjet çdo varianti lihet një rrugicë me gjerësi prej 30 cm dhe ndërmjet çdo përsëritjeve lihet rrugë me gjerësi 60 cm për të lejuar kryerjen e shërbimeve. Rreth e rrotull fushës eksperimentale në gjerësi prej 10 m mbillet grurë i zakonshëm si zonë mbrojtëse.

Materialet bimore: Në studim u përfshinë: 13 Kultivare gruri,(*krijuar nga institucionet kërkimore shkencore dhe të sjellë nga kompani të huaja për tu testuar në kushtet e vendit tonë*). 1- Lucia; 2- Mia; 3- Katerina; 4- Krajlica; 5- Mateo ; 6- Europa; 7- Apache; 8 Simonid; 9- Azul; 10- Bizansia ; 11- Michelangelo; LVS; dhe 12- Dajti (X kontroll);

Koha e studimit: Studimi u krye në bashkëpunim me (ESHFF)-ve dhe (QTTB)-së Lushnje si zona më e përshtatëshme për kultivimin e grurit gjatë sezonit të mbjelljes 2014-2015

Te dhenat klimaterike: Të dhënat klimatike për të gjithë muajt e vegjetacionit të grurit do të merren nga (Albanian State Meteorological Service in Rinas) për zonën e Lushnjës.

Vlerësimi i sëmundjes:

Menyra e marrjes se mostrave: Në provat eksperimentale do të vlerësohen në mënyrë rastësore 50 bimë (në pesë pika diagonal) me nga 10 bimë dhe do të vlerësohet kalliri për prekjen nga sëmundjet e kallirit

Koha e vlerësimit: Vlerësimet për sëmundjet e kallirit do të kryhen dy herë në stadin 10.5 dhe 11 sipas Feekesit. Large, E.C. (1954).

Vlerësimi sasior i sëmundjes: Parametri kryesor për vlerësimin sasior të sëmundjeve u muar Intesiteti i sëmundjes (I) i cili jepet me anë të formulës së më poshtëme:

$$I \text{ në } \% = s / S * 100 \quad \text{Nutter (2006)}$$


Ku: I = Intesiteti i sëmundjes s = % e sipërfaqes së kallirit të prekur nga sëmundja S = sipërfaqja totale e kallirit

Ky raport sasior i Nutter (2006) në lidhje intesitetin e sëmundjes (I) u vlerësua: Për Fuzariozën e kallirit (*Fusarium graminearum*) duke modifikuar klasat nga 0-9 të N.A. Cobb (1892) dhe Peterson, R.F., A.B. Campbell dhe A.E. Hannah. (1948) në 6 klasa (0-5) nga Varaku et al (2014) ku çdo klase i përgjigjet numri dhe përqindja e sipërfaqes së prekur të kallirit nga sëmundja (*Fusarium graminearum*) në %. Vlerësimi vizual i infeksionit natyral të sëmundjes në studim u bë duke përdorur celësat fushor të vrojttimeve të quajtur SADs (*Standart area diagram*). Imazhet për SADs u krijuan duke përdorur P.C Severity Pro softëare (Lamari, L.2002.) i paraqitur në figurën e mëposhtëme (Shih Figura 1).

Prekshmëria e sëmundjes (Imc në %) është përlllogaritur me anë të formulës së Indeksit të McKinney: McKinney.H.H.(1923) si më poshtë

$$Imc \text{ ne } \% = \Sigma \{(ni \cdot xi) / N \cdot X\} \cdot 100$$

Figura 1. Çelësi fushor (SADs) *Standart area diagram* për vlerësimin e Fuzariozes se kallirit te grurit (*Fusarium graminearum*)



ku :Imc % = Indeksi i Mckinney, Σ = Shuma e prodhimeve, ni = Frekuenca ose numri i bimëve të vrojtuar për secilën klasë, xi= Vlera e secilës klasë, N= Numri total i bimëve të vlerësuar. X= Vlera e klasës më të lart.

Vlerësimi cilësor i sëmundjes: Për të patur një kuadër të qartë për nivelin e qëndrueshmërisë për secilin kultivar të vendosur në provat në Qëndrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB)- ne Lushnjë është bërë kategorizimi i indeksit të Sëmundjeve (Imc në %) në tipin e infeksionit (TI) për prekshmëri nga Fuzariozes se kallirit te grurit (*Fusarium graminearum*) sipas **Pasquini M., Delogu G. (2003)**, (Shih tabela 1) më poshtë:

Tabela 1. Kategorizimi i indeksit të Sëmundjeve Imc në % në Tipin e Reaksionit (TR) për prekëshmëri nga sëmundjet në studim.

Nr	% e Indeksit të McKinney (Imc)	TR	Pershkrimi i Tipit te Reaksionit
1	(Imc = 0%);	I	Kultivari imune ose krejtësisht të paprekëshme
2	(Imc = 0.1-5%);	VR	Kultivari rezistente në të gjitha fazat e zhvillimit
3	(Imc = 5.1-15%)	R	Kultivari mesatarisht rezistente, rezistente bima e rritur
4	(Imc = 15.1-30%);	MR	Kultivari mesatarisht e prekëshme, e ndjeshme bima e re dhe kalliri, mesatarisht e ndjeshme bima e rritur
5	(Imc = 30.1-40%);	MP	Kultivari i prekëshm; bima e re, e rritura dhe kalliri i ndjeshem
6	(Imc =>40.1%).	P	Kultivari konsiderohent jashtëzakonisht prekëshm

Ku: **I** = Imune; Imc-ja në % = 0; **VR** = Shumë Rezistente: Imc-ja në % shkon nga 0 deri në 5%; **R** = Rezistente: Imc-ja në % shkon nga 5.1% deri në 15%; **MR** = Mesatarisht Rezistent : Imc-ja në % shkon nga 15.1% deri në 30 %; **MP** = Mesatarisht i Prekshem: Imc-ja në shkon nga 30.1% % deri në 40%; **P**= i Prekshem: Imc –ja në % shkon mbi 40.1%.

ANALIZA STATISTIKORE E TE DHENAVE

Përpunimi i të dhënave u bë me llogaritjen e mesatareve aritmetike dhe analizën e variancës (ANOVA) nje faktoriale duke perdorur programin statistikor **ASSISTAT (2015)** - website <http://www.assistat.com> By Francisco de A. S. e Silva DEAG-CTRN-UFC.

Krahasimet e mesatareve në cifte u bë sipas testit të Studentit dhe me kontrollin duke përdorur testin e Dunnett (Testi i rrangeve të shumëfishtë) për të dy nivelet e propabilitetit p = 0.05 dhe p = 0.01 me programin statistikor SAS 2009.

REZULTATET DHE DISKUTIMI I TYRE

Kushtet klimaterike gjatë vitit 2015 në (QTTB)-në Lushnjë

Të dhënat e motit për vitin 2015 për muajt Prill, Maj dhe Qershor janë paraqitur në tabelën 2. Faktorët e mjedisit (në veçanti temperatura) kanë ndikuar në shkallën e zhvillimit të sëmundjeve në grurë por edhe vetë sjellja e kultivarëve ndaj tyre. Megjithatë, faktorët gjenetike kanë rolin e tyre përcaktues në sjelljen e kultivarëve ndaj sëmundjeve brënda veprimit të faktorëve të jashtëm klimaterikë. Kjo duket si në sjelljen e kultivarëve në të njëjtin ambjent mjedisor gjë që përfaqëson qëndrueshmërinë e brendëshme gjenetike të kultivarëve në studim.

Tabela 2. Të dhënat mbi temperature mesatare dhe shumen e reshjeve per muajin Prill, Maj dhe Qershor ne Lushnje për vitin 2015

Viti	Vendi	Variablet ne studim	Prill	Maj	Qershor	
2015	Lushnje	Temp	Mes	14	18.1	22.6
			Min	7.7	12.6	17.1
			Max	20.8	24,1	28.8
		Reshjet	58	64	12	
		Lageshtia ajrore	78	68	65	

Pare në këtë aspekt në kushtet e këtij viti pra viti 2015 kemi përhapje dhe indeks te ndyshëm për Fuzariozën e kallirit të grurit (*Fusarium graminearum*) për kultivarët e marrë në studim.

Intesiteti i sëmundjes (Imc-ja në %) për Fuzariozën e kallirit të grurit (*Fusarium graminearum*) gjatë vitit 2015 në (QTTB)-në Lushnjë

Në tabelën 3 janë sjellë rezultatet e vrojtimeve mbi indeksin e sëmundjes ndaj Fuzariozes se kallirit të grurit (*Fusarium graminearum*) për vitin 2015 në provën e ESHFF-së në QTTB-në Lushnjë.

Nga të dhënat e tabelës 3 shohim se për vitin 2015 në QTTB në Lushnjë indeksi i sëmundjes Imc-ja në % varion nga 4.83%, 5.046, 5.206 dhe 6/7133 % përkatësisht në kultivarët Lucia, Mateo, Azul dhe Michelangelo arrin deri në 34.926 % në kultivarin Dajti/ Pra për vitin 2015 kemi një ndryshim për vlerat e indeksit të sëmundjes si për Imc-në minimale dhe ate maksimale me 30.096 dhe me vleren mesatare – 18.16%. Ndryshimet e vërtetuara ndërmjet kultivarëve, duke përdorur testin Tukey Kramer me diferencën më të vogël të vërtetuar DMV=3.63404 i rendisin kultivarët në klasa të ndryshme, që në tabelë jepen me gërma të ndryshme. Kështu në klasën **a** kemi të përfshirë kultivarët Dajti X2 kontroll dhe në klasën **ab** dhe **abc** kultivarët Simonid dhe LVS X1 kontroll ku dhe klasat **bcd** dhe **cde** me kultivaret përkatësisht Simonid, Apache dhe Krajlica paraqiten me nivel te ulët vërtetësie ne krahasim këta me kultivarët Lucia, Mateo, Azul dhe Michelangelo që renditen në klasa **f**. (Shih tabela 3)

Tabela 3. Vlerësimet mbi Indeks in e sëmundjes (Imc-ja ne %) për Fuzariozen e kallirit te grurit (*Fusarium graminearum*) gjatë vitit 2015 në (QTTB)-në Lushnjë

Vendi studim	Kultivaret ne studim	Perseritjet			Shuma e Imc-ve ne %	Mesatarja e Imc-ve ne %	Vleresimi	
		P1	P2	P3			TI* *	Testi Tukey Kramer
Fusha eksperimentale QTTB ne Lushnje	Lucia	4.82	5.82	3.85	14.49	4.83	VR	f
	Mia	22.45	18.1	16.2	56.75	18.91	MR	cde
	Katerina	11.75	16.12	9.87	37.74	12.58	R	def
	Krajlica	26.20	14.62	7.75	48.57	16.19	MR	cde
	Mateo	7.1	5.02	3.02	15.14	5.046	R	f
	Europa	11.16	8.05	8.67	27.88	9.293	R	ef
	Apache	24.68	24.32	14.3	63.32	21.106	MR	bcd
	Simonid	30.18	32.3	27.3	89.78	29.926	MR	ab
	Azul	6.2	5.12	4.3	15.62	5.206		f
	Bizansia	30.3	28.1	25.6	84	28	MR	abc
	Michelangelo	7.1	7.02	6.02	20.14	6.7133	R	f
	LVS X1 kontroll	28.08	25.87	21.6	75.55	25.183	MR	bc
	Dajti X2 kontroll	35.18	32.3	37.3	104.78	34.926	MR	a*
	SHUMA	245.2	222.7	185.8	653.76			
	Mesataret	18.86	17.13	14.2		16.76308		
Dmv	Dmv=3.63404 per @ 0,05							

*a = niveli më i ulët i vërtetësisë për DMV =3.63404 për @=0.05 % dhe f= niveli më i lartë i vërtetësisë për DMV =3.63404 për @=0.05 sipas testit Tukey Kramer.

**TI = I = Imune; VR = Shumë Rezistente; R = Rezistente; MR = Mesatarisht Rezistent ; MP = Mesatarisht i Prekshem; P= i Prekshem:

Analiza e variancës (ANOVA) në tabelën 4 për vitin 2015 tregon se ndërmjet kultivarëve të grurit të butë ka ndryshime të vërtetuara statistikiisht. Kjo provohet nga vlerat e “F”-ve faktike për kultivarët e cila rezulton të jetë më e madhe se vlera e “F”-ve teorike tabelare sipas Fisherit për të dy nivelet e vërtetësisë $P=0.05$ dhe $P=0.01$.

Nga krahasimi i “F”-ve faktike të përsëritjeve me ato tabelore rezulton se përsëritjet nuk japin ndryshime të vërtetuara statistikiisht për të dy nivelet e vërtetësisë $P=0.05$ dhe $P=0.01$ sepse “F”-të faktike rezultojnë të jenë më të vogla se “F”-të teorike gjë që tregon se eksperimenti ynë është ngritur në kushte korrekte i cili na lejon për të vazhduar më tej analizën e të dhënave.


Tabela 4 Analiza e variancës (ANOVA) mbi vlerësimet mbi Indeksit e sëmundjes (Imc-ja në %) për Fuzariozën e kallirit të grurit (*Fusarium graminearum*) gjatë vitit 2015 në (QTTB)-në Lushnjë

Vendi i studimit	VITI	Burimi i variacionit	Shuma kuadratike	Shkallët e lirisë	Mesatarja kuadratike	Variacioni mesat kuadratik		
						F-faktike	F-teorike	
							95%	99%
QTTB-ja LUSHNJË	2015	Kultivarët	3935.14 2	12	327.928 5	35.4648* *	2.18 3	3.031
		Përsëritjet	138.409 1	2	69.2045 5	2.4843ns	3.40 2	5.613
		Mbetja	221.918 1	24	9.24658 7			
		Totali i ndryshueshmërisë	4295.47	38				

****:** E vërtetuar për nivelin e propabilitetit 1% ($p < 0.01$) ; *****: E vërtetuar për nivelin e propabilitetit 5% ($0.01 = < p < 0.05$) ; **ns:** Pa vërtetësi të propabilitetit ($p \geq 0.05$)


Nëpërmjet grafikut 1 shohim që kultivarët që kanë indeks sëmundje më të ulët ndaj Fuzariozës së kallirit të grurit (*Fusarium graminearum*) gjatë vitit 2015 në (QTTB)-në Lushnje paraqiten me kollona të vogla pra indeksi i sëmundjes Imc-ja në % varion nga varion nga 4.83%, 5.046, 5.206 dhe 6/7133 % përkatësisht në kultivarët Lucia, Mateo Azul dhe Michelangelo arrin deri në 34.926 % në kultivarin Dajti/ Pra për vitin 2015 kemi një ndryshim për vlerat e indeksit të sëmundjes si për Imc-në minimale dhe atë maksimale me 30.096 dhe me vlerën mesatare – 18.16%..

Grafiku 1. Vlerësimet mbi Indeksit e sëmundjes (Imc-ja në %) për Fuzariozën e kallirit të grurit (*Fusarium graminearum*) gjatë vitit 2015 në (QTTB)-në Lushnjë



Ndryshime të ngjajshme të kultivarëve të grurit të butë mbi sjelljen e tyre ndaj ndaj Fuzariozes së kallirit të grurit (*Fusarium graminearum*) gjatë vitit 2015 në (QTTB)-në Lushnje kjo shihet edhe nga tabela 3 dhe figura ku kultivarët që kanë ndryshueshmëri dhe të vërtetuar statistikiisht për nivelin e propabilitetit $P=0.05$ janë me rrahë blu dhe pikërisht kultivarët Lucia, Mateo Azul, Michelangelo, Europa dhe Katerina të cilët janë nën vlerën e mesatares së përgjithëshme ku në rastin tonë është vlera 16.76308%.

Figura 2 Diagrama e boksploleve për mesataren e Imc-ve në %) për per Fuzariozën e kallirit te grurit (*Fusarium graminearum*) gjatë vitit 2015 në (QTTB)-në Lushnjë



PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

1- Nga studimi rezulton se ndërmjet kultivarëve të grurit ekzistojnë ndryshime të krahasueshme midis tyre. Analizat e variancave dhe krahasimet e të gjitha mesatareve, me testin Tukey Kramer me diferencën më të vogël të vërtetuar $DMV=3.63404$ për $\alpha = 0.05$) provuan se ndërmjet dhe brenda gjenotipeve të grurit ekziston një variabilitet i gjërë për tërësinë e tipareve të marra në studim.

2- Nga të dhënat për vitin 2015 në QTTB në Lushnjë indeksi i sëmundjes Imc-ja në % varion nga 4.83%, 5.046, 5.206 dhe 6/7133 % përkatësisht në kultivarët Lucia, Mateo, Azul dhe Michelangelo arrin deri në 34.926 % në kultivarin Dajti. Pra për vitin 2015 kemi një ndryshim për vlerat e indeksit të sëmundjes si për Imc-në minimale dhe atë maksimale me 30.096% dhe me vlerën mesatare 18.16%.

3- Rezultatet e studimit tregojnë se për vitin 2015 në QTTB në Lushnjë rezultatet më të mira për prekshmëri më të ulët ndaj Fuzariozes së kallirit të grurit (*Fusarium graminearum*) janë kultivarët Lucia, Mateo, Azul dhe Michelangelo.

LITERATURA

1. **Agrios GN 2005.** Plant Pathology NeëJork f.245-280.
2. **Assistat Version 7.7 beta (2015)** - Ëëbsite <http://ëëë.assistat.com> By Francisco de A. S. e Silva DEAG-CTRN-UFCE
3. **Bockus, W. W., Bowden, R. L., Hunger, R. M., Morrill, È. L., Murray, T. D., and Smiley, R. È. 2010.** Compendium of Wheat Diseases and Pests, 3rd ed. American Phytopathological Society, St. Paul, MN. f. 43-44..

4. **Cooke, B. M. 2006.** Disease assessment and yield loss. **In: *The Epidemiology of Plant Diseases*. B. M. Cooke, D. Gareth Jones and B. Kaye (Eds.) Second edition.** The Netherlands: Springer.f.61
5. **Hasani, M. e Ruci, TH.,2002.** Të dhëna paraprake mbi qendrushmërinë e grurit të butë ndaj disa sëmundjeve kryesore gjethore. Rev. Shqip. Shkenc. Bujq. N.1 f:28
6. FAO : UN Food & Agriculture Organisation 2014)
7. **McKinney H.H. (1923).** Influence of soil temperature and moisture on infection of wheat seedlings by *Helminthosporium sativum*. Journal Agricultural Research, **26**:195-217.
8. **Kaltani, T e B.Celo,** 1992. “Fitopatologjia bujqesore “ Pjesa e pergjithshme dhe e vecante
9. **Harlan, J.R.,** 1981 “The early history of ëheat
10. **Large, E.e. 1954.** Growth stages in cereals. Illustrations of the Feeke's scale. Plant Pathol. 3:129
11. **Oerke, E.C.,** 1994 “Crop production and crop protection – Estimated losses in major food and cash crops.
12. **Peterson, R.F., Campbell, A.B. and Hannah, A.E. 1948.** A diagrammatic scale for estimating rust intensity of leaves and stem of cereals. *Can. J. Res. Sect. C*, 26: 496-500
13. **Russel, G.E.** 1981 Plant Breeding for pests and diseases resistance. Academic Press. London, Neëyork.
14. **Raport vjetor** i Ministrise se Bujqesise dhe ushqimit (Annual report year 2014)
15. **Ruci, TH; Sulovari,H; Vrapì, H. 2007.**Qëndrushmëria e grurit ndaj disa sëmundjeve ajrore. (Monografi) / Tiranë: Mokra, 2007
16. **Varaku S .1998** “Sëmundjet kryesore të grurit dhe masat për kontrollin e tyre.
17. **Vrapì.H. 2013.** Sjellja e kultivarëve të grurit të butë ndaj disa sëmundjeve kërpudhore gjethore në provat e Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve në Shqipëri. ”(Diseratacion)f.43-87
18. SAS Institute Inc. 2009. **JMP® 8 Design of Experiments Guide, Second Edition.** Cary, NC: SAS Institute Inc

**TOLERANCA E NËNSHARTESAVE ANTIFILOKSERIKE 140Ru DHE SO4 NDAJ
PËRQËNDRIMIT TË KLORURIT TË NATRIUMIT NË TOKË
TOLERANCE OF 140RU AND SO4 ANTIPHYLLOXERIC ROOTSTOCKS TO
SODIUM CHLORIDE CONCENTRATION IN THE SOIL**

FATBARDHA SHPATI*, ¹LUSH SUSAJ*, ELISABETA SUSAJ**

* PhD Student, Agricultural University of Tirana, Department of Horticulture and Landscape Architecture, Kodër Kamëz 1029, Tirana, Albania

¹* Agricultural University of Tirana, Department of Horticulture and Landscape Architecture, Kodër Kamëz 1029, Tirana, Albania

** POLIS University, Faculty of Planning, Environment, and Urban Management (FPMMU), Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar
Kodi Postar 1051, Kutia Postare 2995, Tiranë, Albania

lusaj63@hotmail.com

PËRMBLEDHJE

Studimi mbi tolerancën e nënshartesave antifilokserike 140Ru dhe SO4 ndaj klorurit të natriumit u krye gjatë viti 2014 në Bazën Eksperimentale të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Copat njëvjeçare të dy nënshartesave u siguruan nga një fidanishte private. Për trajtim u përdor NaCl në 6 përqëndrime të ndryshme [kontrolli (ujë i zakonshëm rubineti), 2000, 4000, 6000, 8000 dhe 10000 ppm], me 5 vazo me nga dy copa, për çdo përsëritje. U llogarit dhe u vlerësua numri i bimëve të mbijetuara dhe shkalla e vyshkjes dhe tharjes së gjetheve dhe sharmendave për të gjitha trajtimet dhe për të dyja nënshartesat. U vrojtua se me rritjen e përqëndrimit të NaCl, shkalla e vyshkjes dhe tharjes rritet në mënyrë sinjifikative dhe ulet numri i bimëve të mbijetuara për të dyja nënshartesat. Numri më i ulët i bimëve të mbijetuara u vrojtua për nënshartesën SO4 të trajtuar me 6000, 8000 dhe 10000 ppm NaCl (0%), ndërkohë që numri më i lartë u vrojtua për variantin e kontrollit dhe 2000 ppm NaCl (100%). Për nënshartesën 140Ru, numri i bimëve të mbijetuara rezultoi 88.3%, ndërsa për SO4 rezultoi 45%, me një diferencë prej 43.3%, për shkak të genotipit të ndryshëm dhe karaktereve specifike të metabolizmit të nënshartesave. Bazuar në Kodin 402 të OIV (nivelet e vlerësimit 1-9), nënshartesa SO4 është më e ndjeshme dhe më pak rezistente ndaj përqëndrimit të NaCl, krahasuar me 140Ru. Rezultatet e vrojtuara vërtetohen statistikisht nga ANOVA ($p \leq 0.05$), ku $F = 26.125 > F_{crit} = 3.3258$ dhe ($F = 48.52291 > F_{crit} = 3.072467$ dhe $P\text{-value} = 1.9464E-05 = 1.9464/10^5 < \alpha = 0.05$).

Fjalë kyç: 140Ru, SO4, nënshartesë, përqëndrim i klorurit të natriumit (NaCl), tolerancë.

ABSTRACT

The study of tolerance of the antiphyllloxeric rootstocks 140Ru and SO4 to sodium chloride was carried out during 2014, at the Experimental Base of the Agricultural University of Tirana. One year old cuttings of both rootstocks were collected from a private nursery. Six concentrations (treatments) of NaCl [control (normal water), 2000, 4000, 6000, 8000, and 10000 ppm] with five pots with 2 plants for each pots, in total, 60 plants for each rootstock, were used. There were accounted and evaluated the number of survived plants and the degree of shriveling and necrosis of leaves and shoots of all treatments for both rootstocks. There was observed that, with the increase of NaCl concentration, the degree of shriveling and necrosis of leaves and shoots was significantly increased and the number of survived plants was decreased for both rootstocks. The lowest number of survived plants was observed for SO4 treated with 6000 ppm NaCl (20%), 8000 and 10000 ppm NaCl (0%), while the highest number was observed for control and 2000 ppm NaCl (100%). The total number of survived plants for all treatments was 88.3% for 140Ru, while for SO4 it was 45%, with a difference

of 43.3%, because of specific rootstock's metabolism characters and genotype. Based on the OIV Code 402 (evaluation levels 1-9), rootstock SO4 was shown to be more sensitive and less resistant to sodium chloride concentration compare to 140Ru. The observed results were statistically confirmed by ANOVA ($p \leq 0.05$), $F = 26.125 > F_{crit} = 3.3258$ and $P\text{-value} = 1.9464E-05 = 1.9464/10^5 < \alpha = 0.05$.

Key words: 140Ru, SO4, rootstock, sodium chloride (NaCl) concentration, tolerance.

1. HYRJE

Kripëzimi i tokës është një problem serioz që rritet në mënyrë të vazhdueshme në shumë rajone të botës, veçanërisht në zonat e thata dhe gjysëm të thata (semiaride) (Giri *et al.*, 2003; Al-Karaki, 2006). Në vitin 2000, tokat e kripura zinin rreth 7% të tokës në botë (Ruiz-Lozano *et al.*, 2001), në 2007 tokat e kripura zinin rreth 77 milion hektarë nga 1.5 bilion hektarë të tokës arë në gjithë botën (Sheng *et al.*, 2008), dhe mendohet që kripëzimi i tokës arë do të arrijë në rreth 50% të humbjeve të tokës nga mesi i shekullit 21 (Wang *et al.*, 2003). Nivelet e larta të kripëzimit në tokë (>4 dS m⁻¹ ose $>0.1\%$ e përmbajtjes së tokës) vjen kryesisht nga kripurat që gjenden në ujin e ujitjes dhe plehrat kimike që përdoren në bujqësi, sasia e ulët e reshjeve dhe temperaturat e larta në këto rajone, si dhe shfrytëzimi tej kapaciteteve të burimeve ujore të disponueshme (p.sh. ujrato tokësore) (Evelin *et al.*, 2009; Al-Karaki, 2006). Kripëzimi i tokës nëpërmjet akumulimit të ngadaltë të kriprave nga uji i përdorur për ujitje vazhdon me një ritëm që shpesh kalon pa u vënë re. Me çdo ujitje të njëpasnjëshme, uji i pastër transpirohet nga bimët bujqësore dhe avullohet nga sipërfaqja e tokës, duke lënë pas pak më shumë kripë se sa ishte përpara ujitjes. Për ta sqaruar më tej procesin: kloruret janë jonet minerale më të dëmshme për vreshtat, lëvizin lehtësisht në tokë dhe mund të shpëlahen nga shirat e dendura apo ujitjet e tepërta, poshtë, në zonën e rrënjëve të hardhisë. Përqëndrimi i klorureve mund të vazhdojë të rritet pa u vënë re për shumë vite. Nëse në një rajon të caktuar bien sasi të mjaftueshme reshjesh ose nëse uji i ujitjes është me cilësi të lartë dhe i bollshëm për të shpëlarë kripurat poshtë zonës së shtrirjes së sistemit rrënjor, kripurat e tepërta të tokës nuk mund të bëhen kurrë problem shqetësues. Në disa rajone, uji i pijshëm është i kripur dhe afër sipërfaqes së tokës, kështu që shpërlarja nuk mund ta kontrollojë problemin e kripëzimit, meqenëse rrënjët e bimëve tërheqin sasi të konsiderueshme kriprash nga uji i pijshëm.

Vreshtarët duhet të monitorojnë rregullisht kripëzimin në vreshtat e tyre, veçanërisht ku sasia e reshjeve është e ulët për disa vite me radhë. Në momentin që vërehen simptomat e para në gjethet e hardhisë ("djegie nga kripa", inde nekrotike në pjesët anësore të gjethëve, etj), kripëzimi i tokës shpesh është në nivele kritike dhe mund të ndikojë negativisht në rritjen dhe prodhimin e hardhisë (Serra *et al.*, 2014; Fort and Walker, 2011). Hardhia është bimë relativisht rezistente dhe tolerante ndaj përqëndrimit të kripës në tokë dhe në ujin e ujitjes, por vuan seriozisht në tokat me përmbajtje të lartë hekuri, kloruresh dhe sulfat natriumi (Susaj, 2012). Nënshartesat komerciale më të përdorshme kanë një kapacitet qëndrueshmërie mesatar për kripurat, megjithatë, disa prej tyre janë përjashtues shumë të dobët të klorideve. Nënshartesat me qëndrueshmëri të mirë ndaj klorideve kanë një ndikim pozitiv të rëndësishëm në prodhimin e hardhisë në vitet e vështira dhe mund të durojnë disa dëmtime që mund të ndodhin në vitet e thata që janë jashtëzakonisht stresuese për bimët.

Rëndësia e kripëzimit të tokës për prodhimin e hardhisë është e madhe (Tester dhe Davenport, 2003), për sa kohë që kripëzimi ndikon fuqimisht në rritjen dhe zhvillimin e bimëve dhe çon në humbje të mëdha të prodhimit (Serra *et al.*, 2014; Evelin *et al.*, 2009; Mathur *et al.*, 2007; Giri *et al.*, 2003). Efektet direkte të kriprave në bimë përfshijnë: (a) zvogëlimin e potencialit osmotik të solucionit tokësor që zvogëlon sasinë e ujit në dispozicion të bimës, duke shkaktuar thatësi të fiziologjike - për të kundërvepruar ndaj këtij

problem, bimët duhet të ruajnë një potencial osmotik të brendshëm më të ulët në mënyrë që të parandalojnë lëvizjen e ujit nga rrënjët në token rreth bimëve (Feng *et al.*, 2002); (b) toksicitet nga teprica e joneve Na^+ dhe Cl^- në qelizë – efektet toksike përfshijnë shkatërrimin e strukturës së enzimave dhe makromolekulave të tjera (Schwarz, 1995); shkatërrimin e organeleve qelizore dhe metabolizmit të tyre, dëmtime të membranës qelizore dhe të organeleve; shkatërrimin e proceseve të fotosintezës, frymëmarrjes dhe sintezës së proteinave (Feng *et al.*, 2002); (c) çekuilibër të lëndëve ushqyese në bimë të shkakuar nga thithja dhe/ose transporti i lëndëve ushqyese në lastarë (sharmenda) që çon në mungesë të joneve; (d) klorozë dhe pjesë nekrotike të gjetheve dhe sharmendave; (e) çrregullime hormonale, si p.sh. sintezë të ulët të auksinave, etj (McKersie and Leshem, 1994); dhe (f) ulje të cilësisë së prodhimit si rezultat i dehidratimit të shpejtë, vyshkjes dhe tharjes së bimëve të prekura (Serra *et al.*, 2014; Hasegawa *et al.*, 1986; Levit, 1980).

Nënshartesat amerikane të hardhisë kanë nivel të ndryshëm tolerance ndaj kriprave. Dardeniz *et al.* (2006) kanë treguar se nënshartesa 41 B është nënshartesa më e qëndrueshme, e ndjekur nga 140Ru dhe 1103P, dhe më pak rezistente është Kober 5 BB.

Qëllimi i këtij studimi ka qenë përcaktimi i tolerancës ndaj klorurit të natriumit të dy nënshartesave antifilokserike amerikane, 140Ru and SO4, të rritura dhe të përdorura gjerësisht në prodhimin e fidanëve në Shqipëri. Nënshartesa 140Ru është krijuar nga kryqëzimi *Vitis Berlandieri x Vitis Rupestris*, ndërsa SO4 është krijuar nga kryqëzimi *Vitis Berlandieri x Vitis Riparia* (Cousins, 2005).

Vlerësimi i karaktereve të hardhisë bëhet duke u bazuar në kodet dhe nivelet e shprehjes të Deskriptorëve Ndërkombëtarë të Hardhisë (OIV, 2001; UPOV, 2008; IPGRI, 1997). Vlerësimi për rezistencën e nënshartesave ndaj klorureve (kriprave) bëhet duke u bazuar në Kodin 402 të OIV, me nivelet e vlerësimit 1, 3, 5, 7, 9 (Susaj, 2014; UPOV, 2008; OIV, 2001) dhe Kodin 8.6 të IPGRI (Susaj, 2014; IPGRI, 1997).

2. MATERIALI DHE METODA

Studimi mbi tolerancën e nënshartesave antifilokserike 140Ru dhe SO4, ndaj klorurit të natriumit u krye gjatë viti 2014 në Bazën Eksperimentale të Universitetit Bujqësor të Tiranës, në Valias. Copat njëvjeçare të dy nënshartesave, 140Ru dhe SO4, të përdorura gjerësisht në prodhimin e fidanëve në Shqipëri, u siguruan nga një fidanishte private. Copat e sharmendave, pas trajtimit me fungicide, janë shtratifikuar në rërë për tre muaj, në temperaturë 1-4°C dhe lagështirë ajrore 85-90%. Në 4 mars 2014, copat u nxorrën nga shtratifikimi dhe u lanë në ujë të zakonshëm për 24 orë me qëllim që të fitonin turgorin normal. Para mbjelljes, copat, me diametër 7-8 mm, u prenë me nga dy-tre sytha, 7 mm poshtë sythit të parë dhe 2.5 cm sipër sythit të dytë. Copat e prera u mbollën për rrënjëzim në vazo me vëllim 9.5 litra, të mbushura me perlit. Mbjellja u bë më 5 mars 2014. Vazot për rrënjëzimin e copave u vendosën në serrën me nebulizim të Bazës Eksperimentale të UBT. Në ngritjen e studimit është përdorur skema e bllokut të randomizuar, me tre përsëritje, me 6 (gjashtë) variante (6 përqëndrime të ndryshme NaCl) (0-10000 ppm], me nga 10 bimë (copa) me gjatësi dhe trashësi të njëjtë për çdo variant. Copat janë trajtuar sipas praktikave të zakonshme të prodhimit të fidanëve dhe janë ujitur me ujë të zakonshëm rubineti deri në fillimin e aplikimit të ujitjes me ujë të kripur në përqëndrime të ndryshme. Një muaj pas mbjelljes, copat zhvilluan 2-3 lastarë. Pas datës 15 Korrik, copat e rrënjëzuara u trajtuan me ujë me përqëndrime të ndryshme të klorurit të natriumit për 62 ditë. Variantet e përdorura ishin si më poshtë:

V1 – kontroll (ujitje me ujë të zakonshëm rubineti)

V2 – ujitje me solucion 2000 ppm NaCl

V3 – ujitje me solucion 4000 ppm NaCl

V4 – ujitje me solucion 6000 ppm NaCl

V5 – ujitje me solucion 8000 ppm NaCl

V6 – ujitje me solucion 10000 ppm NaCl

Variantet (trajtimet) u etiketuan me etiketa plastike të palëvizshme, ku ishte shënuar emri i nënshartesës, përsëritja dhe përqëndrimi i solucionit të kripës (NaCl). Duke filluar nga data 15 korrik, bimët në vazo janë ujitur me solucion NaCl në 6 përqëndrime të ndryshme, siç u përshkrua më lart. Vrojtimet dhe vlerësimet për tolerancën e nënshartesave 140Ru dhe SO₄ ndaj përqëndrimit të NaCl u bë çdo dy javë (30 korrik, 15 gusht, 30 gusht dhe 15 shtator). Vlerësimi për rezistencën e nënshartesave ndaj klorureve (kriprave) u bë më 15 shtator, duke u bazuar në numrin e copave të rrënjëzuara të mbijetuara dy muaj pas fillimit të trajtimit me solucion NaCl dhe në shkallën e vyshkjes dhe nekrozës së gjetheve dhe sharmendave, për trajtimet e ndryshme dhe për të dyja nënshartesat.

Vlerësimi i nekrozës (rezistencës së nënshartesave ndaj klorureve – kripës) u bë duke u bazuar në Kodin 402 të OIV, me nivelet e vlerësimit: 1 (rezistencë shumë e ulët - nekroza zë pjesët anësore deri në gjithë llapën e gjethes, që çon në rënien e gjetheve; nekroza shumë e madhe dhe shumë e shpejtë); 3 (rezistencë e ulët – nekrozë pjesërisht e madhe dhe e shpejtë e gjetheve); 5 (rezistencë mesatare – fundet e nervaturave janë të nekrotizuara); 7 (rezistencë e lartë – pamje nekroze në pjesët anësore të gjethes, nekroza është me pika me diametër deri 1 cm); 9 (rezistenca shumë e lartë – gjethet plotësisht të gjelbra, totalisht pa nekrozë) dhe Kodit 8.6 të IPGRI (Susaj, 2014; UPOV, 2008; OIV, 2001) IPGRI, 1997).

Rezultatet e vrojtuarat iu nënshtruan analizës statistikore të variancës, duke përdorur ANOVA ($p \leq 0.05$) (Lekaj *et al.*, 2014).

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Bimët e trajtuara me përqëndrimet më të larta të kripës filluan të shfaqin disa simptoma duke filluar që dy javët e para (30 korrik). Numri i bimëve të mbijetuara për çdo variant, për çdo përsëritje, u llogarit dhe u vlerësua me 15 shtator, 62 ditë pas trajtimit të parë me solucion NaCl. Vlerësimi u bazua në shkallën e vyshkjes dhe nekrozës (tharjes) së gjetheve dhe sharmendave për të gjitha trajtimet dhe për të dyja nënshartesat. Rezultatet e vrojtuarat treguan se me rritjen e përqëndrimit të NaCl, shkalla e vyshkjes dhe tharjes rritet në mënyrë sinjifikative dhe ulet numri i bimëve të mbijetuara për të dyja nënshartesat, 140Ru dhe SO₄, por shkalla e reagimit të nënshartesave ndaj trajtimeve të ndryshme rezultoi i ndryshëm. Për variantin e kontrollit (ujë i zakonshëm rubineti) u vrojtua një rritje dhe zhvillim normal i fidanëve për të dyja nënshartesat dhe 100% e bimëve rezultuan të shëndetshme.

Për nënshartesën 140Ru, edhe pse mbijetuan 88.3% e bimëve, variantet e ndryshme ndryshuan në mënyrë sinjifikative për numrin e bimëve të shëndetshme. Për përqëndrimin më të ulët të NaCl (V2 - 2000 ppm) u vrojtua rritje dhe zhvillim normal për 40% të bimëve, ndërkohë që për 60% të tyre u vrojtuan gjethë të vogla dhe të vyshkura. Shkalla më e lartë e dëmtimit u vrojtua për variantet 5 dhe 6 (8000 and 10000 ppm NaCl), ku u vrojtuan respektivisht 70% dhe 60% bimë të mbijetuara, të ndjekur nga varianti 4 (6000 ppm NaCl), ku numri i bimëve të mbijetuara me sharmenda të njoma ishte 100% dhe 100% e bimëve kishin gjethë të rëna (Tabela 1).

Tabela 1. Efekti i përqëndrimeve të ndryshme të klorurit të natriumit në qëndrueshmërinë e nënshartesës së hardhisë 140Ru

Përqëndrimi i NaCl (variantet)	Numri i copave (bimëve) (vlera mesatare)					
	Të mbjella	Bimë të shëndetshme	Me gjethë të vyshkura	Me gjethë nekrotike	Me gjethë të rëna	Me sharmenda nekrotike
V1 - 0 ppm	10	10	0	0	0	0

V2 - 2000 ppm	10	4	6	0	0	0
V3 - 4000 ppm	10	0	3	7	0	0
V4 - 6000 ppm	10	0	0	0	10	0
V ₅ - 8000 ppm	10	0	0	0	7	3
V ₆ - 10000 ppm	10	0	0	0	6	4
Total	60	14	9	7	23	7
%	100	23.3	15	11.7	38.3	11.7

Për nënshartesën SO₄, shkalla e dëmtimit të bimëve (shkalla e vyshkjes dhe nekrozës së gjetheve dhe sharmendave) për të gjitha trajtimet ishte më e lartë, krahasuar me 140Ru. Numri i bimëve të mbijetuara në total ishte 45%, me një diferencë prej 43.3% krahasuar me 140Ru. Duke filluar që nga përqëndrimi më i ulët i solucionit të NaCl (2000 ppm), asnjë bimë nuk rezultoi e shëndetshme, por 60% e bimëve kishin gjethe të vyshkura dhe 40% e tyre kishin gjethe nekrotike. Për V3 (4000 ppm NaCl), 50% bimëve kishin gjethe të rëna dhe 50% sharmenda të nekrotizuara. Shkalla më e lartë e dëmtimit u vrojtua për variantet 5 dhe 6 (8000 and 10000 ppm NaCl), ku për 100% e bimëve shfaqën me sharmenda të nekrotizuara (Tabela 2).

Tabela 2. Efekti i përqëndrimeve të ndryshme të klorurit të natriumit në qëndrueshmërinë e nënshartesës së hardhisë SO₄

Përqëndrimi i NaCl (variantet)	Numri i copave (bimëve) (vlera mesatare)					
	Copa të mbjella	Bimë të shëndetshme	Me gjethe të vyshkura	Me gjethe nekrotike	Me gjethe të rëna	Me sharmenda nekrotike
V1 - 0 ppm	10	10	0	0	0	0
V2 - 2000 ppm	10	0	6	4	0	0
V3 - 4000 ppm	10	0	0	0	5	5
V4 - 6000 ppm	10	0	0	0	2	8
V ₅ - 8000 ppm	10	0	0	0	0	10
V ₆ - 10000 ppm	10	0	0	0	0	10
Total	60	10	6	4	7	33
%	100	16.7	10	6.6	11.7	55

Të dhënat e vrojtuar treguan se midis nënshartesave ekzistojnë diferenca të rëndësishme, të vërtetuara statistikisht, për numrin e bimëve të mbijetuara në total. Numri i bimëve të mbijetuara në total për 140Ru ishte 88.3, ndërsa për SO₄ ishte 45%, me një diferencë prej 43.3% (Table 3). Nënshartesa 140Ru ka rezultuar më e qëndrueshme se SO₄ për të njëjtin përqëndrim të klorurit të natriumit në tokë dhe SO₄ ka rezultuar më e ndjeshme. Diferenca

midis nënshartesave për qëndrueshmërinë – tolerancën ndaj NaCl në tokë vjen kryesisht për shkak të genotipit të ndryshëm dhe karaktereve specifike të metabolizmit të nënshartesave. Të dhënat e përfuara janë të ngjashme me Dardeniz *et al.* (2006). Të dhënat treguan se janë vërejtur ndryshime të vërtetuara statistikisht midis varianteve (përqëndrimi i NaCl) për numrin e bimëve të mbijetuara për nënshartesën 140Ru dhe midis varianteve për SO4 (Tabela 3).

Table 3. Efekti i përqëndrimeve të ndryshme të klorurit të natriumit në qëndrueshmërinë e nënshartesave 140Ru dhe SO4 (vlera mesatare)

Përqëndrimi i NaCl (variantet)	Bimë të mbjella	Bimë të mbijetuara	
		140Ru	SO4
V1 - 0 ppm	10	10 ^{aA}	10 ^{aA}
V2 - 2000 ppm	10	10 ^{aA}	10 ^{aA}
V3 - 4000 ppm	10	10 ^{aA}	5 ^{bB}
V4 - 6000 ppm	10	10 ^{aA}	2 ^{bC}
V5 - 8000 ppm	10	7 ^{aB}	0 ^{bD}
V6 - 10000 ppm	10	6 ^{aB}	0 ^{bD}

Vlerësimi për rezistencën e nënshartesave 140Ru and SO4 ndaj klorureve (kripës) u bë duke u bazuar në Kodin 402 të OIV, bazuar në vyshkjen dhe nekrozën e gjetheve dhe sharmendave, me nivelet e vlerësimit: 1 (rezistencë shumë e ulët - nekroza zë pjesët anësore deri në gjithë llapën e gjetheve, që çon në rënien e gjetheve; nekroza shumë e madhe dhe shumë e shpejtë); 3 (rezistencë e ulët – nekrozë pjesërisht e madhe dhe e shpejtë e gjetheve); 5 (rezistencë mesatare – fundet e nervaturave janë të nekrotizuara); 7 (rezistencë e lartë – pamje nekroze në pjesët anësore të gjetheve, nekroza është me pika me diametër deri 1 cm); 9 (rezistenca shumë e lartë – gjethet plotësisht të gjelbra, totalisht pa nekrozë) dhe Kodit 8.6 të IPGRI (Susaj, 2014; UPOV, 2008; OIV, 2001) IPGRI, 1997).

Për nënshartesën 140Ru, vlerësimi i varianteve rezultoi nga 1 deri në 9. Variantet 5 dhe 6 (8000 dhe 10000 ppm NaCl), janë vlerësuar me 1, çfarë do të thotë se 140Ru, ka rezultuar rezistente deri në 6000 ppm NaCl në tokë. Për SO4, kater variante (V3, V4, V5 and V6), që treguan shkallë të lartë nekroze të gjetheve dhe sharmendave, janë vlerësuar me 1 (rezistencë shumë e ulët - nekroza zë pjesët anësore deri në gjithë llapën e gjetheve, që çon në rënien e gjetheve; nekroza shumë e madhe dhe shumë e shpejtë) dhe vetëm varianti 2 (2000 ppm) u vlerësua me 5 (rezistencë mesatare – pamje nekroze në pjesët anësore të gjetheve, nekroza është me pika me diametër deri 1 cm). Shkalla e tharjes (nekrozës) së sharmendave është rritur nga 50% për V2 (2000 ppm NaCl) në 100% për V3, V4, V5 dhe V6 (4000, 6000, 8000 dhe 10000 ppm NaCl), respektivisht. Vlerësimi ampelografik për rezistencën ndaj klorurit të natriumit, bazuar në nivelin dominant të nekrozës së gjetheve, sipas varianteve, është dhënë në Tabelën 4.

Tabela 4. Vlerësimi ampelografik për rezistencën ndaj klorurit të natriumit të nënshartesave 140Ru and SO4, sipas niveleve të ndryshme të klorurit të natriumit në tokë

Përqëndrimi i NaCl (variantet)	Niveli i vlerësimit	
	140Ru	SO4
V1 - 0 ppm	9	9
V2 - 2000 ppm	7	5
V3 - 4000 ppm	5	1
V4 - 6000 ppm	3	1
V5 - 8000 ppm	1	1

V ₆ - 10000 ppm	1	1
----------------------------	---	---

Diferencat midis varianteve dhe nënshartesave për rezistencën – tolerancën ndaj klorurit të natriumit konfirmohen statistikisht nga analiza e variaciones (Anova: Two-Factor Without Replication) (Lekja *et al.*, 2014). Për variantet (përqëndrimi i klorurit të natriumit), vlera e treguesit statistikor $F = 26.125 > F_{crit} = 3.3258$ dhe $P\text{-value} = 1.9464E-05 = 1.9464/10^5 < \alpha = 0.05$, ndërsa për nënshartesat, vlera e treguesit statistikor $F = 7.5 > F_{crit} = 4.1028$ dhe $P\text{-value} = 0.00024 < \alpha = 0.05$. Rezultatet e vrojtuar konfirmojnë se ekziston një lidhje e rëndësishme, sinjifikative, midis përqëndrimit të klorurit të natriumit në tokë, nënshartesës dhe shkallës së nekrozës së gjetheve dhe sharmendave (mbijetesës së bimëve) (Tabela 5).

Tabela 5. Rezultatet a analizës së variaciones (ANOVA: Two-Factor Without Replication) për lidhjen midis përqëndrimit të klorurit të natriumit në tokë dhe nënshartesës ($\alpha = 0.05$)

Source of Variation	SS	F	P-value	Fcrit
Rows (Variantet)	139.333	26.125	1.9464E-05	3.3258
Columns (Nënshartesat)	16	7.5	0.00024	4.1028
Error	10.666			
Total	166			

KONKLUZIONE

Përqëndrimi i klorurit të natriumit në tokë, ndikon fuqimisht në shkallën e rezistencës së nënshartesave të hardhisë 140Ru dhe SO₄.

Me rritjen e përqëndrimit të NaCl, shkalla e vyshkjes dhe tharjes (nekrozës) së gjetheve dhe sharmendave rritet në mënyrë sinjifikative dhe ulet numri i bimëve të mbijetuara për të dyja nënshartesat, 140Ru dhe SO₄.

Nënshartesa SO₄ është më e ndjeshme dhe më pak rezistente ndaj përqëndrimit të klorurit të natriumit në tokë, krahasuar me 140Ru. Nënshartesa 140Ru reziston mjaft mirë deri në 4000 ppm NaCl në tokë, ndërsa SO₄ deri në 2000 ppm.

LITERATURA

1. Al-Karaki, G. N. (2006) Nursery inoculation of tomato with arbuscular mycorrhizal fungi and subsequent performance under irrigation with saline water. *Scientia Horticulturae* 109, 1–7.
2. Cousins, P. (2005) Viticultural applications of the origins of our rootstocks. Rootstock Symposium, Missouri. February 5, 2005, 6-7.
3. Dardeniz, A., Muftuoglu, N.M, Altay, H. (2006) Determination of salt tolerance of same American Grape Rootstocks. *Bangladesh Journal of Botany* 35 (2), 143-150.
4. Evelin, H., Kapoor, R., Giri, B. (2009) Arbuscular mycorrhizal fungi in alleviation of salt stress: a review. *Annals of Botany* 104, 1263–1280. DOI:10.1093/aob/mcp251. Available online at www.aob.oxfordjournals.org.
5. Feng, G., Zhang, F.S., Li, X., Tian, C.Y., Tang, C., Rengel, Z. (2002). Improved tolerance of maize plants to salt stress by arbuscular mycorrhiza is related to higher accumulation of soluble sugars in roots. *Mycorrhiza* 12: 185–190.
6. Fort, K., Walker, A. (2011) Breeding Salt Tolerant Rootstocks. *Foundation Plant Services, FPS Grape Program Newsletter October 2011, 9-11*. <http://iv.ucdavis.edu/files/134523.pdf>.
7. Giri, B., Kapoor, R., Mukerji, K.G. (2003) Influence of arbuscular mycorrhizal fungi and salinity on growth, biomass and mineral nutrition of *Acacia auriculiformis*. *Biology and Fertility of Soils* 38, 170–175.
8. Hasegava, P.M., Bressan, R.A., Handa, A.V. (1986) Cellular mechanisms of salinity tolerance. *Hort. Sci.* 21 (6), 1317-1324.

9. IPGRI (International Plant Genetic Resources Institute, Rome, Italy). (1997) Descriptors for Grapevine (*Vitis* spp.), 63 p.
10. Lekaj, P., Gjini, B., Ozuni, E., Mulliri, J., Mustafa, S., Ahmeti, A. (2014) Aplikime kompjuteri në Microsoft Excel. Botim i Universitetit Bujqësor të Tiranës, 212-218.
11. Levit, J. (1980) Responses of Plants to Environmental Stresses. Vol II, 2nd edn. Academic Press, New York, 607.
12. Mathur, N., Singh, J., Bohra, S., Vyas, A. (2007) Arbuscular mycorrhizal status of medicinal halophytes in saline areas of Indian Thar Desert. International Journal of Soil Science 2, 119–127.
13. McKersie, B.D., Leshem, Y.Y. (1994) Stress and stress coping in cultivated plants. Kluwer Academic Publisher, Netherlands, 256.
14. OIV (Office International de la Vigne et du Vin, Paris, France). (2001). 2nd Edition of the OIV Descriptor List for Grape varieties and *Vitis* Species, 178 p.
15. Ruiz-Lozano, J. M., Collados, C., Barea, J. M., Azco'n, R. (2001) Arbuscular mycorrhizal symbiosis can alleviate drought induced nodule senescence in soybean plants. *Plant Physiology* 82, 346–350.
16. Serra, I., Strever, A., Myburgh, P. A., Deloire, A. (2014) Review: the interaction between rootstocks and cultivars (*Vitis vinifera* L.) to enhance drought tolerance in grapevine. *Australian Journal of Grape and Wine Research* 20, 1–14. doi: 10.1111/ajgw.12054. © 2013 Australian Society of Viticulture and Oenology Inc.
17. Sheng, M., Tang, M., Chan, H., Yang, B., Zhang, F., Huang, Y. (2008) Influence of arbuscular mycorrhizae on photosynthesis and water status of maize plants under salt stress. *Mycorrhiza* 18, 287–296.
18. Susaj, L. (2014) Assessment methods of grapevine species and cultivars. Textbook for students and ampelographers (In Albanian) 120 p, 37, 62,113.
19. Susaj, L. (2012) Practical Ampelography (Teaching student book) Agricultural University of Tirana, Albania, 162.
20. Tester, M., Davenport, R. (2003) Na⁺ tolerance and Na⁺ transport in higher plants. *Annals of Botany* 91, 503–527.
21. UPOV (International Union for the Protection of New Varieties of Plants, Geneva, Switzerland). (2008). Grapevine UPOV code: VITIS *Vitis* L. Guidelines for the conduct of tests for distinctness, uniformity and stability, 52 p.
22. Wang, W., Vinocur, B., Altman, A. (2003) Plant responses to drought, salinity and extreme temperatures: toward genetic engineering for stress tolerance. *Planta* 218, 1–14.

STUDIMI I VARËSISË: PERIUdhË VEGJETATIVE KALLËZIM- PJEKJE DHE PRODUKTIVITET TEK DISA GENOTIPE TË GRURIT TË BUTË NË RAJONIN E KORÇËS

GJERGJI MERO, KRISTAQ TENEQEXHI

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë

gjmero@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Duhet të pranojmë që objektivi kryesor në krijimin e një genotipi të ri të çdo kulture bujqësore është rritja e produktivitetit.

Por nuk mjafton vetëm kapaciteti "teorik" i një genotipi të ri. Ai duhet të zotërojë stabilitet prodhimi e për rrjedhje "jetëgjatësi" në kultivim.

Artikulli në fjalë analizon lidhjet korrelative midis produktivitetit dhe fazës fenologjike kallëzim-pjekje. Të gjitha rajonet ekologjike, të cilat garantojnë për genotipet në kultivim fenofazë të gjatë kallëzim-pjekje, karakterizohen nga prodhime të larta gruri, të cilat arrijnë mbi 8 ton/Ha prodhim kokërr.

Shembuj të tillë takojmë në Hollandë, Danimarkë, Bullgari, Angli, ku kjo periudhë bimore arrin mbi 65-70 ditë.

Në këtë studim konstatojmë kultivarë gruri me kapacitete mbi 60 kv/Ha, të cilët zotërojnë periudhë kallëzim-pjekje mbi 55 ditë.

Prova është kryer në 2 vite studimore dhe në çdo vit takojmë të njëjtën ligjësi statistiko-matematikore. Pra, sa më e gjatë kjo fenofazë bimore, aq më i lartë është produktiviteti.

Vlerat e koeficientëve të korelacionit arrijnë deri në $\sqrt{r} = +0,93$, lidhje këto të forta korrelative.

Fjalët kyçe: genotipe gruri, periudhë vegjetative, korelacion etj.

HYRJE

Gruri zë vendin kryesor në grupin e bimëve cereale. Vlerat e larta të tij pasqyrohen jo vetëm nga sipërfaqja e madhe që kultivohet (mbi 228 milion Ha), por edhe nga përmbajtja e proteinës, karbohidrateve, kriprave minerale, pigmenteve etj.

Të gjitha këto vlera e renditin këtë specie të kultivuar të parën midis katërshes së bimëve "magjike".

Evidencat e para arkeologjike të kultivimit të tij datojnë jo më pak se 8000 vjet para lindjes së Krishtit (Felaman – 1976).

Progresi i teknikave kultivale dhe përmirësimi gjenetik i realizuar prej njeriut qysh prej fillimit të shekullit të XX-të janë shoqëruar me rritje të ndjeshme të rendimenteve, të cilat kanë kaluar nga 8 • 6 kv/Ha në vitin 1900 në shkallë botërore, e deri në nivelet e sotme, mbi 35 kv/Ha.

Shtimi i prodhimit të grurit të butë deri në vitin 1990 bazohej në dy drejtime:

- a) në rritjen e sipërfaqes mbjellëse
- b) në rritjen e rendimentit

Gruri ka areal të gjerë kultivimi falë plasticitetit të lartë që zotëron. Objektivat e përgjithshme të përmirësimit të kësaj bime ecin drejt uljes së kostos së prodhimit, përmirësimit të rregullaritetit të rendimenteve, rritjes së cilësive teknologjike etj.

Tipari hershmëri kallëzimi, sot konsiderohet si një tipar fenologjik me vlera të larta, veçanërisht në grumbullimin e asimilateve, që ndikojnë si në shtimin e numrit të kokrrave në kallzë, edhe në rritjen e peshës së kokrrës.

Tipari hershmëri kallëzimi ndikon fuqishëm veçanërisht në nënperiudhën lulëzim-pjekje.

Shumica e asimilateve të stokuara në kokërr është rrjedhje e fotosintezës pas fazës së lulëzimit. Vlerat e treguesit foliar janë gjithmonë jolimitante. Një lidhje pozitive ekziston

midis zgjatjes së funksionit të sistemit foliar dhe rendimentit në kokërr (Gate'-Ph-1999). Mbështetur në gjendjen dhe moshën e saj, gjethja e parë nën kallë, sikundër quhet gjethi "flamur", luan rol kryesor në përplotësimin e kokrrës. Në një provë të kryer nga studiuesi Mons (INRA-1998) mbi 13 genotipe gruri të butë, rimobilizimi i asimilateve ka marrë pjesë për vlerën 20-22% të përmbushjes së kokrrës. Një element i rëndësishëm është dhe studimi i limiteve të përmirësimit të produktivitetit. Në këtë aspekt studiohen limitet biologjike.

MATERIALI DHE METODA

Studimi është kryer për një periudhë kohe dy-vjeçare, 2012-2014 në tokat e Qendrës Kërkimore Korçë (Q.T.T.B). Në provë janë vendosur 11 genotipe gruri të butë të krijuara nga institucione kërkimore në vend dhe të introduktuara nga rajone me klimë të përafërt me atë të zonës ku janë studiuar ato (rajoni i Korçës). Prova krahasuese është realizuar konform kushteve që përcakton teknika e eksperimentimit shkencor, ku janë përfshirë të tre tipet e provës:

- a) fushore
- b) ½ laboratorike
- c) laboratorike

Janë zbatuar skemat e rondonizuara sipas Nozolonit.

Madhësia e variantit 21 m².

Agroteknika e zbatuar është ajo me 4 përsëritje, që përdorin sot fermerët e rajonit për të marrë mbi 45-55 kv/Ha prodhim kokërr.

Janë përdorur 120 kg/Ha azot lëndë aktive në trajtë nitrat amoni në vegjetacion, si dhe 90 kg/Ha fosfor lëndë aktive.

Janë mbajtur shënimet fenologjike, përshkrime fushore dhe matje të ndryshme biometrike për çdo kultivar.

Nga përsëritja e katërt janë marrë mostra për analiza kimiko-teknologjike, të cilat nuk po i paraqitim në material.

Produktiviteti i shprehur në kv/Ha për çdo genotip është përpunuar statistikisht, ku janë nxjerrë dhe vlerat shprehëse deri tek korelacionet.

REZULTATET DHE DISKUTIMI I TYRE

Për vitin studimor 2012-2013 rezulton të kemi një periudhë bimore kallëzim-pjekje të vlerësuar në ditë, mesatarisht prej 53,63. Vlerat e dispersionit, pra sigma është 2,90 dhe vlera e koeficientit të variacionit është 5,4 %, tepër kuptimplota për një studim aplikativ.

Në këtë vit studimor, nga përpunimi statistikor i materialit shifër rezulton të kemi lidhje korelative të dobët me kahje pozitive të shprehur me $\sqrt{r} = + 0,26$.

Kultivari me kapacitetin më të lartë produktiv rezulton të jetë L-4, me 6874 kv/Ha, ndërkohë kur periudha vegjetative e tij kallëzim-pjekje është 59 ditë. Kultivari DAJTI mjaft mirë i rajonizuar në zonën e Korçës, qëndron në nivelin prej 55.41 kv/Ha me 57 ditë vegjetacion, ndërsa kultivari SILVIA me 50 ditë vegjetacion, zotëron rendimentin 47.08 kv/Ha.

Tabela e mëposhtme na njeh me vlerat e produktivitetit dhe periudhës vegjetative kallëzim-pjekje për vitin studimor 2012-2013.

Tabela nr. 1 Viti 2013

NR	Emërtimi i kultivarëve	Periudha vegetative kallëzim-pjekje Ditë	Rendimenti kv/Ha
X1	DAJTI	57	55•41
X2	SILVIA	50	47•08
X3	RUSIA	58	60•82
X4	SOISONS	53	55•41
X5	CIANOX JUBILE	56	54,16
X6	PROGRES	55	47•95
X7	L-4	59	68•74
X8	ALTRIA	52	59,65
X9	NAGAL	55	57,08
X10	Nr - 22	52	49•0
X11	Nr - 13	56	43•95
\bar{x}	Mesatarja	53•63	54,47
$\sqrt{\quad}$	Shmangia kuadratike	2•90	6,85
Cu	Koeficienti i variacionit %	5,40%	12,57

$$\sqrt{\frac{\sum (x_i - \bar{x})^2}{n}}$$

$$Cu = \frac{\sqrt{\quad}}{7} \cdot 100\% \quad \sqrt{\frac{\sum x \cdot \sum y}{\sum x \cdot \sum y} - \bar{x} \cdot \bar{y}} = + 0,26$$

Ndërsa viti studimor 2013-2014 u karakterizua me shkurtim të periudhës vegetative totale mbirje-pjekje.

Fenofaza kallëzim-pjekje është realizuar vetëm për 41•54 ditë ose rreth 12 ditë më pak vegetacion kundrejt vitit të parë studimor.

Për efekt të këtij shkurtimi edhe rendimenti kokërr i provës fushore ka zbritur vetëm në nivelin prej 47•03 kv/Ha ose 7•44 kv/Ha më pak se viti 2012-2013.

Kjo rënie e rendimentit ndihet fuqishëm tek të gjithë kultivarët e grurit, veçanërisht tek ata kultivarë me indekse plasticiteti të ulët ose me bi të lartë. Të tillë kultivarë janë: L-4, ALTRIA, RUSIA, CIANOX JUBILE etj.

Niveli produktiv i këtyre kultivarëve ka zbritur respektivisht në: 21,31 kv/Ha, 14,44, 12,31, 10,48 dhe 9,28 kv/Ha tek kultivari NAGAL.

Kultivari DAJTI vlerësohet me indekse të bi ~ 0,57, pra konsiderohet si antistresant dhe diferenca midis dy viteve studimore është vetëm 1,69 kv/Ha, ndërkohë kur rënia mesatare e krejt fushës së provës është 7,44 kv/Ha.

Përshtatshmëria e lartë ndaj faktorëve të larmishëm mjedisorë i kanë dhënë kultivarit DAJTI “statusin” e kultivarit të rajonizuar, jo vetëm në rajonin e Korçës, por edhe në shkallë vendi, duke “uzurpuar” një sipërfaqe totale mbi 80 mijë Ha në shkallë vendi.

Tabela e mëposhtme na njeh me vlerat e parametrave që po studiojmë:

Tabela nr.2

N/R	Emërtimi i kultivarëve	Periudha vegetative kallëzim-pjekje Ditë	Rendimenti kv/Ha
X1	DAJTI	45	53,72
X2	SILVIA	40	47,55
X3	RUSIA	43	55,57
X4	SOISONS	39	43,10
X5	CIANOX JUBILE	40	32,85
X6	PROGRES	40	45,85
X7	L-4	44	54,30
X8	ALTRIA	41	49,17
X9	NAGAL	43	47,80
X10	Nr - 22	41	44,17
X11	Nr - 13	41	43,32
\bar{x}	Mesatarja	41,54	47,03
\sqrt{y}	Shmangia kuadratike	1,37	$\sqrt{y} = 6,06$
Cu	Koeficienti i variacionit %	4,89%	Cuy = 12,8

$$\sqrt{r} = \frac{\sqrt{x} \cdot \sqrt{y}}{\sqrt{\bar{x} \cdot \bar{y}} - \bar{x} \cdot \bar{y}} \quad \sqrt{r} = +0,93$$

Sikundër shihet nga përpunimi statistikor i materialit shifër rezulton të kemi lidhje korelative shumë të forta me vlerë të koeficientit të korelacionit $\sqrt{r} = +0,93$.

Pra, në këtë vit studimor ku ndihet një rënie e periudhës së vegjetacionit e fakti kohë: kallëzim-pjekje është tepër i fuqishëm në produktivitet.

Rënie e produktivitetit e kanë ndierë fuqishëm kultivarët: L-4, ALTRIA, RUSIA, SOISONS, NAGAL etj (shih faqen 7/1).

PËRFUNDIME

- Periudha vegetative kallëzim-pjekje konsiderohet si vendimtare në përcaktimin e produktivitetit të grurit të butë, pasi me të janë të lidhur dy elementët strukturorë të prodhimit: numri i kokrrave në kallzë dhe pesha absolute, të cilat përcaktojnë rreth 35-40 % të produktivitetit.

- Sa më e gjatë të jetë kjo fenofazë, aq më i lartë është produktiviteti i kultivarit. Kështu, për vitin studimor 2012-2013 ekzistojnë lidhje korelative me vlerë të $\sqrt{r} = +0,26$.

- Në vitin studimor 2013-2014 koeficienti i korelacionit rezulton $\sqrt{r} = +0,93$, vlerë kjo e fuqishme mbi produktivitetin kokërr. (Niveli i katërt i lidhjes korelative i emërtuar shumë i fortë)

- Sa më e shkurtër periudha vegetative totale (e përgjithshme), aq më të forta janë lidhjet korelative midis dy parametrave në studim: periudhë kallëzim-pjekje dhe produktivitet.

- Kultivarët me indekse të ulta të bi, më të vogla se 0,60, janë më të qëndrueshëm ndaj efektit “pakësim vegjetacion”. Kjo vërtetohet edhe në studime të krijuara në specie bujqësore të tjera si misër, fasule etj.

Tabela e mëposhtme pasqyron diferencat në prodhimtari të çdo kultivari në studim midis dy viteve të provës.

Tabela nr. 3

NR	Emërtimi i kultivarëve	Rendimenti kv/Ha sipas viteve në studim		Diferenca në prodhim kv/Ha midis dy viteve
		2013	2014	
1	DAJTI	55.41	53.72	- 1,67
2	SILVIA	47.08	47.55	+ 0.47
3	RUSIA	60.82	55.57	- 5.25
4	SOISONS	55.41	43.10	-12.31
5	CIANOX JUBILE	54.16	32.85	-21.31
6	PROGRES	47.95	45.85	-2.10
7	L-4	68.74	54.30	-14.44
8	ALTRIA	59.65	49.17	-10.48
9	NAGAL	57.08	47.80	- 9.28
10	Nr - 22	49.0	44.17	- 4.83
11	Nr - 13	43.95	43.32	- 0,63
X	Vlera mesatare kv/Ha	54.47	47.03	- 7.44

REFERENCAT

1. Aurian P. 1990 “Le ble’ tendre”
2. Gate’ PH. 1990 “L’ ecophysiologiedu ble’ ”
3. Grup autorësh 1983 “Fitoteknia”
4. Grup autorësh 1967 “Improvement soft wheat’
5. Morgan C.L. 1989 “Genetic improvement in the yield of winter wheat”



Seksioni/Section 2
Prodhim Shtazor/Animal production

**EFEKTI I ZV. QUMËSHITIT NË RRRITJEN E VIÇAVE HOLSTEIN PËR REMONT
DERI NË KËPUTJE
EFFECT OF MILK REPLACER ON GROWTH OF PREWEANED HOLSTEIN
REPLACEMENT HEIFER CALVES**

FIQIRI TAHIRI¹, LUAN HAJNO¹

¹Drejtoria e Teknologjive Blegtorale, Qendra Transferimit Teknologjive Bujqësore, Fushë
Krujë, ALBANIA
e-mail: l_hajno@yahoo.it

PËRMBLEDHJE

Studimi u realizua në fermën e qumështit “Rramilli”, Shijak. Objektivi ishte për të vlerësuar efektet e dietave me zv. qumështi dhe tradicionale (qumësht të plotë) në performancën e rritjes të viçave Holstein për remont. Një total prej 24 viça (n=12 krerë për secilin grup) u përfshinë në eksperiment. Viçat u caktuan në mënyrë të rastësishme në trajtimet. Viçat u këputën në moshë 70 ditë. Sasia dhe shpërblimi i ushqimit si dhe shtesa e peshës u llogaritën për periudhat: 7-21; 22-35 ; 36-56; 57-63, 64-70 ditë. Kostot e dietave u llogaritën për gjithë periudhën deri në këputje (7-70 days). Shtesat e peshës mesatare ditore për viçat e grupit të kontrollit të ushqyer me qumësht të plotë+starter+bari i thatë jonxhe sipas periudhave rezultuan 8.4; 15.6, 10.9; 7.9 dhe 2.9 % (p<0.05, 0.05, 0.05, 0.001, 0.4) më të larta se viçat e grupit të eksperimentit të ushqyer me zv. qumështi+starter+bari i thatë jonxhe respektivisht, ose mesatarisht 9.9 % (730 vs 664g) më e lartë për gjithë periudhën deri në këputje (7-70 days). Shpërblimi ushqimit (shtesë peshe/usqim) për viçat e grupit të kontrollit ishte mesatarisht 9.5 % (0.46 vs 0.42) më e lartë (0.48; 0.48, 0.45, 0.43, 0.43) se viçat e grupit të eksperimentit (0.45, 0.41, 0.41, 0.40, 0.42) për gjithë periudhën deri në këputje (7-70 ditë). Dietat me zv. qumështi rezultuan me një kosto prej 12.7 % (212.9 vs 240.07 lek) më të ulët se dietat me qumësht të plotë, mesatarisht për gjithë periudhën deri në këputje (7-70 ditë). Si konkluzion, përdorimi i dietave me zv. qumështi në të ushqyerit e viçave për remont është i leverdishëm për shkak të koston më të ulët.

Fjalë kyç: shpërblim ushqimi, shtesë peshe, viç, zv. qumështi,

ABSTRACT

Study was carried out in dairy farm “Rramilli”, Shijak. The objective was to evaluate effects of milk replacer and traditional (whole milk) diets on growth performance of Holstein replacement heifer calves. A total of 24 calves (n= 12 heads of each group) was included in trial. The calves were randomly assigned to treatments. The calves were weaned at 70 days old. Feed intake and efficiency as well as weight gain, were computed for the periods 7-21; 22-35 ; 36-56; 57-63, 64-70 days. The costs of diets were accounted for all the period up to weaning (7-70 days). Average daily weight gain for control group calves fed whole milk+starter+alfalfa hay according to the periods resulted 8.4; 15.6, 10.9; 7.9 dhe 2.9 % (p<0.05, 0.05, 0.05, 0.001, 0.4) higher than experiment group calves fed milk replacer+starter+alfalfa hay respectively, or on the average, 9.9 % (730 vs 664g) higher for all the period up to weaning (7-70 days). Feed efficiency (gain/feed) for control group calves was averagely 9.5 % (0.46 vs 0.42) higher (0.48; 0.48; 0.45; 0.43; 0.43) than experiment group ones (0.45; 0.41; 0.41; 0.40; 0.42) for all the period up to weaning (7-70 days). Milk replacer diets resulted in a cost of 12.7 % (212.9 vs 240.07 lek) lower than whole milk diets, on the average for all the period up to weaning (7-70 days). As a conclusion, use of milk replacer diets in feeding replacement heifer calves is profitable due to lower cost.

Key words: calf, feed efficiency, milk replacer, weight gain,

HYRJE

Të ushqyerit e viçave me zv. qumështit ka gjetur një përdorim të gjërë falë përmirësimeve teknologjike të bëra në industrinë e përgatitjes së tyre, duke bërë të mundur prodhimin e zv. qumështit të acidifikuar dhe të pasuruar me probiotikë etj. të një cilësie shumë të lartë dhe rritjen mjaft të mirë dhe të shëndetshëm të viçave (Heinrichs, A.J. et al 1995)

Tre strategji apo sisteme të rritjes deri në këputje të viçave egzistojnë: (i) Sistemi i rritjes që bazohet në programin e "rritjes së përsheptuar" (Drackley, J. K. 2001; Jasper, J. and D.M. Weary 2002). – përdorimi i zv. qumështit pluhur, në një sasi 2-3 % të peshës gjallë të viçit ose të lëngshëm 16-20 % të peshës gjallë dhe me një përmbajtje 26-30 % prot.bruto dhe 25-30 % ynd. bruto si dhe cilësi shumë të lartë dhe shtesë peshe të lartë (mbi 900 g/ditë); (ii) programi i të ushqyerit të kufizuar (konvencional) –zv. qumështit (pluhur) jepet në sasi 1-1.25 % të peshës gjallë (450-600gr/dite) ose të lëngshëm (8-10 % peshës gjallë), me përmbajtje 20-22 % prot. bruto dhe 15-20 % ynd. bruto dhe shtesë peshe mesatare 300-400g/ditë; (iii) programi i të ushqyerit "mesatarisht agresiv", që është i ndërmjetëm midis programit të "rritjes përsheptuar" dhe atij konvencional përta i përket sasisë së zv. qumështit pluhur (1.5-1.75 % të peshës gjallë) të përdorur në të ushqyerit e viçave (Stamey et al., 2006; Hill et al., 2006).

Tradicionalisht, viçat janë ushqyer me sasira të kufizuara të qumështit ose zv. qumështit(8-10 % të peshës gjallë në lindje për shkak se zv. qumështit i përdorur në fillimet e veta, ishte i një cilësie jo të lartë dhe nuk shfrytëzohej mirë nga viçat kur jepej në sasira të larta. Viçat reagojnë qartësisht ndaj sasirave më të mëdha të qumështit ose zv. qumështit duke realizuar shtesa peshe më të larta (Huber et al., 1984; Diaz et al., 2001, Jasper et al 2002, Bartlett et al., 2006).

Sipas Hill et al.,2006, është e arësyeshme të presim që viçat e ushqyer me qumësht të plotë të rriten më mirë se ato të ushqyer me një sasi ekuivalente të lëndës thatë nga zv. qumështit, për shkak të diferencave në densitetin në lëndë ushqyese midis qumështit të plotë dhe zv. qumështit.

Objekti i studimit ishte krahasimi i ndikimit të dietave me zv. qumësht +starter+ bari i thatë dhe i dietave tradicionale (qumësht i plotë + starter+bar i thatë) në performancën e rritjes të viçave para këputjes dhe vlerësimi i efektivitetit ekonomik të dietave.

MATERIALET DHE METODAT

Studimi u realizua në fermën e qumështit "Rramilli"–Likesh, Shijak. Në eksperiment u përfshinë 24 krere viça femra të ndarë në mënyrë të rastësishme në 2 grupe me nga 12 krerë secili. Periudha e eksperimentit zgjati 10 javë. Njëri grup shërbeu si grup kontrolli ku dieta e përdorur ishte ajo tradicionale bazuar në qumësht të plotë+starter+bar i thatë jonxhe dhe grupi i eksperimentit me zv. qumështi + starter + bar i thatë jonxhe i cilësisë së lartë. Viçat u këputën në moshën 70 ditë. Për përgatitjen e zv. qumështit të lëngshëm dhe përdorimin e saj si dhe starterit në të ushqyerit e viçave janë ndjekur procedurat dhe normat e rekomanduara nga kompania prodhuese. Zv. qumështit pluhur u hodh mbi ujë dhe u përzie derisa u tret plotësisht dhe u krijua një masë e lëngshme uniforme. Zv. qumështit i lëngshëm u përgatit me 12.5 % lëndë të thatë (125 g/litër ujë) në temperaturë 42⁰C dhe ju dha viçave në temperaturë 35-37 ⁰C në dy vafte, në mëngjez (7⁰⁰)dhe darke(18⁰⁰). Starteri i është ofruar viçave në ditën e 5 –të të moshës ndërsa bari i thatë i jonxhës në ditën 28-të (javën e 4-rt) të moshës. Viçat u mbajtën në bokse në ambiente stalle gjysëm të hapura. Sasia e starterit dhe barit të thatë ka qënë e njëjtë për të dy grupet, me qëllim për të parë efektin e zv. qumështit dhe për ta krahasuar me qumështin e plotë. Të dhënat u grumbulluan për sasinë e ushqimeve të konsumuar (zv qumështi/qumësht i plotë, starter dhe bari i thatë), shtesën e peshës realizuar sipas grupmoshave dhe efektiviteti i konvertimit ushqimit. Në fund të çdo periudhe është

kryer peshimi i viçave. Të dhënat individuale për çdo kafshë të eksperimentit u llogaritën mbi bazën e mesatares për periudhën. Sasia mesatare e konsumit të ushqimit dhe shtesa mesatare e peshës u kalkuluan për çdo viç për periudhën (7-21; 22-42 ; 43-63 dhe 64-70 ditë). Eficienca e konverimit ushqimit në shtesë peshe u llogarit për secilën grupmoshë. Gjithashtu u vlerësua efektiviteti ekonomik i dietave.

Përmbajtja në lëndë ushqyese në një kg l. thatë e ushqimeve të përdorur:

Zv. Qumështi SANOLAK PREMIUM - Perberja: 21 % protein; 17 % yndyre; 9.2 % hiri; 0.2 % fiber; 1.7 % Lizine; 1.2 % Kalcium; 0.7 % fosfor; 50 000 UI Vit. A; 5 000 UI Vit. D₃; 100 mg Vit. E; 4 mg Vit K₃; 100 mg Vit. C; 8 mg Vit. B₁; 14 mg Vit. B₂; 3 mg Vit. B₆; 34 mg Vit. B₁₂; 30 mcg Ca-D- pantotenat; 26 mg acid nikoteinik; 1 mg acid folik; 200 mcg biotinë; 1650 mg klorid kolin; 15 mg beta karotin; 100 mg hekur; 0.8 x 10⁹ CFU bakterie te acidit laktik dhe Enterococcus faecium

Zv. Qumeshti MILSAN-Përbërja: 23 % prot., 17 % ynd., 2.5 % fiber, 9 % hiri, 1.7 % Lizinë, 0.9 % Calcium, 0.7 % Fosfor; 50 000 UI Vit. A; 5 000 UI, Vit. D₃; 100 mg, Vit. E; 4 mg Vit K₃; 100 mg Vit. C; 4 mg Vit. B₁; 4 mg Vit. B₂; 2 mg Vit. B₆; 20 mg Vit. B₁₂; 10 mg Ca-D- pantotenat; 20 mg acid nikoteinik; 1 mg acid folik; 200 mg biotinë; 250 mg klorid kolin; 100 mg hekur; 0.8 x 10⁹ CFU bakterie te acidit laktik dhe Enterococcus faecium

Qumësht i plotë (në 1 kg l.thate), : 22.5 MJ EM, prot. bruto 25.4 %, ynd. bruto 30.8 %, Ca 1%, P 0.75%, Hiri 6.9 %.

Përzierja e starterit të përdorur: 35 % Megi + 40 % misër + 25 % grurë. Përmbajtja në lëndë ushqyese % / kg l. thatë e ushqimeve të përdorur:

Starter Meggi 35 : 10.5 MJ EM, 33.0 % prot. bruto, 4 % yndyrë bruto, 4.5 % fibër bruto, 1.8 % Lizinë, 0.5 % Metioninë, 16.5 % hiri, 2.6 % Kalcium (Ca), 1.1 % Fosfor, 1 % Natrium, 0.5 % magnez; vit A 60000 UI; vit D₃ 6000 UI; vit E 600 mg; vit K₃ 6 mg; vit C 120 mg; vit B₁ 70 mg; vit B₂ 13 mg; vit B₆ 10 mg ; vit B₁₂ 60 mg; Ca-D-pantotenat 30 mg; acid nikotik 80 mg; acid folik 1 mg; biotin 790 mg; klorid kolin 1800 mg; hekur ne formën e (Fe SO₄*H₂O) 500 mg, Zink (ZnO) 750 mg, Mangan ne formen e Oksidit te Manganit (MnO) 485 mg; Bakër (CuSO₄* 5 H₂O)120 mg, Jod [Ca(JO₃)₂] 12 mg; Cobalt 2 CoCO₃ * 3 Co (OH)₂ * H₂O) 2 mg; Selen ne formën e Seleniti natriumit(Na₂ SeO₃) 2 mg

Misër kokërr: EM (MJ) 12.84; prot. bruto 10.40 % ; fiber bruto 2.62 %; ynd. bruto 4.17 %; hiri 1.45 %;

Grurë kokërr : E M (MJ) 12.67; prot. bruto 12.79 %; fibër bruto 2.67 %; ynd. bruto 2.08 %; hiri 1.96 %;

B. thatë i jonxhës – EM (MJ) 8.25; prot. bruto 17.62 %, ynd. bruto 1.52 %, fiber bruto 36.5 %,

Të dhënat u përpunuan statistikisht me ANOVA

RESULTATET DHE DISKUTIMI

Të dhënat në lidhje me dinamikën e zhvillimit trupor të paraqitura në tab. 1 tregojnë që viçat e grupit të kontrollit të ushqyer me qumësht të plotë kanë tregues më të mirë krahasuar me viçat e grupit të eksperimentit në të cilën është përdorur zv. qumështi. Këto diferenca rezultojnë në të gjitha grupmoshat e viçave nga lindja deri në këputje dhe që vërtetohen statistikisht sipas niveleve probalitare (significance) të pasqyruar në tabelën 1.

Tabela 1. Performanca e rritjes viçave sipas periudhave të moshës

Tiparet	grupi kontrollit	grupi eksperimentit	s.e.d	Significance
Nr. i kafshëve	12	12		
pesha e gjallë (kg)	mean ±δ	mean ±δ		
lindje	40.88±1.95	41.08±2.07	0.58	0.8177
7-d	43.84±1.80	43.6±2.11	0.56	0.7553
21-d	51.49±2.10	50.64±2.35	0.65	0.3621
35-d	61.96±2.61	59.70±2.91	0.80	0.0581
56-d	78.37±3.75	74.52±3.83	1.09	0.0207
63-d	84.14±3.98	79.79±4.12	1.16	0.0153
70-d	89.91±4.37	85.40±4.57	1.29	0.0216
shtese peshe mesat.(g/d)				
7-21-d	546.00±52.37	503.75±42.50	1.37	0.0411
22-35-d	747.75±54.12	646.83±63.47	1.66	0.0426
36-56-d	781.92±65.88	704.83±54.14	1.73	0.0490
57-63-d	813.75±47.94	753.92±48.69	1.39	0.0018
64-70-d	824.92±60.35	801.83±72.60	1.92	0.4061

Duke shqyrtuar shtesat e peshës të rezultuara sipas periudhave si në grupin e kontrollit ashtu dhe të eksperimentit vërejmë që dinamika e zhvillimit trupor të viçave në të dy grupet paraqitet e ndryshme në grup moshat e ndryshme. Shtesat e peshes së viçave të grupit të kontrollit për periudhat 7-21; 22-35; 36-56; 57-63; dhe 64-70 rezultojnë 8.4, 15.6, 10.9, 7.9 dhe 2.9 % respektivisht më të larta krahasuar me viçat e grupit të eksperimentit ose me një mesatare prej 9.9 % (730 g vs. 664g).

Diferenca të tilla janë për shkak të diferencave në vlerë ushqyese që egziston midis qumështit dhe zv. qumështit. Rezultat të ngjashme janë raportuar nga Stamey et al., 2006; Hill et al., 2006. Të dhënat tregojnë që diferencat në shtesë peshe midis viçave të grupit të kontrollit dhe atyre të eksperimentit me avancimin e moshës zvoglohen. Kjo ndodh për shkak të efektit që ka rritja e konsumit starterit pas moshës 8 javë, duke zënë një peshë specifike më të madhe në plotësimin e nevojave ushqimore të viçave dhe zvoglimit të sasisë së konsumit të ushqimit të lëngshëm (qumështit/zv. qumështit) dhe për pasojë të ndikimit të tij në shtesë peshe.

Në tabelën 2 jepet skema e përdorimit të zv. qumështit Sanolac Premium deri në moshën 21 ditëshë dhe Milsanit pas moshës tre javë deri në këputje (22-70 d). Vëmendje e veçantë i është kushtuar kalimit gradual nga kulloshtra dhe qumështi tranzit në të ushqyerit me normë të plotë me zv. qumështi Sanolac premium. Kjo procedurë është e nevojshme për tu ndjekur me qëllim për të parandaluar diarenë që mund të shkaktohet nga përdorimi i zv. qumështit.

Tabela 2. Sasia e qumështit të plotë/zv.qumështit (litër/ krerë/ditë) konsumuar nga viçat sipas moshës

Mosha (ditë)	Grupi kontrollit	Grupi eksperimentit
1 - 3	kulloshter + qum. tranzit	kulloshter + qum. tranzit
d 4-rt	2 x 2.0 litra qum. plotë	2 x 2.0 litra (75 % qum. plotë + 25 % zv.q (Sanolac Premium)
d 5-të	2 x 2.5 ,, ,,	2 x 2.5 ,, (50 % qum. plotë + 50 % zv.q (Sanolac Premium)
d 6-të	2 x 2.5 ,, ,,	2 x 2.5 ,, (25 % qum. plotë + 75 % zv.q.(Sanolac Premium)

7-21	2 x 3.0 „ „	2 x 3.0 „ Sanolac Premium
22-35	2 x 3.0 „ „	2 x 3.0 „ Milsan
36-56	2 x 2.5 „ „	2 x 2.5 „ „
57-63	2 x 2.0 „ „	2 x 2.0 „ „
64-70	2 x 1.5 „ „	2 x 1.5 „ „

Në tabelën 3 jepet struktura e dietave ushqimore sipas periudhave deri në këputje. Racioni ushqimor ditor mesatar (kg/l.thatë/krerë/ditë) për gjithë periudhën deri në këputje rezulton me një strukturë (në % të lëndës thatë) 40.2 % e zë ushqimi i lëngshëm (qumështi i plotë/zv. qumësht), 50.8 % starteri dhe 9 % bari i thatë i jonxhës

Tabela 3. Sasia ushqimit (kg l. thatë /ditë/krerë) konsumuar nga viçat sipas moshës

Moshë (ditë)	Grupi Kontrollit				Grupi eksperimentit			
	Totali	Qum. i plotë	Starter	Bari i thatë jonxhe	Totali	Zv. qumështi	Starter	Bari i thatë jonxhe
7-21	1.130	0.750	0.380	-	1.130	0.750	0.380	-
22-35	1.560	0.750	0.675	0.135	1.560	0.750	0.620	0.135
36-56	1.718	0.625	0.920	0.173	1.718	0.625	0.920	0.173
57-63	1.882	0.500	1.140	0.242	1.882	0.500	1.140	0.242
64-70	1.893	0.375	1.256	0.262	1.893	0.375	1.256	0.262
Mes.(7-70ditë)	1.589	0.639	0.807	0.143	1.589	0.639	0.807	0.143
EM(MJ/kg thate)	1.	22.5	12.02	8.25		17.86	12.02	8.25
Prot. bruto(%)		25.4	18.50	17.62		22.55	18.50	17.62

Duke ju referuar të dhënave të tab. 4, shkalla e konvertimit të ushqimit në shtesë peshe midis viçave të grupit të kontrollit me ato të eksperimentit paraqitet e ndryshme për periudhat moshore të ndryshme. Siç shihet në javët e para të moshës së viçave tek të dy grupet (kontrollit&eksperimentit), shkalla e konvertimit të ushqimit në shtesë peshe rezulton më e lartë krahasuar me periudhat e mëvonshme dhe që është e lidhur me peshën specifike më të madhe që zë ushqimi i lëngshëm (qumështi i plotë/zv. qumështit) në plotësimin e nevojave ushqimore e cila ka vlerë biologjike më të lartë. Efektiviteti i konvertimit ushqimit në shtesë peshe për viçat e grupit të kontrollit rezulton mesatarisht 9.5 % (0.46vs 0.42) më i lartë se grupi eksperimentit në të cilën është përdorur zv. qumështi.

Tabela 4. Efiçensa e konvertimit të ushqimit në shtesë peshe

Moshë (ditë)	Grupi kontrollit			Grupi eksperimentit		
	kg l.thatë /ditë/krerë	Shtesë peshe kg/dite	Shtesë peshe/ ushqim	kg l. thatë /ditë/krerë	Shtesë peshe g/ditë	Shtesë peshe/ ushqim
7-21	1.130	0.546	0.48	1.130	0.504	0.45
22- 35	1.560	0.748	0.48	1.560	0.647	0.41
36-56	1.718	0.782	0.45	1.718	0.705	0.41
57-63	1.882	0.814	0.43	1.882	0.753	0.40
64-70	1.893	0.825	0.43	1.893	0.802	0.42

Në tabelën 5 jepen të dhënat mbi koston e racionit ushqimor ditor mesatar për gjithë periudhën deri në këputje (7-84d). Në grupin e kontrollit është zbritur diferenca në shtesë peshe mesatare ditore prej + 66 g krahasuar me grupin e eksperimentit e cila është llogaritur si e ardhur. Siç shihet, dietat me zv. qumështi të përdorura në grupin e eksperimentit rezultojnë me një kosto prej 12.7 % (212.90 vs.240.07 lek) më e ulët krahasuar me grupin e kontrollit në të cilën është përdorur qumështi i plotë. Kosto më e ulët është raportuar gjithashtu nga Drackley, J. K. 2001.

Tabela 5. *Kosto e racionit ushqimor ditor (lek) për gjithë periudhën deri në këputje (7-84 d)

Grupi i kontrollit				Grupi eksperimentit			
Ushqimet	Sasia	Lek/kg	Vlefta	Ushqimet	Sasia	Lek/kg	Vlefta
Qumësht plotë(litra)	5.10	36.70	187.17	Zv. qumeshti(litra)	5.1	27.53	140.40
Starter (kg fizik)	0.896	77.60	69.52	Starter (kg fizik)	0.896	77.60	69.52
B. thatë jonxhe (kg fizik)	0.160	18.60	2.98	B. thate jonxhe (kg fizik)	0.160	18.60	2.98
Shuma			259.67				
Zbritet (dif.shtesës peshës (g/d)	0.066	297.0	19.60				
Kosto			240.07	Kosto			212.90

*Çmimi (lek/kg) i qumështit të plotë dhe barit të thatë të jonxhës është llogaritur me çmimin e kostove të prodhuar në fermë, ndërsa ushqimet e tjera janë siguruar nga blerja në treg. Çmimi i zv. qumështit pluhur: 235 lek/kg ; starter Megi 160 lek/kg, misri kokërr 35lek/kg; gruri kokërr 40 lek/kg,

KONKLUZIONI

Viçat e ushqyer me dieta me qumësht të plotë për periudhën deri në këputje paraqesin performancë më të mirë në shtesën e peshës dhe efikasitet më të lartë të konvertimit të ushqimit për të njëjtën sasi të lëndës thate të konsumuar por me një kosto më të lartë krahasuar me dietat me zv. qumeshti. Prandaj përdorimi i dietave me zv. qumështi (konvencional) në të ushqyerit e viçave në fermat e qumështit paraqet leverdi ekonomike për shkak të koston më të ulët, pavarësisht performancës së rritjes relativisht pak më të ulët për periudhën para këputjes.

LITERATURA

Revista shkencore

1. Bartlett, K. S., F.K. McKeith, M.J.VanderHaar, G.E.Dahl and J. K. Drackley. Growth and body
2. composition of dairy calves fed milk replacers containing different amounts of protein at two
3. feeding rates J. Anim. Sci. 2006, 84(6):1454-1467
4. Diaz, M.C., M.E. Van Amburg, J.M. Smith, J.M. Kelsey, and E.L. Hutten. Composition of growth of Holstein calves fed milk replacer from birth to 105-kilogram body weight. J. Dairy Sci. 2001; 84(4):
5. 830-842
6. Heinrichs, A.J., S.J. Wells, and W.C.Losinger. A study of the use of milk replacers for dairy calves
7. in the United States. J. Dairy Sci. 1995; 78(12): 2831-2837

8. Hill, T. M., J. M. Aldrich, R. L. Schlotterbeck, and H. G. Bateman, II. 2006a. Effects of feeding calves different rates and protein concentrations of twenty percent fat milk replacers on growth during the neonatal period. *Prof. Anim. Sci.* 22:252.
9. Hill, T. M., J. M. Aldrich, R. L. Schlotterbeck, and H. G. Bateman, II. 2006b. Effects of feeding rate and concentrations of protein and fat of milk replacers fed to neonatal calves. *Prof. Anim. Sci.* 22:374.
10. Huber, J.T., N.L. Jacobson, A.D. McGilliard, J.L. Morrill, and R.S. Allen. Influence of feeding
11. different amounts of milk on performance, health, and absorption capability of baby calves. *J.*
12. *Dairy Sci.* 1984; 67:2957-2963
13. Jasper, J. and D.M. Weary. Effects of ad libitum milk intake on dairy calves. *J. Dairy Sci.* 2002; 85(11):3054-3058.
14. Stamey, J. A., R. L. Wallace, K. R. Grinstead, D. R. Bremmer, and J. K. Drackley. 2006. Influence of plane of nutrition on growth of dairy calves. *J. Dairy Sci.* 89(Suppl. 1):50. (Abstr.)
- 15. Proceedings**
16. Drackley, J. K. 2001. Milk feeding strategies for calves: Does “accelerated growth” make sense? Pages 27-36 in *Proc. 5th Annu. Professional Dairy Heifer Growers Assoc. National Conf., Seattle, WA. PDHGA, Savoy, IL.*
- 17. Libra**
18. National Research Council. *Nutrient Requirements of Dairy Cattle.* 7th Rev. Ed. National Academy
19. Press, Washington, DC. 2001

SEKTORI I GJEDHIT NË KOSOVË-SFIDAT DHE PËRSPEKTIVAT CATTLE SECTOR IN KOSOVO-CHALLENGES AND PERSPECTIVES

MEDIN ZEQRIRI¹, HYSEN BYTYQI², YLLI BIÇOKU³,

¹Gjilan Municipality, Republic of Kosovo, and PhD candidate at Agricultural University of Tirana, ALBANIA,

E-mail: medinzeqiri@yahoo.com

²Faculty of Agriculture and Veterinary, University of Prishtina, Prishtina- KOSOVO,

E-mail: hysen.bytyqi@uni-pr.edu

³Faculty of Agriculture and Environment, Agricultural University of Tirana, ALBANIA.

E-mail: bicokuy@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Qëllimi i kësaj analize është që të japë një përshkrim sasior dhe cilësor të sektorit të gjedhit të Kosovës, si dhe sfidat dhe perspektivat e tij. Bujqësia, në Kosovë, është e orientuar drejtë mbijetesës, për shkak të madhësisë shumë të vogël të fermës (1.52 ha për familje), dhe për këtë arsye shumica e tyre janë ferma mikse. Vetëm 15-20% e qumështit dhe mishit të prodhuar shkon për përpunim. Në përgjithësi, prodhimi blegtoral është parë si një nga degët thelbësore të bujqësisë të Kosovës. Efikasiteti ekonomik dhe produktiviteti janë në nivel të ulët. Vlerësimi i performancës të fermave që mbarështojnë gjedh nuk është i mundur, për shkak të mungesës së të dhënave. Për këtë material janë përdorur të dhëna të statistikave bujqësore, studime, raporte, si dhe intervista me ekspertë të bujqësisë. Për të përmirësuar këtë situatë, janë të nevojshme, të zbatohen disa programe dhe politika ekonomike për të përmirësuar produktivitetin e sektorit të qumështit, cilësinë e produkteve, zbatimin e praktikave të mira të prodhimit blegtoral, praktikave të mira higjienike dhe standardet e mirëqenies së kafshëve.

Fjalët kyçe: *Fermat e vogla, mbijetesë, produktet blegtorale, produktiviteti, sektori i qumështit.*

ABSTRACT

The objective of this analysis is to provide a quantitative and qualitative description of the Kosovo cattle subsector, its challenges and perspective. Kosovo agriculture sector still remains subsistence-oriented, due to a very small average farm size (1.52 ha per family) - most farms are mixed. Hence, only 15-20 % of milk and meat is delivered to milk and meat processors. Generally, livestock production is seen as a backbone of Kosovo's agriculture. The economic efficiency and productivity are at low level. Assessment of the performance at cattle farm level is not possible because data are missing. This paper is based on secondary agricultural statistics, studies/reports, and as well expert interviews. To improve the situation several economic and policy programs are needed to: improve the productivity of the dairy sector; improve safety and quality standards including good livestock practices, good hygiene practices and animal welfare standards.

Key words: *Dairy sector, livestock products, productivity, small sized farms, subsistence.*

1.INTRODUCTION

Kosovo continues to be predominantly a rural economy with 12 percent of GDP generated by agriculture, and is the largest employer in Kosovo today, accounting for approximately 35 percent of total employment (World Bank, 2011; IPA, 2013; Qeveria, 2013). The majority of the Kosovo's population (61 percent) lives in rural areas (FAO, 2014).

Source: MAFCP Statistics Yearbook of Albania for 2012 and authors' calculation


The average milk yield in 1990 was 1482 litres/cow/year and recorded 2712 litres in 2013, which is considered very low compared to the average of the EU-27, which is slightly higher than 6 500 litres per cow per year.

The low capital intensity of production has resulted in low productivity, relatively high production costs and low profitability, which in turn prevent the accumulation of capital for financial investment, thus perpetuating the low production and productivity levels on many dairy farms.

The developing cattle sector makes a considerable demand on feed and the supply and quality of fodder supplies. Possibilities for the expansion of natural pastures are limited, so increased feed must come from improved production of fodder such as alfalfa, corn and other grasses as well as improved utilization of industrial compound feed.

Most dairy farms are very small with 1 or 2 cows per farm. Only about 3 372 farms have more than five dairy cows (MAFCP, 2008 and 2012). However, the structural change to market orientation has already started, as illustrated in the following figure.

Figure 2: Dynamics of commercial cow farms



Source: MAFCP -Statistics Yearbook of Albania for 2008, and 2012

Several household farms that intend to continue their farm businesses in the long term have started in recent years with the import of heifers, improving cattle barns, investing in basic milking machines and improving feeding systems in order to specialize in milk production. Also, the establishment of some new dairy cattle farms with modern equipment and more than 50 cows per farm has been observed in recent years. These types of dairy farms already have a much higher productivity than the majority of very small dairy farms with 1-2 cows.

Table 2: Bovine Milk and Meat Production in Albania (in thousand tons)

Descriptor	1990	1992	1995	1998	2000	2005	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Cow milk	421	486	791	722	807	930	895	907	930	955	957	969
Bovine meat	40,0	42,5	55,9	58,1	63,0	68,1	66,0	66,0	68,0	68,7	69,0	69,7

Source: MAFCP Statistics Yearbook of Albania for 2012, INSTAT 2013

Most milk producers are semi-subsistence farming households. The market (mainly for cow's milk) is characterized by the existence of both informal (direct selling from farmers) and formal market channels (collection and distribution by dairies).

It is assumed that more than half of the milk produced in Albania is used for farmers' own consumption, sold directly on informal markets or used for feeding animals (e.g. calves) and only up to 12 percent reaches the processing industry (RisiAlbania, 2014). These figures reveal the importance of livestock and dairy production for sustaining rural livelihoods. While according the annual survey of the MAFCP (2007) only 23 percent¹ produced milk is going to the dairies for processing.

Majority of the cattle milk and meat supply originates from plain areas of Fier, Lushnje, Elbasan, Shkoder and Tirana where the density of cattle is higher and access to feeding is less difficult.

¹ There is discrepancy between different authors as are missing the official statistics.

1.3 Milk and Meat Processing Industry

After 1990 the former state owned milk and meat processing units were destroyed. Starting in 1992, several private families set up new private milk and meat processing units under very simple conditions. Step by step, further investments in buildings and equipment took place in several growing dairies and meat processing¹.

Milk Processing. The dairy sector is one of the most important industries in the agribusiness sector of Albania and has grown very significantly over the last five years. To produce high quality milk and milk products under global competition is the key challenge for the future of the dairy industry in Albania. Most of the small processing units use traditional cheese production technologies. There are about 25 modern dairy processing plants in Albania that are operating successfully, although they are struggling with competition from the informal market.

The dairy plants with complete milk processing lines produce pasteurized milk, yogurt, UHT milk, butter, butter milk, curd and cheese and fruit yogurt. These milk processing plants are the main suppliers of Albanian consumers, especially those in urban areas who prefer to buy processed milk products in shops and supermarkets.

The dairy processing industry – along with the milk collection system – is still in the process of modernizing structures and technologies. While most small processing units still use traditional craftsmanship technologies. A number of modern processing plants are operating successfully, although they are struggling with competition from informal markets.

The milk collection and distribution system is characterized by informal organization. Usually there is no formalized contractual system established between milk producers and processors. Depending on the distance from the urban markets, farmers have the choice to sell their milk directly to the consumers or in small shops, to local processing units or to milk collectors.

The main “quality control” is to buy from trusted sellers and boil the milk at home. The price of this milk is considerably lower than pasteurized milk, making it affordable for the rural and urban poor. Moreover many consumers have a positive evaluation of this kind of milk as more fresh because of the direct linkage with the farmer.

Processed and packaged products face strong competition from informal raw milk sales and sale of loose traditionally crafted products. One important cost factor in the formal market is imposed by regulations and tax restrictions, especially VAT.

The main dairy products produced in Albania from cow milk re: (i) pasteurized milk, (ii) UHT milk, (iii) butter milk, (iv) butter, (v) yoghurt, (vi) white cheese, and (vii) yellow cheese.

Meat Processing. Meat processing industry was the first agro-industry sector that has been consolidated and developed. The industry is concentrated in the domestic market and relies on imports of frozen meat at cheap price, which is provided by some large importers.

In 2013 the cow’s milk production of Albania was 969 000 tonnes or 85.7 percent of total raw milk while bovine meat was 69 700 tones or 45,5 percent of total meat produced in the country (INSTAT, 2014).

The main meat products produced by processors are different kind of salami and sausage. Technology and equipment of the leading milk and meat processing companies are modern and comply with the national standards, and they apply HACCP.

¹ Before 1991 Albania had about 18 state owned milk processing units. It was reported that the largest of them had a processing capacity up to 100 tonnes per day. All of them had been destroyed and only the building of one is now again used and updated as milk processing plant.

2. Profile of main value chain operators

Farmers. Approximately 214 000 farming families are managing cattle for milk and meat production. The majority of cow milk and beef production units are very small with 2 or 3 cows per farm and their off-springs. Almost 3,000 farms with dairy cows have more than 5 cows, while the bull fattening farms are very rare. Most of the beef is coming from the dairy farms as the result of the culling animals and their calves. In Albania is lacking the tradition to manage beef breed. In the last 10 years farmers have started to crossbreed their cows with beef breed using the artificial insemination.

In the low land, which is the most intensive one, farmers are breeding mainly cows that are crossbreed with Black&White and Holstein breeds, in hilly areas, which is less intensive, predominantly are the crossbreeds with Jersey breed.

The insemination practice of cows in Albania is based on artificial and natural insemination. The artificial inseminations are apparently more used and according to MAFCP statistics (2012), 60% of cows are inseminated artificially. All of the bull semen is imported.

In small dairy farms (1 to 10 cows) cows are usually milked by hand, which affects negatively hygiene and food safety. Only dairy farms, specialised in milk production (normally more than 10 cows) started to use the mobile milking machines over the last years. Farms with more than 50 cows usually have milk storage tanks with cooling system and farms with more than 100 milking cows have milking parlour.

There are limited or no financial incentives to increase milk quality, since prices are determined mainly by quantity and fat content. The majority of the milk producers have no information about the microbiological status of their raw milk. (MARDWA, 2014).

Very few farms are specialised in bovine meat production and they slaughter their animals in a very low weight, where the average live weight of slaughtered fattening bullocks is about 220-280 kg.

Input and service suppliers. Major inputs into farm-level dairy and beef production are farm-grown forage or pasture and family labour. Concentrate feed is used to a small extent (there are not specific statistics on that). Several traders are involved with the import of: (i) cereals for animal purpose, (ii) protein feed- mainly soybean meal, (iii) animal feed, (iv) bull semen, and (v) heifers. Veterinary services are provided by private veterinarians – private veterinarian extension services are relatively well-organized and more efficient compared to the agronomic or zootechnical services. Typical veterinarian services including artificial insemination and treatment (for diseases) are present in most parts of the country.

Processors. According to data from MAFCP (2012) the total number of milk processing units in Albania ranged between 300 and 400 units during the last years, but this figure may be much higher, as there are hundreds of informal processing plants that are not included in the official statistics.

This figure shows a very fragmented industry, with an average of three employees and processing capacity of 1 – 2 tons of milk per day. About 300 of the processing units are small cheese plants with simple traditional technology. The hygiene conditions of most of such small processing plants are not in conformity with requirements of the Albanian¹ and the European standards.

There are 63 registered meat processors, which are operating successfully, but the 5 biggest processors dominate the industry (MARDWA, 2014).

As the local meat is limited and expensive, processing companies are importing 95 % of their needed raw meat mainly from Brazil and Canada, usually as deep frozen meat (Markhof et

¹ Law No. 944 date 11.11.2005, and Food Law No. 9863, date 28.1.2008

al., 2010). This means that exist a very weak link between livestock farmers and meat processing industry.

Collectors. Larger milk processors rely on milk collectors for the supply of raw milk. There are two profiles of collectors. First type of collectors, are simply employees of the processing plant who work for the company against a monthly salary. Second type of collectors, act as independent intermediaries – they buy milk from farmers and add a margin to cover cost and profit, and sell to the processor in the context of a long term relation. Larger processors may have several collectors and may have a combination of them (employees and independent).

Slaughterhouses and Butchers. Traditionally, cattle are slaughtered partly on the farm by the farmer or the butcher (small slaughter point) who then takes the meat to his shop. According to the Albanian law¹ the animals must be slaughtered in approved slaughterhouses; but given the small number of slaughterhouses in operation, the small capacity of processing (mostly 3-4 cattle per day), and the distance of the slaughterhouse may be concluded that slaughtering is not properly done. The farmers and/or butchers do not pay attention to the liquid and solid waste from slaughtering (Markhof et al, 2010).

Fresh meat and its products sold in retail stores are not always guaranteed (especially small cities and rural areas) due to the partial implementation of the law and shortcomings in infrastructure, including a lack of abattoirs that meet national minimum standards. Slaughterhouses need to be improved and to meet food safety standards. Currently 11 new slaughterhouses meet the required standards (MARDWA, 2014). There is a weak link between the processing industry and domestic supply as raw meat for as long as import prices are low and slaughterhouses are not nearly in line with capacity and required standards.

Wholesalers tend to connect usually small processors with fragmented retail sector. Their role is decreasing as larger companies are improving their production and distribution network – larger companies tend to distribute directly to retailers.

Retailers Most consumers buy cheese and other milk by-products in specialised groceries. Therefore, such small groceries that trade cheese, other mil by-products, olive oil and meat by products as well as other agro-food traditional products play a crucial role in the dairy value chain. The emergence of supermarket chains is changing the retail sector structure and patterns.

Price of Animal Feed: Animal feed prices are high and this is an obstacle to the increase of productivity, especially in cows and fattening bulls. Thus, a kilogram of compound feed for cows is 30- 40 percent higher than 1 kg of milk.

Health situation: The diseases caused by the microbiological contamination of food remain major threats to public health. The problems in the Animal Health and Food Safety System have been identified by several studies/reports, most notably in meat and milk products. Brucellosis has been a major health concern (WHO, 2009; World Bank, 2007). One of the reasons, behind this situation, in addition to weak law enforcement, is also low farmer awareness about animal diseases and food safety standards and their implications in terms of health risks for the farmer households and for the final consumers.

Advisory Service: However, the weak knowledge of modern production technologies and animal welfare and health requirements are the main problems faced by farmers and where the advisory service needs to work in the future. In a survey, conducted by the authors during 2014, was found that most farmers are not aware about the institutions in charge of food safety and animal health control. About 1/3 of the farmers stated that they never or rarely use ear tags to identify their livestock animals, about 80 percent of the respondents state that they have no cooling tank for storing the milk, which is a prerequisite for attaining milk safety and quality standards. in addition most farmers' state that they do not know symptoms of the

¹¹ Law No.10 465, date 29.09.2011 "On Veterinary Service in the Republic of Albania

Brucellosis (60%) and TBC (64%), indicating the low awareness level among farmers about animal diseases and food safety [Gjeci et al, 2015].

Extension and Veterinary Services must plan awareness, teaching and training programs for dairy farmers to improve safety standards at farm level.

Farmers Education: Only 3% of the farm holders have university education and 37% have upper secondary or tertiary education, while the remaining 63% have lower secondary, primary or no education. About one-third of the farm holders have agricultural education background. These are likely to be the older farmers, who have accomplished agricultural vocational high schools in the past. (MARDWA, 2014)

3. MARKET AND TRADE

World Trade Organization (WTO) accession in September 2000 and the implementation of a number of bilateral free trade agreements with the countries in the region in recent years mean that Albanian producers are facing stiffer competition, specifically as a result of higher quality dairy products being present on the domestic market. The import of milk and its product is only 7-10% of the domestic consumption (Meço et al, 2010; MAFCP, 2012; INSTAT 2013)

With regard to livestock, Albania has a deficit of meat and milk. In 2013 it imported 11 824 tonnes of milk and dairy products, amounted to more than ALL 2 billion (INSTAT, 2014).

Meat imports remains high and stable over the past few years reaching about 36,319 MT in 2012, which corresponds to about 1/4 of the domestic supply. In addition, there are increased imports of live animals, especially pigs and cattle. Imports of bovine meat is still low, reaching about 1 700 tonnes or 4.7% of total meat imports (MARDWA, 2014)¹.

About 90-93 percent of consumer demand for milk and its products is currently met by local products and 7-10 percent by imports. In 2013, the main imported products were dairy products and UHT milk, which came mainly from Italy, Greece, Slovenia and other European countries.

A considerable number of farmers sell the raw milk and fresh meat that they produce directly to consumers without charging VAT (informal market), and thus creating unfair competition for the emerging Albanian milk and meat processing industry.

One important cost factor in the formal market is imposed by regulations and tax restrictions, especially VAT. On the consumer side, there is still a lack of awareness on prices paid for quality. The price that farmers get for their raw milk is fixed based on fat percentage, however, the control is weak and farmers can easily abuse this system. A major problem for farmers is the lack of a contractual framework and delayed payments.

Although the Albanian dairy and meat industry can be characterized by improving technologies, hygienic conditions and control systems, it is still far from being competitive with developed countries. Yet it is believed that the industry will be able to compete with products from neighbouring countries, especially if Albania continues to harmonize programs and practices with those of the European Union.

Lack of cooperation among farmers and a poor vertical cooperation or partnership between milk & meat processors and producers also represent causes of inefficiency and inconsistent product quality.

4. Government policy for the sector

Due to the significance of livestock, particularly in rural areas, MARDWA has selected the milk and meat sector as a policy priority and the Albanian government is inclined to support primary production and the dairy industry. One of the stated objectives is to improve the

¹ Author calculations based on the data of Inter-sectoral Strategy of Rural Development, 2014-2020.

competitiveness of products in order to substitute for import and increase export potential (GoA, 2013).

Agricultural funding remains limited, compared to the needs of the sector and to other countries in the region. Furthermore, national support measures provide subsidies for actual production rather than promoting competitiveness and facilitating access to credit. (EC, 2014)

4.1 Main policy documents

The MARDWA performs its functions on the basis of three main documents: the *National Strategy for Development and Integration (NSDI)*, the *Mid-Term Budget Program (MBP)*, and *Sectoral, Sub-Sectoral and Crosscutting Strategies*, where are detailed mid-term and long-term policy objectives, the main interventions, the monitoring tools and the costs of implementation of policies and interventions. The MARDWA short term policies are detailed in the Yearly Program and the relevant activities in the Yearly Action Plan.

The National Strategy for Development and Integration 2014-2020, considers agriculture as one of the key sectors and it aims to enhance competitiveness and growth through Innovation. The MARDWA, in collaboration with other line ministries, has prepared the Crosscutting Strategy for Agriculture and Rural Development (ISARD) in Albania for the period 2014-2020.¹, which will be partly implemented through the IPARD III Programme² (Instrument of Pre-Accession Assistance for Rural Development) and partly from the National Support Program which is updated in yearly basis.

4.2 Government financial support for the sector

The Albanian Government started in 2007 the subsidy/support schemes program, but livestock sector was not part of it. The 2008 program comprised some direct support measures (premium per cow) for dairy/livestock farming and subsidized interest rates of loans for agro-food processing companies. Since 2010 the programme changed from the support related to the number of cows to the milk delivered to the milk processors.

The current national support schemes combine elements of investment support and direct payments for increasing the production in the most important agricultural sectors. In 2014, support to agriculture and rural development was implemented through 21 measures of which 20 measures are varying forms of direct payments; only 4 measures are for the livestock sector.

In the last eight years 40 development schemes were supported. Livestock has received 1.02 billion ALL, or about 16.3% of total budget expenditures. Within livestock support 45.6% of the expenditures were given to the cattle sector (**Musabelliu et al., 2014**).

The 2015 state support measures for dairy livestock include:

- Payment of 10 ALL/litre of milk, for livestock farms 10 – 80 cows, in line with quantities declared to tax authorities (and supplied to processors).
- Subsidy of 70 % of the interest rate for 7 subsequent years for investments in farms and agro-industry.
- Guarantee fund, covering 50 % of the principal, for loans up to 20 million ALL.

In addition milk and meat production and processing is supported and by IPARD as the instrument for the implementation of the Rural Development Cross-Cutting Strategy.

¹ (ISARD) aims to "Support and to develop the appropriate framework conditions for an efficient, innovative and viable agro-food sector capable to sustain the competitive pressure and meeting the requirements of the EU market". The ISARD target is the creation of 25000 new jobs in agro-food processing activities

² IPARD III is the instrument for the implementation of the Rural Development Cross-Cutting Strategy. The present programme covers the period 2014-2016.).

CONCLUSIONS

The size of cattle farms in Albania is currently too small to be competitive. Therefore, it is important to facilitate structural change in the coming years through support programs focused on economically viable farm structures including the establishment of producer groups. Cattle farms continue to have problems with their sustainability as a result of the small scale structures. Low technology standards and use of poor genetic material (mainly cross breeds) for milk and meat production is another constraint. The overall efficiency of production is low due to improper animal feeding and the limited application of modern production techniques.

The overall compliance of producers and processors with minimum national standards and EU food safety standards, environmental protection, animal health and welfare has to be improved considerably.

Milk and meat quality is a key issue. Therefore, support should highlight investments in improving milking technology, slaughtering of animals, hygiene, storage and housing facilities and related equipment.

Taking into consideration the overall situation in the sector, future interventions should be oriented towards: (i) Improving farm structure; (ii) Increasing overall competitiveness; (iii) Improving the status of attainment of national and EU standards

There is clear indication of needs in improving farmer skills and knowledge for improving cattle management, milk yields and fattening bulls daily body weight, as these yield levels achieved in Albania are far below what would be expected based on the comparative data analysis with regards to natural conditions. The other gap lays in the sales and marketing components and increasing capacities of downstream value chain market participants.

Acknowledgment: The authors of this paper are thankful to Dr. Drini Imami and Dr. Edvin Zhllima for their comments and contributions.

REFERENCES

1. **DSA, (2011):** Agribusiness sector survey, Final report for Italian Cooperation”, Tirana, Albania.
2. **EC (2014):** Indicative Strategy Paper for Albania (2014-2020). Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA II).
3. **Foy Reed, B., Skreli, E., (2013):** Agricultural Markets in a Transitioning Economy. An Albanian Case Study. ISBN- 13: 978 1 78064 100 3
4. **GoA, (2013):** Programi i Qeverise 2013-2017 (The Program of the Government of Albania), available at: <http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Programe/Programi-i-Qeverise.pdf>
5. **Gjeçi, G., Biçoku, Y., Imami, D., (2015):** Awareness about Food Safety and Animal Health Standards – the case of dairy cattle in Albania.
6. **INSTAT (2013):** Statistikat e Bujqesise.
7. **INSTAT (2014):** Statistikat e Bujqesise. <http://www.instat.gov.al/en/themes.aspx>
8. **MAFCP (2007):** Inter-Sectoral Rural Development Strategy of Albania, 2007-2013.
9. **MAFCP (2008):** Vjetari Statistikor 2007.
10. **MAFCP (2012):** Vjetari Statistikor 2011.
11. **MARDWA, (2014):** Strategjia Ndersektorale per Zhvillimin Rural dhe Bujqesor, 2014-2020. (Inter-Sectoral Rural Development Strategy of Albania).
12. **Markhof, M.M, Musabelliu, B., Zusi, A., (2010):** Analysis of Meat Sector. “Capacity Building for Implementing the Rural Development Strategy”. The European Union’s IPA 2008 Programe. For the Republic of Albania
13. **Meço, M., Sula, R., Kec, R., Çerava, A., (2010):** Assesemnt of Profitability of Dairy Sector in Albania.

14. **Musabelliu, B., Sulçe, S., Meço, M., Maçi, A., Kongoli, R., Dobi, P., Biçoku, Y., Brahushi, F., (2014):** Analiza e Skemave Meshtetese- Politikat dhe Strategjite e Nderhyrjeve ne Bujqesi. Studim per MBZHRAU.

15. **RisiAlbania (2014):** Project Document 2013 – 2017, Annex 11: First subsector analyses- Agro processing. <http://risialbania.al/wp-content/uploads/2014/10/Agro-processing-First-Subsector-Analysis1.pdf>

16. **World Bank, (2007):** Albania Strategic Policies for a More Competitive Agriculture Sector”, Sustainable Development Sector Unit Europe and Central Asia, Tirana, Albania. Report No. AAA18-AL Available at: http://www.wds.worldbank.org/external/default/WDSContentServer/WDSP/IB/2007/11/29/000310607_20071129100849/Rendered/PDF/AAA18optmzd0AL.pdf. Last accessed, May, 2015

17. **World Health Organization, (2009):** Strengthening food safety and nutrition policies and services in South-eastern Europe. Edited by: Dorit Nitzan Kaluski. Available at: http://www.euro.who.int/data/assets/pdf_file/0006/99897/E92650.pdf. Last accessed, May 2015.

APLIKIMI I BIOTEKNOLOGJISË SË INSEMINIMIT ARTIFICIAL, ME SPERMË TË SEKSUAR PËR RRRITJEN E NIVELIT TË REMONTIMIT TË TUFËS, ME MESHQERA ME KAPACITETET TË LARTË PRODHUES.
APPLICATION OF BIOTECHNOLOGY OF ARTIFICIAL INSEMINATION WITH SEXED SEMEN TO INCREASE THE LEVEL OF REPLACEMENT OF THE HERD THE HEIFER WITH HIGH PRODUCTION CAPACITY.

* FATMIRA LEKA (SULAJ), ILIR KARAGJOZI, HELGA TOPI, BURBUQE CARA
Qendra Transferimit Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë
Adresa : Rruga e Rinasit, Fushë Krujë, ALBANIA
E - mail : sulafatmira@ymail.com

PËRMBLEDHJE

Riprodhimi eficient i drejtuar i tufave të lopëve me kapacitete të larta prodhuese mbetet një nga sfidat që perballen sot fermat e nivelit të mesëm e potenciale në vendin tonë. Aplikimi i bioteknologjive avangarde të Inseminimit Artificial (IA) në gjedhë përbën sot një nga drejtimet më të rëndësishme të grupeve të kërkuesve në mbarë botën. Testimi i spermës së seksuar u realizua në Biofermen “Rramilli”- Shijak-Durrës, për periudhën 2014-2015. Në fermë mbarështohen 354 gjedh të racës Holshtein nga këto 200 krerë lopë. Lopët kanë realizuar rreth 6000 litra në 305 ditë laktacion, pas pjelljes së parë. Rendimenti mesatar i realizuar është mbi 7000 litra qumësht /laktacion. Sperma e seksuar është e furnizuar nga WIDE WORLD SIREs, USA. nëpërmjet shoqatës LEAA që operon në Shqipëri. Dozat vijnë nga dema të racës Holshtein, me drejtim qumësht. Demat shquhen për aftësi trasmetuese 96-97%. Janë vlerësuar në 329-588 bija në përbërje të 111-192 tufave me lopë.

Në tufë aplikohet IA me spermë të ngrirë, me metoden rektocervikale. Gjatë vitit 2014 janë monitoruar 71 krerë mëshqera. Nga monitorimi i grupit të mëshqerave për kriteret e moshës dhe peshës janë inseminuar 31 krerë me spermë të seksuar.

Mëshqerat janë inseminuar sipas kriterëve teknike të riprodhimit . Mosha në inseminimin e parë 19.6 ± 1.3 muaj; Peshë në inseminimin e parë 385.5 ± 27.8 kg. Nga grupi i mëshqerave të inseminuara janë kthyer në cikël (afsh) 12 krerë mëshqera ose 38 % e tyre. Fekonduar me inseminim të parë 17 mëshqera ose 55% e totalit; Indeksi i inseminimit të mëshqerave 2.1. Indeksi fekondimit mbi bazën e mëshqerave të fekonduara rezulton 1.1. Fekonduar 19 krerë mëshqera ose 61%. Nga këto u fituan 17 krerë viça femra dhe vetëm 2 viça meshkuj. Aplikimi në “Biofermen Rramilli”, siguroi prodhimin e viçave femër në masën 90%. nga 50 % me metodën konvencionale. Bioteknologjia ofron potencial për progress gjenetik më të shpejtë pasi prodhon mëshqera më shumë në numër (remontim i tufës i garantuar).

Fjalët Kyçe : Bioteknologji, inseminim artificial, mëshqera, riprodhim, sperma seksuar.

ABSTRACT

Efficient reproduction of cattle herds directed by higher production capacity remains one of the challenges that face today's farms medium and potential of level in our country. Application of biotechnology avant-garde artificial insemination (AI) in cattle constitutes today one of the most important directions of research groups worldwide. Heifer production with high production capacity is now the main principal direction as the base for a sustainable dairy production in our country. One of these biotechnology is the heifer artificial insemination with sexed semen.

Testing of sexed semen was conducted in Bio - farm "Rramilli" - Shijak Durrës, for the period 2014-2015. Farm cattle reared 354 heads Holstein breed of these 200 heads are cows. Cows on average realized around 6000 liters per 305 day lactation after the first calving. Average yield is about 7000 liters / lactation. Sexed semen is supplied by WORLD WIDE

sires, USA, through LEAA association operating in the country. Frozen doses collected from Holstein breed bulls for milk production. Bulls are known for transmitter capability 96-97%. They are estimated at 329 to 588 daughters' within 111-192 cow herds.

In herds apply IA with frozen semen, by the recto - cervical method. During 2014 were monitored 71 heads heifer. From the monitoring group heifer for age and weight criteria are inseminated 31 heads with sexed semen.

Heifer are inseminated according to technical criteria of reproduction. Age at first insemination 19.6 ± 1.3 months; Weight at first insemination 385.5 ± 27.8 kg. From the heifer group returned in the cycle (heat) 12 heads heifer or 38% of them. Conception rate at the first insemination 17 heifer or 55% of the total; Insemination index of 2.1. Index based on heifer conception results 1.1. Rate of fecundation 19 heads heifer or 61%. Of these 17 heads are the female calves and only 2 male calves. Applying the AI with sexed semen in "Bio-farm Rramilli", assured production of female calves at 90%. from 50% to the conventional method. This biotechnology offers the potential for more rapid herd genetic progress as replacement heifers can be guaranteed bred from the best cows in the herd.

HYRJE

Riprodhimi eficient i drejtuar i tufave të lopëve me kapacitete të larta prodhuese mbetet një nga sfidat që perballen sot fermat e nivelit të mesëm e potenciale. Aplikimi i bioteknologjive avangarde të Inseminimit Artificial në gjedh përbën sot një nga drejtimet më të rëndësishme të grupeve të kërkuesve në mbarë botën. Fermerë në vendet e zhvilluara aplikojnë inseminimin artificial për avantazhin që trasmeton, gjenetikë superiore. Prodhimi i mëshqerave me kapacitete të larta prodhuese përbën sot drejtimin kryesor të tufave si bazament për një prodhim të qëndrueshëm të qumështit. Një nga këto biteknologji është edhe inseminimi artificial i lopëve e mëshqerave me spermë të seksuar.

Përfitimet Potenciale nga Sperma e Seksuar - Aplikimi i saj siguron fermerët prodhimin e viçave femër në masën 90% dhe për pasojë rritjen e mbarështimit të mëshqerave duke siguruar % të lartë remontimi të tufave të tyre. Sperma e seksuar është zhvilluar dhe hedhur në treg për fermerët pas viteve 2000, nga kompanitë e mëdha Amerikane, Angleze etj. Sperma e seksuar nga COGENT UK garanton 90% viça femra (mëshqera) (M. Mulholland). Sperma e seksual e cila do të nënshtrohet testimin është prodhuar në kompaninë më të madhe Gjenetike WIDE WORLD SIREs , USA . Kompania garanton në 100 viça të lindur marjen e 90% femra dhe 10 % meshkuj.

Progresi Gjenetik - Kjo teknologji ofron potencial për progress gjenetik më të shpejtë pasi prodhon mëshqera më shumë në numër (remontim i tufës i garantuar).

Në këtë kuadër për implementimin e bioteknologjisë së inseminimit artificial me spermë të seksuar u përzgjedh "Bioferma Rramilli" pasi plotëson kriteret teknike si : raca, kapacitetet gjenetike, madhësia e tufës, aplikimi i inseminimit artificial me spermë të ngrirë (-196°C) konform bioteknologjisë, baza ushqimore, mbajtja dhe azhornimi i dokumentacionit zooteknik etj.

MATERIALI DHE METODA

Testimi i spermës së seksuar u realizua në Biofermen "Rramilli"- Shijak-Durrës. Në fermë mbarështohen 354 gjedh të racës Holshtein gjithsej nga këto 200 krerë janë lopë dhe viça mbi 3 muaj janë rreth 88 krerë. Viçat meshkuj shiten pas javës së parë të lindjes. Lopët janë me kapacitete të larta prodhuese që në mesatare kanë realizuar rreth 6000 litra në 305 ditë laktacion, pas pjelljes së parë. Rendimenti mesatar i realizuar është mbi 7000 litra qumësht /laktacion.

Në tufë aplikohet Inseminimi Artificial me spermë të ngrirë, me metoden rektocervikale. Grupi target që u nënështua për testim është grupi i viçave femra. Mëshqerat inseminohen sipas kriterëve teknike të riprodhimit .

- Moshë në inseminimin e parë 15-18 muaj;
- Peshë në inseminimin e parë mbi 400 kg;

Inseminimi u aplikua nga specialisti veteriner i fermës. Ardhja në afsh e mëshqerave u zbulua nga punonjësit e fermës. Për diagnostikimin e mbarshmërisë u përdor metoda palpim rektal 2 muaj pas inseminimit fekondues. Sperma e seksuar është e furnizuar nga WIDE WORLD SIREs, USA,. nëpërmjet shoqatës LEAA që operon në Shqipëri, lider për përmirësimin racor në gjedh. Sperma e seksuar është e paketuar në biotubza 0.25 ml, me ngjyrë të kuqe. Dozat vijnë nga dema të racës Holshtein, me drejtim qumësht. Demat shquhen për aftësi trasmetuese 96-97%. Janë vlerësuar në 329-588 bija në përbërje të 111-192 tufave me lopë.

Për të vërtetuar cilësinë fekonduese të spermës u muarën 2 kampione (doza spermë) për t'u kontrolluar në laboratorin e kontrollit të materialit biologjik. Nga analizimi në laborator sperma rezultoi brenda kriterëve teknike për fekondim.

Gjatë periudhës u monitoruan:

- Moshë e viçave femra që mbarështohen në tufë;
- Peshë e viçave femra sipas grup moshave;
- Datat e realizimit të inseminimeve; (regjistri inseminimit në mëshqera)
- Data e kontrollit të mbarshmërisë dhe rezultati.
- Biotubzat të boshatisura dhe të ruajtura konform identifikimit përkatës.
- Pjelljet e planifikuara dhe faktike.

Informacioni i grumbulluar u përpunua me metodat statistikore.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Zhvillimet e reja në të ushqyerit e demave, klasifikimi i spermës dhe mbushja e pajetave , por në veçanti metoda e përdorurur për të ngrirë spermën ka rezultuar në spermën e seksuar që mund të vlerësohet e njëjtë për nga niveli i fekondimit me spermën e ngrirë konvencionale. Teknologjia e re " Harmony Freeze 'pretendon për të përmirësuar vitalitetin e spermës pas shkrirjes , fuqinë (energjinë) duke rezultuar në spermë e fuqishme. Në fermat angleze (Steven) aplikohet bioteknologjia e inseminimit artificial me spermë të seksuar në mëshqerat dhe jo në lopë. Kjo ndodh për arsye të nivelit më të ulët të fekondimit në inseminimin e lopëve me kapacitete të larta prodhuese. Për inseminimin e mëshqerave nevojitet një dozë spermë në përgjithësi dhe për një numër më të vogël nevojiten 2 doza spermë ose objektivi teknik për nivelin e fekondimit 60-70 % dhe indeksi i inseminimit 1.6 . Rekomandimet origjinale që vijnë nga (RuralNI, UK) konsistojnë në aplikimin e inseminimit artificial me spermë të seksuar vetëm në mëshqera .


Gjate vitit 2014 janë monitoruar 71 krerë mëshqera. Nga monitorimi i grupit të mëshqerave për kriteret e moshës dhe peshës janë inseminuar 31 krerë me spermë të seksuar.

Tab.1 Performancat e Zhvillimit të Mëshqerave


<i>Performancat /</i>	<i>Pesha Ins.1</i>	<i>Mosha Ins.1</i>
<i>Treguesit stat.</i>	<i>Kg</i>	<i>Muaj</i>
Nr. Observ.	31	31
Mesatare	385.5	19.6
SD	± 27.8	± 1.3

Siç shihet nga tabela kemi një ulje të lehtë të peshës me rreth 14 kg krahasuar me objektivin dhe rritje të moshës 1.6 muaj mbi objektivin teknik të racës.

Graf.1 Mosha e Mëshqerave në Ins. 1



Graf. 2 Pesha e Mëshqerave në Ins.1



Tab. 2 Performancat Riprodhuese në mëshqerat

Mëshqera Insem.	Kthim në Afsh	% Fek. Ins. I	Indeksi /Ins.	Indeksi/ Fek.	Krerë Fek.	Viça Lindur	Seksi	
							F	M
31	12	17	2.1	1.1	19	19	17	2
	38%	55%			61%		90%	

- Nga grupi i mëshqerave të inseminuara janë kthyer në cikël (afsh) 12 krerë mëshqera ose 38 % e tyre. Për mendimin tonë në kthimin në afsh ka ndikuar kondicioni i mëshqerave.
- Fekonduar me inseminim të parë 17 mëshqera ose 55% e totalit; krahasuar me objektivin teknik rezulton 5% më e ulët. Niveli i fekondimit deri në 6 muaj nga sperma e seksuar është 10% më e ulët se sperma konvencionale. (RuralNI, UK).

Graf. 3 % Fekondimit me Ins.I



Indeksi i inseminimit të mëshqerave 2.1. Indeksi fekondimit mbi bazën e mëshqerave të fekonduara rezulton 1.1. Janë fekonduar 19 krerë mëshqera ose 61%. Nga këto u fituan 17 krerë viça femra dhe vetëm 2 viça meshkuj.

KONKLuzioni :

Aplikimi në “Biofermen Rramilli”, siguroi prodhimin e viçave femër në masën 90%. nga 50 % me metodën konvencionale. Bioteknologjia ofron potencial për progress gjenetik më të shpejtë pasi prodhon mëshqera më shumë në numër (remontim i tufës i garantuar). Aplikimi i saj siguron fermeret prodhimin e viçave femër në masën 90% dhe për pasojë rritjen e mbarështimit të mëshqerave duke siguruar % të lartë remontimi të tufave të tyre.

REFERENCAT

1. Depart. Agricultural and Rural Development, UK, Dairy Herd Fertility Challenge notes., 2012,2013
2. Breeding for Fertility , Depart. Agricultural and Rural Development, UK,
3. Pregnancy Diagnosis , Depart. Agricultural and Rural Development, UK,
4. DARD: Dairy Herd Fertility , Breeding for Fertility , 2005, UK.

KONTROLLI I INTEGRUAR I GJETHEPËRDREDHËSES SHKAKTUAR NGA TAPHRINA DEFORMANS (BERK.)TUL., I DISA KULTIVARËVE PJESHKË DHE NEKTARINA NË ZONËN E TIRANËS, SHQIPËRI.

HAJREDIN TOCA1* , THANAS RUCI

1 -Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri.

PËRMBLEDHJE:

Taphrina deformans (Berk.)Tul., që shkakton gjethepërdredhësen është një sëmundje e cila prek pjeshkën dhe nektarinat në mbarë botën, por ndikimi në zhvillimin dhe prodhimtarinë e kultivarëve të pjeshkës është i ndryshëm në zona të ndryshme. Në Shqipëri gjethepërdredhësja e pjeshkës pothuajse çdo vit shkakton epifiti që arrin të dëmtojë edhe deri në 90% të prodhimit. Ndërsa në pemët e reja dëmi shkon deri në tharjen e tyre. Gjatë vitit 2014 kontrolli i integruar i gjethepërdredhëses së pjeshkës është kryer në skemën eksperimentale me 4 (katër) kultivarë pjeshkë dhe nektarinë në fshatin Marikaj, Tiranë. Skema eksperimentale është një bllok komplet i randomizuar me tre përsëritje. Dinamika e zhvillimit të sëmundjes është bërë duke u bazuar në vërtetimet mbi faktorët kultivar dhe mënyrat e trajtimit. Trajtimet u aplikuan në tre nivele: trajtim kimik, trajtim organik dhe pa trajtim. Nga të dhënat e marra, bazuar në metodat e kontrollit të integruar të sëmundjes, rezultoi se në trajtimet me fungicide organike rezultatet ishin të kënaqëshme. Ndërsa niveli i qëndrueshmërisë bazuar në variantin kontroll për të katër kultivarët në studim ishte mesatar. Në kuadrin e IPM-s, trajtimi me fungicide me bazë bakri, rezultoi me efikasitet të lartë në lidhje me përhapjen e gjethepërdredhëses së pjeshkës.

Fjalë çelës: *Gjethepërdredhësja, intensiteti i sëmundjes, kontroll organik, nektarina, pjeshkë.*

ABSTRACT:

Taphrina deformans (Berk.) Tul., which causes Leaf curl is a disease which affects peaches and nectarines worldwide, but its impact on the development of cultivars and their productivity is different in different areas. In Albania Leaf curl epidemics almost every year causes damage amounting to 90% of production. In the new trees the damage amounts to drying of the tree. Leaf curl management was conducted during 2014 in experimental scheme with four (4) peach and nectarine cultivars in village Marikaj, Tirana. Experimental scheme is a randomized complete block with three repeat. The dynamics of development of the disease was based on observations over cultivar factors and ways of treatment. Treatments were applied at three levels: chemical treatment, organic treatment and no treatment. From the data received, based on integrated methods of disease control, the results in organic fungicide treatments were satisfactory. While the level of sustainability, based on version control for the four cultivars in the study was moderate. In the framework of IPM, treatment with copper-based fungicides, resulting in high efficiency with regard to the spread of leaf curl.

Key-words: *Disease severity, leaf curl, organic control, peach, nectarine.*

HYRJE

Pjeshka është një kulturë që gjen kushte të përshtatëshme kultivimi për shkak të mikrozonave dhe mikroklimeve që gjenden kudo në vendin tonë. Shqipëria si një vend bujqësor ka shumë të domosdoshme vazhdimin me ritme më të shpejta ngritjen e pemtoreve të pjeshkëve. Nga të dhënat e INSTAT në vitin 2014 sipërfaqja e mbjellë me drufrutorë arriti në 12254 (000

*Korespondenca: e-mail: hajredintoca@yahoo.com; Mobil: +355692095802;

rrënjë). Megjithëse janë mbjellë 354 000 rrënjë pemëfrutore vetëm gjatë vitit 2014 përsëri në vendin tonë edhe për shumë vite do të kemi rritje të sipërfaqes së mbjellë me pjeshkë e drufrutorë të tjerë. Sipas INSTAT në vitin 2014 janë importuar 13346 ton fruta më shumë se në vitin 2013. (Burimi: Instituti i Statistikave (INSTAT), Tiranë.)

Hyrja shpejt në prodhim e pjeshkës (nga viti i katërt deri në të gjashtin), lind nevojën për mbrojtje nga sëmundjet dhe dëmtuesit si një hallkë shumë e rëndësishme e procesit të prodhimit. Kontrolli i sëmundjeve në kuadrin e IPM-së merr një kuptim më të madh, kur bëjmë fjalë për trajtime të ndryshme të sëmundjeve, në kuadër të mbrojtjes së mjedisit si dhe të ruajtjes së biodiversitetit.

Sëmundjet kërpudhore tek pjeshka por veçanërisht Gjethepërdredhësja (*Taphrina deformans*), ka ndikim në zhvillimin e bimëve dhe në kompromentimin e prodhimit si dhe gradualisht mund të çoj pemët drejt zhdukjes. Në vite me pranverë të freskët dhe me lagështi dëmet nga gjethepërdredhësja mund të shkojnë në 60-90% të humbjes së prodhimit, gjithashtu në vazhdim mund të vihet në rrezik dhe vet bima. Gjethepërdredhësja në vitin 2014 me pranverë të freskët dhe me lagështi çoi në rrezik bimët. Në fushën eksperimentale ku kryejmë studimin kemi një pemtore të re e cila nuk ka hyrë në prodhim dhe nuk mund të themi gjë për kompromentim të tij për vitin 2014. Gjethepërdredhësja (*Taphrina deformans*), prek kryesisht gjethet, si dhe kërcellin e sapo formuar (barishtar) e prek më shpesh. Gjatë mugullimit dhe rritjes së lastarëve dhe të gjethëve ato marrin njolla sipërfaqësore të madhësive të ndryshme në ngjyrë të zbehtë jeshile apo të kuqe. Këto njolla zmadhohen dhe rriten me shpejtësi, dhe në vazhdim fillojnë të shtrembërojnë dhe të zmadhojnë si fletët e gjethëve dhe lastarët. Në pjesën e poshtme të fletës së deformuar konstatohet një zbardhje deri në pak gri.

Njihen tre specie të gjethepërdredhësës: *Taphrina deformans*, *Taphrina communis* dhe *Taphrina pruni*. Taphrinat janë të vendosura në grupin (Divizion) Ascomycota, nën-grupin (n/Divizion) Taphrinomycotina, klasën Taphrinomycetes, e cila përmban vetëm një rend, rendin Taphrinales, me vetëm një familje që është familja Taphrinaceae. (Bull. Soc. Mycol. Nord Fr. 87: 02-11 (2010) Lille - Jean-Pierre Gavériaux - *Taphrina deformans*).

MATERIALI DHE METODA

Vendi ku u ngrit eksperimenti: Ferma bio e fermerit Hajdar Kuçi, Marikaj, Vorë, Tiranë, Shqipëri.

Shtrirja gjeografike: Lartësia mbi nivelin e detit është 52 m në perëndim dhe 60 m në lindje të eksperimentit. -41° 22' 09" N (në Veri), -19° 37' 17" E (në Lindje).

Koha e studimit: Ngritja e eksperimentit u bë pas hulumtimit të fermës gjatë vitit 2013 për mundësinë e plotësimit të kushteve, si një bllok i veçantë, me cilësitë e një skeme eksperimentale. Skema eksperimentale u konsolidua në Janar 2014.

Skema eksperimentale: Skema eksperimentale (Fig.1) rezultoi një bllok komplet i randomizuar i cili u dizajnuar si skemë dyfaktoriale me tre përsëritje. Katër kultivarë, dy pjeshkë dhe dy nektarina. Gjithësej 288 rrënjë. Variantet me trajtim 9 rrënjë dhe ato patrajtim 6 rrënjë. Skema është e rrethuar nga brez mbrojtës. Faktori i I kryesornë studim ishin: Kultivarët, gjithësej 4 kultivar. Faktori i II kryesor ishte : Trajtimi ndaj shkaktarit të gjethepërdredhësës. Trajtimet u aplikuan në tre nivele: Niveli i I me trajtim organik, Niveli i II me trajtim kimik dhe Niveli i III pa trajtim.



Figura 1. Skema eksperimentale dizenuar mbi bllokun eksperimental të pjeshkëve me pamje reale nga Google earth.

P.M.B.-t që u përdorën në skemë për vitin 2014: Tek niveli i I (Trajtimi organik), për fletëpërdredhësen u përdor preparati Pastë Bordolezi. Në nivelin e II (Trajtimi kimik), për fletëpërdredhësen, u përdor preparati Delan, (Lënda aktive 700g/kg dithianon). Niveli i III-pa trajtim.

Vlerësimi i sëmundjes: Koha e vlerësimit të sëmundjes ishte 12 ditë pas trajtimeve. Për vlerësimin vizual të sëmundjes në çdo variant me 9 pemë janë vlerësuar tre pemët e mesit. Në variantet me 6 pemë janë vlerësuar dy pemë. Në vlerësimin vizual është përdorur çelësi fushor për gjethepërdredhësen.(Fig.2)

Vlerësimi vizual i intensitetit të sëmundjes të shkaktuar nga Gjethepërdredhësja (*Taphrina deformans*), është bazuar në SADs (standard area diagrams) që shpreh përqindjen e sipërfaqes së gjetheve të okupuara nga sëmundja. (Lebeda and Widrlechner, 2003).

Intensiteti dhe përhapja e infeksionit janë llogaritur duke përdorur indeksin e McKinney (McKinney, 1923) (modifikuar nga Cooke, 2006). Indeksi i McKinney (Imc) është llogaritur duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$DI (Imc) \% = \frac{\sum (n \times v)}{N \times X} \times 100$$

n = klasa e infeksionit; *v* = numri i pemëve për çdo klasë; *N* = totali i pemëve të vrojtuar; *X* = shkalla më e lartë e vlerësimit.






Vlerësi mi në klasa	Intesiteti i sëmundjes (Ds) në %	Çelësi fushor (SADs) për vlerësimin e (<i>Taphrina deformans</i>)	Përshkrimi i sëmundjes që jep në organet e prekura (<i>Taphrina deformans</i>)
0	0		Asnjë simptomë.
1	1-5 %		Disa buketa e gjethe me hipertrofi të pjesshme.
2	5.1-30 %		Buketa e gjethe të veçanta komplet me hipertrofi.
3	30.1-60 %		Shumë buketa e gjethe të fryra dhe lastar të përdredhur
4	60.1-100 %		Praktikisht të gjitha buketat dhe gjethet të fryra si dhe shumë lastar të përdredhur.

Figura 2. Çelësi fushor për vlerësimin e gjethepërdredhjes së pjeshkës (*Taphrina deformans*) në pemtoren bio të pjeshkëve në Marikaj, Vorë, Tiranë. (Burimi: Th. Ruci, 2006, Tezë masteri pranë UBT. Dizenuar nga kompjuteri, nga programi P.C. Severity Pro software. Lamari, L.2002.)

ANALIZA STATISTIKORE E TË DHËNAVE:

Përpunimi i të dhënave për periudhën e studimit (Kultivar x metodë trajtimesh për vitin 2014) për të gjitha mjediset e provës: për mesataret, variancën dhe deviacionin standard u bënë duke përdorur analizën e variancës (ANOVA) me programin statistikor ASSISTAT (2014) Version 7.7 - Website <http://www.assistat.com> By Francisco de A. S. e Silva DEAG-CTRNUFC.

3- REZULTATET DHE DISKUTIME

Të dhënat fillestare mbi rezultatet e arritura mbi indeksin e sëmundjes ndaj Gjethepërdredhjes së pjeshkës (*Taphrina deformans*) mbi tre trajtimet dhe katër kultivarët në studim jepen në tabelën 1. Aty paraqiten të dy faktorët e analizuar nga të dhënat pas vërtetimit, kultivarët dhe trajtimet. Trajtimet janë pasqyruar gjithashtu në tre nivele, trajtimi organik, trajtimi kimik dhe pa trajtim.


Mesataret për përsëritjet dhe për kultivarët janë pjesë e kësaj table dhe na kanë ndihmuar për klasifikime të mëtejshme rreth rezultateve. Po në këtë tabelë kemi pasqyruar krahasimin me kontrollin dhe i kemi klasifikuar duke përdorur metodën e kontrollit Dunets (*Dunnett's Method Control*).

Të gjitha këto të dhëna rreth indeksit të sëmundjes i kemi paraqitur më tej në grafikun 1.

Tabela 1. Indeksi i sëmundjes Imc-ja në % për Gjethepërdredhësen e pjeshkës (*Taphrina deformans*) viti 2014.

Nr	Kultivarët Faktori (A)	Trajtimet Faktori (B)	Indeksi i sëmundjes Imc-ja ne % sipas përsëritjeve			Shuma	Mesatarja	Klasat sipas testit Dunets
			P1	P2	P3			
1	RED STAR	T.Organik	23	27	24	74	24.66	B
		T.Kimik	13	15	14	42	14	C
		Kontroll	34	38	43	115	38.33	A
		Shuma	70	80	81	231	-	
		Mes	23.33	26.66	27	-	25.66	
		Dmv	Dmv = 2.86282 për @ 0.005 %					
2	VENUS	T.Organik	32	28	31	91	30.33	B
		T.Kimik	14	17	13	44	14.66	C
		Kontroll	45	53	47	145	48.33	A
		Shuma	91	98	91	280		
		Mes	30.33	32.66	30.33		31.11	
		Dmv	Dmv = 2.86282 për @ 0.005 %					
3	ROAJAL I ZI	T.Organik	21	18	23	62	20.66	B
		T.Kimik	11	9	13	33	11	C
		Kontroll	35	42	46	123	41	A
		Shuma	67	69	82	218		
		Mes	22.33	23	27.33		24.22	
		Dmv	Dmv = 2.86282 për @ 0.005 %					
4	GOMEA	T.Organik	24	22	19	65	21.66	B
		T.Kimik	4	8	6	18	6	C
		Kontroll	43	45	39	127	42.33	A
		Shuma	71	75	64	210		
		Mes	23.66	25	21.33		23.33	
		Dmv	Dmv = 2.86282 për @ 0.005 %					

Shënim: A=niveli më i ulët i vërtetësisë për DMV =2.96880 për @=0.05 % dhe C=niveli më i lartë i vërtetësisë për DMV =2.96880 për @=0.05 sipas testit Dunnett s.



Grafiku 1. Mbi Indeks të Sëmundjes (Imc-ja në %) për Gjethepërdredhësen e pjeshkës (*Taphrina deformans*) për të katër kultivarët dhe tre trajtimet viti 2014.

Nga të dhënat e tabelës 1 dhe grafikut 1 shohim se në metodën ku kemi përdorur PMB për të mbrojtur Gjethepërdredhësen e pjeshkës (*Taphrina deformans*) indeksi i kësaj sëmundjeje, Imc-ja në %, varion nga 6% në kultivarin Gomea dhe deri në 14% në kultivarin Red Star dhe krahasuar me kontrollin që varion nga 38.33% në kultivarin Red Star dhe deri në 48.33% në kultivarin Venus.

Rezultate vërtet të kënaqëshme janë dhe në trajtimet me metodën organike ku niveli i infeksionit pra Imc-ja në % është përkatësisht 20.66% në kultivarin Roajal i Zi dhe deri në 30.33% në kultivarin Venus.

Analiza e variancës (ANOVA) është pasqyruar tek tabela 2 mbi vlerësimin e Indeksit të sëmundjes (Imc në %) në provën me fungicide për të dy metodat e trajtimit për të katër kultivarët në studim për vitin 2014 tregon se për të katër kultivarët Red Star, Venus, Roajal i Zi dhe Gomea kemi ndryshime të vërtetuara statistikiisht për të dy nivelet e vërtetësisë $P=0.05\%$ dhe $P=0.01\%$ (6.944 dhe 18). Kjo provohet nga vlerat e “F”-ve faktike për metodat e trajtimit në studim (trajtimi kimik dhe ai organik) ku vlera e “F”-ve faktike rezulton të jetë më e madhe se vlera e “F”-ve teorike tabelare sipas Fisherit për të dy nivelet e vërtetësisë $P=0.05\%$ dhe $P=0.01\%$.

Tabela 2. Analiza e variancës (ANOVA) mbi Indeks të Sëmundjes (Imc-ja në %) për Gjethepërdredhësen e pjeshkës (*Taphrina deformans*) viti 2014.

Kultivarët	Burimet e Variacionit	Shkallët e lirisë	Shuma kuadratik e	Mesatarja kuadratik e	Vlerat e < F >		
					F.Faktike	< F teorike >	
						95%	99%
RED STAR	Trajtimet	2	892.666	446.333	66.95*	6.944	18
	Përsëritjet	2	24.666	12.333	1.85	6.944	18
	Gabimi	4	26.666	6.666			
	Totali i variacionit	8	944				
VENUS	Trajtimet	2	1702.889	851.444	82.84*	6.944	18
	Përsëritjet	2	10.888	5.444	0.5297	6.944	18
	Gabimi	4	41.111	10.277			

	Totali i variacionit	8	1754.889				
ROAJAL I ZI	Trajtimet	2	1406.889	703.444	73.19*	6.944	18
	Përsëritjet	2	44.222	22.111	2.300	6.944	18
	Gabimi	4	38.444	9.611			
	Totali i variacionit	8	1489.556				
GOMEA	Trajtimet	2	1992.667	996.333	213.5*	6.944	18
	Përsëritjet	2	20.666	10.333	2.2142	6.944	18
	Gabimi	4	18.666	4.666			
	Totali i variacionit	8	2032				

Shënim **: E vërtetuar për nivelin e propabilitetit 1% ($p < 0.01$) ; *: E vërtetuar për nivelin e propabilitetit 5% ($0.01 \leq p < 0.05$) ; ns: Pa vërtetësi të propabilitetit ($p \geq 0.05$)

“F”-ja faktike për trajtimet në kultivarin Red Star = 66.95** është më e madhe se të dyja “F”-të teorike për të dy nivelet e vërtetësisë $P=0.05\%$ dhe $P=0.01\%$ (6.944 dhe 18). Për trajtimet në kultivarin Venus = 82.84** është më e madhe se të dyja “F”-të teorike për të dy nivelet e vërtetësisë $P=0.05\%$ dhe $P=0.01\%$ (6.944 dhe 18). Për trajtimet në kultivarin Roajal i Zi = 73.19** është më e madhe se të dyja “F”-të teorike për të dy nivelet e vërtetësisë $P=0.05\%$ dhe $P=0.01\%$ (6.944 dhe 18). Si dhe për trajtimet në kultivarin Gomea = 213.5** është më e madhe se të dyja “F”-të teorike për të dy nivelet e vërtetësisë $P=0.05\%$ dhe $P=0.01\%$ (6.944 dhe 18).

Nga krahasimi i “F”-ve faktike të përsëritjeve për të katër kultivarët në studim (Red Star, Venus, Roajal i Zi dhe Gomea) me ato tabelore rezulton se përsëritjet nuk japin ndryshime të vërtetuara statistikisht për të dy nivelet e vërtetësisë $P=0.05\%$ dhe $P=0.01\%$ sepse “F”-të faktike rezultojnë të jenë më të vogla se “F”-të teorike gjë që tregon se eksperimenti ynë është ngritur në kushte korrekte i cili na lejon për të vazhduar më tej analizën e të dhënave.

Ilustrimin e këtyre ndryshimeve për çdo kultivar që kemi në studim (Red Star, Venus, Roajal i Zi dhe Gomea) e jep dhe figura nr.3 ku paraqitet diagrama e boksploteve (variancat, deviacioni standart dhe mesatarja e Imc-ve në % për Gjethepërdredhësen e pjeshkës (*Taphrina deformans*) për të tre metodat e trajtimit (Kimik, Organik dhe kontroll). Metodot që kanë ndryshueshmëri dhe të vërtetuar statistikisht për nivelin e propabilitetit $P= 0.05\%$ janë me rrahë blu dhe pikërisht: për të katër kultivarët kanë ndryshueshmëri dhe të vërtetuar statistikisht për nivelin e propabilitetit $P=0.05$ sipas testit **Dunnnett's** të cilat janë me rrahë blu pikërisht metodat e trajtimit ajo kimike dhe ajo biologjike.




Figura 3. Diagrama e bokspoteve (variancat, deviacioni standart dhe mesatarja e Imc-ve në %) për të katër kultivarët për kontrollin e Gjethepërdredhëses së pjeshkës (*Taphrina deformans*) për të tre metodat e trajtimit Viti 2014

Rezultatet pas analizës të të dhënave për të tre metodat e trajtimit dhe katër kultivarët në studim tregojnë për një ardhmëri të kënaqëshme nga trajtimi organik si një qëllim i përhershëm në kultivimin e pjeshkëve.

REFERENCAT

1. **Agrios G.N. (2005).** Plant Pathology. Fifth Edition. Elsevier Academic . New York.
2. **Hasani, M. (2005).** Sëmundjet e Pemëve frutore. Tiranë.
3. **Kaltani, T e B.Celo, (1992).** “Fitopatologjia bujqësore”- Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë.
4. **Annual report year 2013.** Raport vjetor i Ministrisë së Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, MBUMK. Tiranë.
5. **Instituti i Statistikave (INSTAT),** Tiranë. Raporti Statistikor 2014.
6. **Cooke, B. M. (2006).** Disease assessment and yield loss. In: *The Epidemiology of Plant Diseases*. B. M. Cooke, D. Gareth Jones and B. Kaye (Eds.) Second edition. The Netherlands: Springer.f.61.
7. **Mckinney H.H. (1923).** Influence of soil temperature and moisture on infection of wheat seedlings by *Helminthosporium sativum*. Journal Agricultural Research, 26:195-217.
8. **Jean-Pierre GAVÉRIAUX** - Bull. Soc. Mycol. Nord Fr. 87: 02-11 (2010) Lille, (*Taphrina deformans*).
9. **SAS Institute Inc. (2009).** JMP® 8 Design of Experiments Guide, Second Edition. Cary, NC: SAS Institute Inc.
10. **Programi statistikor ASSISTAT (2014) Version 7.7** - Website <http://www.assistat.com> By Francisco de A. S. e Silva DEAG-CTRN-UFC.

**TË DHËNA PARAPRAKE PËR SINDROMIN E QËNDRIMIT SHTRIRË NË LOPË,
NË ZONËN E SUHAREKËS NË KOSOVË
PRELIMINARY DATA FOR DOWNER COW SYNDROME IN FARMS OF
SUHAREKA COMMUNE KOSOVO**

JANUZ DURAJ*, VANGJEL CERONI**

* Mjek Veteriner në Prizren, Kosovë,

** Departamenti i Lëndëve Klinike, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Tiranë

Kontakt: dr.durajjanuz@hotmail.com

PËRMBLEDHJE

Sindromi i lopës së shtrirë (*Downer cow*) ka filluar të jetë gjithnjë e më shumë i pranishëm në lopët e fermave për prodhim qumështi. Në literaturë raportohet 3.8 – 28 % incidenca e këtij sindromi në lopët për prodhim qumështi. Studimi përqendrohet në monitorimin paraprak për sindromin e qëndrimit shtrirë në lopët e fermave të Komunës së Suharekës në Kosovë, për vitet 2013- 2014. Për periudhën në studim sindromi i qëndrimit shtrirë në lopë u konstatua në 35 krerë (0.87%). Në vitin 2013 u prekën 14 lopë (0.35%) dhe në vitin 2014 në 21 krerë (0.52%). Më të prekura ishin lopët e racës Frizis me 14 krerë (40 %), Simental me 11 krerë (31.42 %) dhe të racës Holshtein me 8 krerë (22.85 %). Mosha mesatare e lopëve me sindromin e qëndrimit “shtrirë” ishte 7.25 ± 0.3 vjet. Ky sindrom u vërejt më shpesh në muajt e dimrit me 14 krerë (40%) dhe të verës me 10 krerë (28.5%). Nga kontrollet klinike diagnozat më të zakonshme ishin gjendja hipokalcemisë (25 lopë ose 83.8%), luksacioni i artikulacionit koksofemoral (3 raste ose 8.57%), dëmtimet e nervave periferikë (6 raste ose 17.1%) dhe në 1 rast (2.85%) u konstatua mastit i formës së rëndë. Nga rastet gjithsej, në 6 krerë (17.14 %) sindromi i qëndrimit shtrirë u vërejt parapjelljes dhe në 29 raste (82.55%) paspjelljes. Në 13 raste (34.21%) lopët përfunduan me ngordhje pas 8.6 ± 04 ditësh.

Fjalët kyçe: *Sindromi i lopës së “shtrirë”, incidenca, mosha, raca, stina.*

ABSTRACT

Downer cow syndrome has begun to be present more and more in dairy cows farms. In literature, it is reported 3.8 – 28 % incidence of this syndrome in dairy cows. This study is focused on a preliminary monitoring for downer cow syndrome in cows of Suhareka municipality farms, during the years 2013 – 2014.

During this study period, the downer cow syndrome was found in 35 cows (0.87 %). During the year 2013 were affected 14 cows (0.35 %), whereas in the year 2014 in 21 cows (40 %). Simmental with 11 cows (31.42 %), and the Holshtein race with 8 cows (22.85 %). Average age of cows with downer cow syndrome was 7.05 ± 0.3 years. This syndrome was more often noticed during winter months with 14 cows (40 %), whereas during summer months with 10 cows (28.5 %). From the clinical controls, the most usual diagnosis were hypocalcaemia condition (25 cows or 83.8 %), luxation of coxofemoral articulation (3 cases or 8.57 %), peripheral nerves injuries (6 cases or 17.1 %), and in a case (2.85 %) was found a heavy form of mastitis. From all cases, in 6 cows (17.14 %) the downer cow syndrome was noticed during the pre-calving period, whereas in 29 cases (82.55 %) after calving period. In 13 cases (34.21 %), cows ended with death after 8.6 ± 04 days.

Key words: *Downer cow syndrome, incidence, age, race, season.*

1. HYRJE

Lopët të cilat nuk ngriten në këmbë trajtohen si lope me sindromin e qëndrimit “shtrirë”. Shprehja me qëndrim “shtrirë” përshkruan simptomat e kafshës, që është e pa aftë të ngritet dhe zakonisht thuhet për lopët që mbeten të tilla pas pjelljes. Sot pranohet që një lopë duhet të konsiderohet si e prekur nga sindromi i qëndrimit “shtrirë” kur qëndron në gjendje të shtrirë, në pozicion sternal për më shumë se 24 orë dhe pa dëshmi të ndonjë sëmundje sistematike. Gjendja e vazhdueshme e qëndrimit “shtrirë” dhe pamundësia për tu ngritur në këmbë është kriteri bazë për shumicën e veterinarëve kur marrin parasysh një lopë me këtë sindrom. Lopët me qëndrim “shtrirë” zakonisht janë raste të rënda klinike pasi shumica e tyre dështojnë të ngriten pas disa ditësh të kujdesit mjekësor dhe për to shpesh duhet të aplikohet therja e sforcuar. Raportohet (Bicalho, R. C. et al. 2007b) se 3.8 – 28 % të rasteve me gjendje të hipokalcemisë në periudhën rreth pjelljes kalojnë me sindromin e qëndrimit “shtrirë” dhe nga to 20 deri 67 % përfundojnë me ngordhje ose therje të sforcuar. Sindromi I lopes së “shtrirë” është emergjencë mjekësore veterinarë që në shumicë ka përfundim fatal. Rastet me lopë në qëndrim të “shtrirë” përbëjnë sfidë terapeutike për të gjithë mjekët veterinarë që përballen me të tillë pacientë.

2. MATERIALI DHE METODAT

Studimi u përqendrua në lopët për prodhim qumështi të zonës së Suharekës në Kosovë, që mbarështohen në ferma me mbi 30 krerë. Për vitet 2013 dhe 2014 u studiuuan të gjitha rastet e diagnostikuara klinikisht me sindromin e qëndrimit “shtrirë”. Rastet klinike u grupuan dhe u klasifikuan sipas racës, moshës dhe muajve të vitit. Studimi u përhap dhe në klasifikimin e rasteve para apo pas pjelljes, diagnozat më të zakonshme klinike dhe në përfundimet shëndetësore të kafshëve. Në studim u llogaritën dhe ditët mesatare të qëndrimit shtrirë. Te dhënat e fituara u përpunuan statistikisht dhe jepen me poshtë me tabela dhe grafikë. Qëllimi i studimit ishte të evidentohet denduria e rasteve klinike dhe mbi këtë bazë të vazhdohet me drejtime më të thelluara për të gjetur rrugë e mundësi për zvogëlimin e dëmeve në ferma nga sindromi I qëndrimit “shtrirë” në lopë.

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Në literaturë raportohet (Amory J.R. et al. 2006), 3.8 – 28 % incidenca e sindromit të qëndrimit “shtrirë” në lopët për prodhim qumështi. Të dhënat e studimit treguan se për periudhën e viteve 2013 dhe 2014 me sindromin e qëndrimit “shtrirë” në lopët e fermave të zones së Suharekës në Kosove u prekën 35 krerë, ose 0.87 % e kafshëve që mbarështohen. Në vitin 2013 sindromi u diagnostikua në 14 lopë, ose në 0.35% (tab. dhe graf. 1) dhe në vitin 2014 në 21 krerë, ose në 0.52% (tab. dhe graf. 2). Në tabela jepen rastet e hasura sipas muajve të vitit, racave dhe mosha e kafshëve të prekura.

Tabela nr1. Rastet e lopëve me sindromin e qëndrimit shtrirë për vitin 2013.

Muaji	Nr. rasteve	Raca	Mosha
Janar	2	- 1 Frizis	- 8 vjet
		- 1 Simental	- 6 vjet
Mars	1	- 1. Frizis	- 8 vjet
Prill	1	- 1. Frizis	- 11 vjet
Qershor	2	- 1. Frizis	- 7 vjet
		- 1. Frizis	- 11 vjet
Gusht	2	- 1. Holshtein	- 8 vjet
		- 1. Holshtein	- 9 vjet
Shtator	4	- 1. B. zvis	- 7 vjet
		- 1. Simental	- 9 vjet

		- 1. Frizis	- 12 vjet
		- 1. Holshein	- 7 vjet
Dhjetor	2	- 1. Holshtein	- 9 vjet
		- 1. Frizis	- 8 vjet

Të dhënat janë vendosur dhe në grafikë. Në grafikun nr. 1 jepet numri i rasteve për vitin 2013 të lopëve me sindromin e qëndrimit “shtrirë”, sipas racave dhe muajve të vitit. Të dhëna të njejtë, por për vitin 2014 jepen në tabelën dhe grafikun nr. 2.

Rezultatet nga studimi tregojnë incidence shumë më të ulët se shifrat e studiuesve të tjerë të cituar (Bicalho, R. C. et al.2007b; Radostits M. et al.(2000). Sipas mendimit tone ka mundësi që dukuria më e ulët klinike të lidhet me rendimentin mesatar të prodhimit të qumështit dhe me shpërndarjen e individëve sipas racave në popullacionin total të lopëve për prodhim qumështi në zonën e studimit.

Grafiku nr 1. Rastet e lopëve me sindromin e qëndrimit “shtrirë” për vitin 2013 (sipas racave, moshës dhe muajve të vitit).





Tabela nr2. Rastet e lopëve me sindromin e qëndrimit “shtrirë” për vitin 2014, (sipas racave, moshës dhe muajve të vitit).

Muaji	Nr rasteve	Raca	Mosha
Janar	4	- Simental	- 7 vjet
		- Simental	- 8 vjet
		- Frizis	- 9 vjet
		- Frizis	- 11 vjet
Shkurt	4	- Frizis	- 6 vjet
		- Simental	- 6 vjet
		- Holshtein	- 9 vjet
		- Simental	- 6 vjet
Prill	3	- Simental	- 8 vjet
		- Simental	- 5 vjet
		- Frizis	- 11 vjet
Qershor	2	- Frizis	- 8 vjet
		- Holshtein	- 9 vjet
Korrik	2	- Holshtein	- 6 vjet
		- Simental	- 7 vjet
Gusht	2	- Frizis	- 6 vjet
		- Frizis	- 12 vjet
Shtator	1	- Simental	- 8 vjet
Tetor	1	- Holshtein	- 11 vjet
Dhjetor	2	- Brun zvis	- 8 vjet
		- Simental	- 5 vjet


Grafiku nr 2. Rastet e lopëve me sindromin e qëndrimit shtrirë për vitin 2014 (sipas racave dhe muajve të vitit).



Nga rastet e studiuara dhe të paraqitura në tabelat e grafikët më sipër duket se më të prekura nga sindromi i qëndrimit “shtrirë” ishin lopët e racës Frizis me 14 krerë (40%), Simental me 11 krerë (31.42%) dhe të racës Holshtein me 8 krerë (22.85%). Mosha mesatare e lopëve me sindromin e qëndrimit “shtrirë” ishte 7.25 ± 0.3 vjet.

Sindromi i qëndrimit “shtrirë” u vërejt në 5 krerë në stinën e Pranverës, në 10 krerë në stinën e Verës, në 6 krerë në stinën e vjeshtës dhe në 14 krerë në stinën e Dimrit. Më shpesh ky sindrom në lopë u konstatua në muajt e dimrit me 14 krerë (40%) dhe të verës me 10 krerë (28.5%). Pas grupimit dhe përpunimit të të dhënave, incidenca e sindromit me qëndrim “shtrirë” të lopëve në fermat e zonës në studim ishte si në grafikët më poshtë me nr 3 dhe 4.

Grafiku nr 3. Rastet e lopëve me sindromin e qëndrimit shtrirë për vitin 2013 (sipas racave dhe stineve të vitit).



Të dhënat tona përkojnë me ato të studiuesve të tjerë, (Bicalho, R. C. et al.2007b; Goff J. P. et al. 1995, 1997), të cilët theksojnë se incidenca më e lartë e sindromit të qëndrimit “shtrirë” në lopë (39%) vërehet gjatë tre muajve të ftohtë të vitit, dhjetor, janar dhe shkurt.

Nga kontrollet klinike diagnozat më të zakonshme të vendosura ishin gjendja e hipokalcemisë (25 lopë ose 83.8%), luksacioni i artikulationit koksofemoral (3 raste ose 8.57%), dëmtimet e nervave periferikë (6 raste ose 17.1%) dhe në 1 rast (2.85%) ishte konstatuar mastit i formës së rëndë, tabela 3.

Grafiku nr 4. Rastet e lopëve me sindromin e qëndrimit shtrirë për vitin 2014 (sipas racave dhe stinëve të vitit).




Tabela nr 3. Diagnozatat më të zakonshme të vendosura për shkakun e sindromit të qëndrimit “shtrirë”, për vitet 2013 dhe 2014.

Vitet	Diagnozat më të zakonshme klinike për sindromin e qëndrimit “shtrirë” në lopë									
	Hipokalcemi		Dëmtime nervash		Fraktura		Luksacion koxofemoral		Të tjera	
	Krere	%	Krere	%	Krere	%	Krere	%	Krere	%
2013	10	71.4	1	7.19	1	7.19	1	7.19	1	7.19
2014	8	38.1	9	42.8	1	4.76	2	9.52	1	4.76
SHUMA	18	51.4	10	28.5	2	5.71	3	8.57	2	5.71

Nga literatura e shfrytëzuar nuk kemi gjetur të dhëna për ballafaqim me këtë tregues. Më së shumti sindromi I qëndrimit “shtrirë” në lopë u konstatuar pas pjelljes (29 rasteose 82.85 %). Para pjelljes sindromi u takuanë 6 raste ose në 17.14 %, tabela 4.

Tabela nr 4. Rastet me sindromin e qëndrimit shtrirë në raport me periudhën e pjelljes dhe prognozën e tyre, për vitet 2013 dhe 2014.

Vitet	Rastet e paraqitura									
	Para pjelljes		Pas pjelljes		Dite qendrimi	Sheruar		Demtuar		
	Krere	%	Krere	%	mesatare	Krere	%	Krere	%	
2013	2	14.28	12	85.71	7.4 ± 0.3	10	71.4	4	28.5	
2014	4	19.04	17	80.95	8.8 ± 0.3	12	57.1	9	42.8	
SHUMA	6	17.14	29	82.85	8.6 ± 0.4	22	62.8	13	37.1	

Sipas të dhënave të literatures (Sielman E.S. et al. 1997; Sattler N, et al. 1998), afro 6 % e rasteve ndodhin para pjelljes. Përafërsisht 58 % e rasteve ndodhin brenda 24 orëve të para pas pjelljes dhe afro 37 % brenda 100 ditëve të para paspjelljes.

Nga të dhënat tona duket se në 62.8 % të rasteve rezultatet kanë qenë positive dhe lopët janë shëruar klinikisht. Në 37.1 % të rasteve rezultatet kanë qenë negative dhe lopët janë sakrifikuar ose kanë ngordhur. Qëndrimi I shtrirë ishte mesatarisht 8.6 ditë për lopët e sëmura. Të dhënat e literatures pranojnë se ngallopët me sindromin e qëndrimit “shtrirë” afro 30 % ngordhin dhe deri 32 % kalojnë në therje te sforcuar.

4. PËRFUNDIME

- Në lopët e fermave të zonës së Suharekës në Kosovë, sindromi i qëndrimit të “shtrirë” është i pranishëm në 0.87 % të kafshëve që mbarështohen.
- Më të prekura nga sindromi i qëndrimit “shtrirë” janë lopët e racës Frizis (40 %), Simental (31.42 %) dhe të racës Holshtein (22.85 %).
- Moshë mesatare e lopëve me sindromin e qëndrimit “shtrirë” është 7.25 ± 0.3 vjet.
- Më shpesh sindromi i qëndrimit “shtrirë” në lopë konstatohet në muajt e dimrit (40%) dhe të verës (28.5%).
- Diagnozë më të zakonshme për sindromin e qëndrimit “shtrirë” në lope janë gjendja e hipokalcemisë (83.8%), luksacioni i artikulationit koksofemoral (8.57%) dhe dëmtimet e nervave periferikë (17.1%).
- Sindromi I qëndrimit “shtrirë” në lope konstatohet më shpesh pas pjelljes (82.85%).
- Me trajtime të kujdeshme mundet që në afro 62.8 % të rasteve rezultatet të jenë positive për shërimin klinik të lopëve me sindromin e qëndrimit të “shtrirë”.

5. LITERATURA

Revista shkencore:

1. Amory JR, Kloosterman P, Barker ZE, Wright JL, Blowey RW, Green LE. Risk factors for reduced locomotion in dairy cattle on nineteen farms in The Netherlands. *J. Dairy Sci.* 2006, 89:1509–1515.
2. Bicalho, R. C., F. Vokey, H. N. Erb and C. L. Guard. Visual locomotion scoring in the first seventy days in milk: Impact on pregnancy and survival. *J. Dairy Sci.* 2007b, 90:4586-4591.
3. Goff J. P., R. L. Horst. Physiological changes at parturition and the relationship to metabolic disorders. *J. Dairy sci.* 1997, 80, 1260-1268.
4. Goff, J. P., T. A. Reihardt, D. C. Beitz, R. L. Horst. Breed affects tissue vitamin D receptor concentration in periparturient dairy cows: A milk fever risk factor? *J. Dairy sci.* 1995, 78(Suppl. 1) 184-187.
5. Sielman ES, Sweeney RW, Whitlock RH, et al: Hypokalemia syndrome in dairy cows: 10 cases (1992–1996). 1997, *JAVMA* 210:240–243.
6. Sattler N, Fecteau G, Girard C, et al: Description of 14 cases of bovine hypokalemia syndrome. 1998, *Vet Rec.* 143:503–507.

Tekste:

5. Radostits, O. M., C. C. Gay, D. C. Blood, K. W. Hinchcliff. *Veterinary Medicine*, 2000, London, New York, Philadelphia, San Francisco, St. Louis, Sydney, pp. 1805-1806

PËRDORIMI I ENZIMAVE NË TË USHQYERIT E MONOGASTRIKËVE NJË MUNDËSI MË SHUMË PËR REDUKTIMIN E NDOTJES AMBIENTALE.

R. PENGU¹, E. DELIA²

¹ Fan.S. Noli University, Albania, ² Agricultural University of Tirana, Albania
rezanap@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Pjesa më e madhe e fosforit që përmbahet në ushqimet bimore është në formën e fosforit fitik. Përmbajtja e tij përfaqëson rreth 60-70 % të fosforit tek drithërat dhe 50-60 % në bimët vajore dhe nënproduktet e industrisë që përdoren si ushqim për kafshët. Kafshët monogastrike, shpendë e derra kanë aftësi të kufizuara për tretjen e fosforit fitik. Pjesa më e madhe e tij eliminohet me feçe pa u prekur nga lëngjet dhe enzimat e aparatit tretës. Për këtë arsye në racionet e kafshëve monogastrike për sigurimin e niveleve të domosdoshme të fosforit, përdoren fosfate minerale të tipit mono e bikalçik me tretshmëri më të lartë. Krahas saj, grupet fosforike të fitateve që përmbahen në ushqimet bimore, duke qenë relativisht të ngopur me ngarkesa negative, formojnë komplekse të patretshëm dhe me elementët minerale: Ca, Mg, Zn, Cu si dhe me fraksionet proteinike, duke penguar përdorimin e pjesshëm të tyre. Eliminimi i komplekseve të tilla fosforike të patretshme dhe i fosfateve minerale krijon probleme edhe për ndotjen e mjedisit. Për këtë arsye, në disa vende janë përcaktuar me legjistacion kufizime të detyrueshme për përdorimin e tyre në racionet e kafshëve.

Fjalë –kyçe: *Blegtori intensive, mjedisi, ndotja e ujit dhe tokës, mbetjet shtazore, enzimat.*

ABSTRACT

One of the important reasons of soil and water pollution in Albania is the agricultural techniques and animal manures. Soil and water are compounding parts of it are before the risks of pollution presenting problems for the change of environmental equilibrium. Nevertheless the agricultural is always in front of difficulties from the influence of agronomic techniques and the animal rests.

Excessive animal manure and fertilizer inputs do cause various environmental problems, related to the accumulation and elevated leaching, runoff of nutrients (N and P) and heavy metal to ground water and surface water. This is particularly true in areas where animal production has been geographically concentrated.

Interest in phytase for non ruminant animals take place in regions, where soil and groundwater pollution due to animal wastes is a serious problem and phosphorus is a major concern.

Key-words: livestock development, environment, water and soil pollution, animal manure, enzymes.

HYRJE

Pjesa më e madhe e fosforit që përmbahet në ushqimet bimore është në formën e fosforit fitik. Përmbajtja e tij përfaqëson rreth 60-70 % të fosforit tek drithërat dhe 50-60 % në bimët vajore dhe nënproduktet e industrisë që përdoren si ushqim për kafshët, Jongbloed (1993). Kafshët monogastrike, shpendë e derra kanë aftësi të kufizuara për tretjen e fosforit fitik Pointillart (1993). Pjesa më e madhe e tij eliminohet me feçe pa u prekur nga lëngjet dhe enzimat e aparatit tretës. Për këtë arsye në racionet e kafshëve monogastrike për sigurimin e niveleve të domosdoshme të fosforit, përdoren fosfate minerale të tipit mono e bikalçik me tretshmëri më të lartë. Krahas saj, grupet fosforike të fitateve që përmbahen në ushqimet bimore, duke qenë relativisht të ngopur me ngarkesa negative, formojnë komplekse të patretshme dhe me elementët minerale: Ca, Mg, Zn, Cu si dhe me fraksionet proteinike, duke penguar përdorimin e pjesshëm të tyre Thompson (1980).

Eliminimi i komplekseve të tilla fosforike të patretshme dhe i fosfateve minerale krijon probleme edhe për ndotjen e mjedisit. Për këtë arsye, në disa vende janë përcaktuar me legjistacion kufizime të detyrueshme për përdorimin e tyre në racionet e kafshëve Eeckhout and Paepe (1994).

Cilësitë antiushqyese të fitateve janë studiuar in vivo dhe in vitro si në shpendë edhe në derra Jongbloed et al (1993), Ravindron (1995) dhe ka rezultuar ndikimi negativ i tyre jo vetëm për përvetësimin e fosforit, por pjesërisht dhe të elementëve të tjerë mineralë e proteinikë Ingelman et al (1993), Guillet et al (1995). Studimet e ndërmarra në 10-vjeçarët e fundit në fushën e bioteknologjisë, kanë vënë në pah efektin pozitiv të përdorimit të fitazës mikrobike për shfrytëzimin më të mirë të fosforit fitik dhe lënien në mjedis të më pak mbetjeve fosforike të patretshme. Fitaza mikrobike defosforizon P nga fitatet duke e bërë atë të disponueshëm për organizmin dhe të padëmshëm për ambientin Rodehutsord et al (1995). Sipas Ravindron (1995) dhe Jongbloed et al (1993) fitazat endogjene dhe ato të formuara nga mikroorganizmat intestinale nuk janë në gjendje të çlirojnë sasi të mjaftueshme të fosforit fitik, prandaj këtë mund ta realizojë një sasi shtesë enzimash mikrobike në racione.

Rëndësia nutricionale e acidit fitik dhe fitazës

Sasia e fosforit të lidhur me fitatin, në të ushqyerit e kafshëve monogastrike përbën një burim të ulët të shfrytëzimit të fosforit, sidomos në rastin e dietave ushqimore me aktivitet të ulët fitazik. Në këtë situatë shfrytëzimi i lëndëve minerale dhe i elementëve të tjerë gjurmë reduktohet në mënyrë të ndjeshme nga prania e kompleksit fitat.

Rritja e përqëndrimit të kalçiumit rrit aktivitetin antinutricional të acidit fitik, të disa lëndëve minerale dhe pengon veprimin e enzimës, fitazë. Studimet tregojnë se ky efekt mund të jetë i lidhur gjithashtu me rritjen e sasisë së vitaminës D.

Ekzistojnë gjithashtu të dhëna të tjera për funksionet mbrojtëse të acidit fitik të tilla si:

1. nxit formimin e radikaleve të lira
2. ngadalësimin e thithjes post -prandiale të glukozës
3. uljen e sasisë së kolesterolit në plazmë dhe të triglicerideve
4. ndryshime në transportin e metaleve të rënda.

Mekanizmat bazë që shpjegojnë këto veprime pozitive të acidit fitik ende sot janë të pasqaruara plotësisht. Studimet e sotme tregojnë për rëndësinë nutricionale dhe ekologjike të përdorimit të fitazës mikrobiale në të ushqyerit e kafshëve monogastrike si derra dhe shpendë. Në stomakun dhe në zorrët e këtyre të fundit sasia e fitazës endogjene është tepër e ulët ose shpesh mungon fare. Është kjo arsyeja që aktiviteti fitazik bimor ka një rëndësi të vecantë në përcaktimin e dozës së fitazës mikrobiale të përdorur në dietat ushqimore të kafshëve monogastrike.

Fitaza bimore e farërave të bimëve të familjes graminore si elb, tritikale, grurë, tërshërë, misër nuk është në të njëjtin nivel.

Problemet që lidhen me ndotjen e tokës nga fekalet e kafshëve monogastrike.

1. Probleme në shëndetin human dhe shtazor, për shkak të marrjes së sasive të larta të NO₃ në ujin e pijshëm, kontaminimit me (N, Pb, Cu Zn) të ushqimeve të gjelbra Sulce and Veizaj (2006).

2. Shkatërrimi i Ekosistemit për shkak të kontaminimit të ujërave nëntokësore (>100 mg NO₃- L-1), eutrofikimit të sipërfaqes së ujërave me N dhe P, kontaminimit të tokës dhe ujërave me (Cu, Zn, Pb, dhe pesticide).

3. Një arsye tjetër e ndotjes ambientale në zonën e marrë në studim janë mbetjet shtazore Piu and Locher (2001). Në këtë zonë ka rreth 1 milion pula prodhimi dhe rreth 32.000 krerë gjedhë ose 1.4 krerë/ ha. Si përfundim mund të themi se në këtë zonë mbetjet shtazore për

njësi të tokës së punueshme janë disa herë më të larta se nevojat e bimëve të kultivuara për to Borici et al (2005).

MATERIALI DHE METODA

Eksperimenti me një grup gicash në moshën 28 ditëshe u realizua në një fermë private të rritjes dhe mbarështimit të derrit. Kjo fermë është e organizuar si një fermë me cikël të mbyllur, pra aty gjenden të gjitha ambientet e nevojshme duke filluar nga materniteti, Flat-Deck, etj. Në eksperiment u vendosën 12 gica /grup. Në krijimin e grupeve është patur parasysh "parimi i analogjisë" përta i përket treguesve prodhues të dosave, nga të cilat janë përzgjedhur gicat në eksperiment, si dhe moshës e peshës mesatare të grupit.

Në të dy grupet, pra në grupin e kontrollit dhe atë të eksperimentit u përdor e njëjta recepturë ushqimore, bazuar në kërkesat ushqimore, që kanë gicat e kësaj moshe. Në grupin e eksperimentit është përdorur enzima fitazë (*Aspergillus niger*, Natuphos) 800 FTU/kg ushqim. Ushqimi i përdorur në eksperiment përmban produkte dhe nënprodukte të drithërave si: misër, grurë, produkte dhe nënprodukte të farërave vajore si: bërsi soje, vaj soje.

Tabela 1. Racioni ushqimor i përdorur në eksperiment.

Ushqimet	%
Misër	19.80
Grurë	38.00
Bërsi soje	13.00
Vaj soje	3.10
Hime gruri	12.00
Farm acid latici	5.00
Aringe danesi 999	1.60
Acipig	6.50
Premiks	1.00
Shuma	100%

Përbërja mineralo-vitaminike e 1 kg premiks është si më poshtë:

1.200.000 UI vit A

600 mg vit B₂

10.000 mg Zn

1.800 mg Acid pantotenik

4.000 mg vit E

70 mg Co

75. 000 mg Fe

20.000 µg biotin

50.000 mg choline chlorid

120.000 UI vit D₃

7.500 mg Mn

400 mg vit B₆

200 mg vit B₁

150 mg Jod

2.500 mg niacin

4.000 µg vit B₁₂

PËRPUNIMI STATISTIKOR I TË DHËNAVE.

Përpunimi statistikor i të dhënave të eksperimentit si dhe ndikimi i faktorit studimor u studjuan përmes analizës së variancës me metodën "ANOVA" (ANOVA-single factor). Krahasimi midis dy grupeve të eksperimentit u bë me T-test për numër të barabartë variancash (Two Sample Assuming Equal Variances).

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Tabela 2. Treguesit e prodhimitarisë në eksperimentin me gicat pas këputjes.

		Grupi i kontrollit	Grupi i eksperimentit
Treguesit e prodhimitarisë	n	X±SD	X±SD
Pesha në fillim, kg	12	6,35 ± 0.30	6,40 ± 0.40
Pesha përfundimtare, kg		15.5 ± 1.06	16.0 ± 0.96
Dinamika e shtesës së peshës, g/ditë		217.8 ± 10.0	228.5 ± 7.33
Treguesi i konvertimit të ushqimit, kg ushqim/kg shtesë peshe		1.82 ± 0.11	1.76 ± 0.10

Nga tabela e mësipërme duket se megjithëse nuk ka ndryshime të vërtetuara statistikisht ka një tendencë të qartë për përmirësimin e treguesve të prodhimit në grupin e trajtuar me enzimën Natuphos. Kështu pesha mesatare e gicave në fund të eksperimentit, tek grupi i eksperimentit është 3.2% më e lartë, krahasuar me grupin e kontrollit. Të njëjtën tendencë kanë edhe treguesit e tjerë si: dinamika e shtesës së peshës dhe indeksi i konvertimit të ushqimit.

Dinamika e shtesës së peshës në grupin e eksperimentit është rritur 4.9%, krahasuar me kontrollin, ndërsa indeksi i konvertimit të ushqimit, tek grupi i eksperimentit është ulur në masën 3.4%, krahasuar me kontrollin.

Shpesh në literaturë gjen diskutime kontradiktore për ekzistencën e fitazës intestinale tek monogastrikët. Nga njëra anë ka fakte dhe rezultate që flasin për ekzistencën e saj (Yang et al. 1991a,b) dhe nga ana tjetër mendime që hidroliza sasiore e fitatit përmes enzimave intestinale nuk është adekuate, po të marrim në konsideratë mikroflorën intestinale. (Wise and Gilbert 1982) në provat krahasuese me minj të zakonshëm dhe gnotobiotikë, zbuloi se këta të fundit kanë eliminuar afërsisht 100% të fitatit që përmbajnë ushqimet. Ndërsa tek minjtë e zakonshëm përqindja e hidrolizës së fitatit varion nga 22% kur dieta përmban 13g Ca/kg diet në 56% kur përmban 7g Ca/kg diet.

Në rastin e mossuplementimit me fitazë në dietën e minjve, hidroliza e fitatit i dedikohet tërësisht fitazës mikrobiale të florës intestinale. (Williams and Taylor 1985) kanë treguar se ekziston një aktivitet i ulët fitazik në mukozë, në të gjitha segmentet e zorrës së hollë. Sidoqoftë cekumi dhe koloni janë vendi ku hidrolizohet përmes mikroorganizmave një pjesë e mirë e fitatit, që gjendet në digjestë. Studimet dhe rezultatet e mëvonshme të (Greiner et al. 1993) kanë identifikuar prej *Escherichia coli* dy lloje fitazash periplazmike

Tek derrat pas dhënies së dietës gjysmë-sintetike me bazë kazeinë dhe amidon misri nuk u konstatua thithje e fosforit në zorrë nga fitati i kalciumit. Provat me derra (Pallauf et al 1992a) kanë dëshmuar se kufizimi i suplementimit me fosfor, në një dietë ushqimore me bazë misër-bërsi soje ka ulur tretshmërinë e fosforit fitik, që përmban dieta e mësipërme. (Pontillart et al. 1984) analizoi aktivitetin fitazik në zorrën e hollë të derrat dhe konkludoi se ajo është e rendit 0,6-1,3 mU/mg proteinë, pra ka një aktivitet tepër të lehtë fitazik.

Aktiviteti fitazik matet me njësinë e fitazës. Sipas (Engelen et al. 1994) një njësi fitazë (FTU) është përcaktuar si aktiviteti fitazik në kushte optimale, pH 5,5 dhe temperaturë 37°C, që

cliron 1µmol fosfat inorganik prej fitatit të natriumit, në një minutë. Gjatë përdorimit të fitazës mikrobike tek derrat, të ushqyer me dieta ushqimore me bazë misër, grurë dhe elb, u vu re një korrelacion pozitiv midis sasisë së fitazës mikrobike dhe hidrolizës gastro-intestinale të acidit fitik. Kështu rezultoi se zbërthimi i fitatit në stomak dhe në pjesën proksimale të zorrës së hollë ishte më e lartë për grurin, elbin dhe pastaj për misrin. (Pontillart et al 1987) krahasoi një dietë (tritikale-soja) të pasur në fitazë 440 FTU/kg me një dietë (misër-sojë) të varfër në fitazë 9 FTU/kg. Sasia e fosforit të përgjithshëm në të dy dietat ishte i njëjtë 0.35-0.40%. Kur këto dieta u përdorën në të ushqyerit e derrave në rritje u vu re që racioni i pasur në fitazë përmirësoi thithjen aparente të fosforit në masën 65%, kundrejt 48%, mineralizimin më të mirë të kockave dhe dinamikën e shtesës së peshës në masën 710 g/ditë, kundrejt 640 g/ditë të matur në dietën me aktivitet të ulët fitazik. Në provat e mëtejshme (Pointillart 1991) vuri re se gjatë shtimit të 20% bërsi thekre (1200 FTU/kg) në një racion ushqimor me bazë misër-sojë (fofori i përgjithshëm 0,42-0,44%) të përdorur tek derrat, pati një rritje të thithjes aparente të fosforit të përgjithshëm nga 36% në 55%. Shumë autorë tregojnë se fitaza bimore ka një ndikim të dukshëm në hidrolizën gastro-intestinale të acidit fitik. Kështu në një dietë ushqimore me bazë misër-sojë, tek e cila aktiviteti fitazik është tepër i ulët dhe shpesh i paidentifikuar, mund të shfrytëzohet vetëm 29% e fosforit të përgjithshëm. Gjatë të ushqyerit të gicave me dietën e parë të përbërë nga misër, elb, fasule, bizele (260 FTU/kg) dhe dietën e dytë grurë, elb, bërsi soje (360 FTU/kg), kur sasia e fosforit të përgjithshëm ishte e njëjtë 0,4%, u vu re një rritje e shfrytëzimit të fosforit nga 48 deri në 55%.

Të gjitha rezultatet e eksperimenteve vërtetojnë faktin që fitaza intestinale tek monogastrikët ka një ndikim tepër të ulët në shkallën e shfrytëzimit të fosforit fitik. Në kontrast me këtë fakt, përdorimi në dietat ushqimore i tërshërës, tritikaleve, grurit dhe elbit, rrit shkallën e shfrytëzimit të fosforit fitik dhe të lëndëve minerale e elementeve gjurmë.

Nga përdorimi i enzimës Natuphos është reduktuar gjithashtu sasia e fosforit në fekale në masën 25%.

KONKLUZIONI

Impakti ambjental që sjell zhvillimi dhe përqëndrimi i blegtorisë në zona të ndryshme mund të reduktohet përmes përdorimit të enzimave mikrobiale në të ushqyerit e kafshëve monogastrike, shpendë dhe derra. Nga përdorimi i enzimës Natuphos në racionet ushqimore të derrave u vu re një përmirësim i dukshëm i treguesve të prodhimit dhe reduktim i sasisë së P në feçe në masën 25%.

LITERATURA

1. Boriçi, J. Canco, G. Veizaj, E.: Soil and water pollution as a result of agriculture techniques and animal rests. Abstract on the International Conference: Element balances as a Tool for Sustainable Land Management (2005). Proceedings
2. Eeckhout, W. and M. De. Paep: Total phosphorus, phytate-phosphorus and phytase activity in plant feedstuffs. Animal Feed Science and Technology 1994; 47: 19-29.
3. Engelen, A.J., Heeft, F.C., Randsdorp, P.H.G., Smit, D.L.C. Simple and rapid determination of phytase activity. J.AOAC Int 1994; 77: 760-764.
4. Greiner, R., Konietzny, U., Jany, K-D. Purification and characterization of two phytases from *Escherichia coli*. Arch.Biochim.Biophys Acta 1993; 303: 107-113.
5. Guillet, I., Hollwich, C., Schwarz, G., Rambeck, W. A. Einfluss von Phytat und Phytase auf die Cadmiumakkumulation bei Ratte, Wachtel Hühnerküken und Schwein. Porc.Soc.Nutr.Physiol 1995: 4,94.

6. Ingelman, H-J., Rimbach, G., Pallauf, J. Phytinsäure-ein antinutritiver Faktor? Ernährungsumschau 1993; 40: 400-404.
7. Jongbloed, A. W., Kemme, P. A., Mroz, Z. The role of microbial phytases in pig nutrition. In: Wenk, C., Boessinger, M. (eds): Enzymes in Animal Nutrition, pp. 173-180, Institut für Nutztierwissenschaften ETH Zürich 1993.
8. Pallauf, J., Höhler, D., Rimbach, G., Neusser, H. Einfluss einer Zulage an mikrobieller Phytase zu einer Mais-Soja-Diät auf die scheinbare Absorption von Phosphor und Calcium beim ferkel. J. Anim. Physiol. A. Anim. Nutr 1992; 67: 30-40.
9. Piu, Th and Locher, E. Technical yearbook. 2001.
10. Pointillart, A. Importance of phytates and cereal phytases in the feeding of pigs. In: Wenk, C., Boessinger, M. (eds.): Enzymes in Animal Nutrition, pp. 192-198. Institut für Nutztier wissenschaften ETH Zürich 1993.
11. Pointillart, A., Fontaine, N., Thomasset, M. Phytate phosphorus utilization and intestinal phosphates in pigs fed low phosphorus: wheat or corn diets. Nutr. Rep. Int. 1984; 29: 473-483.
12. Pointillart, A., Fourdin, A., Fontaine, N. Importance of cereal phytase activity for phytate-phosphorus utilization by growing pigs fed diets containing triticale or corn. J. Nutr. 1987; 117: 907-913.
13. Pointillart, A. Enhancement of phosphorus utilization in growing pigs fed phytate-rich diets by using rye bran. J. Anim. Sci. 1991; 69: 1109-1115
14. Ravindron, V., Bryden, W. W., Kornegay, E. T. Phytates: occurrence, bioavailability and implication in poultry nutrition. Poultry Avian Biol. Rev. 1995; 6(2): 125-143
15. Rodehutsord, M., Faust, M., Lorenz, H. Digestibility of phosphorus contained in soybean meal, barley and different varieties of wheat, without or with supplemental phytase fed to pigs and additivity of digestibility in wheat –soybean meal diet. J. Anim. Physiol. A. Anim. Nutr. 1995; 75: 40-48.
16. Sulce, S and Veizaj, E. Evaluation of potential pollution from agricultural activities at Durrës region (Albania). Proceedings
17. Williams, P. J., Taylor, T. G. A comparative study of phytate hydrolysis in the gastrointestinal tract of the golden hamster (*Mesocricetus auratus*) and the laboratory rat. Br. J. Nutr. 1985; 54: 429-435.
18. Wise, A., Gilbert, D. J. Phytate hydrolysis by germfree and conventional rats. Appl. Environ. Microbiol. 1982; 43: 753-756.
19. Yang, W. J., Matsuda, Y., Inomata, M., Nakagawa, H. Developmental and dietary induction of the 90k subunit of rat intestinal phytase. Biochim. Biophys. Acta 1991; 1075: 83-87.
20. Yang, W. J., Matsuda, Y., Sano, S., Matsutani, H., Nakagawa, H. Purification and characterization from rat intestinal mucosa. Biochim. Biophys. Acta 1991; 1075: 75-82.

**TESTIMI SEZONAL I MËMAVE TË BLETËVE TË PRODHUARA ME TEKNIKËN
E SHARTIMIT ME TRANSFERIMIN E LARVAVE
THE SEASONAL TESTING OF THE QUEEN BEES PRODUCED THROUGH THE
GRAFTING TECHNIQUE**

SABAH SENA, MARTIN LLAZANI, LUMTURI SENA*, MARIANA NIKOLLA

*Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës

lumturisena@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Qëllimi i këtij studimi është të përcaktohet periudha më e përshtatshme për prodhimin e mëmave rezultative të bletëve me ane të teknikës së shartimit me transferimin e larvave. Ky studim u krye për periudhën Maj-Gusht të ndarë përkatësisht në tre faza me nga 45 ditë secila. Për këtë, u përdorën familjet më të forta të parkut. Për secilën fazë u prodhuan nga 10 mëma, për të cilat u gjykua për performancën e tyre. U regjistruan në vazhdimësi shkalla e vulosjes së larvave, dalja (çelja) e mëmave të reja, koha e kopulimit të tyre, madhësia e mëmave dhe numri i vezëve të prodhuara prej tyre për kohën që u mbajtën në nukleuse. Në përfundim të provës rezultoi se, si vulosja e larvave (në ditën e 8.5), ashtu edhe dalja e mëmave (në ditën e 15.6) ka qenë më e hershme në fazën e parë. Është vërejtur një tendencë për vonesë në kohën e kopulimit të mëmave në fazën e parë krahasimisht me dy të tjerat (21.6-24 orë). Periudha Qershor-Korrik u karakterizua nga një prodhimtari maksimale nga ana e mëmave (1950 vezë/ditë). Mëmat me peshë më të madhe janë siguruar në muajt maj-qershor. Në të tre fazat e testimit rezultoi me një uniformitet optimal treguesi për kohën e daljes së mëmave dhe për peshën e tyre. Vonesa në daljen e mëmave ka ndikuar negativisht në peshën e tyre trupore (-0.80), por ka shkurtuar kohën e kopulimit të mëmave (-0.98).

Fjalë - kyç: *Fazë, mëma, nukleus, performancë, teknika e shartimit të larvave.*

ABSTRACT

The purpose of this study is to determine the most appropriate period for the production of quality queen bees through the grafting technique, which consists on the larva transfer. This study was conducted in the period May-August divided respectively in three phases of 45 days each. For this purpose, the strongest bee colonies of the apiary were used. During each stage, 10 queen-bees were produced, which were evaluated by their performance. The rate of larvae sealing, the hatch of new queen bees, their copulation time, the body size, and the number of laid eggs during the time they were held in the nuclei, was recorded and monitored. At the end of the test it was seen that, both the sealing of larvae (at the 8.5 day), and the queen bees emergence/hatching (at the 15.6 day) happened earlier in the first phase. A tendency for delay of the queen bees' copulation was noted in the first phase, in comparison with the other two ones (21.6-24 hours). The June-July period was characterized by a maximum egg production by the queen bees (1950 eggs/day). The heaviest queen bees are provided during May-June period. During all the three testing stages, both queen bees' emergency time and their body weight resulted to be within an optimum uniformity. The delay in the queen bees' emergency, has negatively affected their body weight (-0.80), but has reduced the queen bees' copulation time (-0.98).

Key-Words: *larvae grafting technique, nucleus, performance, queen-bees, stage.*

1. HYRJE

Prezenca e një mëme të re, vitale me një bekgraund të njohur gjenetik është esenciale për të pasur një menaxhim të suksesshëm të familjes bletë. Për pasojë, zevëndësimi i rregullt i mëmës është një faktor kyç për mbajtjen e familjeve të qeta, punëtore dhe produktive (Greer P, 2005; Trisel D E., 2014).

Produktiviteti i mëmave të bletëve varet nga moshja e tyre, raca, koha e mbarështimit, pesha në kohën e daljes, metoda e shartimit, numri i ovarioleve, numri i spermatozoideve në spermatekë, etj (Wen-Cheng H., Chong-Yuan Z, 1985; Mahbobi A, etj 2012). Një veçori biologjike e rëndësishme e familjes bletë është aftësia për të rritur mëma duke përdorur larvat e reja të moshës 1-3 ditëshe, të cilat kanë potencial për tu bërë mëma riprodhuese, nëse ushqehen mjaftueshëm me qumësht (Gensen, 2000; Sena L., etj., 2010).

Mëmat mund të rriten nga larvat e puntoreve deri në moshën 3 ditëshe, nëpërmjet shartimit të larvave në kupëzat artificiale (Weiss. 1983; Dodologlu & Emsen, 1998). Nëpërmjet rritjes artificiale mund të përzgjidhen mëmat me tipare të dëshiruara të tilla si prodhimtari e lartë mjalti, vitaliteti i lartë i gjeneratës, me zhvillim të hershëm të familjes në pranverë, etj (Jonestone, 2008).

Teknikat e rritjes së mëmave janë zhvilluar për të mbajtur familje të forta bletësh dhe për të zevëndësuar mëmën e vjetër dhe të padëshirueshme në këto familje (Joseph L., 2011). Sipas Abbasi K H., etj, (2015), prodhimi i mëmave me teknikën e shartimit të larvave ndikon pozitivisht në prodhimin e mjaltit, në zhvillimin e gjeneratës në pakësimin e tendencës për roitje.

Bazuar në sa theksuam më sipër, kryem këtë studim për të vlerësuar performancën e mëmave të rritura gjatë periudhës Maj-Gusht.

Objekti i studimit: Përcaktimi i kohës më të favorshme për rritjen e mëmave të bletëve me teknikën e shartimit me transferimit të larvave dhe identifikimi i ndikimit në treguesit e performancës.

2. MATERIALI DHE METODA

U provua efekti i sezonit në rritjen e mëmave të bletëve me metodën me mbjellje. Eksperimenti u krye në një park bletësh në afërsi të Tiranës. Studimi u krye në një periudhë kohore Maj- Gusht 2012 dhe u nda përkatësisht në tre faza:

- Faza e parë: 15 Maj – 30 Qershor
- Faza e dyte: 15 Qershor – 30 Korrik;
- Faza e dytë: 15 Korrik – 30 Gusht.

Secila nga fazat zgjati përkatësisht 45 ditë. Për këtë në çdo fazë u zgjodh një nga familjet më të forta të parkut. Gjatë kësaj periudhe kushtet kullosore lokale për bletët (poleni dhe nektari) ishin të mira.

Në fillim i përgatitëm kupëzat, të cilat i futëm në dyll të shkrirë në mënyrë që të merrnin formën e hojeve të vërteta. Kupëzat më pas i vendosem në kornizë, të cilën e futëm në zgjua në mënyrë që bletët t'i lustronin kupëzat. Në të njejtën kohë në familjen furnizuese futëm një kornizë të pastër me dyllë dhe e izoluam mëmën për të lëshuar vezët. Pas 12 orëve i nxorëm të dy kornizat dhe i çuam në ambientin ku e realizuam mbjelljen.

Në dhomën ku u bë mbjellja e larvave krijuam kushtet që temperatura e mjedisit të ishte mbi 25°C dhe lagështia optimale rreth 70-75%. Për ta kryer mbjelljen u siguria një sasi qumësht mëme jo më e vjetër se 24 orë, dhe më pas e holluam me ujë të distiluar. Pasi i siguruam të gjitha kushtet e nevojshme e bëmë mbjelljen e vezëve.

Në fundin e çdo kupëze vendosëm nga një pikë qumësht mëme dhe me anë të gjilpërës morëm vezë nga hojet dhe i vendosëm në kupëza. Vezët i nxorëm nga hojet me mdihmën e lupës që të mos dëmtoheshin. Mjedisi ku u realizua mbjellja ishte i errësuar për të mos u prishur qumështi i mëmës. E gjithë procedura e mbjelljes zgjati më pak se 20 minuta dhe më

pas korniza me kupëzat u vendos në zgjoin dado. Pas 48 orëve e bëmë kontrollin e parë, ku përzgjedhëm vetëm kupëzat që ishin më shumë të ushqyera dhe njëkohësisht u eliminuan kupëzat e paushqyera, ose të ushqyera dobët.

Zgjoin dado e kishim përgatitur 8-9 ditë më parë. Kesaj familje ia kishim larguar mëmën. Pas vendosjes së kornizës me vezë të reja zgjoin e mbyllëm dhe e furnizuar me ushqim që bletët ta kishin ushqimin më afër. Dy ditë më vonë e hapëm zgjoin për të bërë kontrollin e shtretërve. Në këtë kontroll u përzgjedhën vezët që ishin ushqyer më mirë, ndërsa vezët e ushqyera dobët u eliminuan.

Ditën e 14 dhe të 15 bëmë përgatitjen e nukleusëve ku i mbollëm shtretërit e mëmave. Kupëzat u vendosën midis dy kornizave për secilin nukleus. Në nukleus u vendosën bletët punëtore të njëjtit zgjuar. Nukleusët e përgatitur në këtë mënyrë i bartëm në një largësi rreth 10 km larg zgjoit në mënyrë që mëmat të çelnin dhe të kopuloheshin me meshkujt e parqeve tjera dhe arsye tjetër ishte që bletët të mos ktheheshin përsëri në zgjoin nga i kishim marrë. Kjo metodë është e përsëritur 3 herë gjatë tre sezoneve. Për secilën fazë u përzgjedhen dhe iu nënshtuan eksperimentit vetëm 10 vezët më të mira. Pra, për secilën fazë u testuan 10 mëma. Treguesit që u regjistruan gjatë prodhimit të mëmave për secilën fazë:

- Koha e vulosjes së larvave (në ditë).
- Koha e daljes (çeljes) së mëmave (në ditë).
- Ecuria e kopulimit të mëmave dhe fillimi i pjelljes së vezëve
- Prodhimi e vezëve nga mëmat e reja të kopuluara në nukleus. Në fund të cdo faze është caktuar një ditë për realizimin e matjeve të mëmave të kopuluara për cdo grup. Pra, është bërë numërimi i vezëve të pjella nga mëma për cdo nukleus me anë të kornizës rrjetë.
- Peshat trupore e mëmave të kopuluara. Peshimi u krye me peshore të posaçme për bletët (material argjendi).

Për treguesit e rritjes së mëmave u llogarit edhe uniformiteti (Cv - koeficientin e variacionit) sipas formulës: $CV = SD/M$ (e shprehur në përqindje).

Rezultatet e përfutuara iu nënshtuan përpunimit statistikor me metodën ANOVA dhe analizën deskriptive.

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Parametrat e rritjes së mëmave

Koha e vulosjes së larvave

Në fazën e parë vërehet një vulojë më e hershme e larvave krahasimisht me dy fazat në vazhdim (përkatesisht 21.6 orë dhe 24 orë). Kjo është rezultat i pasurisë kullimore, temperaturave dhe lagështisë mjaft të favorshme për këtë fazë. Në dy fazat e tjera diferencat në kohë janë të pakonsiderueshme.

Koha e daljes së mëmave

Koha e daljes së mëmave, ashtu si edhe koha e vulosjes ka qenë më e hershme në fazën e parë krahasimisht me dy fazat e tjera. Sipas Dedei S, 1990, konfirmohet se numri i mëmave të rritura me shartim është më i madh në muajt Maj, Qershor dhe korrik. Vuloja dhe çelja një ditë më herët në fazën e parë mund të shpjegohet me zgjedhjen e larvave më të reja. Pra, rezultatet më të mira lidhur me rritjen e mëmave u arritën për fazën e parë (Maj – Qershor) Sipas Greer P (2005) mëmat çelin pas 15 – 17 ditësh. Sipas Clive de Bruyn (2003,) Thomo K., etj. (2005), Sena L. (2010), Ahmad K J (2013), koha totale për zhvillimin e memes është rreth 16 ditë.

Ecuria e kopulimit të mëmave

Megjithëse në fazën e parë koha e kopulimit të mëmave ka qenë më e vonuar se në dy fazat e tjera (përkatesisht 0.9 ditë më vonë se në fazën e dytë dhe 1 ditë më vonë se në fazën e tretë), përsëri diferencat nuk janë të vërtetuara statistikisht për $p \leq 0.05$. Pra, vërejmë se megjithëse në fazën e parë mëmat kanë çelur pothuaj një ditë më herët kanë kryer fluturimin e martesës

një ditë më vonë. Kjo lidhet më forcën e familjeve, kushtet atmosferike dhe orjentimin e zgjojve. Megjithatë, koha e kopulimit të mëmave në të tre fazat qëndron brenda limiteve optimale. Sipas Ahmad K J., etj (2013) fluturimi i martesës është regjistruar 20-24 ditë pas shartimit të larvave ose 6-10 ditë pas celjes. Sipas Souza D.A (2013), mëmat filluan pjelljen e vezëve në moshën 8.7-10.5 ditë.

Prodhimi i vezëve nga mëmat e reja në nukleuse

Të bie në sy prodhimi maksimal i vezëve në fazën e dytë (Qershor-Korrik). Kjo ndodh sepse kjo periudhë karakterizohet nga ushqimi i bollshëm (kullota + ushqimi suplementar + sherbet). Si pasojë edhe forca e familjes arrin kulmin në këtë periudhë. Kushtet atmosferike në këtë sezon janë të favorshme. Kurse në fazën e tretë shënohet një rënie e prodhimit të vezëve nga mëmat (17.9%), sepse pakësohet baza ushqimore (rezervat e nektarit dhe të polenit). Pra, mund të konkludojmë se sezoni ka ndikuar ndjeshëm në prodhimin e vezëve nga ana e mëmave në nukleuse. Sipas Ahmad K J., etj (2013) pjellja e vezëve nga mëmat ka filluar 23 ditë pas shartimit, ose menjëherë pas fluturimit të martesës. Një mëmë e kopuluar dhe e ushqyer mirë mund të pjellë rreth 2000 vezë/ditë gjatë periudhës së pranverës (Root and Root, 1980).

Tabela nr 1. Përmbledhëse e treguesve të performancës së mëmave të bletëve sipas fazave

Treguesit	Faza e I	Faza e II	Faza e III
Koha e vulosjes së larvave (ditë)	8.5 ± 0.71	9.4 ± 0.52	9.5 ± 0.53
Koha e daljes së mëmave (ditë)	15.6 ± 0.52	16.6 ± 0.52	16.5 ± 0.53
Koha e kopulimit të mëmave (ditë)	11.2 ± 1.87	10.3 ± 0.82	10.2 ± 2.57
Prodhimi i vezëve nga mëmat (nr)	1720 ± 182.32	1950 ± 799.74	1600 ± 323.18
Pesha e mëmave të kopuluara (mg)	292 ± 9.49	271.5 ± 12.92	249 ± 9.37

Pesha trupore e memave të kopuluara

Mëmat me peshë më të madhe sigurohen në muajt maj-Qershor. Pesha e mëmave pëson një rënie nga njëra fazë në tjetrën me diferenca sinjifikante. Kjo është e lidhur me pasurinë kullosore, e cila vjen në rënje nga muaji Maj e deri në Gusht. Sipas B.Boreviç, 1993, kjo peshë varion nga 180-325mg. Pra, shohim se pesha e mëmave të eksperimentimit tonë për të tre grupet në harkun kohor Maj-Gusht është brenda këtyre kufijve (vlera optimale). Sipas Dedei, S (1995), mëmat e rritura gjatë muajit qershor janë më të mira për nga madhësia dhe parametrat e produktivitetit krahasimisht me ato të rritura në korrik. Mëmat me peshë më të madhe do të prodhojnë koloni më të forta me një variacion gjenetik më të madh (Tarpy & Page, 2000; Kraus etj, 2005; Kahya etj, 2008, Tarpy etj, 2011).

Në tabelën 2 paraqitet uniformiteti i llogaritur me anë të Cv për treguesit e rritjes së mëmave.

Tabela nr 2. Uniformiteti (Cv) për treguesit e performancës së mëmave sipas fazave (%)

Treguesit	Faza e I	Faza e II	Faza e III
Koha e vulosjes së larvave	8.4	5.5	5.6
Koha e daljes (çeljes) së mëmave	3.3	3.1	3.2
Koha e kopulimit të mëmave	16.7	7.9	25.2
Pesha trupore e mëmave të kopuluara	3.3	4.8	3.8

Lidhur me treguesin e kohës së vulosjes së larvave mund të konstatojmë se në fazën e dytë dhe të tretë ka një uniformitet të kënaqshëm krahasimisht me fazën e parë. Për treguesin e çeljes së mëmave dhe peshën trupore të tyre Cv ka vlere mjaft të ulta për të tre fazat, gjë që tregon për një uniformitet të shkëlqyer. Vetëm në fazën e dytë ka pasur një uniformitet

optimal për kohën e kopulimit të mëmave, kurse në dy fazat e tjera variabiliteti është i theksuar. Bazuar në literaturë, mund të konkludojmë për një uniformitet optimal kur vlerat e CV është deri në 8%. Vlerat më të larta se kjo shifër flasin për një uniformitet të dobët.

Tabela nr 3. Korelacionet midis treguesve të rritjes së mëmave

	Vulosja e larvave	Dalja e memave	Kopulimi i memave	Prodhimi i vezeve	Pesha e memave
Vulosja e larvave	1				
Dalja e memave	0,983516	1			
Kopulimi i memave	-1	-0,98352	1		
Prodhimi i vezeve	0,088475	0,267126	-0,08847	1	
Pesha e memave	-0,89626	-0,80129	0,896258	0,362497	1

Në tabelën 3 verehen lidhjet korrelative midis treguesve të rritjes së mëmave. Sa më shpejt të vulosen larvat, aq më shpejt do të dalin mëmat (korelacion pozitiv 0.98). Vonesa në daljen e mëmave do të ndikojë negativisht në peshën trupore të tyre (-0.80) dhe do të shkurtojë kohën e kopulimit të mëmave (-0.98). Prodhimi i vezëve nga mëmat për kohën e testimit të tyre ka lidhje mjaft të dobta me treguesit e lartpërmendur.

4. PËRFUNDIME

- Rezultatet më të mira lidhur me rritjen e mëmave me teknikën e shartimit me transferimin e larvave u fituan në fazën e parë (Maj-Qershor). Megjithatë diferencat me dy fazat e tjera janë të pa vërtetuara statistikisht.
- Mëmat e prodhuara në fazën e parë kanë shfaqur tendencën për të vonuar fluturimin e martesës krahasimisht me mëmat e prodhuara në dy fazat e tjera (përkatesisht me 0.9 dhe 1 ditë). Ka pasur korrelacion negativ midis treguesve të rritjes së mëmave dhe kohës së kopulimit të mëmave.
- Prodhimi i vezëve nga mëmat në nukleuse arriti pikun në muajt Qershor-korrik, ndërsa në fazën e tretë ra në nivelin 17.9%, si pasojë e pakësimit të nektarit dhe të polenit.
- Nga muaji Maj-Gusht, pesha e mëmave ka pësuar një rënje të ndjeshme. Ka rezultuar një korrelacion negativ midis kohës së daljes së mëmave dhe peshës trupore të tyre.

LITERATURA

1. Abbasi K H., Shafiq M., Ahmad K J., Razzaq A., Saleem M. and Ullah M A. Performance of larval grafted queen vs queen produced through natural method in *Apis mellifera*. Journal of Entomology and Zoology Studies. 2015; 3 (2): 47-49
2. Ahmad K J., Shafiq M., Abbasi K H., Razzaq A., Saleem M. and Ullah M A. Production of quality queens by artificial rearing technique (larval grafting). Persian gulf protection. 2013; 2 (2): 26-29.
3. Clive de Bruyn (2003) Practical Beekeeping,
4. Dedei S. (1995) Extensive Program in Bee Production, (Bulletin of Ag. Sciences Nr.2).
5. Dodologlu A., Emsen B. Relationship between larvae age and characteristics of queen honey bee (*Apis mellifera* L) after single and double grafting. J.Vet and Anim Sci.1998; 21: 379-385
6. Gensen M. Queen rearing with *Apis cerana* - the Jensen method. Bees for Development Journal 2000; 1:55.
7. Greer P. Queen bee replacement. 2004. Honey bee research report 2005. RIRDC. Publication 2005; No. 05/053
8. Jonstone, M. Rearing queen bees, Honey Bees, Richmond, USA. Prime facts 828.2008.

9. Joseph L, Queen Rearing Basics. Latshaw Apiaries LLC. Harlem Road. New Albany. OH 430541614.855.9065, 2011.
10. Kahya Y, Gençer HV, Woyke J. Weight at emergence of hohey bee (*Apis mellifera* *Caucasica*) queens and its effect on live weights and the pre and post mating period. *J.Apicult. Res.* 2008; 47: 118-125.
11. Kraus FB, Neumann P, Moritz FA. Genetic variance of mating frequency in the honey bee (*Apis mellifera* L). *Insects Sociaux.* 2005; 52: 1-5.
12. Mahbobi A., Farshineh-Adl M., Wouke J., Abbasi S. Effects of the age of grafted larvae and the effects of supplemental feeding on some characteristics of Iranian queen honey bees (*Apis mellifera* Skorikov, 1929). *Journal of Apicultural Science.* 2012; 56 (1): 93-98.
13. Root AI, Root ER. The ABC and XYZ of Bee Culture. Medina, Ohio: The A. I. Root Company, USA, OCLC 6586488, 1980.
14. Sena L., Sena S., Gjurgji F., Nikolla M. Seasonal application of jenter's method for a successful queen bees' rearing in Albania. *BIOTECHNOL. & BIOTECHNOL.* 2010; 433-437.
15. Souza D.A, Bezzera-Laure M.A.F., Francoy T.M. & Gonçalves L.S. Experimental evaluation of the reproductive quality of Africanized queen bees (*Apis mellifera*) on the basis of body weight at emergence. *Genetics and molecular research.* 2013; 12 (4): 5382-5391
16. Tarpy D.R and Page Jr RE. No behavioral control over frequency in queen honey bee (*Apis Mellifera* L): Implications for the evolution of extreme polyandry. *Am. Nat.* 2000;155: 820-827.
17. Tarpy DR, Keller JJ, Caren JR, & Delaney DA. Experimentally induced variation in the physical reproductive potential and mating success in honey bee queens. *Insects Sociaux.* 2011; 58: 569-574.
18. Thomo K., Sena L., Maluta V., Shehu L. *Bletaria.* 2005
19. Trisel D E. Comparison of Artificial Insemination and Natural Mating Methods of Queen Honeybee. *Honeybee rearing. The queen bee is essential,* 2014. Web Actical. <http://www.fairmontstate.edu.com>.
20. Weis K. The influence of rearing condition of queen development. In: F. Ruttner (Ed). *Queen rearing biological basis and technical instruction:* 1983; 83-177.
21. Wen-Cheng H., Chong-Yuan Z. The relationship between the weight of queen honeybee at various stages and the number of ovarioles, eggs laid and sealed brood produced. *Honey Bee Science.* 1985; 6(3): 113-116.

**VLERËSIMI I KARAKTERISTIKAVE MORFOMETRIKE NË DHITË E RACËS
SË VENDIT NË SHQIPËRI
EVALUATION OF MORPHOMETRIC CHARACTERISTICS OF THE ALBANIAN
LOCAL GOATS**

PËLLUMB ZALLA, EGON ANDONI, VASILIKA DINI, KUSHTRIM MUÇAJ
Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Universiteti Bujqësor i Tiranës
Departamenti i Lëndëve Morfofunktionale, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Universiteti
Bujqësor i Tiranës, SHQIPËRI
pellumbzalla@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Studimi mbi ndikimin e moshës dhe seksit në treguesit morfologjik u krye në dhitë e vendit që mbarështohen në zonat malore të Krujës dhe Burrelit. Ai u krye në 80 krerë dhi të mbarështuara në regjim kullor. Dhitë ishin klinikisht të shëndetshme. Ato u ndanë në grupe, sipas moshës (< 1 vjeç, 1 - 2 vjeç, 2 - 3 vjeç, 3 - 4 vjeç) dhe seksit (femra, meshkuj). U vlerësuan treguesit e mëposhtëm: lartësia në xhidavi, gjatësia e trupi, gjatësia e qafës, perimetri i qafës, perimetri i kraharorit, gjerësia e vitheve, gjatësia e faqeve, lartësia e gjymtyrës së parme, lartësia e pjesës së pasme. Nga matjet morfometrike dhe analiza statistikore e tyre, rezultoi që midis individëve të të njëjtit grup kishte ndryshime në vlerat statistikore të treguesve morfometrik. Midis sekseve kishte ndryshime statistikore vetëm për treguesit, gjatësia e qafës ($P \leq 0.05$) dhe perimetri i kraharorit ($P \leq 0.004$). Moshë dhe treguesit morfometrik, kishin lidhje korelative të mirë, ku koeficienti i korrelacionit varioje 0.87 – 0.94. Pra, moshë ka një ndikim pozitiv në të gjithë treguesit morfometrik.

Fjalë kyç: dhi, moshë, seksi parametrat morfometrik, analiza statistikore

ABSTRACT

This study was carried out in goats reared in the mountainous areas of Kruje and Burrel districts. The influence of age and sex on morphological indicators was tested by employing proper statistical tests. In this study were involved 80 healthy goats of local bred managed in extensive condition. They were divided into groups according their age (< 1 year, 1-2 years, 2-3 years, 3-4 years) and sex (female, male). The following indicators were assessed: Withers Height (WH), Rump Height (RH), Rump Width (RW), and Body Length (BL), Neck Circumference (NC), Chest Circumference (CHC), Face Length (FL), Neck Length (NL), and Foreleg Length (FLL). Morphometric measurements and their statistical analysis showed that among individuals of the same group there are significantly differences in morphometric values. The statistical analyses showed that there is a statistical difference between the sexes only for particular indicators related with length of the neck ($P \leq 0.05$) and chest circumference ($P \leq 0.004$). In addition, there is an obviously positive correlation between age and morphometric indicators, correlation coefficient (r) ranged from 0.87 - 0.94.

Keywords: goats, age, sex, morphometric traits, statistical analysis

HYRJE

Dhitë zënë një vend të rëndësishëm në popullatat e kafshëve që mbarështohen në zonat malore të Shqipërisë. Në Shqipëri mbarështohen rreth 759000 krerë dhi (Min Bujq). Ato kanë një kontribut të rëndësishëm në industrinë e qumështit, mishit, lëkurës dhe qimeve. Prodhimi vjetor I qumështit nga dhitë arrin në 67000 ton, ndërsa I mishit 45.3 ton (Min Bujq). Madhësia e vogël trupore trupore e dhive të vendit që I lejon ato të shfrytëzojnë më mirë

kullotën, aftësitë e larta përshtatëse, pjelloria dhe rezistenca ndaj sëmundjeve I bëjnë ato specie të rëndësishme dhe me interes. Racat autoktone janë burime të rëndësishme gjenetike. Vlerësimi i parametrave të rritjes në kafshën e gjallë është i nevojshëm për një prodhim optimal dhe të qëndrueshëm.

Lidhjet që ekziston midis tipareve lineare të trupit japin informacion të dobishëm për performancën, produktiviteten dhe karakteristikat e karkasave (Ibe, 1989; Ibe and Ezekwe, 1994). Matjet sasiore të madhësisë dhe formës së trupit janë të nevojshme për vlerësimin e parametrave gjenetik të racave të kafshëve (Chineke, 2000). Krahas peshës trupore matjet lineare të trupit në kafshët për mish janë të nevojshme për përcaktimin sasior dhe formës së trupit (Ibe, 1989; Ibe and Ezekwe, 1994).

Sistemi i matjes lineare të trupit u zhvilluar nga Alderson (1999), për të siguruar një vlerësim të tipit në gjedhët për mish dhe vlerën e një kafshe. Kjo është e nevojshme në kafshët e reja si masë për të mundësuar vlerësimin më të hershme të racave, përzgjedhjen dhe parashikimin e një vlerësimi të saktë . Ndryshueshmëria në madhësinë e trupit është një nga kriteret e përdorura për

klasifikimin e racat e dhive (Devendra dhe Burns , 1983). Jeffery dhe Berg (1972) raportuan se në kafshët e matuara, matjet lineare të trupit janë në thelb një konstante e reflektuar në madhësinë e trashëgueshme të skeletit .

Matjet lineare të trupit janë përdorur për të demonstruar efektin e kryqëzimit të racave, si kriter për zëvendësimin selektiv të kafshëve dhe vlerësimin e racave në një mjedis të kontrolluar (Shrestha et al , 1984; . Searle et al , 1989 dhe Sharma et al , 1977) .

Studimi kishte për qëllim vlerësimin e ndikimit të moshës dhe seksit në parametrat morfometrik në dhitë e vendit.

MATERIALI DHE METODA

Vlerësimi I parametrave morfologjik nëpërmjet matjeve lineare të trupit u realizua në dhitë e vendit që mbarështohen në zonën malore të Krujës dhe Burrelit. Studimi u krye në 80 krerë dhi të vendit të ndara sipas moshës (< 1 vjeç, 1 - 2 vjeç, 2 - 3 vjeç, 3 – 5 vjeç) dhe seksit (femra, meshkuj). Dhitë mbarështohen në regjim kullor. Për sejcilën kafshë të marrë në studim u bë vlerësimi i treguesve klinik normal.

Matjet lineare të trupit për sejcilën kafshë u bënë për treguesit morfologjik si: lartësia në xhidavi (WH), gjatësia e trupi (BL), gjatësia e qafës (NL), perimetri i qafës (NC), perimetri i kraharorit (CHC), gjerësia e vitheve (RW), gjatësia e faqeve (FL), lartësia e gjymtyrës së parme (FLL), lartësia e pjesës së pasme (RH).

Të dhënat e përfituara për parametrat morfologjik u analizuan statistikisht duke përdorur programin ANOVA. U vlerësuan treguesit e mëposhtëm statistikor: mesatarja aritmetike (mean), devijacioni standart (ds), koeficienti i variacionit (cv), koeficienti i korrelacionit, vërtetësia e ndryshimeve (t_{stat}).

Mosha (vjeç)	Femra (krerë)	Meshkuj (krerë)
0 - 1	10	10
1 - 2	11	9
2 - 3	13	7
3 - 5	15	5



Figura nr. 1 Harta e zonave të kampionimit

REZULTATET DHE DISKUTIMI I TYRE


Tabela 1 paraqet vlerat statistikore (mes, ds dhe cv) të treguesve morfometrik (lartësia në xhidavi (HW), gjatësia e trupi (BL), gjatësia e qafës (NL), perimetri i qafës (NC), perimetri i kraharorit (CHC), gjerësia e vitheve (RW), gjatësia e faqeve (FL), lartësia e gjymtyrës së parme (FLL), lartësia e pjesës së pasme (RH) sipas moshës. Individëve e të njëjtit grup paraqesin ndryshime statistikore për të gjithë treguesit morfometrik. Në grup moshën (0 – 1 vjeç) këto ndryshime ishin më sinjifikative për treguesin gjatësi e qafës ($cv = 7.547$), grup moshën (1 – 2 vjeç) për treguesin perimetër i qafës ($cv = 10.6$), grup moshën (2 – 3 vjeç) për treguesin gjerësi e vitheve ($cv = 9.165$) dhe për grup moshën (3 – 5 vjeç) ndryshimet ishin më sinjifikative për treguesin lartësi e pjesës së pasme ($cv = 7.685$). Siç shihet dhe nga tabela, me rritjen e moshës kemi rritje në vlera të treguesve morfometrik. Për treguesin lartësi e gjymtyrës së parme verëhen ndryshime sinjifikative midis grupmoshave 0 – 1 vjeç dhe 1 – 2 vjeç, ndërsa midis grupmoshat 2 – 3 vjeç dhe 3 – 5 vjeç këto ndryshime janë jo sinjifikative.

Tabela nr. 1 Vlerat statistikore të treguesve morfometrik sipas moshës


MOSHA (VJEÇ)	T STAT	TREGUESIT MORFOMETRIK								
		WH	BL	NL	NC	CHC	RW	FL	FLL	RH
0 - 1	MES	45.33	63.67	17.67	23.67	57.67	9.333	13.33	31	49.67
	DS	0.577	4.163	2.309	1.528	1.528	0.577	0.577	1	2.517
	CV	0.735	3.775	7.547	3.726	1.529	3.571	2.5	1.862	2.925
1 - 2	MES	58	83.33	23.33	30.33	73	13.33	18.33	37.67	64
	DS	3.606	2.309	0.577	3.215	4.583	0.577	0.577	2.309	1
	CV	6.216	2.771	2.474	10.6	6.278	4.33	3.149	6.131	1.563
2 - 3	MES	68	97.67	30.67	33.33	90	16.67	19.33	43.67	71.33
	DS	5.568	5.132	4.726	2.309	4.359	1.528	0.577	0.577	4.726
	CV	8.188	5.254	15.41	6.928	4.843	9.165	2.986	1.322	6.625
3 - 5	MES	72.67	103.3	26.67	36.67	100	18.67	21.33	44.67	71.67
	DS	3.512	2.517	1.528	1.528	4.583	1.155	0.577	0.577	5.508
	CV	4.833	2.435	5.728	4.166	4.583	6.186	2.706	1.293	7.685

MES = mesatarja aritmetike, DS = devijacioni standart , CV = koeficienti I variacionit
 Midis vlerave për të gjithë treguesit morfometrik dhe moshës ka një lidhje korrelative të mirë (grafiku 1/ a,b,c,d,e,f,g,h,i). Treguesit gjatësi e trupit dhe perimetër I qafës paraqesin një lidhje korrelative më sinjifikative me moshën (koeficienti i korrelacionit = 0.94) . Treguesi lartësi e pjesës së pasme rezultoi me një lidhje korrelative më pak sinjifikative (koeficienti I korrelacionit = 0.84).


Grafiku nr. 1/a Lidhja korelative midis WH dhe moshës




Grafiku nr. 1/b Lidhja korelative midis BL dhe moshës




Grafiku nr. 1/c Lidhja korelative midis NL dhe moshës




Grafiku nr. 1/d Lidhja korelative midis NC dhe moshës



Grafiku nr. 1/e Lidhja korelative midis RW dhe moshës




Grafiku nr. 1/f Lidhja korelative midis CHC dhe




moshës

Grafiku nr. 1/g Lidhja korelative midis FL dhe moshës



Grafiku nr. 1/h Lidhja korelative midis FLL dhe moshës



Të dhënat e këtij studimi përputhen me të dhënat e autorëve të tjerë (Salako (2004), Abdullah et al. (2004), Ebegebulem et al 2011) të cilët theksojnë në studimet e tyre ndikimin moshës së kafshës në vlerat e parametrave morfologjik.

Grafiku nr. 1/i Lidhja korelative midis RH dhe moshës




Tabela nr. 2 Vlerat e ndryshimeve statistikore të treguesve morfometrik sipas seksit

T.STAT	TREGUESIT MORFOMETRIK								
	WH	BL	NL	NC	CHC	RW	FL	FLL	RH
$P \leq$	0.302	0.33	0.057	0.464	0.004	0.954	0.423	0.159	0.478
t crit	4.303	4.303	4.303	4.303	4.303	4.303	4.303	4.303	4.303
t stat	-1.379	-0.512	4.87	-0.898	15.5	0.15	0.972	-2.2	-0.866

Tabela nr. 2 pasqyron vërtetësinë e ndryshimeve statistikore në treguesit morfometrik sipas seksit. Siç shihet nga tabela seksi ka ndikim sinjifikativ në dy tregues, gjatësia e qafës ($p \leq 0.05$) dhe perimetri i kraharorit ($p \leq 0.004$). Treguesit e tjerë morfometrik nuk paraqesin ndryshime sinjifikative. Këto të dhëna përputhen me të dhënat e autorëve të tjerë (Ifut, et al., 1991, Katongole et al. 1996, Abdullah et al. 2004, Adewunmi et al. 2008) të cilët në studimet e tyre raportojnë variacion në vlerat e treguesve morfometrik në meshkuj dhe femra. Ndryshimet në vlerat e treguesve morfometrik të lidhura me seksin mund të jenë si pasojë e lëshimit të hormonit testosteron nga testet e meshkujve të maturuar seksualisht, I cili ka

veprim stimulus në rritje (Frandsen and Whitten, 1981) . Pra, në vlerat më të larta të këtyre treguesve në meshkuj.

KONKLuzionET

Vlerat e parametrave morfometrik paraqesin ndryshime statistikore midis individëve të të njëjtit grup moshe. Moshë është një faktor i rëndësishëm në treguesit morfometrik. Vlerat e këtyre treguesve rriten me rritjen e moshës së kafshës. Koeficienti i korrelacionit variohet 0.84 – 0.94.

Midis sekseve rezultuan ndryshime statistikore vetëm për treguesit, gjatësia e qafës ($p \leq 0.05$) dhe perimetri i kraharorit ($p \leq 0.004$).

LITERATURA

1. Abdullah, A.R., Ojedapo, L.O., Adedeji, T.A., Olayeni, T.B. and Adedeji, S.O. (2004). Body Conformation Characteristics of West African Dwarf Goats in the Derived Savanna Zone of Nigeria. *Tropical Journal of Animal Science* 7 (2): 95 – 100.
2. Alderson, G.L.H. (1999). The development of a system of linear measurements to provide an assessment of type and function of beef cattle. *Animal Genetic Resources Information*, 25: 45 -55.
3. Adewunmi, O.O., Chineke, C.A., Alokun, J.A. and Onine, C. (2008). Weight and Linear Body Measurement of Yankassa, West African Dwarf Sheep and their Crosses. *Proceedings of 33rd Annual Conference of NSAP, held in Ogun State*. Pp.3-6.
4. Devendra, C. and Burns, M. (1983). *Goat Production in the Tropics*. 2Nd Edition, Farnham Royal Commonwealth Agricultural Bureau, UK. Pp.60.
5. Ebegbulem V.N., Ibe S.N., Ozung P.O., Ubuja J.A (2011) Morphometric trait characteristics of West African dwarf goats in abia state, South east Nigeria. *Continental J. Agricultural Science* 5 (2): 1 - 6,
6. Ibe, S.N. (1989). Measurement of Size and Conformation in Commercial Broilers. *Journal of Animal Breeding and Genetics*, 106: 461 – 469.
7. Ibe, S.N. and Ezekwe, A. G. (1994). Quantifying Size and Shape Difference between Muturu and N'dama breeds of Cattle. *Nigerian Journal of Animal Production*. 21: 51 – 58
8. Jeffery, H. B. and Berg, R. J. (1972). An Evaluation of Several Measurements of Beef Cow Size as related to Progeny Performance. *Canadian Journal of Animal Science* 52: 23 -37.
9. Salako, A. E. (2004). Maturity Rate of Some Morphometric Traits in the West African Dwarf Sheep of Nigeria. *Trop. J. Anim. Sci.* 7(1): 51 -55.
10. Searle, T.W., McGraham, N. and Donnelly, J.B. (1989). Breed and Sex Differences in Skeletal Dimensions of Sheep in the First Year of Life. *Journal of Agricultural Science* 113: 349 – 354.

NDRYSHIMET CITOLOGJIKE NË VICAT ME PNEUMONI PASTERELARE CYTOLOGICAL RESPONSE DURING PASTEURELLA PNEUMONIA IN CALVES

PËLLUMB ZALLA, XHELIL KOLECI, EGON ANDONI, ENKELEDA OZUNI

Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Universiteti Bujqësor i Tiranës

Departamenti i Lëndëve Morfofunktionale, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Universiteti

Bujqësor i Tiranës, SHQIPËRI

pellumbzalla@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Sëmundjet respiratore të gjedhit përbëjnë patologjitë më frekvente dhe pjesa dërmuese e tyre kanë shkakësi mikrobike. Kategoria më e prekshme janë vicat e moshës deri një vjeç. Gjatë infeksioneve bakteriale ndodh aktivizimi i imunitetit qelizor dhe atij humoral. Studimi u krye në 50 krerë viça me shenja të pneumonisë. Kampionet e marra nga rrugët respiratore (nazofaring, lavazhet trakeobronkiale) dhe mushkëritë, u izoluan dy shkaktarë bakterialë: *Mannhemia haemolitica* (14 raste në nazofaring dhe 11 raste në mushkëri) dhe *Pasterela multocida* (11 raste në nazofaring dhe 6 raste në mushkëri).

Nga lavazhi bronkiale i secilës kafshë, u pergaditën preparate histologjike të cilat u ngjyrosen me ngjyra Romanovski. Nga ekzaminimi mikroskopik i preparateve histologjike rezultoi që vlerat qelizore ishin: makrofagë 49.4 ± 5.1 , limfocite 3.87 ± 0.54 , neutrofile 47.6 ± 5.3 dhe qeliza epiteliale 0.6 ± 0.34 . Pra, kemi rënie të numrit të makrofageve dhe limfociteve dhe rritje të numrit të neutrofileve.

Fjalë kyç: gjedhë, pneumonia, *Mannhemia haemolitica*, *Pasterela multocida*, makrofagë, limfocite, neutrofile

ABSTRACT

Bovine respiratory diseases are most frequent pathologies and often they have microbial etiology. The calves aged up to one year old are at highest risk. During microbial exposure, either endogen or exogenous, respiratory tract response activation of cellular and the humoral immunity. This study was conducted on 50 calves with signs of pneumonia. From samples taken from the respiratory tract (naso-pharynx, tracheobronchial lavages) and lungs were isolated two bacterial causes: *Mannhemia haemolitica* (14 cases form naso-pharynx and 11 cases from lungs) and *Pasterela multocida* (11 cases form naso-pharynx and 6 cases from lungs).

The bronchial wash samples were used to prepare histologically smears and were stained according Romanovski method. Microscopic slides examination showed that bacterial infection induces changes in cell count values: they were as follow: macrophages 49.4 ± 5.1 , lymphocytes 3.87 ± 0.54 , neutrophils 47.6 ± 5.3 and epithelial cells 0.6 ± 0.34 . It was a clear that there is obviously decreasing the number of macrophages and lymphocytes and increasing number of neutrophils.

Keywords: calves, pneumonia, *Mannhemia haemolitica*, *Pasterela multocida*, macrophages, lymphocytes, neutrophils

HYRJE

Sëmundjet respiratore akute të padiferencuara të gjedhit (SRAPGj) janë sëmundjet më të shpeshta për gjedhin me drejtim prodhim qumështi apo mishi. Morboziteti nga sëmundjet respiratore raportohet në vlerat 65-79 %, ndërsa mortaliteti varion, kështu 44-72 % të rasteve të ngordhjeve të gjedhit janë pasojë e këtyre sëmundjeve (Otto M. Radostits *et al*, 2007).

Pjesa e sipërme e aparatit frymëmarrjes krahas funksioneve të tjera shërben edhe si rezervuarë i mikroflorës rezidente dhe asaj tranzitore. Përbërja e kësaj flore ndikohet nga mjedisi dhe specia. Për më shumë, aerosoli i mjedisit të kontaminuar shkakton ekspozimin e traktit respirator ndaj mikroorganizmave patogjenë. Kjo situatë është e shpeshtë sidomos gjatë pneumonisë enzootike të viçave si edhe në situatën ku një numër i madh kafshësh ndajnë midis tyre një hapsirë të vogël në mjedise me ventilim të pamjaftueshëm dhe qëndrojnë në kondita higjienike të papërshtatshme. Në kushte normale, parenkima e mushkërive është bakteriologjikisht sterile. Grimcat bërthamore 1- 2 µm kalojnë në bronket respiratore dhe në hapsirën alveolare, por fagocitohen nga makrofagët alveolarë dhe ose nga neutrofilet. Pastrimi i qelizave të vdekura fagocitare nga pjesa terminale e traktit respirator zakonisht arrihet nga kombinimi i kollës dhe i aktivitetit mukociliar (Quinn *et al*, 2013).

Indi limfoid bronkial përmban njëkohësisht limfocitet T dhe B dhe është prezent në mukozë dhe submukozë në të gjithë nivelet e traktit respirator. Qelizat plazmatike që janë derivate të limfociteve B sekretojnë IgA në sipërfaqen e mukozës e cila bllokon adezionin e agjentëve bakterial dhe adsorbimin e agjentëve viral në receptorët specifik qelizorë. Përqëndrimi i IgA, është më i lartë në pjesën e sipërme të traktit respirator se në atë të poshtme, koncentrimi rritet gjatë përgjigjes inflamatore. Përqëndrimi i IgG është më i lartë se IgA në bronket respiratore dhe në alveola. IgG vepron në këtë nivel si opsoninë dhe ndihmon makrofagët alveolarë për një fagocitozë më efektive. Gjithashtu, likuidi alveolarë përmban surfaktant i cili veç funksionit tensioaktiv, vepron si opsonizues, njëllor si edhe IgG (Liggitt HD *et al* 1985, Quinn *et al*, 2013).

Pavarsisht faktorëve të mësipërm mbrojtës, sëmundjet respiratore përbëjnë një nga patologjitë me ndikim ekonomik negativ në industrinë e gjedhit. Patologjia më e rëndë por edhe me e shpeshtë është bronkopneumonia. Bronkopneumonitë bakteriale zakonisht kanë origjinë aerogene. Faktorët predispozues janë infeksionet virale apo mykoplazmatike të traktit respirator dhe faktorët stresues mjedisor që inhibojnë mekanizmat e klerancës respiratore dhe kompetencën imunitare. Lokalizimi i lezioneve në mënyrë karakteristike përfshijnë rajonet kraniventrale të mushkërive Në brendësi të lobulit të prekur ndodhin procese të tilla si infiltrimi neutrofilik dhe eksudimi serofibrinöz. Ato shtrihen nga vatra fillestare në alveolat dhe bronket përreth. Rezultati përfundimtar i bronkopneumonisë varet nga virulenca e shkaktarit dhe nga shkalla e përgjigjes inflamatore. Kur membrana bazale alveolare mbetet e padëmtuar dhe eksudati eliminohet shpejt është i mundshëm riparimi i plotë strukturor dhe funksional indeve të prekura. Në shumicën e rasteve, si rrjedhojë e shtrirjes masive të lezionit origjinal zhvillohet inflamacion supurativ kronik dhe fibrozë e vatrës primare. Në bronkopneumonitë kronike shenjat klinike respiratore mund të shprehen minimalisht, megjithatë dëmet ekonomike mund të jenë të konsiderueshme si rrjedhojë e uljes së produktivitetit të kafshëve të tufave të prekura. Reaksioni inflamator përhapet shpejt në indin pulmonar dhe shpesh përfshin lobin si të tërë. Pneumonitë këtij tipi shkaktohen nga shkaktarë virulentë si *Mannheimia haemolytica* dhe *Pasteurella multocida* (Quinn *et al*, 2013).

Studimi u fokusua në vlerësimin e ndryshimeve qelizore në përmbajtjen e lavazheve bronkio-alveolare dhe në izolimin e agjentëve patogjenë bakterial.

MATERIALI DHE METODA

Në studim u morë 100 vica 50 me shenja të sëmundjeve respiratore dhe 50 pa shenja respiratore. Kampionet u prelevuan si nga kafshët e sëmura dhe ato të shëndosha: si mostra

shërbyen tampon nazal, lavazhe bronkiale dhe inde pulmonare nga kafshët në studim që u therrën. Nga kampionet e mbledhur u tentua izolimi i agjentëve bakterial duke përdorur terrene e përshtatshme agar-gjak dhe agar MacConkey. Agjentët e izoluar u identifikuan duke përdorur metoda klasike bakteriologjike, bazuar në: krakteristikat e kolonive të *Pasteurella multocida* dhe *Mannhemia hemolytica*, rezultatet e testit të oksidazës, rezultatet e ngjyrimi sipas metodës së Gramit, ndërsa metoda Gimsa u përdor në kampinet e marra nga indi pulmonar për të vënë në dukje bipolaritetin karakteristik.

Analiza citologjike. Nga mushkëritë me lezione, u morën lavazhe bronkiale dhe u analizuan me tej për të përcaktuar ndryshimet qelizore. Për përcaktimin e ndryshimeve citologjike, u përdor 50 ml lavazh fluid, u centrifugua me 2000 rpm për 10 minuta dhe precipitati pas risuspendimit me 0,5 ml NaCl u analizua më tej, duke përgatitur strisho mikroskopike në lamë. Preparatet histologjike u përgaditën sipas protokollit standard dhe u ngjyrosën sipas metodës Romanovski. Kufiri limit për të përcaktuar raportin e qelizave në kafshët me shenja klinike respiratore dhe ato pa shenja respiratore u vendos limiti 200 qeliza.

REZULTATET DHE DISKUTIMI I TYRE

Rezultatet bakteriologjike mbi shkaktarët bakterial themelor përshkruhen në tabelën 1, ndërsa rezultatet citologjike paraqiten në tabelën 2.

Tabela nr. 1 Rezultatet bakteriologjike

	Viça me shenja respiratore (50)		Viça pa shenja respiratore (50)	
	Mushkëri	Nazofaring	Mushkëri	Nazofaring
Izolimi i <i>P.multocida</i>	6	11	-	4
Izolimi i <i>M.haemolytica</i>	11	14		12
Totali	17	25		16

Tabela nr. 2 Rezultatet citologjike

Tipi i qelizave	Viça me shenja respiratore		Viça pa shenja respiratore	
	Mesatarja	Dev.standard		
Makrofagë	49.4	5.1	63.4	3.67
Limfocite	3.87	0.54	4.95	0.64
Neutrofile	47.6	5.3	25.8	4.2
Qeliza epiteliale	0.6	0.34	2.4	0.56

Rezultatet e provave kulturore tregojnë se në rrugët e sipërme dhe të poshtme të frymëmarrjes të viçave me sëmundje respiratore ishin të pranishëm një shumëllojshmëri mikroorganizmash. Këto rezultate ka të ngjarë të pasqyrojnë nivelin e lartë të ekspozimit ndaj faktorëve riskues dhe agjentëve infektiv. Izolimi i agjentëve mikrobikë *Pasteurella multocida* dhe *Mannhemia hemolytica*, në indin pulmonar janë tregues i shkakësisë bakteriale, por kjo është e pamjaftueshme për identifikimin nëse ato përbëjnë shkakësi primare apo sekondare. Nga trakti i sipërm respirator u izolua *Pasteurella multocida* dhe *Mannhemia hemolytica*, në të dy grupet e viçave në studim, ndërsa nga indi pulmonar agjentët e mësipërm u izoluan vetëm në viçat me shenja respiratore. Të dy shkaktarët e mësipërm u izoluan më shpesh nga kampionet e marrë në nazofaring (50%) krahasuar me ato të mushkërive (34%), Tabela 1. Agjenti i izoluar më shpesh në mostrat pulmonare rezultoi *M.haemolytica* (22%), krahasuar

me *P.multocida* (22%). Për me tepër *M.haemolytica* rezultoi më shumë e pranishme edhe në kampionet e marra nga nazofaring (Tabela 1).

Prania e *Pasteurella multocida* dhe *Mannheimia hemolytica* justifikojnë edhe ndryshimet qelizore në lavazhet bronkioalveolare. Studimi ynë tregoi se ekziston një rritje sinjifikative të numrit të neutrofileve dhe një ulje të numrit të makrofagëve (Tabela 2). Numri dhe lloji i qelizave të lëngut BA janë tregues të dobishme të inflamacionit të mushkërive (Quinn *et al*, 2013, Walker *et al*, 1985). Raporti normal i makrofagëve me neutrofilet në fluidin BA arrin deri 10: 1, megjithatë, në viça me sëmundje respiratore përqindja e neutrofileve rritet në mënyrë të tillë sa ky raport mund të përmbysset deri në vlerat 1:10 (Walker *et al*, 1985, Lopez *et al* 1986).

Numri i limfociteve, nuk tregon ndonjë ndryshim sinjifikativ, pavarësisht se ekziston një rënie e lehtë në vlera mesatare. Kjo gjendje mund të lidhet me ekspozimin e individëve në studim me faktorë stresues. Megjithatë, duhet theksuar se në disa individë u evidentua një rritje 3-4 herë mbi mesataren e numrit të limfociteve, ndoshta kjo mund të lidhet me qarkullimin e ndonjë infeksioni viral (Ligitt, 1985).

Ndryshimet qelizore janë një tregues me vlerë jo vetëm për shkallën e inflamacionit por edhe mbi momentin e ndëhyrjes mjekuese dhe kursin e terapisë. Studime të tjera janë në vazhdim në lidhje me praninë e shkaktarëve të tjerë mikrobikë, ndjeshmërinë e tyre ndaj antimikrobikëve dhe analizimin gjenetik të shkaktarëve

LITERATURA

1. Liggett HD (1985). Defense mechanisms in the bovine lung. Symposium on bovine respiratory disease. Vet Clin North Am Food Anim Pract; 1: 347-366.
2. Lopez A, Maxie Mg, Ruhnke L, Savan M, Thomson RG (1986). Cellular inflammatory response in the lungs of calves exposed to bovine viral diarrhoea virus, Mycoplasma bovis, and Pasteurella haemolytica. Am J Vet Res; 47: 1283-1286.
3. Otto M, Radostits, Clive C. Gay, Kenneth W. Hinchcliff and Peter D. Constable (2007). Respiratory disease in Veterinary Medicine, Veterinary Medicine: A textbook of the diseases of cattle, horses, sheep, pigs and goats, Xth edition pg 899-915.
4. P. J. Quinn, B. K. Markey, F. C. Leonard, P. Hartigan, S. Fanning, E. S. FitzPatrick (2011) *Pasteurella* and *Mannheimia* species in Veterinary Microbiology and Microbial Disease Textbook, second edition, 300-307
5. Walker RD, Hopkins FM, Schultz TW, Mccracken MD, Moore RN (1985). Changes in leukocyte populations in pulmonary lavage fluids of calves after inhalation of Pasteurella haemolytica. Am J Vet Res; 46: 2429-2433. 24.

LARINGO -TRAKEITI INFEKTIV I SHPENDËVE NË SHQIPËRI
POULTRY INFEKTIV LARYNGO -TRACHEITIS IN ALBANIA
FLORIAN GJONI¹, JASEMIN BEJLERI¹, PETRO GJONI¹, VALBONA GJONI²,
JULJANA RADO³

¹ Veterinary Private Section.

² Control of Infectious Diseases Department,
Institute of Public Health. Aleksandër Moisiu Str. 80.

³ Animal Health Department, Institute of Food Safety and Veterinary,
Aleksandër Moisiu Str.82. TIRANA, ALBANIA.

E-mail: florian.gjoni@yahoo.com

ABSTRACT

Avian infectious laryngotracheitis (ILT) is the viral respiratory infection of poultry. Infectious virus (*gallid herpesvirus 1*) is a member of the family *Herpesviridae*, subfamily *Alphaherpesvirinae*, genus *Varicellovirus*. ILT is world-wide distributed but the greatest incidence is generally seen in areas of highly intensive poultry production.

Aim: To assess the presence of poultry ILT in Albania territory.

Methods: The diagnose of LTI disease was established by histopathology, microscopic detection of intranuclear inclusion bodies Coudry-A in epithelial cells, reaction of precipitation on agar-gel immunodiffusion method too.

Resultes: Before 1941 there have been known sporadic cases of LTI. By investigations until 2005, 37.8 % of controlled chickens, resultet positive. The presence of antibodies in the blood indicates the circulation of virus strains apatogjene's LTI. 2005-2010, LTI's disease, broke into three foci which had economic and commercial links between them and affected chickens in ages from 50-80 weeks. In unvaccinated economies against LTI 's economic losses resulted on 18.6 % of the Mortality and 35.74 % egg production decreased within an average period of 31 days. In vaccinated economy against LTI 's, the mortality was 2.52 % (about 8.5 times less) and egg production 8.55 % (4 times less) . This shows the protective power of the vaccine .

Conclusions: ILT disease remains a constant threat through outbreaks originating from chickens on production sites which are reservoirs of ILTV infection. In the geographic regions that are free of ILT, should be taken measures to prevent introduction of the virus.

Keywords: *Avian infectious laryngotracheitis virus*, *Gallid herpesvirus 1*.

HYRJE

Laringotrakeiti infektiv i shpendëve (LTI), është një infeksion viral i aparatit respirator, që shkakton humbje të rënda ekonomike si rezultat i ngordhjeve të shumta dhe uljes së prodhimit të vezëve. Sëmundja është e përhapur në të gjitha shtetet (Rajoni i Paqësorit, Australi, Zelandë e Re, Kiribati etj.), që kanë një avikulturë të tipit industrial të zhvilluar. (6, 8, 12). Shkaktari i sëmundjes është një anëtar i *Familjes Herpesviridae*, të nënfamiljes *α-herpesvirinae*, gjinia *Varicellovirus*. Virusi nga ana taksonomike është identifikuar si *Gallid herpesvirus 1*. Morfologjia dhe struktura e virusit të LTI-së është tipike e herpesvirusit (16, 25). Virusi qëndron gjatë në organizëm për shumë muaj dhe vite. Në mjedisin e jashtëm ai ka rezistencë të ulët dhe shkatërrohet shpejt nga dezinfektantët e ndryshëm. Gjatë kultivimit “*in vitro*”, virusi inaktivohet në 60°C për afërsisht 15 minuta (16, 32). Speciet që preken nga LTI janë pulat, fazanët, gjelat e detit dhe pallojtë. Replikimi i virusit aktiv ndodh një javë pas infeksionit, ndërsa izolimi i virusit nga zogjtë e ngordhur afërsisht 10 ditë pas infeksionit, (15, 20, 31). 10 ditë deri 4 javë pas infeksionit trakeal, zhvillohet faza latente gjatë së cilës invadohen indet nervore. Përdorimi i metodave të PCR-së nga Williams (28), ka konfirmuar se ganglioni trakeal është vendi kryesor ku zhvillohet virusi i LTI-së në fazën latente.

Zakonisht sëmundja konstatohet më shpesh në shpendët e moshës 3-9 muaj. Shumica e shtameve të veçuar janë shpesh patogenë dhe shfaqin diferenca në virulencë. Shenjat klinike: rinit, edemë e kokës, vështirësi frymëmarrjeje, rënie prodhimtarie, anoreksi, eksudat trakeal hemorragjik i cili mund të pushtojë sqepin, pneumoni ose bronkopneumoni (Fig.1, 2, 3). Shërimi i shpendëve ndodh pas 2-4 javëve.

Fig.1 Pulë me rinit dhe edemë të kokës



Fig.2 Pulë që paraqet vështirësi në frymëmarrje



Fig.3 Eksudat hemorragjik që ka pushtuar trakenë



Transmetimi i sëmundjes bëhet: nëpërmjet kontaktit me shpendët e sëmurë (4, 5, 7, 9). Në kushtet natyrale, kontaminimi bëhet kryesisht me rrugë aerogjene, por edhe me anë të ushqimit, ujit, jashtëqitjeve si dhe veshmbathjeve të personelit të shërbimit. (30, 31). Nuk ekzistojnë të dhëna për transmetimin e infeksionit me rrugë transovariale. Metodat diagnostike të përdorura për konfirmimin e diagnozës sipas OIE (26) dhe Tripathy (27) janë: ekzaminimi histologjik i trakesë (10), zbulimi i virusit në embrionet e vezëve të pulës, zbulimi i antitropave specifike në gjak (ELISA, Precipitim në Agar-Xhel, Prova e Virus Neutralizimit dhe Imunofluoreshenca). Në praktikën laboratorike, diagnoza më e shpejtë është zbulimi i invazioneve intranukleare të tipit *Cowdry-A* specifike të herpesvireve në qelizat e mukozës së trakesë dhe i antikorpeve specifike me metodën e seroprecipitimit në agar xhel (11, 13). Në rastet e infeksioneve kronike dhe asimptomatike zbulimi i antitropave në gjak tregon për praninë e infeksionit të LTI-së (Fig. 4, 5, 6).

Fig. 4 Inkluzione intraqelizore të qelizave epiteliiale trakeale




Fig. 5 Inluzion intraqelizor i tipit Coudry A (Ngjyrimi me hematoksilinë eozinë)





Fig. 6 Konfirmimi i pozitivitetit të diagnozës me metodën e precipitimit (difuzionit në agar-xhel)



Diagnoza diferenciale duhet bërë me: pseudopestin, bronkitin infektiv, influencën avjare, pasterelozat, coryzën, infeksionet respiratore të shkaktuara nga adenoviruset, format diferike e linë, mykoplazmat, aspergilozat dhe avitaminozat A.

Përgjigja imune: Vaksinimi i parë me vaksinë të modifikuar siguron mbrojtje të pjesëshme për 3-4 ditë pas ekspozimit dhe mbrojtje të plotë një javë më pas. (14, 19, 24). Nivelet më të larta të mbrojtjes sigurohen 15-20 javë pas vaksinimit. Rivaksinimi me vaksinë të gjallë mund ose jo të ndihmojë në ruajtjen e imunitetit. (24, 17, 29). Parandalimi i sëmundjes së LTI-së bëhet me imunizimin e shpendëve dhe aplikimin e masave të biosigurisë, me një vaksinë të gjallë të dobësuar. Është e këshillueshme që vaksinimet kundër LTI-së, të bëhen vetëm në ekonomitë që mbarështojnë shpendë në zonat e sëmundjes (33).

Qëllimi i studimit të ndërmarrë, ishte që të vlerësohej prania e LTI-së në Shqipëri.

MATERIALET DHE METODAT

Si materiale patologjike shërbyen serume dhe materiale histopatologjike nga traketë e pulave të ngordhura. Për vendosjen e diagnozës u përdorur metoda histopatologjike, ngjyrimi dhe kontrolli mikroskopik i materialeve të prelevuara nga traketë dhe metoda e imunodifuzionit në agar-xhel e aplikuar për zbulimin e At të LTI-së në serume.

REZULTATET

Në Shqipëri sëmundja e LTI para Vitit 1941, ka patur të dhëna të pakonfirmuara për disa raste klinike. Pas këtij viti dhe deri në Vitin 2005 nuk ka patur raste të sëmundjes me shfaqje klinike te saj. (1, 2).

Nga 1998-2002 dhe 2004-2005, kontrollet e kryera në 18 ekonomi me rritje të përqëndruar të pulave, në 8 rrethe të vendit (Tiranë, Durrës, Kavajë, Shkodër, Elbasan, Fier, Berat, Peshkopi), në 2723 krerë të kontrolluar, kanë rezultuar pozitive 1016 (37.3%) prej tyre (3), dhe infeksioni ka qenë i formës subklinike. Në formën e saj klinike akute, sëmundja u shfaq për herë të parë, në rrethin e Durrësit, në muajin Korrik të Vitit 2005 në shpendë të pavaksinuar kundër LTI-së. U prekën pulat nga mosha 17-86 javë. Dëmtimet kapnin mesataren 17.84% të krerëve. Prodhimi i vezëve pati humbje mesatare 39% që vazhdoi për 5-6 jave, piku minimal i prodhimit arriti mesataren 7.78%. Në zogjtë e sapofutur në prodhim piku maksimal i prodhimit u vonua 18-32 ditë, me mesatare 26 ditë. Në Vitin 2006 në një distancë rreth 20 km ajrore nga vatra e parë, u shfaq vatra e dytë e sëmundjes. Ndërmjet të dy vatrave kishte lidhje ekonomike dhe tregëtare. Infeksioni u konstatua në pula të moshës 115 javë, të pavaksinuar kundër sëmundjes. Shenjat klinike ishin të njëjta si në vatrën e parë. Sëmundja u vlerësua e formës subakute. Shpendët e moshës 15 javë më parë i qenë nënshtruar mudës artificiale. Sëmundja për 38 ditë shkaktoi 32% humbje në krerët dhe humbje 38.6% të prodhimit të vezëve për 50 ditë. Prodhimi më i ulët i vezëve arriti 6.9%. Virulenca e shtamit të LTI-së ishte e lartë. Rishfaqja e sëmundjes së LTI-së, në përgjithësi e tipit subakut, rishtas në vatrën e parë, u vërejt pas 3 vitesh (2008-2009), në pula të vaksinuara (me dy ndërhyrje) me vaksinë kundër LTI-së, qysh kur kishin qenë zogj, në moshat 23 dhe 90 ditë. Dëmtimet qenë të moderuara. U prekën pula të moshës 30-104 javë. Në pulat pjellëse u vërejt ulje prodhimi me mesatare 10.5%. Pati raste të shoqërimit të LTI-së me infeksione sekondare (Pseudopest dhe *E. Coli*), të cilat ndikuan në rritjen e dëmtimeve si në krerë edhe në prodhim. Për luftimin e infeksionit nga *E. Coli* krahas vaksinimit me dy ndërhyrje në zogj 23 dhe 90 ditësh, u krye edhe trajtimi me antibiotikë i krerëve. Vatra e tretë e sëmundjes u konstatua gjatë muajit Gusht 2010, në një ekonomi tjetër me pula të pavaksinuar ndaj LTI-së, të moshës 74 javëshe. Edhe kjo ekonomi kishte lidhje tregëtare me vatrën e parë të sëmundjes. Sëmundja u shfaq me shenjat karakteristike të sëmundjes. Diagnoza laboratorike në laboratorët e ISUV, konfirmoi dyshimet në diagnozën klinike sëmundjes. Sëmundja u vlerësua e formës subakute. Nga sëmundja për 19 ditë rrjesht, ekonomia pati një dëm prej 1.000000 lekë nga humbjet në krerë dhe një dëm tjetër prej 5.000000 lekë nga humbja e prodhimit. Ngordhën 5.97% e krerëve. Prodhimi i vezëve për 16 ditë u ul nga rreth 70% që ishte në fillim të sëmundjes, në 26.22% ndërsa për periudhën 32 ditore të sëmundjes ishte në vlerën 29.55%. Pas kësaj date filloi ngritja e prodhimit por, niveli i përgjithshëm i prodhimit, mbeti me rreth 20% më i ulët.

DISKUTIME

Në një vështrim të përgjithshëm të situatës së sëmundjes së LTI-së në Shqipëri, vërehet se para Vitit 1941, ka patur disa raste të LTI-së në pula. Pas këtij viti deri në Vitin 2005, është konstatuar një pozitivitet prej 37.8% e sëmundjes, por pa shfaqje të shenjave klinike. Në periudhën 2005-2010, sëmundja shpërtheu në tre vatra, me shenjat e saj karakteristike klinike dhe anatomo-histopatologjike. Të tre vatrat e sëmundjes, kanë patur lidhje ekonomike e tregëtare midis tyre. Sëmundja është shfaqur në format akute dhe subakute por në përgjithësi me leziona të moderuara. Janë prekur krerë të moshës 17-115 javë, me predominim më shumë në moshat nga 50-80 javë. Në ekonomitë e pavaksinuara kundër LTI-së, dëmtimet në krerë për të tre vatrat, kanë qenë në një mesatare prej 18.6% e krerëve në tufë, me limite nga 5.3%-32%. Këto dëmtime kanë ndodhur brenda një periudhe mesatare prej 31 ditësh (limitet 19-38 ditë). Në ekonominë ku ishte kryer vaksinimi kundër LTI-së, dëmtimet në krerë kapnin mesataren 2.52% (limitet 0.36-0.92%), pra 8.5 herë më pak gjë që tregon për fuqinë mbrojtëse të vaksinës. Në ekonomitë e pavaksinuara kundër LTI-së, humbjet në vezë gjatë kohës së sëmundjes kapnin mesataren 35.74% (limitet 29.55-44.5%), brenda një periudhe prej 44 ditësh (limitet 30-50 ditë). Në vatrën e vaksinuar kundër LTI-së, duke përjashtuar ato me bashkëshoqërim me pseudopestin, humbjet në vezë nga sëmundja kanë qenë në mesatare 8.55% (limitet 3.5-14.1%). Krahasuar me ato të pavaksinuara, humbjet në vezë kanë qenë, katër herë më pak. Në lokalet me praninë veç LTI-së edhe të pseudopestit, dëmtimet në vezë kanë qenë të larta (21.7-55%) sepse, të dy infeksionet ndikojnë në prodhimin e vezëve.

KONKLUZIONE

Gjendja epizootike e vendit, flet për qarkullim të LTI në shpendët e disa ekonomive të përqëndruara që herë pas here shpërthen sëmundjen në trajtën e saj klinike. Rekomandohet përmirësimi i punës për forcimin e rregullave karantinore në qarkullimin e shpendëve, ambalazheve të ushqimeve dhe njerëzve nga njera ekonomi në tjetrën, ruajtja e ekonomive të pastra nëpërmjet evitimit të çdo kontakti me tufat e vaksinuara apo që kanë kaluar sëmundjen, nëpërmjet një karantine strikte, furnizimi me zogj nga ekonomi me tufa prindërore të pastra nga LTI. kryherje kontrollesh laboratorike periodike për prezencën e LTI-së në ekonomi. Në rast qarkullimi të virusit të përdoret vaksinimi i tufave. Të kryhen me rigorozitet masat sanitaro-veterinare në ekonomitë e kontaminuara nëpërmjet depopullimit të lokaleve, pastrimit, dezinfektimit dhe lënies bosh për 4-6 javë para futjes së shpendëve të rinj. Të bëhet vaksinimi i shpendëve në ekonomitë e infektuara. Vaksinimi të kryhet në zogjtë 4-5 javësh dhe në tufat e vezëve përsëritet në moshën 8-12 javëshe.

LITERATURA

1. Rroku C., Pavli E. Teknika Histopatologjike. 1979.
2. Bejleri J., 2003. Sëmundjet e shpendëve.
3. Bejleri J., Qafmolla L., Duka S., Buletini i Shkencave Bujqësore Nr. 13, Vol. 9 2010. LTI në shpendë dhe situata epizootike e tij në vendin tonë.
4. CALNEK B.W., 1997. Patologia aviare, 10 edizione italiana.
5. Whiteman and Bickford A.A. 1979. Avian Disease Manual. Third edition.
6. Gordon R.F., 1979. Pathologie des volailles.
7. Herceg Mc.call. 1971- La laringotracheite virale nei polli. Sel. Vet. 1972,3,119.
8. Gusev V.F. & Kononov G.A. 1969, "Spravočnik po boljeznam ptie".
9. Avian Disease Manual- Third Edition- (The American Association of Avian Pathologists).
10. William J Bacha, Jr. and Linda M.Bacha. Color Atlas of Veterinary Histology. Second Edition, 2000.
11. John Crocker, David Burnett. The science of Laboratory Diagnosis. Second Edition, 2005.

12. Sezdan F.T.W., 1990. Poultry Diseases.
13. Manual of Veterinary Investigation Laboratory Techniques. Vol. 2. Third Edition 1984.
14. Bagust T.J. - Laryngotracheitis (Gallid-1) herpesvirus infection in the chicken. 4. Latency establishment by wild and vaccine strains of ILT virus. *Avian Pathol.*, 15. (1986).
15. Bagust T.J., Calnek B.W. & Fahey K.J. - Gallid-1 herpesvirus infection in the chicken. 3. Reinvestigation of the pathogenesis of infectious laryngotracheitis in acute and early post-acute respiratory disease. *Avian Dis.*, 30. (1986).
16. Bagust T.J. & Guy J.S. - Laryngotracheitis. In Diseases of poultry, 10th Ed. (B.W. Calnek with H.J. Barnes, C.W. Beard, L.R. McDougald & Y.M. Saif, eds). Iowa State University Press, Ames. (1997).
17. Fahey K.J. & York J.J. - The role of mucosal antibody in immunity to infectious laryngotracheitis virus in chickens. *J. gen. Virol.*, 71. (1990).
18. Guy J.S., Barnes H.J. & Smith L.G. (1990). - Virulence of infectious laryngotracheitis viruses: comparison of modified-live vaccine viruses and North Carolina field isolates. *Avian Dis.*, 34.
19. Hitchner S.B. (1975). - Infectious laryngotracheitis: the virus and the immune response. *Am. J. vet. Res.*, 36.
20. Hitchner S.B., Fabricant J. & Bagust T.J. (1977). - A fluorescent antibody study of the pathogenesis of infectious laryngotracheitis. *Avian Dis.*, 21.
21. Biggs P.M. - The world of poultry disease. *Avian Pathol.*, 11. (1982).
22. Jordan F.T.W., Evanson H.M. & Bennett J.M. - The survival of the virus of infectious laryngotracheitis. *Zentralbl. Veterinärmed.*, B, 14. (1967).
23. Clark J.K., Robertson G.M. & Purcell D.A. - Spray vaccination of chickens using infectious laryngotracheitis vims. *Aust. vet.J.*, 56. (1980).
24. Jordan F.T.W. (1981). - Immunity to infectious laryngotracheitis. In Avian immunology (M.E. Ross, L.N. Payne & B.M. Freeman, eds). British Poultry Science Ltd, Edinburgh.
25. Murphy F.A., Fauquet C.M., Bishop D.H.L., Ghabrial S.A., Jarvis A.W., Martelli G.P., Mayo M.A. & Summers M.D. (eds) (1995). - Virus taxonomy: classification and nomenclature of viruses. Sixth report of the International Committee on Taxonomy of Viruses. Springer-Verlag, Vienna and New York, 586 pp.
26. Office International des Epizooties (OIE) (1996). - Manual of standards for diagnostic tests and vaccines, 3rd Ed. OIE, Paris, 723 pp.
27. Tripathy D.N. (1998). - Infectious laryngotracheitis. In Isolation and identification of avian pathogens, 4th Ed. (D.E. Swayne, J.R. Glisson, M.W. Jackwood, J.E. Pearson & W.M. Reed, eds). American Association of Avian Pathologists, Inc., Pennsylvania.
28. Williams R.A., Bennett M., Bradbury J.M., Gaskell R.M., Jones R.C. & Jordan F.T.W. (1992). - Demonstration of sites of latency of infectious laryngotracheitis virus using the polymerase chain reaction. *J. gen. Virol.*, 73.
29. York J.J., Young J.G. & Fahey K.J. (1989). - The appearance of viral antigen and antibody in the trachea of naïve and vaccinated chickens infected with infectious laryngotracheitis virus. *Avian Pathol.*, 18.
30. Guy, J.S and Garcia, M. Laryngotracheitis. In: Diseases of Poultry, 12th Edition (eds. Saif, Y.M., Fadly A.M., Glissen J.R., McDougald L.R., Nolan L.K., Swayne D.E.) *Wiley-Blackwell.* (2008).

**NJË STUDIM PARAPRAK I MARDHËNIES GJATËSI- PESHË TË SALMO
LETNICA (KARAMAN, 1924) PËR ANËN SHQIPTARE TË LIQENIT.
A PRELIMINARY STUDY ON LENGTH- WEIGHT RELATIONSHIP OF SALMO
LETNICA (KARAMAN, 1924) FOR THE ALBANIAN LAKE SIDE.**

VIOLA PRIFTI¹, ILIR PALLA²

^{1,2}“Fan Noli” University, Korçë, ALBANIA

¹viola.prifti@live.com

²pallailir@yahoo.com

ABSTRAKT

Në ciklin e tyre të jetës, sidomos në fazat e hershme të jetës, peshqit kalojnë nëpër faza të ndryshme të rritjes me modele të ndryshme të mardhënies gjatësi-peshë. Mardhënia gjatësi-peshë është analiza më e zakonshme e përdorur që aplikohet për disa qëllime në fushën e peshkimit, ndër të cilat vlerësimi i peshës nga gjatësia është një nga më të popullarizuarat. Ky studim është bërë për të analizuar marrëdhënien gjatësi-peshë të troftës së Liqenit të Ohrit, *Salmo letnica* (Karaman, 1924). Gjatësia totale dhe pesha e trupit në mostrat e studiuara, është vërejtur të ndryshojë mes individëve të marrë nga vende të ndryshme të përcaktuara në përputhje me objektivat e studimit. Vlerat e peshës ndryshojnë nga 200 g deri 1100 g dhe gjatësia e përgjithshme e trupit nga 26 cm deri në 56 cm. Peshqit janë ndarë në dy grupe; të egër dhe të kultivuar në ekonomi, për të përfunduar me rezultate krahasuese. Nga matjet është llogaritur koeficienti i regresit dhe koeficienti i korrelacionit. Qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizojë karakterizimin e rritjes së koranit, *Salmo letnica*, bazuar në mardhënien gjatësi- peshë.

Fjalë kyçe: *Salmo letnica, relacioni gjatësi-peshë, gjatësi totale, peshë e trupit, koeficienti i regresit, koeficienti i korrelacionit*

ABSTRACT

In their life cycle, especially at early life stages, fishes pass through distinct growth phases with different length-weight relationship patterns. Length-Weight relationship is the most commonly used analysis which has been used for several purposes in fisheries field among which estimation of weight from length is the most popular one. The present study has been performed to analyse the length-weight relationship of Lake Ohrid trout, *Salmo letnica* (Karaman, 1924). Total Length and Body Weight of the studied specimens have been observed to vary individuals from different locations defined according to the objectives of the study. The weight value vary from 200 g to 1100 g and the total length from 26 cm to 56 cm. The fishes were divided into two groups; the wild and hatcheries to conclude compared results. From the measurements the regression coefficient and the correlation coefficient has been calculated. The main purpose of this paper is to analyse the growth characterization of *Salmo letnica*, based on the length- weight relationship.

Key words: *Salmo letnica, Length-Weight relationship, total length, body weight, regression coefficient, correlation coefficient*

INTRODUCTION

In the fishery biology and taxonomic studies, the morphometric measurements and statistical relationships of fishes have a main importance (Tandon et al 1993; Simon et al 2010a). Length-weight relationship is a significant tool in fish biology, physiology, ecology, fisheries assessment and fish conservation. These studies are used as a tool for fish conservation in several parts of the world providing information on the condition, growth pattern, ontogenic changes and in fish population dynamics (Oscoz et al 2005; Simon et al 2009).

Length-weight relationships give information on the condition and growth patterns of fish (Bagenal and Tesch, 1978). Fish are said to exhibit isometric growth when length increases in equal proportions with body weight for constant specific gravity. The regression co-efficient for isometric growth is '3' and values greater or lesser than '3' indicate allometric growth (Gayando and Pauly, 1997).

To analyse the data on the length- weight relationship it is possible to use also the bootstrapping method. The bootstrap is a general approach to statistical inference based on building a sampling distribution for a statistic by re- sampling from the data. (Efron and Tibshirani 1993).

Salmo letnica, Lake Ohrid trout, is an endemic specie and one of the most important fish for the both transboundary countries Albania and Macedonia. It has an economic importance but at the same time it is object of so many studies about its development biology in the habitat. Since 1935 is founded a program of artificial fecundation of Lake Ohrid trout for the Macedonian part and latter even for Albanian part. According to these activities every year the water of Lake Ohrid is populated with millions of parrs. The main propose of this paper is to make a preliminary analyse to the development stages of wild and cultivated fish.

MATERIALS AND METHOD

Salmo letnica is one of the most important endemic species of Lake Ohrid. Its development biology has a great importance for both littoral countries Albania and Macedonia. For this study we defined two areas receiving the Koran individuals; private economy of cultivation of trout in Zagorcan and part of the lake shore in Pogradec (fig. 1). The specimens were measured and for each of them we took notes about the morphological aspects and possible visible differences. We measured the total length and weight for 18 cultivated individuals in Zagorcan. The same measurements we did also for 30 wild individuals from Lake Ohrid, Albanian side.

The L-W relationship was analyzed by using the equation $W = aL^b$ (Pauly, 1983). In this equation the W is the total weight of fish in gram; L represent total length of fish in cm; the coefficient a is the intercept of the graph and its value describes the rate of change of weight with length related to body form; the coefficient b is the slope of the graph and its value describes the weight at unit length.

The equation was log transformed in $\log W = \log a + b \log L$, to estimate the parameters ' a ' and ' b '. When b is equal to three (3), isometric pattern of growth occurs but when b is not equal to 3, allometric pattern of growth occurs. Fishes exhibit positive allometric growth when b is greater than 3 and negative allometric growth when b is lesser than 3.




Fig. 1. Schematic presentation of Lake Ohrid and the study sites.

RESULTS

Analysing the measurements we organized the values in the tables bellow. Table number 1 shows the values of the fishes cultivated in the private economy in Zagorcan. Table number 2 presents the results of measurements from wild fishes.

Tab.1 The minimum, the maximal and mean values of fishes from private economies in Zagorcan.

	<i>Minimum value</i>	<i>Maximum value</i>	<i>Mean value</i>
<i>Length (cm)</i>	26	56	34.80
<i>Weight (g)</i>	230	1100	482.77

Tab.2 The minimum, the maximal and mean values of fishes from Lake Ohrid, Albanian side.

	<i>Minimum value</i>	<i>Maximum value</i>	<i>Mean value</i>
<i>Length (cm)</i>	26.5	47	35.32
<i>Weight (g)</i>	200	1100	472.33

The regression equation has found highly significant regression coefficient ‘r’ values ranged from 0,9832 for the Zagorcani’s samples to 0,9504 for wild samples from Lake Ohrid. To calculate the coefficient a and b we log-transformed data and use linear regression. The figures below (fig.2 for Zagorcani’s fishes and fig.3 for the Lake Ohrid fishes) present the graphs of the linear regression for the log of length and log of weight relationship. Through the regression line there are the dots for each measurement. The equation shows the values of the growth coefficient. So for the analyzed samples of cultivated fishes coefficient a= 0,3826; the coefficient b= 1,9709; the R² = 0,9525. For the analyzed samples of wild fishes the coefficient a= 2,0104; the coefficient b= 3,0013 and R²= 0,9283.




Fig 2. Relationship between log of length and log of weight for Zagorcani's fishes.




Fig 3. Relationship between log of length and log of weight for Lake Ohrid fishes.

CONCLUSIONS AND DISCUSSIONS

Based on the results of Length- weight relationship from this study, in both groups the linear regression shows a strong link. So as for the wild fishes also for the cultivated there was an optimal rate of growth. Based on the correlation coefficient values we conclude that there is a strong link between length and weight. Both results are closely to 1; $r = 0,9832$ for Zagorcani's samples and $r = 0,9504$ for the Lake Ohrid fishes.

According to growth coefficient b we can't said that the fishes exhibit the isometric growth because for the two groups the value of b is not equal to 3. For the cultivated fishes $b = 1,9709$ and according to this we can say that the Zagorcani's fishes exhibit negative allometric growth. For the wild fishes $b = 3,0013$ so they exhibit positive allometric growth. Based on the values of the b coefficient the cultivated fishes grow faster in length than in weight and the wild fishes grow faster in weight than in length. The environment conditions have their impact on length- weight relationship and these should be a very important element to be controlled during the cultivated states of the fishes.

REFERENCES

1. Anderson, R.O., Gutreuter, S.J., 1983. Length weight and associated structural indices. In: Nielsen, L.A., Johnson, D.L. (Eds.), *Fisheries Techniques*. American Fisheries Society, Bethesda, Maryland, pp. 283–300.
2. Bagenal, T.B. and A.T. Tesch, 1978. *Conditions and Growth Patterns in Fresh Water Habitats*. Blackwell Scientific Publications, Oxford, pp: 75 -89.
3. Efron.B,Tibshirani.R.J (1993). *An Introduction to the Bootstrap*. Chapman & Hall, New York. 105-115.
4. Gayando, F.C. and D. Pauly, 1997. FAO ICLARM stock assessment tools (FISAT): References Manual, FAO Computerized Information Series (Fisheries) (8): 262.
5. Gomiero, L. M., Braga, F. M. S (2005). The condition factor of fishes from two river basins in Sao Paulo state, Southeast of Brazil. *Acta Scientiarum*. 27:73-78.
6. Lima-Junior, S. E., Cardone I. B., Goite, R (2002). Determination of a method for calculation of Allometric Condition Factor of fish. *Acta scientiarum*. 24:397- 400.
7. Oscoz J., Campos F., Escala M. C., 2005 Weight–length relationships of some fish species of the Iberian Peninsula. *Journal of Applied Ichthyology* 21:73–74.
8. Pauly, D (1983). Some simple methods for the assessment of tropical fish stocks. FAO Fisheries Technical paper, (234), FAO, Rome, Italy, 52 pp.
9. Pauly,D (1993). Linear regressions in fisheries research. *Journal of the Fisheries Research Board of Canada*, 30:409-434.
10. Riedel, R., Caskey, L.M., Hurlbert, S.H (2007). Lengthweight relations and growth rates of dominant fishes of the Salton Sea: implications for predation by fish-eating birds. *Lake and Reservoir Management*. 23:528-535.
11. Simon K. D., Bakar Y., Samat A., Zaidi C. C., Aziz A., Mazlan A. G., 2009 Population growth, trophic level, and reproductive biology of two congeneric archer fishes (*Toxotes chatareus*, Hamilton 1822 and *Toxotes jaculatrix*, Pallas 1767) inhabiting Malaysian coastal waters. *Journal of Zhejiang University Science B* 10(12):902–911
12. Simon K. D., Mazlan A. G., Samat A., Zaidi C. C., Aziz A., 2010a Size, growth and age of two congeneric archer fishes (*Toxotes jaculatrix* Pallas, 1767 and *Toxotes chatareus* Hamilton, 1822) inhabiting Malaysian coastal waters. *Sains Malaysiana* 39(5):697–704.
13. Sparre, P., E. Ursin and S.C. Venema., 1989. *Introduction to tropical fish stock assessment*. Part 1. Manual. FAO Fish. Tech. Pap. 306.1. FAO, Rome, 337p.
14. Tandon K. K., Johal M. S., Bala S., 1993 Morphometry of *Cirrhinus reba* (Hamilton) from Kanjli wetland, Punjab, India. *Research Bulletin of the Punjab University, Science* 43(1-4):73–78.

THE MOST COMMON INDICATORS FOR SARA CONDITION IN COWS FOR MILK PRODUCTION
INDIKATORËT MË TË ZAKONSHËM DIAGNOSTIKË PËR SINDROMIN SARA NË LOPËT PËR PRODHIM QUMËSHTI

EMILIAN SHABANI *; XHEVDET KRASNIQI **; NEXHAT MAZREKU **;
BRUNILDA ELEZI *

* Departamenti i Lëndëve Klinike, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Tiranë

** Mjek Veteriner në Malishevë, Kosovë,

Kontakt: emilian3shabani@yahoo.it

PËRMBLEDHJE

Sindromi SARA (acidoza nënakute e rumenit) është problem i zakonshëm shëndetësor në lopët e fermave për prodhim qumështi. Ky sindrom është i vështirë të diagnostikohet klinikisht në individë dhe në nivel tufe. Shenjat klinike dytësore (*diarre, distension i rumenit, reduktimi i konsumit të ushqimit, hemorragjitë vatrore në rajonin subsolar të thundrave, laminiti aspetik, kondicioni i dobët trupor, absceset pa shkaqe të dukshme, epistaksisi, çrregullimet në treguesit e riprodhimit, etj.*) dhe mungesa e testeve specifike diagnostike përbëjnë karakteristikat kryesore të këtij sindromi.

Studimi disavjeçar synon të identifikojë vlerën diagnostike të disa indikatorëve të lidhur me strukturën e racionit ushqimor, të % së yndyrës në qumësht dhe të pH të përmbajtjes nga rumeni. Fermat që përdorin racione me nivele të ulëta të ushqimeve që fermentohen me vështirësi celulozës (nën 25%) dhe nivele të larta të ushqimeve lehtësisht të fermentueshme (mbi 45%) kanë incidencë të lartë të gjendjes SARA. % e yndyrës në qumësht orienton për praninë e gjendjes SARA. Diagnoza për sindromin SARA në nivel tufe fiton vlera edhe mbas reagimit në gjendjen klinike të kafshëve të diktuar nga korretimi i racionit ushqimor. pH i përmbajtjes nga rumeni (varësisht nga teknika dhe koha e marrjes pas ushqimit) mbetet indikator i me vlerë më të plotë diagnostike. Vëzhgimi i hollësishëm i simptomavedytësore klinike dhe analiza e lëngutnga përmbajtja e rumenitbëjnë të mundur diagnostikimin e hershëm të gjendjes SARA në lopët e fermave.

Fjalët kyçe: *Indikatorë diagnostikë, pH i rumenit, % e yndyrës, sindromi SARA, struktura e racionit.*

ABSTRACT

SARA syndrome (subacuterumenacidosis) is a common health problem in the farm of cows for milk production. This syndrome is clinically difficult to diagnose in individual and in herdlevel. Secondary clinical signs (*diarrhea, distension of the rumen, reducing of food consumption, subsolar focal bleeding in region of hooves, aseptic laminitis, poor body condition, abscesses without obvious causes, epistaxis, alterations in indicators of reproduction, etc.*) and lack of specific diagnostic tests constitute the main characteristics of this syndrome. Multi year study aims to identify the diagnostic value of some indicators regarding the structure of the food rations, the % of milk fat content and pH of the rumen. Farms that use portions with low levels of foods that ferment with difficulties the cellulose (under 25%) and high levels of food easily fermentable (over 45%) have the highest incidence of SARA condition. SARA syndrome diagnosis at the herdlevel gains value after clinical response in animal condition imposed by correction of food rations. pH of rumen content (depending on the technique and the time after food intake) remains indicator with full diagnostic value.

Detailed observation of secondary clinical symptoms and analysis of fluid from the rumen content enable early diagnosis of the SARA condition in farm of cows.

Keywords: Diagnostic indicators, rumen pH, % of fat, SARA syndrome, the structure of the ration.

1. HYRJJE

Acidoza nënaku e rumenit apo gjendja SARA, është problemi më i zakonshëm shëndetësor në lopët e fermave për prodhim qumështi (Ceroni V. e bp. 2011); Enemark, 2008). Gjendja SARA karakterizohet nga episode ditore të uljes së pH të përmbajtjes së rumenit midis vlerave 5.5 dhe 5.0 (Krause, 2006, Oetzel, 2003), nga 3 deri në 5 orë në ditë, (Kleen, 2003). Në bazën e shkaktimit për sindromin SARA qëndrojnë faktorë të lidhur dhe me të ushqyerit e kafshëve, (Kleen, J.L. et al. 2003). Tepçicat e ushqimeve karbohidratike apo lehtësisht të fermentueshme në racion, shpesh bëhen shkak për lindjen e gjendjes së acidozës në rumen, (Garry, F.B., 2002; Nocek, J.E., 1997; Oetzel G.R., 2003). Kjo gjendje sëmundësose nuk manifestohet me shenja klinike të dukshme. Mungesa e testeve specifike diagnostike dhe prania e shenjave klinike dytësore të vonuara përbëjnë karakteristikat kryesore të sindromit, (Nocek, J.E. 1997). Duke vëzhguar hollësisht shenjat klinike dhe duke analizuar lëngun e përmbajtjes është e mundur diagnostikimi i acidozës nënaku ruminale, (Enemark, J.M.D., 2008). Më shpesh nga gjendja SARA preken lopët në fillimin e laktacionit dhe ato me moshë mesatare. Të dhënat e autorëve për shkallën e prekshmërisë së lopëve nga gjendja SARA janë të ndryshme, por shumica pranojnë që lopët në muajin e parë pas pjelljes dhe lopët e laktacionit të 3 – 5, janë më të rrezikuara për t'u prekur, (Ceroni V. e bp. 2005). Në studime të mëparshme edhe në lopët e fermave në vendin tonë është vlerësuar incidenca e gjendjes SARA nga 12 deri në 37 %, (Ceroni V. e bp. 2011). Studimi synon të evidentojë bashkëlidhjet ndërmjet strukturës së racionit ushqimor, përqindjes së yndyrës në qumësht dhe gjendjes SARA, me qëllim përdorimin e indikatorëve indirektë për orientimin e diagnozës klinike të gjendjes SARA.

2. MATERIALI DHE METODAT

Të dhënat e paraqitura janë pjesë e një studimi shumëvjeçar të realizuar në vitet 2012 – 2015, në 4 ferma lopësh për prodhim qumështi, me rregjim intensiv mbarështimi. Në secilën fermë u përzgjedhën në mënyrë rastësore (për çdo vit) nga 12 krerë lopë të moshave, racave dhe në perioda të ndryshme të laktacionit, pa shenja klinike të ndonjë sëmundjeje dhe në gjendje të mirë të kondicionit trupor. Kafshët u trajtuan me racione ushqimore të përcaktuara që tëndryshonin nga përmbajtja e fibrave që fermentohen me vështirësi (celulozës) dhe të fibrave që fermentohen me lehtësi. Përpunimi i strukturës së racionit ushqimor u bë sipas të dhënave të Animal Nutrition (McDonald, 2005). Kafshët ishin me prodhimtari mesatare 5000 - 8000 litra qumësht në vit. Në kafshët e përzgjedhura në çdo stinë të vitit u morrën kampione nga përmbajtja e rumenit nëpërmjet rumenocentezës nazoezofagale, 3 - 6 orë mbas konsumit të ushqimit të miksuar. pH i përmbajtjes nga rumeni u mat me pH-metër portabël, menjëherë pas kampionimit. Për të njëjtat kafshë u përcaktua % e yndyrës së qumështit me metodat e zakonshme që përdoren në fabrikat e grumbullimit të qumështit. Kafshët e zgjedhura në grupet e eksperimentit u ndoqën klinikisht për të gjithë kohën e vazhdimit të eksperimentit. Në grupet e kafshëve ku u prezantuan ndryshime në vlerat e pH të përmbajtjes së rumenit u realizua korigjimi i strukturës së racionit ushqimor dhe u vlerësuan përfundimet. Rezultatet e fituara u grupuan dhe u përpunuan statistikisht. Në përfundim u përcaktuan bashkëlidhjet midis faktorëve dhe u hartuan grafikët e regresit linear dhe ekuacionet e regresit një faktorial.

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI

1. Racionet ushqimore të përdorura në periudhën e eksperimentit siguronin strukturën me parametrat sikurse tregohet në tabelen 1. Përlllogaritja e elementëve strukturorë të racionit ushqimor u realizua sipas tabelave të Animal Nutrition (McDonald, 2005). Në konsideratëu morrën treguesit e sasisë së lëndës së thatë në kg dhe në % ndaj totalit në kg fizik, sasia e celulozës në kg dhe në % ndaj lëndës së thatë dhe sasia e fibrave lehtësisht të fermentueshme në kg dhe në % ndaj lëndës së thatë.

Tabelanr1. Treguesit strukturorëmetabolikë të racionit ushqimor, sipas grupeve të lopëve.

Grupet e lopëve	Racioni në kg fizik dhe %	Lëndë e thatë (DM) nëkg. dhe %	Celulozë (CF) nëkg dhe %.	Fibra lehtësisht të ferment. (NDF) nëkg dhe %.
Grupi I	30	7.35	1.99	3.67
Në %	100 %	24.53 %	28.36 %	49.93 %
Grupi II	37	8.49	2.63	3.54
Në %	100 %	22.94 %	30.97 %	41.69 %
Grupi III	28	8.64	3.11	3.26
Në %	100 %	30.85 %	35.99 %	37.73 %
Grupi IV	33	8.71	3.01	3.12
Ne %	100 %	26.39 %	34.55 %	35.82 %

Racioni ushqimor i përdorur sipas grupeve të lopëve siguronte për grupin e parë 7,35 kg lëndë të thatëose 24.53%, 7,35 kg celulozë ose 28.36 % të lëndës së thatë dhe 3.64 kg fibra lehtësisht të fermentueshme ose 49.93 % të lëndës së thatë. Sikurse duket në tabelën 1 për çdo grup të kafshëve në eksperiment janë ruajtur përbërje dhe raporte të ndryshuara të treguesve strukturorë të racionit ushqimor.

Në periudhën e eksperimentit nivelet mesatare të pH ruminal ishin si në tabelën 2. Vlera mesatare e pH të përmbajtjes së rumenit për periudhën 4 mujore ishte 5.51 ± 0.3 në lopët e grupit të parë, 5.68 ± 0.2 në lopët e grupit të dytë, 5.92 ± 0.3 në lopët e grupit të trete dhe 5.81 ± 0.1 në lopët e grupit të katërt. Të dhënat e fituara pas përpunimit treguan ndryshime dhe diferenca në vlerat mesatare mujore të pH, që shkojnë nga minimumi 0,37 deri në 0.52 njësi pH. Të dhënat vërtetohën statistikiisht ($P < 0.09$)

Tabela nr 2. Niveli mesatar i pH të përmbajtjes së rumenit në lopë, sipas muajve paspjelljes.

Grupet e lopëve	Niveli mesatar i pH të përmbajtjes së rumenit sipas muajve				Niveli Mesatar
	Muaji I	Muaji II	Muaji III	Muaji IV	
Grupi I ^{te}	5.43 ± 0.3	5.54 ± 0.1	5.42 ± 0.2	5.44 ± 0.3	5.51 ± 0.3
Grupi II ^{te}	5.56 ± 0.1	5.62 ± 0.2	5.60 ± 0.2	5.67 ± 0.1	5.68 ± 0.2
Grupi III ^{te}	5.91 ± 0.1	6.1 ± 0.3	6.24 ± 0.2	5.87 ± 0.3	6.02 ± 0.3
Grupi IV ^{te}	5.82 ± 0.2	5.78 ± 0.2	5.77 ± 0.1	5.83 ± 0.2	5.91 ± 0.1


Të dhënat treguan se në grupin e parë dhe të dytë të eksperimentit vlerat e pH në përmbajtjen e rumenit ishin në intervale më poshtë se 5.7 dhe më lart se 5.5. Në vlera të tilla kafshët vuajnë nga gjendja e acidozës nënakute të rumenit ose sindromi SARA, në dallim nga lopët e grupeve të tjera të cilat kishin vlera të pH në përmbajtjen e rumenit më të larta se 5.7 dhe më të ulta se 6.1.

Pas përpunimit statistikor u hartua grafiku i regresit linear dhe ekuacioni i regresit njëfaktorial

Grafikun 1

Marrëdhëniet midis pH të mirmbajtjes së rumenit në lope dhe sasisë së celulozës në racionin ushqimor (në %).


$$R^2 = 0.594. \quad pH(\text{rumenit}) = -84.37 + (19.74 \times \% \text{ celulozës})$$



Nga grafiku i regresit linear dhe koeficienti i korelacionit të gjetur duket se midis përmbajtjes së celulozës në racion dhe pH të përmbajtjes së rumenit ka lidhje të forta korelative të karakterit pozitiv. Natyrisht, sipas të dhënave tona, kjo lidhje është e vërtetë për vlerat e përmbajtjes së celulozës në racion nga minimumi 24 % deri në maksimum 31 %. Për vlera të tjera të përmbajtjes së celulozës në racion ekuacioni i lidhjes nuk është i vërtetë.

2. Sipas metodikës, për kafshët e grupeve të eksperimentit u përcaktua % e yndyrës së qumështit, për çdo ditë me metodat e zakonshme që përdoren në praktikë. Të dhënat u grupuan, u llogaritën mesataret për çdo grup dhe më pas u ballafaquan me vlerat mesatare të pH të përmbajtjes së rumenit. Përfundimet jepen në grafikun e regresit linear dhe në ekuacionin e varësisë një faktoriale.

Grafiku 2: Marrëdhëniet midis pH të përmbajtjes së rumenit dhe % së yndyrës në qumësht. $R^2 = 0.431$. $pH(\text{rumenit}) = 3.531 + (0.114 \times \% \text{ yndyrës})$



Të dhënat e fituara evidentuan faktin se midis pH të përmbajtjes së rumenit dhe % së yndyrës në qumësht ka lidhje korelative me fortësi mesatare dhe të karakterit pozitiv. % e yndyrës në qumësht ulet proporcionalisht uljes së vlerës së pH të përmbajtjes së rumenit. Të dhënat e fituara janë të vërtetuara statistikisht për vlerat kufi të pH të përmbajtjes së rumenit nga 5.5 deri në 6.2. Për vlera të tjera mbi dhe nën kufijtë e mësipërm ekuacioni i regresit të varësisë një faktoriale nuk është i vërtetë.

Analiza e kujdesshme e racionit ushqimor të tufës prej kohësh ka përbërë një procedurë diagnostike efikase, (Krause, K.M. et al. 2006). Vëmendje e veçantë i kushtohet sasisë së

lëndës së thatë, sasisë së fibrave që fermentohen me vështirësi (celuloza CF), fibrave që fermentohen me lehtësi (NDF), etj, (Nocek, J.E. 1997). Megjithatë, duhet theksuar se diagnoza e acidozës nënakute të rumenit nuk bazohet vetëm në analizën e racionit ushqimor dhe kjo sepse ka dy probleme që duhen nënvizuar. Së pari, vlerat e racionit ushqimor nuk reflektojnë gjithmonë sasinë e vërtetë të ushqimit që lopët konsumojnë dhe Së dyti, edhe nëse racioni ushqimor është përpiluar si duhet, analiza e ushqimit nuk e parashikon tërësisht se çfarë ndodh me ushqimin në rumenin e secilit individ. Në vijim të diskutimit për strukturën dhe përmbajtjen e racionit ushqimor, vlerat e pH ruminal do të varen nga sasia totale që ka konsumuar kafsha, nga madhësia e particelave ushqimore, nga niveli i lagështisë, nga modelet e konsumimit të ushqimit dhe nga veprimi i faktorëve të tjerë rrethues ambjentalë, (Morgante M, et al. 2007; Oetzel G.R. 2003). Megjithatë, nga të dhënat e fituara mundet të konkludohet se struktura dhe përmbajtja e racionit ushqimor mundet të shfrytëzohen në dobi të diagnozës paraprake për acidozën nënakute të rumenit në lopët e qumështit.

Mesatarja e % së yndyrës së qumështit është përdorur shpesh si indikator i acidozës nënakute ruminale në nivel tufe, (Brown M.S.2000).Përqindja e ulët (jonormale) e yndyrës nëqumësht zakonisht është rezultat i ndodhive të acidozës së rumenit, por një dukuri e tillë mundet të haset edhe në gjendje të tjera sëmundësore si në tepritë e yndyrës dhe të jonoforeve në racionin ushqimor, etj, shkaqe potenciale. Megjithatë, sipas shumë studimeve të realizuara,(Enemark, J.M.D., 2008), tufat e lopëve të qumështit të cilat rezultojnë me % normale apo të ulur të yndyrës në qumësht kanë probleme me acidozën nënakute të rumenit, (Morgante M. et al. 2007).Në lopët me prani të acidozës nënakute të rumenit, të ushqyera me racione të ndryshme, prodhohet qumësht me nivele të ulëta yndyre. Lopët në peridhën e hershme të laktacionit janë më të ndjeshme për tu prekur nga acidoza e rumenit, por % e yndyrës së qumështit në këto lopë shpesh nuk ka bashkëlidhje pozitive me pH e përmbajtjes së rumenit.

Nga të dhënat e studimit duket se midis vlerës së pH të përmbajtjes së rumenit dhe yndyrës në qumësht ka lidhje korelative dhe se ky tregues mundet të shfrytëzohet për diagnozën indirekte të pranisë së acidozës nënakute të rumenit në lopët e qumështit. Bashkëlidhja ka vlerë kur matjet e % së yndyrës në qumësht realizohen individualisht, pasi kur qumështi përzihet me atë të prodhuar nga pjesa tjetër e tufës, % e ulët e yndyrës së individëve të veçantë maskohet dhe zakonisht mbetet e pazbuluar.

4. PËRFUNDIME

- Në tufat e lopëve për prodhim qumështi ekzistojnë dhe indikatorë të tjerë ndihmës për diagnozën indirekte të acidozës nënakute të rumenit.
- Struktura dhe përmbajtja e racionit ushqimor sikurse dhe % e yndyrës së qumështit të prodhuar mundet të shfrytëzohen si indikatorë ndihmës për praninë e acidozës nënakute të rumenit në lopët e tufave për prodhim qumështi.
- Midis treguesit të përmbajtjes së celulozës në racionin ushqimor dhe vlerës së pH në përmbajtjen e rumenit ka lidhje të forta korelative ($R^2=0.594$), të karakterit pozitiv. Kjo lidhje është e kufizuar për vlerat e përmbajtjes së celulozës në racion nga minimumi 24 % deri në maksimum 31 %.
- Lidhje korelative të fortësisë mesatare ($R^2=0.431$) dhe të karakterit pozitiv ka dhe midis vlerës së pH në përmbajtjen e rumenit dhe përqindjes së yndyrës në qumështin e prodhuar. Ky tregues ka vlera individuale dhe të vërtetuara statistikisht pas muajit të dytë të laktacionit.
- Treguesit e strukturës së racionit ushqimor dhe të përqindjes së yndyrës në qumësht mundet të shfrytëzohen si indikatorë orientues për vlerësimin e statusit shëndetësor të tufës të lidhur me praninë e sindromit të acidozës nënakute të rumenit.

5. LITERATURA

Revistashkencore:

1. Ceroni V. e bp. Frequency of the subacute rumen acidosis (SARA) in same cattle farms.
2. Journal of Institute Alb-Shkenca. 2011. Vëll. IV, Nr. 1, fq. 63 – 67.
3. Enemark, J.M.D. The monitoring, prevention and treatment of sub-acuteruminalacidosis (SARA):
4. 2008. *A review. Vet. J.*, 176: 32-43.
5. Kleen, J.L; Hooijer, GA; Rehage, J; Noordhuizen, J.P. SubacuteRuminalAcidosis in DairyCows.
6. 2003: - *A Review; J. Vet Med A: 50 406 – 414*
7. Krause, K.M., Oetzel, G.R. UnderstandingandpreventingsubacuteRuminalacidosis in dairyherds:
8. 2006. *A review, AnimalFeedScienceandTechnology* **126**, 215–236.
9. Morgante M, Stelletta C, Berzaghi P, Ganesella M, Andrighetto I. Subacuterumenacidosis in
10. lactatingcows: an investigation in intensive Italian Dairy herds.2007:JournalofAnimal
11. PhysiologyandAnimalNutrition 91: 226-234.
12. Nocek, J.E. Bovine Acidosis: Implications on laminitis.1997.J. Dairy Sci. 80, 1005 - 1028
13. Oetzel G.R. Subacute ruminal acidosis in dairy cattle. 2003:*Adv. Dairy Sci. Tech.*, 15: 307-317.
14. Brown M.S. - Evaluation model of acute and subacute acidosis. (2000):J. of animal science 78:3155-
15. 3168.
16. **Tekste:**
17. Ceroni V. e bp - Ketozanë lopët e qumështit (Monografi).2005:112-157.
18. Garry, F.B. -Indigestion in ruminants.in: B.P. SMITH (ed.): Large Animal Internal
19. Medicine 2nd ed. Mosby, St. Louis and Baltimore,2002: pp.722 - 747
20. McDonald P. - Animal Nutrition.(1995).

**VARIATION IN THE REPRODUCTION INDICATORS IN COWS WITH
SUBCLINICAL ACIDOSIS CONDITION
LUHATJET NË PARAMETRAT E RIPRODHIMIT NË LOPË ME GJENDJE TË
ACIDOZËS SUBKLINIKE**

ERMAL YZEIRAJ* ; VANGJEL CERONI**

* Mjek Veteriner në Qarkun e Fierit,

** Departamenti i lëndëve Klinike, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Tiranë

Email: yzeirajermal@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Në periudhën Mars 2013 deri në Mars 2015 në tre grupe lopësh me nga 20 krerë u studiuan luhatjet në treguesit e riprodhimit në lopë varësisht nga gjendja e acidozës subklinike. Në grupet e kafshëve u përdorën racione të ndryshme ushqimore duke patur në konsideratë sasinë e lëndës së thatë, sasinë e fibrave që fermentohen lehtësisht, sasinë e fibrave të fermentueshme me vështirësi, energjinë metabolike totale dhe energjinë e metabolizueshme. Kafshët e të tre grupeve u kontrolluan përgjatë 4 muajve të parë pas pjelljes për pH e rumenit dhe nivelin e glukozës në gjak. Në lopët e grupit të parë të eksperimentit me vlera mesatare të pH të rumenit 5.7 ± 0.3 dhe me gjendje hipoglicemie (1.88 ± 0.03 mMol/litër) u realizua servis perioda prej 134.15 ± 6.55 ditë dhe indeksi i ndërzimit prej 2.25 ± 0.22 për lopë barse. Në lopët e grupit të dytëme vlera mesatare të pH të rumenit 5.9 ± 0.2 dhe me gjendje glicemie 2.28 ± 0.03 mMol/litër u realizua servis perioda prej 105.4 ± 6.13 ditë dhe indeksi i ndërzimit prej 1.6 ± 0.1 për lopë barse. Në grupin e kontrollit me vlera mesatare të pH të rumenit 6.2 ± 0.2 dhe me gjendje glicemie 2.88 ± 0.03 mMol/litër, u realizua servis perioda prej 84.73 ± 5.34 ditë dhe indeksi i ndërzimit prej 1.42 ± 0.22 për lopë barse. Të dhënat vertetohen statistikisht. Marrëdhënie më të forta korelative u gjetën midis nivelit të glukozës dhe servis periodës ($R^2 = -0.713$).

Fjalët kyçe: *Acidoza subklinike, hypoglicemia, indeksi i ndërzimeve, servis perioda, marrëdhënie korelative.*

ABSTRACT

During the period from March 2013 to March 2015 were study the variations in the indicators of reproduction in 3 group of cows with 20 cows for each group, depending on the subclinical acidosis conditions. Different rations of food were given to the three groups of cows taking into consideration the drying matter, the quantity of fibers that are easily fermented, the quantity of hardly fermented fibres, total metabolic energy and metabolisation energy. All herds were kept under control during the first four month after calving for the rumen pH and the level of glucose in blood. In the first group of the experiment with an average value of rumen pH of 5.7 ± 0.3 and with the glycemic condition (1.88 ± 0.03 mMol/liter) was achieved servis period of 139.15 ± 26.55 days and the index of copulation 2.25 ± 0.22 for each pregnant cow. In the second group of cows with an average value of rumen pH 5.9 ± 0.2 and with glycemic condition 2.28 ± 0.03 mMol/liter was achieved servis period 97.4 ± 16.13 days and the index of copulation 1.6 ± 0.1 for each pregnant cow. In control group of cows with an average value of rumen pH 6.2 ± 0.2 and with the glycemic condition 2.88 ± 0.03 mMol/liter was achieved servis period 84.73 ± 5.34 days and the index of copulation of 1.32 ± 0.22 for each pregnant cow. Datas are statistically proven. Strong correlative relations were found between glucose levels and servis period with a value of ($R^2 = -0.713$).

Key words: *subclinical acidosis, hypoglycemia, index of the copulation, servis period, correlative relation.*

1. HYRJE

Ushqimi konsiderohet si faktor që luan një rol të rëndësishëm në statusin e shëndetit të lopëve. Lopët e ushqyera me nivele të larta të drithërave ose me ushqime lehtësisht të fermentueshme janë shpesh subjekte me rrezik të rritur për t'u prekur nga acidoza ruminale e formës klinike apo subklinike, (Radostits O. M., et al. 2005), Coffey M.P., et al. 2002). Format e acidozës së rumenit jo vetëm që janë të pranishme në lopët e tufave me prodhimtari të lartë në vendin tonë, por gjithnjë e më tepër po shtojnë pasojat dhe dukuritë dytësore. Treguesit dytësorë më të ndikueshëm nga sindromi i acidozës subklinike në lopë janë ata të riprodhimit. Në lopët që vuajnë nga gjendja e acidozës subklinike të rumenit në periudhën e parë paspajlljes, ulen aftësitë riprodhuese të manifestuara me zgjatjen e servis periodës dhe rritjen e indeksit të ndërtimeve.

Në mënyrë krahasuese me grupe eksperimenti u studiu ndikimi i gjendjes së acidozës subklinike mbi parametrat e riprodhimit në lopë. Në konsideratë u morrën dhe u analizuan treguesit për vlerat e pH të përmbajtjes së rumenit, niveli iglicemisë dhe treguesit bazë të riprodhimit si koha në ditë e shfaqes së afshit të parë, indeksi i ndërtimeve dhe veçanërisht periudha e servis periodës. Studimi u drejtua në përcaktimin e ndërlidhjeve dhe varësisë së treguesve të riprodhimit në lopë nga gjendja e acidozës subklinike, si dhe në përcaktimin e mundësive parandaluese për pasojat negative në prodhimin dhe riprodhimin e kafshëve.

2. MATERIALI DHE METODAT

Studimi u realizua gjatë periudhës Mars 2013 deri në Mars 2015. Për studim u zgjodhën grupe lopësh me nga 20 krerë të moshës 3 - 5 vjeçe, në periudhë barsërisë së avancuar dhe në fillimin e laktacionit deri në ndërzimin fekondues. Një muaj parapajlljes dhe 3 muaj paspajlljes, lopët e grupeve të eksperimentit u trajtuan me racione ushqimore që përmbanin sasi të ndryshme ushqimi të koncentruar. Me përzgjedhje për çdo grup lopësh u kampionua përmbajtje nga rumeni me teknikën e rumenocentezës, 3 deri 5 orë pas marrjes së ushqimit të koncentruar dhe menjëherë u mat pH me pH-metër portabël. Nga të gjithë lopët u prelevua gjak nga venat e veshit, në periudhën 2 javë parapajlljes dhe deri 3 muaj paspajlljes, çdo 2 javë. Kampionet e gjakut u kontrolluan për përmbajtjen e glukozës me metodën e shpejtë.

Për të gjitha lopët në studim u ndoqën treguesit më kryesorë të riprodhimit, koha e shfaqes së afshit të parë paspajlljes (paraservis perioda), koha deri në ndërzimin fekondues (servis perioda) dhe numri mesatar i ndërtimeve (indeksi i ndërzimit) për lopë të barsur.

Të dhënat e fituara u përpunuan statistikisht dhe në përfundim u llogaritën bashkëlidhjet, varësitë korelative midis treguesve në studim dhe ekuacionet e regresit njëfaktorial midis treguesve sasiore dhe cilësore.

3. REZULTATET DHE DISKTIMI

Racionet ushqimore të përdorura në periudhën e eksperimentit siguronin parametrat e strukturës sikurse tregohet në tabelën nr1: Llogaritjet tabelore janë bërë sipas Animal Nutrition (McDonald, 2005). Grupi i parë dhe i dytë ishin grupe eksperimenti dhe grupi i tretë i kontrollit.

Tabela nr1. Treguesit metabolikë tabelare të racionit ushqimor, sipas grupeve të lopëve.

Grupet e lopëve	Lëndë e thatë (DM) kg.	Celulozë (CF) kg	Fibrat lehtësisht të ferment. (NDF) kg.	Energjia totale (ME) në MJ
Grupi I	8.15	1.99	3.67	88.23
Grupi II	8.64	3.11	3.26	71.36
Grupi kontrollit	8.49	2.63	3.54	74.36

Racioni ushqimor i përdorur te lopët sipas grupeve siguronte raportin midis përmbajtjes së celulozës (CF) me lëndën e thatë 24,41 % në grupin e parë, 35.99 % në grupin e dytë dhe 30.97 % në grupin e kontrollit. Përmbajtje të ndryshme kishte në racionet e lopëve dhe në sasinë e fibrave (NDF) lehtësisht të fermentueshme (përkatesisht 45.12 % në grupin e parë, 37.73 % në grupin e dytë dhe 41.69 % në grupin e kontrollit). Rezultatet e llogaritjeve janë mbi sasinë totale të lëndës së thatë (DM) të racionit ushqimor. Bazuar në treguesit tabelorë të racionit ushqimor, u synua që në grupin e parë të lopëve të sigurohej nivel i lartë i energjisë së metabolizueshme dhe kushte për lindjen e acidozës subklinike të rumenit. Rezultatet e kontrollit të pH nga përmbajtja e rumenit jepen në tabelën 2. Ndryshimet në vlerat e pH të përmbajtjes së rumenit në lopët sipas grupeve vërtetohen statistikiisht ($P > 0.905$).

Tabela nr 2. Niveli mesatar i pH të përmbajtjes së rumenit në lopët e grupeve të eksperimentit dhe kontrollit, sipas muajve para dhe pas pjelljes.

Grupet e lopëve	Niveli mesatar i pH nga përmbajtja e rumenit (M±m)				
	Para pjelljes	Muaji I ^{te}	Muaji II ^{te}	Muaji III ^{te}	Mesatare
Grupi I-re	5.8 ± 0.1	5.8 ± 0.2	5.7 ± 0.2	5.8 ± 0.2	5.7±0.3
Grupi II-te	5.8 ± 0.2	5.9 ± 0.2	5.9 ± 0.2	6.1 ± 0.3	6.2±0.2
Grupi kontroll	5.8 ± 0.2	5.9 ± 0.1	5.9 ± 0.1	5.9 ± 0.2	5.9±0.2

Nga treguesit metabolikë të kontrolluar u vërejt se në lopët e grupit të parë kishte nivel më të ulët të glicemisë, për të gjithë kohën e eksperimentit, tabela3. Në lopët e grupit të dytë dhe të kontrollit, pavarësisht se niveli i glicemisë ishte më i lartë se në lopët e grupit të parë, përsëri në individë kishte gjendje hipoglicemie.

Tabela nr3. Niveli mesatar i glukozës në lopët e grupeve të eksperimentit, sipas muajve.

Grupet e lopëve	Niveli mesatar i glukozës sipas muajve mMol/liter				
	Para pjelljes	Muaji I ^{te}	Muaji II ^{te}	Muaji III ^{te}	Mesatare
Grupi I ^{te}	1.96 ± 0.01	1.92 ± 0.03	1.87 ± 0.02	1.84 ± 0.04	1.88 ± 0.03
Grupi II ^{te}	2.73 ± 0.01	2.92 ± 0.02	2.87 ± 0.03	2.94 ± 0.04	2.88±0.03
Grupi kontroll	2.16 ± 0.03	1.92 ± 0.01	2.37 ± 0.01	2.91 ± 0.02	2.28±0.03

Në tabelë, jepen vlerat mesatare të glukozës në gjak, sipas grupeve të lopëve. Vlerat më të ulura të glukozës u regjistruan në periudhën deri 1 muaj paspjelljes. Ndryshimet në vlerat e glukozës për grupet e lopëve në eksperiment vërtetohen statistikiisht ($P > 0.955$).


Treguesit e riprodhimit në fund të periudhës së studimit u llogaritën të veçuara sipas grupeve. Të dhënat jepen në tabelën 4.

Tabela nr 4. Treguesit e riprodhimit në vlera mesatare për lopët sipas grupeve në studim


Grupet lopëve	Nr.	Treguesit e riprodhimit (M ± m) dhe vërtetësia e ndryshimit (d)					
		Servis perioda	d	P/ser. period	d	Indeks ndërz.	d
Grupi I ^{te}	20	134.15 ± 6.55	133.2	84.13 ± 5.34	17.68	2.25 ± 0.22	22.87
Grupi II ^{te}	20	105.41 ± 6.13	62.14	77.32 ± 4.10	16.42	1.61 ± 0.1	18.43
Grupi kontrollit	20	84.73 ± 5.34	84.12	81.11 ± 5.21	16.61	1.42 ± 0.22	19.32

Të dhënat e fituara treguan semë të ndryshuar nga norma ishin servis perioda dhe indeksi i ndërzimeve. Servis perioda në grupin e lopëve me gjendje të acidozës subklinike rritet në 134.3±6.55 ditë dhe indeksi i ndërzimeve rritet në 2.25±0.22, kundrejt 105.4±6.13 ditë të servis periodës dhe 1.61±0.1 ndërzime për lopë të barsur që ishin në lopët e grupit të dytë dhe 84.73±5.34 ditë dhe 1.42±0.22 ndërzime për lopët e konsideruara normale. Treguesi i paraservis periodës, nuk paraqiste ndryshime të dukshme midis grupeve të kafshëve në studim.

Grafiku nr1. Bashkëlidhjet e nivelit të glukozës paspjelljes, me servis periodën. ($R^2 = - 0.713$). $S. Perioda = 521.34 - 9.16 \times Glukoza$



Grafiku nr2. Bashkëlidhjet e nivelit të glukozës parapjelljes me indeksin e ndërzimeve. ($R^2 = - 0.572$). $I. Ndërzimit = 14.65 - 0.32 \times Glukoza$.



Karakteristike ishte lidhja e indeksit të ndërzimeve me gliceminë në nivel më të ulët, por e vërtetuar statistikisht.

Treguesi metabolik më me interes lidhur me parametrat e riprodhimit gjatë pranisë së sindromit të acidozës subklinike, është niveli i glukozës në gjak, (Anderson L. 1993). Sipas

(Goldhwk C. et al. 2009), acidoza subklinike si një sindrom kompleks metabolik ndikon ndjeshëm në lindjen e çrregullimeve të tjera, përfshirë dhe parametrat e riprodhimit, (Oikonomu G. et al. 2008). Ndikimi i hipoglicemisë në parametrat e riprodhimit lidhet me frenimin e ciklit të pentozofosfateve dhe biosintezës së 17- β estradiolit dhe progesteronit. Këta parametra kryesisht përmbledhin indeksin e ndërzimeve dhe servis periodën e më pak paraservis periodën. Ndikimet e hipoglicemisë në gjendjet e acidozës subklinike në aftësitë riprodhuese të lopëve paspjelljes janë regjistruar edhe nga studiues të tjerë. Për (Walsh R. et al. 2007) dhe (Duffield T. 2000, 2001, 2002), zgjatja e servis periodës në lopë me gjendje të acidozës subklinike është 40 - 90 ditë e më tepër. Nga të dhënat tona servis perioda në lopët me gjendje të ketozës subklinike rritet me deri 62 ditë dhe indeksi i ndërzimeve rritet me 0.9 ndërzime për lopë barse. Lidhjet e nivelit të glukozës me servis periodën dhe indeksin e ndërzimeve janë të forta dhe vërtetohen statistikisht.

Marrëdhëniet midis parametrave të riprodhimit dhe treguesve metabolikë, të përcaktuar nga grafikët e varësisë dhe ekuacionet e regresit të çifteve kanë nivele të ndryshme fortësie korelative. Të dhënat e studimit tregojnë se korelacionet e çifteve midis gjendjes së acidozës subklinike, indeksit të ndërzimeve dhe servis periodës paraqiten të forta dhe të karakterit negativ. Në përlllogaritjen e bashkëlidhjeve midis gjendjes së acidozës subklinike me treguesin e glicemisë ka interesat praktike për t'u shfrytëzuar.

4. KONKLUZIONE

- Nga treguesit metabolikë, niveli i glukozës në gjak është i mjaftueshëm për të vlerësuar gjendjen e acidozës subklinike në lopë.
- Midis gjendjes së acidozës subklinike në lopë, indeksit të ndërzimeve dhe servis periodës ekzistojnë lidhje të forta korelative të karakterit negativ. Ekuacionet e regresit dëshmojnë se rritja e gjendjes së acidozës pasohet në mënyrë të sigurtëme zgjatjen e servis periodës dhe rritjen e indeksit të ndërzimeve. Paraservis perioda nuk paraqitet e ndikuar nga gjendja e acidozës subklinike.
- Ndjekja e gjendjes së acidozës subklinike në lopë është me interesa praktike të shumëfishta, për parandalimin e pasojave në uljen e parametrave të riprodhimit.

5. LITERATURA

Revista Shkencore:

1. Anderson L. Subclinical ketosis in dairy cows. *Vet. Clin. North Am. Food Am. 1993. Pract.*:233-248.
2. Coffey M.P., G. Simm, S. Brotherstone. Energy balance profiles for the first three lactations of dairy cows estimated using random regression. 2002. *Journal of Dairy Science*.
3. Duffield T.F. Sub-clinical ketosis in lactating dairy cattle. *Metabolic disorders of ruminants*. 2000. *Vet. Clin. North Am.*, 16: 231-253.
4. Goldhawk C., N. Chapinal. Parturient feeding behavior is an early indicator of subclinical ketosis. 2009. *Journal of Dairy Science*. 92(10): 4971
5. Oikonomou G., G. Arsenos. Genetic Relationship of Body energy and Blood Metabolites with Reprod. In *Holstein Cows*. 2008. *J Dairy Sci*, November 1, 91(11): 4323–4332.
6. Walsh R.B., J.S. Walton. The Effect of Subclinical Ketosis in Early Lactation on Reprod. Performance of Postpartum Dairy Cows. 2007. *J. of Dairy Science*.

Tekste:

12. Radostits O. M., C.C. Gay, D.C. Blood, K.W. Hinchcliff. Veterinary Medicine, saunders, 2005.Pages
13. 1452-1462.90(6):2788-96.

Prossedings të konferencave apo simpoziumeve shkencore:

14. Duffield T. Importance of Subclinical Ketosis in Lactating Dairy Cattle. 2001.
15. Proc. Michigan Vet. Conf.
16. Duffield T. Impact, Prevention, and Monitoring of Subclinical Ketosis in Transition Dairy Cows.2002.
17. Proc. Minn. Dairy Health Conf.

APLIKIMI I SKEMAVE TË NDRYSHME TË MJEKIMIT NË VARËSI TË SHKALLËS SË RËNDESËS SË ÇALIMIT
THE APPLICATION OF VARIOUS SCHEMES OF TREATMENT DEPENDING ON THE DEGREE OF SEVERITY OF LAMENESS

EGLANTINA XHEMOLLARI*

*Department of Clinical Subjects, Agriculture University of Tirana, ALBANIA.

E-mail: eglantina_xhemollari@yahoo.it

PËRMBLEDHJE

Për këtë studim u përzgjedhën dele që manifestonin klinikisht simptomën e çalimit. Varësisht nga klinika e shprehjes së shkallës së çalimit, delet i ndamë në 3 grupe. Delet me çalim të formës së lehtë u trajtuan vetëm me prerje të bririt të thundrave dhe dezinfektimin sipërfaqësor me solucion Permanganat kaliumi. Delet me çalim të formës mesatare u trajtuan me prerje të thundrave, dezinfektim dhe me preparatin Lincomycin HCL. Delet me çalim të formës së rëndë u trajtuan me prerjen e thundrave, pastrimin, dezinfektimin e tyre. Gjithashtu u përdor edhe mjekimi i përgjithshëm të deleve me preparatin Lincomycin HCL dhe shtuam në mjekim antiinflamatorin Flunixin meglumine. Në këtë studim rezultoi se trajtimi i deleve që manifestonin klinikisht çalimin e formës së rëndë dhe mesatare realizohet mirë me përdorimin e antibiotikëve të tipit të Lincomycin HCL, pas trajtimit me prerje të bririt të thundrave. Kombinimi i Lincomycin HCL me preparatin Flunixin meglumine e fuqizon veprimin e të parit dhe rezultatet e fituara janë më të larta.

Fjalë kyçe: *çalim, dele, Flunixin meglumine, Lincomycin HCL, trajtim.*

ABSTRACT

The sheep that clinically manifested the symptom of lameness were selected for this study. Depending on the clinical expression of the scale of lameness, the sheep were classified into 3 groups. The sheep with the slight scale of lameness were treated only with the heel horn cut and surface disinfection with potassium permanganate solution. The sheep with the average scale of lameness were treated with incision heels, disinfection and Lincomycin HCL medication. The sheep with severe condition of lameness were treated with heels cutting, cleaning, disinfection. Also, general treatment was used with Lincomycin HCL and added Flunixin meglumine antiinflammatory medication. In this study, the treatment of sheep which manifested clinically the severe and average condition of lameness, it appeared to be adequate with the use of antibiotics Lincomycin HCL after the heel horn was cut. The treatment of Lincomycin HCL combined with Flunixin meglumine strengthens the action of the first medication and the results obtained are more positive.

Key words: *Flunixin meglumine, lameness, Lincomycin HCL, sheep, treatment.*

1. HYRJE

Tradita e mbarështimit të bagëtive të imta është pasuar me breza dhe në ditët e sotme vazhdon të jetë një biznes me leverdi ekonomike.

Në vendin tonë sot mbarështohet një numër i konsiderueshem i bagëtive të imta.

Rritja e numërit të krerëve për këto kategori kafshësh po shoqërohet gjithnjë dhe më shumë me përmirësimin racor të tyre. Kjo ka bërë që dhe rendimentet e prodhimeve të rriten e për rrjedhojë edhe të ardhurat nga këto kafshë të jenë më të mëdha.

Rritja e numërit të krerëve dhe përmirësimi racor natyrshëm kanë nxjerrë më në pah dhe probleme të patologjive që lidhen sa me predispozitat racore, aq dhe me kushtet e mbarështimit të tyre.

Kushtet konkrete të mbarështimit të blegtorisë, kanë kërkuar dhe kërkojnë ndër të tjera nga shërbimi veterinar, njohjen e gjëndjes për shkallën e përhapjes së këtij sindromi.

Ky studim pavarësisht nga përmasat e tij synon që në dele, për sindromin e çalimit të ndërtohen programe punë parandaluese dhe mjekuese duke vendosur në qëndër të vëmendjes thundrën si strukturë anatomike dhe kujdesin për të. Kontrolli i vazhdueshëm i thundrave dhe prerjet periodike të tyre, kur është e nevojshme, në dele mundet të jenë një element shumë i rëndësishëm në parandalimin e shfaqes së dëmtimeve të saj dhe për rrjedhojë për parandalimin e çalimit me të gjitha pasojat e tij të dëmshme.

2. MATERIALI DHE METODA

Për realizimin e këtij studimi janë përzgjedhur dele të cilat klinikisht kanë manifestuar sindromin e çalimit. Varësisht nga klinika e shprehjes së shkallës së çalimit delet janë ndarë në grupe me:

- a) çalim të formës së lehtë.
- b) çalim të formës mesatare. (Në këtë grup janë përfshirë kafshë të cilat ecin me kërcim por që e vendosin këmbën në tokë).
- c) çalim të formës së rëndë. (Në këtë grup janë përfshirë kafshë të cilat nuk e vendosin fare këmbën në tokë).

Mbas kontrollit klinik të kafshëve të sëmura dhe të thundrave të tyre është përcaktuar shkalla e dëmtimit të thundrave :

- Dele që çalojnë vetëm nga rritje e bririt të thundrave mbi përmasat normale.
- Dele me çalime nga deformimet e thundrave dhe me prani të ulçerave jo të thella, ose të sipërfaqshme të tabanit.
- Dele me çalime nga deformime të mëdha të thundrave dhe ulçera të thella të tabanit.

Varësisht nga grupimi i fundit i dëmtimeve në thundra është bërë trajtimi i deleve si më poshtë :

1. Në grupin e parë të deleve me çalime të formës së lehtë dhe mesatare me deformime të thundrave dhe me ulçera të sipërfaqshme, do të bëjmë vetëm prerjen e bririt e thundrave në përmasat e normës dhe dezinfektimin e tyre.
2. Në grupin e dytë të deleve me çalime të formës mesatare, me deformime dhe ulçera jo të thella të tabanit do të aplikojmë prerje të thundrave dhe trajtim me preparatin Linkomicinë HCL. me dozë 1 ml për 10 kg peshë të gjallë, *i/m*.
3. Në grupin e tretë për efekte krahasimi, do të bëjmë prerjen e thundrave, pastrirnin, dezinfektimin e tyre dhe mjekimin e përgjithshëm të deleve me preparatin Linkomicinë HCL, në dozat e treguara me sipër, të kombinuar me antiinflamatorin Flunixin meglumin në dozë 0.8 mg për kg peshë të gjallë.

peshkatarë); Sterbeq - Malesi e Madhe (15 peshkatore); Kalldrums - Malesi e Madhe (19 peshkatarë); Jubice - Malesi e Madhe (25 peshkatore); Flake - Malesi e Madhe (17 peshkatore); Zogaj – Shkoder (30 peshkatore); Shkodra 2 (15 peshkatore); Shiroke-Shkoder (14 peshkatore); Kamice - Malesi e Madhe (17 fishermen) dhe Grizhe - Malesi e Madhe (11 peshkatore). Aktiviteti i peshkimit në Liqenin e Shkodrës menaxhohet nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP) dhe kontrollon nga Inspektorati i Peshkimit të Qarkut të Shkodrës. Në OMP -në e Shkodrës janë të organizuar të gjithë peshkatarët që kryejnë aktivitetin e tyre në zonën ujëmbledhëse të liqenit të Shkodrës, nga Vau i Dejës në Grykëderdhjen e Lumit Buna.

Speciet kryesore të peshqve që zihen për qëllime tregëtare në Liqenin e Shkodrës janë krapit dhe gjuca, megjithëse në sezona të caktuara qefulli, ngjala dhe kubla përfshihen në peshqit që kanë peshë në zënie; kjo për shkak të karakterit migrator të këtyre llojeve dhe të lidhjeve të liqenit me detin nëpërmjet Lumit Buna.

Sasia më e madhe e peshkut zihet me rrjeta nailoni bentike me përmasa të ndryshme syzesh (rrjeta gjuce, rrjeta krapit, rrjeta njile) me trata krahu dhe me long line me grepa. Rrjeta të mëdha përdoren në periudhën e dimrit për peshkimin e gjucës në dy zona: Shirokë dhe Zogaj). Në periudhën e dimrit zëniet më të mëdha i takojnë gjucës, ndërsa në sezonet e tjera, zëniet e specieve të tjera kanë peshë më të madhe.

Për një kohë të gjatë pas viteve '90 nuk është kryer dokumentimi i zënieve dhe i sforcos së peshkimit të përdorur në Liqenin e Shkodrës. Vetëm pas organizimit të peshkatarëve në OMP-në e Liqenit, ata u detyruan të mbushnin ditaret e peshkimit (logbooks) për aktivitetin e tyre të peshkimit.

Nga përpunimi i të dhënave të mbledhura, është llogaritur se në pjesën shqipëtare të Liqenit të Shkodrës prodhimi i peshkore totale për vitin 2014 është rreth 533 ton peshk, nga të cilët 32.3% janë shkurt, 31.1% krap, 15.9% karas, 15.6% gjucë, 3.6% qefull, 0.6% perkë, 0.5 ngjalë dhe 0.3% lloçë. Në Figurën 1 është paraqitur totali i zënieve për vitin 2014 për llojet më të peshkuara. Sasia vjetore e peshkut të zënë në dajlanin e Lumit Buna është 5 ton/vit, nga të cilat 3.6 t janë qefull dhe 1.4 t janë ngjalë.




Figura 1. Zëniet vjetore sipas llojeve më të peshkuara ne Liqenin e Shkodrës për vitin 2014.

Tabela 1. Numri mesatar i ditëve të peshkimit në muaj për një njësi sforco (1 varkë, 2 peshkatarë) nga 205 njësi peshkimi të licensuara në Liqenin e Shkodrës.

Jan.	Shk.	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nent.	Dhjet.
13.1	10.8	11.5	1.1	0.3	12.1	13.2	13.3	14.0	13.9	12.6	10.5

Siç duket edhe nga Tabela 1, numri mesatar i ditëve të peshkimit në vit për një njësi të sforcos është (1 varkë, dy peshkatarë) është 126. Sforco e peshkimit (CPUE) u llogarit të jetë 20.1 kg/ njësi peshkimi / ditë.




Figura 2. Zëniet mujore për llojet më të peshkuara të liqenit të Shkodrës për vitin 2014. (Periudha prill deri në mes të majit është sezon i mbyllur për peshkimin tregëtar në Liqenin e Shkodrës).




Figura 3. Përbërja llojore e peshkimit tregëtar në 2014 në Liqenin e Shkodrës.

Krahasuar me të dhënat e vitit 2013 (Dervishi et.al., 2014; Kolaneci et al., 2014), prodhimitaria totale e liqenit në 2014 është rritur me 136 ton. Struktura e zënieve në liqenin e Shkodrës gjithashtu paraqet ndryshime. Me gjithë rritjen e prodhimitarisë totale të liqenit në 2014 krahasuar me 2013, prodhimitaria e gjucës ka rënë me 19.3%. Shkaku i kësaj rënie të prodhimitarisë mund të jenë përmbytjet e viteve 2011, 2012 në pellgun ujëmbledhës të Lumit

Drin & Liqenit të Shkrodrës, që për shkak të rritjes së nivelit të ujit mund të kenë dëmtuar vezët, larvat dhe juvenilët e gjucës. Monitorimi i metejshëm i prodhimit të gjucës, por edhe i përbërjes moshore të popullatës së saj do të na japi informacionin e nevojshëm për të shpjeguar rënien e prodhimit të gjucës. Zëniet e shkurtit janë rritur me 52.1% krahasuar me 2013. Ka të ngjarë që zëniet të jenë edhe më të larta se kaq, por nuk deklarohen nga peshkatarët, meqenëse ata e kthejnë përsëri në liqen një pjesë të peshkut të zënë për shkak të preferencës së ulët që ka tregu për këtë lloj. Një tjetër fenomen negativ që vihet re është ulja e prodhimit të peshqve migratorë si qefulli, ngjala dhe kubla. Zëniet e qefullit dhe ngjalës në 2014 janë ulur përkatësisht me 48% dhe 37.2% krahasuar me 2013. Për kublën mungojnë të dhënat nga OMP-ja e Liqenit të Shkodrës për këtë vit. Ka mundësi që zvogëlimi i popullatave të peshqve migratorë të jetë rezultat i moshapjes së portave të dajlanit në Lumin e Bunës dhe zënien e paligjshme të peshqve në periudhën e migrimit të tyre në ujrat e brendshme. Ashtu siç është duke u implementuar me sukses në Liqenin e Shkodrës plani i menaxhimit të peshkimit, do të rekomandim një kontroll më të rreptë të kufizimeve në kohe të peshkimit edhe në Lumin e Bunës, në mënyrë që t'ju lejohet migrimi i llojeve me vlera të larta ekonomike si ngjala, blini, qefulli, etj.

4. LITERATURA

1. Dervishi, B., V. Kolaneci, A. Çinari, A. Haziraj. (2014) Evaluation of ichthyic species and fishery catch structure in Shkodra Lake. Book of Abstracts, Second International Conference on Applied Biotechnology, September, 22, Tirana, Albania p. 16.
2. Kolaneci, V., B. Dervishi, R. Baku. (2014) Evaluation of population's dynamics of carp in Shkodra Lake. Proceedings, Second International Conference on Applied Biotechnology, September, 22, Tirana, Albania p. 63-66.
3. Dhora Dh, Smajlaj Rr, Dhora A, (2008) Katalogu i peshqve të ujrave të brendshme të Shqipërisë. Bul. Shk., Ser. Shk. Nat., 58, pp. 100-130.
4. Filipi, N. (1957) Iktiofauna e liqenit të Shkodrës.
5. Marić, D. & Milošević, D. (2011). Catalog of freshwater fishes (Osteichthyes) of Montenegro. Montenegrin academy of Sciences and arts. Volume 5, Book 4. Podgorica. pp 114
6. Memia, Sh. (1988) Studimi i dinamikës së populacioneve të gjucës (A.alborela, F.) dhe krapit (C.carpio, L.) në Liqenin e Shkodrës dhe të Fierzës. Dizertacion. 70 p.
7. MMPAU (Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave) 2011-2013. Plani i Menaxhimit të Peshkimit dhe Akuakulturës.

**ANTIBIOTIKOREZISTENCA NË DISA SHTAME TË IZOLUARA TË
SALMONELLA ENTERITIDIS NGA SHPENDËT PËR PRODHIMIN E VEZËVE NË
REGJIONIN E SHTIMES-KOSOVË**

HYZER RIZANI**, BESART JASHARI**, SMAJL RIZANI**, PRANVERA CABELI*,
TANA SHTYLLA*, SONILA ÇOÇOLI*

*Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Tiranë, Shqipëri

**Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë, Prishtinë,
KOSOVË

Email: hyzer.rizani@gmail.com

PËRMBLEDHJA:

Salmonella enteritidis përfaqësojnë një grup bakteresh të njohura si shkaktare të ethes tifoide, helmimeve ushqimore, gastroenteriteve, ethes enterike si dhe sëmundje të tjera në njerëz. Njerëzit infektohen kryesisht përmes ujit të kontaminuar ose ushqimeve, veçanërisht mishit, mishit të pulave dhe vezëve. Gjinia Salmonella përfshin mbi 2300 serotipeve të bakteve. Salmonella enteritidis dhe Salmonella typhimurium janë përgjegjës përmbi 50% të të gjitha infeksioneve të shkaktuar në njerëz kudo në botë. Qëllimi i këtij studimi është përcaktimi indieshmerisë dhe rezistencës ndaj antibiotikëve të disa shtameve të izoluara të Salmonella enteritidis në fermat dhe pularitë private për prodhimin e vezëve në Shtime-Kosovë. Janë hulumtuar 20 ferma dhe shpendari private të ndryshme nga komuna e Shtimes. Në total janë analizuar 104 mostra nga feçet, vezët dhe organet e pulave. Izolimi dhe identifikimi është bërë sipas ISO 6579:2002. Nga 104 mostrat e analizuar janë izoluar 9 (8.65 %) shtame të Salmonella spp., dhe nga këto janë konfirmuar 4 (3.84%) shtame të Salmonella enteritidis. Testi i antibiogramës është kryer në 4 shtame të Salmonella enteritidis me metodën Kirby-Bauer. Disk metoda e testit të difuzionit në përputhshmëri me standardin e institucioneve dhe laboratorëve klinike CLSI. Është përdorur Mueller Hinton agar me disqet e antibiotikëve të grupeve të ndryshme ku kemi fituar këto rezultate në ndjeshmëri dhe rezistencë: Gentamicin 10 mcg-S/66.2%, I/12.4% dhe R/21.4%, Trimethoprim-sulfamethoxazole Sxt 25 mcg – S/33.4, I/48.3% dhe R/18.3%, Ampicilin Amp 2 mcg S/15.6%, I/23.5 dhe R– 60.9% dhe Cephalixin CL 30mg-S/16.4, I/77 dhe R/6.6%.

Fjalëkyçe: *Salmonella, I-intermediar, rezistencë, shtame, antibiogram.*

SUMMARY

Salmonella enteritidis is a group of bacteria that cause typhoid fever, food poisoning, gastroenteritis, enteric fever and other diseases. Humans become infected mainly through contaminated water or food, especially meat, poultry and eggs. Salmonella genus includes over 2,300 serotypes of bacteria. Salmonella enteritidis and Salmonella typhimurium are responsible for over 50% of all human infections in the World. The purpose of this study has been the definition of sensibility and resistancetoward antibiotics of some isolated strains of Salmonella enteritidisdgender in private farms and poultry for the production of eggs in Shtime-Kosovo. There are investigated 20 different private poultry farms from Shtime municipality. In total 104 samples were analyzed by faeces, eggs and poultry bodies. Isolation and identification has been made according to ISO 6579: 2002. From 104 analyzed samples are isolated 9 (8.65%) strains of Salmonella spp, and from these are confirmed 4 (3.84%) strains of Salmonella enteritidis. Antibiogram test is performed on 4 strains of salmonella enteritidis Kirby-Bauer method. Disk diffusion test method must be in compliance with the standard of CLSI clinical institutes and laboratories. Mueller Hinton agar was used with drives of various antibiotics where we get these

results in sensitivity and resistance: Gentamicin 10mcg-S / 66.2%, I / 12.4% and R / 21.4%, Trimethoprim-sulfamethoxazole SXT 25 mcg - S / 33.4, I / 48.3% and R / 18.3%, Ampicillin Amp 2 mcg S / 15.6%, I / R 23.5 and 60.9% and cephalexin 30mg CL-S / 16.4, I / 77 and R / 6.6%.

Key words: *Salmonella*, *I-intermediate*, *resistance*, *strain*, *sensitivity*.

HYRJE

Salmonellozat përfaqësojnë një sëmundje bakteriale të traktit intestinal. Përfaqësuesit e gjinisë *Salmonella* janë një grup bakteresh që shkaktojnë ethen tifoide, helmimet ushqimore, gastroenteritet, ethen enterike dhe sëmundje të tjera në njerëz. *Salmonella enteritidis* është një bakter gram-negativ në formë shkopi i njohur si shkaktar i sëmundjes diarrike në njerëz [1]. Njerëzit infektohen kryesisht për mes ujit të kontaminuar ose ushqimeve, veçanërisht mishit, mishit të pulave dhe vezëve. Produktet e pulave dhe vezët janë të ndotura shpesh me *S. enteritidis*, ndërsa produktet viçit janë të ndotura zakonisht me *S. typhimurium*.

Lufta ndaj këtyre baktereve konsiston në zgjedhjen e antibiotikëve efektive, mbasi është kritike trajtimi i infeksioneve invasive të shkaktuara nga speciet e gjinisë *Salmonella*, sepse rezistenca e tyre ndaj antibiotikëve është rritur. Rezistenca antimikrobale është një problem në rritje për shëndetin publik human dhe veterinar, pasi ka rritje në morbiditetin dhe mortalitetin të njeriut dhe kafshës. Antibiotikët përdoren për trajtimin e kafshëve të infektuara për të mbrojtur ato nga sëmundjet infektive, por përdorimi i madh i antimikrobikëve mund të shkaktojë seleksionimin dhe përhapjen e patogjenëve rezistentë si *S. enteritidis*, të cilët transmetohen tek njerëzit nëpërmjet ushqimit të kontaminuar.

MATERIALI DHE METODAT

Studimi është kryer në Laboratorin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në Kosovë. Studimi është kryer në periudhën kohore, janar-dhjetor 2014 me kampione të vezëve, feçeve, dhe organeve. Janë hulumtuar gjithsej 104 mostra, prej nga janë izoluar 9 shtame të *Salmonella* spp, 4 prej tyre janë shtame të *Salmonella enteritidis*. Janë testuar 4 shtame të *Salmonella enteritidis* në ndjeshmëri dhe rezistence ndaj grupeve të ndryshme të antibiotikëve. Testimi është kryer sipas Kirby-Bauer metodës me disk difuzion në përputhshmëri me standardet e CLSI [1].

Materiali për testim është përdorë: terreni Mueller Hinton Agar 2 i rehidruar në pjatë 90 mm, NaCl 0,9%, antibiotikët: Gentamicin 10mcg, Trimethoprim-sulfamethoxazole Sxt 25 mcg, Ampicilin Amp 2 mcg, dhe Cephalexin CL 30mg.

Shtamet e *S. enteritidis* janë përgatitur paraprakisht në terren pasurues BPW pastaj janë transferuar në pjatë me MHA-2 ku shtrirja është bërë në mënyrë uniforme në tërë sipërfaqen e pjatës. Më pas janë vendosur disqet e antibiotikëve në distancë të caktuara dhe pjatat janë futurë në inkubim në 37 °C për 24 orë. Pas inkubimit janë ekzaminuar rezultatet duke bërë matjet me anë të noniusit (kaliperit) për secilin disk (antibiotik).

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Ekzaminimet u kryen në Laborator të Nivelit të Dytë të Sigurisë dhe shtamet e izoluar të *Salmonella enteritidis* janë testuar me metodën e antibiogramës. Rezultatet e fituara për shtamet në studim janë si më poshtë: Gentamicina 66.2%, antibiotiku sulfamethoxazole 33.4%. Shtamet e *Salmonella enteritidis* kanë treguar rezistencë më të lartë në Ampicilin 60.9%, ndërsa me ndjeshmëri mesatare është treguar antibiotiku Cephalexin 77%.

Tabela 1. Përqindja e ndjeshmerisë dhe rezistencës së Salmonella enteritidis, ndaj disa antibiotikeve.

Gentamicin (10mcg), Trimethoprim-sulfamethoxazole (Sxt 25 mcg), Ampicilin (Amp 2 mcg), Cephalexin (CL 30 mg).

Nr.	Antibiotikë te zgjedhur	Nr.shtameve	Sensitive	Intermediate	Rezistente
1.	Gentamicin 10mcg	4	62.2 %	12.4%	21.4%
2.	Trimethoprim-sulfamethoxazole Sxt 25 mcg	4	33.4%	48.3%	18.3 %,
3.	Ampicilin Amp 2 mcg	4	15.6%	23.5%	60.9%
4.	Cephalexin CL 30 mg	4	16.4%	77%	6.6%.

Sikurse vihet re nga tabela e më sipërme, shtamet në studim të festuara me metodën e Kirby Bauer-it kanë treguar këto rezultate në ndjeshmëri 62.2% Gentamicina 10mcg, dhe më pak të ndjeshme me 33.4% Trimethoprim-sulfamethoxazole Sxt 25 mcg, rezistente është treguar në antibiotikun Ampicilin Amp 2 mcg me 60.9% dhe me ndjeshmeri mesatare antibiotiku Cephalexin CL 30 mg me 77%. Shtamet e Salmonella enteritidis vazhdojnë të shfaqin rezistente ndaj antibiotikut Ampicilin ku nga 32 izolate 21 prej tyre janë paraqitur si rezistente në antibiotikun Ampicilin ose shprehur në përqindje 65.62% në qendrën kombëtare për kërkime toksikologjike në Irak[7].

Edhe në hulumtime të kryera në fermat e pulave në Kinë në vitin 2008, prej 311 shtameve të mbledhura nga burime të ndryshme janë izoluar dy serovare: Salmonella indiana 133(42.8%) dhe Salmonella enteritidis 178(57.2%) dhe është vlersuar rezistenca antimikrobiale. Rezultatet e këtij studimi prezantojnë një rezistencë dhe ndjeshmëri që përputhet me rezultatet tona[8].

Shqetësimi në rritje e rezistences mikrobiale ndaj antibiotikeve shihet edhe në hulumtimet e bëra shumë vende të botës ku një hulumtim i tillë është bërë në Brazil dhe shihet një ngrtje e antibiotikorezistences ndaj ampicilinës 18,9%, dhe gentamicinës 9.6%) gjatë periudhës së studimit[6.10]. Rezistenca antimikrobiale e shtameve të Salmonella enteritidis në përgjithësi është e koduar nga plazmide, e cila fitohet si pasojë e presionit të vazhdueshëm e përdorimit pa kriter të antibiotikëve në mjekësinë humane dhe veterinare[9].

KONKLUZIONET

Rezultatet e fituara mbi shtame të Salmonella enteritidis me testimin e ndjeshmerisë dhe rezistencës antimikrobiale janë si më poshtë:

Për herë të parë është kryer prova e antibiogramës për shtamet e Salmonella enteritidis të izoluar në fermat e pulave në regjionin e Shtimes.

- Salmonella enteritidis ka treguar ndjeshmëri të lartë ndaj antibiotikut Gentamicin 10 mcg me përqindje 66.2%, gjithashtu edhe njëpërqindje pak më të ulët të ndjeshmerisë është paraqitur në antibiotikun Trimethoprim-sulfamethoxazole Sxt 25 mcg me 33.4% dhe antibiotiku Cephalexin CL 30 me 16.4%.

- Shtamet e Salmonella enteritidis janë shfaqur rezistente ndaj antibiotikut Ampicilin Amp 2 mcg me përqindje 60.9%.
 - Ndërsa në antibiotikun Cephalexin CL 30 mg shtamet e Salmonella enteritidis janë paraqitur intermediate 77%, gjithashtu edhe në antibiotikun Trimethoprim-sulfamethoxazole Sxt 25 mcg është paraqitur një përqindje 48.3%.
- Rezultatet e para tregojnë se përdorimi i antibiotikëve në industrinë e shpendarisë në Kosovë behet pa kriter. Kjo nënvizon nevojën e përdorimit me shumë kujdes të antibiotikëve në praktikën veterinare për të shmangur problemet në rritje të antibiotiko – rezistencës dhe në mjekësinë humane.

LITERATURA

1. Çabeli, P. a. (2006). Bakteriologjia-Mykologji Veterinare. Tiranë: Universiteti Bujqësori Tiranës.
2. F. Polo a, M. F., & *, I. I. (2006, January 17). <http://onlinelibrary.wiley.com>. Retrieved from <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/j.1574-6968.1998.tb12919.x/references>.
3. Bauer KA, J Sherris, M Turk.: Antibiotic susceptibility testing by standardized single disc method. *Amer. J Clin Pathol*, 1966 45: 493-496.
4. Jan Hudzicki: Kirby-Bauer Disk Diffusion Susceptibility Test Protocol. American Society for Microbiology, Washington, DC 2009, Accessed 10 September 2010
5. Salm-Surv, G. (2003). Laboratory Protocols . In R. S. Hendriksen, Laboratory Protocols Level 1 Training Course Identification of Salmonella. Global Salm-Surv.
6. Costa RG, Festivo ML, Araujo MS, Reis EM, Lázaro NS, Rodrigues DP. Antimicrobial susceptibility and serovars of salmonella circulating in commercial poultry carcasses and poultry products in Brazil. *J Food Prot.* 2013Dec;76(12):2011-7. doi: 10.4315/0362-028X.JFP-13-164. PubMed PMID: 24290674.
7. Mezal EH, Sabol A, Khan MA, Ali N, Stefanova R, Khan AA. Isolation and molecular characterization of Salmonella enterica serovar Enteritidis from poultry house and clinical samples during 2010. *Food Microbiol.* 2014Apr;38:67-74. doi: 10.1016/j.fm.2013.08.003. Epub 2013 Aug 27. PubMed PMID:24290628.
8. Lu Y, Wu CM, Wu GJ, Zhao HY, He T, Cao XY, Dai L, Xia LN, Qin SS, Shen JZ. Prevalence of antimicrobial resistance among Salmonella isolates from chicken in China. *Foodborne Pathog Dis.* 2011 Jan;8(1):45-53. doi: 10.1089/fpd.2010.0605. Epub 2010 Nov 17. PubMed PMID: 21083518.
9. Threlfall EJ, Frost JA: Plasmid profile typing can be used to subdivide phage type 49 of Salmonella typhimurium outbreak investigation. *Epidemiol Infect* 1990, 104: 243-51.
10. Vaz CS, Streck AF, Michael GB, Marks FS, Rodrigues DP, Dos Reis EM, Cardoso MR, Canal CW. Antimicrobial resistance and subtyping of Salmonella enterica subspecies enterica serovar Enteritidis isolated from human outbreaks and poultry in southern Brazil. *Poult Sci.* 2010 Jul;89(7):1530-6. doi: 10.3382/ps.2009-00453. PubMed PMID: 20548083.
11. Hulaj Beqe, Çabeli Pranvera, Goga Izedin, Shtylla Tana.: Isolation, identification and prevalence of Salmonella spp. in some poultry farm for egg production in Kosovo Albanian *j.agric.sci.* ISSN: 22182020,(2012), (Special Edition) Copyright © Agricultural University of Tirana.

**RIPRODHIMI I PROGRAMUAQR NE DELE JAShte SEZONIT TE
RIPRODHIMIT
PROGRAMMED REPRODUCTION IN SHEEP OUTSIDE THE MATING SEASON
TAULANT KASTRATI¹, LUIGJ TURMALAJ², BLERTA MEHMEDI³**

¹ Practical Veterinary, KOSOVO

² University of Tirana, Veterinary Medicine Faculty, ALBANIA

³ University of Pristine, Faculty of Agriculture and Veterinary, Boulevard “Bill Clinton” nn.,
10000 Pristine, KOSOVO
kastratitaulant@yahoo.com

ABSTRACT

The ewes follow the seasonal reproductive pattern which in the climate conditions of Kosovo means that the sexual activity is manifested from June to August. We assessed the efficiency of two hormonal protocols for the oestrus synchronization in ewes out of the sexual season (during March–April 2012). For this reason two experimental groups, each comprised of 50 Sharr breed ewes, are formed. The both groups had the same breeding and physiological status (all are over 60 days after parturition) as well as management conditions. The treatment for the first group was comprised of progestagen vaginal sponge insertion (Fluor Geston Acetate, 40 mg, Intervet®) for 14 days and the 500 IU of eCG (equine Chorionic Gonadotropin), Foligon (Intervet®), i/m were applied at the time of vaginal sponge removal. The second group followed the similar protocol, but they were additionally treated with 0.1 mg/ewe gonadotropin releasing hormone (GnRH; Fertagyl, Intervet®) 36 h after the eCG application. The oestrus was detected by presentation of the ewes to ram 48 h after the vaginal device was removed. The presented ewes were mated twice in the interval of 12 hours. From the data of the study we have the rate that induced oestrus for the both groups was 94 % and 96 % respectively ($P > 0.05$). We believe that combining hormonal treatment following an accurate methodology delivers very good results in inducing and synchronizing the estrus out of the mating season in sheep.

Key-words: *oestrus detection; mated; out of season; oestrus synchronization*

PËRMBLEDHJE

Delet ndjekim procesin riprodhues sezonal, i cili në kushtet klimaterike të Kosovës nënkupton manifestimin e aktivitetit seksual nga periudha Qershor – Gusht. Ne përlllogaritëm efikasitetin e dy protokolleve hormonale për sinronizimin estral në delet jashtë sezonit seksual (Mars – Prill 2012). Për këtë arsye u formuan dy grupe eksperimentale, secili i përbërë nga 50 dele të racës Sharr. Të dyja grupet patën të njëjtin status riprodhues dhe fiziologjik (të gjitha janë mbi 60 ditë pas lindjes) si dhe kushtet menaxhuese. Trajtimi për grupin e parë u krye me tampon vaginal me përmbajtje progesteroni (Fluor Geston Acetate, 40 mg, Intervet®) për 14 ditë dhe me 500 IU eCG (equine Chorionic Gonadotropin), Foligon (Intervet®), i/m u aplikuan në të njëjtën kohë me heqjen e sfungjerit vaginal. Grupi i dytë ndoqi të njëjtën procedurë, por ata u trajtuan me 0.1 mg/dele shtese gonadotropinë që çliron hormone (GnRH; Fertagyl, Intervet®) 36 h pas aplikimit të eCG. Estrusi u dallua nga ekspozimi i deleve ndaj dashit 48 orë pasi pajisja vaginale ishte hequr. Delet e ekspozuara u çiftëzuan dy herë në një interval prej 12 orësh. Nga të dhënat e studimit ka rezultuar që estrusi i detyruar për të dyja grupet ishte respektivisht 94% dhe 96% ($P > 0.05$). Ne besojmë se kombinimi i trajtimit hormonal i bërë sipas një metodologjie të përcaktuar saktësisht, do të sjellë rezultate shumë të mira gjenerimin dhe sinkronizimin e estrusit jashtë sezonit të çiftëzimit në dele.

Fjalë-kyçe: *zbulimi i afshit, ndërzim, jashtë sezonit, sinkronizimi i afshit*

HYRJE

Dhent konsiderohen specie me aktivitet seksual sezonal. Varësisht nga pozicioni gjeografik ky aktivitet është i ndryshëm (fotoperioda). Në kushtet e Kosoves, periudha e aktivitetit seksual, është gjatë muajve Qershor-Gusht. Periudha e inaktivitetit seksual (anestrusit të thellë) shfaqen në muajt Janar-Mars. Studimet e avancuara mbi fiziologjin e riprodhimit të delet kanë treguar se aktiviteti seksual i tyre mund të nxitet nëpërmjet trajtimeve hormonal edhe jashtë sezonit të riprodhimit. Delet pas pjelljes bien në gjëndjen e anestrusit sezonal ose të laktacionit. Shkalla e anestrusit varet nga një ser faktorësh si; gjëndja shëndetësore, të ushqyerit, raporti dritë/errësirë në harkun e 24 orëve (fotoperioda), mëmëzimi, faktori mashkull, prodhimi i qumështit, etj. (Scaramuzzi et al, 1999, Sulo 1990). Trupi i verdhe i barrësisë tek delet regrdohet para pjelljes (Beghelli, 1992, Bartlewski et al, 1999). Kjo do të thotë që vezoret e deleve pas pjelljes nuk kane as TV si burim i progesteronit dhe as folikula antrale si burim të estrogenëve. Për rrjedhoj në gjakun qarkullues të deleve mungoj te dy këta hormone të cilët janë të domosdoshem për nxitjen e hipotalamusit për të prodhuar GnRH (Youngquist 1997, Skaramuzzi et al, 1999, Skinner et al, 2002). Mungesa e GnRH, bën që edhe hipofiza të mos prodhoj HFS dhe HL. Gjatë periudhës së anestrusit, kinetika folikulare (folikulogjeneza atonike), është i kufizuar. Në vezore rriten folikula të vogla me diameter deri 5 mm, të cilat më pas atrezohen (Bartlewski et al, 1998). Ky proces ovarik nxitet kryesisht nga faktoret lokal të rritjes. Procesi përseritet disa herë deri sa faktoret ambiental, menaxherial dhe ata hormonal, “pranohen” nga biologjia e ciklit estral të delet (Caraty et al, 2002, Mori et al, 1998). Nderhyrja nga jashtë me hormone sintetike si Progesteron, PMSG dh GnRH, nxisin aksin hipotalamo-hipofizo-vezore në dobi të aktivizimit të proceseve të riprodhimit dhe jashtë sezonit të ndërimit (Intervet, 2002, Miller et al, 1998, Ozbej et al, 2001). Thelbi biologjik i trajtimit hormonal të deleve jashtë sezonit të ndërimit qëndron; në aftësinë e tamponit vaginal për të cliruar progesteron (trup i verdhë artificial) dhe nxitur Hipotalamusin dhe Hipofizën për të prodhuar HFS dhe HL. (Bonanno et al, 1997, Biba et al, 2004, Degl’Inocennti et al, 1992, Beghelli 1992, Evans et al, 2004).

MATERIALI DHE METODA

Ky studim u realizua në kushtet e klimës së Pejës, Kosove. Për këtë qëllim u përzgjollën dele të racës “Sharri”, të moshës 2-6 vjece. Delet janë rreth 60 ditë pas pjelljes dhe pa mëmëzim të qëngjave. Statusi fiziologjik i vezoreve u përcaktua nëpërmjet ekografisë. Statusi metabolik nëpërmjet nivelin e glukozës në gjak. Delet u mbajten në kushte të barabarta mbarështimi (ushqimi, uji, hapsirës, etj). Trajtimi hormonal u bë sipas grupeve të eksperimentit.

Grupi i parë (50 krere) mori këtë trajtim hormonal:

Dita 1 (Mengjes). Vëndosja e tamponit në vaginë (Fluor-Geston-Acetat, 40 mg).

Dita 14 (Mengjes). Hegja e tamponit vaginal dhe injektimi i PMSG (Foligon), 500 UI, i/m.

Dita 16 (Mengjes). Zbulimi i afshit dhe ndërimit individual i kontrolluar (natyral).

Grupi i dytë (50 krerë), përvec trajtimit të mësipërm delet u trajtuan me GnRH, 0.1mg (Fertagyl), 36 orë pas injektimit të PMSG.

Per realizimin e ndërimit u perzgjodhen 10 desh te se njejtës race me kondicion shendetsor optimal. Po ashtu per deshët u krye edhe ekzaminimi andrologjik.

Nderzimi u krye duke respektuer nje ngarkes normale deri 5 dele per dash dhe nderzimi ng njeri tek tjetri me 20 minuta pauz. Nderzimi u be dy here ne dite me interval 12 ore.

Studimi synon: së pari, të vlerësojë shkallën e nxitjes dhe sinkronizimit të afshit në dele gjatë anestrusit të thellë, me ndihmen e faktorit hormonal (FGA+PMSG) dhe së dyti, të vlerësojë shkallën e pjellorisë dhe pjellshmerisë për dy skemat hormonale të trajtimit (FGA+PMSG & FGA+PMSG + GnRH) kjo e fundit do te publikohet ne nje kohe tjeter.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Drejtimet kryesore të studimit u përqëndruan në vlerësimin e aktivitetit ovarik te deleve jashte sezonit të riprodhimit, nëpërmjet ekografisë (anestrusi i thellë), për statusin metabolik, nëpërmjet matjes së nivelit të glukozës në gjak, për shkallën e nxitjes dhe sinkronizimit të afshit si dhe për shkallën e pjellorisë dhe lindshmërisë së qëngjave me dy metodat e trajtimit hormonal.

a. Aktiviteti ovarik gjatë anestrusit të thellë në delet e eksperimentit.

Nga imazhet ekografike të marra nga një sondazh në delet e eksperimentit, rezulton se “kinetika folikulare” është prezente edhe jashtë sezonit të ndërimit. Megjithate diametri i folikulave varion nga 2-5 mm. Këto folikula nuk mund të prodhojnë sasin e duhur të estrogenëve për nxitjen e ciklit estral (Bartlewski et al, 1998, McNilly et al, 1991, Broers, 1996, Beghelli, 1992). Mos arritja e maturimit dhe më pas të ovulimit ose luteinizimit të folikulave, bën që të mungoj edhe burimi i progesteronit, faktor hormonal shumë i rëndësishëm për aktivitetin seksual (Driancourt et al, 1997, Scaramuzzi et al, 1998,).

b. Për sa i përket statusit metabolik, vemendjen e përqëndruam në drejtim të nivelit të glukozës në gjak. Duhet theksuar se pa një shtrat metabolik normal, rezultatet e trajtimit hormonal mbeten të ulta (Nagatani et al, 2000, Breadford et al, 1999, Bartlewski et al, 1999, Blache et al, 2000). Të dhënat e përfuara paraqitën në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1. Përqëndrimet e glukozës në delet e eksperimentit.

Grupet	Krerë	Përqëndrimi mesatar
Gr. i parë (FGA+PMSG)	50	50.6 ± 2.27 mg/%
Gr. i dytë (FGA+PMSG+GnRH)	50	53.9 ± 2.00 mg/%

Të dhënat tregojnë se përqëndrimi i glukozës në gjakë janë normale dhe dëshmojnë për një status metabolik optimal sa i përket nivelit të energjisë. Sipas Chagas & Blanch, vlerësimi i kondicionit riprodhues të deleve nëpërmjet “glucose hypothesis”, mbetet një alternative prognostike e vlefshme në praktikën e riprodhimit ovin.

c. Për treguesin e nxitjes dhe sinkronizimit të afshit. Përdorimi nga jashtë i dy hormoneve sintetike (Progesteron dhe PMSG), ka si qëllim nxitjen e aktivitetit seksual në delet e trajtuara. Dy grupet kanë një trajtim të njëjtë në drejtim të nxitjes së afshit. Të dhënat pasqyrohen në tabelën 2.

Tabela 2. Shkalla e nxitjes dhe sinkronizimit të afshit nëpërmjet trajtimit hormonal.

Grupet dhe krerët	Trajtimet	Pranimi i ndërimit pas PMSG			Shkalla e nxitjes/%
		48 orë	60 orë	72 orë	
I parë (50)	(FGA+PMSG)	50	48	-	94%
I dytë (50)	(FGA+PMSG+GnRH)	50	50	-	96%

Ardhja në afsh dhe ndërimiti i njëkohshëm i deleve në të dy grupet (95 %), dëshmon efektshmërinë e lartë të sistemit hormonal në studim (Domingues 1998). Veprimi i kombinuar i progesteronit dhe PMSG, kanë nxitur një afsh “natyral” dhe fertil. Këto rezultate janë ndihmuar edhe nga prezenca e kinetikës folikulare të vezoreve në delet e eksperimentit.

PËRFUNDIME

► Në kushtet e Kosoves, delet gjatë anestrusit të thellë (Mars-Prill), rezultojnë me aktivitet ovarik. Nëpërmjet ekografisë në vezoret e deleve u gjetën folikula me Ø 2-5 mm.

► Përqëndrimi i glukozës në gjak lëviz nga 50.6 ± 2.27 mg/% në grupin e parë në 53.9 ± 2.00 mg/%, për grupin e dytë ($P < 0.05$). Ky nivel mund të merret si tregues i mirëqënjës shëndetësore të deleve përpara trajtimit hormonal.

► Trajtimi metodik i deleve në anestrusin e thellë me sistemin “dy valent” (FGA + PMSG), ose “tre valent” (FGA + PMSG + GnRH), nxitë afshin në 95 % të krerëve të trajtuara.

LITERATURA

1. Bartlewski M.P, Beard P.A, Cook J.S, and Rawling C.N. “Ovarian follicular dynamics during anoestrus in ewes”. *Journal Reproduction and Fertility*. 1998, 113; 275-285.
2. Bartlewski M.P, Beard P.A, Cook J.S, Honaramooza A, and Rawling C.N. “Ovarian antral follicular dynamics and their relationship with endocrine variables throughout the oestrous cycle in breeds of sheep differing in prolificacy”. *Journal Reproduction and Fertility*. 1999. 115; 111-124.
3. Beghelli V. “Regolazione endocrina dell’attività riproduttiva nella pecora e nella capra” Associazione Nazionale della pastorizia. Perugia, 1992;37-50.
4. Blache D, Chagas M.L, Blackberry A.M, Vercoe E. Ph, and Martin B.G. “Metabolic factors affecting the reproductive axis in male sheep”. *Journal Reproduction and Fertility*. 2000. 120; 1-11.
5. Biba N, Sulo Xh, Turmalaj L, Degl’Innocenti S, Polisca A, Di Salvo P. “Implementazione della conoscenza tecnico-scientifiche nel settore della riproduzione animale con particolare riferimento alle specie ovina e caprina. Progetto, FMV, Perugia-FMV, Tirane. 2002-2004.
6. Bonanno A, Grigoli A, Portolano B, Todaro M. “Effects of treatment with Fluor-Gestone-Acetate (FGA) and Pregnant Mare Serum Gonadotropine (PMSG) for oestrus induction and synchronization on the quality of milk products from Comisana ewes”. *Scienza e Tecnica Lattiero Casearia*. 1997, 48; 111-132.
7. Broers P. “La riproduzione nell’ovino”. In: *Compendio di Riproduzione Animale*. Intervet. 1996; 97-123.
8. Caraty A, Delaleu B, Chesneau D, and Fabre-Nys C. “Sequential role of E2 and GnRH for the expression of estrous behavior in ewes”. *Endocrinology*. 2002, 143(1);139-145.
9. Degl’Innocenti S, Carnevali F, Polisca A, Sargenti M. “Comparazione tra tre diversi metodi di iniezione e sincronizzazione degli estri nella pecora sarda. *Il Vergaro*, 1986, 5, 21-24.
10. Driancourt A.M. “Ovulation rate: Control mechanisms and manipulation”. In: *International conference on production diseases, in farm animals*. 1997, Berlin.11-14.
11. Ginther JO, et al. “Mechanism of follicle deviation in monovular farm species”. *Animal Reproduction Science*. 2000, 58. 197-213.
12. Evans O.C.A. “Pattern and manipulation of follicle development in sheep and goats”. 55-th annual meeting. 2004. Slovenia;1-10.
13. Maracek I, Krajnickova M, Kostecky M, Gresarova G, Valocky I. “Tertiary follicular growth wave dynamics after oestrus synchronization and superovulation in ewes and goats”. *Animal Physiology*. 2002. 71, 481-486.
14. Intervet. “CRONO-GEST” per induzione e la sincronizzazione nell specie ovine e caprine”. Milano. 2002.
15. McNeilly S.A, Picton M.H, Campbell K.B and Baird T.D. “Gonadotrophic control of follicle growth in ewes”. *Journal Reproduction and Fertility*. 1991, 43, 259-265.
16. Miller WD, Blache D. “Control metabolic messengers and the effects of nutrition on gonadotrophin secretion in sheep”. *Journal of Reproduction and Fertility*. 1998, 112, 347-356.
17. Mori J. “Hormones of reproduction in farm animals: Basic and practical advances”. Kitasoto University. 1998; 45-55.

18. Ozbej O, Tatli P. “ The effects of oestrous synchronization and flushing on reproduction of Awassi ewes”. VETCD 2001, 19; 109-115.
19. Scaramuzzi J.R and Downing A.J. “Effect of progesterone on the GnRH-induced secretion of estradiol and androstenedion from the autotransplanted ovary of the anoestrous ewes”. Journal Reproduction and Fertility. 1999, 123; 269-280.
20. Skinner C.D, Cilliers D.S and Skinner D.J. “Effect of ram introduction on the oestrous cycle of springbok ewes”. Reproduction. 2002, 124; 509-513.
21. Sulo Xh. “Animal Reproduction and Theier Pathology”. 1990, (1), 145-150.
22. Youngquist R.S. “ Induction of fertile oestrus in ewes during the anestrous or transitional periode”. In: Current Therapy in Large Animal Theriogenology. 1997, 573, 607-611.

SUPPLEMENTATION WITH BIOTINE FOR PREVENTION OF ASEPTIC LAMINITIS IN COWS FOR MILK PRODUCTION

NEXHAT MAZREKU*, VANGJEL CERONI**, EMILIAN SHABANI**, AVNI ROBAJ***, XHEVDET KRASNIQI*

nairanireteV* in Malishevë, Kosovë

ënariT ,enicideM yranireteV fo ytlucaF ,seidutS lacinilC fo tneatraped**

.ënithsirP ,yranireteV dna erutlucirgA fo ytlucaF ***

Contact: vangjelceroni@yahoo.com

ABSTRACT

Lameness syndrome caused by aseptic laminitis is common in farm of cows for milk production. In the period March 2013 - March 2015, in the area of Malisheva into two groups of 20 heads of cattle, Simmental breed, at the beginning of lactation was studied impact of biotin in preventing laminitis and in hematological and hemato-biochemical indicators. Animals in the experiment were treated with equal portions of food with high content of easily fermentable foods. Animals of the second group were treated with a supplement containing biotin (nutrised). Ruminal fluid and blood samples from the jugular vein were analyzed every two weeks in the lab for the entire period of the experiment. From cows in the study sampled blood to assess leukocytes (WBC), red blood cell (RBC), total protein (TP), creatinine, bilirubin, magnesium (Mg), phosphorus (P) and calcium (Ca). Results were processed statistically. In the first group in the 3 heads (15%) laminitis syndrome manifested by changes in the values of some indicators. In cows with laminitis had decreased levels of Ca (7.32 ± 0.08 versus 8.76 ± 0.11 mg %), total protein (6.63 ± 0.05 versus 7.22 ± 0.05 g%) and inorganic phosphorus (5.48 ± 0.05 versus 6.11 ± 0.11 mg%). Increased values were found in the number of leukocytes (9.53 ± 0.09 versus $7.22 \pm 0.04 \times 10^3$), creatinine (2.12 ± 0.03 versus 1.3 ± 0.01 mg%) and bilirubin (0.63 ± 0.01 versus 0.44 ± 0.03 mg%), while the index values erythrocyte and magnesium underwent no changes.

Key words: *Biotin; aseptic laminitis; hemato-biochemical indicators; ruminal fluid.*

1. INTRODUCTION

In cows laminitis clinically manifested as lameness syndrome, is the most frequent pathology in cows in the period up to 4 months after calving. The term laminitis represents an aseptic inflammation of lamellar corium of the hoof wall that can spread to the sole surface, (Clakson, 2006). The causal factors of this process are various and are associated with housing conditions and especially with disorders in the diet of animals. A significant impact is caused by subacute ruminal acidosis (SARA), according to (Garry 2002 & Oetzel 2000). This condition is associated with weight loss, reduction in milk production, disorders in reproduction indicators and increase in the incidence of laminitis, (Ceroni et al., 2005; 2011). The increased presence of laminitis syndrome in cows in our farms raised the necessity for a study in order to experimentally determine the impact of biotin supplementation in the diet of dairy cows on the values of some of the hematological and hemato-biochemical indicators, and on preventing laminitis.

2. MATERIALS AND METHODS

The study was conducted during March 2013 - March 2015 with two groups of 20 dairy cows each in a farm where cows are fed a year-round silage based diet. Cows from both groups were randomly selected, belonged to the Simmental breed, and were in the period of early lactation with average milk production of 5000 – 6000 liters. In the trial period animals were treated equal with food rations with excessive rapidly fermentable foods. The structure of diet was processed with table data according to (McDonald et al. 1995). For the experiment group we applied supplementation with multivitamin product Nutrisel which contains 24 mg of biotin. Cows were fed Nutrisel at doses of 5 gr per cow during the entire period of experiment.

Animals from both groups were examined to measure the pH level of rumen contents. Rumen samples were collected by applying naso-esophageal probe, every two weeks, 3 hours after feed intake and 2 days prior to blood sampling. Blood samples from both groups were collected to evaluate some of the hematological and hemato-biochemical indicators. Blood samples from the jugular vein were collected every 2 weeks in two test tubes, with and without anticoagulants (EDTA). Numbers of white blood cells and red blood cells were counted by manual count method in MEDILAB – Prishtina. Using vacutainer tubes serum was obtained from a centrifuge with 2500 spins per minute, for a total of 20 minutes. The total protein, calcium, inorganic phosphorus, magnesium, total bilirubin and creatinine were than measured using the hemato-biochemical indicators. Cows in the experiment were monitored for possible clinical presence or absence of lameness syndrome from laminitis.

The obtained data were divided into control group, experiment and cows with laminitis. Results were statistically processed by variance analysis to assess effects on the group and significant statistical differences between animals from the two groups. Conclusions were drawn to determine the impact of biotin supplementation on hematological and hemato-biochemical indicators and prevention of occurrence of laminitis syndrome in cows. Statistical changes were evaluated ($p < 0.05$) for hematological and hemato-biochemical indicators.

3. RESULTS AND DISCUSSIONS

The data obtained during the entire trial period were divided in groups and statistically processed by groups; control group, experiment group and group of cows with occurrence of laminitis. In the end we calculated the mean values for each indicator, standard deviation and the reliability of change of indicator values by individuals in groups.

In the end of experiment, lameness syndrome was observed in 3 cows (15 %) in the control group; where there was no Nutrisel supplement feeding. Mean values for hematological indicators and rumen content pH in the group of cows with laminitis are shown on Table 1.

The obtained values show alterations in red blood cell (RBC) numbers with significant differences (not statistically confirmed) among animals in experiment group and laminitis group as compared with norm indicators and value indicators in control group. A different situation was presented with values of total leukocytes. The number of leukocytes increased in experiment group (8.11 ± 0.11 versus $7.22 \pm 0.04 \times 10^3/\text{ml}$). Increased values for leukocyte were also obtained in laminitis cows group ($9.53 \pm 0.09 \times 10^3/\text{ml}$). The differences in indicator values among groups of animals in the experiment are statistically confirmed ($P < 0.05$).

Table nr 1. Annual mean values for some of the hematological indicators and rumen pH in cows by groups; control, experiment and cows with laminitis.

Cow groups	Reference values	Mean values			
		M	± m	σ	tD
A- Control					
<i>WBC (x 103/μl)</i>	4 - 12	7.22	0.04	0.24	- 23.7
<i>RBC (x 106/μl)</i>	5 - 10	5.91	0.06	0.20	- 23.7
<i>Rumen pH</i>	6.2	6.19	0.22	0.11	- 16.2
B- Experiment					
<i>WBC (x 103/μl)</i>	4 - 12	8.11*	0.11	0.36	- 23.7
<i>RBC (x 106/μl)</i>	5 - 10	7.04	0.06	0.19	- 23.7
<i>Rumen pH</i>	6.2	6.22	0.3	0.09	- 12.8
C- Animals with laminitis					
<i>WBC (x 103/μl)</i>	4 - 12	9.53*†	0.09	0.31	- 23.7
<i>RBC (x 106/μl)</i>	5 - 10	6.29	0.1	0.31	-23.7
<i>Rumen pH</i>	6.2	5.63	0.24	0.11	- 14.2

*: Significant differences vs. group A ($p < 0.05$); † vs. group B ($p < 0.05$).

Comparative data for hemato-biochemical indicator mean values in cows in control group, experiment group and cows with laminitis are shown in Table 2. Statistical differences in indicators of cows of the three groups were found statistically significant, when $P < 0,05$.

Data comparison revealed no significant differences in mean values for magnesium concentrations. Indicators for total protein, total calcium and inorganic phosphorus underwent a slight decrease in animals with laminitis as compared with indicators in animals in experiment group. Total creatinine and bilirubin concentrations increased statistically in the experiment group and laminitis cows group. In cows with laminitis decreased levels were registered for Ca (7.32 ± 0.08 in cows with laminitis versus 8.76 ± 0.11 mg % in control group cows), protein (6.63 ± 0.05 vs. 7.22 ± 0.05 g %) and phosphorus (5.48 ± 0.05 vs. 6.11 ± 0.11 mg %). Increased values were found for creatinine indicators (2.12 ± 0.03 in cows with laminitis versus 1.3 ± 0.01 mg/%, in control group cows) and total bilirubin (0.63 ± 0.01 vs. 0.44 ± 0.03 mg/%), whereas no changes were observed for magnesium values.

Animals selected for the study were relatively homogenous in terms of breed, age, body weight and days in lactation during the period of collecting the samples. The third group was composed of animals in which we observed clinical signs of aseptic laminitis. The obtained data revealed changes in annual and monthly mean values for some of the hematological and hemato-biochemical indicators in cows of different groups. According to (Oetzel 2000 & Ceroni 2005; 2011), changes in the values of hematological and hemato-biochemical parameters are related to alternating pH values in the rumen contents. According to the data from the study, white blood cells were significantly higher in animals with signs of laminitis syndrome. The increase in the numbers of white cells was mainly on account of the increase of neutrophiles. Increase in white blood cell counts was also registered in experiment group cows treated with Nutrisel. The change in the values of white cells in experiment group cows was statistically confirmed ($P < 0.05$). The indicator for the number of erythrocytes showed that obtained values registered no significant changes. These conclusions are supported by other authors, (Ceroni 2011; Meglia et al. 2001; Morgante et al. 2007), etc.

Table nr 2. Mean values for hemato-biochemical indicators in cows of experiment group, control group and cows with laminitis.

Cow groups	Reference values	Mean values			
		M	± m	σ	tD
A- Control					
Total protein (g/%)	9.7 – 12.4	7.22	0.05	0.15	- 7.78
Total Ca (mg/%)	6.7 – 8.1	8.76	0.11	0.42	- 3.59
Inorganic P (mg/%)	5.6 – 6.5	6.11	0.11	0.35	- 6.6
Magnesium (mg/%)	1.8 – 2.3	1.82	0.01	0.05	- 38.8
Creatinine (mg/%)	1.0 – 2.0	1.3	0.01	0.05	- 42.9
Total bilirubin (mg/%)	0.01 - 0.5	0.44	0.03	0.10	- 32.1
B- Experiment					
Total protein (g/%)	9.7 – 12.4	7.09	0.08	0.26	1.31
Total Ca (mg/%)	6.7 – 8.1	9.32	0.07	0.24	- 3.59
Inorganic P (mg/%)	5.6 – 6.5	6.77 *	0.11	0.39	- 3.9
Magnesium (mg/%)	1.8 – 2.3	1.82 *	0.02	0.08	- 3.4
Creatinine (mg/%)	1.0 – 2.0	1.7	0.02	0.07	- 15.5
Total bilirubin (mg/%)	0.01 - 0.5	0.37	0.01	0.06	1.82
C- Cows with laminitis					
Total protein (g/%)	9.7 – 12.4	6.63 *	0.05	0.16	- 4.6
Total Ca (mg/%)	6.7 – 8.1	7.32 *	0.08	0.28	- 16.9
Inorganic P (mg/%)	5.6 – 6.5	5.48 *	0.05	0.17	- 9.3
Magnesium (mg/%)	1.8 – 2.3	1.82	0.02	0.06	- 3.3
Creatinine (mg/%)	1.0 – 2.0	2.12	0.03	0.11	8.06
Total bilirubin (mg/%)	0.01 - 0.5	0.63	0.01	0.03	- 5.3

*: Significant differences, versus control group ($p < 0.05$). Reference values according to Radostits (2005).

The study revealed a presence of increased levels of total protein, total calcium and inorganic phosphorus and decreased levels of creatinine and total bilirubin in experiment group cows as compared with same indicators in control group cows. The changes in the values of total protein were not statistically confirmed ($P > 0.5$). Changes in the values of total calcium among the groups were also statistically confirmed ($P < 0.005$). The opposite was observed in cows with laminitis. Changes in the values of hemato-biochemical indicators must have been caused by supplementation with biotin which influences the preserving of the balance of bacterial populations in rumen. Concentration of macrominerals such as total calcium, inorganic phosphorus in blood serum and concentrations of total protein, creatinine and total bilirubin were interesting findings which suggest that macromineral concentrations might be more predicative and revealing than was held before. Considering the data obtained we think that concentrations of hemato-biochemical indicators were sensitively affected in cows with laminitis. These conclusions are supported by findings by other authors, (Ceroni 2011; Garry 2002; & Oetzel 2000).

4. CONCLUSIONS

- Changes in hematological and hematobiochemical parameters were present in cows in the early period after calving.
- Supplementation with biotin in dairy cow has an impact in improving hematological and hemato-biochemical indicators. Indicators most likely to be impacted are the total of white blood cells, total protein, total calcium and inorganic phosphorus.
- In the group of cows treated with supplemental Biotin no case of laminitis was observed. In control group cows we observed 3 (15 %) cows with laminitis.

- In cows with laminitis evident differences were registered in hematological and hemato-biochemical indicators as compared with indicators in animals in the experiment group. Indicators with most evident changes were the total of white blood cells, total protein, total calcium, inorganic phosphorus, creatinine and total bilirubin.
- Supplementation with biotin in the diet of dairy cows is likely to prevent the occurrence of aseptic laminitis syndrome.

5. REFERENCES

Revista shkencore:

1. Ceroni V. e bp. Treguesit e gjakut në lopë në varësi të gjendjes ketonike. Revista Shqiptare e Shkencave Bujqësore. 2005, Nr.6/Vol. 4, fq.110 - 114
2. Ceroni V. e bp. Acidoza nënakte e rumenit dhe sindromi i çalimit në lopë në periudhën e parë të laktacionit. Buletini i Shkencave Natyrore. 2011. Nr. 11, fq. 130 - 136
3. Ceroni V. e bp. Hematological indicators affected by the subacute ruminal acidosis in dairy cows. Journal of Animal and Veterinary Advances. 2011, fq. 367-371
4. Meglia G.E., Johannisson A., Petersson L., Waller K.P. Changes in some blood micronutrients, leukocytes and neutrophil expression of adhesion molecules in periparturient dairy cows. Acta Vet Scand. 2011, Vol 42: 139 - 150.
5. Morgante M., Stelletta C., Berzaghi P., Giancesella M., Andrighetto I. Subacute rumen acidosis in lactating cows: an investigation in intensive Italian Dairy herds. J. of Animal Physiology and Animal Nutrition. 2007. 91: 226-234.

Libra:

1. Clakson M.L. Incidence and prevalence of lameness in dairy cow. 2006, fq.27-39.
2. Garry F.B. Indigestion in ruminants. In: Smith. B. P. (ed.), Large Animal Internal Medicine, 2002, 3rd edn. pp. 722-747.
3. McDonald P. Animal nutrition. 1995, pp. 367-371.
4. Radostits O.M., Blood D.C., Gay C.C. Acute carbohydrate engorgement of ruminants (rumen, overload). Veterinary Medicine. Philadelphia, 2005; pp. 262-269.

Proceedings të konferencave apo simpoziumeve shkencore:

1. Oetzel G.R. Clinical aspects of ruminal acidosis in dairy cattle. Proceedings of the 33rd Annual Convention of the American Association of Bovine Practitioner, 2000, pp. 46-53.



Seksioni/Section 3
Bujqësia dhe Mjedisja/Agriculture and Environment

**STUDIM I VDEKSHMËRISË RRUGORE TË FAUNËS SË EGËR VERTEBRORE
(AMFIBË DHE REPTILË) NË INFRASTRUKTURAT LINEARE
STUDY ON ROAD MORTALITY OF VERTEBRATE WILDLIFE FAUNA
(AMPHIBIANS AND REPTILES) IN LINEAR INFRASTRUCTURES**

ELISON ROTA^{1*}, ALBERT KOPALI¹, ADRIAN DOKO¹, SIMIR KRASNIQI²

¹Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri

²Departamenti i Edukimit Profesional, Prizren, Kosovë

*soni@ubt.edu.al

Abstrakt

Biodiversiteti vlerësohet sot si pasuria më e madhe e njerëzimit për vetë funksionet ekologjike që ai kryen. Por ndryshimi i habitateve dhe humbja e tyre, nëpërmjet shpyllëzimeve, aktiviteteve bujqësore, urbane e industriale, ndërtimi i infrastrukturave rrugore, ka shkaktuar humbje të konsiderueshme të specieve. Faktori kryesor në dëmtimin e biodiversitetit, atij floristik dhe veçanërisht faunistik, është fragmentizimi i territorit. Fragmentizimi i territorit nga infrastrukturat rrugore dhe impaktit të automjeteve mbi faunën vertebrorë, veçanërisht të asaj tokësore, ku kategoria më e prekshme rezulton të jetë ajo e amfibëve dhe reptilëve, është një problem proekupues në shumë vende të botës. Kjo për faktin se, sipas studimeve të kryera, shumë popullata të kafshëve të egra vertebrorë kanë pësuar një rënie të ndjeshme në zonat ku janë ndërtuar infrastrukturat rrugore. Rrugët dhe trafiku rrugor janë burimi kryesor i vdekshmërisë së tyre. Kërkimet mbi përcaktimin e nivelit të vdekshmërisë rrugore dhe marrja e masave projektuese për zbutjen e impaktit negativ të tyre, është e rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit faunistik. Ky studim ka pasur si qëllim evidentimin e shkallës së dëmtimit të faunës së vogël vertebrorë (amfibë e reptilë) në disa segmente të infrastrukturave rrugore, shtrirë ndërmjet ekosistemeve natyrore, në kushtet e Shqipërisë.

Fjale çelës: *biodiversitet, fragmentizim, amfibë, reptilë, vdekshmëri rrugore.*

ABSTRACT

Nowadays the biodiversity is estimated as the biggest humankind ownership for its spatial ecological functions that it performs. But the change and loss of their habitat through deforestation, agriculture, urban and industrial activities, and construction of road infrastructure has caused considerable loss of the ecological species. The main factor on flora and fauna in particular biodiversity damages is the fragmentation of the territory. Territory fragmentation from the road infrastructure and the impact of vehicles on vertebrate fauna, especially of that land fauna, where the category with most obvious results are that of amphibians and reptiles, is a distract problem in many countries. This is for the reason that according to the studies many populations of wild vertebrate animals have declined significantly in areas where built road infrastructures are. Roads and road traffic are the main source of their mortality. Research on the determination of the road mortality level and the project measures assumption to minimize their negative impact, it is important for the conservation of the fauna biodiversity. This study aimed at identifying the damaged degree of small vertebrate fauna (amphibious and reptile) in some segments of road infrastructure, extending between natural ecosystems in terms of Albania.

Key words: *amphibians, biodiversity, fauna, fragmentation, reptiles, road mortality.*

1.HYRJE

Dëmtimi i biodiversitetit floristik e veçanërisht atij faunistik, nga aktivitetet njerëzore, është tashmë një realitet, i cili evidentohet nga fakti se niveli i zhdukjes është shumë herë më i lartë krahasuar me kohën përpara se njeriu të ndërhynte në natyrë, kohë në të cilën verifikohesh vetëm zhdukja sipas ritmeve natyrore. Proçesi i cili ndikon më shumë në dëmtimin e biodiversitetit të ekosistemeve është ai i fragmentizimit të territorit. Në të gjithë Europën, proçesi i fragmentizimit të territorit sot vlerësohet si një problem i rëndësishëm i cili duhet studiuar në raport me impaktet që sjell në ekosisteme e sidomos në zhdukjen e biodiversitetit (Romano B., 2000). Proçesi i fragmentizimit të territorit nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturave lineare të transportit (rrugë e hekurudha) ka përbërë dhe përbën një problem proekupues në Europë (Prillewitz F.C., 1997). Ndërtimi i tyre sjell një sërë impaktesh negative në territor si shkatërrim i habitateve dhe fragmentizim të tyre, ndryshim i gjëndjes hidrogeologjike, ndotje të natyrave nga më të ndryshmet dhe vdekshmëri të popullatave shtazore (Bennet A.,1991; Forman R., Alexander L., 1998; Trombulak S.C., Frissel C.A., 2000, Shepard D.B., et.al.,2008). Një tjetër efekt që ndikon mbi shkatërrimin e popullatave dhe që krijohet nga fragmentizimi i infrastrukturave rrugore është efekti barriera (Corlatti L., et al., 2009; Kerth G., Melber M., 2009). Fragmentizimi i habitateve nga ana e tij përbën një nga faktorët më ndikues të rrezikut për mbijetesën e popullatave shtazore (Battisti C., 2004). Studimet sjellin shumë të dhëna mbi impaktet negative të rrugëve mbi jetën e egër dhe ekosistemet, duke sugjeruar që këto infrastruktura paraqesin faktorin kryesor në humbjen e biodiversitetit (Forman R., et.al., 2003). Ndërtimi i infrastrukturave rrugore dhe rritja e trafikut rrugor përbën një nga faktorët e vdekshmërisë rrugore duke ndikuar në përhapjen e tyre dhe në rritjen e rrezikut të zhdukjes (Trombulak S.C., Frissell C.A., 2000; Forman R., et al., 2003, Beaudry F., et.al., 2008, Row R.J., et.al., 2007). Shumë specie vertebrorësh tokësorë dëmtohen nga vdekshmëria rrugore në hapësira të ndryshme europiane (Mader H.J., 1984 ; Dinetti M., 2000). Kategoria më e prekshme nga trafiku rrugor se sa speciet e tjera janë amfibët sepse ata i kalojnë rrugët ngadalë dhe nuk vihen re që të shmangen nga drejtuesit (Hels T., Buchwald E., 2001; Vijayakumar S.P., Vasudevan K., 2001 ; Gryz J., Krauze D.,2008). Vdekshmëria rrugore e amfibëve si evidentojnë edhe studime të tjera të kryera më parë është e lidhur me llojet e habitateve pranë rrugëve dhe me intensitetin e trafikut rrugor (Clevenger A.P., et al, 2003; Mazerolle M.J.,2004). Të njëjtën sjellje kanë edhe reptilët, por duke qënë se lëvizshmëria e tyre është më e madhe niveli i vdekshmërisë rrugore është relativisht më i ulët. Shumë studime evidentojnë nivelin e vdekshmërisë rrugore për amfibët (Fahrig L., et al., 1995, Cooke A.S., 1995; Vos C.C., Chardon J.P. 1998; Hels T.,Buchwald E.,2001; Vijayakumar S.P., et al., 2001; Semlitsch R.D.,et al., 2007, Glista D.J., et al., 2008); dhe reptilët (Rodda G.H.,1990; Bernardino F.S., Dalrymple G.H., 1992, Rosen P.C., Lowe C.H., 1994; Aresco M.J., 2005, Lebboroni M., Corti C., 2006, Shepard D.B., et al., 2008). Vdekshmëria rrugore është një nga impaktet direkte mbi amfibët dhe reptilët, por ndërtimi i këtyre infrastrukturave ka edhe impakte indirekte që mund të ndikojë sjelljen e tyre, aftësinë riprodhuese, ekspozimin e kafshëve ndaj ndryshimeve klimatike dhe si barriera për izolimin e popullatave (Mader H.J., 1984; de Maynadier P.G.,Hunter Jr., 1998; Hels T., Buchwald E., 2001). Zbutja e vdekshmërisë rrugore kërkon njohuri mbi mënyrat e levizjeve të specieve dhe proceseve të tjera në shkallë të ndryshme hapsinore (Malo J.E.,et al., 2004). Së fundmi, me qëllim zbutjen e këtyre impakteve, janë propozuar në nivel european disa strategji të planifikimit territorial (Battisti C., 2004). Qëllimi i këtij studimi ka qënë vlerësimi i nivelit të vdekshmërisë rrugore për faunën e vogël vertebrorë, speciet e amfibëve dhe reptilëve në disa akse rrugore në kushtet e Shqipërisë. Rezultat e studimit do të shërbejnë për sensibilizimin dhe marrjen në konsideratë të tyre në strategjitë e planifikimit territorial, për krijimin e infrastrukturave të nevojshme për lehtësimin e levizjeve të tyre dhe për zbutjen e

impakteve e zvogëlimin e nivelit të dëmtimit të biodiversitetit faunistik në hapësirat e zëna nga infrastrukturat lineare rrugore.

2. MATERIALI DHE METODAT

Realizimi i këtij studimi është bazuar në procesin e monitorimit të disa akseve rrugore dhe metodologjia e ndjekur është bazuar në studime të tjera të kryera më parë në disa vende (Mazerolle M.J., 2004; Beaudry, F., et.al., 2008; Cooke, A.S. 1995; Fahrig, L., J. et.al.,1995; Fahrig, L., et.al.,2003; Glista, D. J.,et.al.,2008; Hels T., et.al.,2001; Row, J.R.,et.al.,2007; Shepard, D. B.,et.al.,2008). Studimi është kryer gjatë vitit 2015 duke e shtrirë hapësirën e vrojtimit në dy akse kryesore rrugore, njëra hapësirë rrugore që kufizohet në të dy anët nga ekosisteme natyrore, kryesisht ekosistemeve pyjore dhe lumore (fluviale) dhe tjetri nga aktivitete bujqësore. Është shtrirë në këto dy akse duke qënë se ndryshon tipologjia e ekosistemeve, për pasojë dhe natyra e inventari i gjallesave, natyra e rrugëve si dhe intensiteti i trafikut. Zona e parë e vrojtimit është shtrirë në aksin e superstradës Milot – Kukës në zonën e Ndërfushës e cila kufizohet në të dy anët nga ekosisteme natyrore dhe prania e rrjedhjeve ujore të lumit të Fanit duke qënë se është mjaft e pasur me faunën e egër vertebrorë. Zona e dytë shtrihet në aksin Lushnje – Fier në zonën e Kolonjës duke qënë se është një aks që kufizohet nga ekosisteme bujqësore. Monitorimi është kryer në këto akse duke lëvizur me makinë me shpejtësi të vogël (40 km/ore) përgjatë një aksi 15 km dhe duke regjistruar speciet e gjetura. Kampionimi është kryer çdo 15 ditë nga fillimi i majit deri në 15 gusht. Gjatë monitorimit është vrojtuar paisja me elemente infrastrukturorë të këtyre akseve rrugore si ngritja e rrethimeve, tubacionet e kalimit dhe sinjalistika për faunën e egër vertebrorë. Vështirësi ka pasur në monitorimin e këtyre dy kategorive për arsye se mbetjet e individëve të dëmtuar qëndrojnë gjatë në rrugë gjë e cila vështirëson identifikimin e tyre (Scocciati C., Ferri V., 1996). Një pjesë e individëve të dëmtuar janë dërguar në laborator për identifikimin e tyre duke qënë se kanë qënë shumë të dëmtuar. Të dhënat janë perpunuar për të fituar për secilën specie një tregues të frekuencës dhe një tregues të dëndësisë. Treguesi i frekuencës evidenton frekuencën e një specie të veçantë ndaj totalit ($F = n/N \times 100$; ku n = numri i individëve të species dhe N = numri i individëve total. Treguesi i dëndësisë paraqet numrin e individëve të gjetur për 100 km përkrah (A = $n/1200 \times 100$; n = numri i individëve të gjetur për çdo specie të veçantë dhe 1200 km e përkrah gjatë monitorimit) (Moscatelli M., Zapparoli M., 2004).


3. REZULTATE DHE DISKUTIME

Nga monitorimi në aksin rrugor që kufizohet nga ekosisteme natyrore dhe që shtrihet në autostradën Milot - Kukës vërehet një prani më e madhe e kategorisë së reptilëve ku përveç hardhucave janë evidentuar edhe gjarpërinj të dëmtuar nga automjetet në këtë aks, si dhe dëmtime të amfibëve të cilët janë më shumë të pranishëm në afërsi të baseneve ujore. Frekuenca e lëvizjes në këtë aks është relativisht e lartë dhe me shpejtësi deri 100 km/orë dhe duhet theksuar se kjo autostradë nuk ka mbrojtje të veçanta si anë betoni apo nënkalime si tombino për kalimin e kategorive të amfibëve dhe reptilëve. Mungon edhe sinjalistika për të paralajmëruar drejtuesit në vendet ku është evidentuar një prani më e lartë e kalimit të kafshëve të egra. Autostrada në njërin anë të saj kufizohet nga lumi dhe kjo është një arsye e lëvizjes së kafshëve në anën tjetër për ujë, ushqim e qëndrim. Duhet theksuar se në segmentin e monitoruar janë gjetur të dëmtuara dhe kategori të tjera të vertebrorëve më të mëdhenj si njëthundrakë dhe kafshë shtëpiake si qentë apo macet afër zonave të banuara

Tabela nr.1 – Kategoritë e specieve të dëmtuara amfibe e reptile në zonën me kufizim ekosisteme natyrore

Kategoritë e kafsheve të monitoruara	Numri i individeve (n)	Numri i specieve (s)	Treguesi i Frekuences (F)	Treguesi i dendesise (A)
Amfibe				
Thithlopa (<i>Bufo bufo</i>)	8	1	17.3	0.6
Bretkosa e përrenjve (<i>Rana graeca</i>)	15	1	32.6	1.25
Bretkosa e gjelbër e zakonshme (<i>Rana balcanica</i>)	9		19.5	0.75
Bretkosa e kuqërremtë e pyllit (<i>Rana temporaria</i>)	4		8.6	0.33
Bretkosa barkverdhë (<i>Bombina variegata</i>)	3	1	6.5	0.25
Breshka e zakonshme (<i>Testudo hermanni</i>)	7	1	15.2	0.53
Reptile				
Zhapiu i gjelbër (<i>Lacerta viridis</i>)	18	1	33.9	1.5
Hardhucë bari (<i>Podarcis taurica</i>)	22	1	41.5	1.8
Nepërka (<i>Vipera ammodytes</i>)	8	1	4.24	0.6
Nepërka e malit me njolla të ndërprera (<i>Vipera berus</i>)	5		9.4	0.41

Grafiku 1 - Kategoritë e specieve të dëmtuara amfibë e reptilë në zonën me kufizim ekosisteme natyrore




Nga analiza e mësipërme shikohet se popullatat e dëmtuara më shumë nga aksidentet rrugore janë popullatat e reptilëve, dëndësia e të cilëve është më e madhe në zonë dhe më e vogël e amfibëve, të cilët më rrallë kalojnë rrugën.

Nga monitorimi në aksin rrugor që gjendet e kufizuar me ekosisteme bujqësore në rrugën Lushnjë - Fier shikojmë që kemi një rritje të pranishmë të amfibëve me dëmtime më të mëdha sidomos gjatë orëve të mëngjesit duke qënë se lëvizin më shumë gjatë natës. Po kështu janë gjetur të dëmtuar edhe lloje të ndryshme të reptilëve, ku në këtë periudhë ka një nivel më të lartë të vdekshmërisë e cila lidhet me shqetësimet njerëzore të këtyre specieve në agroekosisteme gjatë proceseve të ndryshme bujqësore (si kositje, etj.) gjë e cila detyron një lëvizshmëri më të madhe të tyre.

Tabela nr.2. Kategoritë e specieve të demtuara amfibe e reptile në zonën me kufizim ekosisteme bujqësore

Kategoritë e kafsheve të monitoruara	Numri i individeve (n)	Numri i specieve (s)	Treguesi i Frekuences (F)	Treguesi i dendesise (A)
Amfibe				
Thithlopa (<i>Bufo bufo</i>)	6	1	16.6	0.5
Bretkosa e përrenjve (<i>Rana graeca</i>)	12	1	33.3	1
Bretkosa e gjelbër e zakonshme (<i>Rana balcanica</i>)	4	1	11.1	0.3
Bretkosa e kuqërremtë e pyllit (<i>Rana temporaria</i>)	7	1	19.4	0.5
Bretkosa barkverdhë (<i>Bombina variegata</i>)	4	1	11.1	0.3
Breshka e zakonshme (<i>Testudo hermanni</i>)	3		8.3	0.25
Reptile				
Zhapiu i gjelbër (<i>Lacerta viridis</i>)	3	1	10.7	0.25
Hardhuce bari (<i>Podarcis taurica</i>)	15	1	53.5	1.25
Neperka (<i>Vipera ammodytes</i>)	2	1	7.4	0.1
Neperka e malit me njolla të nderprera (<i>Vipera berus</i>)	5	1	17.8	0.4
	3	1	10.7	0.25

Grafiku 2 - Kategoritë e specieve të demtuara amfibë e reptilë në zonën me kufizim ekosisteme bujqësore



4. KONKLUSIONE

Studimi i kryer në këto akse rrugore në Shqipëri nëpërmjet teknikave të monitorimit evidentohet se impakti i shkaktuar nga aktivitetet njerëzore mbi biodiversitetin (faunën e egër të vogël vertebrorë) është i konsiderueshëm në infrastrukturën rrugore. Të dy kategoritë e analizuar, amfibë dhe reptilë, rezultojnë të dëmtuara nga vdekshmëria rrugore. Ky nivel impakti, ka zvogëluar dukshëm apo ka çuar edhe në zhdukje të popullatave lokale të faunës së egër vertebrorë. Kjo gjë, ashtu si rezulton edhe nga monitorimi vjen si pasojë e moskompletimit të infrastrukturave lineare rrugore me elementët e nevojshëm infrastrukturorë për mbrojtjen apo kalimin e këtyre dy kategorive, amfibë e reptilë, në anë të ndryshme të rrugëve. Fragmentizimi i hapësirave nga infrastrukturën lineare rrugore kërkon edhe marrjen e masave të nevojshme në projektim për të minimizuar impaktet. Është e nevojshme që akset rrugore në zonat rurale të plotësohen me rrethime me rrjeta apo pengesa betoni apo nënkalime për vertebrorët e vegjël si amfibët e reptilët. Është e nevojshme në projektimin e rrugëve të vendosen urëkalimet të cilat zvogëlojnë impaktin e fragmentizimit ekologjik. Duhet të vendosen, atje ku është e mundur nënkalime faunistike për kalimin e kategorive të ndryshme të kafshëve, e cila do të rriste p.sh., për amfibët mundësinë riprodhuese.

5. REFERENCAT

1. Aresco, M. J. The effect of sex-specific terrestrial movements and roads on the sex ratio of freshwater turtles. *Biological Conservation*, 2005, 123:37-44.
2. Battisti C: Frammentazione ambientale, connettività, reti ecologiche. Un contributo teorico e metodologico con particolare riferimento alla fauna selvatica. Provincia di Roma, Assessorato alle Politiche Agricole, Ambientali e Protezione Civile, Roma. 2004
3. Beaudry, F., deMaynadier, P.G., Hunter Jr., M.L., Identifying road mortality threat at multiple spatial scales for semi-aquatic turtles. *Biological Conservation*, 2008. 141, 2550–2563.
4. Bennet, A: “Roads, roadsides and wildlife conservation: a review”, in Saunders D.A. and Hobbs R.J. (Ed.): *The role of corridors*. New South Wales Surrey Beatty & Sons, (1991) pp. 99-117.
5. Bernardino, F. S., G. H. Dalrymple. Seasonal activity and road mortality of the snakes of the Pahayokee wetlands of Everglades National Park, USA. *Biological Conservation* . 1992, 62:71-75.
6. Corlatti L, Hackländer K., Frey-Roos, F. “Ability of wildlife overpasses to provide connectivity and prevent genetic isolation”, *Conservation Biology*, (2009): 23, 3, pp. 548-556.
7. Clevenger A.P., Chruszczyk B., Gunson K.E., Spatial patterns and factors influencing small vertebrate fauna road-kill aggregations. *Biological Conservation* 2003, 109: 15–26.
8. Cooke, A.S.. Road mortality of common toads (*Bufo bufo*) near a breeding site. *Amphibia-Reptilia* 1995 16: 87-90.
9. C.R., Heanue, K., Jones, J.A., Swanson, F.J., Turrentine, T. and Winter, T.C. *Road ecology: science and solutions*, Island Press, Washington, D.C. 2003.
10. Dinetti M., *Infrastrutture ecologiche*. Il Verde Editoriale, Milano. 2000
11. deMaynadier, P. G., M. L. Hunter Jr. 1998. Effects of silvicultural edges on the distribution and abundance of amphibians in Maine. *Conservation Biology*. 12: 340-352.
12. Fahrig, L., J. H. Pedlar, S. E. Pope, P. D. Taylor and J. F. Wegner.. Effect of road traffic on amphibian density. *Biological Conservation* 1995, 73:177-182.
13. Forman R., Alexander, L. “Roads and their major ecological effects”, *Annual Review of Ecology and Systematics*, (1998): 29, pp. 207-231.

14. Forman, R.T.T., Sperling, D., Bissonette, J.A., Clevenger, A.P., Cutshall, C.D., Dale, V.H., Fahrig, L., France, R., Goldman, C.R., Heanue, K., Jones, J.A., Swanson, F.J., Turrentine, T., Winter, T.C.,. Road Ecology: Science and Solutions. Island Press, Washington, DC, USA. 2003
15. Glista, D. J., T. L. DeVault and J. A. Dewoody.. Vertebrate road mortality predominantly impacts amphibians. *Herpetological Conservation Biology* 2008, 3:77-87.
16. Gryz, J., Krauze, D.: Mortality of vertebrates on a road crossing the Biebrza Valley (NE Poland). *European Journal of Wildlife Research* (2008) 54: 709-714.
17. Hels T, Buchwald E,. The effect of road kills on amphibian populations. *Biological Conservation*,. 2001, 99: 331–340.
18. Kerth, G. Melber, M “Species-specific barrier effects of a motorway on the habitat use of two threatened forest-living bat species”, *Biological Conservation*, . (2009): 142, pp. 270-279.
19. Lebboroni, M., Corti, C.. Road killing of lizards and traffic density in central Italy. In: *Proceedings of the 13th Congress of the Societas Europaea Herpetologica* (eds. M. Vences, J. Köhler, T. Ziegler and W. Böhme), *Herpetologia Bonnensis II*, Bonn, Germany, 2006, pp. 81-82.
20. Mader, H.J.. Animal habitat isolation by roads and agricultural fields. *Biological Conservation*. 1984, 29: 81-96.
21. Malo, J.E., Suarez, F., Diez, A.,. Can we mitigate animalvehicle accidents using predictive models? *Journal of Applied Ecology* 2004, 41, 701–710.
22. Mazerolle M.J.,. Amphibian road mortality in response to nightly variationsvariation in traffic intensity. *Herpetologica* 2004, 60: 45–53.
23. Moscatelli M., Zapparoli M. Mortalita da traffico veicolare in vertebrati terrestri nell’alto Lazio (Italia Centrale).*Proceedings of the Conference “Road infrastructure and biodiversity.Environmental impacts and mitigation solutions”*.Pisa. ., 2004
24. Prillewitz, F.C.. Fragmentation, not forever. In: Canters, K., Piepers, A. and Hendriks-eersma, A., (Eds.) *Proceedings of the international conference on Habitat fragmentation and infrastructure in Maastricht Den Hague, Delft, The Netherlands: Ministry of Transport, Public Works and Water Management, Road and Hydraulic Engineering division*. 1997
25. Rodda, G.H.,. Highway madness revisited: roadkilled Iguana iguana in the llanos of Venezuela. *J. Herpetol.* 1990, 24: 209-211.
26. Romano, B.,. Continuità ambientale, pianificazioni care per il riassetto ecologico del territorio. *Andromeda Edizioni*. Teramo. 2000
27. Rosen, P.C., Lowe, C.H.. Highway mortality of snakes in the Sonoran desert of southern Arizona. *Biol. Con.* 1994, 68: 143-148.
28. Row, J.R., Blouin-Demers, G., Weatherhead, P.J., Demographic effects of road mortality in black ratsnakes (*Elaphe obsoleta*). *Biological Conservation* , 2007.137,117–124.
29. Semlitsch, R.D., Ryan, T.J., Hamed, K., Chatfi eld, M., Drehman, B., Pekarek, N., Spath, M. and Watland, A.. Salamander abundance along road edges and within abandoned logging roads in Appalachian forests. *Conserv. Biol.* 2007, 21: 59-167.
30. Scoccianti C., Ferri V., - Fauna selvatica e infrastrutture viarie. *Atti I Congresso S.H.I.*, Torino, 2-6 ott. 1996. *Boll. Mus. reg. Sci. nat.*, Torino. 1996
31. Sutherland WJ *Ecological census techniques*. Blackwell, Massachusetts, (2004)
32. Shepard, D. B., M. J. Dreslik, B. C. Jellenand and C. A. Phillips. . Reptile road mortality around an oasis in the Illinois corn desert with emphasis on the endangered Eastern Massasauga. *Copeia* 2008:350-359.
33. Trombulak, S., Frissel, C.: “Review of ecological effects of roads on terrestrial and aquatic communities”, *Conservation Biology*, (2000) 14 (1), pp. 18-30.

34. Vijayakumar S.P., Vasudevan K., Herpetofaunal mortality on roads in the Anamalai Hills, southern Western Ghats. *Hamadryad* 2001. 26: 265–272.
35. Vos, C.C., Chardon, J.P., Effects habitat fragmentation and of road density on the distribution pattern of the moor frog *Rana arvalis*. *J. Appl. Ecol.* 1998. 35: 44-56.

STUDIM PËR KARAKTERIZIMIN AGROKLIMATIK TË FUSHËS SË KORÇËS STUDIES ON AGROCLIMATIC CHARACTERIZATION OF THE AREA OF KORÇA

ALBERT KOPALI^{1*}, ADRIAN DOKO¹,

¹ Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri
^{*}albertkopali@yahoo.it

PËRMBLEDHJE

Analiza e ecurisë së regjimit klimatik dhe përcaktimi i kufijve termikë dhe pluviometrikë është me rëndësi parësore për kultivimin e bimëve bujqësore. Përcaktimi i ndryshueshmërisë klimatike dhe analizimi i tendencave të ecurisë së faktorëve ekologjikë klimatikë është përcaktuese për qëndrueshmërinë e prodhimit bujqësor. Prodhimtaria dhe qëndrueshmëria e sistemeve bujqësore varet nga shkalla e optimizimit të lidhjeve të bimëve bujqësore me kushtet klimatike. Kjo kërkon një njohje të mirë të kushteve klimatike të zonës si dhe një analizë të hollësishme për përcaktimin e kufijve termikë dhe pluviometrikë për gjetjen e vlerave kufizuese për bimë të ndryshme bujqësore. Nga ana tjetër veçoritë klimatike të zonave duhen parë në dinamizmin e ndryshimeve klimatike që po vërehen në dekadat e fundit. Në mënyrë të veçantë ndryshimet që po vërehen në regjimin e reshjeve, shpërndarjen dhe intensitetin, po shfaqin ndikime të dukshme në bujqësi. Një përcaktim i saktë i kushteve klimatike të zonave do të shërbejë për modelimin e territoreve bujqësore e rurale dhe përcaktimin e teknologjive më të përshtatshme të kultivimit të bimëve bujqësore. Studimi analizon ecurinë termike e pluviometrike të fushës së Korçës, një zonë tradicionale dhe e zhvilluar bujqësore.

Fjalë çelës: *agroekosistem, agroklimë, klimë, reshje, temperaturë.*

ABSTRACT

Analysis of climate regime and thermal evolution and pluviometric limits determination it has fundamental importance for the cultivation of agriculture crops. Determination of climate variability and analysis of the progress of climate ecological factors trends is decisive for the sustainability of the agricultural production. Productivity and sustainability of agricultural systems depends on the optimization scale of agricultural plant connections with climatic conditions. This requires a better understanding of the climatic conditions of the area as well as a detailed analysis for the determination of thermal and pluviometric limits for finding limiting values of different agricultural crops. On the other hand climatic zones particulars must be seen in the climate dynamic changes that is observed in recent decades. In particular the changes that are observed in the regime, distribution and intensity of rainfalls are giving significant impacts on agriculture. A precise definition of the areas climate conditions will serve for agriculture and rural territories modeling and for the determination of the most appropriate technologies of cultivation of agricultural crops. The study analyzes the thermal and pluviometric performance on the plain area of Korça which is a traditional and develop agriculture zone.

Key words: *agro ecosystem, agro climate, climate, precipitation, temperature.*

1. HYRJE

Qëndrueshmëria e agroekosistemeve dhe e prodhimit të tyre në kohë kërkon kryerjen e studimeve për njohjen e kushteve klimatike e sidomos mikroklimatike të zonave të ndryshme. Regjimet klimatike dhe luhatjet ndërvjetore e ndërzonale të elementëve meteorologjikë ndikojnë në qëndrueshmërinë e prodhimit të bimëve bujqësore. Pavarësisht shkallës së përshtatjes të bimëve bujqësore me mjedisin klimatik dhe nivelin e teknologjisë së përdorur, luhatjet ndërvjetore të elementëve klimatikë përcaktojnë nivelin e prodhimit të realizuar. Nga ana tjetër, bimët bujqësore kanë kërkesa klimatike të diferencuara dhe e shtrijnë ciklin e tyre të zhvillimit në periudha të ndryshme të vitit, ku jo gjithnjë, kushtet klimatike janë të përshtatshme. Tiparet klimatike të zonave të ndryshme janë të studiuara dhe shprehen me anë të klasifikimeve klimatike (Ndarjet klimatike të territorit shqiptar, IHM,1978), por në rastin e bimëve bujqësore duhet karakterizuar mjedisi klimatik nëpërmjet klasifikimit agroklimatik të zonave, duke qene se brenda të njëjtës zonë bimë të ndryshme reagojnë në forma të ndryshme. Klasifikimi agroklimatik i zonave të ndryshme bujqësore mundëson rajonizimin agroklimatik të territorit (Peçuli V., Kopali A,2007), i cili lejon ndërtimin e teknologjive të përshtatshme dhe zgjedhjen e bimëve në përputhje me veçoritë e tyre. Në literaturë ka pak shembuj të studimeve në të cilat lëkundjet normale ndërvjetore të klimës të jenë trupëzuar në një metodologji të vlerësimit të rrezikut bujqësor të një territori (van Lanen *et al.*, 1992; Hudson e Birnie 1999; Duce *et al.*,2006). Por, studimet duhen parë edhe në aspektin e ndikimit të ndryshimeve klimatike, të cilat tashmë janë një realitet, përcaktuar nga impakti i aktiviteteve njerëzore në mjedisin klimatik (atmosferik). Në 150 vitet e fundit, temperatura sipërfaqësore e planetit është rritur me një vlerë të përfshirë ndërmjet 0.6 e 0.8°C (IPCC,2007). Sipas studimeve të kryera (IPCC, 2007), Europa Jugore, pjesë e së cilës është edhe Shqipëria, po bëhet më e thatë e më e nxehtë dhe me më pak reshje. Bujqësia dhe zonat rurale do të preken më shumë nga ndryshimet klimatike dhe veçanërisht nga mungesa e reshjeve (Baettig *et al.*,2007). Njohjet aktuale bazuar në një bashkësi të madhe provash, tregojnë që pjesa më e madhe e tokave bujqësore të analizuara kanë pësuar një rritje të dukshme të temperaturës si minimale dhe maksimale nga fillimi i shekullit të XX (Donat, M. G., *et al.*,2013). Në fakt, sipas studimeve (Hansen, J., *et.al.*,2012), ka vetëm një nivel mesatar të besueshmërisë në zvogëlimin e eskursionit termik ditor dhe impaktit kompleksiv në shpërndarjen e propabilitetit dhe kjo mbetet një çështje e hapur. Por dëmi më i madh i bimëve bujqësore vjen nga temperaturat e ulëta kur ato kalojnë pragjet termike për bimë të caktuara se sa nga ato të larta. Pikërisht, përcaktimi i minimumeve termike merr një rëndësi të veçantë për kultivimin e bimëve bujqësore. Në Europë e në Mesdhe, ka një variabilitet të dukshëm stinor e rajonal të reshjeve dhe pjesa më e madhe gjatë dimrit (IPCC,2013). Një problem për bujqësinë është edhe thatësia, fenomen, frekuenca e të cilës është vlerësuar në mënyrë të plotë në raportin e SREX (IPCC,2012). Edhe Shqipëria nuk është e përjashtuar nga këto ndikime të cilat janë analizuar edhe nga studime të mëparshme (World Bank,2009; Kopali A., *et.al.*2012). Shqipëria gjendet në Evropën jug-lindore, në anën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, mbi detet Adriatik dhe Jon. Ajo ka një sipërfaqe prej 28,745km² dhe terreni i Shqipërisë është kryesisht malor. Zonat malore e kodrinore zënë rreth 77% të territorit me një lartësi mesatare 708 metra mbi nivelin e detit, thuhet sa dyfishi i asaj europiane. Por, pavarësisht këtij fakti, disa zona si ajo e fushës së Korçës, e cila bën pjesë në zonën mesdhetare paramalore jugore të territorit shqiptar, janë nga zonat më prodhuese bujqësore. Kjo zonë shtrihet në lartësinë 898.6 m mbi nivelin e detit, në gjërësi gjeografike 40° e 36' dhe gjatësi gjeografike 20° e 44'. Qëllimi i këtij studimi ka qenë analizimi i ecurisë klimatike të zonës së Korçës, referuar treguesve kryesore dhe variacioneve të tyre në kohë (temperaturë, reshje, lagështi relative e ajrit, shpejtësi e erës, ndriçim diellor), veçanërisht përcaktimi i minimumeve e maksimumeve termike e pluviometrike, madhësi këto me ndikime përcaktuese të prodhimit bujqësor.


2. MATERIALI DHE METODAT

Në studim janë përdorur të dhëna klimatike të cilat i referohen stacioneve meteorologjike të zonës fushore të Korçës për treguesit kryesore meteorologjike (reshjet, temperaturat, lagështia relative e ajrit, shpejtësia dhe drejtimi i erës, rrezatimi diellor). Të dhënat përfaqësojnë seri historike të cilat përfshijnë intervale të ndryshme kohore dhe janë siguruar nga botimet e IHM (1978,1979, 1980, 1990), Banka Botërore (2009), për disa stacione meteorologjike të zonës fushore të Korçës (Korçë A., Orman Pojan, Maliq, Sheqeras) dhe konkretisht: për një numër të konsiderueshëm vitesh (1970-1990, 1990-2009), të cilat janë të mjaftueshme për analiza të tilla. Të dhënat për periudhat kohore përkatëse janë dixhitalizuar për përfitim të vlerave të ndryshoreve klimatike: a) të dhënat e reshjeve ditore e mujore të çdo viti; b) të dhënat e temperaturave mesatare, maksimale dhe minimale ditore e mujore; c) të dhënat ditore e mujore të temperaturave mesatare, maksimale dhe minimale absolute; d) të dhënat mujore të numrit të ditëve me lagështi relative më të vogël ose të barabartë me 50%; e) të dhënat mujore të numrit të ditëve me lagështi relative më të madhe ose të barabartë me 80% ($\geq 80\%$) për 14 orë; f) të dhënat mujore mbi drejtimin dhe shpejtësinë e erës; g) të dhënat mujore mbi diellzimin. Mbi bazën e të dhënave janë llogaritur frekuencat me tepricë të paracaktuara të vlerave të reshjeve, mujore dhe vjetore (Benincasa et al., 1991). Frekuenca me tepricë e reshjeve (P) ka qënë më e madhe ose e barabartë me një vlerë (P_z), është llogaritur: $F(P \geq P_z) = z / n + 1$. Frekuenca jo me tepricë e reshjeve (P) ka qënë më e vogël ose e barabartë me një vlerë (P_z), është llogaritur: $F(P \geq P_z) = 1 - F(P \geq P_z) = 1 - z / n + 1$. ku: n - është numri total i vëzhgimeve të disponueshme për serinë e konsideruar; z - numri në rradhë zbritëse i vlerave të reshjeve të serisë së konsideruar. Janë llogaritur vlerat e reshjeve me frekuencë me tepricë dhe jo tepricë të 25% dhe 75% me vlerat mesatare mujore e vjetore (INTERREG II,2001). Përcaktimi i periudhave me thatësi u bë sipas metodës së diagramave ombrotermike Bagnlous&Gossen (Bagnlous F, Gossen H., 1957). Ecuria e temperaturës dhe reshjeve dhe tendencat e tyre janë analizuar me anë të ekuacioneve të regresionit dhe koeficientëve të korrelacionit. Në studim janë analizuar të dhëna mujore për drejtimin dhe shpejtësinë e erës dhe diellzimin.

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Nga përpunimi i të dhënave janë përcaktuar tiparet klimatike të zonës fushore të Korçës mbi bazën e 4 ndryshoreve kryesore të analizuar: reshjet mesatare (mm); temperatura mesatare vjetore ($^{\circ}\text{C}$); numri mesatar i ditëve të vitit me lagështi relative $\geq 80\%$ dhe numri mesatar i ditëve të vitit me lagështi relative $\leq 50\%$ për 14 orë. Nga studimi për homogjenizimin klimatik të territorit shqiptar (Kopali A., etj, 2013), është bërë karakterizimi agroklimatik i cili paraqet interes të veçantë për kultivimin e bimëve bujqësore e hartimin e tekologjive të përshtatshme të kultivimit sidomos në fushën e mbrojtjes së bimëve.

Figura nr.1 Përcaktimi i zonave klimatike homogjene në territorin e Shqipërisë dhe zona e Korçës



Zona fushore e Korçës, mbi bazën e analizimit të 4 ndryshoreve kryesore klimatike, ka një sjellje si më poshtë.

Tabela nr.1 Përcaktimi i parametrave klimatikë të zonës së Korçës

Zona klimatike e Korçës	Reshjet vjetore (mm)	Temperatura mesatare vjetore (°C)	Nr. mesatar i ditëve vjetore me lagështi > 80% për 14 orë	Nr. mesatar i ditëve vjetore me lagështi < 50% për 14 orë
	806.0	9.9	58.5	155.4


Përsa i përket reshjeve, territori shqiptar karakterizohet nga sasi relativisht të larta të reshjeve, nga 649 deri 1060 mm në vit, në zonën e ultësirës perëndimore dhe kodrinore dhe 2295 deri 3117 mm në vit në zonat malore. Zona e Korçës bën pjesë në zonën me më pak reshje, ndikuar nga pozicioni gjeografik (reshjet vjetore me 75% të probabilitetit të rastisjes janë në vlerat 694 dhe 968 mm dhe me një probabilitet prej 25% në vlerat 944 dhe 1396 mm).

Tabela nr.2 Lartësia mesatare mujore e vjetore e reshjeve (mm), Korçë

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
141.5	34.3	82.5	96.3	103.8	30.0	6.8	5.8	16.2	14.8	196.9	53.0	781.9

Nga tabela shikohet se sasia vjetore e shumës së reshjeve është më afër propabilitetit të rastisjes me 75 % të kësaj dukurie. Sasia maksimale ditore e reshjeve ndër vite është 66.3 mm e regjistruar n 31 dhjetor, me një numër maksimal prej 152 ditë me reshje. Tendenca e reshjeve është analizuar me anë të ekuacioneve të regesionit dhe koefiçientëve të korrelacionit: $y = - 0.75 x + 806.05$, ($r = 0.255$). Nga analiza shikohet që ka pak luhatje ndërvjetore të shumës së reshjeve me një tendencë në rënie e regjimit të reshjeve në vitet e fundit, e cila duket se ndikohet nga ndryshimet e mundshme klimatike.

Grafiku nr.1 Ecuria e sjelljes së reshjeve në zonën e Korçës



Në këtë zonë temperaturat mesatare vjetore variojnë nga 9.1 në 10.7°C dhe temperaturat mesatare maksimale nga 13.3 në 15.6 °C dhe ato minimale midis 4.4 e 6.0°C. Temperaturat maksimale absolute, janë regjistruar në muajin korrik 29.7°C me një propabilitet prej 75% dhe në vlerat 33.2°C me një propabilitet prej 25%, temperaturat minimale absolute janë regjistruar në muajin janar në vlerat -7.0 me një propabilitet prej 75% dhe -14.4°C me një propabilitet 25%.

Tabela nr.3 Nivelet e temperaturave mesatare, maksimale e minimale mujore e vjetore (°C), (Korçë)

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Tmes	0.3	4.3	5.5	7.9	12.6	17.7	20.1	19.2	13.5	9.7	3.6	4.5	9.9
Tmax	4.0	8.3	10.2	12.7	18.2	24.4	26.6	25.9	19.7	14.7	9.4	8.1	14.9
Tmin	-2.9	0.8	1.4	3.8	7.5	11.3	13.0	12.3	8.6	5.0	-1.7	0.9	5.0


Nga analizimi i temperaturave mesatare maksimale evidentohen 64 ditë vjetore me temperatura mesatare maksimale mbi 25°C dhe 84 ditë vjetore me temperatura mesatare minimale nën 0°C si dhe 16 ditë vjetore me temperatura mesatare maksimale mbi 30°C.

Tabela nr.4 Nivelet e temperaturave maksimale e minimale absolute për zonën e Korçës

Muaji	Temperatura maksimale absolute		Temperatura minimale absolute	
	P (0.25) >x	P (0.75) <x	P (0.25) >x	P (0.75) <x
I	10.7	7.9	-14.4	-5.9
II	15.9	10.1	-13.8	-6.5
III	20.1	14.8	-10.7	-3.9
IV	23.9	20.2	-3.0	-0.4
V	29.2	24.2	1.9	4.0
VI	30.7	28.5	4.1	6.5
VII	33.2	29.7	5.4	8.2
VIII	32.3	28.9	7.2	9.4
IX	29.0	26.0	1.2	6.4
X	23.8	20.9	-3.2	0.5
XI	19.1	15.6	-7.2	-3.0
XII	13.3	10.5	-13.8	-7.0

Zona fushore e Korçës ka rreth 58.5 ditë që kanë lagështi $\geq 80\%$ për 14 orë dhe rreth 155.4 ditë me lagështi $\leq 50\%$. Nga analiza grafike e të dhënave rezulton se zona fushore e Korçës karakterizohet nga një lagështi relative e ajrit me rreth 68 % si mesatare vjetore.


Figura nr.2 Hapësirat klimatike homogjene përsa i përket numrit të ditëve me lagështi relative $\geq 80\%$ dhe $\leq 50\%$ për 14 orë në territorin shqiptar dhe atë të Korçës.



Bazuar mbi të dhënat pluviometrike dhe termometrike, është llogaritur propabiliteti i niveleve të lagështisë relative vlerësuar në tre orë të ndryshme, gjatë 24 orëve (ora 7, 14 dhe 21) dhe verifikohet që nivelet më të larta të lagështisë relative të ajrit janë në orën 7 me 78 % si mesatare vjetore dhe më të ulëta në orën 14 me 52 % si mesatare vjetore. Muajt me lagështi më të lartë janë janari me 81% , ndjekur nga dhjetori me 80% , marsi me 79% dhe shkurti me 74%. Me lagështi $\leq 30\%$ janë rreth 55 ditë, me lagështi $\leq 50\%$ janë 180 ditë dhe me lagështi $\geq 80\%$ janë 53 ditë, pra rezulton pak a shumë e njëjta situatë që rezulton edhe nga analiza grafike.

Në studim janë analizuar periudhat me thatësi të vitit me anë të diagramave ombrotermike të Bagnoulus-Gausseen nga ku vrojtohet që periudhat e thatësisë në zonën e Korçës janë të shkurtra dhe me një rëndësi të lehtë, ato ndodhin në muajt korrik dhe gusht gjatë të cilave do të ishte e nevojshme të ndërhyhet me anë të ujitjeve, sidomos për bimët perimore. Nga analiza grafike vrojtohet që thatësia në këtë zonë në kontekstin agroklimatik fillon nga 10 ditori i parë i muajit qershor dhe vazhdon deri në 10 ditoren e tretë të muajit gusht. Megjithatë, gjatë periudhës së thatësisë janë verifikuar reshje (thujse në të gjitha vitet gjatë muajve korrik e gusht) edhe pse me intensitet të ulët, të cilat zbusin ndikimin negativ të thatësisë dhe e bëjnë atë që të ketë zgjatje relativisht të shkurtër.

Grafiku nr.2 Diagrama ombrotermike e Bagnoulus & Gausseen për periudhat e thatësisë në zonën klimatike të Korçës.



Njohja e periudhës me thatësi, nëpërmjet këtij treguesi ka vlera agroklimatike duke qenë se ai mund të përdoret për programimin e mjaft praktikave agronomike.

Nga analizimi i drejtimit dhe shpejtësisë së erës për zonën e Korçës, rezulton se dominojnë erërat me drejtim jugperëndim me 179 raste vjetore, pastaj vijnë ato nga veriu me 102 raste dhe lindja me 46 raste. Erëra me shpejtësi më të madhe janë vërejtur që fryjnë nga juglindja të cilat shkojnë deri në 14.0 m/sek, jugu 7.5 m/sek, të ndjekura nga ato që fryjnë nga veriperëndimi me 6.3 m/sek.

Tabela nr.5 Era, drejtimi dhe shpejtësia (vjetore)

Rastet e drejtimit dhe shpejtësia	N		NE		E		SE		S		SW		W		NW		Qetesia
	r	s	r	s	r	s	r	s	r	s	r	s	r	s	r	s	
	h	h	h	h	h	h	h	h	h	h	h	h	h	h	h	h	
	10		2		4		2		6		17		1		1		698
	2		3		6		8				9		8		7		

Vendi ynë karakterizohet nga një intensitet relativisht i lartë i diellzimit (sasia e orëve me diell) i cili sillet mbi 2400 orë. Në pjesën jugore e perëndimore të vendit është mbi 2500 orë, ndërsa në fushën e Myzeqesë shkon në mbi 2700 orë.

Tabela nr.6 Mesatarja e shumave mujore e vjetore të zgjatjes së diellzimit në orë, Korçë.

Muajt												Shuma vjetore
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
119.	51.	96.	123.	252.	311.	382.	249.	243.	186.	144.	102.	2262.
9	4	2	4	2	4	5	2	0	1	2	7	2

Nga analiza shikohet se zona e Korçës karakterizohet nga sasi mesatare të diellzimit, rreth 2250 orë vjetore, gjë që e bën një zonë mjaft të përshtatshme për rritjen e zhvillimit e shumë bimëve si drithërat, bimët perimore e drufrutorët.

Nga analizimi i numrit të ditëve me ngjarje të veçanta atmosferike, zona e Korçës ka si mesatare vjetore rreth 97 ditë me shi, 30 ditë me shtërngata shiu, 98 ditë me brymë, 12 ditë me stuhi, 98 ditë të vranëta dhe 97 ditë të kthjellëta.

4.KONKLUZIONE

Nga analizimi i serive historike të një numri të madh të dhënash klimatike të regjistruara për zonën fushore të Korçës rezulton se përsa i takon regjimit të reshjeve bën pjesë në zonën me më pak reshje, ndikuar nga pozicioni gjeografik, me një sasi mesatare vjetore 806.0 mm. Regjimi i temperaturave karakterizohet nga temperatura mesatare vjetore 9.9°C, temperatura mesatare maksimale 14.9°C dhe ato mesatare minimale 5.0°C. Ka 64 ditë vjetore me temperatura mesatare maksimale mbi 25°C dhe 84 ditë vjetore me temperatura mesatare minimale nën 0°C. Zona fushore e Korçës ka rreth 58.5 ditë me lageshti $\geq 80\%$ për 14 orë dhe rreth 155.4 ditë me lageshti $\leq 50\%$; me një lageshti relative të ajrit rreth 68 % si mesatare vjetore. Thatësira në kontekstin agroklimatik fillon nga 10 ditori i parë i muajit qershor deri në 10 ditorin e tretë të muajit gusht. Dominojnë erërat me drejtim jugperëndim me 179 raste vjetore, ato nga veriu me 102 raste dhe lindja me 46 raste. Erëra me shpejtësi më të madhe janë vërejtur nga juglindja të cilat shkojnë deri në 14.0 m/sek, jugu 7.5 m/sek dhe nga veriperëndimi me 6.3 m/sek. Ka një diellzim rreth 2250 orë vjetore.

5.REFERENCAT

1. Baettig M.B., Wild M., Imboden D.M.. A climate change index: where climate change may be most prominent in the 21st century. Geophys. Res. Lett. 34. L01705. 2007.
2. Bagnlous F., Gossen H. Les climats biologiques et leur classification. Ann. De Geogr., 1957 : 2.
3. Benincasa F., Maracchi G., Rossi P. Agrometeorologia. Patron Editore Bologna. 1991.
4. Donat, M. G., et al. Updated analyses of temperature and precipitation extreme indices since the beginning of the twentieth century: The HadEX2 dataset, J. Geophys. Res. Atmos., 2013:118, 2098–2118, doi:10.1002/jgrd.50150.

5. Duce P., Cesaraccio C., Canu S., Motroni A., Dettori M., Cocco T., Antolini G., Zinoni F. Individuazione delle aree agricole e delle colture a forte rischio per variazioni climatiche. In Risultati Conclusivi del Progetto finalizzato di ricerca "Climagri – Cambiamenti climatici e agricoltura". 2006.: 79-91. Roma: CRA-UCEA.
6. Kopali A., Peculi V., Teqja Z., Rota E. A study on agroclimatic characterization of Albanian Territory. Albanian j. agric. sci. ISSN: 2218-2020, 2012, Nr. 3/Vol. 11, p.173-177.
7. IPCC, 2007: Report of the Intergovernmental Panel on Climate Change, Solomon, S., D. Qin, M. Manning, Z. Chen, M. Marquis, K.B. Averyt, M. Tignor and H.L. Miller (eds.), 2007: The Physical Science Basis. Contribution of Working Group I to the Fourth Assessment IPCC.]. Cambridge University Press, Cambridge, United Kingdom and New York, NY, USA, 996 pp.
8. IPCC, 2012: Managing the Risks of Extreme Events and Disasters to Advance Climate Change Adaptation. A Special Report of Working Groups I and II of the Intergovernmental Panel on Climate Change [Field, C.B., V. Barros, T.F. Stocker, D. Qin, D.J. Dokken, K.L. Ebi, M.D. Mastrandrea, K.J. Mach, G.-K. Plattner, S.K. Allen, M. Tignor, and P.M. Midgley (eds.)]. Cambridge University Press, Cambridge, UK, and New York, NY, USA, 582 pp.
9. IPCC, 2013: Working Group I AR5: Climate Change 2013: The Physical Science Basis.
10. Institut Hidrometeorologjike –Academie des Scineces. Le climat de l’Albanie. Volume I.Precipitations atmospheriques. Editions Hidmet, Tirane. , 1978, 1979, 1980.
11. Institut Hidrometeorologjike –Academie des Scineces. Le climat de l’Albanie. Volume II. La temperature de l’air. Editions Hidmet, Tirane. 1990,
12. Instituti Hidrometeorologjik. Atlasi klimatik i Shqiperise, Tirane, 1990.
13. INTERREG II ITALIA-ALBANIA, Misura 6.2 – Cooperazione in agricoltura - Delimitazione di aree climatiche omogenee.2001.
14. Hansen, J., M. Sato, and R. Ruedy. Perception of climate change. Proceedings of the National Academy of Sciences of the United States of America, 109. 2012.
15. Hudson G., Birnie R.V. A method of land evaluation including year to year weather variability. Agric. For. Meteorol., ., 1999, 101: 203-216.
16. Peçuli V.,Kopali A. Agroekologjia, Tekst mesimor,f.331-350. 2007.
17. van Lanen H.A.J., Hackten Broeke M.J.D.,Bouma J., de Groot W.J.M. A mixed qualitative-quantitative physical land evaluation methodology. Geoderma, 1992, 55: 37-54.
18. World Bank, ECA Databank. Washington DC. 2009.

**STUDIM I DIVERSITETIT FLORISTIK NË LUGINËN E LUMBARDHIT TË PRIZRENIT NË RRJEDHEN E MESME PREJ PRIZRENIT NË REÇAN
FLORISTIC DIVERSITY STUDY ON THE MIDDLE UPSTREAM OF LUMBARDH RIVER OF PRIZREN VALLEY FROM PRIZREN TILL REÇAN**

SIMIR KRASNIQI^{1*}, ALBERT KOPALI², ADRIAN DOKO², ELISON ROTA²

¹Drejtor i Edukimit Profesional, Prizren, Kosovë

²Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë, Universiteti Bujqesor i Tiranës, Shqipëri

*simirkrasniqi@hotmail.com

PERMBLEDHJE

Qëndrueshmëria e sistemeve ekologjike varet nga niveli i biodiversitetit të pranishëm në to dhe një rol të pazëvendësueshëm luan fitodiversiteti. Ai përfaqësohet nga bashkësia e specieve bimore spontane të cilat përbëjnë florën e një rajoni. Studimi i fitocenozave të zonave të veçanta mbetet një objektiv i përhershëm në fushën e kërkimit të biologjisë së ruajtjes. Diversiteti ekosistemik i ka dhënë vend krijimit të një flore të pasur të dukshme në hapesirat fluviale. Analiza floristike e zonave të ndryshme ekologjike lejon njohjen e florës spontane të këtyre hapësirave. Kryerja e studimeve do të mundësojë vlerësimin si të pasurisë dhe diversitetit të specieve bimore të cilat përbëjnë informacione të rëndësishme ekologjike. Shumë hapësira të pasura me diversitet floristik janë akoma të pa studiuar. Një zonë e tillë është në luginën e Lumbardhit të Prizrenit, e cila në një shtrirje relativisht të vogël, paraqet një diversitet të lart floristik. Ky studim ka pasur si qëllim evidentimin e florës spontane të kësaj lugine, njohjen e specieve native, kryesisht në rrjedhën e mesme me një shtrirje nga qyteti i Prizrenit deri në fshatin Reçan, për njohjen, shpërndarjen dhe gjendjen ekzistuese të specieve bimore. Njohja e pasurisë floristike të kësaj hapsire territoriale do të përbejë një material të vlefshëm për evidentimin e vlerave ekologjike që paraqet, ruajtjen dhe administrimin më të mirë të saj.

Fjale çeles: *biodiversitet, fito-diversitet, florë spontane, pasuri llojore, specie.*

ABSTRACT

The sustainability of ecosystems depends on the level of biodiversity presented in them and there an irreplaceable role played by phyto-diversity. It is represented by the community of spontaneous plant species that form a regional flora. Phytocenosis study of specific areas remains a permanent goal of the research and of conservation biology. Ecosystem diversity has given place at the creation of an evident rich flora in the fluvial areas. Floristic analysis of different ecological zones allow the recognition of spontaneous flora of these areas. Conducting different studies will enable the evaluation of property and diversity of plant species that gives important ecological information. Many rich floristic diversity areas are still not studied. One such area is the valley of Lumbardh river of Prizren, which in a relatively small extent, represents a high floristic diversity. This study aimed to identify the flora of this valley, the recognition of native species, mainly in the middle upstream with a stretch from the town of Prizren till the Reçan village, for recognition, distribution and current situation of plant species. Knowing the floristic richness of this territory space will be a valuable material for the identification of ecological values that it represents, for the conservation and management of its best values.

Key words: *biodiversity, phyto-diversity, spontaneous flora, specie.*

HYRJE

Një rol të rëndësishëm në funksionimin, rolet ekologjike dhe qëndrueshmërinë e ekosistemeve fluviale luajnë jo vetëm përbërësit abiotike si cilësia e ujrave, niveli i kripezimit, rrjedhjet, prania e gazeve të tretura, por edhe përbërësit biotikë. Një shkallë e lartë e ndërveprimit midis këtyre përbërësve rrit qëndrueshmërinë e ekosistemeve. Në përbërësit biotikë, ai floristik, fitodiversiteti, ka një rol ekologjik të pazëvendësueshëm. Prania e fitodiversitetit (specieve), përgjatë rrjedhjes së ujrave, krijon zona ekotonale nëpërmjet të cilave realizohet një shkallë e lartë ndërveprimi me ekosistemet rrethues. Shkalla e ndërveprimit varet nga niveli i diversitetit dhe prania formave të ndryshme morfologjike të cilat diferencohen në rrjedhjet e ujrave sidomos në lidhje me lartësinë. Diversiteti morfologjik favorizon zhvillimin, ruajtjen e habitatit dhe rritjen e biodiversitetit (Jungwirth et. al. 2003). Biodiversiteti i pasur i hapësirave fluviale kryen një sërë rolesh ekologjike në ekosistemet përkatëse si në mjedisin abiotik duke konsoliduar brigjet lumore, mbrojtjen e tyre nga erozioni, pasurimin me humus që nxit riciklimin e elementeve dhe rrit funksionimin e ekosistemeve. Përmireson kushtet mikroklimatike e moderon vlerat e elementeve meteorologjike. Por, ai rrit rolet ekologjike të mjedisit biotik duke krijuar habitate të përshtatshme për një numër shumë të madh të organizmave strehuese në këto hapësira. Një rol i rëndësishëm ekologjik i tyre është krijimi i hapësirave me vlera të larta peizazhistike për përdorim nga ana e njeriut për aktivitete turizmi e shlodhje. Por hapësirat fluviale gjithnjë janë shfrytëzuar nga njeriu për qëllime të ndryshme ekonomike si kullota për blegtorine, aktivitete bujqësore e urbane duke ndikuar mbi fitodiversitetin e tyre. Këto aktivitete kanë krijuar fragmentizime të territorit duke ndikuar drejtpërsëdrejti edhe mbi biodiversitetin faunistik. Kjo evidenton rëndësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së tyre. Fitodiversiteti i luginës së lumit të Lumbardhit të Prizrenit është shumë i pasur me specie, ku një numër i konsiderueshëm tashmë janë të studiuar, por ka akoma shumë specie të tjera të pastudiuar, studimi i të cilave paraqet interes të veçantë jo vetëm në këndvështrimin botanik, por edhe të funksioneve ekologjike. Kjo pasuri llojore (fitodiversiteti) dhe diversiteti morfologjik që takohet në këtë rrjedhë lumi, është rezultat i heterogjenitetit të kushteve ekologjike (klimatike, tokësore dhe lartësisë mbi nivelin e detit) dhe përshtatshmërisë të bimeve ndaj tyre. Karakteristikat gjeografike të zonës, kushtet klimatike, tokësore e hidrologjike kanë një ndikim të rëndësishëm në shpërndarjen e specieve bimore dhe shtazore (Shukriu A.,1979). Lartësia mesatare mbidetare shkon 412 deri 500 m, ndërsa në zonën malore, ku buron lumi i Lumbardhit kalon mbi 2000 m. Është e rrethuar me Malet e Sharrit dhe ka një rrjet të pasur dhe të ngjeshur të lumenjve, ku lumi kryesor është Lumbardhi, që rrjedhin drejt Drinit të Bardhë. Lumenjtë të cilët rrjedhin nga Mali i Sharrit janë shumë të shpejtë dhe të thellë dhe kanë çarje të ngushta, të cilat shpesh formojnë kanione, si është ai i grykës Duvska. Klima është kontinentale alpine, por depërtojnë edhe rryma mesdhetare të Adriatikut nëpërmjet kanionit të Drinit të Bardhë që favorizojnë përshtatjen dhe zhvillimin e formave të ndryshme bimore të cilat shfaqen nëpërmjet diversitetit morfologjik. Temperatura mesatare vjetore është 12.5⁰C, me temperaturën më të ulët 1.3⁰C gjatë muajit janar dhe me temperaturën më të lartë 23.2 °C gjatë muajit korrik. Ka rreth 229 ditë pa ngrica. Vlera mesatare e reshjeve në këtë zonë varijon nga 670 deri në 1200 mm/vit dhe vlera mesatare e lagështisë relative është 60-70 %. Rrezatimi diellor në periudhën e vegjetacionit shkon 458 kcal/cm²/ditë dhe vlera mesatare e shpejtësisë së erës është rreth 2.8 m/s (Cavolli R., 1997). Studimi është kryer në luginën e lumit të Lumbardhit të Prizrenit e cila i përket komunës së Prizrenit që shtrihet në Jug të Kosovës. Lumbardhi kalon përmes qytetit të Prizrenit, buron nga zona malore 2360 m lartësi mbidetare, është një lumë me rrjedhje të shpejtë, me një gjatësi 35.5 km dhe me pellgun ujëmbledhës 226 km². Pellgu ujëmbledhës paraqet një basen silikat akullnajor i maleve të larta nga ku buron Lumbardhi i Prizrenit, i cili ka krijuar një luginë me vlera të

larta gjeologjike, hidrologjike, biogeografike, floristike, faunistike e matricë të pasur peizazhistike.

Qëllimi i këtij studimi ka qenë njohja e florës ekzistuese, familjet, gjinitë dhe speciet, në luginën e Lumbardhit të Prizrenit, në rrjedhën e mesme prej Prizrenit në Reçan, ndikimi i impaktit të njeriut në këtë rrjedhë dhe dhënia e rekomandimeve lidhur me mbrojtjen nga dëmtimet e specieve. Studimi është kryer nga muaji mars deri në shtator vitit 2014, kohë gjatë të cilës janë realizuar shumë eksplorime në terren të cilat kanë dhënë rezultate interesante për fitodiversitetin e këtij territori.

MATERIALI DHE METODAT

Studimi ka përfshirë luginën e rrjedhjes së mesme të lumit të Lumbardhit prej Prizrenit deri në Reçan dhe është realizuar nga muaji mars deri në shtator të vitit 2014. Studimi ka evidentuar fitodiversitetin e kësaj lugine, familjet, gjinitë dhe speciet bimore. Gjatë studimit janë regjistruar, një numër i madh i specieve bimore si speciet endemike dhe mjekësore. Janë vlerësuar karakteristikat gjeografike të luginës si pozicioni gjeografik, gjeomorfologjia, kushtet klimatike e hidrologjike (Shukriu A., 1979). Metoda e përdorur për identifikimin e specieve bimore ka qenë ajo Braun-Blanquet (1949). Speciet bimore janë regjistruar dhe herbarizuar duke filluar nga muaji mars me fillimin e vegetacionit deri në muajin shtator. Bimët barishtore janë mbledhur në kohën e lulëzimit ose të frutifikimit dhe me kujdes për t'i mbledhur me të gjitha organet vegjetative dhe riprodhuese. Për bimët drunore janë marrë pjesë të kërcellit me gjethe, lule dhe fruta, me qëllim të determinimit të tyre. Bimët e mbledhura janë herbarizuar me metoda standarde për herbarizim. Në fund të muajit shtator është bërë determinimi i bimëve, referuar burimeve të literaturës (Demiri M., 1983; Rexhepi F., 2000; Millaku F., 1993; Horvat I., 1949; Vangjeli V. et.al. 2000; Diklic N., Nikolic B., 1970-1977; Mitrush I., 1966; Pajazitaj Q., 2004; Tutin T.G., et.al.1980).

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Bazuar në analizimin e të dhënave të fituara në terren për karakteristikat gjeografike të luginës si pozicioni gjeografik, gjeomorfologjia, kushtet klimatike e hidrologjike, nga studimi rezulton se lugina e Lumbardhit të Prizrenit karakterizohet nga një gjeomorfologji e pasur e terrenit e cila ka lejuar zhvillimin e diversitetit morfologjik me forma të ndryshme bimore barishtore, shkurre e drunore. Karakterizohet nga një klimë kontinentale alpine me depërtimin e vazhdueshëm të rrymave mesdhetare nga deti Adriatik nëpërmjet Drinit të Bardhë të cilat krijojnë zona mikroklimatike që favorizojnë zhvillimin e shumë specieve bimore, në rrjedhën e mesme të Lumbardhit. Prania e ujrave ka favorizuar zhvillimin e formave të shumta bimore, të cilat kryejnë role të shumëfishta ekologjike. Bazuar në metodën floristike Braun-Blanquet (1949), gjatë periudhës kohore nga muaji mars deri në fund të muajit shtator, janë konstatuar këto të dhëna floristike: 46 familje, 123 gjini dhe 157 specie, ku prej tyre mund të citojmë, Pteridiofita me 3 familje, 4 gjini me gjithsej 4 specie. a) Equisetaceae 1 familje, 1 gjini me gjithsej 1 specie; b) Cupresaceae 1 familje, 1 gjini 1 specie; c) Polipodyaceae 1 familje, 2 gjini 2 specie d) Dicotyledonae 39 familje, 111 gjini me gjithsej 136 specie; e) Monocotyledonae 4 familje, 10 gjini me gjithsej 17 specie. Nga të gjitha grupet e bimëve familjet me më së shumti specie të konstatuara janë: nga Pteridiophyta familja, Polypodiaceae. Equisetaceae, familja: Cupresaceae, nga Dicotyledonet si familje me numër më të madhë të specieve janë familjet: Asteraceae, Rosaceae, Fabaceae, Convolvulaceae, Oleaceae, Betullaceae, Ranunculaceae, Brassicaceae, Primulaceae, Lamiaceae etj. Nga Monocotyledonet si familje me më shumë specie janë familja: Poaceae, Liliaceae, Orchidaceae etj.

Tabela nr.1 Paraqitje e familjeve dhe numri i specieve për familje.

Nr.	Familjet	Numri i specieve
1	Equisetaceae	1
2	Polypodiaceae	2
3	Cupressaceae	1
4	Asteraceae	24
5	Rosaceae	15
6	Fabaceae	13
7	Ranunculaceae	4
8	Lamiaceae	9
9	Linaceae	2
10	Boraginaceae	2
11	Brassicaceae	8
12	Betullaceae	3
13	Poligonaceae	2
14	Apiaceae	4
15	Oleaceae	3
16	Betullaceae	4
17	Ulmaceae	1
18	Crasulaceae	2
19	Campanulaceae	3
20	Convolvulaceae	5
21	Malvaceae	2
22	Gentianaceae	1
23	Aristolochiaceae	1
24	Plantaginaceae	1
25	Scrophulariaceae	1
26	Solanaceae	1
27	Fagaceae	2
28	Plantanaceae	1
29	Vitaceae	2
30	Euphorbiaceae	2
31	Cornaceae	2
32	Caprifoliaceae	2
33	Urticaceae	2
34	Papaveraceae	1
35	Salicaceae	3
36	Aceraceae	2
37	Moraceae	3
38	Juglanaceae	1
39	Araliaceae	1
40	Primulaceae	2
41	Violaceae	1
42	Hipericaceae	1
43	Liliaceae	2
44	Dioscoraceae	1
45	Orchidaceae	1
46	Poaceae	10

Tabela nr.2. Familjet, gjinitë, speciet në rrjedhën e mesme të Lumbardhit prej Prizrenit në Reçan.

<p>PTERIDOPHYTA- BIMËT ME SPORE</p> <p>1. FAM. EQUISETACEAE (Ekuizetore) 1.Equisetum Arvense L. (<i>Këputja e arave</i>)</p> <p>2.FAM. POLYPODIACEAE (Fierore) 1.Pteridium aquilinum. Kuhn. (<i>Fiershqipe</i>) 2.Polypodium vulgare L. (<i>Fieri i murit</i>)</p> <p>GYMNOSPERMAE- FARËZHESHURA</p> <p>3.FAM.CUPRESSACE (Selviore) 1. Juniperus Communis L. (<i>Dëllinja e zezë</i>)</p> <p>ANGIOSPERMAE -FARËVESHURA</p> <p>MAGNOLIATE (DIKOTILEONEAE)</p> <p>4. FAM . ASTERACEAE (Kompozite) 1.Centaurea jaceae L. (<i>Kokqeli</i>) 2. Centaurea alba L. (<i>Kokqeli alba</i>) 3.Xeranthem inapertum L.(<i>Kserantemi i paqelur</i>) 4.Cicorium intybus L.(<i>Ckore lulukorja</i>) 5.Inula salicina L. (<i>Omani shelgor</i>) 6. Inula britannica L. (<i>Omani Britanik</i>) 7.Anthemis tinctoria L. (<i>Syviqja ngjyruese</i>) 8.Lucanthemum vulgare L.(<i>Lulebardha e rëndomt</i>) 9.Carduus nutans L. (<i>Freshkulli</i>) 10.Achillea millefolium L. (<i>Barpezmi mijëfletësh</i>) 11.Achillea linguilata Waldst. et Kit (<i>B. gjuhëzor</i>) 12.Achillea grandifolia L. (<i>B. gjethëmadhë</i>) 13.Bellis perennis L. (<i>Luleshqerra shumëvjeare</i>) 14. Tusilago farfara L.(<i>Thundërmushka</i>) 15. Tanacetum vulgare L. (<i>Karajpeli</i>) 16.Tanacetum corymbosum L. (<i>Karajpeli vasakor</i>) 17. Echinops sphaerocephalus L.(<i>Einopsi kokëruzullor</i>) 18.Tragopogon Pratensis L.(<i>Lulebrigja livadhit</i>) 19.Eupatorium cannabinum L.(<i>Eupatori</i>) 20.Bellis perennis. L (<i>Luleshqerra</i>) 21.Taraxacum officinale. Weh (<i>Luleshurdha mjekësor</i>) 22.Bellis annua L. (<i>Rrezngushtu</i>) 23.Hieracium pilosella L. (<i>Këmasha me pak lesh</i>) 24.Arctium lappa L. (<i>Rrodhja</i>)</p> <p>5. FAM. ROSACEAE 1. Pyrus eleagrifolia Pallas. (<i>Dardhukëla gjethehunap</i>) 2. Pyrus pyraeaster Burgs.(<i>Dardhukëla</i>) 3.Pyrus communis L. (<i>Dardha</i>) 4. Prunus spinosa L.(<i>Kulumbria</i>) 5.Prunus Avium L. (<i>Qërshija e egër</i>) 6. Mespilus germanica L.(<i>Mushmolla e dimrit</i>) 7. Malus sylvestris L. (<i>Molla e egër</i>)</p>	<p>13. FAM. POLYGONACEAE 1.Rumex acetosella L. (<i>Lëpjata majoshe</i>) 2.Rumex crispus L.(<i>Lëpjata kaqurrele</i>)</p> <p>14. FAM – APIACEAE 1.Erigium campestre L. (<i>Gjëmbardhi i fushës</i>) 2.Smyrnium perfoliatum L. (<i>S. i përgjethur</i>) 3.Orlaya grandiflora L. (<i>Orlaja lulemadhe</i>) 4.Daucus carrota L. (<i>Karrota e egër</i>)</p> <p>15. FAM. OLEACEAE 1.Fraxinus ornus . L. (<i>Frashëri i bardhë</i>) 2. Fraxinus excelsior L.(<i>Frashëri</i>) 3.Ligustrum Vulgare L.(<i>Voshtra e rëndomtë</i>)</p> <p>16. FAM. BETULLACEAE 1.Alnus glutinosa L.Gearnt (<i>Verri i zi</i>) 2.Carpinus orientalis Mill. (<i>Shkoza e zezë</i>) 3.Coryllus avellana L. (<i>Lajthia</i>) 4.Betulla alba L.(<i>Mështekna e bardhë</i>)</p> <p>17. FAM. ULMACEAE 1.Ulmus Campestris L. (<i>Vidhi</i>)</p> <p>18. FAM. CRASULACEAE 1.Sedum acre L. (<i>Rrushëqyqja e athët</i>) 2.Sedum telephium L. (<i>Rrushëqyqja e telefit</i>)</p> <p>19. FAM. CAMPANULACEAE 1.Campanula rapunculoides L.(<i>Lulekëmbana</i>) 2.Campanula sparsa L. (<i>Lulekëmbana</i>) 3. Campanula spatulata Sbirth.(<i>L. shpatullore</i>)</p> <p>20. FAM. CONVULVULACEAE 1.Calystegia sylvatica L.(Kit) Griseb.(<i>G.pyjor</i>) 2. Convovulus arvensis L. (<i>Dredhja e arës</i>) 3.Convovulus althaeoides L. (<i>Dredhja</i>) 4.Convovulus cantabrica L.(<i>Dredhja kantabris</i>) 5.Cuscuta europea L. (<i>Kuskuta europiane</i>)</p> <p>21. FAM. MALVACEAE 1.Alcea pallid (Willd). (<i>Mëllaga e butë e zbetë</i>) 2. Malva Sylvestris.L.(<i>Molla e egër</i>)</p> <p>22. FAM. GENTIANACEAE 1.Centarium Verna L. (<i>G.pranverore</i>)</p> <p>23. FAM. ARISTOLOCHIACEAE 1.Aristolochia clematitis L. (<i>Petriku kulpër</i>)</p> <p>24. FAM. PLANTAGINACEAE 1.Plantago media L. (<i>Gj.ndërmjemë</i>)</p> <p>25. FAM. SCROPHULARIACEAE 1.Digitalis lanata Eher. (<i>Luletogëza leshtake</i>)</p> <p>26. FAM. SOLANACEAE 1.Solanum dulcamara L. (<i>Idhnakthi i idhët</i>)</p> <p>27. FAM. FAGACEAE 1. Quercus robur L. (<i>Dushku</i>) 2. Castanea sativa Miller. (<i>Geshtënja</i>)</p> <p>28. FAM. PLANTANACEAE 1.Plantanus orientalis L. (<i>Rrapi</i>)</p> <p>29. FAM. VITACEAE 1.Vitis sylvestris. L. (<i>Hardhia e egër</i>)</p>
---	--

8. Crataegus monogyna Jascq.(Murrizi njëbërthamësh)	2. Vitis vinifera. L. (Hardhia)
9. Rosa canina L.(Trëndafili i egër)	30. FAM. EUPHORBIACEAE
10.Rosa pendulina L. (Trëndafili i varës)	1.Euphorbia palustris L.(Qumështorja ligatinës)
11.Rosa arvensis L. (Trëndafili i arës)	2.Euphorbia myrsinites L.(Qumështorja mërsinë)
12.Sorbus aria L. (Vadha)	31. FAM. CORNACEAE
13.Fragaria vesca L.(Luleshtrydhja erëmyshku)	1.Cornus sanguine L. (Thanukla)
14.Cydonia oblonga Mill. (Ftoi)	2. Cornus mas L. (Thana)
15.Rubus ulmifolius Schott.(Manaferra fermanë)	32. FAM. CAPRIFOLIACEAE
6. FAM. FABACEAE	1.Sambucus ebulus L. (Qingla)
1.Anthyllis vullneraria L. (Antili Shërues)	2.Sambucus nigra L. (Shtogu)
2.Melilotus alba Med.(Makthi i bardhë)	33. FAM. URTICACEAE
3.Ononis spinosa L. (Kalmuthi gjembor)	1.Urtica dioica L. (Hithore dioike)
4.Lathyrus tuberosum L.(Vingjra zardhokore)	2.Parietaria officinalis L.(K.mjekësor)
5.Trifolium incarnatum L.(T. ngjyrë mishi)	34. FAM. PAPAVERACEAE
6.Trifolium pretense L.(Tërfili i livadhit)	1.Papaver rhoeas L. (Lulëkuqja)
7. Trifolium repens L. (Tërfili i Zvarritës)	35. FAM. SALICACEAE
8. Vicia sativa L. (Grashtina kultivuar)	1.Populus tremula L.(Plepi i egër)
9. Robinia pseudoacacia L. (Shallëgemi)	2.Salix alba L. (Shelgu i bardhë)
10. Medicago sativa. L. (Jonxha)	3.Salix Caprea L. (Shelgu i egër)
11.Medicago polymorpha L. (Jonxha shumëtrajtshe)	36. FAM. ACERACEAE
12.Colutea arborescent L. (Fshikëkarta)	1.Acer tataricum L. (Ulëza)
13. Coronilla varia L. (Milëza e ndryshme)	2.Acer monssulanum L. (Krekëza)
7. FAM. RANUNCULACEAE	37. FAM. MORACEAE
1.Helleborus odoratus Eäldst et Kit. (Shpendra)	1. Morus alba L. (Mani i bardhë)
2.Nigella damascena L. (Nigella e Damaskut)	2. Morus nigra L. (Mani i zi)
3.Thalictrum flavum L. (Pipanolle e verdhë)	3. Ficus carica L. (Fiku)
4.Clematis vitalba L. (Kulpra e egër)	38. FAM. JUGLANACEAE
8. FAM. LAMIACEAE	1. Juglans regia L. (Arra)
1.Ajuga reptans L. (Ajuga zvarranike)	39. FAM. ARALIACEAE
2.Mentha langifolia L.Huds (M. gjethegjatë)	1. Hedera helix L. (Urthi)
3.Salvia verticulata L. (Sherebela qerthullake)	40. FAM. PRIMULACEAE
4.Satureja montana L. (Trumëza)	1.Cyklamen neapolitanum Ten. (B.gjetheurithi)
5.Galeopsis speciosa Mill. (Galeopsi i hijshëm)	2.Primula vulgaris Huds. (A.rëndomtë)
6.Clinopodium vulgare L.(Statureja vulgaris Fritsh)	41. FAM. VIOLACEAE
7.Origanum vulgare L. (Rigoni zakonshëm)	1. Viola odorata L.(Manushaqja)
8.Lamium bifidum L.(Hithëbuta bigëzuar)	42. FAM. HYPERICACEAE
9.Micromeria albanica L. (B. shqiptar)	1.Hypericum perforatum L. (Lulebalsami)
9.FAM. LINACEAE	LILIATE (MONOCOTILEDONE)
1.Linum perenne L. (Liri shumëvjeqar)	43. FAM. LILIACEAE
2.Linum hirsutum L. (Liri qimeashpër)	1.Allium sphaerocephalum L. (Q.kokeerruzullor)
10. FAM. BERBERIDACEAE	2. Allium flavum L. (Qepa e verdhë)
1.Berberis vulgaris L.(Mëlqinja e rëndomtë)	44.FAM. DIOSCORACEAE
2. Mahonia aquifolium Nutt. (Mahonija gjetheajshje)	1.Tamus communis L. (Pejza rrushë gjarpëri)
11. FAM. BORAGINACEAE	45.FAM. ORCHIDACEAE
2. Symphytum tuberosum L. (K. Zardhokore)	1.Orchis morio L.(Salepi morio)
3. Onosma echioides L. (Ç. si selligë)	46. FAM. POACEAE
4. Anchusa officinalis L. (Gj. Mjekësore)	1. Lolium perenne L. (Egjra shumëvjeqare)
12.FAM. BRASICACEAE	2. Hordeum murinum L.(Elbi i minjëve)
1.Arabis turrita. L. (Arabësi kullë)	3. Dactylis glomerata L. (Telishi)
	4. Bromus squarresus L. (Bari luspak)
	5.Bromus arvensis L. (Bari i arës)
	5. Bromus hordeaceus L.(Bari bultosh)
	6. Bromus racemosus L. (Bari me vilë)
	7. Cynosurus echinatus L. (Bishtqeni gjembak)

2. Berteroa Incana L. (<i>Shtrapëri</i>)	8. Poa pratensis L. (<i>Flokëza e livadhit</i>)
3. Peltaria alliacea. Jasq (<i>P. hudhëurore</i>)	9. Poa bulbosa L. (<i>F. qepore</i>)
4. Roripa lippipenzensis. Wulf. Reichenb (<i>R.e lipicës</i>)	10. Phleum pratense L. (<i>Fleumi i livadhit</i>)
5. Lunaria rediviva L. (<i>Lunaria e përtriturar</i>)	11. Sesleria Comosa L. (<i>P.me baluke</i>)
6. Capsella bursa pastoris L. (<i>Shtrapëri</i>)	13. Sesleria autumnalis (Scop). (<i>P.vjeshtës</i>)
7. Cardamine hirsute L. (<i>Kardamini çimeashpër</i>)	
8. Thlapsi praecox Wulfen. (<i>T.i hershëm</i>)	

4.KONKLUZIONE

Bazuar në studimin e kryer në hapësirën e rrjedhjes së mesme të Lumbardhit prej Prizrenit në Reçan, rezulton se ka prani të madhe të specieve bimore si ato barishtore, shkurrore, drunore, bime endemike e mjekësore. Një pjesë e konsiderueshme e tyre gjenden në formën e fitocenozave duke realizuar role të shumfishta ekologjike. Rezultatet e studimit tregojnë që janë konstatuar: 46 familje, 123 gjini dhe 157 specie, ku prej tyre mund ti citojmë; a) Equisetaceae 1 familje, 1 gjini 1 specie ; b) Cupresaceae 1 familje, 1 gjini 1 specie ; c) Polipodiaceae 1 familje , 1 gjini 2 specie: ; d) Dikotiledonae 39 familje, 111 gjini 136 specie ; e) Monocotiledonae 4 familje, 11 gjini 17 specie. Nga të gjitha grupet bimëve familjet me numër më të madh të specieve të konstatuara janë: Pteridiophyta, familja, Polipodiaceae familja, Equisetaceae, familja Cupresaceae. Nga Dicotiledonaea si familje me numër më të madh të specieve janë familjet: Asteraceae, Rosaceae, Fabaceae, Convolvulaceae, Oleaceae, Betullaceae, Ranunculaceae, Brasicaceae, Primulaceae, Lamiaceae. Monocotiledonet si familje me numër më të madh të specieve janë: Poaceae, Liliaceae, Orchidaceae. Fitocenozat në rrjedhën e Lumbardhit të Prizrenit luan një rol të rëndësishëm ekologjik në peizazhin e kësaj lugine duke rritur cilësinë peisazhike e cila mundëson një sërë aktivitete turistike në këtë zonë. Fitodiversiteti i kësaj rrjedhe lumi në disa zona është dëmtuar dhe gjendet i rrezikuar nga aktivitete të ndryshme të komuniteteve lokale si ndërtimet pa kriter, prerja e drurëve, kullotja e bagëtive e djegia në disa zona.

5.REFERENCAT

1. Biondi E. The phytosociological approach to landscape study. *Ann. bot. (Roma)*, 1994 - 52: 135-141.
2. Biondi E., M. Baldoni, F. Taffetani & I. Vagge. Biodiversity and dynamic characteristics of the fluvial vegetation of two natural park in the hydrogeographic basin of the Po river (Italy). *Phytocoenosis*, 1999, 11: 161-167.
3. Biondi E., R. Calandra, D. Gigante, S. Pignatelli, E. Rampiccioni & R. Venenzoni. *Il paesaggio vegetale della provincia di Terni*. Provincia di Terni e Università di Perugia. 2002.
4. Braun-Blanquet J. Plant sociology. McGraw Hill, London New York, 1932.
5. Çavolli, R.: Gjeografia regjionale e Kosovës. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematiko - Natyrore, Prishtinë, 1997.
6. Daget P. Poissonet J.: Analyse phytologique stepat des. Aplikacione agronomiques. CNRS KEAP, Montpellier, doc. 1969, 48: 66.
7. Tutin T.G. Flora Europaea, 1-5. – Cambridge University Press, Cambridge, 1980.
8. Demiri, M: Flora Ekskursioniste e Shqipërisë. Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë. 1983.
9. Diklić, N. Nikolic. B.: Flora SRS, Belgrade, 1970 – 1977: 1-9.
10. Horvat, I.: Nauka obljninim zajednicima, Hrvatske. Zagreb, 1949.
11. Jungwirth, M., Haidvogel, G., Moog, O., Muhar, S., Schmutz, S. Angewandte Fischökologie an Fliessgewässern. Facultas Universitätsverlag, Vienna. 2003.

12. Košanin, N.: Sistematski odnosi geografija. Liliun albanicum i L. carnolicum. SA Beograd. 1926.
13. Millaku, F.: Flora planine Maja Rusolija (Prokletije), Suveç. u Zagrebu, Zagreb, 1993.
14. Pajazitaj Q. Percaktuesi i Bimëve, Universiteti i Prishtinës, FSHMN, 2004.
15. Plani Lokal i Veprimt në Biodiversitet të Komunës së Prizrenit 2013 – 2017. Prizren, 2013, f.37.
16. Pirola A. Elementi di Fitosociologia. Coop. Libr.Univ., Bologna. 1970.
17. Rexhepi, F. Flora e maleve te larta te Kosoves. Prishtinë,1986.
18. Rexhepi, F: Subalpinka i alpinkska flora unë vegetacija Ošljaka problemi i njeni zaštite. Čovek i Bilja, Novi Sad, 1983, 585-591.
19. Rexhepi, F. Vegetacioni i Kosovës. Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i shkencave te natyrës. Prishtinë,1979.
20. Rexhepi, F.: Bimet endemike të Kosovës. Universiteti Prishtinës. Prishtinë, 2000.
21. Shukriu, A. Kushtëzimi ekologjik. Shpërndarja zonale në lumin Bistrica- studim i Doktoratës Disertacion i mbrojtur në Universitetin e Zagrebit, 1979.
22. Vangjeli, et al. Flora e Shqipërisë. (Akademia e Shkencave të R.SH, Qendra e Kërkimeve Biologjike). Tiranë, 2000.

GRASS SNAKE, *Natrix sp*, AS A POTENTIAL BIOINDICATOR OF FRESH WATER ECOSYSTEM'S HEALTH-A CASE STUDY IN ERZENI RIVER, TIRANA, ALBANIA

ALIKO VALBONA^{1*}, QIRJO MIHALLAQ¹, LOCE EVIS¹

Tirana University, Faculty of Natural Sciences, Department of Biology, Tirana, Albania

*Correspondence author: e-mail: valbona.aliko@fshn.edu.al

ABSTRACT

Water snakes use both aquatic and terrestrial food resources and they are middle-to top-level predators. Water snakes are also susceptible organisms to accumulation of environmental contaminants since they are widespread in distribution and relatively abundant. The aim of this work was to study for the first time, the possible effects of water pollution on *Natrix natrix* blood erythrocytes. For this purpose, the mean nucleated erythrocyte (MNE) frequencies and nuclear and cellular abnormalities in the peripheral blood erythrocytes of *Natrix natrix* specimens collected from Erzeni River (Tirana) were evaluated. The blood glucose concentrations were also measured, as an indicator of general stress in animals. In addition, erythrocyte abnormalities like deformed cells and their nuclei, vacuolated erythrocytes and karyorhectic cells were observed in the blood films, especially on the specimens collected in polluted site. Significant high frequency of micro nucleated erythrocytes and plasmatic glucose concentration in blood of grass snake were found. We conclude that similar abnormalities observed in the erythrocytes clearly indicate that *Natrix natrix* is affected by cytotoxic and genotoxic contaminants and it could potentially be a very good bio indicator of fresh water ecosystem health

Key words: *Grass snake, nuclear abnormalities, genotoxicity, bio indicator.*

1. INTRODUCTION

There is a decreasing in the number of reptile species result from different causes such as habitat loss and degradation, relationships with other species, environmental impacts, diseases, unsustainable land use, and global climate change (Gibbons et al. 2000). Pesticides are one of the major causes of environmental pollution/contamination, accumulate in different compartments of the ecosystem (e.g. sediment, groundwater, and surface water) and pose a threat for many species (Finizio et al. 2001, Kerby et al. 2010, Bradford et al. 2011, Johnson et al. 2013).

Nowadays, because of pollution of water bodies due to anthropogenic activity, the reptile species in Albania are posing serious threats affecting their overall health status. The quality classification of rivers in Albania, according to these UNECE criteria, categorises Erzeni River in Category III of water quality (ARCADIS ECOLAS / IEEP / Metroeconomica / Enviro-L Content 06/11347 – Albania). The Erzeni River presents high levels of iron, manganese, nitrates, BOD, etc. This is due to domestic and industrial discharge from densely populated areas along its bed. At some areas, local agriculture development, provides pesticide charge to river water, making it, in long term, harmful for specimens living in water and its river's bank.

It is of great importance to determine and evaluate the genotoxic effects of pollution both on terrestrial and aquatic reptiles (Gardner & Oberdörster 2006). Although genotoxic effects to amphibians have been investigated extensively, such studies on reptiles are missing at all (Aliko et al. 2011, 2013). Until now, in our country, there are no studies on effects of environmental pollution on reptile body health with focus in genotoxicity and cytotoxicity effects of contaminants on snake blood. Taking into consideration the fact that water snakes use both aquatic and terrestrial food resources and they are middle-to top-level predators, it

can be expected that these organisms can accumulate environmental contaminants because of their widespread distribution and their relatively abundance.

Recently, morphological changes in the erythrocytes have been among the important bio indicators used to interpret environmental pollution effects (Strunjak-Perović et al. 2010, Hayretdag et al. 2014) Besides the erythrocyte cell abnormalities, formation of a micronucleus and the formation of blebbed, notched, lobed, and vacuolated nuclei were also used as parameters with which the genotoxic effect was revealed (Carrasco et al. 1990; Nascimento et al. 2010, Marcussi et al. 2011). Studies addressing formation of MN in snake species are very limited in the open literature. In one of these studies, MN formation in the erythrocytes of juvenile and adult individuals of 43 different vertebrates, including snakes, was studied by Zúñiga-González et al. (2001). In another recent study, variations in micronuclei frequencies and nuclear abnormalities in a seasonal manner were determined in *Hierophis gemonensis* specimens using controlled observation approach (Strunjak-Perović et al. 2010).

The grass snake (*Natrix natrix*, Linnaeus 1758), sometimes called water snake, is a Eurasian, non-venomous colubrid species with a wide distribution range. The grass snake is a semi-aquatic species and feeds almost exclusively on amphibians especially on the common toad and the common frog. Grass snakes are strong swimmers and may be found close to fresh water. Because they are comparatively long-lived organisms and occupy middle or higher positions in the food chain, they have proven to be very suitable for biomonitoring studies (Hopkins, 2000).

The present study aims to determine mean micronucleus frequencies, cellular and nuclear abnormalities in *Natrix natrix* collected from one heavily agricultural polluted region of Erzeni River (Tirana) in the period when they were active and report preliminary genotoxic effect results. This is the first time that erythrocyte alterations are used in order to evaluate potential cytotoxic and genotoxic effects of water pollution in reptiles of Erzeni River.

2. MATERIALS AND METHODS

Snakes were caught by the water in two sites alongside Erzeni River, Tirana, during April 2015; one site was situated nearby an agricultural area, and the other site was in a less contaminated part of the river. The last one was used as a control site. Ten snake specimens were caught at each site. All captured snakes were adult females and in good body condition. Specimens were brought to the laboratory for blood collection soon after they were caught in the field. Blood collected from the caudal vein and peripheral thin blood smears were prepared in duplicate on clean slides for each snake. Slides were fixed in ethanol (%100) for 20 minutes and dried at room temperature, and after stained with Giemmsa-Romanowski stain (Sigma Aldrich) according to the method of Dacie et al. (1984). To determine the frequencies of micronuclei and nuclear abnormalities, 2000 erythrocytes from each slide replicate, a total of (2X2000) 4000 erythrocytes, were coded and scored blind under 1000X magnification by the same experienced researcher. The nuclear abnormalities were determined according to Carrasco et al., (1990).

Determination of plasmatic glucose concentration was done quantitatively by glucose oxidase enzymatic method, by measuring it level spectrophotometrically at 340 nm (Sigma Aldrich kit).

Data of cell and nuclear abnormalities showed a non-normal distribution. The results are presented as median values \pm SD. One sample T-test and Paired samples T-test were used to evaluate differences of erythrocyte abnormalities between sampling sites. In both cases, p values < 0.05 was considered for statistical significance.

3. RESULTS AND DISCUSSION


Five types of erythrocyte morphological alterations (dividing, micro-nucleated, echinocyte, vacuolated, and enucleated) and three types of nuclear abnormalities were detected: nuclear bud, notched, and blebbed nuclei. The frequencies of micronucleus, cell and nuclear abnormalities, and plasmatic glucose levels, are shown in Table 1 and Figure 1.

Table 1. Data on sampling sites, specimens, micronucleus frequency, erythrocyte abnormalities and plasmatic glucose values in *N. natrix*.

Sampling Site	Specimen	MNE	EA	Glucose Level (mmol/L)
Polluted	<i>N. natrix</i> (n=10)	0.35± 0.05	27.15± 0.6	5.3± 0.53
Non-polluted	<i>N. natrix</i> (n=10)	0.11± 0.01	1.89± 0.3	1.3± 0.3

Our results showed a significant increase ($p < 0.05$) in total erythrocyte and nuclear abnormalities in individuals from polluted site, compared to the less contaminated area. The most frequent erythrocyte abnormalities were cell deformity, presence of micronucleus, and vacuolated cells. The higher frequency of cellular and nuclear deformities in erythrocytes of *Natrix natrix*, demonstrate for the presence of genotoxic chronic stress as a consequence of long term pollution of Erzeni River by contaminants of anthropogenic origin.

Figure 1. Micronucleus frequency, erythrocyte abnormalities and glucose level in *N. natrix*.



All individuals sampling from polluted site exhibit a significant increase in plasmatic glucose levels comparing with specimens collected at non-polluted site. This fact, support the idea that presence of contaminants in fresh water can induce stress to grass snake which is expressed by an increase by five times of the plasmatic glucose level.

Presence of erythrocyte nuclei with irregular margins in reptiles was pointed out by different authors as physiologic condition (Arikan et al. 2009; Claver and Quaglia 2009; Mayer et al. 2005) or consequence of malnutrition, anorexia and chronic diseases (Pendl 2006; Reavill, 2005). However, there is no data about assessment of this phenomenon as pollution indicator in snakes. Since reptilian erythrocytes are nucleated it also could be suitable for implementation of this test in assessment of exposure to environmental contaminants.

Similar MNE results to ours were reported from Aymak (2010) in his study, who reports higher MNE frequencies at localities where heavy metal pollution/contamination is particularly high compared with a relatively clean/uncontaminated area. Furthermore, Aymak also stated that MNE frequencies showed seasonal variations. In our study, the collection of the specimens in May and at temperatures relatively constant, minimizes the possible seasonal variation of the MNE frequencies.

Erythrocyte nuclear deformities can be explained by the fact that as far that the cell detects an affected region, it began a process of repair and elimination of the chromatin (Shimizu et al., 1998; Ergene et al., 2007). The affected part is then moved to the periphery of the nucleus

and is eliminated by exocytosis. Thus, prior the complete elimination, the nuclear membrane may present imperfections, characterizing the nuclear abnormalities.

Our finding of a high number of nuclear abnormalities together with micro nucleated erythrocytes, can be explained also with the possible presence of oxidative stress induced by the presence of pesticides or heavy metals in the river sediments and surface waters. During oxidative stress, the first target is the cell membrane that by having its permeability and selectivity altered by lipid peroxidation, became the nucleus more susceptible, and therefore, might form nuclear abnormalities and micronuclei.

Alternatively, erythrocyte cells under pesticides or heavy metal pollution, can change their form in order to compensate for low water oxygen content. In this case they tend to become round or tear-drop in shape (echinocytes). Cellular abnormalities, later, tend to direct the cell to death. The presence of deformed erythrocytes and cytoplasmic vacuolization suggested that contaminants present in polluted site of Erzeni River, can cause hypoxic conditions, which results, in depression of ATP that lead to abnormal shape of red blood cells Witenska, 2004).

4. CONCLUSIONS

In conclusion, the current study provides baseline data regarding micronuclei and nuclear abnormalities in grass snake *N. natrix* and suggests that these assays may be useful for evaluating exposure of reptiles to genotoxic agents. However, it will be necessary to extend this kind of studies in different pollutes areas in order to evaluate the role of different contaminants in appearance of MN, and NA.

5. LITERATURE

1. Aliko V., Sula E., Morina V., Biba A. Ndryshimet eritrocitare si pergjigje fiziologjike ndaj stresit te ndotjes ne amfibe. Buletini i Shkencave Natyrore. 2013; 16:92-101.
2. Aliko, V. Biba, A. Micronuclei induction in *ranidae* & *buffonidae* tadpoles by the pyrethroid insecticide lambda-cyhalothrin. Journal of Ecosystems and Ecology Science (IJEES). 2011; 1, Special issue: 43-48.
3. Arikan H., Gocmen B., Atatur M., Kumlutas, Y., Cicek. K. Morphology of peripheral blood cells from various Turkish snake. Northwest J Zool. 2009; 5(1):61–73.
4. Aymak, C. (2010): Determination of heavy metal pollution and its genotoxic effects by using micronucleus test in *Rana ridibunda* Pallas, 1771 (Ranidae, Amphibia) living in Mersin. Mersin University, PhD. Thesis.
5. Bradford PT, Goldstein AM, Tamura D *et al.* (2011) Cancer and neurologic degeneration in xeroderma pigmentosum: long term follow-up characterises the role of DNA repair. *J Med Genet* 48:168–176.
6. Carrasco, K. R.; Tilbury, K. L.; Myers, M. S. Assessment of the Piscine Micronucleus Test as an in situ biological indicator of chemical contaminant effects. *Canadian J. Fish. Sci.* 1990; 47: 2123-2136.
7. Carrasco, K.R., Tilbury, K.L., Myers, M.S. Assessment of the piscine micronucleus test as an in situ biological indicator of chemical contaminant effects. *Can Aquatic Sci.* 1990; 47:2123–2136.
8. Claver JA, Quaglia AIE (2009) Comparative morphology, development and function of blood cells in no mammalian vertebrates. *J Exotic Pet Med* 18(2):87–97.
9. Dacie, J.V. and Lewis S.M. Practical haematology sixth ed. Churchill Livingston, Edinburgh, Melbourne and New York 1984; 24 - 36.
10. Ergene S, Cavas T, Celik A, Köleli N, Aymak C. Evaluation of river water genotoxicity using the piscine micronucleus test. *Environ Mol Mutagen.* 2007; 48:421–429.

11. Finizio A., Calliera M., Vighi M. "Rating Systems for Pesticide Risk Classification on Different Ecosystems". *Ecotox Environ Safe*. 2001; 49: 262-74.
12. Gardner, S.C. and Oberdörster, E. *Toxicology of reptiles*. Boca Raton: CRS press, 2006.
13. Gibbons, J. W. The global decline of reptiles, déjà vu amphibians. *Bioscience* 2000; 50: 653–666.
14. Hayretdağ, S., Gürkan, M., Yakin, B. and Varol, C. A preliminary study on micronuclei and nuclear abnormalities in the erythrocytes of some colubrid snakes from Turkey. *Tok. Biharean Biologist*. 2014; 8 (1): 53-55.
15. Hopkins, W.A. (2000). Reptile toxicology: challenges and opportunities on the last frontier of vertebrate ecotoxicology. *Environ. Toxicology. Chem.* 19, 2391-2393.
16. Johnson, P., Preston, D., Hoverman J., and Richgels, K. Biodiversity decreases disease through predictable changes in host community competence. *Nature* 2013; 494: 230-234.
17. Kerby, J. L., Richards-Hrdlicka, K. L., Storfer, A. and Skelly, D. K. An examination of amphibian sensitivity to environmental contaminants: are amphibians poor canaries? *Ecol. Lett.* 2010; 13: 60-67.
18. Marcussi, S., Santos, P. R. S., Menaldo, D., Silveira L., Santos-Filho, N., Mazzi, M., Silva, S., Stábeli, R., Greggi Antunes, L., Soares, A. Evaluation of the genotoxicity of *Crotalus durissus terrificus* snake venom and its isolated toxins on human lymphocytes. *Mutation Research/Fundamental and Molecular Mechanisms of Mutagenesis*, 2011; 724(1-2):59-63.
19. Mayer J, Knoll J, Innis C, Mitchell AM (2005) Characterizing the hematologic and plasma chemistry profiles of captive Chinese water dragons, *Physignathus oncinus*. *J Herpetology Med Surg*. 15(3):16–23.
20. Nascimento FF, Pereira LG, Geise L, Bezerra AM, D'Andrea PS. Colonization process of the Brazilian common vesper mouse, *Calomys expulsus* (Cricetidae, Sigmodontinae): a biogeographic hypothesis. *J Hered.* 2011; 102: 260–268.
21. Pendl, H. Morphological changes in red blood cells of birds and reptiles and their interpretation. *Isr J Vet Med*. 2006; 61(1):1–12.
22. Reavill, D. Selected topics in reptile clinical pathology. Lecture given at the U.C. Davis Avian/Exotic Animal Symposium 2005; 1–12.
23. Shimizu, N., Itoh, H., Utiyama, H., Wahl, G. M. Selective entrapment of extrachromosomal amplified DNA by nuclear budding and micro nucleation during S-phase. *Journal of Cell Biology* 1998; 140/6:1307-1320.
24. Strunjak-Perović I, Lisičić D, Čoz-Rakovac R, Topić Popović N, Jadan M, Benković V, Tadić Z Evaluation of micronucleus and erythrocytic nuclear abnormalities in Balkan whip snake *Hierophis gemonensis*. *Ecotoxicology* 2010; 19:1460-1465.
25. Witenska, M. The effect of toxic chemicals on blood cell morphology in fish. *Fresenius Environmental Bulletin* 2004; 12a:1-7.
26. Zuniga-Gonzalez, G., Torres-Bugarin, O., Zamora-Perez, A., Gomez-Meda, B.C., Ramos Ibarra, M.L., Martinez-Gonzalez, S., Gonzalez-Rodriguez, A., Luna-Aguirre, J., Ramos-Mora, A., Ontiveros-Lira, D. & Gallegos Arreola, M.P. Differences in the number of micro nucleated erythrocytes among young and adult animals including human spontaneous micronuclei in 43 species. *Mut. Res.* 2001; 494: 161-167.

**RESURSET UJORE-MBROJTJA, VETIT FIZIKO-KIMIKE DHE
BAKTERIOLOGJIKE NË RAJONIN E KLINËS
TAFË VESELAJ¹, SELVETE KRASNIQI²**

¹Agjencia Për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Rr. “Luan Haradinaj” Ndërtesa e Qeverisë
(ish Rilindja) 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

²Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës, Rr. “Nëna Tereze”, pn, Rrethi i Spitalit,
10000, Prishtinë, Republika e Kosovës
tafe.veselaj@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Klina është e vetmja Komunë në Kosovë që në territorin e saj qarkullojnë 5 lumenj. Territori është i pasur me resurse ujore që varet jeta e banorëve të qytetit dhe viseve rurale. Shfrytëzimi i resurseve ujore për pije është minimal veçanërisht për 10 mijë banorët e qytetit. Mospërdorimi i ujit për pije vjen si pasojë i ndotjes nga lumi. Banorët e Klinës ujin për pije e shfrytëzojnë nga burimi i quajtur “Pusi Jarinës”. Distanca e burimit të ujit nga lumi është 1m. Studimit është bërë gjatë vitit 2004. Qëllim i studimit ishte përcaktimin e shkallës së ndotjes së burimit ujore. Si krahasim janë përdorur burimet ujore për pije të Komunave Pejë dhe Istog. Në studim janë përdorur metodologjitë; vrojtimi, përshkrimi i gjendjes, analizimi dhe krahasimi statistikor i rezultateve laboratorike. Janë analizuar në total 82 mostra. Në burimin e Klinës janë analizuar 20 mostra, në Istog 19 dhe në Pejë 43 mostra. Sipas rezultateve në Klinë turbiditeti si indikator që pengon dezinfektimin e ujit të pijes, 25% e mostrave janë mbi vlerën normale, ndërsa në komunat tjera ky indikator është në vlerat e normales. Në burimin e Klinës parametrat si; Cl⁻ dhe NH₄⁺ kanë rezultuar me vlera të larta. Në këtë burim mbi 65% te mostrave me NO₂ janë mbi vlerat e lejuar. Prezenca e NO₃⁻ është mbi vlerën e lejuar më 5% të mostrave, ndërsa në Pejë dhe Istog, ky parametër është në vlera normale. Në Klinë, në aspektin bakteriologjik, 55.6% e mostrave janë të kontaminuara me ndotës që kanë origjinë fekale (E. Coli). Burimi i ujit në Klinë nuk ka mbrojtje sanitare dhe as zona mbrojtëse.

Fjalët kyçe: kontaminimi, ndotja e resurseve ujore, zonat mbrojtëse etj.

ABSTRACT

Klina is the only municipality in Kosovo in which's territory five rivers pass through. The territory is rich with water resources that play a crucial role for city and rural area residents. Despite the abundance of water resources only a small part of 10000 inhabitants use it for drinking purposes. The low rate of water use for drinking purposes is mostly due to poor water quality. Inhabitants of Klina are supplied with drinking water from the water well so called “Jarina Well), which is only 1 m from the contaminated river.

The study conducted during 2004 aimed at determination of water well pollution level. For comparative purposes the quality of drinking water resources of Peja and Istog municipalities are used. The methodology used: observation, description of the situation, laboratory result analyzes, and data statistics comparison. The 82 samples were analyzed, Klina-20, Istog -19, and Peja 43 samples. According to the results, in Klina, the turbidity as an indicator that prevents the drinking water disinfection, 25% of samples were above the allowed value, while in the other municipalities results were within allowed values. Parameters of Cl⁻ and NH₄⁺ have resulted with higher values in Klina. Over 65% of the NO₂ samples have resulted over the allowed values. Furthermore, 5% of NO₃ samples in Klina resulted over allowed values, while in Peja and Istog, this parameter is the within the normal value. In bacteriological aspect, 55.6% of samples in Klina are contaminated with fecal origin (E. Coli). In Kline water source has no protection as a lack of protective zones.

Keywords: contamination of water, pollutants, water resources, protection areas etc.

1. HYRJE

Uji është burim jete dhe i pazëvendësueshëm për ekzistencën në planetin e tokës. Është një kërkesë e domosdoshëm për jetë, por mund të bëhet edhe shkaktar i vuajtjeve dhe vdekjeve në mungesë të sanitacionit. Derisa numri i banoreve po rritet dita ditës, sasia e ujit të pijes me cilësi higjienike po bëhet me i pakët. Uji i resurseve ujore në mënyrë të vazhdueshëm po rrezikohet nga ujërat e ndotura. Ndotja e mjedisit po ndikon në kualitetin e ujit si në aspektin kimik (nitrate, fosfate, metale të rënda, pesticide etj), me mbetje dhe ndotje në aspektin e kontaminimit patogjenik.(Peter Morris&Riki Therivel,2003).

Llogariten së sot në botë të sëmuret zënë rreth 25% të shtretërve në spitale. Rritja e pakontrolluar e popullatës rrit shpenzimet për 4% në vit. Në shtetet e pazhvilluar 60% të banoreve nuk kanë ujë higjienik për pije, ndërsa 75% e tyre nuk kanë kurrfarë mundësie për jetë në kushte sanitare.Për shkak të rëndësisë së ruajtjes së shëndetit të popullatës dhe qasjen adekuate në ujin e sigurt për pije, aprovimi i standardeve në këtë fushë është më se i domosdoshëm.(WHO,2008)

Komuna e Klinës ka një popullsi me mbi 54.000 banorë të shtrirë në 54 vendbanime.(UN, 2005).Klina shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës (Rrafshi i Dukagjinit). Pjesa verilindore është përbërë prej viseve malore të Llapushës dhe Drenicës, ndërsa në pjesën perëndimore shtrihen fushat që përfshinë Rrafshin e Dukagjinit. Në përbërjen gjeomorfologjike dhe gjeologjike të tokës marrin pjesë biformacionet ultrabazike, vullkanogjene-sedimentare, dijabazo-strallore e jurasikut të epërm, formacionet karbonatike i kretakut të poshtëm dhe të sipërm, depozitimet e pliocenit dhe te plio-kuaternarit. (Shabani, B.- Elezaj, Z. 2002). Struktura pedologjike e tokës në këtë lokalitet është mjaft e larmishme dhe përfshin rreth 12 tipe të tokave (Harta pedologjike, 1974).

Rajoni i Klinës karakterizohet më temperatura relativisht të larta më një vlerë mesatare vjetore 11 °C dhe me të reshura mesatare vjetore prej 724.6 mm.(Tahirsyla, S. 2003).

Lokaliteti i Klinës ka resurse të shumta ujore duke përfshirë 5 lumenj dhe disa burime ujore me vlera të larta natyrore. Burimi i vetëm për furnizim me uji të pijes për 10000 banorët e qytetit është burimi i quajtur “Pusi i Jarinës”. Mbrojtja e këtij burimi është mjaftë e vështirë për shkak të pozitës gjeografike. Mbrojtja e sipërfaqeve të hapura të ujit është një problem madhor. Ai mund të mbrohet prej aktiviteteve të njeriut, por kur është rasti i një lumi mbrojtja mund të realizohet në një pjesë të kufizuar, a shumë vështirë do të ishte përgjatë tërë rrjedhës.(WHO, 1985).

Studimi është i fokusuar në burimin e ujit për pije të banorëve të qytetit të Klinës (Pusi i Jarinës). Burimi ka kapacitet të furnizimit me 200 l/sec. Nga burimi furnizohen 25% e popullatës së Klinës me uji të pijes. Qasja në kanalizim e banorëve është vetëm 9%.

Edhe pas 10 viteve(2005-2015), në qytetin e Klinës akoma është e njëjta situatë. Banorët akoma nuk e përdorin ujin për pije për shkak të mos përmbushjes së standardeve për konsum. Konsumi i ujit të kontaminuar mund të shkaktojë një periudhë të diarresë që është e pakëndshme për të rriturit dhe vdekjeprurëse për fëmijët. Pos ndotjes uji në burim shoqërohet edhe me turbullira të ndikuar nga Lumi. Niveli i lartë i turbullirës mund të mbrojë mikroorganizmat patogjen nga efektet e dezinfektimit, të stimulojë rritjen e baktereve dhe japin rritje të konsiderueshme të shpenzimit të klorit. Dezinfektim me klor i ujit të pijshëm ka kufizime ndaj protozoave, patogjenët e në veçanti Cryptosporidium dhe disa virus(Latif, B.2000). Sëmundjet hidrike dhe shkaktarët me të shpeshtë të tyre janë; tifoja abdominale, dizenteria, tularemia, gastroenteritet, sëmundje të lëkurës etj.

E vetmja shpresë për banorët është vënia në funksion e impiantit-fabrikës për uji të pijes. Impianti për përpunimin e ujit ka përfunduar që 4 vite dhe akoma nuk është vënë në funksion. Rreziku i këtij impianti do të ishte në rast të mos menaxhimit të mirë dhe efikas në çdo kohë, për shkak se uji merret direkt nga Lumi i Drinit të Bardh. Kjo pastaj do të

rezikonte shëndetin e popullatës nëse do të furnizonte me ujë të pa trajtuar sipas standardeve .

Qëllimi i studimit:

Studimi është bërë gjatë vitit 2004 dhe si qëllim kishte përcaktimin e nivelit të ndotjes. Në studim janë të përfshirë burimet ujore të Pejës dhe Istogut. Parametrat janë përcaktuar në bazë të instruksioneve administrative të shëndetësisë 2/1999(UN,1999).

Studimi kishte si qëllim tri aspekte:

- Se në çfarë shkalle të ndotjes është burimi i ujit në qytetin e Klinës,
- Përcaktimi i parametrave fiziko-kimik dhe baktriologjike.
- Krahasimi i parametrave fiziko kimik dhe bakteriologjik me burimet të ujit të qytetit të Pejës dhe Istogut.

2. MATERIALI DHE METODA

Janë shfrytëzuar të dhënat nga vrojtimi vizual, higjeniko-sanitar, fotografimi, të dhënat nga GPS, Zonat mbrojtëse, përkrahimi dhe metoda krahasuese. Është shfrytëzuar literaturë nga IKSHP, OBSH dhe informacione tjera për këtë fushë.

Janë shfrytëzuar metodat e vrojtimit, deskriptive dhe metoda krahasuese. Gjithsejtë janë analizuar 82 mostra. Në burimin e Klinës janë marrë 20 mostra, ndërsa për krahasim në burimet si; në Pejë janë analizuar 43 dhe në Istog 19 mostra. Mostrat janë marr dhe analizuar në parametrat e standardëve të OBSH-së. Janë analizuar parametrat: temperatura, turbullira, Ph, KMno4, klori i lire, kloruret, amonjaku, nitritet, nitratet dhe përçueshmëria elektrike. Rezultatet laboratorike janë përpunuar dhe krahasuar në mënyre statistikore. Parametrat janë analizuar përmes Spektrofotometrit “Helios dhe Merck”.

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Lëkundjet e temperaturës kanë treguar jo stabilitet. Kjo si rezultat i ndikimit nga Lumi. Pothuajse 85 % te mostrave të ujit në Burimin e Klinës kanë lëkundje jashtë standardit(8-12 C).

Turbiditeti si një parametër mjaftë i rritur në burimin e Klinës ka rezultuar me mbi 25% të mostrave me turbiditet të lartë. Turbiditeti i lartë paraqitet sidomos në Janar, Mars dhe Tetor. Ky parametër në burimet e ujit në Istog dhe Peja janë stabile. (Fig.1).Turbiditeti paraqet një pengës për klorizimin efikas të ujërave.




Fig.1. Mesatarja mujore e turbulencës në burimet e ujit

Në burimin e ujit në Klinë, 65% të mostrave kanë rezultuar me nitrite të cilat kanë tejkaluar vlerat maksimale të lejuara. Janari dhe Prilli është periudha e ngritjes së vlerave të larta. Kjo është një tregues i ndotjes së ujërave nga ujërat e shkarkuar urbane dhe bujqësisë .(Fig.2).




Fig.2. Mestarja mujore e nitriteve në burimet ujore

Kloruret dhe amoniaku edhe pse brenda limiteve në tri burimet e ujit, burimi i ujit në Klinë ka vlera më të larta në krahasim me Istog dhe Pejë (Fig.3).




Fig.3. Mesatarja mujore e amoniakut në burimet ujore


Në aspektin bakteriologjik , rezultatet kanë treguar për prezencën e mikroorganizmave patogjen si pasojë e kontaminimit fekal dhe ujërave urbane.

Burimi i ujit në Klinë, 55.6% e mostrave kanë treguar se ka kontaminim me E. coli (50% të mostrave), Klebsiella dhe Enterobacter me 5.6%.

Burimi i ujit në Istog në aspektin bakteriologjik ka treguar tipare të pastra dhe nuk është paraqitur në asnjë mostër prezencën e mikroorganizmave patogjen. Burimi i ujit në Pejë prej 43 mostrimeve vetëm një rast është paraqitur me organizmat patogjen apo 2.3% të mostrave (Tab.1).

Tab.1. Prezenca e Fecal Coliform të shprehur në % në mostra të ujit

Fecal Coriform	Water resources					
- List of the authorised additives in feedingstuffs published in application of Article 9t (b) of Council Directive 70/524/EEC concerning additives in feedingstuffs. *OJ C 50*, 25.02.2004, p. 1-144.
- Cannavan, A., Ball, G. and Kennedy, D.G. 1999. Determination of nicarbazin in feeds using liquid chromatography-electrospray mass spectrometry. *Analyst*, 124: 1431.
- Cannavan, A., Ball, G. and Kennedy, D.G. 2000. Nicarbazin contamination in feeds as a cause of residues in eggs. *Food Addit. Contam.* 17: 829-836.

5. ISO (International Standards Organization), 1997. Capability of detection — Part 1: Terms and definitions, Part 2: Methodology in the linear calibration case Part 2: Methodology in the linear calibration case. ISO 11843-1: 1997.
6. McEvoy, J.D., Smyth, W.G. and Kennedy, D.G. 2003. Contamination of animal feedingstuff with nicarbazin: investigations in a feed mill. *Food Addit. Contam.* 20: 136-40.
7. Protocol for the design, conduct and interpretation of method-performance studies, *Pure Applied Chem.* 67: 331.
8. Kennedy D.G., Hughes P.J. and Blanchflower, W.J. 1998a. Ionophore residues in eggs in Northern Ireland: incidence and cause, *Food Addit. Contam.* 15(5): 535-541.
9. Kennedy, D.G., Smyth, W., Hewitt, S. and McEvoy, J. 1998b. Monensin carry-over into unmedicated broiler feeds. *Analyst* 123: 2529-2533.
10. Dusi G, Faggionato E., Gamba V., Baiguera A. Determination of nicarbazin and clopidol in poultry feeds by liquid chromatography” Department of Chemistry, *Journal of Chromatography A*, 882 (2000) 79–84.

**MONITORIMI I PARAMETRAVE MIKROBIOLOGJIKE DHE FIZIKO-KIMIKE
NË PIJET JOALKOOLIKE TË PRODHUARA NË RAJONIN E KORÇËS
MONITORING OF MICROBIOLOGICAL AND PHYSIC-CHEMICAL
PARAMETERS IN THE NON-ALCOHOLIC BEVERAGES PRODUCED IN THE
REGION OF KORÇA**

Dr. ARBEN GJATA¹, Dr. SULLTANA AJCE², Msc. XHULJA QIRINXHI¹

¹Departament of Biochemistry, University "Fan S. Noli", Korça, Albania

²Departament of Agro Food, University "Fan S. Noli", Korça, Albania

Email: gjataarben2003@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Në rajonin e Korçës, ka vite që prodhohen pije joalkoolike nga dy stabilimente dhe disa punishte duke u nisur nga koncentre me përqëndrime të ndryshme, dhe kohët e fundit me lëngje natyrore nëpërmjet shtrydhjes së frutave

Qëllimi i studimit është të kontribuojmë në lidhje me vlerësimin e cilësisë dhe sigurisë së pijeve joalkoolike, të prodhuara në zonën e Korçës, përmes monitorimit të parametrave fiziko-kimikë, mikrobiologjikë dhe studimit të shtesave konservuese të përdorura, për të ruajtur cilësinë, rritur qëndrueshmërinë dhe kohëzgjatjen e përdorimit të pijeve joalkoolike duke përfshirë edhe ato energjike prodhuar në rajonin e Korçës, shumë të rëndësishme për aplikim në industrinë e prodhimit. Për këtë qëllim u morën kampione të ndryshme dhe u analizuan përbërësit fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë të pijeve joalkoolike

Rezultatet e monitorimit fiziko-kimik, treguan se pijet e buta joalkoolike të prodhuara në rajonin e Korçës kanë luhajtje të këtyre parametrave dhe devijime nga **standartet**. Rezultatet e monitorimit mikrobiologjik ishin të kënaqshme

Fjalët çelës: *fruta, koncentrat, konservant, ngarkesë totale mikrobike, pije joalkoolike.*

ABSTRACT

In Korça, region, for many years has been produced non-alcoholic beverages from two plants and some workshops starting from concentrates with different concentrations, and recently with natural juices by squeezing the fruits.

The study was conducted to contribute to the assessment of the quality and safety of non-alcoholic beverages, manufactured in Korça, through monitoring of their physic-chemical and microbiological parameters. The study serves also to give the practical use of preservatives in order to assure the quality of storage for enhancing the stability and longtime duration of non-alcoholic beverages including those energetic produced in the region of Korça, very important for the application in the manufacturing industry. For these purposes there were taken into consideration different samples of non-alcoholic beverages and for them the necessary physic-chemical and microbiological analysis were carried out. Physic-chemical results of the monitoring showed that non-alcoholic soft drinks manufactured in Korca region demonstrate fluctuations in these parameters and deviations from standards. Microbiological monitoring results were satisfactory.

Key words: concentrate, fruits, non-alcoholic beverages, preservatives, total microbial load.

HYRJE

Rajoni i Korçës, ka vite që i prodhon pijet e buta jo alkoolike . Fillesat e saj industriale janë që me ndërtimin e fabrikës së Birra Korçës. Sot kemi nga dy stabilimente dhe disa punishte që prodhojnë pijet e buta jo alkoolike duke u nisur nga koncentrate me përqëndrime të ndryshme, dhe kohët e fundit me lëngje natyrore nëpërmjet shtrydhjes së frutave.

Disa nga përbërësit kryesorë të pijeve joalkoolike janë: Uji: është një ndër përbërësit më të bollshëm të saj mesatarisht; karbohidrate: fruktozë , glukozë etj; proteina : përmbajtje shumë e varfër; Lipide: përmbajtje shumë e varfër; fibra dhe acide organike: të cilat ndihmojnë në thithjen e kalciumit, hekurit, magnezit; pektinat; substancat fitocide: shërbejnë si substanca antibakteriale; pigmente: karotenoide; esteret: të cilat i japin aromën e saj karakteristike..

Problematika kryesore në industrinë e lëngjeve të frutave është ruajtja për një kohë të gjatë e tyre. Pijet joalkoolike pësojnë ndryshime për arsye të faktorëve të ndryshëm si drita, ajri, mikroorganizmat, kështu që duhen përdorur te gjitha strategjitë që pengojnë veprimin e faktorëve që veprojnë në to, të përdorura vetëm ose të koordinuara mes tyre.

Këto pije jane mjaft delikate në aspektin e ruajtjes apo në funksion të konceptit të prishjes së lëngjeve . per kete qëllim u bë monitorimi i tyre , ku u analizuan në detaje një sërë treguesish fiziko-kimikë

Pijet joalkoolike janë nga kontribuesit kryesorë ushqimorë të përditshëm të një sërë elementëve ushqyes për shembull sigurimi i vitaminës C nga lëngjet e frutave përbën 21% e totalit.(Cano, M. et al 2008)

Qëllimi i studimit është të kontribuojmë në lidhje me vlerësimin e cilësisë dhe sigurisë së pijeve joalkoolike, të prodhuara në zonën e Korçës, përmes monitorimit të parametrave fiziko-kimikë, mikrobiologjikë dhe studimit të shtesave konservuese të përdorura, për të ruajtur cilësinë, rritur qëndrueshmërinë dhe kohëzgjatjen e përdorimit të pijeve joalkoolike duke përfshirë edhe ato energjike .

MATERIALE DHE METODA

Studimi i parametrave fiziko-kimike i pijeve të buta jo alkoolike të prodhuara në rajonin e Korçës" u krye në Laboratorët e Universitetit "Fan S.Noli" dhe analizat mikrobiologjike u realizuan në laboratorin biokimik të Drejtorisë së Higjienës dhe Epidemiologjisë të Korçës. Monitorimi i parametrave fiziko-kimike dhe mikrobiologjike në pijet e buta jo alkoolike u shtri në:

1- analizimin në detaje të një sërë treguesish fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë si, metanolit vitaminë C, aciditetin, pH , përmbajtjen e lëndës së thatë , karbohidrateve totale, karbohidrateve reduktuese, benzoatit të natriumit , sorbatit te kaliumit, Numuri i formolit, Numërin e përgjithshëm bakterial e të myqeve .

2- Monitorimi i treguesve fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë u shtri në kohë për një periudhë deri ne 18 muaj. Eksperimentimi u krye me lëng molle të prodhuar nga kompania F.

Përgatitja e mostrave

U morën mostra nga tre kompanitë (F, XH dhe V) Konkretisht u morën këto dy grupe mostrash:

1-Mostra të lëngjeve të frutave.

2-Mostra të pijeve me gaz dhe pijeve energjetike

Analizimi i mostrave u krye me metodika standarte ndërkombëtare dhe me paisje bashkëkohore.

- Përcaktimi i acidit askorbik u krye duke përdorur me përpikmëri procedurat e metodës standarte analitike me diklor 2,6 indofenol (FAO, 1991)
- Si metodë për përcaktimin e metanolit u përdor metoda spektrofotometrike ku metanoli oksidohet deri në aldehid formik dhe më pas ky i fundit përcaktohet në mënyrë

sasiore me formimin e një kompleksi ngjyrë violet nga bashkëveprimi me acid kromotropik. Përcaktimi u krye në spektrofotometër në gjatësinë 575 nm (OIV-MA-AS312-03BR, 2009)

- Përcaktimi i aciditetit total te titrueshëm u krye duke përdorur me përpikmëri procedurat e metodës standarte analitike (AOAC Official method.,1980)
- Përcaktimi i sheqernave reduktuese (%)u krye duke përdorur me përpikmëri procedurat e metodës standarte analitike lane Eynon ,metodë (AOAC, 1984).
- Përcaktimi i lëndës së thatë u krye me refraktometrin e tavolinës ABBE në temperaturën 20° C.
- Metoda e përdorur për përcaktimin analitik të karbohidrateve totale është metoda me Fenol e Acid sulfurik për karbohidratet totale prej S.S. Nielsen,(Nielsen S.S.,2010) metodë me spektrofotometër për përcaktimin e karbohidrateve totale në spektrofotometër në gjatësinë e valës 490nm. Fillimisht u përgatit një seri standartesh nga një solucion standard 100mg/L glukozë. Me këtë krijuam një lakore standarte në spektrofotometër nga e cila rezultoi ekuacioni i vartësisë së koncentrimin me A- absorbancën: $C = 92.0739 \times A + 1.6343$ dhe faktori i regresionit = **0.996248**
- Metoda e përdorur për përcaktimet mikrobiologjike (Feng P., etj.,2002)
- Për benzoatet e sorbatet u përdor metoda me (HPLC)

REZULTATE DHE DISKUTIME

Mbas analizimit të mostrave të grumbulluara për treguesit e mësipërm përmendur , rezultatet e mara dhe të përpunuara statistikisht u vendosën në tabelën.1, 2, 3 te cilat japin rrezultatet mesatare të përfuara sipas metodikave të lartpërmendura:

Tabela. 1. Rezultatet mesatare të analizave fiziko-kimike në pijet e buta jo alkolike.

Loji I mostres	Amballazhimi	Lend e that Bx	Vit C, mg/100 ml	Metanol mg/L	Ac.Tot. % si ac. citrik	pH	numuri i formolit/100g	Benzoat Na mg/L	Sorbat K mg/L	NPM col/ml	Mikroorganizma
Lëng J pjeshke	Tetra Pak	3	11.3	40	0.19	3.56	0.7	-	-	0	
Lëng J dardhë	Tetra Pak	3	10.5	29	0.13	3.59	0.7	-	-	0	
Lëng molle F me pasterizim +velcorin	Shish e PET	13.5	5.13	270	0.36	3.59	6	-	-	0	
Lëng molle F me pasterizi+velcorin + Ba	Shish e PET	9	20.69	140	0.16	3.66	3.3	149.8 ±2.26	-	0	
Lëng molle F e pasterizuar	Shish e Qelq	11.9	4.6	35	0.32	3.6	5.5	-	-	0	
Leng frutash me koncentrat molle +velkorin(F)	Shish e PET	9.5	15.8	140	0.37	3.05	2.6	78.77 ±1.5	115.77 ±2.54	0	
Lëng S dardhe	Tetra Pak	10.6	13.6	58	0.18	3.52	1	-	-	0	

Lëng S pjeshke	Tetra Pak	11	8.9	81	0.17	3.57	2.6	-	-	0
Lëng J qershi	Tetra Pak	1.5	10.4	1.8	0.12	3.55	3	-	-	0
Lëng S qershi	Tetra Pak	12	10.1	2.5	0.14	3.6	5.3	-	-	0

Tabela.2. Rezultatet mesatare të analizave fiziko-kimike në pijet e buta jo alkoolike me gaz.

Loji i mostres	Ambalazhimi	Lend e that Bx	Vit C, mg/100 ml	Metanol mg/L	Ac.Tot. % si ac. citrik	pH	Benzoat Na mg/L	Sorbat K mg/L	NPM col/ml Mikroorganiz
Pije energjike(F)	Shishe PET	9	-	-	0.73	3.39	150.98 ±2.6	-	0
Pije me gaz cola(XH)	Shishe PET	11	-	-	0.15 si ac. fosforik	2.63	144,7 ±2.65	265.9 ±4.5	0
Pije me gaz kajsi (XH)	Shishe PET	0.6	-	20	0.17	3.53	144,7 ±2.65	240.73 ±4.1	0
Pije me gaz portokall(XH)	Shishe PET	0.6	-	12	0.17	3.52	144,7 ±2.65	240.73 ±4.1	0
Pije me gaz gazoz(XH)	Shishe PET	0.5	-	-	0.19	3.48	144,7 ±2.65	240.73 ±4.1	0
Pije energjike(V)	Shishe PET	9	-	-	0.19	3.49	440.91 ±6.5	-	0
Pije me gaz limon(V)	Shishe PET	9,1	8.5	12	0.6	2.75	538.01 ±7.9	-	0
Pije me gaz portokall(V)	Shishe PET	9	8.5	15	0.39	2.91	529.58 ±7.9	-	0

Tabela3. Rezultatet mesatare të analizave fiziko-kimike e mikrobiologjike në lëngjet e frutave të prodhuar me koncentrate në kompaninë (F).

Lloji I mostres	Amballazhimi	Lend e that Bx	Ac.Tot. % si ac. citrik	pH	Benzoat Na mg/L	Sorbat K mg/L	NPM col/ml Mikroorganizm
Lëng frutash me koncentrat molle +velkorin (F)	Shishe PET	9.5	0.37	3.05	78.77 ±1.5	115.77 ±2.54	0
Lëng frutash me koncentrat kajsi +velkorin (F)	Shishe PET	8	0.25	3.31	78.77 ±1.5	115.77 ±2.54	0
Lëng frutash me koncentrat karote velkorin (F)	Shishe PET	9.5	0.39	2.87	78.77 ±1.5	115.77 ±2.54	0
Lëng frutash me koncentrat limoni velkorin (F)	Shishe PET	9	0.6	2.71	78.77 ±1.5	115.77 ±2.54	0
Lëng frutash me koncentrat qershie velkorin (F)	Shishe PET	10.5	0.42	2.99	78.77 ±1.5	115.77 ±2.54	0
Lëng frutash me koncentrat pjeshke velkorin (F)	Shishe PET	8	0.27	3.38	78.77 ±1.5	115.77 ±2.54	0
Lëng frutash me koncentrat rushi velkorin (F)	Shishe PET	10	0.39	2.98	78.77 ±1.5	115.77 ±2.54	0

Monitorimi në kohë

Eksperimentimi i dytë ka të bëjë me monitorimin e qëndrueshmërisë së lëngjeve të frutave të prodhuara në rajonin e Korçës.

Monitorimi i treguesve fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë u shtri në kohë për një periudhë deri në 18 muaj. Eksperimentimi u krye me lëng molle të prodhuar nga kompania F.

Nga këto parti të prodhuara u morën mostrat dhe u magazinuan në rruajtje në temperaturën e ambientit . Analizimi i tyre për treguesit fiziko kimikë , mikrobiologjikë dhe organoshqisorë u krye në tre periudha kohe , së pari 0 muajsh, pas tre muajsh ruajtje dhe pas 18 muaj ruajtje domethënë pas 6 muajsh që kish kaluar afati i rruajtjes.

Rezultate:

Mbas analizimit të mostrave të grumbulluara për treguesit e mësipërm përmendur, u morën rezultate të përpunuara statistikisht, të cilat janë vendosur në tabelën 4 :

Tabela.4. Rezultatet mesatare të analizave fiziko-kimike e mikrobiologjike në lëngjet e mollës 100% prodhuar në kompaninë (F).

Treguesit e analizuar	Koha e ruajtjes 0 Muaj		Koha e ruajtjes 3 Muaj		Koha e ruajtjes 18 Muaj	
	Lëng molle (F) i pasterizuar	Lëng molle (F) me pasterizim +velcorin	Lëng molle (F) i pasterizuar	Lëng molle (F) me pasterizim +velcorin	Lëng molle (F) i pasterizuar	Lëng molle (F) me pasterizim +velcorin
Amballazhim i	Shishe qelqi	Shishe PET	Shishe qelqi	Shishe PET	Shishe qelqi	Shishe PET
Lënd e that Bx	11.9	13.5	11.9	13.5	11.8	13.5
Ac.Tot. % si ac.malik	0.32	0.36	0.35	0.38	0.37	0.42
pH	3.6	3.59	3.6	3.59	3.47	3.46
Karb tot. g/l	102.47	119.7	102.47	119.7	101.6	119.7
karbohidrateve reduktues g/L	62.3	66.9	76.8	80.2	84.4	93.6
Vitamin C mg/100ml	4.6	5.13	2.52	2.92	0	0
Benzoat Na mg/L	0	0	0	0	0	0
Sorbat K mg/L	0	0	0	0	0	0
Metanol mg/L	35	155	35	155	35	155
Numri i formolit	5.5	6	5.5	6	5.5	6
NPM col/ml	0	0	0	0	0.780×10^3	0.492×10^3
myku col/ml	0	0	0	0	0.003×10^3	0.002×10^3
E. coli/ml	0	0	0	0	0	0
VI. organoshqisor	Normal	Normal	Normal	Normal	Normal	Normal




Fig. 1 , Degradimi i Acidit askorbik gjatë ruajtjes të lëngut të mollës për një periudhë kohe 18 mujore.




Fig. 2. Ritja e aciditetit total gjatë ruajtjes të lëngut të mollës për një periudhë kohe 18 mujore




Fig. 3. Ritja e karbohidrateve reduktues gjatë ruajtjes të lëngut të mollës për një periudhë 18 mujore.




Fig. 4. Histograma e numrit të kolonive të myqeve, të lëngut të mollës për një periudhë 18 mujore




Fig. 5. Histograma e numrit të përgjithshëm të mikroorganizmave gjatë ruajtjes të lëngut të mollës për një periudhë 18 mujore

PERFUNDIME

- Sikurse shihet nga rezultatet e paraqitura në tabelat Nr 1 ; 2; 3; të parametrave fiziko-kimike në pijet e buta jo alkoolike të prodhuara në rajonin e Korçës kanë luhajtje të këtyre parametrave gjë që tregon për një mosstabilitet në standardizimin e këtyre treguesve.
- Treguesit më stabil paraqiten aciditeti total dhe për rrjedhojë dhe pH i cili është një tregues shumë i rëndësishëm i lidhur ngushtë me mekanizmin e veprimeve rruajtëse të të gjithë konservantëve të përdorur konkretisht për këto pije.
- Sasia e benzoatit të natriumit të izoluar nga analizat në këto pije shkon nga 78.77 në një rast, në 144.7 e deri në 150.98 mg /L Në një rast, në një punishte (V), rezultoi sasia nga 440.91 në 538.01 mg /L benzoat natriumi një vlerë mbi tre fishin e normës së lejuar e cila paraqet një risk për sigurinë ushqimore
- Sasia e sorbatit të kaliumit të gjetur nga analizat në këto pije shkon nga 115.77 në 265.9 mg /L pjesa më e madhe kanë përmbajtjen 240.73 mg /L
- Pra shtuesit konservues klasikë të përdorur në këto pije të tillë si benzoati i natriumit dhe sorbati i kaliumit paraqiten relativisht mirë përkundrejt limiteve
- Treguesi i sasisë së metanolit ka rëndësi vetëm për pijet që përdorin si konservat velkorinin. Sasia e metanolit e përcaktuar nga analizat në këto pije shkon nga 140 në 270 mg/L. Duke ditur që nga hidroliza e sasisë limit të velkorinit prej 250 mg/L nuk kalon sasinë e 120mg/L metanol kemi një nivel të lartë të metanolit në mostrën “Lëng molle F me pasterizim +velcorin”. Ky nivel i tillë shpjegohet me mos korrektesinë e injektimit të Velkorinit
- Po të tilla luhajtje ka dhe numri i formolit i cili është i lidhur proporcionalisht me sasinë e lëngut të frutave të përdorur për përgatitjen e këtyre pijeve. Dhe në këto raste vërehet një abuzivitet në sasinë e lëngut të frutave të përdorur për përgatitjen e këtyre pijeve krahasuar me çfarë deklarohehet në etiketë.
- Të gjitha sjellin uljen e cilësisë së pijeve të buta jo alkoolike.
- Për sa i përket monitorimit mikrobiologjik treguesit kanë dalë të kënaqshëm gjë që tregon se prodhuesit tregojnë një kujdes të veçantë për këtë aspekt

Përfundime të eksperimentimit të dytë

- Eksperimentimi i dytë ka të bëjë me monitorimin e treguesve fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë i shtrirë në kohë për një periudhë deri në 18 muaj i cili tregoi se kishin një stabilitet të mirë.
- Gjatë monitorimit u konstatuan këto ndryshime të treguesve fiziko-kimikë dhe mikrobiologjike:
- Së pari në përgjithësi, rezultatet tregojnë se ka pasur një degradim të shpejtë të Acidit askorbik që në muajin e parë të magazinimit. **Fig. 1** ky degradim mund t'i atribuohet kryesisht oksigjenit që është tretur në lëng para mbushjes së shisheve dhe ajrit në hapësirën boshe të shishes. Gjithashtu mund t'i atribuohet aktivitetit të, citokrom-oksidadës dhe peroksidazave. (Abbasi A., Niakosusari M., 2008).
- Së dyti vërehet një rritje e aciditetit të lëngut të mollës gjatë ruajtjes **Fig. 2.** Kjo rritje e aciditetit mund të jetë për shkak të formimit të acideve nga fermentimi i karbohidrateve dhe nga oksidimi i sheqernave reduktues, për shkak të degradimit të substancave pektike etj
- Së treti kemi një rritje graduale të sasisë së karbohidrateve reduktuese (**Fig. 3.**). Rritja e karbohidrateve reduktuese mund të jetë për shkak të zbrërthimit të karbohidrateve jo reduktues në karbohidrate reduktuese.
- Këto rezultate janë në përputhje me gjetjet e studiuesve të tjerë
- Së fundi ngarkesa mikrobiologjike filloi të shfaqet shumë më pas datës së skadimit .

REKUMANDIME

- Organet kopetente duhet të kenë monitorim të vazhdueshëm për këto abuzime dhe zbatimin e sistemit HACCP për të mbrojtur konsumatorin
- Prodhuesit e pijeve të buta në rajonin e Korçës që përdorin benzoatin e natriumit si konservant, duhet të kenë monitorim korrekt të sasisë që përdorin e cila nuk duhet ti kalojë 150mg/L.
- Institucioneve të kontrollit ju rekomandojmë se duhet urgjentisht të analizojnë dhe të monitorojnë sasinë e këtyre konservantëve pasi përdorimi abuziv apo mos korrektësia e tyre përbën një risk për konsumatorin.
- Përdorimi i Velcorinit nga prodhuesit e lëngjeve të frutave, e cila është e barabartë me 250 mg/L megjithëse është në nivel të pranueshëm nga standardi shtetëror, përsëri ka një nivel të metanolit mbetës në lëngjet e frutave e barabartë me 120 mg/L. Duke pasur parasysh se këto lëngje konsumohen nga fëmijët, dhe nuk ka kufizim në përdorimin e tyre, duhet një kujdes i veçantë dhe shumë korrekt i përdorimit të këtij konservanti

REFERENCA:

1. **Abbasi A.**, Niakosusari M., (2008) Kinetics of Ascorbic Acid Degradation in Un-Pasteurized Iranian Lemon Juice During Regular Storage Conditions. Pakistan Jurnal of Biological Sciences 11 (10) 1365-1369.
2. AOAC Official method 942.15 Acidity(titratable) of fruit products. B. Glass electrode method .1980
3. Cano, M. Pilar, Cano, M. Pilar; Barta, Josef ,Handbook of Fruits and Fruit Processing. Hoboken, NJ, USA: Wiley-Blackwell, 2008.
4. Costa A; Barata A; Malfeito-Ferreira M & Loureiro V, (2008) “ *Evaluation of the inhibitory effect of dimethyl dicarbonate (DMDC) against wine micro-organisms*”, Food Microbiol., vol. 25, no 2, p. 422-427
5. FAO, (1991) Manuals of Food Quality Control 14 / 8, page 194 / Pearson’s Composition and Analysis of Foods 9th edn, , page 264 .
6. Feng P., Weagant S.D., Grant M.A., Burkhardt W. 2002 Bacteriological Analytical Manual Chapter 4 ,Enumeration of *Escherichia coli* and the Coliform Bacteria September 2002
7. Interpretive Guideline(2012) No. 2012-01 Consumption of Methanol Resulting from Pectin that Occurs Naturally in Fruits and Vegetables Office of Environmental Health Hazard Assessment California Environmental Protection Agency
8. Mehmood Z, Zeb A, Ayub M, Bibi N, Badshah A. (2008) Effect of Pasteurization and Chemical Preservatives on the Quality and Shelf Stability of Apple Juice . Am. J. Food Techlo. **3**, 147-15
9. Ministria e Bujqesise Ushqimit dhe Mrojties se Konsumatorit -“RREGULLORE PER LENGJET E FRUTAVE DHE PRODUKTE TE NGJAJSHME ME TO”2012
10. Nielsen S.S.2010, Metoda meFenol-Acid sulfurik për karbohidratet totale prej S.S. Nielsen, *Food Analysis Laboratory Manual*,2010
11. OIV-MA-AS312-03B : R2009) Compendium of international methods of analysis-OIV Methanol OIV-MA-AS312-03B : R2009 1Method OIV-MA-AS312-03B 2009
12. Rhiz-Nielo, A, AI. Lopez, M.R. Lopez, M.J. Lopez and D.J. Dijkstra, 1997. Analysis of sugar from strawberry cultivar of commercial interest-contents evaluation. Proceeding of the Third International Strawberry Symposium, Veldhonen, Netherland. 29 Vol. 2, Acta-Hortic.,439: 663-664.
13. Saad B, Bari MdF, Saleh MI, Ahmad K, Talib MK. 2005 Simultaneous determination of preservatives (benzoic acid, sorbic acid, methylparaben and propylparaben) in foodstuffs using high-performance liquid chromatography. J. Chromatography A. 2005

14. Safdar NM, Asrar M, Abdullah N, Zia-ur-Rahman, Shah WH, (1999) Studies on the effect of storage condition on ascorbic acid, acidity and pH of tomato concentrate. *Pak. J. Food Sci.*, Vol. 9 Pages: 15-17.
15. Sinha N.K, Handbook and fruits processing 2006, 16 apples , p. 271,27
16. Tfouni SAV, Toledo MCF. Determination of benzoic and sorbic acids in Brazilian food. *Food Control* 2002; 13: 117 - 23.
17. Troja R: 2011. Chemistry and Food Technology (Kimia dhe teknologjia e ushqimeve), Tirana 2011.

.

**MONITORIMI I PËRMBAJTJES SË QELIZAVE SOMATIKE TË QUMËSHITIT
TË PA PËRPUNUAR NË QENDRAT E GRUMBULLIMIT TË RAJONIT TË
KORÇËS**

**MONITORING THE CONTENT OF SOMATIC CELLS RAW MILK COLLECTION
CENTERS IN THE REGION OF KORÇA**

ARBEN GJATA¹, EDLIRA GJATA³.

¹Department of Biochemistry, University "Fan S. Noli", Korça, Albania

²Technological schools Korça, Albania

Email: gjataarben2003@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Prodhimi i qumështit ka një traditë të gjatë në rajonin e Korçës. Testimi i rregullt i cilësisë së qumështit të papërpunuar është instrument i rëndësishëm për zhvillimin e sektorit të qumështit dhe mbrojtjen e konsumatorit. Ky studim ka për qëllim të përcaktojë karakteristikat mikrobiologjike (numri total i mikrobeve mezofile (MPN) dhe qelizave somatike numrin (SCC).) Ky studim u zhvillua në periudhën mars-shtator 2010-2014 për qumështin e lopës. Metodatat e përdorura për analiza janë ato të përshkruara me Rregulloren e Bashkimit Europian të publikuar nga Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit datë 25.3.2011

Rezultatet tregojnë variacione të ndryshme të parametrave të analizuar si vijon: aerobe mezofile në nivelet nga 76.9×10^4 ne 197.5×10^4 Cfu/ml dhe numuri i qelizave somatike lëviznin nga 313×10^3 - 1294×10^3 sc/ml, Në shumicën e mostrave treguesit ishin larg standartit dhe direktivave të Bashkimit Europian për Shqipërinë .

Përfundimi: Forcimi i higjenes në të gjitha fazat dhe forcimi i kontrollit nga autoritetet kompetente.

Fjalët kyçe: autoritet kompetente, qeliza somatike, qumësht i papërpunuar, qumësht lope,

ABSTRACT

Milk production has a long tradition in region of Korça. Regular testing of the quality of raw milk is important instrument for the development of dairy sector and consumer protection. This study aims to determine microbiological characteristics (total number of mezophile microbes (NPM) and somatic cells number (SCC).) This study took place in the period March- September 2010-2014 for cow milk

The methods used for analyses were those described by the Regulation of the European Union published by the Albanian Ministry of Agriculture dated 03.25.2011

The results show different variations of the parameters analyzed as follows: Mesophilic count was 76.9×10^4 ne 197.5×10^4 Cfu/mL and somatic cell count of 313×10^3 - 1294×10^3 SC/mL. The majority of samples indicators were far from standard and European Union directives for Albania.

Conclusions: Strengthening of hygiene at all stages and strengthen control by the competent authority.

Key words: competent authority, Cow milk, raw milk, somatic cell,

HYRJE

Qarku i Korçës është një rajon me potencial të lartë në fushën e blegtorisë ai posedon 38119 krerë gjedhë , 204202 të leshta dhe 61457 të dhirta.

“Qumësht i papërpunuar” është produkti i përftuar nga sekretimi i gjendrave të qumështit të një ose më shumë lopëve, deleve, dhive apo buallicave, i cili nuk është ngrohur mbi 40 gradë C dhe që nuk i është nënshtruar asnjë veprimi me efekt të ngjashëm.

Qumështi është një burim i rëndësishëm ushqimor. Qumështi i freskët konsiderohet si një dietë të plotë , sepse ajo përmban elemente ushqyes thelbësore si laktoze , yndyrë, proteina , minerale , vitamina etj. Cilësia dhe siguria e qumështit të lopës si lëndë e parë është shumë e rëndësishme për kompanitë e përpunimit të qumështit dhe konsumatorëve. Për shkak të metodave të prodhimit, është e pamundur për të eliminuar plotësisht kontaminimin e qumështit me mikroorganizma, prandaj përmbajtja mikrobiale e qumështit është një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e cilësisë së tij. Qumështi duhet të jetë i çliruar nga kontaminimet mikrobike të cilat mund të jenë të rrezikshme për shëndetin e konsumatorëve. Një nivel i lartë i qelizave somatike mund të rrisë proteolizisin në qumësht që ndikon në proceset teknologjike. (*Peter Zajac et al.,2012*) Në këtë kuadër përmbajtja e qelizave somatike paraqet një faktor shumë të rëndësishëm për mënyrën e përpunimit të qumështit. Një hap kryesor në përpunimin e qumështit është ndarja centrifugale që shkakton heqjen e papastërtive të ngurta, duke përfshirë qelizat somatike, nga qumështi para pasterizimit. Përmbajtja e lartë e qelizave somatike mund të ndikojë në lipolizën dhe proteolizën në qumësht, të cilat çojnë në shije të huaja dhe zvogëlojnë qëndrueshmërinë e produkteve (Ma, Y. et al 2000b;. Santos et al 2003.) Në djathë ndikon negativisht në rendiment (Politis et al 1988a;. Politis et al 1988b;. Klei et al 1998.). Prandaj është e rëndësishme për të shmangur përmbajtjen e lartë të qelizave somatike në qumësht gjatë përpunimit të qumështit ose më mirë për të reduktuar ato para prodhimit.

Me vendim nr.1132, datë 5.8.2008 te Këshillit te Ministrave normat për grumbullimin e qumështit të papërpunuar nga ferma prodhuese në momentin e dorëzimit në qendrat grumbulluese ose përpunuese janë:

Treguesit	Faza III Deri më 31. 12.2013
Përmbajtja e mikroflorës së përgjithshme (mezofile aerobike) në 30°C (për ml)	≤100. 000 (a3)
Përmbajtja e qelizave somatike (për ml).	≤ 400. 000 (b3)

Qëllimi i studimit është të kontribuojmë në lidhje me vlerësimin e cilësisë dhe sigurisë të qumështit të pa përpunuar në rajonin e Korçës nëpërmjet monitorimit të përmbajtjes së Numrit të qelizave somatike (SCC)

MATERIALET DHE METODAT

Monitorimi i përmbajtjes së qelizave somatike dhe përmbajtja e mikroflorës së përgjithshme të qumështit të pa përpunuar në qendrat e grumbullimit të rajonit të Korçës" u krye në Laboratorët e Universitetit “Fan S.Noli” dhe analizat mikrobiologjike u realizuan në laboratorin biokimik të Drejtorisë së Higjienës dhe Epidemiologjisë të Korçës .

Monitorimi u zhvillua në periudhën 2010-2014 për qumështin e lopës .

Monitorimi u shtri gjatë muajit maj , maj e qershor , në dalje të dimrit në mars e në dalje të verës në shtator në mënyrë që sudimi të përfshinte si periudhat e laktacionit dhe periudhat stinore.

Për këtë janë mbledhur mostrat e qumështit të prodhuar në rajonin e Korçës, sipas një grafiku të paracaktuar .

Përgatitja e Mostrave

Mostrat e qumështit u grumbulluan nga qendrat grumbulluese ose përpunuese të rajonit të Korçës. Marrja e mostrave për analizë u krye sipas SSH ISO 707: 1999.

Mostrat e qumështit u vendosën në shishe sterile qelqi 250ml të cilat u moren menjëherë mbas përzjerjes së qumështit dhe u transportuan në termose me ftohje (në 4-6 ° C) në një diapazon kohor nga mjelja me pak se 2 orë në vartësi të distancës së qendrave të grumbullimit me laboratorin. Numuri i qendrave ku u morën mostrat për analizë ishte 21 me një shpërndarje uniforme gjeografike në rethet Korçë, Devoll, Pogradec dhe Kolonjë. Mostrat u çuan në laborator ku ju nënshtruan menjëherë analizave mikrobiologjike.

Analizimi i mostrave

Mostra e qumështit u çuan në temperaturë 20 °C., u përzjenë plotësisht për të siguruar një shpërndarje homogjene në të gjithë mostrën.

Secilës prej mostrave ju përcaktuan parametrat mikrobiologjik si :

Nr qelizave somatike Përcaktimi u krye sipas metodës mikroskopike ISO International Standard (ISO), no. 13366-1/3 / 2001, Numri total i mikroorganizmave Përcaktimi u krye duke përdorur me përpikmëri procedurat e metodave standarte analitike të përcaktuara nga BE. Metoda e numurimit horizontal në 30 ° C aerob mezofil (ISO 4833:2003, ISO 8261)

REZULTATE DHE DISKUTIME

Mbas analizimit të mostrave të grumbulluara për Numrin e qelizave somatike (SCC) rezultatet e marra dhe të përpunuara statistikisht u vendosën në Histograma e cila jep rezultatet mesatare të përfutuara sipas metodikave të lartpërmendura.

Paraqitja e monitorimit u bë për periudhën e vitit 2010 , 2011, 2013 dhe 2014 për qumështin e lopës.

Për periudhën e vitit 2010 rezultatet nga qumështi i lopës të marra nga qendrat grumbulluese ose përpunuese të rajonit të Korçës. në vitin 2010 tregojnë se 77% e mostrave nuk plotësojnë kufirin e legjislacionit prej ≤ 400.000 qeliza somatike (për ml). Ato pika që kanë rezultate të mira ishin disa komplekse model për prodhimin e qumështit të lopës.




Fig. 1 .Histograma e numrit të qelizave somatike për vitin 2010

Për periudhën e vitit 2011 rezultatet nga qumështi i lopës të marra nga qendrat grumbulluese ose përpunuese të rajonit të Korçës. në mars të 2011 tregojnë se 100% e mostrave nuk plotësojnë kufirin e legjislacionit prej ≤ 400.000 qeliza somatike (për ml). Kurse në muajin shtator kemi 95%. e mostrave nuk plotësojnë kufirin e legjislacionit. Megjithatë nga Histograma Fig. 2, dallohet një përmirësim i dukshëm i

rezultateve në muajin shtator Kjo shpjegohet se kemi ngritje të temperaturave të mjedisit të cilat ndikojnë në gjendjen e laktacionit.




Fig. 2. Histograma e numrit të qelizave somatike për vitin 2011

Për periudhën e vitit 2013 rezultatet nga qumështi i lopës të mara nga qendrat grumbulluese ose përpunuese të rajonit të Korçës. në maj të 2013 tregojnë se 67% e mostrave nuk plotësojnë kufirin e legjislacionit prej ≤ 400.000 qeliza somatike (për ml). Kurse në muajin qershor kemi 71% e mostrave nuk plotësojnë kufirin e legjislacionit. Nga Histograma Fig. 3, dallohet një ndryshim i lehtë midis dy muajve me tendencë përmirësimi.




Fig. 3. Histograma e numrit të qelizave somatike për vitin 2013

Për periudhën e vitit 2014 rezultatet nga qumështi i lopës të mara nga qendrat grumbulluese ose përpunuese të rajonit të Korçës. në maj të vitin 2014 tregojnë se 100% e mostrave nuk plotësojnë kufirin e legjislacionit prej ≤ 400.000 qeliza somatike (për ml). Nga Histogramat Fig. 4 dallohet një ndryshim me vitet e mëparshme me tendencë përmirësimi




Fig. 4 .Histograma e numrit të qelizave somatike për vitin 2013

Mbas mesatarizimit të ponderuar me sasinë e qumështit që grumbullohet nxorëm mesataret vjetore për Numrin e qelizave somatike (SCC) rezultatet e mara dhe të përpunuara statistikiisht u vendosën në Tabela .fig.5. Histograma e numrit të qelizave somatike për kater vitet tregojnë tendencë përmirësimi nga viti 2010 në 2014 . Megjithatë është larg standarteve të vendit dhe B.E.




Fig.5.Histograma e rezultatet mesatare vjetore të numrit të qelizave somatike për katër vitet

Nga analizat e kryera për sa i përket numrit total të mikroorganizmave (NPM) aerobe mezofile të inkubuara në 30 °C vërejmë se 100% e mostrave nuk plotësojnë kufirin e legjislacionit prej ≤ 100.000 (NPM) cfu/ml por ishin disa fish më të larta. Rezultatet tregojnë nivelet e numrit total të mikroorganizmave (NPM) aerobe mezofile nga 76.9×10^4 në 197.5×10^4 Cfu/ml.

PËRFUNDIME

Për sa i përket rezultateve të nxjerra nga monitorimi për qelizat somatike janë shumë larg normave të caktuara nga Komuniteti Europjan për Shqipërinë ndërsa për sa i përket (NPM) mikroorganizmave aerobe mezofile të gjitha mostrat e qumështit rezultuan larg normave të lejuara. Kjo ka ardhur si rezultat :

- Higjena e keqe e mjeljes dhe e stallave
- Përdorimi i pakët i mjeljes mekanike
- Higjena jo e mirë e enëve të grumbullimit sidomos vazhdimi I përdorimit të enëve plastike
- Ekzistenca e mastiteve subklinike (të padukshme)

- *Përdorimi i pakët i tankeve ftohës në pikat e grumbullimit*
- *Moskonsolidimi i fermave të lopëve me numër të madh lopesh dhe ushqyerja shkencore*
- *Ndikimi I ushqyerjes dhe kushteve atmosferike*

REKOMANDIME

- Për sigurimin e një cilësie të lartë në qumështin e grumbulluar është i domosdoshëm aplikimi i praktikave të mira të higjenës dhe i HACCP në të gjitha hapat e teknologjisë së qumështit duke filluar nga grumbullimi, transporti, perpunimi, ruajtja dhe tregtimi i qumështit.
- Përqendrimi i kremeve të lopëve krijimi i fermave me shumë krerë.
- Futja e mjeljes mekanike, pajisja me tankera ftohës
- Autoriteti kompetent duhet të sigurojë efektivitetin e kontrolleve zyrtare në zbatimin me korektësi të rregulloreve dhe ligjit.
- Zbatimi I kushteve higjenike
- Heqja nga qarkullimi i enëve grumbulluese plastike etj.

REFERENCA

1. Kallco I, 2005 Mikrobiologjia Ushqimore, Korce Maj 2005
2. Leo M.L. Nollet, Fidel Toldra 2009 **Handbook of Dairy Foods Analysis** edited by Leo M.L. Nollet, Fidel Toldra Publisher CRC Press, 2009, ISBN1420046322, 9781420046328
3. Ma, Y. and D. M. Barbano (2000a) Gravity separation of raw bovine milk: fat globule size distribution and fat content of milk fractions. *J Dairy Sci* **83** (8): 1719-27.
4. Ma, Y., C. Ryan, D. M. Barbano, D. M. Galton, M. A. Rudan and K. J. Boor (2000b) Effects of somatic cell count on quality and shelf-life of pasteurized fluid milk. *J Dairy Sci* **83** (2): 264-74.
5. Maldaner N, Scapin D, Oro D, Rossi E. M. 2012. Evaluation of Microbiological Quality of Raw Milk Produced at Two Properties in the Far West of Santa Catarina, Brasil, *Food and Public Health* 2012, 2(3): 79-84
6. Milk. Enumeration of somatic cells. Pt. 1: Microscopic method.- (English) In: ISO International Standard (ISO), no. 13366-1/3 / International Organization for Standardization, Geneva (Switzerland) , 1997 , 1. ed. , v. 1-3
7. Simigic N.; Djekic, I.; Tomasevic, I.; Miocinovic, J. and Gvozdenovic, R. (2012). Implication of food safety measures on microbiological quality of raw milk and pasteurized milk. *Food Control*, 25, 728-731.
8. Peter Zajác, Martin Tomáška, Anna Murárová, Jozef Capla, Jozef Curlej 2012, QUALITY AND SAFETY OF RAW COW'S MILK IN SLOVAKIA IN 2011 *Potravinarstvo*, vol. 6, 2012, no. 2, p. 64-73 ISSN 1337-0960
9. Politis, I. and K. F. Ng Kwai Hang (1988a) Effects of somatic cell count and milk composition on cheese composition and cheese-making efficiency. *Journal of Dairy Science* **71**: 1711-1719.
10. Politis, I. and K. F. Ng Kwai Hang (1988b) Association between somatic cell count of milk and cheese yielding capacity. *Journal of Dairy Science* **71**: 1720-1727.
11. Santos, M. V., Y. Ma and D. M. Barbano (2003) Effect of somatic cell count on proteolysis and

17. lipolysis in pasteurized fluid milk during shelf-life storage. *J Dairy Sci* **86** (8): 2491-503.
18. Schukken, Y.H., Wilson, D.J., Welcome, F., Garrison-Tikofsky, L. and Gonzalez, R.N. (2003). Monitoring Udder Health and Milk Quality Using Somatic Cell Counts.
20. *Veterinary research* 34, 579-596.
21. Troja R: 2005. Chemistry and Food Technology (Kimia dhe teknologjia e ushqimeve), Tirana 2005.
22. UDHËZIM Nr.5, datë 25.3.2011 MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT Për kërkesat specifike të higjienës për stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të qumështit, dhe produkteve me bazë qumështi
23. Walstra, P., Wouters, J.T.M. and Geurts, T.J. (2006). *Dairy Science and Technology*. CRC.

**PREFERENCAT E KASAPEVE PER TE SHITUR NJE PRODUCT TE
STANDARDIZUAR DHE TE PAKETUAR
BUTCHER PREFERENCES FOR SELLING STANDARDIZED AND PACKED
PRODUCTS**

¹ETLEVA MUÇA*, ¹PANILA RESULAJ**, ¹LEDIA THOMA*, ¹ ANA KPAJ
*Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri
** Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
evadashi@yahoo.fr

PËRMBLEDHJE

Industria e mishit është një nga sektorët me rritjen më të shpejtë në Shqipëri gjatë dekadës së fundit. Ky fakt i dedikohet kushteve optimale për mbarështrimin e bagëtive dhe sidomos atyre të imta. Por nga ana tjetër, kjo industri në Shqipëri është kryesisht paorganizuar, si dhe ka një numër të madh punëtorësh të pakualifikuar që punojnë në thertore. Duke parë mënyrën e therjes së kafshëve, punonjësit janë në mënyrë të vazhdueshme të ekspozuar ndaj shumë semundjeve të cilat dëmtojnë shëndetin e tyre.

Nën këtë këndvështrim, studimi ka si objektivi të vlerësojë ndërgjegjësimin, sjelljen dhe zgjedhjen e kasapëve lidhur me standartizimin dhe paketimin e mishit, si dhe përcaktimin e një profili kasapi që është i gatshëm për të ruajtur dhe shitur mish qengji cilësor në dyqanet e tyre.

Studimi u zhvillua në qytetin e Tiranës, me dyqanet e kasapëve për të vlerësuar opinionin e tyre dhe gadishmërinë për të paguar për mishin e qengjit. Pyetësi i përdorur në studim në dyqanet e kasapëve në Tiranë (zonat urbane dhe periferitë e saj) është i mbyllur. Gjithashtu për të bërë një klasterifikim të kasapëve pyetësorët janë zhvilluar në tre drejtime : 1. Tregu i hapur i kasapeve; 2. Dyqane të specializuara kasapësh; 3. Hipermarkete.

Si konkluzion mund të themi që mishi i qengjit me origjinë nga zonat malore është më shumë i preferuar krahasuar me ato të zonave të ulta, por (kjo mund të përdoret si një avantazh, nëse etiketimi ose mjetet e tjera të marketingut janë të mundshëm të informojnë dhe bindin konsumatorët). Megjithatë implementimi i identifikimit të origjinës, duhet të jetë një prioritet për qeverinë dhe grupeve të tjera të interesit, ndërsa prodhuesit duhet të konsiderojnë prezantimin dhe promovimin e etiketimit të tyre .

Fjalë kyç : *preferencat e kasapëve, WTP,*

ABSTRACT

Meat industry is one of the sectors with quickest growth in Albania in the last decade. This is mainly due to the Albania's optimal conditions for animal breeding, especially for sheep and goats. On the other side, this industry in Albania is mostly unorganized and a large number of unskilled laborers work in slaughterhouses. Looking at the kinds of animals slaughtered, the workers are constantly exposed to many diseases that are detrimental to workers' health. Under this optic, the study has as objective to evaluate butcher awareness, attitude, and choice regarding standardized and packed meats and to determine a butcher profile for those who are ready to keep and sell such quality lamb meat in their establishment.

The survey will be conducted in Tirana city with butcher shops to assess their opinion and willingness-to-pay (WTP) for lamb products. The instrument we will use for the survey will be a closed questionnaire distributed across the butcher shops in Tirana (urban and suburban areas) in order to cover different classes of them: 1. Open market butchers; 2. Specialized butcher shops; 3. Hypermarkets.

¹ Autorët kanë kontribut të barabartë

As a conclusion we can say that lamb meat from the mountainous areas is more preferred compared to the one of the low land areas, but (it can be used as an advantage, if labeling or other marketing tools are available to inform and convince consumers. Therefore the implementation of origin identification, must be a priority for the government and other stakeholders, while producers must consider the presentation and the promotion of their labels, (i.e producers brand associations).

Key words: *butcher preference, WTP, Cluster*

HYRJE

Blegtoria është një nga sektorët me rritje bujqësore më të shpejtë në Shqipëri në vitet e fundit, pasi Shqipëria ka kushte optimale për mbarështimin e të imtave, gjedhit, apo shpendëve (MBZHRAU, 2014). Nga ana tjetër prodhimi i mishit të qengjit është konsideruar si një mundësi e madhe për zhvillimin dhe rritjen e sektorit të bujqësisë shqiptare (BB, 2007), për shkak se ai është një përbërës i rëndësishëm i dietës tradicionale Shqiptare.

Aktualisht në vend numri i të imtave ka arritur rreth 2.8 milion (MBZHRAU 2014), nga të cilat 1.9 milion janë dele. Në përgjithësi, rritja e produktivitetit dhe aksesit më i mirë në treg e çoi në rritje këtë sektor, megjithatë ka shumë më tepër për të bërë në përmbushjen dhe rritjen e kërkesave urbane (BB, 2007).

Shumica e konsumatorëve blejnë mish qengji tek kasapët, dhe disa të tjerë drejtpërdrejtë nga fermerët - vetëm rreth 5% e konsumatorëve në zonat urbane blenë mish qengji në supermarket apo lloje të tjera dyqanesh të shitjes me pakicë (DSA, 2010). Mishi i qengjit vendas blihet kryesisht i freskët tek kasapët, ndërsa mishi i qengjit nga importi gjendet zakonisht i ngrirë në supermarketete apo minimarkete.

Nga ana tjetër eksporti i mishit është i ulët, ndërkohë që importi mbetet i lartë dhe i qëndrueshëm në vitet e fundit duke shënuar rreth 40.000 ton/vit, që korrespondon me më shumë se 25% e ofertës së brendshme (MBZHRAU 2013).

Pavarësisht përmirësimeve të fundit, produktiviteti dhe efikasiteti mbeten sfidat kryesore të këtij sektori, duke kontribuar kështu në kostot e larta të prodhimit dhe në çmime për produktin e qumështit dhe të mishit.

2. MATERIALI DHE METODA

Objektivi kryesor i këtij artikulli është analizimi i preferencave të kasapëve në qytetin e Tiranës për të mbajtur dhe shitur mish qengji të standardizuar. Për të realizuar këtë artikull u zhvilluan 50 anketa gjysëm të mbyllura me shitësit e mishit për të përcaktuar se si ata e ruajnë dhe shesin produktin e tyre. Kasapët u intervistuan ballë për ballë, pasi sipas Dillman (1978) sondazhet me metodën e intervistave ballë për ballë do të lejojnë mundësinë e marrjes së rezultateve disi më të plota dhe të sakta se sa duke përdorur metodat e tjera të anketimit.

Meqenëse numri i të anketuarëve është i konsiderueshëm për të përdorur programe të posaçme për përpunimin e të dhënave jemi mbështetur në një analizë më të thjeshtë në Microsoft Excel.

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Prodhimi i ripërtpësve të vegjël (kryesisht dele dhe pak dhi) është një burim i rëndësishëm i të ardhurave për ekonomitë e vogla bujqësore shqiptare, veçanërisht në zonat e varfëra rurale malore. Në këto zona, forcimi i produktivitetit të ripërtpësve të vegjël është konsideruar si një sektor prioritar nga Strategjia e Sektorit të Bujqësisë dhe Ushqimit nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK, 2007).

Përgjithësisht mishi i gjedhit zë vendin e parë për konsumit, ndërsa mishi i qengjit përdoret më shumë në periudhat e festave fetare si Pashkë apo Ramazan.


Mishi i qengjit vendas është më i preferuar sesa ai i importit, dhe për më tepër, mishi i qengjit i vendeve malore është shumë më i pëlqyer sesa mishi i qengjit i vendeve fushore. Ky rezultat mund të përdoret si një avantazh nëse etiketimi dhe mjete të tjera të marketingut janë të disponueshme për të informuar dhe për të bindur konsumatorët e origjinës.

Megjithatë kasapët përballen me një sërë vështirësish që lidhen me tregtimin e mishit të qengjit:

- Gjetja e të imtave gjatë gjithë periudhave të vitit me qëllim plotësimin e kërkesave të konsumatorëve. Përgjithësisht prodhimi është sezonal dhe fermerët individualë mund të ofrojnë sasi të vogla të produktit.
- Negocimi i çmimit me fermerët individualë. Pjesa me e madhe e kasapëve kanë krijuar marrëdhënie individuale me fermerët pasi nuk ekzistojnë tregje të formalizuara të gjësë së gjallë.
- Konkurenca që vjen nga supermarketet e hipermarketet të cilët oftojnë produkte të standardizuara.

Në këto kushte mishi i prodhuar nga fermeret ndjek rrugët e mëposhtme nga prodhimi i produktit deri tek pjata e konsumatorit. Është e qartë se kjo skemë është një thjeshtësim i realitetit, pasi numri i lojtarëve dhe qarqeve mund të jetë edhe më i lartë dhe se këto rrjete shpesh mund të jenë shumë herë më të ndërlikuara.

Skema 1. Diagrami i shpërndarjes së mishit të kuq



Burimi: Përpunim i autorëve

Qengjat shiten kryesisht nga fermerët kur janë të vegjël pasi ekziston një kërkesë më e lartë për mishin e qengjave të rinj. Përveç kësaj, për shkak se qumështi i deleve sjell shpesh më shumë përfitime se sa mishi, fermerët kanë tendencë për të "hequr qafe" qengjat sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të "shpëtojnë" delet e qumështit nga shitja. Kështu, qengjat që dominojnë tregun janë ata me peshë mesatarisht 8 - 15 kg.

Nga ana tjetër nga anketimi rezulton se pothuajse gjysma e kasapëve i therin kafshët në thertore private. Ata preferojnë që therja të bëhet në moment dhe ndonjëherë vëzhgojnë personalisht të gjithë procesin. Për konsumatorin, ky fakt konsiderohet si dëshmi se mishi është i freskët dhe me cilësi të lartë. Megjithatë, kjo praktikë nuk është e lejuar nga shteti.

Gjithashtu kasapët përpara tregtimit të produktit në dyqanet e tyre kryejnë kontrollet veterinarë të nevojshme me qëllim lejimin e tregtimit të produktit. Por në shumicën e rasteve për kasapët vula veterinarë është vetëm çeshtje procedurash pasi ata besojnë se kontrolli i cilësisë varet nga eksperiencia e tyre profesionale.

Sipas tyre për pjesën më të madhe të konsumatorëve cilësia dhe çmimi konsiderohen si elementet kryesore të vlerësimit të produktit. Por për klasat e identifikuar të konsumatorëve është shumë më i rëndësishëm garantimi i produktit nga kasapët lokalë, sesa ai të pajisur nga qeveria me vulën e sigurisë. Kjo lidhet me faktin se vitet e fundit konsumatorët gjithnjë e më pak po besojnë në sigurinë ushqimore të ofruar nga strukturat e autoritetit të mbrojtjes së ushqimit.

Kjo ka pasoja të forta për hartuesit e politikave përsa i përket përfundimit të kapaciteteve dhe përmirësimit të imazhit të sistemit veterinar publik dhe kontrollit të sigurisë së ushqimore. Nga ana tjetër, për besimin relativisht të fortë që vjen nga grupet e mëdha lokale të konsumit, kasapët e njohur duhet të përfshijë marketingun, promovimin dhe strategjitë e komunikimit të aktorëve të ndryshëm duhet të mbështeten kryesisht në kasapët vendas për të mbuluar të gjitha kërkesat e konsumatorëve. Gjithsesi, qeveria duhet gjithashtu të inkurajojë kasapët lokalë si dhe mbarështuesit të marrin pjesë në skemat e inspektimit të sigurisë dhe cilësisë meqënëse pritet që konsumatorët e ardhshëm urbane, të kenë më pak kontakte me kasapët lokalë dhe do të duhet të mbështeten më tepër në certifikim.

Origjina e mishit të qengjit është një faktor shumë i rëndësishëm në blerjet e konsumatorit. Bernabeu dhe Tendero (2005) gjetën se origjina ishte një atribut i rëndësishëm për fuqinë blerëse në zona të ndryshme të Spanjës. Konsumatorët dhe kasapët që morën pjesë në grupet e fokusit konfirmuan një preferencë të fortë për mish qengji vendas në krahasim me atë të importuar. Përveç kësaj, qengjat e rritur në kullota malore është e perceptuar të jenë të cilësisë më të lartë sesa qengjat e rritur në zonat fushore. Kështu, për këtë atribut, u përfshinë tre nivele: importi, vendet malore dhe vendet fushore.

Gjithashtu dhe certifikimi është një atribut thelbësor, veçanërisht në rastin e vendeve në zhvillim si Shqipëria, e cila përballet me probleme serioze në zbatimin e sigurisë së ushqimit. Në studimet e konsumit që nuk përfshijnë si psh. cilësinë dhe indikatorët e sigurimit të sigurtë, konsumatorët përdorin çmimin si prove (Chan-Halbrendt et al., 2010). Burimet e vetme të kontrollit të sigurisë të mishit të qengjit në Shqipëri janë nga njëra anë, inspektimi veterinar shtetëror dhe certifikimi, dhe në anën tjetër besimi personal në kasapët lokalë.

Pra, si përfundim mund të themi se konsumatori lidh cilësinë të mishit vendin e origjinës së kafshëve në bazë të imazhit që ai ka për pejsazhin e një rajoni apo një tjetër. Prandaj zbatimi i identifikimit të origjinës duhet të jetë një prioritet për qeverinë dhe aktorë të tjerë, ndërkohë që prodhuesit duhet të marrin në konsideratë prezantimin dhe promovimin e markave të tyre (p.sh. markat e shoqërive prodhuese).

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nëpërmjet këtij artikulli u përpoqëm të bënim një analizë të preferencave të kasapëve për të shitur mish të kuq dhe veçanërisht mish qengji nisur nga preferencat e konsumatorëve urbanë duke përfshirë, origjinën çmimin, peshën dhe sigurinë (certifikimi).

Për pjesën më të madhe të të anketuarve të përfshirë në studim, origjina është pothuajse faktori më i rëndësishëm për perzgjedhjen e mishit të qengjit. Kjo pasohet nga pesha e produktit dhe certifikimi. Megjithatë, rëndësia e peshës, si dhe e çmimeve dhe certifikimit duket se ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në varësi të konsumatorëve (niveli i të ardhurave, shkollimi, punësimi etj.).

Për sa kohë etiketimi i duhur është në vend për të shmangur mashtrimin nga thertoret ose shitësit, duket se konkurrenca e mishit të qengjit të importit nuk është një problem i madh për industrinë e mishit të qengjit shqiptar. Mishit i qengjit i vendeve malore është i preferuar

fuqishëm në krahasim me mishin e zonave fushore, por (që mund të përdoret si një avantazh nëse etiketimi ose mjete të tjera të marketingut janë në dispozicion për të informuar dhe për të bindur konsumatorët e origjinës).

Në këto kushte, zbatimi i identifikimit të origjinës duhet të jetë një prioritet për qeverinë dhe aktorët e tjerë, ndërkohë që prodhuesit duhet të konsiderojnë prezantimin dhe promovimin e markave të tyre (dmth. shoqatave të markave prodhuese).

Ka një mosbesim i qartë në zbatimin publik të sigurisë së ushqimit, kur shumica e grupeve të konsumit nuk zgjedhin vulën veterinare si një burim parësor të cilësisë së mishit dhe të sigurisë.

Kanalet e shitjes dhe të tregtisë janë pak të zhvilluara. Sektori nuk ka një zinxhir vlerash të zhvilluar. Nuk ofrohen shërbime për të shtuar vlerën e produktit.

Për kasapët është i domosdoshme nënshkrimi i kontratave afatgjata me fermerët dhe tregtarët me qëllim garantimin e cilësisë dhe vazhdimësisë së produktit.

LITERATURA

1. Bernabeu R. and Tendero A. (2005) "Preference structure for lamb meat consumers. A Spanish case study. Meat Science 2005.
2. Dillman D.A. (1978). Mail and Telephone Surveys: The total design method. New York: Wiley and Sons.
3. Hobbs, Jill, Dee Von Bailey, David Dickinson, and Morteza Haghiri. (2005) Traceability in the Canadian Red Meat Sector: Do Consumers Care? Canadian Journal of Agricultural Economics 53 (2005) 47-65
4. Imami, D., Chan-Halbrendt, C., Quanguo, Zh, Zhllima, E., "Conjoint analysis of consumer preferences for lamb meat in central and southwest urban Albania", 2011 International Food and Agribusiness Management Review, Volume 14, Issue 3
5. Martin Mautner Markhof, Bahri Musabelliu, Alban Zusi, „Capacity Building for Implementing the Rural Development Strategy“ : Analysis of Meat Sector, December 2010
6. MBUMK Vjetaret statistikore 2007, 2013, 2014.
7. MBUMK. (2009). Strategjia sektoriale e bujqësisë 2007-2013. Dokument politikash i Ministrisë.
8. MBZHRAU (2013). Strategjia sektoriale e bujqësisë 2014-2020. Dokument politikash i Ministrisë.
9. Unnevehr, L.J., Villamil A.P., and Hasler C. 1999. "Measuring consumer demand for functional foods and the impact health on labeling regulation" Paper presented at the FAMC Conference on New Approaches to Consumer Welfare,
10. World Bank (2007). "Albania Strategic Policies for a More Competitive Agriculture Sector" Country Report 2007.

TENDENCA E ALERGJIVE USHQIMORE NË NJË GRUP TË POPULLATËS SHQIPTARE

XHULIANA QIRINXHI, INA TOSKA, ERALDA BELISHTA

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, Shqipëri

xh.qirinxhi@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Ky studim ka për qëllim të nxjerr në pah grupet kryesore të alergenëve ushqimorë që shfaqin më së shumti alergji.

Janë analizuar 155 individë, me shpërndarje rastësore moshe dhe seksi. Teknika e përdorur quhet Polycheck, dhe është një enzyme immune assay, për matjen sasiore të IgE alergen – specifike në serum. 20 alergenë janë të vendosur së bashku në një kasetë. Gjatë inkubimit IgE allergen-specifike në serum të pacientit lidhen me alergenët e tyre korrespondues.

Nga diganoza serologjike e 155 individëve u vu re se alergenët që shfaqin më shumë alergji janë: lajthia, karrota, selinoja dhe molla.

Rreth 47.9% e popullatës në studim paraqesin alergji për më pak se pesë grupe nga alergenët në studim, ndërsa 23.2% paraqesin alergji për më tepër se pesë grupe.

Fjalë kyçe: Alergji ushqimore, IgE, allergen, enzyme immune assay, etj.

1. HYRJE

Alergjia është një çrregullim mbindjeshmërie i sistemit imun. Reaksionet alergjike ndodhin kur sistemi imun i një personi reagon ndaj substancave të padëmshme të mjedistit. Substanca që shkakton alergji quhet allergen dhe këto reaksione janë të fituara, të parashikuara dhe të shpejta. Alergjia është një nga katër format e mbindjeshnërisë dhe bën pjesë në mbindjeshmërinë e tipit të I (e menjëhershme). Reaksionet alergjike janë të ndryshme për shkak të aktivizimit të tepruar të disa qelizave të bardha të gjaku që quhen "mast cells" dhe bazofile, nga një lloj antitropi i quajtur imunoglobulina E (IgE).

Alergjia është një reaksion i hipersensibilitetit që shkaktohet me pjesëmarrjen e mekanizmave specifike imunologjike.

Reaksionet e ndryshme ndaj ushqimeve shkaktohen nga një intolerancë ndaj ushqimeve të caktuara. Intoleranca e derivuar nga një mekanizëm imunologjik referohet si alergji ushqimor, ndërsa forma jo-immunologjike quhet intolerancë ushqimore. Alergjia e ndërmjetësuar nga Ig-E përbën tipin më të zakonshëm dhe më të rrezikshëm në të njëjtën kohë, të reaksioneve ushqimore.

Imunoglobulinat E janë një klasë antitropash që gjendet vetëm tek gjitarët. IgE-të gjenden si monomerë që përmbajnë dy vargje të rënda dhe dy vargje të lehta. Ato luajnë rolin kryesor në mbindjeshmërinë e tipit të parë, e cila shfaq sëmundje të ndryshme alergjike si astma, riniti alergjik, alergjia nga ushqimet, disa tipe urtikariesh e deri dermatit atopik. (Gould et al, 2003).

Megjithëse IgE është në sasi jo të bollshme në serum, është e aftë të shkaktojë reaksione të fuqishme pezmatimi.




Fig 1. Skema e një reaksioni alergjik ushqimor

2. MATERIALI DHE METODA

Kampioni përmban 155 individë, me shpërndarje rastësore moshe dhe seksi për një periudhë kohore prej tre vjetesh 2012-2015. Të gjitha rastet e analizave janë kryer pranë laboratorit “Intermedica”

Të gjitha mostrat e serumit u ruajtën në frigorifer në temperaturë 2-8 ° C, deri në tre ditë. Në momentin që duhet të ruheshin për më gjatë ato u vendosën në ngrirje, në temperaturë - 20 ° C.

Materialet që nevojiten”

- Kitet Polycheck
- Programi BIS (Biocheck Imaging Software), për analizimin e rezultateve
- Tundës me 30rrotullime/min
- Pipeta (200- 1000µl), pipetë 1 ml për të shpërndarë solucionin shpëlarës
- Ujë i demineralizuar
- Shishe 1 L për solucionin shpëlarës
- Kompjuter, printer
- Skaner për leximin e matjeve

Screening Polycheck është një analizë imunoenzimologjike, që përdoret për matjen e IgE-ve alergjen specifike në serum. Kjo analizë përbëhet nga 20 rreshta me alergjenë të ndryshëm dhe pesë rreshta me kalibrues, të vendosur në një suport nitro-celuloze, që ndodhet në pusin e kasetës Polycheck. Gjatë inkubimit të serumit të pacientit, IgE-të alergjen specifike lidhen me alergjenët korrespondues. Komponentët e palidhur largohen nëpërmjet shpëlarjes. Antitruapat anti-IgE të shënuar me ligandë monoklonalë, lidhen tel alergeni I lidhur me IgE-në. antitruapat e palidhur largohen nëpërmjet shpëlarjes. Anti-ligandët e markuar me enzimë lidhen me komplekset immune: teprica e konjugatit enzimatik largohet me shpëlarje. Shtohet solucion substratit dhe enzima specifike të lidhura ndryshojnë substratin pa ngjyrë në një precipitat me ngjyrë të errët. Intesiteti i ngjyrës është proporcional me përqëndrimin e IgE alergjen specifike në serumin e pacientit. Me ndihmën e sistemit të leximit të imazheve, Software

Biocheck, bëhet interpretimi i të dhënave në kasetat Polycheck PC. Secili alergjen do të identifikohet në përputhje me kurbën e kalibrimit në çdo kasetë dhe do të përcaktohet në mënyrë sasiore përqëndrimi i çdo IgE-je allergen specifike.




Fig2. Pamje e kasetës

Ecuria e analizës:

1. Nxirren kasetat dhe shenjohen
2. Inkubohen për 30 min
3. Mbulohen kasetat me solucion shpëlarës dhe përmbysen në letër thithëse
4. Hedhim 250µl solucion start dhe inkubojmë për 60 sek. Përmbytet përsëri kasetat në letër thithëse.
5. Shtojmë 200 µl të serumit të pacientit dhe inkubojmë për 60 min në një tundës
6. Kullojmë mostart dhe i shpëllajmë tre herë me nga 1 ml buffer shpëlarës. Shtojmë 250µl buffer shpëlarës dhe inkubojmë për 5 min në tundës. Kullojmë dhe shpëllajmë tre herë me nga 1 ml buffer shpëlarës. Thajmë me kujdes kasetat me letër thithëse.
7. Pipetojmë 250 µl antitrop anti-IgE dhe inkubojmë për 45 min në tundës. Kullojmë dhe shpëllajmë 3 herë me nga 1 ml buffer shpëlarës. Thajmë me kujdes kasetat me letër thithëse
8. Shtojmë 250 µl anti-ligand dhe inkubojmë për 20 min në tundës. Kullojmë dhe shpëllajmë si në pikën 7.
9. Pipetojmë 250 µl solucion substrati dhe inkubojmë në errësirë për 20 min. më pas kullojmë solucionin e substratit dhe e shpëllajmë si në hapin 7.
10. Thajmë kapakun dhe vlerësojmë kasetat duke përdorur skaner dhe programin Biocheck Imaging

REZULTATE DHE DISKUTIME

Nga diganoza serologjike e 155 individëve u vu re se alergjenët që shfaqin më shumë allergji janë: lajthia, karrota, selinoja dhe molla.




Fig 2. Paraqitje grafike e alergenëve që shfaqin më shumë alergji

Rreth 47.9% e popullatës në studim paraqesin alergji për më pak se pesë grupe nga alergenët në studim, ndërsa 23.2% paraqesin alergji për më tepër se pesë grupe.




Fig 3. Përqindja që zenë grupimi i pesë alergenëve

Koeficienti i korrelacionit Pearson midis qumështit dhe kazeinës është rreth 0.84, çka tregon se individët alergjikë ndaj njërit alergen, me shumë mundësi paraqiten alergjikë edhe ndaj tjetrit.

3. KONKLUZIONE

Në grupin e popullatës në studim grupet që shfaqin më së shumti alergji janë lajthia, selino, karrota dhe molla. Në shumicën e njerëzve kemi një hipërsensibilitet kryesisht ndaj alergenëve të mësipërm. Përse ndodh kështu, vlen të thuhet që organizmi është ndërtuar në mënyrë të tillë. Ky studim paraqet tjesht një trend.

Një pjesë e popullatës shfaq alergji në më pak se pesë grupe alergenesh dhe i takon një shifër 47.9%, ndërsa 23.2% e popullatës shfaqin alergji në më shumë se pesë alergenë.

Midis kazeinës dhe qumshtit koeficienti i korrelacionit Pearson është rreth 0.84, duke treguar një lidhje të fortë midis dy grupeve të alergenëve. Pra ata individë që janë alergjikë nga qumshiti janë edhe ndaj kazeinës edhe anasjelltas.

4. LITERATURA

1. Allergy diagnostic, Cassette-Format, page 5.
2. Aboiron.J; ‘*Les allergies alimentaires*’
3. URL: http://ëëë.aaia.ca/en/milk_brochure_en.pdf
4. winter, ËE; Hardt, NS; Fuhrman, S(2000). “Immunoglobulin E: importance in parasitic infections and hypersensitivity reponses”
5. Ishizaka K. (1989): Basic mecanisms of IgE-mediated hypersensitivity. Current Opinion Immunology 1

**VLERËSIMI I TREGUESVE FIZIKO-KIMIKË TË DISA KULTIVARËVE
AUTOKTONE TË FIKUT
EVALUATION OF PHYSICO-CHEMICAL PARAMETERS OF SOME
AUTOCHTHONOUS FIG CULTIVARS**

LUZIANA HOXHA^{*}, RENATA KONGOLI^{*}, MIGENA HOXHA^{*}, BAHRI HODAJ^{**}

^{*}Faculty of Biotechnology and Food, Agricultural University of Tirana

^{**}Faculty of Agriculture, Agricultural University of Tirana

Kodër Kamëz, SH1, Tirana 1000; Albania

hoxhaluziana@hotmail.com

ABSTRACT

This study is carried out to evaluate physico-chemical parameters of six autochthonous Albanian fig cultivars cultivated in Tirana, Elbasan, Kavaja and Berat. Fresh Figs samples of ten kilograms of *Lashti*, *Shengjinas i Zi*, *Kraps i Zi*, *Shengjinas i Bardhe*, *Nof i Bardhe*, *Durrsak* varieties, were sent to Laboratory of Agri food Technologies for further analyses. Three repetitions of each cultivar was blended in Warring Blender and: moisture content, mineral content, titratable acidity, pH, ascorbic acid content, and total carbohydrate content, were determined.

The results of determinations showed that moisture content ranged from 78.91 to 81.65 %, titratable acidity ranged 0.24-0.45 g CA/100g FW, pH ranged from 4.95 to 5.28, ascorbic acid content ranged 30.55-88.67 mg/100g FW, total carbohydrate ranged 10.36-19.87 g GLUC/100 g FW, and total mineral content ranged 0.43-0.66%.

The cultivar *Kraps i Zi* of Kavaja region, resulted in highest total carbohydrate content, ascorbic acid and minerals, and lowest in moisture content; *Shengjinas i Bardhe* of Tirana region, had the highest moisture content, and lowest pH content, whereas *Shengjinas i Zi* of Tirana region, resulted in higher pH content. *Durrsak* cultivar of Tirana region resulted in lowest acidity and mineral content. *Lashti* cultivar of Berati resulted in highest value of acidity, ascorbic acid and lowest value in total carbohydrate content.

Key words: *autochthonous, Ficus carica, physico-chemical parameters, carbohydrate.*

1. INTRODUCTION

Ficus carica is a tropic and subtropical plant produced in all Mediterranean basin and countries that have similar climate conditions. Regarding its geographic and climatic position, Albania is a favourable country for fig growing. This specie is well adapted to poor soils and dry climates (Hodaj *et al.*, 2014). In the structure of fruit trees, fig trees represent 15 % of the general number. The Albania is very rich in biodiversity of fig trees, there are a lot of varieties, forms, ecotype, genotype figs (Koka, 2003). The native fig cultivars have been adopted in certain areas and have obtained special features.

Fig is accepted as a symbol of long life throughout the world. It has high content of health-promoting nutrients. Sugars and organic acids have an important contribution to nutritive fig value (Trad *et al.*, 2012).

Fresh figs fruit are rich in amino acids, proteins, carbohydrates, fibers, minerals etc. (Aksoy *et al.* 2001, and Wang *et al.* 2003). Fig fruits have also importance in food industry since it is processed into several products.

For millennium, figs have been a typical component in the health promoting Mediterranean diet (Soloman *et al.*, 2006). There are various fig products commonly processed throughout the world. The dominant among these products are fig jam, fig pickle, dried figs, canned figs, fig preserve etc.

The fruit characteristics are very important for the variety identification and for the determination of fruit destination as fresh figs, dried figs, or local consumption, marketing, etc., (Koka, 2003).

There are few studies evaluating quality parameters among Albanian fig cultivars. This work is carried out to study physico-chemicals parameters of six autochthonous Albanian fig cultivars.

2. MATERIALS AND METHODS

2.1 SAMPLES

Autochthonous Albanian fig cultivars (table 1) grown in Tirana, Kavaja, Elbasan, and Berat, were collected and analyzed in the period June-July 2015. A sample of ten kilograms of fresh figs was harvested by hand and randomly from each cultivar. After collection, the samples were transferred to the Laboratory of Agrifood Technologies as soon as possible for further analysis. Triplications from the most representative fruits of each cultivar were selected 500g sample, based on appearance, maturity and free from defects. The blended samples (Waring Commercial, USA) were used for evaluating moisture content, mineral content, titratable acidity, pH, ascorbic acid content, and total carbohydrate content.

Table 1: Black and white autochthonous fig cultivars and cultivated region

Fig cultivar	Cultivated region	Fig cultivar	Cultivated region
Lashti	Berat	Shengjinasi i Bardhe	Tirana
Shengjinas i Zi	Tirana	Durrsak	Tirana
Kraps i Zi	Kavaje	Nof i Bardhe	Elbasan

2.2 ANALYSIS

Moisture and total mineral content were determined by gravimetric methods. Moisture content was determined by drying to constant weight at 105°C. The total mineral content was determined according to AOAC method (AOAC, 2002) by ash determination, at 550°C in muffle furnace (Thermo Scientific Heraeus) till constant weight. The acidity expressed as citric acid was measured based on the AOAC method (AOAC, 2000). The pH was determined based on the AOAC method (AOAC, 2000) using a digital pH-meter (UB-10, Denver Instrument) after calibration with pH 4.0 and 7.0 standard buffers. For determination of ascorbic acid content is used a simple rapid method according Beesey and King (1933). The total carbohydrate content was determined by anthrone method (Hedge *et al.*, 1962). Results were expressed based on standard graph of glucose. Absorbance was measured with a UV/Vis spectrophotometer (Biochrom, UK) at 630 nm wavelength.

3. RESULTS AND DISCUSSION


In the table 2 is indicated that moisture content varied among selected fig cultivars. The lowest content of the moisture was recorded in the cultivar *Kraps i Zi* (78.91%) and the highest in *Shengjinas i Bardhe* cultivar (81.65%). Results of moisture content were in accordance with other studies (Mohamad *et al.*, 2011; Nakilcioglu and Hıslı, 2013; Kamiloglu and Capanoglu 2015).

Table 2: Moisture and mineral content in selected fig cultivars (mean±SD, n=3)

	<i>Lashti</i>	<i>Shengjinas i Zi</i>	<i>Kraps i Zi</i>	<i>Shengjinas Bardhe</i>	<i>Nofi Bardhe</i>	<i>Durrsak</i>
Moisture content (%)	80.36±0.92	81.16±0.11	78.91±0.21	81.65±0.15	81.50±0.9	79.40±0.04
Mineral content (%)	0.63±0.17	0.55±0.03	0.66±0.01	0.44±0.01	0.47±0.01	0.43±0.005

Mineral content was the lowest in white varieties and the highest in black fig varieties. *Durrsak* cultivar showed lowest mineral content (0.43%), while the highest mineral content resulted at *Kraps i Zi* (0.66%).


Graphic 1: Titratable acidity in selected fig cultivars (mean±SD, n=3)



Graphic 1 shows that between fig cultivars exist variation in titratable acidity values of fig cultivars expressed as citric acid g / 100g FW of sample. The highest value resulted at *Lashti* cultivar (0.45 g citric acid/ 100g FW) and the lowest value was at *Durrsak* cultivar (0.24 g citric acid/ 100g FW). The data obtained are within the limits of other similar studies made in other countries (Gozeleki, 2010; King *et al.*, 2012; Gaaliche *et al.*, 2012; Çalışkan and Polat, 2012; Al- Hameedawi AMS, 2015; Ateyyeh and Sadler, 2006).


In the graphic 2 are shown pH content of selected fig cultivars. There were noted variations between fig cultivars, and results ranged from 4.95 to 5.28, respectively *Shengjinas i Bardhe* and *Shengjinas i Zi* cultivars. The values of pH content were within the limits of reported data of Bouzo *et al.*, (2012) work.

Graphic 2: pH content in selected fig cultivars (mean±SD, n=3)




There were variations in ascorbic acid content between black and white type fig cultivars. The cultivar with the highest content of ascorbic acid resulted *Kraps i Zi* (88.67 mg/100 g FW), and the lowest content resulted *Lashti* (30.55 mg/100 g FW).

Graphic 3: Ascorbic acid content expressed in mg/100 g FW of sample (mean±SD, n=3)



Total carbohydrate content showed variation between the studied fig cultivars. The carbohydrate content ranged from 10.36 to 19.87 g GLUC/100 g FW of sample, respectively the lowest content resulted at *Lashti*, and the highest content resulted at *Kraps i Zi*. The total carbohydrate content was near the range of Al- Hameedawi AMS, (2015).

Graphic 4: Total carbohydrate content expressed g GLUC/100 g FW of sample from studied fig cultivars (mean±SD, n=3)



CONCLUSIONS

Through this study physico-chemical parameters of native fig cultivars may be introduced not only to local markets, also to the interested food industry.

Among selected cultivars *Kraps i Zi* taken from Kavaja region showed the highest values of dry matter, ascorbic acid content, total carbohydrate content, and mineral content, also showed low acidity value. Based on these parameters we recommend this cultivar as the best from studied cultivars to be eaten fresh for its nutritional values, also we suggest it to be used for jam production.

Also, among white cultivars *Durrsak* cultivar taken from Tirana region showed the lowest moisture content, mineral content, titratable acidity and a considerable carbohydrate content. Based on results this cultivar may be suggested to be used for marmalade production and as component of confectionery and pastry industries.

The cultivars *Shengjinas i Bardhe* and *Shengjinas i Zi* taken from Tirana region, also *Nof i Bardhe* taken from Elbasan region showed that are a good source of nutrients, based on values of evaluated parameters. Whereas, the high moisture content that have indicate that are very delicate and perishable, so we recommend to be consumed as fresh fruit. *Lashti* cultivar taken from Berati region showed highest value of titratable acidity, and lowest value of total carbohydrate content. These parameters indicate that this cultivar may be not suitable for industrial purposes.

This study showed that selected autochthonous fig cultivars, which are widely grown in Tirana, Elbasan, Kavaja, and Berat regions, have variation in evaluated physico-chemical parameters. This variation except the plant genetic diversity, is affected from climatic condition of the cultivated region.

REFERENCES

1. Aksoy U., Can H. Z., Hepaksoy S. and Sahin N. Incir Yetistiriciligi. Turkiye Bilimsel ve Teknik Arastirma Kurumu. Turkiye Tarimsal Arastirma Projesi Yayinlari, Tarim Orman ve Gida Teknolojileri Arastirma Grubu, Izmir (Turkey) 2001.
2. Al-Hameedawi AMS. Evaluating some characters of leaves, physical and quality fruits of three fig, *Ficus carica* L., cultivars of second crop that harvested at two maturity stages. ISJ

- Theoretical & Applied Science 2015; 03 (23): 171-175. Doi: <http://dx.doi.org/10.15863/TAS.2015.03.23.29>
3. AOAC International. 2000. Official methods of analysis of AOAC International. 17th edition. Gaithersburg, MD, USA, Association of Analytical Communities.
 4. AOAC International. 2002. Official methods of analysis of AOAC International. 17th edition. 1st revision. Gaithersburg, MD, USA, Association of Analytical Communities.
 5. Ateyyeh A. and Sadder M. Growth Pattern and Fruit Characteristics of Six Common Fig (*Ficus carica* L.) Cultivars in Jordan. Jordan Journal of Agricultural Sciences 2006; 2(2): 105-112.
 6. Bessey O. A., and King C. G. Its determination plant and animal tissues, and the distribution of vitamin C. Journal of Biological Chemistry 1933; 103: 687-698.
 7. Bouzo C.A., Travadelo M., and Gariglio N.F. The effect of different packaging materials on postharvest quality of fresh fig fruit. International Journal of Agriculture and Biology 2012; 14: 821–825.
 8. Çaliskan O. and Polat A. Effects of genotype and harvest year on phytochemical and fruit quality properties of Turkish fig genotypes. Spanish Journal of Agricultural Research 2012; 10(4): 1048-1058
 9. Gaaliche B., Trad M., Hfaiedh M., Lakhel W., and Mars M. Pomological and biochemical characteristics of fig (*ficus carica* l.) Cv. Zidi in different agro-ecological zones of Tunisia. Pakistan Journal of Agricultural Sciences 2012; 49(4): 425-428.
 10. Gozlekci S. Selection studies on fig (*Ficus carica* L.) in Antalya Province of Turkey. African Journal of Biotechnology 2010; 9(46): 7857-7862.
 11. Hedge J.E. and Hofreiter B.T. In: Carbohydrate Chemistry, 17 (Eds. Whistler R.L. and Be Miller, J.N.), Academic Press, New York 1962.
 12. Hodaj B. Ferraj B., Thomaj T., and Susaj L. Pomologjia: speciet kryesore, 2014.
 13. Kamiloglu S. and Capanoglu E. Polyphenol Content in Figs (*Ficus carica* L.): Effect of Sun-Drying. International. Journal of Food Properties 2015; (18):521–535.
 14. King E. S., Hopfer H., Haug M.T., Orsi J. D., Heymann H., Crisosto G. M., Crisosto C. H. Describing the Appearance and Flavor Profiles of Fresh Fig (*Ficus carica* L.) Cultivars. Journal of Food Science 2012; 77(12): 419-429.
 15. Koka T. Studies on local fig (*Ficus carica* L.) germplasm in Albania. Acta Horticulturae 2003; 605:87–89.
 16. Mohamad S., and Hassan H. Determination of Sugars and Mineral Salts in Fresh Figs of Iraqi Cultivars. Tikrit Journal of Pure Science 2011; 16 (1) ISSN: 1813 – 1662.
 17. Nakilcioglu E., and Hisil Y. Research on the phenolic compounds in Sarilop (*ficus carica* l.) Fig variety. GIDA 2013; 38 (5): 267-274.
 18. Soloman A., Golubowicz S., Yablowicz Z., Grossman S., Bergman M., Gottlieb H. E., Altman, A., Kerem Z. and Falaishmant M. A. Antioxidant activities and anthocyanin content of fresh fruits of common fig (*Ficus carica* L.). Journal of Agricultural and Food Chemistry 2006; 54(20):7717-7723.
 19. Trad M., Gaaliche B., Mars M., and Renard C. Quality performance of 'Smyrna' type figs grown under Mediterranean conditions of Tunisia. Journal of Ornamental and Horticultural Plants 2012; 2:139-146
 20. Wang L. Jiang W., Ma K., Ling Z., and Wang Y. The production and research of fig (*Ficus carica* L.) in China. Acta Horticulturae 2003; 605: 191-196.



Seksioni /Section 5&6

**5. Ekonomia Bujqësore dhe Zhvillimi Rural/Agricultural
Economy and Rural Development**

**6. Politikat e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural/Agricultural Policies
and Rural Development**

**NDRYSHIMET DEMOGRAFIKE DHE EKONOMIKE NË SHQIPËRI NË
KËNDVËSHTRIMIN E CENSUSIT TË POPULLSISË DHE BANESAVE 2011
DEMOGRAPHIC AND ECONOMIC CHANGES IN ALBANIA IN VIEW OF THE
POPULATION AND HOUSING CENSUS 2011**

ARBEN KAMBO, FATOS ZERELLI, ALDONA MINGA

Horticulture and & Agro Business Department

Agriculture Faculty

University "Fan .S.Noli" Korçë

ALBANIA

kambo.arben@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Në dy dekadat përpara Censurit të Popullsisë dhe banesave 2011, Shqipëria përjetoi një transformim të popullsisë si rezultat i ndërveprimit të ndryshimeve social-ekonomike dhe ndryshimeve demografike në lindshmëri, vdekshmëri dhe veçanërisht në migracion. Një nga rezultatet më të habitshme që u qartësua kur u bënë të disponueshme të dhënat e censurit, ishte rënia e popullsisë me 8,8 përqind në periudhën ndërmjet dy censuseve të fundit. Pavarësisht rëndësisë që ka në vetvete kjo shifër, ajo fsheh një gamë të gjerë karakteristikash dhe procesesh demografike, të cilat kanë efekte me ndikim të gjerë për shoqërinë, ekonomike dhe politikën. Ky studim analizon realitetin demografik të Shqipërisë që nga 1 Tetori 2011 dhe dëshmon për ndryshimet që sjell kjo situatë. Fokusi i tij kryesor është analiza në nivel kombëtar, megjithëse ai prek edhe ndryshimet rajonale në raste me interes të veçantë. Pjesa më e madhe e informacionit të dhënë bazohet në censusin e vitit 2011, por për të pasuruar analizën është përdorur edhe një shumëllojshmëri burimesh të tjera informacioni, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fjalët kyçe : census, emigrim, jetëgjatësi, popullsia, varësia ekonomike etj.

ABSTRACT

In the two decades before the Census of Population and Housing, 2011, Albania experienced a transformation of the population as a result of the interaction of socio-economic changes and demographic changes in fertility, mortality and migration especially. One of the most surprising results that became clear when it was made available to census data, the population decline was 8.8 percent in the period between the last two census. Despite the importance of the figure itself, it hides a wide range of features and demographic processes, which have far-reaching effects on society, economy and politics. This study analyzes the demographic reality of Albania since 1 October 2011 and testifies to the changes brought about this situation. His main focus is the analysis at the national level, although it also affects regional differences in cases of particular interest. Much of the information provided is based on the 2011 census, but to enrich the analysis is also used a variety of other information sources, national and international.

Keywords: census, economic dependency, longevity, migration, population, etc.

1. CENSUSET E POPULLSISË

Censuri është një burim i rëndësishëm informacioni për planifikimin social ekonomik të një vendi. Synon t'u ofrojë qeverisë, autoriteteve lokale, organizatave ekonomike, shkencore dhe kulturore, si dhe të gjithë shoqërisë civile të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit, për analizat private dhe publike të vendimmarrjes, për kërkime shkencore dhe në përgjithësi për përmirësimin e

njohjes dhe të të kuptuarit nga shtetasit të realitetit demografik, ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Për shkak të natyrës së tij universale, censusi gjithashtu jep informacion për zona të vogla në një vend dhe mund të përdoret si bazë zgjedhje për anketat pranë njësive ekonomike familjare. Megjithatë, censusi ka disavantazhet dhe kufizimet e tij: censusi mund të përmbajë vetëm një numër të kufizuar tematikash, të cilat kufizojnë mundësinë e tij për punë të vërtetë kërkimore. Për shkak të madhësisë së tij dhe kostove të mëdha, ai në shumicën e vendeve, organizohet vetëm njëherë në 10 vjet.

2. SFONDI TEORIK I PROBLEMIT

Brenda kontekstit Evropian, Shqipëria është e vonuar për sa i takon ndryshimeve demografike. Demografët e kanë përshkruar zhvillimin nga regjimet e lindshmërisë dhe vdekshmërisë së lartë tek lindshmëria dhe vdekshmëria e ulët si “tranzicion demografik”. Iniciatorët e kësaj ideje gjatë zhvillimit të përgjithshëm zbuluan një strukturë me faza të njëpasnjëshme në historinë demografike të vendeve Evropiane (Thompson 1929, Landry 1934, Notestein 1945). Duke filluar nga një gjendje Maltusiane me shkallë të lartë lindjeje dhe vdekjeje, e para që filloi të pësojë rënie ishte vdekshmëria, pasuar nga një fazë në të cilën pashmangshmërisht u zvogëlua edhe lindshmëria. Për ato popullsi që po përjetonin këtë tranzicion, ndryshimi në nivelet e lindshmërisë dhe vdekshmërisë rezultuan në një periudhë me një rritje të madhe të popullsisë. Faza e fundit ishte më pak e specifikuar, por përgjithësisht konsiderohej të ishte pak a shumë një popullsi e qëndrueshme me një lindshmëri afër nivelit të zëvendësimit.

Me kalimin e kohës u plotësua dhe u integrua ideja e tranzicionit demografik me katër faza të njëpasnjëshme, në varësi të autorëve, në ndryshimin institucional, kulturor, ekonomik dhe social-strukturor (De Bruijn 1999, Kirk 1996, Van de Kaa 1996). Për disa, parimi fitoi statusin e një teorie të zhvilluar plotësisht, për disa të tjerë ishte thjesht një përgjithësim empirik që kërkonte konkretizim me rrethanat specifike (Greenhalgh 1996, Szreter 1993). Megjithëse nuk ka qenë e mundur të identifikoheshin treguesit kryesorë për parashikimin e fillimit dhe shpejtësinë e rënies së lindshmërisë (Coale dhe Watkins 1986), propozimet kryesore të “teorisë” së tranzicionit demografik qëndrojnë ende: (a) rënia e vdekshmërisë e paraprin në mënyrë të paevitueshme rënien e lindshmërisë; (b) rënia e lindshmërisë pason në mënyrë të pashmangshme rënien e vdekshmërisë; (c) ky proces është i pakthyeshem; dhe (d) procesi është i pashmangshëm për shoqëritë që po kalojnë në modernizim. Në këtë kuptim, ideja e tranzicionit demografik ka të ngjarë të jetë “ligji” më i fuqishëm në shkencat sociale. Sot nuk ka mbetur asnjë vend që të mos ketë hedhur hapat e parë në rrugën e tranzicionit demografik. Deri tani vendet më të zhvilluara kanë kaluar të paktën në fazën e rënies së lindshmërisë dhe të gjitha vendet e zhvilluara e kanë përfunduar tranzicionin. Shqipëria ishte vendi i fundit Evropian që hyri në fazën e fundit të tranzicionit. Në kohën e Censurit të Popullsisë dhe banesave 2001, vdekshmëria ishte e ulët, treguar nga jetëgjatësia e lartë në lindje, madje e lartë në mënyrë të dyshimtë: 72,1 vjeç për meshkuj dhe 78,6 për femrat (INSTAT 1994). Në të njëjtën kohë, lindshmëria ishte akoma më e larta në Evropë, por me Indeks Sintetik të Fekonditetit (ISF) në zbritje, nga 6 në vitet 1960 në 2,31 – që po i afrohej nivelit të zëvendësimit. Studimi Shëndetësor dhe Demografik i Shqipërisë 2008-09 e vlerësoi ISF-në në 1,6 (INSTAT 2010), gjë e cila është zyrtarizimi i faktit se Shqipëria e përfundoi tranzicionin e saj demografik. Modeli i tranzicionit demografik i ka shërbyer demografëve dhe politikëbërësve për një kohë të gjatë. Popullsitë kaluan përtej asaj që kishte supozuar teoria klasike e tranzicionit demografik, me rënien e lindshmërisë më pak se dhe nganjëherë shumë më pak se dy fëmijë mesatarisht. Në të njëjtën kohë, u shfaqën modele të reja demografike në fushën e jetëgjatësisë, martesës, lindjes së fëmijëve dhe migrimit, por nuk

kishte asnjë model të ri në gjendje të jepte një “pse” gjithëpërfshirëse për këto zhvillime ose një kuptim se çfarë do të sillte e ardhmja demografike (Vallin 2002).

Koncepti i Tranzicionit të Dytë Demografik (TDD) ka iniciuar një axhendë kërkimesh tërësisht të re në demografi dhe evidentimi i tij ka ri titulluar tranzicionin fillestar si Tranzicioni i Parë Demografik. Pika e fillimit të TDD-së përkon me futjen në lojë të forcave të reja, të cilat bëjnë dallimin e ndryshimeve demografike të tranzicionit të parë nga i dyti. Sipas autorëve Lesthaeghe dhe Van de Kaa, shfaqja e shoqërive të pasura shkaktoi një zhvendosje të vëmendjes nga nevojat materiale tek ato jo-materiale. Në teorinë Maslowiane (Maslow 1980), nevojat e një rendi më të lartë të tilla si liria e shprehjes, pjesëmarrja dhe emancipimi, vetë-realizimi, autonomia dhe njohja dolën më tepër në krye të vëmendjes së njerëzve gjatë vendimeve të rëndësishme për jetën, për shkak se nevojat material të një rendi më të ulët ishin tashmë të plotësuara. Origjina intelektuale e TDD-së shtrihet më tej tek dallimi i ngjashëm i Ingelhartit ndërmjet orientimeve materialiste dhe post-materialiste (Inglehart 1977, 1990).

3. MATERIALI, METODA BURIMI I TË DHËNAVE

Të dhënat nga Censuset e Popullsisë Shqiptare për vitet janë burimi kryesor i përdorur për të përshkruar karakteristikat demografike dhe të tregut të punës në këtë studim. Të dhënat e Censurit ofrojnë një burim gjithëpërfshirës informacioni në kuptimin që është mbuluar çdo familje dhe çdo banesë kolektive në Shqipëri. Burimi tjetër i të dhënave të përdorura në këtë studim është Anketa Shqiptare e Forcave të Punës. Ajo është një prej anketave më të mëdha që kryhet pranë familjeve në Shqipëri. duke përdorur koncepte dhe përkufizime të miratuara ndërkombëtarisht, të anketuarit e moshës 15 vjeç e lart pyeten rreth karakteristikave të tyre individuale. Metoda e mbledhjes së të dhënave në të dyja burimet përfshin intervistat ballë për ballë, ku mundësohen intervista ku një anëtar në moshë madhore i familjes mund të përgjigjet në emër të anëtarëve të tjerë të familjes. Pyetësi i Censurit është shumëqëllimësh pasi përfshin module të ndryshme që synojnë mbledhjen e informacionit mbi karakteristikat hapësinore, demografike dhe social-ekonomike të popullsisë. Si rrjedhojë, moduli i tij mbi statusin ekonomik ka një numër të kufizuar pyetjesh të lidhura me tregun e punës në krahasim me AFP-në. Anketa e forcave të punës në fakt ka një pyetësor më të gjatë që fokusohet specifikisht në një gamë të gjerë gjetjesh mbi tregun e punës dhe është më i pasur në tipin e informacionit të mbledhur.


Në pyetësin e AFP-së, pyetja e parë që identifikon personat të cilët kanë kryer ndonjë punë gjatë javës referuese, ka pesë kategori përgjigjeje. pyetja korresponduese në Censurin e vitit 2011 ka vetëm katër kategori përgjigjesh. kategoria e përgjigjeve që mungon në pyetësin e Censurit të vitit 2011 lidhet me fermerët që prodhojnë vetëm për vetë-konsum. Në fakt, vlera absolute e punësimit total është shumë më e lartë në AFP sesa në Censurin e vitit 2011; kjo mospërputhje ndodh kryesisht për shkak të raportimit të pamjaftueshëm të dy fenomeneve në Census: prodhimi për vetë-konsum në bujqësi dhe punësimi informal në sektorë të tjerë. Për realizimin e studimit janë përdorur metodat statistikore si regresioni, mesataret, metodat grafike, analiza e serive kohore, induksioni dhe deduksioni.

4. SHPËRNDARJA MOSHORE E POPULLSISË


Procesi i vazhdueshëm i emigrimit në shkallë të gjerë dhe rënia e lindshmërisë dhe vdekshmërisë patën një ndikim shumë të madh në strukturën e popullsisë në Shqipëri. Nëse shohim shpërndarjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë vihet re qartë tranzicioni nga një piramidë klasike e popullsisë në vitet 1979 dhe 1989 në një piramidë konstruktive në vitin 2011. Megjithatë deri në vitin 1989 shpërndarja moshore u karakterizua nga grup moshë që vazhdimisht u zvogëluan me kalimin e kohës, në vitin 2011 një boshllëk i dukshëm shihet për popullsinë e të rinjve dhe moshave të mesme për shkak të emigrimi selektiv sipas moshës.

Krahas kësaj, vihet re një rënie e theksuar e numrit të popullsisë për grup moshat e reja, por edhe më i dukshëm është ky zvogëlim tek brezat e popullsisë nën 55 vjeç për shkak të rënies së lindshmërisë, nga një ISF prej më shumë se 3 (Gjonça, Aassve dhe Mencarini 2008) në më pak se 1,7 në vitin 2011 si dhe nga emigrimi selektiv sipas moshës, të popullsisë në moshë riprodhimi. Nga ana tjetër, brezat më të vjetër janë rritur dukshëm.

Grafiku nr.1:a,b,c,d. Popullsia sipas grup moshave në vitet 1979, 1989, 2001, 2011.



Grafiku nr. 2. Popullsia sipas grup moshave dhe gjinisë në vitet 1989 dhe 2011 (në mijë).



Autorë të ndryshëm kanë arritur në përfundimin se Shqipëria ka një jetëgjatësi më të lartë sesa pritet në bazë të standardit të saj të përgjithshëm të jetesës. Për shembull INSTAT (2004), në vlerësimin e kushteve të jetesës dhe varfërisë arrin në përfundimin se: “Shqiptarët, të njohur për jetëgjatësinë e tyre të lartë me një ‘kosto shumë të ulët’ vazhdojnë të kenë shëndet të mirë edhe pas rënies së Komunizmit. Jetëgjatësia është rritur dhe ata raportojnë një shëndet të mirë në përgjithësi”. Për të provuar një përfundim të tillë dhe për të parë sesa më e lartë mund të jetë jetëgjatësia në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera të ngjashme, u krye një test. Çdo vit UNDP nxjerr Raportin e Zhvillimit Njerëzor, në të cilin vendet klasifikohen sipas një indeksi të zhvillimit njerëzor të vlerësuar (HDI). Sipas HDI-së për vitin 2011, Shqipëria zuri vendin e 70-të në botë. Ky indeks bazohet në disa parametra, duke përfshirë jetëgjatësinë, vitet e shkollimit dhe të ardhurat kombëtare bruto (AKB) për frymë. Për përcaktimin e nivelit ‘normal’ të jetëgjatësisë në Shqipëri, së pari u përzgjodhën të gjitha vendet Evropiane, përveç Shqipërisë. Më pas, për këto vende vlerat e jetëgjatësisë, vitet e arsimimit dhe AKB u futën në programin statistikor SPSS dhe u krye një regresion linear, në të cilin jetëgjatësia ishte variabël i varur ndërsa vitet e arsimimit dhe AKB ishin variabla shpjegues. Modeli tregoi një fuqi vlerësuese të arsyeshme, me një koeficient përcaktimi (R^2) prej 0,456. Vlerat për Shqipërinë për vitet e shkollimit (10,4) dhe AKB për frymë (7.822 US\$), më pas u imputuan në modelin e regresionit. Në këtë mënyrë, numri i viteve që Shqiptarët pritet të jetojnë, duke ditur nivelin e të ardhurave kombëtare për frymë dhe vitet e arsimimit, u vlerësua të jetë 74,5 vjet. Me fjalë të tjera, jetëgjatësia në Shqipëri e vlerësuar në bazë të censurit dhe të dhënave statistikave vitale në fakt është më e lartë (2,5 vjet) sesa do të parashikohej në bazë të standardit të tyre të jetesës (dhe arsimimit). Sigurisht ky është një vlerësim i përafërt dhe është i debatueshëm, por tregon se në të vërtetë niveli aktual i vdekshmërisë në vend duket më i favorshëm sesa pritej. Është sugjeruar se Shqiptarët gëzojnë jetëgjatësi më të madhe sesa pritej, për shkak të dietës së tyre të shëndetshme mesdhetare, e cila ndër të tjera parandalon sëmundjet e zemrës. Në vitin 1997, Gjonça dhe Bobak i dedikuan një artikull në revistën shkencore The Lancet paradoksit shqiptar të jetëgjatësisë. Tabela nr.2 specifikon më tej ndryshimet në madhësinë e popullsisë në Shqipëri, në terma absolutë dhe relativë. Numri i personave në grup moshën 15-64 vjeç ka mbetur mjaft i qëndrueshëm gjatë dy periudhave të fundit ndërmjet censuseve, duke zbritur nga 1,96 milion në vitin 1989 në 1,90 në vitin 2011. Megjithatë, numri i fëmijëve nën moshën 15 vjeç ka pësuar rënie të madhe nga 1,05 milion në vitin 1989 në vetëm 579 mijë në vitin 2011. Nga ana tjetër, në një popullsi me rënie të përgjithshme, një rritje e konsiderueshme vërehet në

numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, nga 169 mijë në 318 mijë në të njëjtën periudhë. Këto ndryshime nënkuptojnë një transformim tërësor të shoqërisë në vetëm 22 vjet. Nga ana tjetër, këto ndryshime kanë implikime të mëdha për çështje të zhvillimit si p.sh. numri i shkollave dhe mësuesve që nevojiten, nevojat për pensione, kujdesi për të moshuarit dhe institucionet shëndetësore që përdoren nga ata dhe numri i personave që pritet të hyjnë në tregun e punës dhe në arsimin e lartë në të ardhmen e afërt. Në terma relative, rritja e numrit të personave të moshuar është edhe më domethënëse. Pjesa e popullsisë 65 vjeç e lart u rrit nga 5 në 11 përqind ndërmjet viteve 1989 dhe 2011. Pjesa e personave shumë të moshuar – persona të moshës 80 vjeç e lart – është akoma e vogël, por edhe kjo është rritur shpejt nga 0,9 përqind në vitin 1989 në 2,1 përqind në vitin 2011. Nga ana tjetër, përqindja e personave nën 15 vjeç në popullsinë gjithsej ka pësuar rënie në më pak se 21 përqind, nga 33 përqind në vitin 1989 dhe madje 37 përqind në vitin 1979. Ndryshimet relative në këto grupe të popullsisë përshkruajnë proceset përbërëse të një popullsie në plakje: nga njëra anë ‘plakja nga baza’, gjithnjë e më shumë me lindje vjetore më të pakta për shkak të lindshmërisë së reduktuar dhe emigrimit të grave në moshat riprodhuese dhe nga ana tjetër ‘plakja nga maja’ gjithnjë e më shumë me një popullsi më të moshuar si efekt i kombinuar i lindshmërisë së lartë në të kaluarën dhe rritjes së jetëgjatësisë (Eurostat 2012).

Tabela nr.1 Treguesit e popullsisë sipas grup moshave në vite.

Treguesit e shpërndarjes së popullsisë	1979			1989			2001			2011		
	MF	M	F	MF	M	F	MF	M	F	MF	M	F
Grupmoshat (në mijë)												
0-14	958,2	496,4	461,8	1.051,2	547,7	503,5	898,8	461,4	437,5	578,6	301,7	276,9
15-64	1.496,1	781,3	714,8	1.960,3	1.017,0	943,3	1.939,1	961,0	978,1	1.904,0	949,7	954,3
65+	136,1	59,7	76,5	168,8	73,0	95,8	231,4	108,1	123,3	317,6	151,7	165,9
Gjithsej	2.590,5	1.337,4	1.253,1	3.180,4	1.637,8	1.542,6	3.069,3	1.530,4	1.538,8	2.800,1	1.403,1	1.397,1
Grupmoshat (në përqindje)												
0-14	37,0	37,1	36,9	33,1	33,4	32,6	29,3	30,1	28,4	20,7	21,5	19,8
15-64	57,8	58,4	57,0	61,6	62,1	61,2	63,2	62,8	63,6	68,0	67,7	68,3
65+	5,3	4,5	6,1	5,3	4,5	6,2	7,5	7,1	8,0	11,3	10,8	11,9
Gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
Koeficientët e varësisë												
Koeficienti total i varësisë ^a	73,1	71,2	75,3	62,2	61,0	63,5	58,3	59,3	57,3	47,1	47,7	46,4
Koeficienti i varësisë së të rinjve ^b	64,0	63,5	64,6	53,6	53,9	53,4	46,4	48,0	44,7	30,4	31,8	29,0
Koeficienti i varësisë së të moshuarve ^c	9,1	7,6	10,7	8,6	7,2	10,2	11,9	11,2	12,6	16,7	16,0	17,4
Mosha												
Mediane	20	20	20	23	23	23	27,1	26,9	27,4	33,5	32,3	34,7
Mesatare	25,2	24,8	25,6	26,7	26,1	27,1	30,2	29,9	30,5	35,2	34,6	35,9
Raportet gjinore^d												
0-14	107			109			105			109		
15-64	109			108			98			100		
65+	78			76			88			91		
Gjithsej	107			106			99			100		

^a Koeficienti i përgjithshëm i varësisë është raporti i popullsisë 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë 15-64 vjeç, shprehur në përqindje.

^b Koeficienti i varësisë së të rinjve është raporti i popullsisë 0-14 vjeç kundrejt popullsisë 15-64 vjeç, shprehur në përqindje.

^c Koeficienti i varësisë së të moshuarve është raporti i popullsisë 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë 15-64 vjeç, shprehur në përqindje.

^d Raporti gjinor është numri meshkujve për 100 femra.

Burimi INSTAT 2015

Tabela tregon se pjesa e popullsisë në grup moshën 15-64 vjeç është rritur në mënyrë të qëndrueshme nga rreth 58 përqind në vitin 1979 në 68 përqind në vitin 2011. Kjo nënkupton se koeficienti i varësisë – raporti i numrit të personave në grup moshat 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart përkundrejt numrit të personave në grup moshën aktive 15-64 vjeç, shprehur në përqindje, ka zbritur në mënyrë të njëtrajtshme. Shqipëria, me koeficientin e saj të ulët të varësisë prej 47 përqind, ndodhet në mes të një dritareje mundësish ekonomike që përkon afërsisht me periudhën ndërmjet censuseve të viteve 2001 dhe në perspektivë 2021.

Kjo rezulton si rrjedhojë e një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive përkundrejt një numri të ulët popullsie të re dhe të moshuar (Bloom, Canning dhe Sevilla 2003). Prej vitit 2021 e në vazhdim, dritarja do të fillojë të mbyllet përsëri për shkak të rritjes

së vazhdueshme të popullsisë së moshuar dhe qëndrueshmërisë në numrin e fëmijëve (INSTAT, 2014). Nëse Shqipëria do të përfitojë plotësisht nga ky dividend demografik do të varet sesa e arsimuar, e aftë dhe e shëndetshme mjaftueshëm do të jetë fuqia punëtore dhe nëse politika të duhura social ekonomike do të vendosen për punësimin e këtyre njerëzve në punë produktive.

Në kontekstin e gjerë Evropian, Shqipëria pozicionohet në mes të vendeve të tjera, përsa i takon koeficientit të përgjithshëm të varësisë, që varion nga 38,9 për Sllovakinë në 54,5 për Francën Megjithatë, për shkak të fazës aktuale të zhvillimit të popullsisë, Shqipëria renditet e katërta me koeficientin më të madh të varësisë së të rinjve dhe e treta me koeficientin më të vogël të varësisë së të moshuarve. Përsa i takon moshës mediane renditet e dyta pas Turqisë me popullsi më të re.

Tabela nr.2: Dinamika e koeficienteve të varësisë të vendeve kryesore evropiane.

Vendi	Koeficientët e Varësisë			Moshë Medianë
	Gjithsej	Të rinjtë	Të moshuarit	
Shqipëria	47,1	30,4	16,7	33,5
Austria	47,7	21,7	26,0	42,0
Belgjika	51,7	25,8	26,0	40,9
Bullgaria	46,4	19,4	27,0	42,5
Danimarka	53,1	27,4	25,7	40,6
Estonia	47,9	22,7	25,2	39,7
Finlanda	51,6	25,0	26,5	42,1
Franca	54,5	28,6	25,9	40,0
Gjermania	51,5	20,3	31,2	44,6
Greqia	50,7	21,7	29,0	42,1
Hollanda	49,3	26,1	23,3	41,0
Hungaria	45,6	21,3	24,4	40,1
Irlanda	48,8	31,7	17,2	34,5
Maqedonia	41,2	24,6	16,5	36,1
Islanda	49,7	31,3	18,4	35,0
Italia	52,3	21,4	30,9	43,5
Kroacia	44,7	22,4	22,4	41,5
Letonia	48,3	21,1	27,2	41,4
Lihtenshtein	42,6	22,8	19,8	41,2
Lituania	48,7	22,1	26,6	41,1
Luksemburgu	45,9	25,7	20,3	39,0
Mali i Zi	46,9	28,3	18,6	36,5
Malta	44,5	22,1	22,4	39,5
Mbretëria e Bashkuar	51,8	26,5	25,3	39,7
Norvegjia	51,1	28,3	22,8	38,7
Polonia	40,2	21,3	18,9	38,0
Portugalia	51,4	22,6	28,9	41,9
Qipro	41,9	23,9	18,0	35,7
Republika Çeke	43,1	20,8	22,3	39,8
Rumania	42,9	21,6	21,3	38,6
Sllovakia	38,9	21,4	17,5	37,4
Sllovenia	44,3	20,5	23,9	41,7
Spanja	47,4	22,2	25,2	40,3
Suedia	54,0	25,6	28,4	40,8
Turqia	48,9	38,1	10,8	29,3
Zvicra	47,1	22,3	24,9	41,6

Burimi: për Shqipërinë, Censusi i Popullsisë dhe Banesave i vitit 2011; për vendet e tjera, databaza e Eurostat-it

5. KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË TREGUT TË PUNËS

Popullsia në moshë pune, popullsia e grup-moshës 15-64 vjeç, ishte rreth 1,9 milionë njerëz në vitin 2011, që përbën 68 përqind e popullsisë gjithsej. Në krahasim me vitin 2001, kjo përqindje ishte rritur me 5 pikë përqind, pothuajse në mënyrë të barabartë për femrat dhe meshkujt. Sikurse tregojnë raportet e ndryshme të varësisë që matin raportin e personave “jo-


produktivë” ndaj atyre “potencialisht produktivë”. Në vitin 2011 ishin 0,47 persona që i përkisnin popullsisë jo në moshë punë për çdo individ në moshë punë (raporti i përgjithshëm i varësisë). Ky raport ka pësuar ulje që prej vitit 2001 (nga 0,58 në 0,47), ku ulja është paksa më e lartë për zonat rurale sesa për ato urbane. Për sa i përket raporteve të varësisë së të rinjve dhe të moshuarve, mund të vërehet se ndërsa raporti i varësisë të të rinjve ka pësuar ulje (pak më shumë në zonat rurale të Shqipërisë), raporti i varësisë së të moshuarve është rritur në mënyrë të barabartë kudo.

Tabela nr.3: Popullsia në moshe punë Census 2001 dhe 2011


	2001			2011		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Numri në mijë	961	978	1.939	950	954	1.904
% ndaj popullsisë gjithsej	62,8	63,6	63,2	67,7	68,3	68,0
- Zonat urbane (%)	64,8	66,2	65,5	68,6	69,7	69,2
- Zonat rurale (%)	61,3	61,6	61,5	66,6	66,7	66,7

Burimi: Të dhënat e Censurit të vitit 2001 dhe 2011

Grafiku nr.3 : Shperndarja e popullsisë në moshë punë Censusi 2001, 2011.




Burimi: Të dhënat e Censurit të vitit 2001 dhe 2011




Burimi: Të dhënat e Censurit të vitit 2001 dhe 2011


Meshkuj, Zonat urbane




Femra, Zonat urbane



Meshkuj, Zonat rurale



Femra, Zonat rurale



Burimi: Të dhënat e Censurit të vitit 2001 dhe 2011

6. PUNËSIMI SIPAS DEGËVE TË AKTIVITETIT EKONOMIK

Ka një ulje të konsiderueshme në përqindjen që zë bujqësia, nga 50,6 përqind në 26,1 përqind gjatë periudhës 2001-2011 (ka shumë të ngjarë për shkak të nën raportimit të numrit të atyre që punojnë në bujqësi në vitin 2011), duke ndikuar përqindjen që zënë të gjitha aktivitetet e tjera ekonomike përkundrejt punësimit gjithsej. Një analizë më e hollësishme tregon se ndërsa industria ka pësuar një rritje me 11 përqind, ndërtimi pësoi një ulje prej 18 përqind në 2011 në krahasim me vitin 2001. Shërbimet gjithashtu pësuan një ulje prej 9,5 përqind gjatë të njëjtës periudhë në Shqipëri ndërkohë që ky sektor punëson numrin më të madh të njerëzve të moshës 15 vjeç e lart në vitin 2011 (rreth 50 përqind të të gjithë të punësuarve në Shqipëri). Për sa i përket ndryshimeve gjinore, duhet theksuar se meshkujt mbizotërojnë në të gjitha degët e ekonomisë.

Tabela nr.4: Struktura e punësimit sipas degëve kryesore të ekonomisë.

Dega e aktivitetit ekonomik	2001			2011		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Numra absolutë						
Bujqësia	315.156	211.821	526.977	118.570	58.175	176.745
Industria	48.367	25.426	73.793	48.789	32.766	81.555
Ndërtimi	52.179	16.482	68.661	54.478	2.234	56.712
Shërbimet	233.944	138.400	372.344	195.060	141.999	337.059
Të panjohur*				15.881	9.998	25.879
Gjithsej	649.646	392.129	1.041.775	432.778	245.172	677.950
Përqindja sipas kolonës						
Bujqësia	48,5	54,0	50,6	27,4	23,7	26,1
Industria	7,4	6,5	7,1	11,3	13,4	12,0
Ndërtimi	8,0	4,2	6,6	12,6	0,9	8,4
Shërbimet	36,0	35,3	35,7	45,1	57,9	49,7
Të panjohur*	-	-	-	3,7	4,1	3,8
Gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
Numri gjithsej i vëzhgimeve	649.646	392.129	1.041.775	432.778	245.172	677.950


Burimi: Të dhënat e Censurit të vitit 2001 dhe 2011

Shënim: Popullsia e moshës 15 vjeç e lart

* Të panjohur do të thotë që informacioni i dhënë nga personat e pyetur mungonte ose ishte i paqartë për t'u koduar.


Niveli i vetëpunësimit zakonisht konsiderohet si tregues i një sipërmarrjeje tepër të rëndësishme në një ekonomi të orientuar nga tregu. Sipas të dhënave të Censurit të vitit 2011, në Shqipëri punëdhënësit, d.m.th. personat e vetëpunësuar me të punësuar kundrejt një page, formojnë një pakicë të vogël, me një përqindje rreth 4,3 përqind në vitin 2011, ku shumica e tyre janë aktivë në shërbimet e tregut dhe industri. Nga ana tjetër, statusi në punësim sipas degëve të ekonomisë konfirmon gjithashtu aspektin informal të bujqësisë shqiptare, që bazohet pothuajse plotësisht në punëtorët e vetëpunësuar pa të punësuar kundrejt një page dhe anëtarët kontribuues në biznesin familjar. Meshkujt kanë më shumë mundësi të jenë të vetëpunësuar se sa femrat, ndërsa këto të fundit kanë më shumë gjasa të jenë të punësuar me pagë ose të kryejnë punë të papaguar brenda një biznesi familjar. Përqindja e meshkujve punëdhënës është të paktën dyfish më e lartë se sa përqindja e punëdhënëseve femra në vitin 2011.

Grafiku nr.4:Përqindja e të punësuarve sipas statusit në punësim në katër degët kryesore, në vitin 2011.



Burimi: Të dhënat e Censurit të vitit 2011


Grafiku nr.5: Shpërndarja e punësimit gjithsej sipas statusit në punësim dhe gjinisë, në vitin 2011.



Burimi: Të dhënat e Censurit 2011

Nëse merren në konsideratë vetëm të punësuarit me pagë nga viti 2007 deri në 2011, puna me kohë të plotë në Shqipëri zakonisht konsiston në rreth 46 orë në javë për të punësuarit me pagë me kohë të pjesshme, shifra korresponduese është relativisht e qëndrueshme gjatë të njëjtës periudhë kohe me rreth 24 orë. Të punësuarit me pagë meshkuj zakonisht punojnë më shumë orë në javë sesa ato femra (46 kundrejt 42 orëve në javë përkatësisht për meshkujt dhe femrat). Ndryshimi gjinor është më i dallueshëm në punët me kohë të plotë se sa në punët me kohë të pjesshme. Mesatarisht, të punësuarit me pagë meshkuj me kohë të plotë punojnë dy deri tre orë më shumë sesa ato femra dhe kjo mund të shpjegohet nga ndryshimet në modelet e punësimit sektoral për të dyja gjinitë.

Grafiku nr.6: Të punësuarit me kohë të plotë dhe të pjesshme ndër të punësuarit gjithsej, sipas sektorit kryesor në vitin 2011.



Burimi: Të dhënat e Anketës së Forcave të Punës 2011

Shënim: Popullsia e moshës 15 vjeç e lart

Tabela nr.5: Shkalla e papunësisë sipas grup-moshave dhe gjinisë, në vitin 2001 dhe 2011

Grup-moshat	2001			2011		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
15-24	35,5	41,6	27,1	52,9	52,1	54,3
25-34	32,6	28,7	38,2	31,5	31,4	31,7
35-44	16,6	6,6	32,3	24,2	22,4	26,8
45-54	8,9	2,2	17,4	22,1	19,8	25,8
55-64	2,9	1,6	7,7	20,7	20,2	22,2
Gjithsej	22,7	18,8	28,4	29,3	28,0	31,4

Burimi: Të dhënat e Censurit të vitit 2001 dhe 2011

Tabela nr.6: Krahësimi i statusit të aktivitetit dhe treguesve kryesorë të forcave të punës sipas AFP dhe Censurit 2011.

Statusi i aktivitetit	Censuri i Popullsisë 2011	AFP 2011 (Trem. 3)
Popullsia e moshës 15 vjeç e lart	2.221.572	2.235.883
Forca e punës	958.255	1.349.024
• Të punësuar	677.950	1.160.477
- Bujqësi	176.745	526.412
- Industri	138.267	218.730
- Shërbime	337.059	414.539
- Të panjohur*	25.879	796
• Të papunë	280.305	188.547
• Jo-aktivë	1.263.317	886.859
Treguesit e forcave të punës	Censuri i Popullsisë 2011	AFP 2011 (Trem. 3)
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës (%)	43,1	60,3
Shkalla e punësimit (%)	30,5	51,9
Shkalla e papunësisë (%)	29,3	14,0

* Të panjohur do të thotë që informacioni i dhënë nga personat e pyetur mungonte ose ishte i paqartë për t'u koduar.

Analiza e hollësishme e përgjigjeve të anketës ndaj pyetësorëve përcakton dy faktorët kryesorë që shpjegojnë ndryshimin në shifra: punësimi në bujqësi (176.745 në Censusin e popullsisë dhe 526.412 në anketën e forcave të punës) dhe punësimi informal në industri dhe shërbime, mbuluar më gjerësisht në anketën e forcave të punës sesa në Censusin e popullsisë. Ndërsa shqyrtojmë dy rreshtat e tjerë të tabelës mund të vërehet se numri i personave të papunë (280.305) dhe numri i personave jo-aktivë (1.263.317) i llogaritur nga Censusi i popullsisë janë më të lartë sesa shifrat korresponduese nga anketa e forcave të punës (përkatesisht 188.547 dhe 886.859). Ndryshimet në këto variabla janë pikërisht imazhi i pasqyruar i ndryshimit të vërejtur më parë mbi shifrën totale të punësimit. Për shkak të kriterit prioritar të përfshirë në kuadrin e forcës së punës për matjen e punësimit dhe papunësisë (sipas të cilit punësimit i jepet prioritet ndaj papunësisë dhe papunësisë ndaj inaktivitetit), personat që nuk klasifikohen si të punësuar ishin klasifikuar si të papunë ose jo-aktivë në Censusin e popullsisë, në varësi të aktivitetit të tyre të kërkimit të punës dhe disponueshmërisë aktuale për punë gjatë periudhave referuese korresponduese të Censurit të popullsisë. Tabela krahason gjithashtu tre treguesit kryesorë të forcave të punës. Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është përqindja e popullsisë nga mosha 15 vjeç e lart ndaj forcave të punës, e përcaktuar si shuma e numrit të të punësuarve dhe të papunëve. Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas Censurit të popullsisë ishte 43,1 përqind në tetor 2011 kundrejt 60,3 përqind sipas anketës së forcave të punës. Vlerat e ndryshme reflektojnë vlerësimet e ndryshme të punësimit dhe të papunësisë të rrjedhura nga dy burimet. Një ndryshim i ngjashëm vihet re për shkallën e punësimit që reflekton ndryshimin vetëm në të dhënat e punësimit. Së fundi, tabela tregon se shkalla e papunësisë e llogaritur mbi bazën e Censurit të popullsisë (29,3 përqind) është më shumë se dyfishi i shkallës së llogaritur nga anketa e forcave të punës (14,0 përqind). Ekzistojnë dy faktorë përbërës që shpjegojnë ndryshimin: (a) papunësia e matur në numëruesin e shkallës është më e lartë sipas Censurit të popullsisë krahasimisht me anketën e forcave të punës, dhe (b) në të njëjtën kohë, forca e punës në emërues është më e ulët për Censusin e popullsisë në krahasim me anketën e forcave të punës.

7. KONKLUSIONE

Censusi i Popullsisë dhe banesave 2011 tregoi se vendi ka kaluar ndryshime demografike të mëdha. Nga Censusi i mëparshëm ka humbur gati 9 përqind të popullsisë së tij dhe që nga censusi i vitit 1989, numri absolut i fëmijëve nën moshën 15 vjeç është reduktuar nga mbi një milion tek më pak se 580 mijë. Në të njëjtën kohë numri i personave të moshuar është më shumë se dyfishuar nga më pak se 170 mijë në rreth 318 mijë dhe moshë medianë e popullsisë është rritur nga 23 në më shumë se 33 vjeç. Përsa i takon lindshmërisë, censusi i vitit 2011 qartësisht tregon një rënie të shpejtë të vazhdueshme të niveleve të përgjithshme të riprodhimit. Aktualisht, me një ISF prej 1,67 Shqipëria nuk është më vendi me lindshmërinë më të lartë në Evropë. Këto janë tendenca që kanë impakt shumë të madh për kërkesën dhe ofertën e shërbimeve sipas moshave si p.sh. arsimimi, shëndeti dhe komponentë të tjerë. Siç mund të pritët këto tendenca do të vazhdojnë, balanca ndërmjet ofertës dhe kërkesës për shkollën, mësues, pensione, shtëpi për të moshuarit, institucione shëndetësore, personel mjekësor dhe shumë të tjera duhet të merret në konsideratë nga politikëbërësit. Në të njëjtën kohë, gjendja aktuale demografike e Shqipërisë nënkupton se ajo është në mes të një periudhe të mundësive ekonomike që mund të zgjasë vetëm rreth 10 vjet, për shkak të raportit ndërmjet grupeve të popullsisë në moshë punë dhe grupeve të varura nga to. Nëse vendi do të shfrytëzojë plotësisht këtë mundësi demografik do të varet nga shkalla e zbatimit të politikave efektive për të përgatitur mjaftueshëm forcën punëtore për tregun e punës dhe nëse aplikohen politika të përshtatshme social ekonomike për sigurimin e një punë produktive. Ndryshimi demografik dhe social ka ndikuar gjithashtu në madhësinë dhe përbërjen e njësive

ekonomike familjare. Pjesa e NjEF-ve me më shumë se një bërthamë familjare është përgjysmuar pothuajse që nga viti 1989 dhe madhësia mesatare e tyre është reduktuar nga 4,7 anëtarë në vitin 1989 në 3,9 vitin 2011. Ekzistojnë ndryshime të mëdha midis të dhënave të punësimit të Censurit të popullsisë dhe atyre që rezultojnë nga anketa e forcave të punës. Ndryshimi midis vlerës së punësimit total nga Censuri i popullsisë dhe vlerës korresponduese nga anketa e forcave të punës ndodh për shkak të dy faktorëve kryesorë: prodhimi për vetë-konsum në bujqësi dhe punësimi informal në sektorë të tjerë të ekonomisë. Shifrat e ndryshme mbi punësimin total kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek vlerat e papunësisë totale. Si pasojë, shkalla e papunësisë e llogaritur nga Censuri i popullsisë është shumë më e lartë sesa shkalla e papunësisë e përfutur nga anketa e forcave të punës. Siç rezulton, matja e punësimit në bujqësi e kryer në Censurin e Popullsisë të Shqipërisë është tashmë më afër përkufizimit standard ndërkombëtar të punësimit të miratuar nga konferenca e 19-të ndërkombëtare e statistikienëve të punës (Gjeneve, tetor 2013). Përkufizimi i ri përjashton punën për prodhimin për përdorim personal të mallrave dhe shërbimeve nga objekti i punësimit.

8. REFERENCA

1. **Bloom, D.E., D. Canning and J. Sevilla 2003.** The demographic dividend: a new perspective on the economic consequences of population change. RAND Population Matters Program MR-1274, Santa Monica CA.
2. **Bruijn, B. de 1999.** Foundations of demographic theory. Choice, process, context. Thela Thesis, Amsterdam.
3. **Bruijn, B. de 2012.** Albania 2011 Population and Housing Census: first quality assessment. Draft mission report. July.
4. **Bruijn, B. de and J.J.Schoorl 2012.** Mission report 10-14 September 2012. INSTAT/ICON/CIRPS.
5. **Carletto, G., Davis, B., Stampini, M. and Zezza, A. 2006.** A country on the move: international migration in post-communist Albania. *International Migration Review*, 40(4): 767-85.
6. **Coale, A.J. and S.C. Watkins eds. 1986.** The decline of fertility in Europe. Princeton University Press, Princeton (N.J.)
7. **Eurostat 2012.** Population structure and ageing.
8. **Gjonca, A., A. Aassve and L. Mencarini 2008.** Albania: Trends and patterns, proximate determinants and policies of fertility change. *Demographic Research* 19(11): 261-292.
9. **Gjonca, A. and M. Bobak 1997.** Albanian paradox, another example of protective effect of Mediterranean lifestyle? *The Lancet* 350 (20/27).
10. **INSTAT Shqipëria Popullsia dhe dinamikat e saj Maj 2014.**
11. **Lesthaeghe, R. 2010.** The Unfolding Story of the Second Demographic Transition. *Population and Development Review* 36(2): 211-251.
12. **Lesthaeghe, R. and D.J. Van de Kaa 1986.** [Two demographic transitions?]. In: Van de Kaa, D.J. and Lesthaeghe, R. (eds.): *bevolking: groei en krimp [Population: waxing and waning]*. Van Loghum Slaterus, Deventer, The Netherlands, pp. 9-24.
13. **Lesthaeghe, R., L. Nèidert and J. Surkyn 2007.** Household Formation and the "Second Demographic Transition" in Europe and the US: Insights from Middle Range Models.
14. **Greenhalgh, S. (ed.) 1995.** Situating fertility. *Anthropology and demographic inquiry*. Cambridge University Press, Cambridge.
15. **Inglehart, R. 1977.** The silent revolution. Princeton University Press, Princeton (N.J.).
16. **Inglehart, R. 1990.** Culture shift in advanced industrial society. Princeton University Press, Princeton (N.J.).
17. **INSTAT 2010.** Albania Demographic and Health Survey 2008-09. INSTAT, Tirana.

18. **Kirk, D. 1996.** Demographic transition theory. *Population Studies*, 50(2): 361-387.
19. **Maslow, A.H. 1970.** *Motivation and personality* (second edition). Harper and Row, New York.
20. **Thompson, W. S. 1929.** Population. *American journal of Sociology*, 34(6): 959-975.
21. **Vallin, J. 2002.** The end of the demographic transition: relief or concern? *Population and Development Review*, 28(1): 105-120.
22. **Van de Kaa, D.j. 1987.** Europe's Second Demographic Transition. *Population bulletin*, 42(1), Population Reference bureau, Washington (D.C.).
23. **Vallin, j. 2002.** The end of the demographic transition: relief or concern? *Population and Development Review*, 28(1): 105-120.
24. **Van de Kaa, D.j. 1996.** Anchored narratives: the story and findings of half a century of research into the determinants of fertility. *Population Studies*, 50(2): 389-432.
25. **Van de Kaa, j. 2002.** The Idea of a Second Demographic Transition in Industrialized Countries Paper presented at the Sixth Welfare Policy Seminar of the National Institute of Population and Social Security, Tokyo, Japan, 29 January 2002.

**POTENCIALI PËR PRODHIMIN E BIOETANOLIT NGA PANXHAR SHEQERI NË
RAJONIN E KORÇËS
SUGAR BEET POTENTIAL FOR BIOETHANOL PRODUCTION IN REGION OF
KORÇA**

ILIR NIÇKO, ARBEN KAMBO, MIRA NASTO
Horticulture and & Agro Business Department
Agriculture Faculty
University "Fan.S.Noli" Korçë
ALBANIA
nicko_ilir@yahoo.com, kambo.arben@yahoo.com

ABSTRACT

This abstract summarizes the possibilities of using sugar beet as a source for bioethanol production. The net gain of energy for sugar beet is competitive to other temperate crops and the residues can be used for livestock feed. Sugar beet is an obvious choice in the quest for cost effective bioethanol production. Because of their high sugar content, sugar beets can double the ethanol production per hectare as compared to corn which reduces land area requirements. Factors that may have significant economic impact on the feasibility of utilizing sugar beets to produce ethanol include ethanol and gasolinë prices, price of inputs such as sugar beets and beet molasses, and corn and sugar prices. Studies show that ethanol price is the most important factor when considering the profitability of an investment in ethanol production. The price of sugar beet is a contractual price agreed between a sugar beet processor and a sugar beet farmer. Sugar beet prices depend on sugar prices. The price of sugar is fixed by the sugar producer according to market conditions and governmental agreements. The process of sugar-to-ethanol conversion is simpler than that of corn-to-ethanol conversion and hence requires less capital and energy resulting in lower production costs and greenhouse gas emissions.

Key- words: bioethanol, farmer, potential, price, sugar beet.

PËRMBLEDHJE

Kjo përmbledhje paraqet mundësitë e përdorimit të panxhar sheqerit si një burim për prodhimin bioetanolit. Fitimi neto i energjisë së panxhar sheqerit është konkurrues krahasuar me kulturat e tjera dhe mbetjet mund të përdoren si ushqim për kafshë. Panxhar sheqeri është një zgjedhje e qartë në kërkimin të një kosto efektive të prodhimit. Për shkak të përmbajtjes së lartë të sheqerit, panxhar sheqeri mund të dyfishojë prodhimin e etanolit për hektar në krahasim me kulturën e misrit duke reduktuar kërkesat e sipërfaqes së tokës. Faktorët që mund të kenë ndikim të rëndësishëm ekonomik në mundësinë e përdorimit të panxhar sheqerit të prodhuar etanol përfshijnë çmimet e etanolit dhe benzinës, çmimi i inputeve të tilla si panxhar sheqeri dhe melasa e panxharit, çmimet misrit dhe sheqerit. Studimet tregojnë se çmimi i etanolit është faktori më i rëndësishëm kur merret parasysh rentabiliteti e një investimi në prodhimin e etanolit. Çmimi i panxhar sheqerit është një çmim kontraktuar i rënë dakord mes një operatori prodhues të bioetanolit dhe një fermeri kultivues të panxhar sheqerit. Çmimet e panxhar sheqerit varen gjithashtu nga çmimet e sheqerit. Çmimi i sheqerit është i fiksuar nga prodhuesi i sheqerit sipas kushteve të tregut dhe marrëveshjeve qeveritare. Procesi i konvertimit të sheqerit në etanol është me i thjeshtë se ajo e misrit në etanol dhe prandaj kërkon më pak kapital dhe energji. Rezulton me kosto më të ulët dhe emisionet e gazrave serre janë me të vogla.

Fjalët kyçe: bioetanol, fermer, potencial, çmim, panxhar sheqeri.

1. HYRJE

Automobilat modernë, të ndërtuara në vitet e para të shekullit të 20, ishin planifikuar për të ushqyer me etanol të marre nga drithërat. Ford promovoi përdorimin e këtij karburanti me bindje të tillë që nga 1938, duke ndërtuar një fabrike që prodhonte rreth 54,000 t /vit. Por interesi për bioetanolin ra pas Luftës së Dytë Botërore për shkak të disponueshmërisë të madhe të gazit natyror dhe naftës. Në fund të viteve të shtatëdhjetë, pas krizës së parë të naftës, kompanitë e ndryshme të naftës filluan të shesin një benzinë që përmban 10% bioetanol, i quajtur gasohol, duke përfituar nga zbritjet tatimore dhënë për bioetanolin. Kombinimi i luhatshmërisë në tregun e naftës dhe burimeve të fundme të naftës me efektet e ndryshimit të klimës globale nga shtimin e CO₂ në atmosferë si rezultat i djegies lëndëve djegëse fosile, ka rritur interesin në gjenerimin e energjisë së qëndrueshme nga biokarburantet e rinovueshme. Aktualisht 10% e kërkesës për energji primare është plotësuar me shfrytëzimin e biomasës. Disa nga biokarburantet përfitohen nga biomasa e papërpunuar, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e tyre përfitohen nga përpunimi i biomasës. Biokarburantet e përfituara nga përpunimi i biomasës ndahen në gjeneratën e parë ku si lende të pare përdoren fara, kokrra, ose sheqerna, të gjeneratës së dytë nga biomasa linjocelulozike dhe të gjeneratës së tretë nga alga dhe alga deti. Një nga qëllimet kryesore në zhvillim e biokarburanteve është ulja e gazrave serrë (GHG). Një tregues i rëndësishëm është matja e efektit të përgjithshëm GHG gjeneruar nga prodhimi i produktit (biokarburanteve), duke përfshirë të gjithë procesin nga nxjerrja e lëndëve të para deri në fund të përdorimit të tyre. Tjetër tregues është bilanci i energjisë fosile të zëvendësuar për njësi, ndryshimi në përdorimin e tokës, vlerësimi i integruar i mjedisit etj.

2. METODA E STUDIMIT


Për kryerjen e studimit janë mbledhur e analizuar të dhënat e serive kohore të prodhimtarisë së panxharit të sheqerit në rajon, rendimentet dhe sipërfaqes së mbjelle. Janë përdorur mesataret, paraqitja grafike, analiza e regresionit dhe analiza e serive kohore. Metoda e analizës dhe sintezës është përdorur për nxjerrjen konkluzioneve bazë. Disa supozime bazë kanë shërbyer për konkluzionet dhe rekomandimet. Studimi ka karakter përshkrues duke e vënë theksin në avantazhet e kultivimit dhe përpunimit të panxharit të sheqerit për prodhimin e bioetanolit. Mbetet i hapur diskutimi sidomos në lidhje me teknologjitë e përpunimit, madhësitë e fabrikës së përpunimit, vendodhjen nga pikëpamja e reduktimit të kostove dhe mbrojtjes së ambientit. Theksojmë se është e rëndësishme hartimi dhe zbatimi i politikave qeveritare për ngritjen, mbrojtjen dhe kontrollin e tregut të prodhimit të bioetanolit.

3. KARAKTERISTIKAT MERCOLOGJIKE


Bioetanolit karakterizohet nga një fuqi kalorifike e lartë 21MJ/L ose 2/3 e atyre që kanë benzina konvencionale. Një nga parametrat më të mirë të tij është fuqia kundër shpërthyes (numri i oktanëve 113) që e bën të përshtatshëm si ushqim të motorëve me kompensim më të madh. Bioetanolit lejon pakësimin e sasisë së përbërësve toksikë të përdorur zakonisht në benzinë për rritjen e numrit të oktanëve. Avullueshmëria më e lartë e bën përzierjen me ajrin më të shpejtë dhe më homogjen, dukë lejuar një djegie më të mirë, ndezjen në të ftohtë të motorit dhe përparësi të mëdha në përshpejtim. Për shkak të fuqisë kalorifike më të ulët përkundrejt benzinës janë të nevojshëm 1.6 kg bioetanol për të zëvendësuar 1 kg benzinë. Përveç kësaj, raporti më i ulët stekiomëtrik ajër karburant dhe vlera më e lartë e avullimit të etanolit kërkojnë ri kalibrim të karburatorit dhe një nxehje më të madhe të përzierjes ajër karburant. Bioetanolit është gërryes dhe higroskopik, prandaj është më e vështirë ta magazinosh dhe ta transportosh në krahasim me lëndët e tjera djegëse (Bordin 2007; Colonna 2006; Pignatelli 2006). Bioetanolit përdoret qoftë si karburant, kryesisht në Brazil, ashtu edhe si shtesë në benzen USA, BE, Indi etj. Bioetanolit mund të shtohet benzinës në përqindje të

ndryshme deri në 20% pa qenë nevoja të modifikohet motori, ndërsa duhen motorë të projektuar posaçërisht për përdorimin e biometanolit në një përqindje më të lartë si për shembull E85-a, një lëndë djegëse e përbërë nga 85% etanol dhe 15% lëndë djegëse me prejardhje fosile si benzinë ose E100 që tregon etanolin e pastër. Teknologjitë e sotme kanë mundësuar përhapjen e automjeteve me sistem të dyfishtë ushqimi me benzinë dhe E85. Etanoli mund të jetë përzier me diezelin, pa qenë nevoja të bëhen ndryshime në motor, megjithatë për shkak të mos përzierjes së alkoolit në diesel në një interval të gjerë temperature karburanti është i paqëndrueshëm dhe i duhet hedhur emulsifikues dhe solvent. Karakteristikat e bioetanolit i japin këtij biokarburanti një reagim përgjithësisht të keq se diezeli. Kjo ka të bëjë me faktin që ka një numër cetani të ndryshëm dhe një vlerë më të ulët të pikës së ndezjes. Bioetanoli tregon vështirësi në ndezje krahasuar me gazoilin. (Camaggio & Lagioia 2004) Në vlerësimin tonë analiza bëhet në këndvështrimin e përdorimit si përzierës me benzinën.

Grafiku nr.1:Konsumi i energjisë fosile në % sipas viteve në Shqipëri



Grafiku nr.2:Konsumi i energjisë se hidrokarbureve në bote në vitin 2012



Grafiku nr.3:Konsumi i energjisë se hidrokarbureve në disa shtete të Evropës në vitin 2012



4. AVANTAZHI I ETANOLIT TË PRODHUAR NGA PANXHAR SHEQERIT NË KRAHASIM ME KULTURAT E TJERA

Shndrimi i sukrozës në etanol është një proces që kërkon vetëm maja fermentimi ndërsa prodhimin e etanolit nga misri gruri ose kokrra të tjera drithi kërkon enzime për të kthyer niseshtenë në sheqerna. Megjithatë panxhar sheqeri ka më shumë vështirësi për të ruajtur se drithërat kokërr. Është llogaritur se sasia e etanolit të prodhuar është 100-120 litra për një ton peshë foragjere panxhar sheqeri përmes procesit të fermentimit. Etanoli ka një përmbajtje të energjisë prej 21.2MJ / l dhe një ton rrënje panxhar sheqeri siguron 2.44GJ energji duke supozuar prodhimin e 115l / ton të konvertuar në etanol. Llogaritet rendimenti 5060 l / ha në krahasim me 1960l / ha për misrin apo 952 l / ha për grurin duke përdorur një vlerësim global 46ton / ha panxhar, 4.9t / Ha misër, 2.8t / ha grurë. Studimet tregojnë se panxhar sheqeri është i përshtatshëm për prodhimin e biogazit falë fermentim e tyre të shpejtë Është llogaritur se sasia e biogazit të prodhuar prej 1 ha e panxhar sheqeri mund të sigurojë energji elektrike për një familje për 3 vjet. Megjithatë, biogazi që është prodhuar nga panxhari i sheqerit është për pjesën më të përdorur në ngrohje, dhe biogazi është gjithashtu një shtesë e vlefshme në sektorin e biokarburanteve. Në disa vende lëndë djegëse fosile është zëvendësuar gradualisht me biogazin. Disa studime parashikojnë se biogazi në Evropë mund të zëvendësojë 25 deri 35% e karburantit fosil të përdorur në automjetet në 2030.Duke Von Felde 2008 vlerësohet se metoda anaerobe e transformimit të panxharit për prodhimin e bio-metanit mund të prodhojë 137% më shumë energji se do të prodhojë fermentimin e panxhar sheqerit në etanol. Një tregues i rëndësishëm që duhet të merret në konsideratë për të vlerësuar përbalueshmërinë e biolëndëve djegëse është bilanci energjetik neto ose raporti midis përmbajtjes energjetike të karburantit final (output bioetanol) dhe inputeve energjetike të përdorura për të prodhuar. Për një kg bioetanol në fazën bujqësore nevojiten 5.6-11.1 MJ/kg; për transport nevojitet 1.01-1.5 MJ/kg dhe në fazën industriale nevojiten 15-18 MJ/kg. Kostoja energjetike e prodhimit të bioetanolit nga panxhari thith në përgjithësi 21-31MJ/kg (Amicarelli, Lagioia & Stifani 2007). Në përgjithësi përdorimi i bioetanolit nga panxhari i sheqerit përzierje të benzinës do të lejonte të ulej lëshimi i monoksidit të karbonit CO, pasi përmbajtja e madhe e oksigjenit në etanol lejon të përfitohet më lehtësisht një djegie e plotë. Një nga treguesit që përdoret për të gjykuar për leverdishmërinë e prodhimit të bioetanolit është kostoja energjetike duke marrë për bazë inputet energjetike për prodhimin e tij. Panxhari i sheqerit karakterizohet nga rendimente të larta, përmirëson cilësinë e tokës, ka ndikim të vogël në ambient krahasuar me kulturat e tjera energjetike, ka shumëllojshmëri destinacion përdorimi si sheqer, etanol, biogas, ushqim për kafshët etj. Si disavantazhe mund të përmendim kohën e shkurtër të ruajtjes për përpunim, ruajtje të komplikuar, kosto relativisht të lartë transporti etj.

Tabela nr.1 :Kostoja energjetike e prodhimit të bioetanolit nga panxhar sheqeri krahasuar me misrin.

Përshkrimi	Bioetanol nga misri MJ/kg	Në %	Bioetanol nga panxhari MJ/kg	Në %
Faza bujqësore	12.6 - 14	41	5.6 - 11.1	32
Transporti	0.38 - 0.4	1	1.0 - 1.5	5
Faza industriale	19	58	15 -18	63
Totali i kostos Energjetike	32.69	100	26.1	100

5. AVANTAZHET E ZONËS SË KORÇËS PËR KULTIVIMIN E PANXHAR SHEQERIT

Panxhari i sheqerit (*Beta Vulgaris*) është kultivuar në Rajonin e Korçës si bime industriale bujqësore. Rrënja (rizokarpi ose fryt rrënjori është prodhimi dhe qëllimi kryesor i kultivimit. Nga 100 kg rrënje janë nxjerre 13-16 e me shume kg sheqer,20-50 kg gjethe,4.5 kg melase,40-45 kg bërsi të njoma si ushqim për blegtorinë dhe se fundi e ashtuquajtura balta e panxharit e cila përmban mesatarisht36-40% CaCO_3 ;0.5%N;0.2-0.6% P_2O_5 ;0.6-0.9% K_2O e cila mund të përdoret për plehërimin e tokave.

Tek kultivarët për qëllime industriale janë mare dhe rendiment mbi 400kv/ha nga i cili janë nxjerre 52-64 kv sheqer,140 kv gjethe dhe 170kv bërsi të njoma. Në fushën e Korçës temperaturat mesatare nga Prill në Shtator është 17grade C^0 me mesataret prill qershor14 grade C^0 ; Korrik - Shtator 20 grade C^0 , pra të mjaftueshme dhe të përshtatshme në tërësi e në veçanti për rritjen dhe zhvillimin normal të bimës Në fushën e Korçës, sipas të dhënave shumëvjeçare, gjate vitit ka rreth 780 mm reshje, kurse gjate vegetacionit bien 295 mm shi ose e shprehur ndryshe 45-50% e nevojave, ndërsa gjate korrik gushtit vetëm 62mm. Kjo bën të nevojshme ujitjet sidomos nga fillimi i korrikut deri në mes të gushtit. Për çdo rrënje me peshe mesatare 500 g gjate periudhës vegetative nevojiten 45-50 litra ujë. Për një rendiment 400kv /ha nevojiten mesatarisht 6000m³ ujë. Prodhimi i panxharit të sheqerit në rajon në periudhën para viteve 1990 vlerësohej pas grurit dhe në ekonomi të veçanta me pataten. Si bime i gjithë prodhimi destinohej për prodhimin e sheqerit duke siguruar sasi të madhe të ardhurash për Kooperativat Bujqësore dhe Ndërmarrjet Bujqësore. Në dallim nga prodhimet e kulturave të tjera bujqësore i gjithë prodhimi transportohej nëpër qendra të caktuara pranë ekonomive bujqësore dhe të administruara nga Kombinati i Prodhimit të Sheqerit. Nga këto qendra prodhimi transportohej sipas një grafiku të studiuar për në Kombinatin e Prodhimit të Sheqerit. Kostoja e prodhimit të panxharit të sheqerit në qarkun e Korçës. Panxhar sheqeri u mboll në rajonin e Korçës në vitin 1950 në një sipërfaqe 1 mijë ha, sipërfaqen më të madhe e arriti në vitin 1980 me 10 mijë ha duke e shtrirë kultivimin dhe në rajonin e Elbasanit, ndërsa pas vitit 1990 sipërfaqja e mbjellë me këtë kulturë u kufizua ndjeshëm si rezultat i mbylljes dhe shkatërrimit të industrisë së përpunimit dhe prodhimit të sheqerit. Aktualisht sipërfaqja e mbjellë në vitin 2013 ishte 900 ha me një rendiment mesatar 339kv/ha kryesisht për ushqim për kafshët.


Tabela nr.2: Struktura e tokës në Qarkun e Korçës sipas rretheve.

Nr	Emërtimi	Tokë gjithsej (ha)	Tokë e punuar (ha)	Pyje (ha)	Livadhe dhe kullota (ha)	Të tjera (ha)
1	Qarku	366.024	86.108	132.075	53.732	94.109
2	Korça	172.478	44.207	54.900	23.604	49.767
3	Pogradec	71.541	17.506	27.330	5.364	21.341
4	Devoll	41.542	13.148	15.165	3.022	10.207
5	Kolonjë	80.463	11.247	34.680	21.742	12.794

Tabela nr.3 : Sipërfaqja e mbjelle sipas bimëve në vite në Qarkun Korçës.

Emërtimi	Sipërfaqja1990 (ha)	Sipërfaqja 2003 (ha)	Sipërfaqja 2010(ha)	Sipërfaqja 2013 (ha)
Grurë	19192	13470	15035	16317
Thekër	2.209	254	427	560
Misër	895	3931	4634	4087
Patate	1710	1583	2023	1911
Panxhar sheqeri	5544	1202	1011	900
Elb distik	2844	1179	2431	2444
Duhan	2439	136	401	66
Perime gjithsej	612	1.553	2550	2507
Fasule	2176	1.936	2110	2339
Tagjira dhe foragjere	13788	13.088	17874	17614
Jonxhë	4822	10.266	11238	11797


Grafiku nr.4:Dinamika e prodhimit të panxhar sheqerit në Shqipëri .




6. SUPOZIMET BAZË

- Ekzistojnë kushte shumë të mira klimatike dhe tokësore për kultivimin e kulturës.
- Kultivimi i saj të bëhet në blloqe me sipërfaqe minimalisht jo më të vogla se 2 Ha. Realizimi i këtij supozimi do të kërkonte angazhimin e pronarëve të tokave, qeverisë dhe sipërmarrësve që do të jenë të interesuar për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një fabrike për prodhimin e etanolit së bashku me të gjithë aksesoret ndihmës, mundësisht në vendin ku ekzistonte dhe funksiononte fabrika e prodhimit të sheqerit.
- Përdorimi i kontratave të qerasë afatgjatë, orientimi i mbjelljeve paraprakisht duke parapaguar fermerëve një pjesë ose gjithë koston e kultivimit të panxharit të sheqerit në këmbim të një marrëveshje për çmimin në varësi të përmbajtjes së sheqerit.
- Politika shtetërore për të nxitur shitblerjen e tokës duke lehtësuar kostot e transaksioneve dhe stimulimi i kontratave afatmesme dhe afatgjata.
- Një politikë stimuluese për çmimin e etanolit të prodhuar në vend nga qeveria duke stimuluar investitorët për sipërmarrjen e ndërtimit dhe shfrytëzimit të një fabrike prodhuese minimalisht me kapacitet 10GL për një vit në këtë rajon.
- Stimulimin në një të ardhme të afërt të mbjelljes dhe kultivimit të panxharit të sheqerit duke e futur në skemat mbështetëse të qeverisë për të dhe nga ekofondi që do të krijohet nga qeveria për stimulimin e politikave ambientaliste në të ardhmen. Kjo mbështetje të jetë e kushtëzuar me stimulimin e fermave me sipërfaqe kultivimi mbi 2 Ha.
- Në supozojmë një treg kërkese për bioetanol minimalisht për zëvendësimin e sasisë prej 10% të sasisë vjetore të benzinës që përdoret në transport në Shqipëri për zëvendësimin e një sasive benzinë 43884000 litra. Konsumi vjetor i benzinës në sektorin e transportit rezulton 438840000 litra. Sasia traqet për tu zëvendësuar 10% dhe e korrektuar me raportin 27:44 (fuqia kalorifike në MJ/kg bioetanol krahasuar me benzinën) (Pin&Vecheit 2008)
- Të imponohen forma të shtrëngimit tregtar si mbi biokarburantet ashtu dhe mbi lëndët e para të importit me qëllim mbajtjen nën tutelë të prodhimit të brendshëm.
- Njehsimet tona janë bazuar në një rendiment mesatar 40 ton/ha dhe përmbajtje sheqeri 15% si dhe duke marrë në konsideratë të ardhurat nga produktet dytësore të cilat përdoren si ushqim për kafshët.
- Kultivimi i kësaj sipërfaqe do të realizohet si rezultat i zvogëlimit kryesisht të sipërfaqes së mbjellë me grurë e cila rezulton një kulturë ekstensive nga pikëpamja e të ardhurave neto për HA rreth 350 EUR/HA (Llogaritjet për rendimentin mesatar 3.25 Ton/Ha Vjetari Statistikor Qarku Korçë 2013). Pakësimi i sipërfaqes së mbjellë me grurë nuk do të ketë impakte në qarkullimin bujqësor si dhe nuk do të ndikojë në tregun e grurit. Në kushtet kur tregu i tij është i hapur dhe rreth 40% të nevojave të tregut të brendshëm përballohet nga importi

Grafiku nr. 5 : E ardhura neto për 1 hektar sipas kulturave. Burimi: Llogaritje të autorëve.




Grafiku nr.6: Dinamika e sipërfaqes se mbjelle me grurë, panxhar sheqeri, patate Qarku Korçë.



Burimi: Vjetari statistikor Qarku Korçë

Grafiku nr.7: Dinamika e çmimit të grurit të importuar në Shqipëri



Burimi: International Trade Centre (<http://www.intracen.org/itc/market-info-tools/trade-statistics/>)

7. REZULTATE DHE DISKUTIME

Duke marrë në konsideratë të dhënat nga studimet e kryera në vlerësojmë që kostoja e bioetanolit 0.9 euro/litër ku 50% ose 0.45eur/litër është kostoja e panxharit të sheqerit.

Bioetanoli nga panxhari i sheqerit rezulton me një kosto prej 0.6-0.9 euro/l. Sipas parashikimeve të bëra nga BE për vitin 2020 parashikohet që sipërfaqja e panxharit të sheqerit e mbjellë për bioetanolin pritet të rritet 12 herë në krahasim me sipërfaqen e mbjellë në vitin 2006(Pignatelli 2008). Në raport me koston e bioetanolit kostoja e biomasës zë mesatarisht 30-40%, përqindje kjo që mund të arrijë në të ardhmen 51-60% të koston së përgjithshme me shtimin e vëllimit të prodhimit. Megjithatë kostot e biokarburanteve të brezit të dytë ndryshojnë sipas përmasave të impianteve, të aftësisë së konvertimit të biomasës në biolëndë djegëse, të çmimit të lëndëve të para dhe nevojës së kapitalit. Si rrjedhim, vlerësimet e kostove të tilla shpesh ndryshojnë në bazë të ndryshimit të vetë koston së lëndës së parë dhe tregimit të teknologjive të ardhshme të shndërrimit (Bradley, Cuypers & Pelkmans 2009).

Duke marrë parasysh që nga 1 ton mesatarisht do të rezultojë 115litra etanol në vlerësojmë që të ardhurat nga 1 ton panxhar sheqerit rezultojnë 51.75EUR/ ton. Të ardhurat për një hektar nga frut-rrënjorët e tregtuar rezultonte për një ha mesatarisht 2070 EUR. Duke supozuar një rendiment prej 40ton/ha sasia e gjetheve për një hektar 8ton. Të ardhurat nga to rezultojnë

400 euro/Ha. Gjithsej të ardhurat për një hektar 2470 EUR/HA. Mbetjet e tjera si kokat e prera nga makineria gjatë prerjes së gjetheve në nuk i marrim në konsideratë duke i vlerësuar si mbetje që mbeten në tokë për plehërim. Duke supozuar një rendiment bioetanoli 4600litra/ha për prodhimin e sasisë traget të bioetanolit nevojiten të mbillen 43884000 :4600=9540 HA sipërfaqe e kultivuar me panxhar sheqeri për çdo vit. Kultivimi i kësaj sipërfaqe do të realizohet si rezultat i zvogëlimit kryesisht të sipërfaqes së mbjellë me grurë e cila rezulton një kulturë ekstensive nga pikëpamja e të ardhurave neto për HA rreth 350 EUR/HA (Llogaritjet për rendimentin mesatar 3.25 Ton/Ha Vjetari Statistikor Qarku Korçë 2013). Pakësimi i sipërfaqes së mbjellë me grurë nuk do të ketë impakte në qarkullimin bujqësor si dhe nuk do të ndikojë në tregun e grurit për sa i përket çmimit të tregut të grurit në kushtet kur tregu i tij është i hapur dhe rreth 40% të nevojave të tregut të brendshëm përballohet nga importi. Nga analiza e të dhënave të tregut të importit të grurit rezulton se është konkurrues në krahasim me tregun e brendshëm si nga pikëpamja e çmimeve dhe cilësisë. Shtimi i sipërfaqes së kultivuar të panxharit do të ketë ndikim në rritjen e krerëve të blegtorisë kryesisht të gjedhëve për qumësht dhe për mish për të cilat rajoni ka mjaft resurse duke përfshirë këtu dhe njohurinë e traditën e trashëguara nga e kaluara. Në kemi marrë për bazë konkluzionet e studimeve të realizuara në lidhje me koston e kultivimit për një hektar duke ju referuar Studimit të kryer nga (Bram Hanse Dissertation to obtain The PHD degree Gottingen 2011) ku kostoja mesatare e kultivimit për teknologji dhe ferma mesatare kostoja e kultivimit rezultoi 21 euro/ton dhe kostoja e plotë mesatare e kultivimit rezulton për një rendiment mesatar 66 ton/ha 1345 EUR/HA.

Çmimi i panxhar sheqerit vendoset midis blerësit dhe prodhuesve bazuar në kushtet e tregut, përmbajtjes së sheqerit, marrëveshjeve qeveritare dhe ndikohen nga disa faktorë si rendimenti i frut-rrënjorit, përmbajtja e sheqerit, tregu i sheqerit etj.

Duke marrë në konsideratë një kosto 25 euro/Ton shpenzimet e kultivimit për një hektar me rendiment 40Ton/HA 1000 EUR/HA. Të ardhurat neto për një HA rezultojnë 1470 EUR/HA. Në këtë të ardhur neto nuk janë përfshirë të ardhurat nga subvencionet qeveritare. Si rezultat i kultivimit të panxharit të sheqerit me supozimin e pakësimit të sipërfaqes së mbjellë me grurë do të kemi një fitim neto shtesë për rajonin prej $(1470-350) \times 9540 \text{ HA} = 10684800 \text{ EUR}$ në vit.

8. INSTRUMENTAT EKONOMIKE DHE POLITIKAT NË MBËSHTETJE TË PRODHIMIT TË BIOETANOLIT

Instrumentet e mbështetjes më përgjithësisht të përdorura në zhvillimin e prodhimit të biokarburanteve kanë qenë përjashtimi nga tatimet, nga kontributet financiare dhe nga taksat doganore të importit. Ulja akcizave mbi biokarburantet, në raport me ato të aplikuarat për lëndët djegëse fosile, kredia tatimore përbëjnë instrumentet më të drejtpërdrejtë dhe më gjerësisht të përdorur për të mundësuar një ulje të efektshme të koston së biokarburanteve. Në USA jepet një kredi tatimore prej 0.09 EUR/L etanol që përdoret për përzierje. Edhe në BE prodhimi i biokarburanteve është i subvencionuar. Vënia e taksave mbi biokarburantet në raport me akcizat e zbatuara mbi lëndët djegëse fosile ndryshon midis vendeve të ndryshme anëtare. Italia ka zbatuar një regjim fiskal lehtësues për një kontingjent vjetor biodiezeli për periudhën 2005-2010 dhe ulje të taksës për etanolin.

Janë të parashikuara mbështetje dhe për lëndët e para të përdorura në prodhimin e biokarburanteve (Reforma e vitit 2003 e politikës së Përbashkët të BE). Megjithatë do të ishte më e pranueshme ulja e përgjithshme e emetimit të gazeve serrë nëpërmjet shtimit të taksës së karbonit me qëllim nxitjen e prodhimit dhe konsumit të biokarburanteve. Për të nxitur si konsumin e bioetanolit dhe biodiezelit është parashikuar dhe përzierja e detyrueshme në përqindje të caktuara me lëndët djegëse fosile. Për të respektuar direktivat e caktuara nga direktiva 2009/28/KE për të kënaqur 20% të kërkesës së përgjithshme për energji dhe 10% të kërkesës së karburanteve për transportin me burime energjetike të rinovueshme Sipas

Nomenklaturës së Kombinar të mallrave etanoli është komercializuar në kodet 220720;220710 pavarësisht destinacionit të përdorimit (prodhime pijesh; tretës; karburant apo të tjera produkte industrial), ndërsa etanoli i përzier me benzinën si lëndë djegëse është klasifikuar në kodin tarifor 3821. Sipas ligjit aktual për akcizat çdo litër alkool jo i denaturuar paguan akcizë 45000 lek/HL ndërsa etanoli si lëndë djegëse me përzierje me më pak se 70% përzierje me vajra nafte të kapitullit 27 paguan akcizë 37 lek/l, ndërsa taksa doganore në të dy rastet është 0. Nga një llogaritje e thjeshtë duke ju referuar çmimit të bursës 0.2eur/l bioetanol në kushtet e lëvrimit FOB si dhe shpenzimet e transportit 150EUR/Ton si dhe akcizës 0.27EUR/l kostoja e 1 litër bioetanol rezulton afërsisht 0.5 EUR/l. Që të mbrohet prodhimi i vendit në propozojmë rritjen e akcizës për bioetanolin deri në masën e barazimit me koston e prodhimit të bioetanolit nga panxhari i sheqerit. Po kështu taksa e karbonit dhe e qarkullimit (1.5 lek/l për benzinën dhe 3 lek/l për naftën dhe 7 lek/l e mbledhur nga importi karburantit për naftën dhe për benzinën të përdoren për krijimin e fondeve që mund të përdoren për subvencionin e kulturave që do të përdoren për prodhim bioetanolit.

9. KONKLUSIONE

Kultivimi dhe përdorimi i panxharit të sheqerit si biomasë për prodhimin e etanolit përbën një potencial të mirë në Rajonin e Korçës, megjithëse kultivimi i tij kërkon rezerva të mëdha ujore rreth 8 litra/ L etanoli, biomasa e panxharit të sheqerit për prodhimin e etanolit ka një rendiment të lartë për hektar dhe rendiment të mirë energjetik.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në kostot e furnizimit janë cilësia e biomasës, masa vëllimore që ka lidhje me koston e magazinimit, përmasat e impiantit të transformimit, kostot e furnizimit, prania e infrastrukturës së transportit dhe magazinimit etj.

Rritja e pjesës së energjisë nga burimet e rinovueshme në konsumin e përgjithshëm final nuk është i rëndësishëm vetëm për plotësimin e detyrave target sipas direktivave të BE-së, por do të shërbente dhe si një shtysë për një zhvillim të suksesshëm afatgjatë të zonës.

Efienca dhe përfitueshmëria e kultivimit dhe përdorimit të kësaj kulture për qëllime energjetike, do të kushtëzohej nga madhësia e sipërfaqeve të kultivimit, teknologjia, dhe pasjet, dhe politikat shtetërore mbështetëse ndaj fermave që do të merren me kultivimin e panxharit të sheqerit dhe politikat qeveritare në fushën e biokarburanteve dhe karburanteve fosile.

Sipërfaqja për prodhimin e panxharit të sheqerit në rajon do të sigurohet kryesisht nga zvogëlimi i sipërfaqes së mbjellë me grurë, ndërkohë që gruri përbën një kultura ekstensive nga pikëpamja e të ardhurave dhe nuk ka risk për rritjen e çmimit të këtij të fundit.

10. REFERENCA

1. **Balat, M., and H. Balat. 2009.** Recent trends in global production and utilization of bio-ethanol fuel. *Applied Energy* 86: 2273-2282.
2. **De Wit, M., M. Junginger, S. Lensnik, M. Londo and A. Fajj. 2010.** Competition between biofuel: Modelling technological learning and cost reduction over time. *Biomass and Bio energy* 34: 203-217.
3. **FAO. 2009.** Economic Data FAO Agribusiness Data 2009.
4. **Giovanni Lagioia, Ottilia De Marco, Vera Amicarelli, Antonella Sgaramella. 2007.** Material Flow Analysis of Sugar Beet Cultivation. *NEW MEDIT N. 3/2007.*
5. **Hanes, B., Schneider, J.H.M., Termorshuizen, A.J. and Varrelmann, M., 2011.** Pests and diseases contribute to sugar beet yield difference between top and averagely managed farms. *Crop Protection* 30, 671-678.
6. **Hanes, B., Ticino, F.G.J., Mußhoff, O. and Marylander, B., 2010.** Comparison of costs and yields of 'type top' and 'type average' growers in Dutch sugar beet growing. *Sugar Industry*. 135, 550-560.

- 7. Hanse Bram. 2011.** To obtain the Ph. D. degree in the Faculty of Agricultural Sciences, Georg-August-University Gottingen, Germany. Improvement of the competitiveness of the sugar beet crop in the Netherlands: Dissertation.
- 8. Hoffman. C.M. 2008** Bio energy from sugar beet physiological of yield formation. Proceedings of the International Center of beet Research 71st congress 14-15 Feb 2008, Brussels, Belgium pp 117-124.
- 9. Shapouri, H., M. Salassi and J.N.Fairbanks. 2006** The economic feasibility of ethanol production from sugar in USA. www.usda.gov/oce/reports/energy/
- 10. Sutton, M.D and J, B. Doran Peterson. 2001** Fermentation of sugar beet pulp for ethanol production using bioengineered. Journal of Sugar Beet Research 38: 19-34.

MOLLA NE KORÇË DHE MUNDËSITË PËR TREGTIMIN E SAJ KORÇA APPLES AND ITS TRADING OPPORTUNITIES

ADRIAN MAHO , ALKETA PASHOLLI

Departamenti i Hortikulturës, Fakulteti i Bujqësisë

Universiteti "F.S.Noli"

Korçë, SHQIPERI

e-mail: maho.adrian@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Qarku i Korçës zë vendin e parë në prodhimin e mollës. Rritja e prodhimit të mollës përveç anëve pozitive, ka nxjerre në pah problemin themelor të filierës së mollës, tregtimin e saj. Analiza e kryer kërkon të japë përgjigje problemeve të mëposhtme

Pamundësia e tregtimit të gjithë prodhimit (rreth 50,000 ton) në një kohë relativisht të shkurtër (Tetor-Nëntor)

Shitja e shpejte e produktit gjate sezonit të vjeljes zvogëlon ndjeshëm çmimin e tij dhe automatikisht fitimin e fermerit.

Mundësi e një fitimi më të mirë duke zgjatur periudhën e ekzistencës së prodhimit vendas në treg. Fitim më i mirë për fermerin ashtu dhe për grumbulluesin.

Plotësim të kërkesave të konsumatorit për molle vendi për një periudhë kohe më të madhe duke ndikuar në uljen e importit.

Studimi analizon në mënyrë të hollësishme kurbën e prodhimit të mollës në Qarku e Korçës dhe në gjithë vendin, konsumin e tregut vendas, kapacitete aktuale të ruajtjes, eksport importet, duke synuar të gjeje zgjidhjen më të shpejtë dhe efektive për këtë problem.

Fjalët çelës: *frigorifer, konsumator, mollë, prodhimtari, Qarku i Korçës, treg.*

ABSTRACT

Korça district occupies the first place for the production of apples in Albania. Increased production of apple apart from the positive aspects has raised the fundamental problem of apple trading. The conducted analysis seeks to provide answers to the following problems:

The impossibility of selling all production (about 50,000 tons) in a relatively short period of time (October-November).

A fast sale of the product during the harvest season significantly reduces its price and automatically the farmer's profits.

Possibility of a better profit by extending the period of local production in the market. This will lead to a better profit for the farmer and for the collector.

To satisfy the customer needs by providing local apples for a longer period of time and by reducing the imports.

The study analyzes in details all stages of apple production in Korça District and across the country, the domestic market consumption, the current capacity of storage, exports and imports, aiming to find the most effective solution for this problem.

Key words: *cool store, consumer, apple, productivity, Korça District, market*

HYRJE

Zhvillimi i Bujqësisë në Qarkun e Korçës përbën një prioritet

Kjo lidhet ngushtësisht:

Me numrin më të madh të banoreve dhe të punësuarve në fshat, me kontributin që jep në ekonominë rajonale, lendet e para për industrinë agroperpunuese, biznesit të farëra fidanëve dhe pesticideve, mundësitë dhe rezervat shumë të mëdha për rritje të mëtejshme.

Sektorët prioritarë të bujqësisë të rajonit të Korçës.

Pas diskutimeve të shumta me specialiste, institucioneve shkencore, fermerëve etj u hartua Strategjia e Zhvillimit të Bujqësisë të Rajonit të Korçës si dokumenti bazë për zhvillimin e bujqësisë së rajonit.

Mbi këtë bazë janë përcaktuar si prioritarë këta sektorë: pemëtari, blegtori, perime, agroturizem, agrobiznes.

Këto prioritete u përcaktuan mbi bazën e **analizës së treguesve ekonomike**. Në ekonominë e centralizuar të para viteve 90 të shekullit të kaluar treguesi bazë i vlerësimit në bujqësi ishte **prodhimtarinë për njësi të sipërfaqes**.

Treguesi bazë i marrë parasysh në kushtet e globalizimit, integritit të tregjeve, është e **ardhura neto për njësi të sipërfaqes**.

Tregues të tjerë që u morën parasysh janë konkurshmeria, largësia nga tregjet, fuqia punëtore, infrastruktura etj.

Karakteristikat e pemëtarisë në qarkun e Korçës

- 42,520 ferma bujqësore në total
- 16,365 ferma me pemëtari
- Mesatarja e madhësisë së fermës 1.4 ha, e parcelës 0.2 ha
- 2,145,041 rrënje molle gjithsej,
- 1,782,686 rrënje molle në prodhim
- Prodhimtaria në vit është 44,814 Ton molle

Tab 1 Zhvillimi i mollës në Qarkun e Korçës

Prodhimi i mollës në vend (Ton)	2008	2009	2010	2013
Prodhimi i mollës në qarkun e Korçës	19,500	23,750	30,634	44,814
Prodhimi i mollës në qarqet e tjera	13,000	13,600	23,970	28,915
Prodhimi total në shkallë vendi	32,500	37,350	54,604	73,729
Molle importi	17,439	15,006	14,060	8,237
Totali konsumi i mollës në shkallë vendi	49,939	52,356	68,664	70,212

Trendi i rritjes së prodhimit të mollës është rreth 3,500 ton në vit.

Konsumi vendas ka një trend shumë me të vogël rritje

Deri në vitin 2012 për shkak të raporteve prodhim konsum eksport, import nuk ka pasur probleme.

Ngritja e kapaciteteve frigoriferike nuk i përgjigjet rritjes së prodhimit

Sot në Korçë janë ngritur 45 frigoriferë me kapacitet rreth 11,000 ton

Leaving methodological issues aside, impact studies have brought forward three (potentially) positive effects of microfinance interventions. First, access to microfinance leads to an increased capacity to deal with risk because it provides access to savings or credit when emergency strikes. This may mean that farm households no longer have to sell productive assets Their income generating capacity in the longer term will, therefore, not be negatively affected. Second, microfinance can ensure that even in difficult circumstances farm families are able to maintaining an adequate diet and remain able to work (Pitt and Khandker, 1998). This is of major importance as wage labour is often the main source of income in low-income households. Third, increased opportunities to invest in productive enterprises have been the discussion on impact focuses almost entirely on the effects of the relationships between microfinance institution and clients over a period of several years.

4. CONCLUSIONS

This general overview of the main features of the rural environment leads to a number of conclusions regarding the supply of financial services in rural areas.

- Loans should be designed to fit the agricultural enterprises of a region both in terms of timing and the amount of finance required.
- Specific attention should be given to the covariant risks associated with the agricultural enterprises and to the fact that a large proportion of clients in a given area will have similar cash flows.
- The latter requires attention for liquidity management to avoid seasonal shortages or excesses. These three consequences are especially relevant in areas where agriculture is the dominant economic sector.
- The cost of transport and information are high in rural areas. This in combination with the small size of individual microfinance transactions leads to high transaction costs for microfinance institutions and their clients.
- Establishing microfinance institutions in rural areas means adding to the existing formal and informal institutions operating in the rural financial market. In order to become an accepted and respected partner, the microfinance institution must compete with the established institutions.
- This overview of the rural environment pinpoints the importance of public services in the health, education, infrastructure and law enforcement sectors.
- The policy environment in which rural markets operate is extremely important because public services and policies impact on the rural economy as a whole and therefore have a direct effect on the way in which financial arrangements are structured and operate.

- Most of rural households are still outside the reach of microfinance. This means that microfinance institutions need to find combinations of organisation structure, operations and financial products that comply sufficiently with the possibilities and priorities of rural households.
- Microfinance institutions have an obligation towards their clients to continue operations, especially in adverse circumstances.
- Stability is partly an internal matter and discussions along the lines of "What do we do if...." should result in provisions and scenarios capable of dealing with foreseeable shocks.

5. REFERENCES

1. Barton, Susana, 2004. PDA technology in microfinance ACCION's experiences implementing Porta Credit. In: *Developing micro banking: creating opportunities for the poor through innovation*. PT Bank BRI, Jakarta. pp. 309-322.
2. Donald, G. 1976. *Credit for small farmers in developing countries*. Westview Press, Colorado, 286 p.
3. Ledgerwood, Joanna, 1999. *Microfinance handbook: an institutional and financial perspective*. The World Bank, Washington D.C., 286p.
4. Moll, H.A.J., 1989. *Farmers and finance: experience with institutional savings and credit in West Java*. Wageningen Agricultural University, 135 p.
5. Moll, Henk A.J., 2005. Costs and benefits of livestock systems and the role of market and nonmarket relationships. *Agricultural Economics* 32: 181-193.
6. Moll, Henk A.J., 2006. Microfinance and rural development: a long term perspective. *Journal of Microfinance* 7 (2): 13-31.
7. Pitt M.M. and S.R. Khandker, 1998. The impact of group-based credit programs on poor households in Bangladesh: does the gender of the participants matter? *Journal of Political Economy* 106 (5): 958-996. Sartorius, K., J. Kirsten and M. Masuku. 2004. *Contract farming models and small farm vertical co-ordination partnerships in Southern Africa*. University of Pretoria and the Flemish Interuniversity Council.
8. Von Pischke, J. D., D.W. Adams, G. Donald, 1983. *Rural financial markets in developing countries: their use and abuse*. The Johns Hopkins University Press, Baltimore, 441 p. Von Pischke, J. D., 1991. *Finance at the frontier: debt capacity and the role of credit in the private economy*. EDI Development Studies, Bank, Washington D.C., 427 p.
9. Yaron, Jacob, 1992. *Assessing development finance institutions: a public interest analysis*. World Bank Discussion Paper 174. Washington D.C.

**PËRGJEGJËSIA SOCIALE E BIZNESEVE NË SEKTORIN E URIZMIT NË
RAJONIN E SARANDËS.
SOCIAL RESPONSIBILITY OF BUSINESSES IN THE TOURISM SECTOR IN THE
REGION OF SARANDA.**

VERONIKA KALLANXHI

Filiali i Sarandës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri

veronika.kallanxhi@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Turizmi është një sektor shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. Ai shfaqet si një komponent madhor për rritjen ekonomike dhe stimulues për zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri. Sektori i turizmit mund të zhvillohet edhe më tej përmes imazhit që krijon Shqipëria si një destinacion turistik. Ka mjaft biznese që operojnë në këtë fushë të cilat përdorin mekanizmin menaxherial të përgjegjësisë sociale në të gjitha dimensionet e mundshme. Pra roli që kanë bizneset që përdorin dhe praktikojnë përgjegjësinë sociale të tyre kundrejt shoqërisë, mjedisit dhe zhvillimit ekonomik është jetik në këtë sektor. Ky është edhe qëllimi kryesor i këtij artikulli. Pyetja se çfarë ndodh konkretisht në këtë sektor në jug të vendit, konkretisht në rajonin e Sarandës, kërkon përgjigje; Si e perceptojnë përgjegjësinë sociale bizneset e vogla apo të mesme që operojnë në fushën e turizmit si për shembull hotelet, restorantet, agjensitë turistike apo edhe bizneset që promovojnë kulturën, historinë dhe vlerat kulturore të vendit dhe të popullit tonë? Ky studim ka për qëllim që të hedh më shumë dritë në marrëdhënien që egziston në bizneset e sektorit të turizmit dhe mekanizmit të menaxhimit siç është përgjegjësia sociale e bizneseve për të patur një turizëm të vazhdueshëm të qëndrueshëm dhe në zhvillim.

Fjale kyç: *përgjegjësia sociale e bizneseve, zhvillim i qëndrueshëm, turizmi, agjensitë turistike, Saranda.*

ABSTRACT

Tourism is an important sector for economic development. He appears as a major component for stimulating economic growth and sustainable development in Albania. The tourism sector can be developed further through the image that creates Albania as a tourist destination. There are many businesses that operate in this field who use managerial mechanism of social responsibility in all possible dimensions. So the role that business that use and practice their social responsibility towards society, the environment and economic development is vital in this sector. This is the main purpose of this article. The question of what happens specifically in this sector in the south of the country, specifically in the region of Saranda, requires a response; How perceive social responsibility small or medium businesses that operates in the tourism sector such as hotels, restaurants, tourist agencies or businesses that promote culture, history and cultural values of the country and our people? This study aims to throw more light on the relationship that exists in the tourism sector businesses and management mechanism as the social responsibility of business, which want to have a sustainable tourism continuous and evolving.

Keywords: *business social responsibility, sustainable development, tourism, tourist agencies, Saranda..*

HYRJE

Turizmi është një nga industritë më të mëdha e më të fuqishme në botë, dhe si e tillë ka një impakt të madh në zhvillimin ekonomik e social të mjaft vendeve, sidomos të atyre në zhvillim ku shihet si një nga burimet më të rëndësishme të të ardhurave, të mundësive të punësimit, të diversifikimit të ekonomisë, të mbrojtjes së ambientit si dhe të promovimit të shkëmbimeve ndërkulturore. Turizmi është një nga sektorët ekonomikë me rritjen më të shpejtë në vendin tonë. Prirja që vihet re aktualisht për të ritur fitimin në periudhë afatshkurtër, pa konsideruar ndikimet afatgjata mbi mjedisin, përbën një nga shqetësimet kryesore për të ardhmen e pasurive kulturore dhe natyrore të vendit tonë. Turizmi mund të ketë një ndikim ekonomik pozitiv në bilancin e pagesave, për punësimin, në rritjen e të ardhurave bruto dhe prodhimit, por ajo mund të ketë dhe efekte negative, sidomos në mjedis.

Rëndësia e turizmit në planin ndërkombëtar

Turizmi është një prej industrive me zhvillim më të shpejtë në shekullin e 21-të për sa i përket kontributit global të PBB, të ardhurave nga shkëmbimi valutor dhe krijimit të vendeve të punës. Sipas Organizatës Botërore të Turizmit të Kombeve të Bashkuara, mbërritjet e turistëve ndërkombëtarë kanë treguar një rritje pothuajse të pandërprerë, dhe kjo ka ardhur nga viti në vit duke u ritur.

Rëndësia e turizmit për ekonominë dhe zhvillimin shoqëror të Shqipërisë

Turizmi është një nga degët kryesore të ekonomisë Shqiptarë e cila në produktin e përgjithshëm bruto GDP, kontribuon me 16.9% (INSTAT, 2013). Sipas llogaritjeve për Shqipërinë nga Këshilli Botëror për Turizmin dhe Udhëtimet (WTTC), kontributi i drejtpërdrejtë i turizmit për PBB për vitin 2013 ishte 68,1 miliardë Lekë, ose 4,8 % të tij ndërsa kontributi i përgjithshëm për ekonominë ishte 239,8 miliardë Lekë ose 16,7%. Përsa i përket hapjes së vendeve të reja të punës, sektori i turizmit ka hapur drejtpërdrejt 41.000 vende pune ose 4,3 % të numrit të përgjithshëm ndërsa në mënyrë të tërthortë ka hapur 146.500 vende pune ose 15,2% të tyre. Aktualisht Shqipëria paraqet mundësi të mëdha për të nxitur dhe zhvilluar të gjitha format e turizmit: turizëm bregdetar, turizëm kulturor, turizmin natyror, ekoturizmin, turizmin rural etj.

Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm është qëllimi kryesor i strategjisë kombëtare për këtë industri por kërkon edhe kujdes të veçantë për mbrojtjen e mjedisit. Me fjalë të tjera, turizmi i qëndrueshëm kërkon një përpjekje kolektive dhe të vetëdijshme për të gjitha bizneset e turizmit, qeveritarët apo vendim-marrësit, politikëbërësit dhe planifikuesit si dhe aktorët kryesorë (shoqëria, OJQ-të, dhe turistët), për të përcaktuar përparësitë mjedisore dhe sociale ku përgjegjësitë apo përgjegjshmëritë e aktorëve kryesor të kësaj industrie të jenë të larta dhe të qëndrueshme. Çështjet në ndërmarrjet e tyre të përditshme duhet të jenë sa etike aq edhe moralisht të pranueshme për shoqërinë, ku këtu përfshijmë edhe ata që u shërbejnë edhe atyre që u shërbehet një produkt apo një shërbim i prodhuar nga ky sektor.

Mbështetja e qeverisë ka qenë e pranishme si në aspektin legjislativ, institucional, organizativ ashtu edhe në mbështetjen financiare të operatorëve turistikë të përfshirë në aktivitetin e turizmit dhe të promovimit të Shqipërisë nëpër botë si një destinacion turistik, me gjithë nevojën e ridimensionimit të politikave dhe ndërhyrjeve të saj për rritjen e performancës.

Turizmi dhe përgjegjësia sociale

Turizmi është një industri shumë e fragmentuar sepse përbëhet në thelb nga shumë biznese të vogla dhe të mesme, dhe si pasojë termi përgjegjësia sociale e korporatave konsiderohet shumë pak i përshtatshëm pasi ajo kufizon përgjegjësinë vetëm për bizneset e mëdha, ndërkohë që sektori i turizmit në rajonin e Sarandes por jo vetëm përbëhet kryesisht nga biznese të vogla dhe të mesme dhe një përqindje shumë të vogël me biznese të mëdha. Në

turizëm, ky kufizim mund të jetë i gabuar për shkak se ndikimet mjedisore dhe sociale të turizmit janë në thelb akumulimi i ndikimeve nga të gjithë lojtarët e industrisë dhe për këtë arsye përqëndrohemi kryesisht tek përgjegjësitë sociale dhe mjedisore të të gjitha bizneseve të sektorit. Përgjegjësia Sociale e Korporatave, është një praktikë menaxheriale, përgjegjëse në menaxhimin e organizatës. Ndikimi i kësaj filozofie menaxheriale vërehet në impaktin që kanë vendimet e kompanisë mbi ambientin, shoqërinë dhe zhvillimin e vetë organizatës (Eccles, Ioannou, & Serafeim, 2011). Përgjegjësia sociale në kompani ka të bëjë me një detyrim, përtej kërkesave të ligjit. Është një angazhim që ndërmarrin kompanitë për tu sjellë në mënyrë etike, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe njëkohësisht duke përmirësuar cilësinë e jetës të punonjësve, të familjeve të tyre si dhe të komunitetit ku ata operojnë (Ioannou, & Serafeim, August, 2010). Përgjegjësia sociale ka të bëjë me mënyrën se si një kompani menaxhon procesin e saj ekonomik dhe prodhon një impakt pozitiv në shoqëri. Harold Johnson mendon se një firmë me përgjegjësi sociale është një udhëheqëse e cila balancon një shumëllojshmëri interesash. Në vend që të përqipet vetëm për fitimet e mëdha të saj, një ndërmarrje përgjegjëse gjithashtu merr në konsideratë punonjësit, furnitorët, tregtarët, komunitetin lokal dhe kombin (Harold Johnson, *Business in Contemporary Society: Framework and Issues*, 1971). Angazhimi dhe përfshirja sociale e bizneseve që operojnë në sektorin e turizmit është e dukshme dhe perceptohet drejtëpërdrejtë për faktin se ky sektor kryesisht ofron shërbime të cilat perceptohen më lehtë nga të gjithë aktorët e shoqërisë.

Ndikimet pozitive të përfshirjes së bizneseve në përgjegjësitë sociale

Përgjegjësia sociale e korporatave / kompanive është kontribut aktiv dhe vullnetar i korporatave / kompanive me qëllim përmirësimin e kushteve sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe po ashtu me qëllim përmirësimin e pozitës së tyre konkurruese. Kompania e cila ka përgjegjësi sociale ndërton besueshmërinë e saj, pasuron imazhin e kompanisë, e bën markën e saj më të fuqishme, kontribuon në përfitimin e ndjeshëm afatgjatë duke kontribuar edhe në :

- Performancë të përmirësuar financiare.
- Ngrin moralin, angazhimin dhe performancën e të punësuarve në kompani
- Zhvillon shkathtësitë e të punësuarve.
- E bën imazhin e kompanisë më të fuqishëm
- Tërheqë investitorë të rinj
- Rrit besueshmërinë dhe preferencën e klientit

Parimet e iniciativave të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave bazohen në dy shtylla:

1. Respekti për vlerat etike, njerëzit, komunitetin dhe mjedisin.
 2. Biznesi nuk është i ndarë nga pjesa tjetër e shoqërisë, ai është i ndërvarur nga shoqëria.
- Prandaj parim kryesor i rolit të kompanive përmes aktiviteteve të përgjegjësisë sociale të korporatave është ndërtimi i një shoqërie më të mirë. Përgjegjësia sociale e korporatave është një përkushtim i vazhdueshëm nga bizneset për sjellje etike dhe të kontribuojnë në zhvillimin e gjithanshëm ekonomik duke përmirësuar cilësinë e jetës së fuqisë punëtore si dhe komunitetit ku ata veprojnë. Koncepti i përgjegjësisë sociale është thuar se i ri në botën e biznesit. Ndërgjegjësimi rreth përgjegjësisë sociale të organizatave të biznesit po rritet shpejt dhe firmat po e pranojnë këtë koncept. Edhe sektori i turizmit nuk bën përjashtim. Bizneset që operojnë në sektorin e turizmit, qoftë të vogla apo të mesme po kuptojnë përgjegjësinë e tyre drejt shoqërisë dhe ambientit. Përgjegjësia sociale është: obligimi i një organizate për të maksimizuar impaktin e saj pozitiv dhe minimizuar impaktin e saj negative në shoqëri". Me fjalë të tjera, është "koncepti që bizneset në mënyrë aktive duhet të merren me mirëqenien e shoqërisë në tërësi". Përgjegjësia sociale mund të ndahet në 2 pjesë: përgjegjësia humane dhe përgjegjësia mjedisore. Përgjegjësia njerëzore i referohet përgjegjësisë së organizatës ndaj pjesëve të ndryshme që lidhen me atë që në gjuhën e biznesit njihen si "aktorët". Tek aktorët

përfshihen të punësuarit, aksionerët, qeveria, konsumatorët, investitorët, furnitorët, konkurentët dhe shoqëria në tërësi. Përgjegjësia mjedisore i referohet përgjegjësisë së organizatës në mbrojtjen e mjedisit.

Turizmi dhe ndikimet negative të saj, mjedisore dhe sociale

Përtej faktit që zhvillimi i turizmit ka efekte pozitive në buxhetin e shtetit dhe të sipërmarrësve të këtij sektori, zhvillimi i turizmit ka edhe shumë ndikime të tjera negative sociale por kryesisht mjedisore. Ndër këto ndikime mund të përmendim:

Ndikime në mjedis:

1. Humbje të habitateve turistike gjatë krijimit të komplekseve dhe zhvillimeve të zonave turistike.

2. Erozion të tokës dhe balotazh të ujit gjatë ndërtimit.

3. Kërkesa e rritur për furnizimin me ujë.

4. Kërkesa e rritur në furnizimin me energji elektrike.

5. Rritet barra për menaxhimin e mbeturinave të ngurta.

6. Ndotja e rrjetit të ujit.

7. Ndotja e ajrit nga mënyra të ndryshme të transportit.

8. Ndryshimi dhe ndotja e detit dhe të plazheve.

9. Ndotje akustike Rritje të zhurmave gjatë pikut turistik. Etj

Ndikime sociale:

1. Tranzicioni nga jetesë tradicionale në modernizim.

2. Konflikt vlerash ose përkeqësim të identitetit dhe të vlerave të sistemit vendor nga takimi i kulturave të ndryshme.

3. Humbja e ekonomive tradicionale në favor të ekonomisë së diversifikuar apo edhe të integruar të turizmit.

4. Zhvendosja e mundshme e popullatës lokale në favor të zhvillimit të turizmit.

5. Humbja e origjinalitetit të artit lokal dhe zejtarisë së komodifikimin.

6. Standardizimi i objekteve turistike.

7. Rritja e krimeve.

8. Pagat e ulëta në punë. Etj

Situata aktuale e produktit dhe shërbimit të sektorit të turizmit në Rajonin e Sarandës

Edhe pse industria e turizmit në Shqipëri është zhvilluar në një mënyrë të paplanifikuar, sektori privat i është përgjigjur në mënyrë spontane kërkesës së tregut duke iu përshtatur në një farë mënyre këtij tregu.

Turizmi bregdetar në Sarandë

Turizmi bregdetar në Sarandë ka qenë produkti kryesor dhe kufizohet me turizmin e detit dhe diellit, i cili është edhe qëllimi kryesor i vizitorëve për në destinacionet bregdetare. Turizmi bregdetar në Sarandë shfaqet me karakteristikat e mëposhtme:

Turizmi bregdetar kufizohet përgjithësisht vetëm tek pushimet “rërë, det dhe diell”.

Në zonën bregdetare nuk ofrohen ekskursione nga operatorët vendas, ka patur përpjekje vitet e fundit por këto përpjekje nuk kanë rezultuar positive.

Shumica e turistëve në destinacionet bregdetare janë nga Shqipëria, Kosova, dhe Maqedonia. Turistët e huaj që vijnë për turizmin e plazhit janë të pranishëm në numër të vogël të tillë si, skandinavet, polakët, italianët, austriakët, britanikët dhe gjermanët; kryesisht në Sarandë për një ofertë të kombinuar të plazhit me disa vizita në atraksionet kulturore rreth zones, pra alternojnë edhe turizmin kulturor me atë historic dhe arkeologjik.

Shpërndarja e turistëve në zonat bregdetare nuk është e njëtrajtshme;

Turizmi i plazhit në Sarandë ka një karakter të theksuar sezonal, duke filluar në qershor korrik, me numrin maksimal në gusht dhe me ulje të menjëhershme me 1 shtator.

Në Sarandë situata është disi më e mirë; për hotelet, sepse ka mjaft hotele që punojnë gjatë gjithë vitit. Në krahasim me qytete të tjera të hqipërisë në Sarandë sezoni veror zgjat rreth 5 muaj, kjo ndoshta se alternohet edhe turizmi kulturor dhe historik.

Duke qenë të varur nga turizmi i plazhit, shumica e hoteleve në zonën bregdetare përballen me vështirësi sezonale të funksionimit.

Turizmi kulturor

Edhe pse nuk është qëllimi kryesor i vizitës në Shqipëri, arkeologjia/trashëgimia/kultura identifikohen si pikat e forta kryesore të Shqipërisë në studime të ndryshme të kryera me vizitorë dhe industrinë e udhëtimeve nga tregjet e huaja. Turizmi kulturor në Shqipëri karakterizohet nga gjendja e mëposhtme:

- Vendet e Trashëgimisë Botërore si parku arkeologjik i Butrintit, Berati dhe Gjirokastra janë atraksione simbol, të ndjekura nga një varg atraksionesh historike dhe kulturore, si dhe monumentesh.

Oferta e akomodimit

Mungojnë të dhënat e sakta mbi hotelet e regjistruara dhe mbi kapacitetet e shtretëve. Sipas statistikave të grumbulluara për vitin 2013 nga Zyra e Shërbimit Turistik, kapaciteti i akomodimit në Shqipëri perbehet nga 27.716 shtretër në 670 hotele. Ndërkohë nga zyra e taksave dhe tarifave vendore të bashkisë së Sarandësnmri I hoteleve të rregjistruara është 97 të tilla. Ky kapacitet duket se nuk është i saktë, pasi ka shumë hotele apo apartamente të cilat nuk janë të rregjistruara pranë kësaj zyre dhe punojnë në informalitet të plotë.

Oferta e akomodimit në Sarandë karakterizohet nga panorama e mëposhtme:

Kapaciteti i hoteleve dominohet nga hotele të vegjel. Mbi 90 për qind e hoteleve të regjistruara kanë më pak se 20 dhoma dhe vetëm 2 për qind kanë më shumë se 40 dhoma. Ende është e paqartësuar kategorizimi I hoteleve me yje. Shumë pak prej hoteleve në Sarandë janë klasifikuar zyrtarisht me yje. Nuk ka asnjë hotel në Sarandëqëtë menaxhohen nga shoqëri ndërkombëtare.

Pjesa më e madhe e ofertës së produktit të akomodimit është shumë poshtë standardeve ndërkombëtare të funksionimit dhe ofron jo mjaftueshem cilësi të lartë krahasuar me standardet ndërkombëtare. Nga viti 2008 klasifikimi i strukturave të akomodimit nuk është më i detyrueshëm me ligj. Nje numer hotelesh kanë vendosur vetë standardin e klasifikimit me yje, sipas vlerësimit të tyre personal, dhe kjo në fakt nuk është aspak etike dhe morale kundrejt klientit I cili mund të mashtrohet lehtesisht. Që prej vitit 2010 një skemë e certifikimit të cilësisë bazuar në kujdesin për klientin, të quajtur "Authentic Albania" ("Shqipëria Autentike"), i është ofruar hoteleve për pjesmarrje mbi bazë vullnetare. Zbatimi i Projektit është mbështetur nga USAID, në bashkëpunim me ATA (Shoqata Shqiptare e Turizmit). Deri tani janë certifikuar 63 hotele në të gjithë territorin e Shqipërisë por shumë pak hotele që operojnë në qytetit e Sarandes janë bërë pjesë e projektit.

2. MATERIALI DHE METODA

Metodologjia për realizimin e këtij artikulli është bazuar në përdorimin e metodave të analizës, metoda e vrojtimit, metoda krahasuese etj. Burimet e informacionit dhe të dhënat janë siguruar nga burime të ndryshme nga literatura e fushës së turizmit dhe të përgjegjësive sociale të korporatave, nga Zyra e Statistikës Sarandë, Zyra e informacionit të turizmit Sarandë, INSTAT, Ministria e Turizmit, Bashkia Sarande, Banka e Shqipërisë, pyetësorët për operatorët turistikë në Shqipëri, si dhe informacione të publikuara nga agjenci ndërkombëtare për turizmin.etj, Gjithashtu si burime sekondare janë përdorur të dhëna të mara nga studime të mëparshme për rajonin turistik të Sarandës.

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Për realizimin e këtij studimi ishte e domosdoshme intervistimi i drejtëpërdrejtë i të gjithë administratoreve apo pronarëve të hoteleve si edhe atyre të agjensive turistike që operojnë në qytetin e Sarandës, si edhe plotesimi nga ana e tyre e pyetsorëve të përgatitur enkas për këtë studim. Numri i hoteleve që moren pjesë në këtë studim është 97; Numri i agjensive turistike është 10. Në studim ka hotele të vogla familjare me maksimumin 10 dhoma, ka edhe hotele të mesme me 20 dhoma ashtu sikurse ka edhe hotele të mëdha me mbi 20 dhoma. Nga ana tjetër ka hotele të cilat kanë edhe shërbimin e restoranteve apo edhe të bareve në shërbim aktiv për klientet e tyre, Pra ka një integrim të biznesit të tyre. Nga ana tjetër janë intervistuar edhe agjentët turistik për të parë nëse e njihnin dhe e zbatonin konceptin e përgjegjësisë sociale qoftë si një mënyrë për të ritur reputacionin e tyre në treg qoftë edhe si mënyrë për të ruajtur apo edhe për të zgjeruar aktivitetin e tyre si rezultat i kujdesit ndaj klientit apo edhe duke shpalosur kujdes ndaj të punësuarve duke i trajnuar.

Duke marrë parasysh karakteristikat e sektorit: sezonalitetin, kryesisht biznese familjare apo të vogla, niveli i arsimit të pronarëve, punonjësve, kohëzgjatja e biznesit në treg etj rezultojnë se vetëm 15 përqind e bizneseve të këtij sektori në rajonin e Sarandës e njihnin konceptin e përgjegjësisë sociale dhe vetëm 5 përqind e tyre e zbatonin atë në një nga drejtimet, sociale apo mjedisore. Shumë pak biznese hotelerie dhe restorantesh planifikonin trajnim të personelit por pothuajse të gjitha bizneset ishin besnik ndaj rimarrjes së personelit të njëjtë sezonin e ardhshëm, ndërkohë që tek agjentët turistik trajnimi ishte thelbësor për personelin. Kujdesi ndaj mjedisit si pjesë e përgjegjësisë sociale ishte aspekti më problematik në këtë sektor në Sarandë, dhe kishte një mungesë të lartë respekti ndaj mjedisit. Pjesa më e madhe e hoteleve gati 90 përqind kanë transformuar dhe ndryshuar ambientet përreth tyre duke dëmtuar mjedisin apo edhe plazhet apo edhe më keq detin në funksion të tyre por pa marr parasysh ndikimet negative në ekosistem apo në zinxhirin ushqimor.

Duke analizuar rezultatet e mësipërme arrijmë në përfundimin se ka shumë punë për tu bërë për të përmirësuar përgjegjësinë sociale të bizneseve në këtë sektor. Ajo që duhet theksuar është se brezi aktual ka një detyrim moral ndaj gjeneratave të ardhshme për të lënë burime të mjaftueshme sociale, mjedisore dhe ekonomike për brezat e ardhshëm që të gëzojnë nivele të larta të mirëqenies së paku aq e lartë sa e jona. Industria turistike jo vetëm që kontribuon me kërkesat e saj të mëdha në konsumin e shpejtë të burimeve natyrore si uji , energjisë, nafta , ushqime dhe lëndë të tjera të para deficietare , duke shumëfishuar numrin e popullsisë në destinationin turistik , por gjithashtu rrit presionin mbi ekosistem , detet , liqenet e lagunat , jetën e egër etj. Turizmi gjeneron ndotje , duke filluar që nga ndotja e ajrit që intensifikohet me shtimin e vrullshëm të transportit , rritja e nivelit të zhurmave , shtimi i sasive të mbetjeve të ngurta dhe ujrave urbane e duke përfunduar me ndotjen panoramike dhe estetike. Ndikime të tilla të pafavorshme në mjedis janë të shkaktuara nga mbikonsumimi i burimeve , ndotjes dhe mbeturinave të gjeneruara nga zhvillimi i infrastrukturës turistike dhe objekteve , transporti dhe aktivitetet e turizmit në vetvete. Disa prej këtyre ndikimeve janë, të pakthyeshme dhe të pasigurta ndërsa në shumë rrethana kostot sociale nuk janë të ngarkuar për turistët dhe nuk përfshijnë mallra që tregëtohen me çmime për njësi. Kjo është veçanërisht e vërtetë në lidhje me turizmin në bazë të mjedisit natyror si dhe historiko-kulturorë e atij të trashëgimisë

REKOMANDIME

5. Përmirësimi dhe Azhurnimi i legjislacionit për Turizmin në fokusin e përafrimit me rregulloren e Bashkimit Europian.
6. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Turizmin të shoqërohet me faturën përkatëse financiare.
7. Krijimi i strukturave dhe kapaciteteve të qëndrueshme për menaxhimin e sektorit të turizmit është e rëndësishme
8. Roli i Ministrisë së turizmit me ministri të tjera të jetë më i lartë për të patur një sinergji veprimesh dhe vendimarrjesh në funksion të përmirësimit të situatës e lënë kaq kohë vetëm në dorën e sipërmarrësve.
9. Mbështetje e strukturave vendase të kontrollit për të fuqizuar infrastruktura të qëndrueshme kontrolli, kompetente dhe të besueshme.
10. Përmirësimi i vazhdueshëm i metodave të përdorura nga këto biznese për të qënë më pranë klientit dhe mjedisit
11. Orientimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve për produktet e sektorit turistik duke aplikuar plane konkrete veprimi në mbrojtje të sektorit dhe në përmirësimin e tij.
12. Ndikimi i strukturave shtetërore të jetë më i pranishëm për të mos patur abuzime në mënyrën e bërjes së biznesit.
13. Zbatimi i ligjit dhe sanksionet duhet të jenë të pranishme për të mos patur dëmtime të rikuperueshme mbi mjedisin
14. Qeverisja vendore ka rol determinant dhe lipset të bashkëpunojë ngushtë me këtë sektor.

LITERATURA

1. Carrol to Ioannou, I., & Serafeim, G. (2010). *The Impact of Corporate Social Responsibility on Investment Recommendations*. Best Paper Proceedings, Academy of Management 2010 Social Issues in Management (SIM) Division): Harvard Business School.
2. Eccles, R. G., Ioannou, I., & Serafeim, G. (2011). *The Impact of a Corporate Culture of Sustainability on Corporate Behavior and Performance*. Harvard Business School.
3. Bashkia Sarandë. Raport i gjendjes aktuale të turizmit në Shqipëri, 2013.
4. Zyra e Statistikës Sarandë.
5. Zyra e informacionit të turizmit Sarandë.
6. INSTAT 2013, Sektori i Turizmit.
7. Strategjia sektoriale e Turizmit.
8. Ministria e Turizmit.
9. Banka e Shqipërisë.
10. Organizatës Botërore të Turizmit të Kombeve të Bashkuara.
11. Këshilli Botëror për Turizmin dhe Udhëtimet WTTC.
12. Eccles, Ioannou, & Serafeim, 2011.
13. Ioannou, & Serafeim, August, 2010.
14. Harold Johnson, *Business in Contemporary Society: Framework and Issues*, 1971.

ANALIZA EKONOMIKO – FINANCIARE E BIMEVE CEREALE NË QARKUN E KORÇËS

BLEZA TENEQEXHI, ILIR SOŠOLI, ALKETA PASHOLLI

Email: bleza1985@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Qarku i Korçës falë kushteve peto – klimaterike, konsiderohet një ndër më të rëndësishmit në kultivimin e bimëve cereale në shkallë vendi. Këto bimë, kultivohen në një sipërfaqe totale prej 23622Ha, me një rendiment mesatar prej 34,4kv/Ha. Vendin kryesor në këtë grup e kap bima e grurit me rreth 16059Ha dhe me një rendiment prej 34,7kv/Ha.

Materiali trajton vlerësimin ekonomik – financiar dhe vlerën kulturele të çdo specie cereale që kultivohet në qarkun e Korçës. Konstatohet që rendimentin më të lartë në këtë grup bimësh e zë misri me 40kv/Ha dhe specifikisht niveli më i lartë produktiv realizohet në rrethin e Korçës me 45,6kv/Ha. Jo pa interes për kultivuesit paraqitet dhe bima e thekrit, e cila në shkallë qarku mbillet në mbi 400Ha me një rendiment mesatar prej 23,6kv/Ha. Mikro – zona ku kultivohet kjo specie është specifike, ku bimët e tjera cereale apo jo cereale, nuk garantojnë rendimente të larta dhe të stabilizuara. Në lidhje me të ardhurat neto monetare, konstatohet se bima e misrit garanton vlerat më të larta kundrejt grurit dhe thekrit. Kështu prej një Ha me misër, fermeri përfiton mbi 92.000 lekë ose 7900 lekë më tepër se gruri dhe 29.400 lekë më tepër se thekri. Kostoja e prodhimit për 1kg grurë vlerësohet me 19 lekë, ajo e misrit me 29,4 lekë dhe e thekrit me 22,6 lekë. Por bimët cereale kanë edhe vlera të larta kulturele. Ato janë parabimë të vlefshme për kulturat e tjera bujqësore, veçanërisht gruri për bimët perimore, misri për drithërat dhe thekri për patatet dhe bishtajoret njëvjeçare.

Fjalët kyçe: bimë cereale, produktivitet, kosto prodhimi, fitim neto etj.

ABSTRACT

The district for the reason peto – climacteric, consider one of more important on the cultivation of the cereal plants in our country. These plants cultivate in the 23622 Ha, with the productivity for 34,4 kv/Ha. The first position in this group to get the plant of soft wheat with 16058Ha, resectivity with 34,7kv/Ha. The material treat the value economic – financial and the cultural value to each the species of cereal that cultivation in the dicrict of Korca. We notice that the hight productivity in this plants group to be up the plant of mals, with the productivity 40kv/Ha. The hight productivity there is in Korca region with 45,6kv/Ha with very interest for the feremers is the rye plants that in the range region cultivate over 400Ha, with the productivity for 23,6kv/Ha. The micro – region there cultivate that plants it is not suitable for the others plants, because in this region realized the loë level of productivity. In the connection of the money notice that maïs plant garante the hight value in money compare with the soft wheat and rye plants. From one ha with the maïs plant, the farmer gains 92.000 lekë, from the soft wheat plant 84500 lekë and from on ha with the rye the farmers goin 63.000 lekë.

Key words: the cereal plants, the productivity, the costo productivity, the profit.

HYRJE

Bimët cereale ku përfshihen: gruri, misri dhe thekri, falë plasticitetit të lartë ekologjik, përshtaten mjaft mirë në rajonet me klimë mesdhetare, paramalore. Elementet atmosferikë të kësaj klime si: temperaturat e ajrit, reshjet dhe ndriçimi diellor, ndikojnë pozitivisht jo vetëm tek produktiviteti, por edhe tek cilësia kimiko – teknologjike e kokrrave të këtyre lloj drithërave.

Qarku i Korçës, në përbërje të të cilit përfshihen rrethet: Korçë, Devoll, Pogradec dhe Kolonjë, historikisht është shquar për prodhime të larta dhe me mikro – rajone specifike me ndriçim më të fortë diellor edhe për cilësi të larta teknologjike të kokrrës.

Kuptohet që çdo lloj drithi ka specifikën e vet në produktivitet dhe cilësi kokrre.

Kështu, bima e misrit shquhet për nivele më të larta produktive se gruri dhe thekri.

Bima e grurit, në zonën fushore të Korçës, Devollit dhe Pogradecit jep mbi 55kv/ha, ndërsa thekri në rajonet malore të këtyre rretheve i kalon të 25kv/ha.

Në grupin e bimëve cereale, misri zë vendin e dytë pas grurit. Në shkallë botërore, misri është një prej bimëve më të rëndësishme për ushqimin direkt dhe indirekt të njeriut. Në vendet e zhvilluara, misri është specia e parë me 19,8% të përmbajtjes së energjisë. Misri konsiderohet sot si një kulturë me fund të dubluar “kokërr silazh”. Interesi i kësaj specie të kultivuar për silazh, shpjegohet me produktivitetin e lartë, me lehtësinë në konservim, me vlerat energjetike, të gjitha këto shoqërohen ose konvergojnë tek sasia e lartë e qumështit të prodhuar.

Duhet të citojmë se rreth 15% e prodhimit të misrit përdoret për industrinë amidonike dhe semolere. Gjithashtu prej embrionit të misrit prodhohet vaj cilësor dhe “corn flakes”.

Në zonat tropikale, misri është një bimë e gjallërishme, që konsumohet gjerësisht nga njeriu dhe në një të ardhme të afërt, niveli produktiv kokërr do të arrijë mbi 200kv/ha. Misri ka përdorim të gjerë në prodhimin e glukozës, dektrozës dhe së fundi prej misrit ka filluar prodhimi i biokarburanteve (Etanolit).

Një tjetër bimë që përfshihet në drithërat, është dhe thekri. Kultivohet prej dy biotipeve: vjeshtore dhe pranverore. Specia vjeshtore konsiderohet si më e qëndrueshmja prej të gjitha specieve cereale ndaj të ftohtit dhe thatësisë. Kokrrat e thektrit kanë vetinë të prodhojnë miell me fuqi të ulët kalorifike, veti kjo tepër e preferueshme për njerëzit me probleme të obezitetit dhe sëmundjes së diabetit.

Përzierja e miellit të grurit me të thektrit në proporcione të studiuar, prodhon bukë me cilësi të larta dietetike.

MATERIALI DHE METODA

Artikulli trajton vlerësimin ekonomik – financiar të bimëve cereale dhe pikërisht të grurit, misrit dhe thektrit nga kënd – vështrimi i përfitimit monetar të fermerit që i kultivon këto specie.

Të dhënat analitike mbi sipërfaqet, rendimentin dhe produktivitetin, e kanë burimin nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Korçë, Seksioni i Statistikave.

Rezultatet dhe diskutimi i tyre

Viti 2011 konsiderohet si viti bujqësor më i mbarë në prodhimin e drithërave, krahasuar me vitin 2012. Në lidhje me sipërfaqen e mbjellë, konstatojmë se midis dy viteve të marra në studim nuk ka ndryshime të theksuara

Tabela Nr 1. Tabela përmbledhëse e sipërfaqeve, rendimenteve dhe prodhimit të drithërave. Qarku Korçë viti 2011.

Nr	Rrethet	Drithëra gjithsej			Grurë			Misër			Thekër		
		Ha	Kv/Ha	Ton	Ha	Kv/Ha	Ton	Ha	Kv/Ha	Ton	Ha	Kv/Ha	Ton
1	Korçë	12192	38,5	46920,6	10020	39,5	39583,5	1629	37,8	6157,3	543	21,7	1179,8
2	Pogradec	2975	34,4	10,242,5	2045	35,0	7157,5	880	33,8	2975	50	22,0	110
3	Kolonjë	1050	34,5	3620	600	35,0	2100	400	35,0	1400	50	24,0	120
4	Devoll	3983	34,5	13729,4	3340	36,0	12.024	597	27,0	1612	46	20,3	93,4
5	QARKU	20200	36,8	74512,5	16,005	38,0	60865	3506	34,6	12144,3	719	20,9	1503,2

Tabelë përmbledhëse e sipërfaqeve, rendimenteve dhe prodhimit të drithërave të Qarkut Korçë Viti 2012

Nr	Rrethet	Drithëra gjithsej			Grurë			Misër			Thekër		
		Ha	Kv/Ha	Ton	Ha	Kv/Ha	Ton	Ha	Kv/Ha	Ton	Ha	Kv/Ha	Ton
1	Korçë	12986	32,3	41950	10077	32	32247	2475	33,6	8811	416	21	892
2	Pogradec	2927	32,8	9596	2030	32,8	6668	857	33,2	2848	40	20	80
3	Kolonjë	1050	29,4	3088	750	29,7	2228	250	30	750	50	22	110
4	Devoll	4139	28	11600	3465	28,2	9792	614	27	1683	60	20,8	124,8
5	QARKU	21102	31,38	66235	16322	31,2	50935	4196	33,6	14093	566	21,3	1207

Për të vlerësuar fitimin neto monetar, për çdo specie të kultivuar, kemi kryer analizën ekonomiko – financiare mbi bazën e kostos kulturave dhe kostos ekonomiko – teknologjike, duke përfshirë të gjitha shpenzimet e kryera të ndara sipas specifikave gjithë përfshirëse.

Për bimën e grurit:

- a) Shpenzime materiale (inpute)
- b) Shpenzime mekanike
- c) Shpenzime agro – teknologjike

A1 = fara 2,5 kv x 6000lekë/kv = 15000lekë

A2 = pleh kimik A21 Nitrat amoni 3kv x 4000 lekë/kv = 12000

A22 DAP 2kv x 6000 lekë = 12000

A3 Herbicid 2kg x 700lekë/kg = 1400lekë

A4 DIZIFEKTANT 0,2kg x 800lekë/kg = 160lekë

Totali i shpenzimeve 30,560lekë.

B. Shpenzime mekanike

B1 = Lërim 26-30cm 1Ha = 12000lekë

B2 = Diskim I + II 1Ha = 10.000lekë

B3 = Mbjellja 1Ha = 5000lekë

B4 = Korrja 1Ha = 8000lekë

B5 Transport drithi 1Ha = 3000lekë

Totali = 38.000lekë.

C. Shpenzime agro – teknologjike

Totali = 3000lekë

Totali i shpenzimeve 71560lekë

Të ardhura nga shitja e prodhimit 161,060lekë

Kostoja për 1kg prodhim 19lekë

Fitimi neto 89,500lekë.

Për bimën e misrit:

A – Shpenzime materiale 37,800lekë

B – Shpenzime mekanike 40,000lekë

C – Shpenzime agro – teknologjike 40,000lekë

Totali i shpenzimeve 117,800lekë	
Të ardhura nga shitja e prodhimit	210.000lekë
Kostoja e 1kg misri = 29,4lekë	
Fitimi neto = 92,400lekë	
Për bimën e thektrit	
A – Shpenzime materiale	20.000lekë
B – Shpenzime mekanike	30,000lekë
C – Shpenzime agro – teknologjike	20,000lekë
Totali i shpenzimeve	52.000lekë
Të ardhura nga shitja e prodhimit	115,000lekë
Kostoja e 1kg thekri = 22,6lekë	
Fitimi neto = 63000lekë	

Vlera kulture

Bima e grurit konsiderohet si një nga parabimët më të preferuara për një shumicë specimesh të kultivuara si: patatja, panxhari, bimët prashitëse dhe leguminoze.

- Misri vlerësohet si parabimë e “ëmbël” për drithërat, perimet, leguminozet, veçanërisht për jonxhën dhe tërëfilin.

- Kultura e thektrit, është mjaft e përshtatshme si parabimë e patates dhe bishtajore njëvjeçare për kokërr, në zonat e larta, mbi 700 – 800 m mbi nivelin e detit.

Sikundër shihet nga analiza ekonomiko – financiare e kryer, rezulton që fitimi neto më i lartë realizohet prej bimës së misrit me një vlerë totale monetare prej 92,400lekë për çdo hektar të mbjellë.

Vendin e dytë për nga leverdishmëria ekonomike e zë bima e grurit me një vlerë totale prej 89.500 lekë për çdo hektar të mbjellë.

Ndonëse në pamje të parë, thekri siguron të ardhura monetare më të pakta se misri e gruri, por me bindje mund të pohojmë se vlerat e kësaj specie janë të larta për mikro – rajonet ku ajo kultivohet.

Janë eksperimentuar edhe specie të tjera në këto rajone ekologjike dhe asnjë prej tyre nuk ka garantuar të ardhura monetare sa thekri.

Por vlerat e thektrit janë dominante si dhe në aspektin kultural dhe artizanal.

PËRFUNDIME

- Bima e misrit zë vendin e parë në grupin e drithërave për vlerën monetare që përftojnë fermerët nga kultivimi. Për çdo një ha të mbjellë, fermeri garanton 92.400lekë fitim.

- Prej bimës së grurit, përftohet një vlerë monetare prej 89,500lekë, ndërkohë kur vlerat kulture të kësaj bime janë multidimensionale për çdo specie tjetër të kultivuar.

- Ndonëse fitimi neto për çdo hektar të mbjellë me bimën e thektrit

- Është më e ulët se ajo e mbjellë me misër e grurë, përsëri kjo specie ka vlera fitimprurëse monetare dhe për më tepër vlera në aspektin agro – teknologjik dhe dietetik.

REFERENCAT

1. INSTAT – “VJETARI STATISTIKOR – 2012, 2013.
2. GALAIS.A “Objectives et ceteres du selection du mais” 1981
3. KOBILIANCKI I.I “Rzhi” 1987
4. MULLER.F “Statistical methods” 1966.

ANALIZA E TË DHËNAVE MBËSHTJELLJEJE (DEA),METODAT QË NUK KËRKOJNË NJË INFORMACION APRIORI,VLERËSIMI CROSS- EFFICIENCY. DATA ENVELOPMENT ANALYSIS (DEA),METHODS THAT DO NOT REQUIRE A PRIORI INFORMATION,CROSS-EFFICIENCY EVALUTION.

BLERTA KRISTO¹, VALENTINA SHEHU²

Fakulteti i Inxhinierise Matematike dhe Inxhinierise Fizike,Universiteti Politeknik i
Tiranes,Tirane Shqiperi ¹

Fakulteti i Shkencave te Natyres,Universiteti i Tiranes,Tirane,Shqiperi²

Email:kristoblerta@yahoo.com

PERMBLEDHJE

Në analizën e të dhënave mbështjelljeje (DEA),programimi matematik është aplikuar për të vlerësuar performancën e efijencës.Kjo metodologji është aplikuar në studimet e jetës reale.Për të përmirësuar performancat, ekzistencat organizative, duhet të vlerësojnë vazhdimisht operacionet ose proceset që lidhen me produktet,shërbimet dhe të tjera.DEA përdor teknika të programimit matematik dhe modelet për të vlerësuar performancën e njësisive peer (shokë),këto njësi peer (shokë) quhen njësi vendimarrëse (DMU_s). Ky studim parashtron një model DEA për rankimin (rradhitjen) e njësisive vendimarrëse ne analizën e të dhënave mbështjelljeje,metoda standarte DEA cross- efficiency(efijencë kryq).Metoda e efijencës kryq është zhvilluar si një zgjerim i DEA-s për rradhitje të (DMU_s) (1986) dhe efijenca maksimale cross (Cook dhe Zhu 2014).

Fjalet kyçe:*Analiza e te dhenave mbeshtjelljeje;vleresimi cross-efficiency;rradhitja DEA.*

ABSTRACT

In Data Envelopment Analysis (DEA),mathematical programming is applied to asses the efficiency performance.This methodology has been applied in real life studies.To improve performances,organizations need to constantly evaluate operations or processes related to products,services and others.DEA uses mathematical programming techniques and models to evaluate the performance of peer units,these peer units are called Decision Making Units (DMU_s). This paper proposes a DEA model for ranking decision making units (DMU_s) in data envelopment analysis,the standart DEA cross -efficiency method.The cross efficiency method is developed as a DEA extension to rank DMU_s (1986) and maximum cross efficiency (Cook and Zhu 2014).

Keywords: *Data envelopment analysis; cross-efficiency evaluation; DEA ranking*

1.HYRJJE

Analiza e te dhenave mbeshtjelljeje (DEA),parashtruar nga autoret Charnes,Cooper dhe Rhodes (1978) ,(shih 6 fq52) eshte bere sot nje metode e metodologji qe mund te thuhet mjaft <<popullore>> per ta perdorur ne shume fusha e sektore prodhimi e sherbimi.Ajo ka nje shtrirje e perdorim shume te larmishem ne perdorimet e programeve matematikore kompjuterike, shtrirja e te cilave po rritet vazhdimisht.Menjane,eficences se vleresuar per njesite vendimarrëse (DMU) (Decision making unit),e cila krahas saj jep informacion me tej ne drejtim te permiresimit te performances se ketyre njesive vendimarrëse.Performanca eshte formatimi i paraqitjes se ndryshimeve te qendrushme ndermjet njesive te strukturuara organizativisht homogjene,prezente ne nje proces prodhimi e sherbimi,dhene ne perceptime e vleresime te caktuara dhe ne ndertime matematikore me cilesite dhe te synimeve support te tyre ,te ketij procesi ne nje moment te caktuar kohor. Njihen jo pak metoda qe synojne rritjen e dallimit te eficences ne DEA ,ndermjet DMU_s .

2.MATERIALI DHE METODAT

Metodat per llogaritjen e eficences cross jane bere me spreadsheet per modelin shumezues CRS,ku rezultatet e eficences dhe peshat optimale jane llogaritur ne tabelen 2.Burimet e informacionit te perdorura ne kete studim perbehen nga te dhena te marra nga Ministria e Shendetesise ne Shqiperi.

3.REZULTATET DHE DISKUTIMI

Nje nder metodat alternative te perdorura ketu te vleresimit eshte dhe ajo e quajtur **cross-eficence** . Kjo eshte perdorur per here te pare nga Sexton dhe etj,e njohur si nje zgjerim i DEA-s(1986) me idene kryesore per ta perdorur vleresimin peer (referent).Me tej problemi u investigua nga Doyle dhe Green (1994).Nje vleresim <<peer>> qe cdo DMU njihet e vleresuar sipas skemes optimale peshe te DMU_s te tjera.Avantazhi i saj qendron mbasi apelon nje rradhitje midis DMU_s dhe eleminon skemat imagjinare peshe,hedh drite ne hapesiren e kufizimeve peshe,nje fushe aplikimi per ekspertet,nje ide e zhvilluar dhe nga Anderson (2002). Meqenese ne modelet DEA mund te kemi zgjidhje optimale te shumefishta (jounike) qe corientojne disa cross-eficencen,Doyle dhe Green propozuan perfshirjen e perdorimin e nje synimi te dyte (funksion objektivi i dyte) me veshtrim per t'u marre me zgjidhjet jounike (nga modeli fillestar klasik DEA).Idea qendrore ishte per te identifikuar peshat optimale qe jo vetem maksimizojne eficencen per nje DMU te vecante sipas vleresimit,por gjithashtu minimizojne eficencen mesatare per DMU_s e tjera (shih Joe Zhu 20014 fq.61).Ata pra zhvilluan modelin e quajtur <<formulimi agresiv>>.Ne anen tjeter skema e peshes se zgjedhur mundet te jete e drejtperdrejte,maksimizimin e cross-eficences per DMU_s e tjera,ndaj dhe formulimi tjeter eshte quajtur dhe <<formulimi miredashes>> (benevolent formulation).Le te supozojme se na jane dhene n-njesi vendimarrese (DMU_s) ku cdo DMU_j ka s outpute te ndryshme dhe m inpute te ndryshme.Pra le te na jene dhene niveli i inputeve x_i ($i=1,2,\dots,m$) dhe niveli i outputeve y_r ($r=1,2,\dots,s$).Ndaj le te themi se na jane dhene x_{ij} dhe y_{rj} vlerat respektive per input dhe output te DMU_j ($j=1,2,\dots,n$).Eficenca cross llogaritet si proces duke kaluar ne dy faza.Faza e pare perdor modelin DEA me te ardhuren konstante te

$$\text{shkalles (CRS) , } ef_j = \frac{\sum_r u_r y_{rj}}{\sum_i v_i x_{ij}} \quad (r=1,2,\dots,s; i=1,2,\dots,m; j=1,2,\dots,n)$$

ku u_r dhe v_i tashme ne literature njihen si peshat (ose rendesat) e inputit dhe outputit te perdorur.Per nje DMU_k te vecante , $k \in \{1,2,\dots,n\}$,rezultati, efecenca relative e te ciles me DMU_s e tjera ndjek modelin:

$$\text{Max } ef_{kk} = \frac{\sum_{r=1}^s u_r y_{rk}}{\sum_{i=1}^m v_i x_{ik}}$$

$$\text{me kushte } ef_{kj} = \frac{\sum_{r=1}^s u_r y_{rj}}{\sum_{i=1}^m v_i x_{ij}} \leq 1 \quad (j=1,2,\dots,n) \quad (1)$$

$$u_{rk}, v_{ik} \geq 0 \quad (r=1,2,\dots,s; i=1,2,\dots,m)$$

ku u_{rk} dhe v_{ik} jane peshat per outputin e r-tedhe inputin e i-te te DMU_k ;keshtu synimi eshte te percaktohet nje set i peshave te input-output qe eshte me i favorshem per DMU_k . Eficenca cross e DMU_j per $j \neq k$, e cila do te perdore peshat e zgjedhura te DMU_k (vleresimi peer) themi:

$$ef_{kj} = \frac{\sum_{r=1}^s u_{rk}^* y_{rj}}{\sum_{i=1}^m v_{ik}^* x_{ij}} \quad (2)$$

shenimi (*) tregon vlerat optimale te marra ne modelin (1).

Mesatarja e te gjitha ef_{kj} ($k=1,2,\dots,n$) shprehur si rezultat i eficences cross per nje DMU_j ($j=1,2,\dots,n$) shkruhet :

$$\overline{ef}_j = \frac{1}{n} \sum_{k=1}^n ef_{kj} \quad (3)$$

Duke perdorur transformimin e Charnes dhe Cooper-it (1962) modeli (1) i cili eshte nje model DEA porse ekuivalentisht mund te transformohet ne modelin e quajtur input-orientuar, modeli CRS shkruhet:

$$\begin{aligned} \text{Max } ef_{kk} &= \sum_{r=1}^s u_{rk} y_{rk} \\ \text{me kushte } \sum_{i=1}^m v_{ik} x_{ik} &= 1 \\ \sum_{r=1}^s u_{rk} y_{rj} - \sum_{i=1}^m v_{ik} x_{ij} &\leq 0 \\ u_{rk}, v_{ik} &\geq 0 \quad (j, k=1, 2, \dots, n; r=1, 2, \dots, s; i=1, 2, \dots, m) \end{aligned}$$

Matrica e eficiencies cross (sipas Doyle dhe Green 1994) paraqitet:

Tabela 1.

Rradhitja e DMU	1	2	3	4	5	...	n	Vleresim i mesatarizuar i <<peer>> (prej referuesve)
1	ef_{11}	ef_{12}	ef_{13}	ef_{14}	ef_{15}	...	ef_{1n}	$E_1 = \frac{1}{n} \sum_{k=1}^n ef_{1k}$
2	ef_{21}	ef_{22}	ef_{23}	ef_{24}	ef_{25}	...	ef_{2n}	$E_2 = \dots$
3	ef_{31}	ef_{32}	ef_{33}	ef_{34}	ef_{35}	...	ef_{3n}	$E_3 = \dots$
4	ef_{41}	ef_{42}	ef_{43}	ef_{44}	ef_{45}	...	ef_{4n}	$E_4 = \dots$
5	ef_{51}	ef_{52}	ef_{53}	ef_{54}	ef_{55}	...	ef_{5n}	$E_5 = \dots$
...
n	ef_{n1}	ef_{n2}	ef_{n3}	ef_{n4}	ef_{n5}	...	ef_{nn}	$E_n = \dots$
Shkalla e papunësisë në nivel vendi në muajin dhjetor 2006 ishte 0.3% më e ulët se e 2005-ses.

Grafiku I mëposhtëm paraqet nivelin e papunësisë për periudhën 1991-2006, në %

Grafiku 1

Papunësia 1991 –2006



Tabela e mëposhtme paraqet nivelin e papunësisë sipas gjinisë dhe grupmoshëve për vitin 2011-2012.

Tabela 1

Papunësia sipas gjinisë dhe moshës
Unemployment by sex and age

Gjinia Sex	Grupmosha Age-group	2011	2012
Gjithsej Total	Total	188,547	173,420
	15-24	56,060	53,247
	25-54	113,248	105,449
	55-64	19,017	14,513
	65+	---	---
Meshkuj Male	Total	102,266	106,059
	15-24	35,952	37,782
	25-54	53,649	57,637
	55-64	12,516	10,430
	65+	148	211
Femra Female	Total	86,282	67,361
	15-24	20,108	15,465
	25-54	59,599	47,812
	55-64	6,501	4,083
	65+	---	---

4.Probleme të identifikuara në tregun e punës dhe masat që duhen ndërmarre

Pa me të voglen kundërshti , pohojmë se viti 2013 e gjeti vendin tonë me rreth 51 mijë vetë me pak të punësuar kundërt vitit 2008. Rritja ekonomike relativisht e qëndrueshme e periudhës 2000-2008 nuk u shoqërua me nivelin e duhur të rritjes së punësimit, të uljes ekonomike joformale dhe zhvillimit të kapitalit njerezor. Për të bërë e mundur këtë transformim të elementeve të lart përmendur, vëmendje duhet përqendruar në marrjen e këtyre masave:

A. Ndryshimin e strukturës së ekonomisë

Pra,nga nje ekonomie bazuar tek konsumi I mallrave te importuara,emigracioni dhe informaliteti, ne nje ekonomi qe bazohet tek puna dhe rritja e produktivitetit nepermjet rritjes se rendimentit.

B. Riorjentimi teresor I arsimit profesional drejt nevojave te tregur dhe kthimi I shtetit ne financuesin dhe mbeshtetesin kryesor te aftesimit profesional. Sistemi mbi te cilin kjo reforme do bazohet eshte sistemi dual gjerman qe karakterizohet nga nderthurja e sistemit teorik me punen praktike profesionale. Vemendje e vecante duhet ti kushtohet kualifikimit te punonjesve me banim ne zonat rurale,ku po rigjallerohet industria agroperpunuese.

C. Tregu shqiptar I punes nuk po shkeputet ende nga "kthetrat" e tregut informal.Sigurimi I stimujve me te favorshem per formalizimin e vendeve te punes,kontraktimi me flexible do ti ndihmonte ne menyre te vecante te punesuarit me vulnerable.

D. Personat me nivel arsimor te ulet ndeshen me probleme me te veshtira ne tregun e punes,kane nje perqendrim te personave me arsim minimal apo pa arsim ne sektorin informal.Niveli I arsimimit eshte I lidhur ngushte dhe me nivelin e te ardhurave per cdo familje.Zgjerimi I aksesit per arsimin dhe formimin profesional eshte vendimtar per zgjidhjen e ketij problem.Ne te ardhmen,me urbanizimin e ekonomise dhe largimin e saj nga sektore bujqesore ekstensiv ,zhvillimi I kapitalit njerezor do te marre vlerat e duhura dhe do te zbutet procesin e uljes se papunesise.

E. Megjithese emigracioni eshte vleresuar si nje burim I mire te ardhurash per familjet shqiptare dhe instrument I dobishem ne menaxhimin e riskut, ai nxit fenomenin e qarkullimit te trurit.Qarkullimi I trurit ofron perfitime potenciale per te ardhmen sepse emigrantet kane perfituar formimin profesional dhe pervoje progressive ne vendet ku ata migrojne.Mjaft positive eshte prirja e emigranteve te cilet kthehen per te hapur biznese te reja ne atdhe.Nisma e re e qeverise per parjashtimin nga taksat per disa vite per keto biznese do te jete shtyse e fuqishme per uljen e papunesise.

F. Grate vazhdojne te kene nivele te ulta punesimi dhe per rrjedhoje shkalle te larte papunesie.Nga vrojtimet e kryera rezulton se pagat per gjinine femerore jane gati 30-32% me te ulta se meshkujt per te njejten lloj pune.Nuk duhet te kemi ne harrese komunitetet rome dhe egjiptiane.Te keto komunitete niveli I papunesise shkon rreth 70%,pa bere fjale per pagat e ulta te paguara per to.Shumica e ketij komuniteti punon ne sektorin

G. informal.Kjo ka pasoja negative sepse ndikon ne uljen e mireqenies sociale te ketyre grupeve.

H. Ndertimi I agjensise kombetare te punesimit,si njesi me buxhet dhe administrim autonom,do te rikonceptoje praktikat me te efektshme ne modernizimin e zyrave te punes, sistemin e sigurimeve te punesimit, programin e nxitjes dhe te punesimit apo edhe trajnimet profesionale.


I. Rrinisja e dialogeve te munguar prej kohesh me sindikatat per te rikthyer kulturen e tripartizimit mes shtetit, punedhensve dhe punemarresve,cka do te rijetesojte edhe keshillin kombetar te punes,si nje instrument themelor ne hartimin e politikave te punesimit,pagave dhe perfitimeve sociale, do te konsiderohet si nje mekanizem dobiprures per ngritjen e mireqenies dhe uljen e papunesise.

5. Klasifikimi sipas te punesuarve

1.Te punesuar sipas sektoreve

Grafiku I meposhtem pasqyron te punesuarit sipas sektoreve.

Grafiku 2



Konstatohet se gjate 4 viteve 2010-2013, te punesuar me te shumte gjenden ne sektorin privat bujqësor dhe me pak te punesuar ne sektorin shtetëror. Kjo per shkak te privatizimeve te shumta, qe u kryen pas viteve 90. Bujqësia vazhdon te mbetet aktiviteti mbizotëruës ne zonat rurale. Edhe pse ky sektor ka shënuar nje fare rritje, perseri ai mbetet i organizuar ne ferma te vogla, me ngastra te copezuara, teper i fragmentarizuar, kryesisht per te siguruar jetesen.


2. Te punesuar sipas aktiviteteve ekonomike.

Gjate tremujorit te dyte te 2014, 43.3% e te punesuarve jane angazhuar ne sektorin e bujqësisë, kurse 22.2% e te punesuarve ushtrojne aktivitet ne sektorin e shërbimeve te tregut. Punesimi ne sektorin jashte shërbimeve te tregut perben 16.7% te krejt punesimit.

- Te punesuarit ne industrine perpunuese perbejne 8.1% te te punesuarve
Perqindja e larte e punesimit ne bujqësi tregon se shoqeria shqiptare mbetet ende nje popullsi rurale me gjithë levizjet e medha drejt zonave urbane. Grafiku I meposhtem paraqet kete situatë ne perqindje.:

Grafiku 3

Struktura e punësimit sipas aktiviteteve ekonomike, Tr.2/14



3. Te punesuarit sipas gjinise dhe grupmoshave.
4. Te punesuarit sipas nivelit arsimor
5. Sektori informal.

STRATEGJIA SEKTORIALE, VIZIONI DHE PRIORITETET

Zgjidhja e problemit te papunesise do te mbetet nje nga prioritetet me emergjente te qeverise shqiptare. Per te realizuar kete emergjence shoqerore, program I qeverise e ka vene theksin tek punesimi dhe zhvillimi cilesor I forces se punes, ne perputhje me direktivat e bashkimit europian dhe rritjen e mireqenies se punonjesve. Objektivi kryesor I strategjise se hartuar eshte identifikimi dhe shikimi I politikave te duhura nxitese te punesimit dhe formimit professional te forces se punes, me qellim hapjen e vendeve te punes. Kjo strategji do te kete ne qender te saj :

- a. rritjen e mundesive per pune te denje
- b. ofrimin e arsimimit dhe formimit professional cilesor per te rinj dhe te rritur
- c. nxitjen e perfshirjes dhe kohezionit social
- d. fuqizimin e tregut te punes dhe sistemit te kualifikimeve

Ne perputhje me vizionin e qeverise, kjo strategji e shikon formimin professional dhe punesimin si 2 gjymtyre te te njejtit trup, duke synuar qe sherbimet e arsimimit dhe formimit professional te jene ngushtesisht te lidhura me ato te punesimit. Strategjia synon te permiresoje ndjeshem sistemin e sherbimeve per punekerkesit, si dhe sistemin e arsimimit dhe formimit professional. Kjo do te realizohet nepermjet formimit te nje sistemi te njehsuar te sherbimeve te punesimit ne mbare vendin tone, sipas modelit te ri te sherbimit ndaj qytetarit, bazuar ne pervojat me te mire europiane.

Pjese e rendesishme e ketij sistemi do te jete edhe ndertimi I nje partneriteti te qendrueshem dhe flexible ne te gjithe aktoret e tregut te punes.

PERFUNDIME

-Rritja e nivelit te punesimit eshte nje nga kushtet per nje zhvillim te qendrueshem te nje vendi dhe qe realizohet permes rritjes se investimeve, permiresimit te infrastructures, si dhe investimeve ne kapitalin njerezor.

-Permiresimi I politikave active dhe passive te punesimit, ne perputhje te plote me marreveshjet dhe konventat nderkombetare

-Aplikimi I programeve extra per komunitetet rome dhe egjiptiane. Kjo do te arrihet nepermjet ngritjes arsimore dhe profesionale, si dhe kualifikimit professional ne qendrat publike falas.

-Promovimi I punesimit dhe formimit professional per personat me aftesi te kufizuar. Kjo do te realizohet nepermjet bashkepunimit te qeverise shqiptare me OJF-te qe operojne ne fushen e aftesise se kufizuar me qellim trajnimit dhe integrimin e personave me aftesi te kufizuar ne tregun e punes, si nje mbrojtje e se drejtes se tyre per shanse dhe mundesi te barabarta punesimi

-Aplikimi I programeve te vecanta per gjinine femer. Kjo presupozon orientimin e duhur te grave drejt profesioneve te kerkuara dhe te pershtatshme per kete zhaner, duke marre ne konsiderate ambientet e pershtatshme, teknologjine e avancuar, deri tek masat per mbrojtjen e shendetit te tyre.

-Krijimi I mundesive dhe kuadrit ligjor per uljen e informalitetit dhe korrupsionit ne tregun e punes. Kjo do te realizohet nepermjet forcimit te bashkepunimit midis institucioneve si Inspektoriati I punes, Inspektoriati I sigurimeve shoqerore, ai I Tatim taksave etj..

REFERENCAT

1. INSTAT
2. Banka Botërore
3. Raporti i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO)
4. Ministria e Punës dhe Ceshtjeve Sociale
5. AHMET MANCELLARI; SULO HADËRI; DHORI KULE; STEFAN QIRICI. “Hyrje në ekonomi”, tekst shkollor “Fakulteti Ekonomik”, Tiranë 2002
6. RUDIGER DORNBUSCH; STANLEY FISCHER “Makroekonomia”, botim ndërkombëtar, Tiranë 2000
7. Publikime të gazetave “Shekulli”, “Shqip”, “Korrieri”
8. Buletini I periodikes, revista “Biznesi”
9. Publikime të revistës “Monitor”

**DEVELOPMENT OF THE AGRI-INDUSTRIAL BUSINESSES ALONG THE
TIRANA-DURRES CORRIDOR
ZHVILLIMI I BIZNESIT AGRO-INDUSTRIAL PËRGJATË KORRIDORIT
TIRANË-DURRËS**

ANILA SULAJ¹, HENRIETA THEMELKO², ANA KAPAJ²

¹Department of Management of Rural Tourism, Faculty of Economy and Agribusiness,
Agriculture University of Tirana, Albania

²Department of Economy and Agrarian Politics for Rural Development, Faculty of Economy
and Agribusiness Agriculture University of Tirana, Albania
e_mail:sulaj_anila@yahoo.com

ABSTRACT

The number of agro-industrial businesses that specialize in production and processing activities along Tirana-Durres corridor from 2001 to 2012 has increased three folds demonstrating the growing trend of this sector of the economy. Approximately 55% of respondents claim that the development of agro-industry in the areas under study is opening up new employment opportunities. According to the data of the study and looking at other similar data coming from these agro-industrial businesses the number of those employed reaches about 12% of the total employed along this corridor. The development of this sector of the economy will have a huge impact on the employment of citizens in both rural and urban areas along this corridor in the future. In this context a modern agri-business sector like this one along the Tirana-Durres corridor should be supported by the kind of modern agriculture which in turn should help increase the variety of products, their production and quality by creating a favorable agribusiness environment which comes with its own share of convenient public infrastructure and services.

PËRMBLEDHJE

Numri i bizneseve agro-industriale që specializohen në prodhimin dhe përpunimin bujqësor përgjatë korridorit Tiranë-Durrës nga viti 2001 deri në 2012 është rritur tre herë duke demonstruar tendencën në rritje të këtij sektori të ekonomisë. Përafërsisht 55% e të anketuarve pohojnë se zhvillimi i agro-industrisë në zonat nën studim ka krijuar mundësi të reja për punësim. Sipas të dhënave të studimit dhe nga të dhëna të tjera të ngjashme tregohet që numri i të punësuarve nga bizneset agro-industriale arrin rreth 12% të totalit të punësuar përgjatë këtij korridori. Zhvillimi i këtij sektori të ekonomisë do të ketë një ndikim të madh në punësimin e banorëve në të dy zonat rurale dhe urbane përgjatë këtij korridori në të ardhmen. Si pasojë e këtij transformimi po krijohet një sektor modern agrobiznesi përgjatë korridorit Tiranë-Durrës i mbështetur nga lloji i bujqësisë moderne e cila do të ndihmojë në rritjen e numrit të produkteve dhe prodhimin e tyre me cilësi, duke krijuar një mjedis të favorshëm agrobiznesit që vjen me pjesën e vet të infrastrukturës publike dhe shërbimeve të përshtatshme.

Fjalë kyç: *zhvillimi, biznesi, agro-ushqimor, Tiranë-Durrës.*

HYRJE

Në shumë vende në mënyrë të veçantë në qytete industria e agrobiznesit është nxitësi kryesor i zhvillimit ekonomik lokal (Barca, et al., 2012). Ne disa rajone të ngjashme me zonen në studim si në Bullgari, Rumani dhe vendet e tjera të Europës Juglindore ka diversitet ekonomik dhe sektori agroindustrial po zhvillohet me shpejteshi (BB, 2008; Marinov& Malhassian 2002). korridorin Tiranë-Durrës, krahas zhvillimit të degëve të tjera të ekonomisë, industria e agrobiznesit vazhdon të jetë një nga sektorët e rëndësishëm të

zhvillimit ekonomik. Në këtë rajon, që po zhvillohet në mënyrë të shpejtë, janë vendosur një sërë aktivitetesh prodhuese të produkteve ushqimore, ushqimeve të blegtorisë, prodhimit të fidanëve, fabrika të përpunimit të drurit, të cilat kanë sjellë rritje punësimi. Investimet në këtë sektor kanë sjellë prodhueshmëri më të lartë dhe rritje të të ardhurave në vitet e fundit. Ka shumë llojshmëri aktivitetesh prodhuese si: prodhimi i pijeve, përpunim agro-industrial, prodhim i ushqimeve të konservuara, etj (EU-Cards, 2006) Pavarësisht nga këto arritje, ka një numër vështirësish që pengojnë zhvillimin e shpejtë të sektorit. Bizneset e agro-përpunimit në Shqipëri janë përballur me konkurrencë për një kohë më të gjatë me bizneset e huaja, të cilët kanë prirjen të kenë një epërsi konkurruese me çmimet e tregut dhe me cilësinë e produkteve. Prandaj është e rëndësishme që ato të mbështeten me politika dhe projekte zhvillimi në mënyrë që të jenë më të orientuara drejt tregut dhe të prodhojnë produkte me cilësi më të lartë (UNDP, 2012; Thisen et al; 2013). Nga të dhënat e studimeve të tjera konstatohet që ka një tendencë për shtimin e produkteve të reja nga industria e agro-përpunimit në zonën Tiranë-Durrës (BB, 2008).

MATERIALET DHE METODA

Metoda e intervistimit dhe të dhënat statistikore janë përdorur duke mbledhur informacionin mbi zhvillimin e biznesve agro-ushqimore në zonat në studim. Për të vlerësuar zhvillimin e biznesit agro-ushqimor përgjatë korridorit Tiranë-Durrës në zonat në studim u përdorën për anketimin e banorëve pyetësorë të strukturuar të cilët përmbanin një sërë pyetjesh. Për çdo bashki dhe komunë, siç është përshkruar edhe më lart, është përdorur kampionimi duke intervistuar në mënyrë rastësore individë të zonave rurale duke siguruar plotësimin e 595 pyetësorëve që grumbullojnë informacionin e duhur. Pyetësoret u dizenuan duke u orientuar sipas detyrave të studimit. Pyetësorët janë të strukturuar në mënyrë të tillë me pyetje specifike për të seleksionuar informacionin mbi bizneset ushqimore që ndodhen në korridorin Tiranë-Durrës.

Pyetësorët e strukturuar për banorët e zonave në studim u hartuan me pyetjetë thjeshta dhe të kuptueshme për nivele të ndryshme arsimit të banorëve të anketuar.

Mbi bazën e këtyre pyetësorëve u drejtuan pyetje mbi treguesit e bizneseve ushqimore mbi: punësimin, papunësinë, vetëpunësimin, punësimin sipas grupmoshave, punësimin në biznesin agro-ushqimor në gjatësi të korridorit. Gjithashtu janë detjtuar pyetje të cilat kanë të bëjnë me vlerësimin nga banorët e anketuar mbi rëndësinë e zhvillimit të agroindustrisë, impaktin që kanë këto aktivitete në zhvillim e korridorit Tiranë-Durrës, vlerësimin e ndikimit të politikave të qeverisjes lokale dhe asaj qendrore për zhvillimin e biznesve agro-ushqimore në korridorin në tërësi.

REZULTATE DHE DISKUTIME

Nga anketimi i kryer gjatë periudhës 2011-2012 në banorët në zonat në studim jepen të dhënat në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Të dhënat e anketimit për rëndësinë e biznesve agro-industriale përgjatë korridorit Tiranë-Durrës

Komuna/ Bashkia	Nr. perso nave të interv istuar	Ur ba n	Ru ral	Vlerësuar nga banorët urbanë					Vlerësuar nga banorët ruralë				
				Shum ë i nevoj shëm	I nevoj shëm	Me rën dës i	Me pak rën dës i	Asp ak rën dës i	Shum ë i nevoj shëm	I nevoj shëm	Me rën dës i	Me pak rën dës i	Asp ak rënd ësis.
Kashar	157	99	58	34	40	6	7	3	27	20	4	5	2
Vorë	160	82	78	42	24	4	11	1	50	4	8	6	10
Manëz	130	60	70	20	17	13	8	2	24	14	20	7	5
Sukth	148	71	77	51	8	5	4	3	22	42	3	6	4
Total	595	312	283	147 (47%)	89 (28%)	28 (8.9%)	30 (9.6%)	9 (2.8%)	123 (43%)	80 (28%)	35 (12%)	24 (8.4%)	21 (7.4%)

Burimi: Pyetëtori për banorët


Zhvillimi i bizneseve agro-ushqimore në korridor është vlerësuar nga banorët e anketuar, të cilët u janë përgjigjur pyetjeve të pyetëtorit. Rezultatet tregojnë që 75% e të intervistuarve në zonat urbane e vlerësojnë atë duke e konsideruar të nevojshëm dhe shumë të nevojshëm. I njëjti fenomen ndodh edhe me banorët e zonëve rurale, ku 71% e personave e vlerësojnë si të rëndësishëm dhe shumë të nevojshëm për zhvillimin e bujqësisë, fermave dhe biznesit agro-ushqimore. Bujqësia dhe agroindustria pavarësisht ndikimit pozitiv të tyre në punësim, vlerësohen se kanë dhe ndikime të tjera negative nga shumica e banorëve të zonave urbane dhe rurale sepse urbanizimi i zonës ka shkaktuar edhe reduktimin e tokës bujqësore dhe hapësirës së gjelbër, më tepër mbetje kimike, ndotje të ajrit dhe tokës. Megjithatë, bujqësia dhe zhvillimi i agroindustrisë janë burim i konsiderueshëm të ardhurash familjare duke rritur mirëqenien e familjeve dhe prodhimin total të zonave në studim.

Tabela 2. Rritja e numrit të bizneseve agro-industriale në korridorin Tiranë-Durrës

Komuna/Bashkia	Viti 2001	Viti 2005	Viti 2009	Viti 2012
Kashar	5	7	15	17
Vorë	8	15	18	25
Manëz	6	12	16	22
Sukth	9	11	19	25
Total	28	45	68	89


Burimi: pyetësorët për administratën dhe banorët.

Figura 1. Vlerësimi i rëndësisë së biznesve agro-industrial nga banorët në zonën urbane



Burimi : Pyetëtori për banorët e zonave

Figura 2. Vlerësimi i rëndësisë së bizneseve agro-industriale nga banorët në zonën rurale



Nga tabela e mësipërme rezultojnë që numri i bizneseve agro-industriale që kryejnë aktivitete prodhuese dhe përpunuese në korridorin Tiranë-Durrës nga viti 2001 në vitin 2012 është rritur pothuajse tri herë duke demonstruar tendencën në rritje të këtij sektori të ekonomisë së këtij rajoni. Natyrisht që rritja e numrit të bizneseve agro-industriale shoqërohet edhe me mundësi të reja punësimi, duke ndikuar në uljen e papunësisë dhe rritjen e të ardhurave për banorët që jetojnë në këtë rajon ashtu si është diskutuar më lart.

65% e të anketuarve deklarojnë se bizneset janë të vendosura afër autostradës, duke patur akses të mirë për tregun si dhe lehtësira të tjera që ua mundëson infrastruktura përgjatë korridorit. Më tepër se 15% e të anketuarve pohojnë se bizneset agro-industriale kryejnë aktivitetet afër qendrave të banuara duke krijuar një mundësi për punësim, por edhe duke mbartur një rrezik për ndotjen e mjedisit dhe shëndetin e banorëve, që jetojnë në afërsi të tyre.

Zhvillimi i bujqësisë dhe agro-industrisë është i dukshëm edhe larg qendrave të banuara në zonat rurale, por dominon vendosja e aktiviteteve bujqësore dhe agro-industriale në afërsi të rrugës. Në zonat rurale janë shtuar sipërfaqjet e mbjella me vreshta, pemë frutore dhe aktivitete blegtorale. Industria e përpunimit të ushqimeve është e lokalizuar më afër autostradës dhe zonës industriale që shtrihet në të dyja anët e korridorit.

Në këto kushte, është e nevojshme që të hartohet një strategji për korridorin që gjithashtu ka një industri të rëndësishme të agrobiznesit, për ta bërë këtë sektor të ekonomisë më konkurrues si në tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Rreth 55% e të anketuarve pohojnë që zhvillimi i agroindustrisë në zonat në studim është një mundësi e re punësimi. Një ndikim të ndjeshëm në punësimin e banorëve kanë dhënë kompanitë e mëdha të prodhimit dhe përpunimit të ushqimeve të tilla si Coca Cola, EHW, Hako etj. Sipas të dhënave të pyetësorit duke i krahasuar edhe me të dhënat e statistikave në këto biznese agro-industriale janë të punësuar rreth 12% e të punësuarve në këtë korridor. Zhvillimi i këtij sektori të ekonomisë do të ketë ndikim në punësimin e banorëve të zonës rurale dhe urbane të këtij korridori edhe në të ardhmen.

Në këtë kuadër një sektor modern agrobiznesi në korridorin Tiranë-Durrës duhet të mbështetet nga një bujqësi moderne për të rritur shumëllojshmërinë e produkteve, prodhimin dhe cilësinë e tyre duke krijuar një ambjent të favorshëm agrobiznesi me infrastrukturë publike dhe shërbime të përshtatshme (EU-Cards, 2006). Studiues të tjerë në vende në zhvillim publikojnë studime ku tregohet se në zonat periferike të kryeqyteteve, në akset rrugore janë të vendosur biznese të agro-industrisë duke krijuar një brez industrial midis kufirit të zonës urbane dhe asaj rurale. Këtë tendencë e shohim dhe në vende të B.E si Greqia, Bullgaria dhe Rumania në periferitë e kryeqyteteve dhe qyteteve të mëdha të cilave janë krijuar zona në të cilat është i lokalizuar agro-biznesi në afërsi të zonave rurale duke patur akses në sigurimin e lëndëve të para për përpunim dhe prodhimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore (UNDP, 2003; Lall et al., 2006; Barca et al., 2012; Camagni & Capello, 2013).

KONKLUZIONE

- Mbi 55% e të intervistuarve e shikojnë zhvillimin e agro-industrisë si një **mundësi punësimi** dhe 33.4% e tyre si një mundësi për zhvillimin e agroturizmit. Ka një perceptim pozitiv për **zhvillimin ekonomik** kanë deklaruar 46,6% e banorëve të anketuar gjatë studimit. Edhe për ndikimin social që ka zhvillimi agro-industrial ka patur një vlerësim pozitiv nga 37,5% e banorëve të anketuar. Një rëndësi të veçantë i kushtohet impaktit që ka zhvillimi i agroturizmit në **përmirësimin e infrastrukturës**. Zhvillimi i agroindustrisë shoqërohet dhe me investime në infrastrukturë kryesisht në zonat rurale ku sipërmarrjet private kanë investuar edhe në përmirësimin e infrastrukturës për zhvillimin e biznesit të tyre. Krijimi i vreshtave, kantineve, fermave dhe qendrave të përpunimit të produkteve bujqësore është shoqëuar edhe rregullimin dhe përmirësimin e infrastrukturës si: rrugët, linjat elektrike, furnizimin me ujë etj. Rreth 22% e banorëve e shikojnë zhvillimin e **agro-turizmit** si një mundësi për zhvillimin e biznesit privat dhe vetëpunësimin duke ndikuar ndjeshëm në zbutjen e varfërisë dhe rritjen e të ardhurave familjare. Edhe për ndikimin pozitiv që ka agro-turizmi në **zhvillimin e komunitetit** ka patur një vlerësim me 25% nga banorët e intervistuar. Vetëm 16% e banorëve të intervistuar mendojnë që zhvillimi i agroindustrisë ka impakt negativ mbi shëndetin, kjo ndoshta nga impakti negative që ka mbi mjedisin duke shkaktuar ndotjen e tij. Impakti negativ për **reduktimin e hapësirës së gjelbër** i dedikohet ndoshta zënies së sipërfaqeve të gjelbra me ndërtime industriale ku përfshihen edhe ato të agro-industrisë.

REFERENCA

1. **Banka Botërore.** (2008), “Shqipëria: Sustaining Growth Beyond the Transition”. A World Bank Country Economic Memorandum. Poverty Reduction and Economic Management Department. Washington, D.C.
2. **Barca, F., McCann, P. & Rodriguez-Pose, A.** (2012), The case for regional development intervention: place-based versus place-neutral approaches’. *Journal of Regional Science* 52: 134-152.
3. **Camagni, R. & R. Capello.** (2013), Regional innovation patterns and the EU regional policy reform: towards smart innovation policies’. *Growth and Change* 44: 355-389.
4. **Lall, Somik V., Harris Selod, and Zmarak Shalizi.** (2006), “Rural Urban Migration in Developing Countries: A Survey of Theoretical Predictions and Empirical Findings”. Policy Research Working Paper 3915, World Bank, Washington, DC
5. **Marinov, V., D. Malhassian.** (2002), Measuring and assessment of regional disparities and their policy implications: the case of Bulgaria.
6. **MBUMK.** (2007), Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit 2007 – 2013, f. 8.
7. **Projekti EU-Cards 2006-2008.** Zhvillim i qëndrueshëm dhe i harmonizuar ne rajonin Tirane-Durres.
8. **Thissen, M., F. van Oort, D. Diodato & A. Ruijs.** (2013), Regional competitiveness and smart specialization in Europe. Place-based development in international economic networks. Cheltenham: Edward Elgar.
9. **UNDP (2003).** Human Development Report/Millennium Development Goals 2003Sen, A.: 1999, Development as Freedom (DAF) (Oxford University Press, Oxford).

**IMPACT OF POLITICS CONCERNING THE SOCIO-ECONOMIC
TRANSFORMATION OF THE TIRANA-DURRES CORRIDOR
IMPAKTI I POLITIKAVE NË LIDHJE ME TRANSFORMIMIN SOCIAL DHE
EKONOMIK TË KORRIDORIT TIRANË-DURRËS**

ANILA SULAJ¹, HENRIETA THEMELKO²

¹Department of Management of Rural Tourism, Faculty of Economy and Agribusiness
Agriculture University of Tirana, Albania

²Department of Economy and Agrarian Politics for Rural Development, Faculty of Economy
and Agribusiness, Agriculture University of Tirana, Albania
e_mail:sulaj_anila@yahoo.com

ABSTRACT

The results obtained from the study do confirm the positive evaluation of the development of the areas along the motorway which triggered by the local government policies. At least 28% of the interviewed residents do see this as an important socio-economic factor. In addition to evaluating the policies, of huge importance to residents in the study-based areas are the policies and projects undertaken by the central government. Along this line as many as 29% of them consider the initiatives, projects and policy initiatives along with those to be conducted in the future as important. About a quarter of people believe that the projects undertaken by the various associations, non-governmental institutions have a direct social and economic impact. A good share of appreciation is shown of regional development strategies which has been considered as positive by 37% of residents. The problems brought about by spontaneous urbanization and development has affected the evaluation done by the residents of the corridor. Lack of urban planning, the problems triggered by unplanned urban development are numerous and as such they have and will have a negative impact on the perception that people entertain of the development and socio-economic transformation of the area.

PËRMBLEDHJE

Rezultatet e fituara nga studimi kanë konfirmuar vlerësimin pozitiv të politikave të qeverisjes vendore në zhvillimin e zonave përgjatë autostradës Tirane-Durrës. Së paku 28% e banorëve të intervistuar e shohin këtë si një faktor të rëndësishëm social-ekonomik. Përveç vlerësimit të politikave, një rëndësie të madhe për banorët në zonat e studiuara kanë politikën dhe projektet e ndërmarra nga qeveria qendrore. Në këtë kontekst më shumë se 29% e banorëve në këto zona i konsiderojnë, projektet dhe iniciativat e politikës së bashku me ata që do të zhvillohet në të ardhmen si të rëndësishme. Rreth një e katërta e njerëzve besojnë se projektet e ndërmarra nga shoqatat e ndryshme, institucionet joqeveritare kanë një ndikim të drejtpërdrejtë social dhe ekonomik. Një vlerësim i mirë është dhënë për strategjinë rajonale të zhvillimit e cila është konsideruar se ka impakt pozitiv nga 37% e banorëve. Problemet që sjell urbanizimi dhe zhvillimi spontan ka ndikuar në vlerësimin e bërë nga banorët e korridorit. Mungesa e planifikimit urban, problemet e shkaktuara nga zhvillimi i paplanifikuar janë të shumta dhe si të tilla ato kanë dhe do të kenë një ndikim negativ në perceptimin që kanë banorët në këtë korridor mbi zhvillimin dhe transformimin social dhe ekonomik të zonës.

Fjalë kyç: *politikën, transformimin, korridorin, Tiranë-Durrës.*

HYRJE

Politikat e zhvillimit rajonal kanë rëndësinë dhe rolin e tyre në një zhvillim të qëndrueshëm. Nuk mund të konceptohet që një proces i tillë të zhvillohet në mënyrë spontane dhe të paplanifikuar. Edhe për rajonin e Tiranës natyrisht hartimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore mbetet prioritet i qeverisjes lokale dhe qendrore.

Tirana mund të klasifikohet në dy zona kryesore ekonomike: a) zona qendrore e Tiranës (qyteti me komunat dhe bashkitë rreth tij) dhe b) korridori Tiranë – Durrës; të cilat janë dy zona që kanë pësuar edhe zhvillimet më të mëdha demografike dhe ekonomike në vend . Zhvillimi i ardhshëm social ekonomik i kësaj pjese të madhe të ekonomisë shqiptare do të varet nga dinamika, organizimi dhe efektiviteti i këtij entiteti urban të integruar nga pikëpamja hapësinore. Një rol të rëndësishëm në këtë zhvillim luajnë politikat e zhvillimit të qëndrueshëm (BB, 2008). Tirana është rritur si një metropol mesdhetar si një faktor i ri në gjeografinë politike, ekonomike dhe kulturore të Europës jug-lindore (Barca et al., 2012). Ky pozicionim i ri ndërkombëtar nënkupton së pari nxitje të zhvillimit për shërbime kulturore të qytetit dhe së dyti forcim i rolit ekonomik të qytetit në lidhje me kontekstin e tij ndërkombëtar strategjik (Camagni & Capello, 2013).

Koncepti i zhvillimit rural në Shqipëri është relativisht i vonë dhe i ka zëvendësuar pak nga pak konceptin e strategjive sektoriale të ndërmarra në Shqipëri në zonat rurale të vendit përgjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Megjithë pranimin në nivel politik të këtij koncepti që në fillim të viteve 90, realisht politikat publike gjatë kësaj periudhe kanë qenë jo eficiente dhe nuk kanë tejkaluar hartimin e strategjive të hartuara. Edhe korridori Tirane-Durres si pjesë e këtij rajoni në zhvillim është nën ndikimin e transformit të shpejtë social-ekonomik. Në këtë kontekst kërkohen përpjekje më thelbësore në ndërtimin e një strategjie të zbatueshme për zhvillimin e korridorit, por edhe përputhshmërinë e kësaj të fundit me linjat strategjike të politikave për zhvillimin urban dhe rural.

MATERIALI DHE METODA

Metoda e anketimit dhe të dhënat dytësore janë përdorur duke mbledhur informacionin mbi ndikimin e politikave në transformimin social ekonomik të zonave në studim. Ndikimi i politikave në këtë transformim është arritur të vlerësohet duke kryer anketat për banorët e korridorit Tiranë-Durrës si dhe duke marrë informacion mbi qeverisjet lokale për strategjitë, planet e zhvillimit dhe politikat e ndjekura ne 5 vitet e fundit në zonat në studim. Është arritur të intervistohen rreth 595 individë që ndihmuan në grumbullimin e informacionit të duhur. Pyetësorët janë të strukturuar në mënyre të tillë me pyetje specifike për të seleksionuar informacionin mbi politikat e ndjekura në zonat në studim.

Në një pjesë të pyetësorit ka patur edhe pyetje të cilat kanë mbledhur opinionet e banorëve të zonave në studim për rëndësinë që ka zhvillimi i korridorit për standardet e jetesës dhe të ardhmen. Në këtë studim janë vlerësuar faktorë të ndryshëm që ndikojnë në zhvillimin e korridorit me anë pyetjeve të thjeshta të tilla si: A ka rëndësi zhvillimi i korridorit? Po zhvillimi i zonës tuaj, komunës ose bashkisë? Seria e pyetjeve të drejtuara kanë patur në fokus zhvillimin e bujqësisë, politikat e qeverisjes qendrore dhe asaj lokale si pjesë e rëndësishme e zhvillimit. Në pyetësor ka patur edhe pyetje të cilat kanë mbledhur opinione për zhvillimin e turizmit, infrastrukturës, roli i lidhshëm të qeverisjes lokale dhe marrja e vendimeve.

REZULTATE DHE DISKUTIME

Tabela 1. Vlerësimi i politikave të zhvillimit dhe në transformimin social-ekonomik të korridorit Tiranë-Durrës

Komuna/Bashkia	Politikat e Qeverisjes Lokale	Projekte të ndërmarra nga qeveria	Projekte të ndërmarrë nga OJQ	Strategjia Rajonale e Zhvillimit	Investimet e huaja
Kashar	39	51	32	61	41
Vorë	44	24	27	52	19
Manëz	57	69	71	80	8
Sukth	27	31	17	29	15
Total	167 (28%)	175 (29%)	147 (25%)	222 (37%)	83 (14%)

Rezultatet e marra konfirmojnë që vlerësohet pozitivisht zhvillimi i korridorit nga politikat e qeverisjes vendore nga 28% e banorëve të intervistuar duke e parë si një faktor të rëndësishëm zhvillimi të faktorëve ekonomiko-socialë. Krahas vlerësimit të politikave lokale, një rëndësi për banorët e zonave në studim kanë politika dhe projektet e ndërmarra nga qeveria qendrore dhe rreth 29% e tyre e konsiderojnë të rëndësishëm iniciativat, projektet dhe politikat e ndërmarra dhe ato që do të realizohen në të ardhmen. Rreth ¼ e banorëve mendojnë që projektet e ndërmarra nga shoqatat, institucionet jo qeveritare e konsiderojnë aktivitetin e tyre si një impakt direkt social dhe ekonomik. Më tepër vlerësim ka patur për strategjitë e zhvillimit rajonal të korridorit duke u vlerësuar nga 37% e banorëve. Problemet që ka sjellë urbanizimi dhe zhvillimi spontan i korridorit kanë ndikuar në vlerësimin që është bërë nga banorët. Mungesa e planifikimit urban, problemet që ka sjellë zhvillimi i paplanifikuar janë të shumta dhe ka patur dhe ka impakt negativ në perceptimin e zhvillimit dhe transformimit social-ekonomik të kësaj zone.




Figura 1. Vlerësimi i ndikimit të politikave në transformimin social-ekonomik të korridorit Tiranë-Durrës

Politikat rajonale të zhvillimit janë dhe mbeten faktori kryesor në krijimin e zonave urbane me një zhvillim të qëndrueshëm dhe të planifikuar (Toto, 2009). Deri tani zhvillimi i korridorit Tiranë-Durrës ka qenë spontan dhe i paplanifikuar dhe ka sjellë probleme të shumta social-ekonomike në zonat në studim. Impakti negativ i urbanizimit është i lidhur me

problemet e ndërtimeve pa kriter dhe infrastrukturën në pjesën larg korridorit (Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, 2015). Mungesa e shërbimeve publike të transportit, edukimi, ndotja e mjedisit janë akoma probleme të pazgjidhura. Në shumë studime të kryera në Europë mbi politikat rajonale të zhvillimit të qendrueshem tregohet se impakti i tyre është i dukshëm dhe konkretizohet me zhvillim të qëndrueshëm social ekonomik dhe me një transformim në të cilin dominon planifimi urban dhe zhvillimi social.

KONKLUZIONE

Politikat e qeverisjes lokale janë vlerësuar nga 28% e banoreve në studim duke arritur në konkluzionin se mbetet shume punë për të bere për hartimin dhe orjentimin e drejtë të politikave të zhvillimit rajonal të qëndrueshëm në korridorin Tiranë-Durrës. Pothuajse 30% e banorëve të anketuar vlerësojnë politikat e qeverisjes qendrore në zhvillimin e korridorit por nuk duhet harruar që 70% e banorëve nuk kanë dhënë vlerësim pozitiv për impaktin e politikave kombëtare të zhvillimit në këtë rajon. Një vlerësim më të mire kanë marrë Strategjitë Rajonale të Zhvillimit të këtij rajoni e cila mbetet si një domosdoshmëri për t'u zbatuar në mënyrë që të sjellë një zhvillim të qëndrueshëm të korridorit Tiranë-Durrës në të ardhmen.

REFERENCA

1. Banka Botërore. (2008), "Shqipëria: Sustaining Growth Beyond the Transition". A World Bank Country Economic Memorandum. Poverty Reduction and Economic Management Department. Washington, D.C.
2. MBUMK. (2007), Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit 2007 – 2013, f. 8.
3. Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes (2007). Strategjia Ndersektoriale per Zhvillimin Rajonal. Dokument – Final.
4. Agjensia Kombetare e Planifikimit te Territorit. Plani i integruar ndersektorial per zonen ekonomike Tirane-Durres. Draft konsultimi mbi dokumentin e politikave. Korrik 2015.
5. Barca, F., McCann, P. & Rodriguez-Pose, A. (2012), The case for regional development intervention: place-based versus place-neutral approaches'. Journal of Regional Science 52: 134-152.
6. Keating, M. (1998), The NEW Regionalism in Western Europe: Territorial Restructuring and Political Change, Cheltenham UK and Northampton MA USA: Edward Elgar.
7. Camagni, R. & R. Capello. (2013), Regional innovation patterns and the EU regional policy reform: towards smart innovation policies'. Growth and Change 44: 355-389.
8. Rudina Toto. (2009). Triologjia e Rajonit Zhvillimi rajonal, nevojë apo kërkesë. Rajonalizimi i Shqipërisë në debat - fuqizimi decentralizimit dhe evoluimi drejt zhvillimit rajonal.

**ZHVILLIMI I SEKTORIT TË BMA NË SHQIPERI ME FOKUS NË TREGTINË
NDËRKOMBËTARE
ALBANIAN MAPS SECTOR DEVELOPMENT WITH FOCUS ON
INTERNATIONAL TRADE**

MERITA GECAJ¹, DRINI IMAMI²

¹ AZHBR dhe Kandidate doktrature, në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

E-mail: merita.gecaj@azhbr.gov.al

² Fakulteti i bujqësis dhe Agrobiznesit, Univeriteti Bujqësor i Tiranës,

E-mail: dimami@ubt.edu.al

PËRMBLEDHJE

Në fushën e tregtisë ndërkombëtare, Bimët Mjekësore dhe Aromatike (BMA) përbëjnë aktivitetin më të rëndësishëm agro-pyjor në Shqipëri. Më shumë se 95% e totalit të BMA të mbledhura eksportohen. Eksporti i BMA përbënë 18% të eksporteve bujqësore si dhe 1.1% të totalit të eksporteve. Statistikat e tregtisë tregojnë se Shqipëria është një furnizues i rëndësishëm i lëndës së parë dhe të produkteve gjysmë të gatshme në BE dhe SHBA për përdorime të ndryshme (ushqimore, industrin e pijeve, shëndetësi, parfume dhe kozmetike, aditivët, etj); 2/3 e sherebelës së importur nga SHBA, në vitin 2014 vjen nga Shqipëria. Që nga viti 2000, eksportet shqiptare janë rritur, në sasi dhe vlerë, si dhe në vitin 2013 ata shënuan 9,330 ton (ose pothuajse dy herë më i lartë krahasuar me vitin 2000. Ndërsa në vlerë arriti në pothuajse 20 milionë euro (gati 1/3 rritje për të njëjtën periudhë reference). Qëllimi i këtij punimi është që të sigurojë informacion për sektorin e BMA-ve në Shqipëri me fokus në tregtinë ndërkombëtare, bazuar në analizën e gjerë e të dhënave dytësore, duke përfshirë bazat e të dhënave të ndryshme të tregtisë ndërkombëtare.

Fjalët kyç: *Spektori BMA, tregtia ndërkombëtare, zhvillimi.*

ABSTRACT

Medicinal and Aromatic Plants (MAPs) is a major agro-forestry business in Albania in terms of international trade. More than 95% of total MAPs collected are exported. Exports of MAPs account for 18% of agricultural exports and 1.1% of total exports. Trade statistics show that Albania is an important supplier of raw materials and half finished products for many EU and US industries in different fields (food and beverage industry, healthcare, cosmetics & perfumes, additives etc.); 2/3 of sage imported by USA in 2014 come from Albanian supply. Since 2000, Albanian exports have been increasing (in quantity and value) and, in 2013 they scored 9,330 Ton (or almost twice as high compared to late 2000', namely 2009), while in value it reached almost 20 Million EUR (almost 1/3 increase for the same reference period). The objective of this paper is to provide insight into Albanian MAPs sector with focus on international trade, based on extensive analysis of secondary data including various international trade databases.

Key words: *MAP Sector, international trade, development.*

HYRJE

Spektori i Bimëve Aromatike Mjekësore (BMA), është një ëaktivitet i rëndësishëm agro-pyjor në Shqipëri, sidomos në aspektin e tregtisë ndërkombëtare. Më shumë se 95% e BMA –ve totale të mbledhura eksportohen. Spektori i BMA është një performues i mirë e në rritje në tregun botëror. Statistikat e tregtisë tregojnë se Shqipëria është një furnizues i rëndësishëm i BMA-ve të papërpunuara ose gjysëm të përpunuara për shumë industri të BE-së dhe SHBA-së në fusha të ndryshme (ushqim dhe pije industri, shëndetësi, parfume dhe kozmetike,

aditivëve etj); në vitin 2014, 2/3 e sherebeles të importuar nga SHBA vjen nga Shqipëria. Që nga viti 2000, eksportet shqiptare janë rritur (në sasi dhe vlerë) dhe, në vitin 2013 ata shënuan 9330 ton. Eksportet e BMA përbëjnë 18% të eksporteve bujqësore dhe 1.1% të totalit të eksporteve. Tregu i brendshëm është shumë më i kufizuar, BMA përdoren kryesisht për qëllime të gatimit, përgatitjen e çajrave bimor apo në mjekësi tradicionale; përpunimi i BMA-ve për tregun vendas është i vogël dhe i kufizuar në paketimin e disa çajrave bimor dhe për nxjerrjen në shkallë të vogël të vajrave të esencës. Nuk ka pasur prodhim të detergjenteve, kozmetike apo ilaçe industriale të bazuar në BMA. Referuar studimeve të mëparshme, numri i njerëzve të përfshirë në sektorin e BMA shkon 75,000 - 100,000 persona, duke e bërë prodhimin e BMA-ve, nën-sektorin pyjor më të rëndësishëm në drejtim të përfshirjes së pjesëtarëve të komuniteteve malore. Grumbullimi dhe - më së fundi - kultivimi i BMA është një aktivitet i rëndësishëm dhe burim i të ardhurave për një numër të madh të familjeve rurale sidomos në zonat malore, edhe pse ajo është në pothuajse në të gjitha rastet një aktivitet me kohë të pjesshme. Të ardhurat nga grumbullimi i BMA janë vlerësuar të japin 17% të të ardhurave familjare në veri të Shqipërisë ", ndërsa kultivimi i BMA është bërë burimi kryesor i të ardhurave për mijëra familje veçanërisht në Malësi të Madhe (rajoni i Shkodrës). Të dhënat më të fundit tregojnë se të ardhurat nga vjelja dhe kultivimi i BMA-ve në veri të Shqipërisë (Malësisë së Madhe, Kukës dhe Dibër) arrin në 35%. Kjo bën të qartë se kultivimi i BMA përfaqëson një burim të madh të të ardhurave për zonat malore dhe të pafavorizuara.

1. METODA

Analiza për Sektorin e BMA është bazuar në rishikimin e të dhënave dytësore ekzistuese (statistika, raporte, dhe literaturë tjetër) si dhe të dhëna të tjera relevante. Akoma nuk ka statistika në lidhje me prodhimin vendas. Statistikat e prodhimit për BMA nuk janë të përfshira në sistemet e informacionit për bujqësin. Për prodhimin nga kultivimi i BMA, jemi mbështetur në rishikimin e studimeve të mëparshme në këtë sektor si dhe intervista të drejtpërdrejta me ekspertë si dhe kultivues të BMA-ve, kryesisht në rajonin e Shkodrës. Referuar faktit që më shumë se 95 % të BMA-ve eksportohet, ne u bazuam në të dhëna për tregtinë ndërkombetare, duke bërë analiza statistikore descriptive.

2. REZULTATET DHE DISKUTIMI

2.1 RËNDËSIA E SEKTORIT TË BIMËVE AROMATIKE MJEKSORE NË EKONOMINË RURALE SHQIPTARE DHE RËNDËSIA SOCIO-EKONOMIKE.

Sektori i Bimëve Aromatike Mjeksore (BMA), është një aktiviteti i rëndësishëm agro-pyjore në Shqipëri, sidomos në aspektin e tregtisë ndërkombëtare. Sektorin e BMA është një performues i mirë e në rritje në tregun botëror. Statistikat e tregtisë tregojnë se Shqipëria është një furnizues i rëndësishëm i tregut botëror për disa lloje bimësh; në vitin 2014, 2/3 e sherebeles të importuar nga SHBA vjen nga Shqipëria. Gjithashtu BMA-të ofrojnë mundësi punësimi dhe të ardhura të mira për familjet në zonat malore. Eksportet e BMA përbëjnë 18% të eksporteve bujqësore dhe 1.1% të totalit të eksporteve.

2.2 TREGU I BRENDSHËM

Tregu i brendshëm për BMA është i vogël, vetëm dy kompani përpunuese shesin produkt me etiket . Këto kompani i shesin produktet e tyre nepërmjet tre alternativave kryesore, farmace, supermarkete si dhe bar restorante. Përpunuesit, në tregun vendas, nuk shesin më shumë se 70 ton në vit, të bimëve mjeksore dhe aromatike. Vlerësohet që shitja e BMA në tregun vendas nuk kalon më shumë se 5 % të totalit të shitjeve nga ky produkt. Tradicionalisht kërkesa kryesore në tregun vendas ka qënë për çaj mali, rigon si dhe

rozmarin. Çaji mali kërkohet nga konsumatori direkt, rigoni dhe rozmarina kërkohet nga perpunuesit e produkteve të mishit dhe restorantet.

2.3 TREGU GLOBAL


Tregjet kryesore për BMA janë ai farmaceutik, kozmetik si dhe tregu ushqimor. Grupi më i madh i përdoruesve është në industrin ushqimore. Tregu i SHBA është blerësi më i madh i BMA, si dhe shumica e sherebelës së blerë përdoret në industrin ushqimore. Pritet që përdorimi i përbërësve natyral në produktet farmaceutike do rritet. Një trend kryesor duke u zhvilluar në tregtinë globale tek përbërësit natyral, është zhvendosja e përpunimit të mëtejshëm të lëndëve të para bimore nga vendet perëndimore në vendet në zhvillim. Arsyeja kryesore është të zvogëlohen kostot duke rritur avantazhin konkurrues. Një segment tjetër që eksportuesit shqiptar për materiale të papërpunuara të BMA, mund të synojnë, është edhe industria kozmetike.

2.4 EKSPORTET SHQIPTARE PËR BMA.

Shqipëria është tradicionalisht një eksportues kryesor i bimëve të thata, në masë. të cilat më së shumti trajtohen dhe ri-paketojnë jashtë vendit dhe përdoret në industrinë ushqimore. Një pjesë e tyre përdoren edhe për esenca vajore. Shqipëria është eksportues i një game të gjerë të produkteve, dhe është e njohur për eksportin e sherbelës, rigon, trumzë. Sherbela përbën gjysmën e vlerës së eksporteve të përgjithshme. SHBA-ja është tregu më i rëndësishëm për sherebelen Shqiptare, ku Shqipëria është furnizuesi më i madh ndërkombëtar. Tregjet kryesore janë Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat thithin më shumë se gjysmën e totalit të eksporteve të BMA. Tregje të tjera të rëndësishme janë Turqia, Italia dhe Franca. Pjesa më e madhe e produkteve të BMA që importohen nga vendet Europiane dhe Turqia, ripërpunohen si dhe ri-eksportohen.

Figura më poshtë tregon tregjet kryesore të eksportit të BMA-ve, Shqipëtare.


Figura 1, Struktura e eksporteve të BMA, sipas vendeve, viti 2004-2013.



Burimi :UNSTAT

Një karakteristikë e rëndësishme e prodhimit shqiptar është se eksportet kryesisht përbëhen nga BMA të egra, kur zgjidhen siç duhet dhe thahen, kanë vlerë më të lartë në treg. BMA të egra kanë vlerë më të lartë të esencave vajore, si dhe një gamë më të gjerë mikroelementësh, krahasuar me BMA e kultivuara.

Figura 2, Struktura e eksporteve sipas vendeve ne vitin 2014




Burimi: UNSTAT

Nga të dhënat duket qarte që për vitin 2014, Gjermania zë përqindjen më të madhe, shënon 36 % të totalit të eksporteve për BMA në gjitha të shtetet. Më pas vjen SHBA me një vlerë 27 % të totalit të eksporteve të BMA-ve për vitin 2014.

2.5 EKSPORTET NË SHBA

Figura 3, Evoluimi i importeve të SHBA, për sherebelën, nga Shqipëria dhe vende të tjera.



Burimi: USDA

Shqipëria është furnizuesi kryesor i tregut të SHBA me sherebelë. Në vitin 2013, përbëntë 72 % të totalit të eksporteve me sherebel në SHBA, e llogaritur në vlerë arrin shifren 10 mln \$. Në vitin 2014, shifrat tregojnë se SHBA importon nga Shqipëria 95 % të Sherebelës.


2.6 EKSPORTET NË EUROPE

Trendi i eksporteve Shqipëtare ndryshon në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian deri më tani tregu Gjerman është më i rëndësishmi, kurse eksportet në Itali dhe France janë pothuajse ekuivalent, Franca po bëhet më e rëndësishme në përdorimin BMA për përpunim

dhe Italia për përdorimin e BMA në industrin ushqimore dhe mjeksi. Të dhënat më të shumta janë për BMA që përdoren për përpunim. Vitet e fundit, në këtë nën-sektor eksporti i BMA-ve drejt vendeve të BE-së ka ardhur në rritje në sasi dhe vlerë.

Maqedonia është gjithashtu një konkurent i fortë në këtë nën-sektor, por në krahasim me Shqipërin dhe Turqin akoma mbetet shumë prapa.

Figure 4: Eksporti i BMA për përpunim nga Shqipëria në vendet e BE (Mt)



Burimi: EUROSTAT

Më shumë se ½ e BMA eksportohen drejt Gjermanisë e cila ndiqet nga Franca dhe Italia.

3. REKOMANDIMET

- Referuar rezultateve nga studime mbi tregtin ndërkombetare dhe eksportet, SHBA importon nga Shqipëria, 95 % të BMA, kryesisht sherebel, por vlerësimi nga cilësia, tregon se BMA-të kanë disa mangësi. *Në këtë kuadër do rekomandohet që Qeveria Shqiptare mund dhe duhet të marrë masa specifike, duke adresuar nevojat specifike të industrisë në këtë sektor, si dhe të mbrojë si dhe të mbrojë cilësinë e lartë të natyrshme të BMA, të cilat janë rrenjësore për Shqipërinë.*
- *Gjithashtu ka nevojë të vazhdueshme në përmirësimin e grumbullimit si dhe përpunimit të Bimëve Mjeksore dhe Aromatike të egra, kjo mund të kombinohet duke dhënë një mbështetje për blerje të pajisjeve të tharjes e kombinuar me një program informues dhe ndërgjegjësues.*
- Një pjesë e konsiderueshme e BMA-ve që importohen nga Vendet Europiane dhe Turqia, ri-përpunohen si dhe ri-eksportohen. *Në mënyrë që të ruhet emri dhe reputacioni i Shqipërisë mbi këtë produkt, duhet konsideruar vendosja e standarteve të forta si dhe praktike për shembull të vendoset një standart minimal për esencën vajore në eksportin e sherebelës.*
- Në Shqipëri gjenden shumë pak burime informacioni në dispozicion të kultivuesve, grumbulluesve, përpunuesve apo eksportuesve të BMA. Përpunuesit dhe eksportuesit kanë nevojë të kuptojnë më mirë targetin në treg si dhe si të krijojnë një lidhje të fortë dhe të qëndrueshme me klientët e tyre, e cila do çojë në një rritje afatgjatë më të qëndrueshme të të ardhura në zinxhirin e vlerës. Gjithashtu është e domosdoshme njohja e zhvillimit të tregut global për BMA. Duke marrë këtë informacion, kultivuesit mund të marrin vendime të sakta mbi çfare të kultivojnë/investojnë. *Në këtë kuadër do rekomandonim një mekanizëm rregullues që përcell informacionin e tregut tek aktorët, mbi BMA në shqipëri.*

LITERATURA

1. DSA, 2010, The Medicinal and Aromatic Plants Value Chain in Albania”, report prepared for USAID – Albania Agriculture Competitiveness (AAC) Program
2. EUROSTAT, 2014, Trade Database
3. Stefanllari, A., 2013, Increase access to international markets by improving supply chain coordination in the medicinal and aromatic plant value chain. SNV-Promali
4. Skreli, E., Imami, D., Medical and Aromatic Plants, Mini-sector Study. Project “Preparation of Inter- sectorial strategy for agriculture and rural development in Albania”, funded by the European Union and facilitated by the Food and Agriculture Organization of the UN through the project GCP/ALB/014/EC IPA 2009, February – June 2014.
5. USDA, 2014, Trade database.
6. UNSTAT, 2014, Comtrade (international trade database).

**SUBVENCIONET NË BUJQËSI – ANALIZË PËRSHKRUESE NË SEKTORIN E
BIMËVE MJEKSORE DHE AROMATIKE”
SUBSIDIES IN AGRICULTURE- DESCRIPTIVE ANALYSES OF MEDICINAL AND
AROMATIC PLANTS SECTOR.**

MERITA GECAJ¹

AZHBR(Agjencia e Pagesave) si dhe Kandidate në Doktorature, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

E-mail: merita.gecaj@azhbr.gov.al

PËRMBLEDHJE

Në këtë punim paraqitet një analizë përshkruese e të dhënave, një analizë e subvencioneve ndër vite për Sektorin e Bimëve Mjeksore dhe Aromatike në Shqipëri, për të vlerësuar politikat mbështetëse të Qeverisë, nëpërmjet subvencionit, në sektorin e BMA. Afati kohor është vlerësuar të jetë afatshkurtër 2-3 vite. Programi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka filluar mbështetjen për këtë sektor në vitin 2012 ndikimi është afatshkurter sepse vet bimët japin produkt dy herë brenda vitit. Të dhënat janë disponuar nga database i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural. Këto të dhëna janë përpunuar në SPSS, duke dhënë fillimisht një analize përshkruese e cila në vazhdim do kombinohet me grupe dhe analiza të shumëllojshme statistikore.

Fjalët kyç; Subvencion, Analizë përshkruese, Sektori i BMA.

ABSTRACT

The objective of this paper is to present a descriptive analysis of data of MAP sector. It is made an analysis of subsidies in the sector of medicinal and aromatic plants in Albania, through years. In order to assess the policies of the Government support, in MAP sector. The studied period is estimated to be in a term of 2-3 years. Program of Agriculture and Rural Development has started support for the sector in 2012 but its impact is provided in a short term period because MAPs provide product twice a year. The data are provided from the database of the Agency for Agricultural and Rural Development. Survey data are entered into a database, and they are analysed in SPSS. Initial analysis consists of descriptive statistics, which will be combined with clustering and multivariate statistical analysis.

Key words; Subsidies, Descriptive analysis, MAP Sector.

1. HYRJE

Qëllimi i studimit është të identifikojë disa nga rezultatet kryesore të politikës së mbështetjes direkte për Sektorin e Bimëve Mjeksore dhe Aromatike në Shqipëri, për të vlerësuar politikat mbështetëse të Qeverisë, nëpërmjet subvencionit në dymbëdhjetë qarqet e Shqipërisë përmes një analize krahasuese, në veçanti, punimi do të analizojë dhe vlerësojë efektivitetin dhe efikasitetin parimet e programit, faktorët e suksesit dhe dështimit si dhe do të propozojë zgjidhje për masa më efektive dhe efikase. Nga viti 2013 deri në vitin janë mbjellë 371.19 ha, e cila është një rritje e madhe në sipërfaqe në krahasim me 274.69 ha të mbjellë në vitin 2012. Kjo rritje e sipërfaqes së mbjellë është nxitur nga subvencionet, si edhe nga krijimi e një baze relativisht moderne të përpunimit në vend, dhe nga rritja e kërkesës në tregjet globale. Skema e mbjelljes në bllok të Bimëve Mjeksore dhe Aromatike si sherebelë, lavanda, timus e rigon, sipas zonave të përcaktuara më parë në rajonizim është mbështetur si fillim në vitin 2012 në masën 50% të kostos totale të projektit, por jo më shumë se 200,000 (dyqind mijë) lekë/ha. Bimët mjeksore dhe aromatike gjënden në të gjithë vendin por në disa rajone janë më të përhapura dhe grumbullimi është më i organizuar këtu përfshihen: Malsia e Madhe, Shkodër,

Skrapar, Elbasan, Korçë, Berat, Permet dhe Durrës. Bimët mjeksore dhe aromatike përbëjnë nën-sektorin më të rëndësishëm pyjor në lidhje me numrin e personave të përfshirë. Të ardhurat nga grumbullimi i bimëve mjeksore dhe aromatike përbëjnë 35 % të të ardhurave në familjet në veri të Shqipërisë. Vitet e fundit, vlerësohet që prodhimi i BMA-ve të kultivuara, ka tejkaluar ndjeshëm nivelet e BMA-ve të egra të grumbulluara në vlerë dhe sasi (nuk ka statistika, porse aktorë të sektorit të kontaktuar, konfirmojnë këtë trend) dhe pritet që roli i kultivimit të rritet më shumë, për shkak të rritjes së sipërfaqes së mbjellë.

2. METODA

Në këtë studim, është paraqitur:

- Rishikim literature dhe i studimeve të mëparshme.
- Analizë institucionale dhe legjislacionit në lidhje me skemat mbështetëse për MAPs.
- Analize e të dhënave dytësore nga databasë e AZHBR.

Analiza është përqendruar në efektet direkte të përfshira brenda një harku kohor afatshkurtër 2-3 vite.

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI


3.1 MBËSHTETJA ME SUBVENCION NGA SHTETI PËR SEKTORIN E BMA, KUADRI LIGJOR.

Skemat e mbështetjes në bujqësi kanë kombinuar dy element mbështetjen e investimeve dhe pagesat direkte. Qëllimi i zbatimit të këtyre skemave është rritja e prodhimit në sektorët më të rëndësishëm bujqësor. Mbështetja për fermerët është siguruar nëpërmjet një sërë skemave vjetore mbështetëse; kryesisht lloje të ndryshme të skemave si pagesë direkte.

Nga viti 2012 dhe në vazhdim viti 2013-2014- 2015 me Vendim të Këshillit të Ministrave, VKM., Nr. 173, datë 26.3.2014, si VKM., Nr.52, datë 21.01.2015 “Mbi përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, është vazhduar mbështetja si pagesë direkte për skemën

- Për mbjellje të bimëve medicinale të kultivuara si sherebele, lavanda, timus, rigon dhe rozmarine, në bllok e sipas zonave të percaktuara me pare per kultivim, ne masen 50% të koston totale te projektit, por jo me shume se 200,000 (dyqind mije) leke/ha.
- Mbështetja, përmes subvencionit, në masën 70% të normës së interesit, për 7 (shtatë) vite radhazi, për kreditë deri në 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, për aktivitetet: ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës, shpendëve dhe bimëve medicinale; mekanizimin e bujqësisë, blegtorisë, akuakulturës dhe bimëve medicinale.

Grafiku 1, shpërndarja e numrit të përfitueseve në vitin 2013.



Burimi: Të dhëna nga MBZHRAU, AZHBR

Evidenca e të dhënave në grafik tregon se numri më i lartë i përfituesve është në qarkun Shkodër, rrethi Malësi e Madhe, ky numër i madh fermerësh sigurojnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave nga mbledhja dhe/ose kultivimi i BMA-ve.


Sipas rajonizimit si dhe evidencave statistikore, në zonën e Malësisë së Madhe, kultivohen kryesisht bimët sherebel, lavanda dhe timus.

- Në 2014 u prezantua skema e investimeve, e cila përfshin mbështetje edhe për **BMA**, Mbështetja e investimeve deri në 50% të vlerës së projektit, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për një subjekt, për: ngritje ambientesh për grumbullim dhe ruajtje të prodhimit; linja për standardizim dhe/ose përpunim prodhimi;

Aplikantët mund të përfitojnë për; Linja/pajisje dhe makineri, të papërdorura; kriter ky që kontribon në cilësi më të lartë për BMA. Shqipëria plotëson 95 % të tregut Amerikan me produktin e BMA por nga cilësia renditet pas vendeve ish-Jugosllavis.

Aplikantët kanë shfaqur interes të madh në skemën e investimeve, gjatë viti 2014 si dhe 2015. Në vitin 2015 janë regjistruar 120 aplikant, në varësi të fondit kanë përfituar vetem 45 % prej tyre. Interesi për të investuar në ndërtim magazine si dhe linja për bimën medicinale është shfaqur në qarqe të ndryshme, Korçë, Gjirokaster, Shkodër. Përveç pamjaftueshmërisë së fondit, vështirësi tjetër kryesore në përfitim, ka qënë edhe pamundësia e plotësimit të dokumentacionit sipas kriterëve në Udhëzim. Dokumenta si p.sh Leje zhvillimore apo Leje ndërtimi, regjistrimi pasurive në ZRPP. Ky fakt, çon në nevojën e rishikimit të legjislacionit, standarteve minimale kombëtare më të lehtësuara, për investimet në sektorin e bujqësisë, të paktën për një periudhë të caktuar kohe.

Grafiku 2, Shpërndarja, në numër, e përfituesve sipas qarqeve në vitin 2014.



Burimi: Të dhëna nga MBZHRAU, AZHBR

Evidenca e të dhënave në grafik tregon se numri më i lartë i përfituesve është në qarkun Shkodër, rrethi Malësi të Madhe, ky numër i madh fermerësh sigurojnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave nga mbledhja dhe/ose kultivimi i BMA-ve. Sipërfaqja e mbjellë me BMA, regjistron rritje të vazhdueshme nga viti 2013- 2014, kjo dhe si pasojë e buxhetit akorduar për këte mase 2013- vlera 73,556,276, 2014- vlera 72,790,250.

Kjo do të thotë që vlera e investimeve nga programi i bujqësisë dhe zhvillimit rural në këtë nënsektor është rritur ndjeshëm e si rrjedhim mund të pohohet që mbështetja ka shërbyer si katalizator i rritjes së sipërfaqes së mbjell me BMA.

3.2 PËR FITUES NGA SUBVENCIONI PËR VITET 2012-2015.


Referuar raporteve tekniko financiare nga AZHBR për vitin 2007 deri në 2015, përmbledhur numri përfituesve 933 fermer, skemën e mbjelljeve të reja, me një impakt në sipërfaqë mbjellë 737.3 ha, shuma e fondit të përfituar nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural 148,714,628 lekë. Eksperienca e krijuar në zbatimin e kësaj skeme tregon se ka thithur një pjesë të konsiderueshme të buxhetit nga fondi për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Tabela 1: Mbështetja për Bimet Mjeksore dhe Aromatike gjatë vitit 2012 – 2015

Skema e Mbështetjes	Mbjellja e BMA
Numri i Përfituesve	933
Sipërfaqja e kultivuar Ha	737.3
Total përfituar	148,714,628

Burimi: Të dhëna nga MBZHRAU, AZHBR

Grafiku 3, Krahasimi i specieve të kultivuara me BMA nga 2010-2014,



Burimi: Të dhëna nga MBZHRAU, AZHBR

Evidencat nga grafiku vërtetojnë se Sherebela përbën sipërfaqen me të madhe krahasuar me speciet e tjera.

3.3 SFIDAT NGA FERMERËT PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMI PËR BUJQËSIN DHE ZHVILLIMIN RURAL.

Nga të dhënat statistikore, numri i aplikantëve me numrin e përfituesve, lind nevoja për identifikim të shkakut për përfitues 60 % më pak sesa numri i aplikimeve, për vitin 2013-2014-2015.

Tabela 2, Paraqet statistikatat aplikim –përfitues nga viti 2012-2015.

Viti	Aplikime Total	Përfitues Total
2012	239	233
2013	893	364
2014	1826	246
2015	56	7

Burimi: Të dhëna nga MBZHRAU, AZHBR

Për vitin 2013-2014, analiza e të dhënave si dhe intervista me ekspertë vërteton dy arsye kryesore, pamjaftueshmeri fondi si dhe vështirësi në plotësimin e dokumentacionit standart sipas kriterëve në udhëzim.

Për vitin 2015, Një hulumtim-intervista me ekspert viti 2015, mbi identifikimin e arsyes së numrit të ulët të përfituesve rezulton se arsye kryesore është paraqitur pamundësia nga fermerët për të plotësuar gjitha kushtet, në dokumentacion, siç përcakton Udhëzimi për vitin 2015. Rënia e numrit të përfituesve në vitin 2015, nuk ka ardhur si rezultat i stimulimit financiar por si pasojë e pamundësisë nga fermerët për të plotësuar kriteret e përcaktuara në udhëzim. Më konkretisht, nuk është siguruar fatura e shitjes (me kasë fiskale) së produkteve të BMA. Kjo dukuri vërteton një informalizim, përgjatë zinxhirit të vlerës, vërteton faktin se kontratat e shitjes ndërmjet prodhuesve dhe grumbulluesve janë akoma fiktive.

4. REZULTATET DHE REKOMANDIME

- Analiza përshkruese për BMA e zhvilluar deri më tani, ka nxjerre në pah disa dukuri mjaft interesante. Së pari, zbatimi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural është përmirësuar ndjeshëm vit pas viti nga 2012-2014, siç dëshmohej nga rritja e sipërfaqes së subvencionuar, si dhe e numrit të përfituesve. Eksperienca e krijuar në zbatimin e kësaj skeme tregon se ka thithur një pjesë të konsiderueshme të buxhetit nga fondi për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. ***Në këtë kuadër rekomandohet hartimi i kuadrit rregullator absolutisht të qartë dhe legjislacion mbrojtës mjedisor në mënyrë që të rregullojë grumbullimin si dhe marketingun për këtë sektor.***

- Për vitin 2015, mbi identifikimin e arsyes së numrit të ulët të përfituesve, intervista me ekspert rezulton: pamundësia nga fermerët për të plotësuar gjitha kushtet, në dokumentacion, siç përcakton Udhëzimi për këtë vit. Rënia e numrit të përfituesve në vitin 2015, nuk ka ardhur si rezultat i stimulimit financiar por si pasojë e pamundësisë nga fermerët për të plotësuar kriteret e përcaktuara në udhëzim. Më konkretisht, nuk është siguruar fatura e shitjes (me kasë fiskale) së produkteve të BMA. Kjo dukuri vërteton një informalizim, përgjatë zinxhirit të vlerës, vërteton faktin se kontratat e shitjes ndërmjet prodhuesve dhe grumbulluesve janë akoma fiktive. ***Në këtë kuadër rekomandohet rishikim i legjislacionit, duke vendosur standarte më të lehtësuara, për investimet në sektorin e bujqësisë, të paktën për një periudhë të caktuar kohe kur sektori bujqësisë të krijojë një terren më të qëndrueshëm.***

- Grumbullimi i bimëve mjeksore dhe aromatike të egra është një aktivitet i rëndësishëm dhe burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje në zonat rurale. ***Në këtë kuadër skemat e mbështetjes duhet të eksplorojnë për specie të reja të mbështetjes në BMA, si p.sh çaj mali etj, duke zgjeruar alternativën e kultivimi nga fermer.***

- Referuar rezultateve nga studime mbi tregtinë ndërkombëtare dhe eksportet, SHBA importon nga Shqipëria, 95 % të BMA, kryesisht sherebel, por vlerësimi nga cilësia, tregon se BMA-të nga Shqipëria renditen pas vendeve të ish-Jugosllavisë. ***Në këtë kuadër do rekomandohet që politika mbështetjes: Duhet të ngrej kapacitet e shërbimeve të ekstensionit apo përfshirje e trajnimeve nga specialist të fushës në kultivim, vjelje, grumbullimin e BMA. Si dhe në skemat e mbështetjes, përveç mbështetjes për sipërfaqe, në listen e shpenzimeve të ligjshme duhet të konsiderohet mbështetje edhe për Labororet për BMA.-Kjo për faktin se do bëjë të mundur një cilësi më të lartë për eksport BMA.***

- Megjithatë, analiza e deritanishme edhe pse në dukje pozitive nuk mjafton për të mbështetur tezen që; mbështetja me subvencion në sektorin e BMA kanë patur një impakt pozitiv. Kjo për shkak se nuk ka qenë e mundur krijimi i skenarit kundërfaktues, për të evidentuar faktin që investimet do të ishin kryer edhe në mungesë të parave publike. Vlen të theksohet, gjithsesi, që analiza e kryer deri më tani nuk ka marrë parasysh mundësinë e efektit të ashtuquajtur *spillover*. Si rrjedhim nuk mund të përjashtohet mundësia që efektet e këtij programi janë të nënvlerësuar pikërisht në saje të efekteve *spillover*.

LITERATURA

1. Assessing the Medical and Aromatic Plants in Albania, Center for International Development at Harvard University, 2014.
2. Baza ligjore për Pagesat Direkte në Bujqësi, viti (2012-2015).
3. Imami D., Leonetti L., Stefanllari A., The evolution of the Medicinal and Aromatic Plants Value Chain in Albania – Implications for Poverty Reduction and Rural Development, 2009, IFAMA.
4. Paul, Boban, Center for International development at Harvard University, July 18, 2014
5. <http://projects.iq.harvard.edu/albaniagroethlab/blog/taking-closer-look-albanian-agriculture>

6. Preka, O., Gecaj, M., Analize e efikasitetit të skemave mbështetëse të bujqësisë shqiptare, botim në Revisten "Ekonomia dhe Agrobizesi", 2013.
7. Skreli, E., Imami, D., Medical and Aromatic Plants, Mini-sector Study. Project "Preparation of Inter- sectorial strategy for agriculture and rural development in Albania", funded by the European Union and facilitated by the Food and Agriculture Organization of the UN through the project GCP/ALB/014/EC IPA 2009, February – June 2014.

SKEMAT MBËSHTETËSE NË BUJQËSI NË QARKUN E KORÇËS AGRICULTURE SUPPORT SCHEMES IN KORÇA REGION

DORJAN MARKU

Universiteti "Fan S. Noli"

Lagjia 3, Rr. "Sofokli Maliqari," KORÇË

E-mail: dorjanmarku@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Në vitet e fundit në Qarkun e Korçës, janë aplikuar skema financiare mbështetëse për zgjerimin e sipërfaqeve të mbjella me pemë frutore, vreshta dhe arrorë, me qëllim rritjen e prodhimit dhe cilësisë. Gjithashtu, financime të ndryshme janë kryer kryesisht në skemat ujitëse dhe kulluese të kësaj zone.

Studimi pasqyron në formë përmbledhëse një tablo të skemave mbështetëse direkte që janë aplikuar në Rajonin e Korçës në vitet e fundit, sa ka qënë numri i fermerëve që kanë përfituar, vlera e përfitimit, dhe sa është raporti në % midis fermerëve të cilët kanë aplikuar dhe atyre që kanë përfituar nga këto skema. Gjithashtu, ky studim u vjen në ndihmë fermerëve duke ju dhënë informacion në lidhje me kriteret konkurruese, mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi i aplikantëve, si dhe jep rekomandime të ndryshme në lidhje me problematikën e aplikimit të skemave mbështetëse në bujqësi, në Rajonin e Korçës.

Studimi është kryer mbi bazën e të dhënave zyrtare të mara nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë të Qarkut Korçë, si dhe duke u bazuar në një rishikim të hollësishëm të literaturës në dispozicion, në mënyrë që të përcaktohet qartësisht situata mbi skemat mbështetëse të aplikuar dhe efektet e aplikimit të tyre në zhvillimin bujqësor të rajonit.

Fjalët kyçe: bujqësi, Korçë, politika bujqësore, skema mbështetëse, zhvillim rural.

ABSTRACT

During the last years in Korca region have been applied agricultural financial support schemes in order to expand the planted area with orchard trees and vineyards in order to increase production and quality of agricultural products. As well, the region has benefited financial support that is mainly awarded for irrigation and drainage schemes.

The study summarizes a frame of the agricultural direct support schemes applied in Korca region, the number of farmers that have benefited from these schemes and total amount, followed by a comparison in % between those farmers who applied for agricultural support and those that benefited from them. In advance, the study can be very useful for farmers, providing them with the necessary information regarding the competitive criteria that have to be accomplished when applying for financial support, on the basis of which the evaluation process is done. It also gives recommendations in terms of the application process and other different issues related to agriculture support policies.

The research paper will be conducted based on official data collected from The Regional Directorate of Agriculture in Korca, followed by a detailed review of the available literature, in order to determine clearly the situation of the applied support schemes and its effects on the development of agriculture in the region.

Key words: agriculture, rural development, agriculture policies, support schemes, Korca

1. HYRJJE

Në mënyrë graduale objektivat e mbështetjes së bujqësisë kanë evoluar në përshtatje me sjelljen e shoqërisë kundrejt bujqësisë. Objektivi i të prodhuarit sasi të mëdha ushqimi me çmime të arsyeshme në mënyrë që të ushqehet popullsia urbane, është duke ardhur gjithmonë në rënie (Frank Van Tongeren 2008).

Në kohët e sotme objektivat kryesore të mbështetjes së bujqësisë nëpërmjet aplikimit të skemave kombëtare kanë ndryshuar. Ato mund të ndahen kryesisht në:

Objektiva kundrejt fermerëve;

- Realizimi i të ardhurave të mjaftueshme
- Reduktimi i ndryshueshmërisë së të ardhurave
- Përmirësimi i konkurrencës të sektorit bujqësor

Objektivat kundrejt konsumatorëve;

- Krijimi i kushteve për prodhimin e produkteve me cilësi dhe siguri të lartë (me çmime të arsyeshme)

Objektivat kundrejt shoqërisë si një e tërë;

- Të mbrojtë ambjentin dhe biodiversitetin
- Të kontribuojë në qëndrueshmërinë e zonave rurale

Bujqësia luan një rol mjaft të rëndësishëm në Qarkun e Korçës, si në aspektin ekonomik ashtu dhe në atë social, mbasi rreth 62% e popullsisë jeton në fshat, duke e bërë atë sektorin më të rëndësishëm në ekonominë e rajonit. Kjo vjen gjithashtu edhe për faktin se Korça zë vendin e dytë për nga sipërfaqja e tokës bujqësore në vend dhe ky sektor sjell rreth 32% të të ardhurave të përgjithshme të rajonit. Megjithatë rritja e bujqësisë është larg potencialeve reale, të cilat vijnë si pasojë e problemeve me të cilat përballet sektori, ku mbizotërojnë ato të lidhura me eksodin rural, sipërfaqen e kufizuar të fermave dhe pronësinë mbi tokën, marketingun e produkteve, ujitjen dhe kullimin, organizimin e dobët të fermerëve etj.

Një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e problemeve të përmendura më lart dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit luajnë dhe politikave mbështetëse të shtetit. Qëllimi kryesor i politikave mbështetëse është zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit bujqësor. Zhvillimi i qëndrueshëm bujqësor garanton ruajtjen dhe përmirësimin e kapaciteteve prodhuese, të ardhura të mjaftueshme për fermerët, punësim të qëndrueshëm, jetesë të denjë dhe përmbushjen e kërkesave ushqimore të brezit aktual.

Duke marrë si rast studimi Qarkun e Korçës, që nga periudha e tranzicionit dhe deri në ditët e sotme janë përdorur një numur i larmishëm i instrumentave politikë për mbështetjen financiare të bujqësisë. Ato grupohen në mbështetje financiare indirekte, e cila është fokusuar së tepërmi në mbështetjen e shërbimeve ndaj fermerëve, krijimin e një klime të favorshme për biznesin, forcimin institucional dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe mbështetja financiare publike direkte, e cila përfshin pagesa në formën e granteve që u jepen fermerëve nëpërmjet disa skemave të caktuara. Duke marrë shkas nga sa më lart, skemat e mbështetjes direkte në të cilën është fokusuar ky studim, përveç lehtësirave financiare që u krijohen fermerëve të rajonit të Korçës për zhvillimin e aktivitetit bujqësor, bëjnë në të njëjtën kohë aktive dhe një pjesë të kursimeve të tyre. Pagesat direkte garantojnë të ardhura të sigurta neto për fermerët, në formën e të ardhurave bazë, duke stabilizuar të ardhurat e tyre që vijnë nga shitjet në treg, meqënëse ato shpeshherë janë të paqëndrueshme.

Përgjithësisht deri në vitin 2007, politikave të mbështetjes për bujqësinë në rajonin e Korçës mund të cilësohen kryesisht si indirekte, nga ku identifikohen lehtësisht se investimet më të mëdha kanë shkuar për rehabilitimin e ujitjes dhe kullimit, rritjen e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit, tokën dhe shërbimet bujqësore.

Gjatë viteve të fundit në fermat e rajonit të Korçës vihen re përpjekje për të ndryshuar në strukturë, në mënyrën e prodhimit dhe të tregëtimit. Instrumentat financiare, kryesisht si ato të subvencionimit që janë quke u përdorur që prej vitit 2007 për zgjerimin e sipërfaqeve të mbjella dhe prodhimin më cilësor bujqësor janë duke dhënë efekte pozitive. Megjithatë, procesi i mbështetjes nga skemat kombëtare ende mbetet një proces me sfida dhe problematika të shumta.

Megjithë ridimensionimin e ri të politikave të mbështetjes direkte dhe efektet pozitive deri diku të këtyre politikave, ende procesi i mbështetjes direkte vazhdon të jetë mjaft kompleks

nga pikëpamja e organizimit, zbatimit dhe monitorimit, si dhe efektivitetit të sistemit të pagesave direkte që aplikohen, duke lënë vend për diskutime të gjera.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizojë performancën e mbështetjes financiare të skemave kombëtare për bujqësinë gjatë periudhës 2007 – 2013, në Qarkun e Korçës, si dhe evidentimi i problemeve kryesore në lidhje me aplikimin tyre.

Në kapitujt vijues të këtij punimi paraqitet në formë përmbledhëse si ka qënë performanca e mbështetjes nga skemat kombëtare që është aplikuar në vitet e fundit, sa ka qënë numri i përfituesve dhe vlera e përfitimit, si dhe pasqyrohen disa nga problematikat në lidhje me procesin e aplikimit të tyre.

2. MATERIALE DHE METODAT

Të dhënat kryesore të përdorura për arritjen e objektivave të studimit janë të dhëna primare, kryesisht raporte nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Korçë, AZHBR, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, INSTAT por edhe të dhëna sekundare, të cilat përfshijnë publikime të autorëve të ndryshëm, artikuj shkencorë dhe gazeta.


Metodat e përdorura për të arritur qëllimin kryesor të studimit janë metoda sasiore, nëpërmjet përpunimit dhe krahasimit të të dhënave të mbledhura nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë e Qarkut Korçë, si dhe metoda cilësore nëpërmjet studimit të autorëve të ndryshëm dhe literaturës.

3. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Mbas vitit 2007 dhe deri në ditët e sotme, në Qarkun e Korçës por edhe në gjithë vendin, skemat kombëtare të mbështetjes janë aplikuar duke kombinuar elementët e mbështetjes me investime dhe pagesa të drejtpërdrejta, për rritjen e prodhimit në disa nga sektorët më të rëndësishëm të Bujqësisë. Gjatë këtyre viteve mbështetja u është ofruar fermerëve nëpërmjet një shumëllojshmërie skemash vjetore, të cilat përfshijnë pagesa të drejtpërdrejta të kombinuara me skema investimesh. Sektorët që janë mbështetur me më shumë përparësi në rajonin e Korçës janë prodhimi i frutave, vreshtave dhe arrorëve nëpërmjet mbështetjes të mbjelljeve të reja të drufrutorëve, investime në sistemet e ujitjes, puse dhe investime në shtimin e fidanëve autoktonë.

Nga përpunimi i të dhënave statistikore, në grafikët e mëposhtëm pasqyrohet performanca e mbështetjes nga skemat kombëtare në Qarkun e Korçës, duke i ndarë ato sipas sektorëve që janë përmendur më lart.


Grafiku nr.1 Performanca e mbështetjes së pentarisë



Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Korçë

Nga përpunimi i të dhënave të marra nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë të Qarkut Korçë, në grafikon nr. 1, rezulton se për sektorin e pemtarisë niveli më i lartë i mbështetjes nga skemat kombëtare është arritur në vitin 2010. Në këtë vit kanë aplikuar për mbështetje nga skemat 447 fermerë dhe kanë përfituar 377 prej tyre, e përkthyer në % kanë përfituar rreth 84% e aplikuesve. Përsa i përket mbjelljeve të reja me drufrutorë niveli më i lartë është arritur në vitin 2008, duke kapur një sipërfaqe prej 217.3 Ha. Nga të dhënat e pasqyruara në grafikon nr.1, vihet re se niveli më i lartë i mbështetjes për këtë sektor rezulton të jetë viti 2012, nga ku kanë përfituar rreth 97 fermerë dhe mbjelljet e reja rezultojnë në nivelin 47.34 Ha.


Grafiku nr.2 Performanca e mbështetjes për vreshtarinë



Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Korçë

Në Grafikon nr.2 pasqyrohet performanca e mbështetjes nga skemat kombëtare për vreshtarinë, sipas të cilit rezulton se viti 2010 është viti më i mbështetur përsa i përket fermerëve që kanë përfituar por edhe sipërfaqes të mbjelljeve të reja, me rreth 14.1 Ha. Viti 2013 është viti me nivelin më të ulët të mbështetjes, sipas të cilit rezulton se kanë përfituar 10 fermerë dhe sipërfaqja e mbjelljeve të reja ka qënë 3.68 Ha.


Grafiku nr 3. Performanca e mbështetjes për sip.mbjellë me arra



Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Korçë

Në vitin 2011 ka filluar të aplikohet për herë të parë mbështetja nga skemat kombëtare për sipërfaqet e mbjella me arra, duke u vlerësuar si viti më i mirë krahasuar me vitet e tjera. Nga grafiku nr.3 vërehet se në këtë vit janë mbështetur 70 fermerë dhe sipërfaqja e mbjelljeve të reja rezulton të jetë 26.86 Ha.


Grafiku nr 4. Performanca e mbështetjes për sip.mbjellë me lajthi



Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Korçë

Përsa i përket mbjelljeve me lajthi, mbështetja nga skemat kombëtare në Qarkun e Korçës ka filluar të aplikohet për herë të parë në vitin 2012. Në grafikun nr. 4 vihet re se gjatë periudhës 2012-2013 kanë përfituar 17 fermerë dhe sipërfaqja e mbjelljeve të reja arrin rreth 10.5 Ha.

Grafiku nr 5. Performanca e mbështetjes për ujitjen me pika



Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Korçë

Në lidhje me sistemet e ujitjes, në grafikun nr.5 pasqyrohet mbështetja nga skemat kombëtare për ujitjen me pika nga ku vërehet se mbështetja më e madhe ka qënë në vitin 2010, me rreth 205 fermerë përfitues dhe sipërfaqe të përgjithshme të mbjelljeve 123.1 Ha. Viti 2011, rezulton si viti me mbështetje më të ulët përse i përket ujitjes me pika, me rreth 32 përfitues dhe një sipërfaqe prej 23.5 Ha.

Mbështetja nga skemat kombëtare e akorduar për periudhën 2008 – 2013 është karakterizuar nga luhajtje të mëdha vjetore, e cila pasqyrohet në tabelën nr 2.

Tabela nr 2. Përfitimi nga skemat kombëtare në Qarkun Korçë në 000 lekë

Viti	Pemtore	Vreshta	Ujitja me pika	Pus	Arra	Lajthi
2008	64,985	5,955	12,312	-	-	-
2009	51,242	5,635	13,440	2,100	-	-
2010	47,575	7,380	36,931	-	-	-
2011	22,403	2,603	6,990	-	9,086	-
2012	9,468	1,301	11,555	-	986	948
2013	25,019	920	-	-	2,114	1,143

Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Korçë

Nga tabela e mësipërme vihet re se niveli më i lartë i mbështetjes për pemtarinë në Qarkun e Korçës është regjistruar në vitin 2008 dhe arrin vlerën prej 64.9 milion lekë. Nga viti 2008 dhe deri në vitin 2013, në pemtari vihet re një luhatje buxhetore nga 64.9 milion lekë (2008) në 9.5 milion lekë (2012).

Në vreshtari mbështetja deri në vitin 2010 ka qënë stabël, duke arritur nivelin më të lartë në po këtë vit me rreth 7.4 milion lekë, ndërsa mbështetja më e ulët vërehet në vitin 2013 me rreth 920 mijë lekë.

Në lidhje me investimet dhe mbështetjen në sistemet e ujitjes, mbështetja më e lartë regjistrohet në vitin 2010, me rreth 36.9 milion lekë, ndërkohë që nga viti në vit numri i përfituesve është ulur ndjeshëm. Në vitin 2011 regjistrohet mbështetja më e ulët në vlerën prej 7 milion lekë.

Përsa i përket përfitimit për sipërfaqet e mbjella me arra dhe lajthi, mbështetja konsiderohet në vlera të ulëta, për shkak se mbjellja e këtyre kulturave në Qarkun e Korçës ka filluar të stimulohet vetëm në 2-3 vitet e fundit.

Në vitin 2014 filluan të aplikohen për herë të parë skemat e reja financiare të mbështetjes, të cilat janë të orientuara drejt mbështetjes të atyre fermerëve që dorëzojnë prodhimin në pikat e grumbullimit. Për tu theksuar është fakti se gjatë këtij viti në rajonin e Korçës numri i fermerëve që kanë përfitur nga kjo skemë e re është mjaft i ulët krahasuar me vitet e tjera, aq sa për sektorë të veçantë (vreshtari) vlera e akorduar për mbështetje nuk ka arritur as edhe për ata fermerë të klasifikuar si të parë.

Kriteret konkurruese dhe ato të vlerësimit të fermerëve të Qarkut të Korçës janë bazuar në udhëzimet që kanë dalë ç' do vit nga Ministria e Bujqësisë. Deri në vitin 2013 kriteret konkurruese dhe ato të vlerësimit kanë qënë pothuajse të njëjta duke pësuar pak ndryshime nga viti në vit. Përgjithësisht ato përfshijnë:

1. Statusin e aplikantit (Fermerë individualë/subjekte me status fizik apo juridik/SHBB)
2. Shtimin e sipërfaqes në bllok për specien që aplikohet
3. Sipërfaqja e tokës së mbjellë
4. Teknika e projektuar për ngritjen e pemtores, sistemet e ujitjes, lajthishtes, arrorëve.
- Sistemimi apo punimi i tokës, shpyllëzimi
- Masat antierozive/kulluese
- Mënyra e ujitjes

Ndërkohë që, për vitin 2014 dhe vitin 2015 kriteret e konkurimit dhe vlerësimit të fermerëve që aplikuan për skemat mbështetëse paraqiten si më poshtë, në varësi të skemës të aplikuar:

1. Sipërfaqja e tokës së mbjellë
2. Teknologjia e kultivimit
3. Kultivarët autoktonë/mënyra e kultivimit
4. Statusi i aplikantit
5. Përkatësia gjinore
6. Moshë e aplikantit

Disa nga problematikat e vërejtura gjatë këtij studimi në lidhje me aplikimin e skemave të mbështetjes kombëtare, që u evidentuan në Qarkun e Korçës janë:

1. Mungesa e partneritetit fermer – shtet ka bërë që për vite me radhë procedurat e pranimit dhe vlerësimit të projekteve të jenë të ngadalta, duke shtuar praktikat abuzuese.
2. Proçesi i tejzgjatur i aplikimit dhe vonesat burokratike të institucioneve të treta (psh vonesa në marrjen e kartelës së pasurisë) kanë bërë që një pjesë e mirë e fermerëve të skualifikohen nga proçesi.
3. Mos orientimi i mbështetjes financiare drejt rajonalizimit të prodhimeve ka bërë që parcelizimi i tokës bujqësore të jetë në nivele të dëshpëruara, duke u bërë pengesë për zhvillimin e sektorit bujqësor të rajonit.

4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Për periudhën 2008 – 2013, masat më të mbështetura në Qarkun e Korçës janë mbjellja e pemëve frutore, ujitja me pika dhe vreshtaria, ndërkohë që mbas vitit 2011 kanë filluar të mbështeten dhe masat për sipërfaqet e mbjella me arra dhe lajthi.
- Viti 2008 dhe 2010 rezultojnë vitet me nivelin më të lartë të mbështetjes nga skemat kombëtare, nga pikëpamja e sipërfaqes së mbjellë dhe vlerës së përfitimit.
- Në qarkun e Korçës gjatë periudhës 2008 – 2013, mbështetja nga skemat kombëtare ka pësuar luhate të ndjeshme dhe statistikat e vitit 2012 na bëjnë që të mendojmë se *“ndihma për fermerët nuk është vetëm çështje dëshire, por edhe çështje buxheti”*
- Objektivat e mbështetjes së bujqësisë sot nuk duhet të fokusohen vetëm në prodhimin e sasive të mëdha të ushqimit me çmime të arsyeshme, por ato duhet të orientohen drejt objektivave të fermerëve, konsumatorëve dhe shoqërisë.
- Mbështetja financiare duhet të bazohet në kushtet teknike, klimatike dhe avantazhet konkurruese të rajonit të Korçës, me qëllim rritjen e produktivitetit, cilësisë, por edhe zgjidhjen e problemit të parcelizimit të tokës.
- Në kuadër të formalizimit të sektorit bujqësor, duhen ofruar subvencione për fermerët që shesin prodhimet e tyre te tregëtarët duke faturuar sipas kërkesave fiskale.

5. REFERENCA

1. Agjencia per Zhvillim bujqësor dhe Rural. Skemat e Mbeshtetjes ne Bujqesi 2014.
2. Van Tongeren, F. (2008), "Agricultural Policy Design and Implementation: A Synthesis", OECD Food, Agriculture and Fisheries Working Papers, No. 7, OECD Publishing.
3. DRBUMK. Plani i Sektorit te Sherbimit Keshillimor – Korce 2014
4. MBUMK. Strategjia Sektoriale e Bujqesise dhe Ushqimit (SSBU) 2007 – 2013.
5. OECD'S Producer Support Estimate and Related Indicators of Agricultural Support. Concepts, Calculations, Interpretation and Use. (The PSE Manual). September 2010.
6. BE-Shqiperi Nenkomiteti mbi Bujqesine dhe Peshkimin. Shkurt 2013.
7. INSTAT. Statistikat e Bujqësisë 2014.

**ZHVILLIMI I AGROINDUSTRIË, NJË PRIORITET NË POLITIKAT
BUJQËSORE TË VENDIT
DEVELOPMENT OF AGRO INDUSTRY, A PRIORITY IN THE COUNTRY'S
AGRICULTURAL POLICIES**

MARIANA NIKOLLA¹, ELFRIDA DISHMEMA^{2*}, BLERTA KRISTO³

¹Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

²Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

³Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Universiteti Politeknik i Tiranës,
Tiranë, Shqipëri

*E-mail: elfridadishmema@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Kalimi nga prodhimi i zakonshëm në prodhimin me standarde të larta është sfida e madhe e bujqësisë shqiptare sot dhe në të ardhmen. Prodhimi bujqësor zë 17.3% të GDP nga i cili prodhimi blegtoral zë rreth 52% të tij. Duke ju referuar zhvillimit të blegtorisë në vite shihet se ka një stabilitet në numrin e krerëve, por ka rritje të prodhimeve të produkteve blegtorale.

Një nga politikat strategjike të MBUMK-së është dhe nxitja e sektorit të agroindustrisë.

Industria agroushqimore ka një zhvillim gradual dhe të qëndrueshëm në vitet e fundit duke siguruar një rritje mesatare vjetore në masën mbi 12%. Gjatë vitit 2012 kemi patur rritje të numrit të ndërmarrjeve agropërpunuese, sidomos në sektorët e konservave, fruta perime, prodhimi i vajit dhe yndyrave të rafinuara, prodhimi i biskotave, prodhimi i ujit mineral dhe pijeve freskuese. Në këtë studim u përdor modeli matematikor DEA për të analizuar efikasitetin e ndërmarrjeve të rajoneve të Shqipërisë në prodhimin e produkteve blegtorale të përpunuara.

Ky model mbështetet në metodën e programimit linear dhe jo vetëm analizon efikasitetin, por përdoret njëkohësisht për përmirësimin e ekonomive joeficiente. Analiza e bërë tregoi që, rajoni i Lezhës ka efikasitet DEA më të vogël (24%) në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë. Ndërkohë që rajone të tilla si: Korçë, Gjirokastrë etj. rezultuan eficientë në industrinë e përpunimit të produkteve blegtorale. Analiza të tilla mund të shtrihen edhe në fusha të tjera të ekonomisë dhe të prodhimit bujqësor dhe blegtoral.

Fjalë kyç: *efikasitet, modeli DEA, produkte blegtorale, rajonet e Shqipërisë, shpenzime.*

ABSTRACT

The transition from ordinary production in production with high standards is the challenge of the albanian agriculture today and in the future. Agricultural production occupies 17.3% of GDP from which livestock production accounts for about 52% of it. Referring to livestock development over the years it is shown that there is a stability in the number of leaders, but is increased the production of livestock products. One of the strategic policies of the Ministry of Agriculture is also promoting agro-industry sector. Agro-food industry has a gradual and steady development in recent years providing an average annual increase of above 12%. During 2012 we have seen an increase in the number of agro-processing enterprises, especially in the sectors of conserves, fruit and vegetables, production of oil and refined fats, the production of biscuits, mineral water production and refreshments. In this study is used mathematical DEA model to analyze the efficiency of enterprises albanian regions in the production of processed dairy products. This model is based on linear programming method and not only analyzes the efficiency but also is used to improve the inefficient economies. Analysis showed that the region of Lezha has the smallest DEA efficiency (24%) in comparison with other regions of Albania. While regions such as Korca, Gjirokastra etc.

resulted efficient in the processing industry of dairy products. Such analysis could be extended to other areas of economic and agricultural and livestock production.

Key words: costs, DEA model, efficiency, livestock products, regions of Albania

1. HYRJE

Agroindustria përbën një ndër sektorët që ka potenciale të mëdha zhvillimi në ditët e sotme. Ajo ndikon ndjeshëm në strukturën ekonomike të vendit. Njohja e politikave të zhvillimit bujqësor, e standarteve dhe mjeteve të nevojshme për të përballuar kostot është një domosdoshmëri në kushtet e sotme të globalizimit. Një nga zhvillimet e rëndësishme në sektorin e agroindustrisë është përpunimi i produkteve blegtorale. Nga blegtoria merren produkte të çmuara ushqimore, mish, qumësht, vezë, mjaltë etj. Blegtoria ka qënë dhe mbetet një ndër sektorët më të rëndësishëm në ecurinë ekonomike dhe sociale të vendit tonë. Prodhimi i mishit peshë e gjallë ka rritje nga viti në vit me rreth 2 %. Struktura e prodhimit të mishit është: gjedhi 46 %, të leshtat 32 %, derri 11 % dhe shpendët me 11 %. (referuar vitit 2013).

Rajonet me prodhim më të lartë janë: Fieri me 15.2 % dhe Elbasani me 12 %.

Rajoni me prodhimin më të ulët është Gjirokastra dhe Durrësi me 4.9 % ndaj totalit të përgjithshëm të prodhimit. Prodhimi i qumështit ka rritje në vite nga 1 deri në 2 %. Struktura e prodhimit të qumështit është: qumësht lope 86%, qumësht dele 7%, qumësht dhie 7% (referuar vitit 2013). Referuar vitit 2013 rajonet me prodhim më të lartë janë: Vlora me 20 %, Fieri me 14 % dhe Elbasani me 13 %. Rajoni me prodhimin më të ulët është Lezha me 1.6 % ndaj totalit të përgjithshëm. Prodhimi i vezëve në vitin 2013 ka patur ulje me 7% ndaj vitit 2012.

Rajoni me prodhimin më të lartë në vite është Durrësi 34 % ndaj prodhimit të përgjithshëm (referuar vitit 2013) dhe rajoni me prodhim më të ulët është Kukësi me 1.5 % ndaj totalit të përgjithshëm të prodhimit. Në prodhimin e mjaltit ka një qëndrueshmëri. Rajoni që ka prodhimin më të lartë është Vlora me 18 % dhe Korça me 16.8 % të prodhimit total. Rajoni me prodhimin me të ulët është Dibra me 3.9 % dhe Lezha me 3.6 % ndaj totalit të përgjithshëm të prodhimit.

Të dhënat e lartpërmendura janë pasqyruar me anë të tabelës nr 1.


Në grafikët nr 1 dhe nr 2 tregohen tendencat në sasi dhe në vite të produkteve kryesore blegtorale.

Tabela nr 1. Përpunimi i produkteve kryesore blegtorale 2009-2013

Vitet	Qarqet													
	Shqipëria	Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlojë	
2009	Qumësht	68.163	1.720	0	4.996	0	14.620	0	1.505	0	0	2.201	42.686	435
	Djathë	523	25	0	51	37	150	8	109	0	4	25	51	63
	Gjalpë	12.887	1.089	12	333	805	2.173	782	1.712	0	525	2.629	477	2.340
	Kos	7.311	422	132	148	321	3.167	22	565	0	192	1.058	1.234	50
2010	Qumësht	100.750	8.630	0	4.574	66	21.640	782	7.239	0	0	1.257	56.562	0
	Djathë	680	52	0	41	40	144	6	146	0	0	26	105	120
	Gjalpë	13.527	993	41	412	314	1.969	875	2.544	0	1.564	2.485	123	2.207
	Kos	10.141	2.127	0	301	92	4.331	150	621	0	508	690	1.321	0
2011	Qumësht	93.601	2.430	0	225	374	12.318	0	1.400	0	0	1.185	75.669	0
	Djathë	12.340	1.381	26	559	375	2.273	567	774	0	808	3.130	549	1.898
	Gjalpë	672	162	0	10	29	122	17	28	0	0	24	173	107
	Kos	10.338	2.079	139	255	39	4.110	160	681	37	63	896	1.544	335
2012	Qumësht	98.516	2.300	0	41.396	0	8.282	0	1.661	0	0	1.106	43.773	0
	Djathë	12.980	2.244	63	564	694	2.828	651	888	0	317	2.189	868	1.674
	Gjalpë	732	42	0	184	45	145	35	28	0	0	23	121	109
	Kos	7.564	546	0	356	944	1.623	164	504	12	24	702	2.547	142
2013	Qumësht	116.971	2.900	0	49.320	0	10.600	11.241	0	0	0	1.296	41.614	0
	Djathë	12.480	2.780	10	229	1.027	2.708	778	652	0	283	2.056	699	1.258
	Gjalpë	597	156	0	24	44	147	22	42	0	0	24	107	31
	Kos	7.765	412	116	578	304	2.674	61	417	33	0	708	2.434	29


Burimi: Vrojtimi Vjetor, Ministria e Bujqësisë

Grafiku nr 1. Prodhime blegtorale



Burimi: Vrojtimi Vjetor, Ministria e Bujqësisë

Grafiku nr 2. Përpunimi i produkteve kryesore blegtorale



Burimi: Vrojtimi Vjetor, Ministria e Bujqësisë

Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i rajoneve eficiente të Republikës në lidhje me produktet blegtorale të përpunuara. Rezultatet e marra nga analiza e bërë japin një tablo orientuese dhe të vlefshme në zhvillimin e industrisë agropërpunuese në vendin tonë. Ky punim është një kontribut shtesë në analizat shkencore në sektorin blegtoral.

2. MATERIALI DHE METODA

Studimi i ndërmarrë synon të evidentojë rajonet eficientë dhe joeficientë të Shqipërisë, në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet për produktet blegtorale të përpunuara. Në funksion të realizimit të studimit u përdorën metodat matematikore, të cilat dhanë një rezultat të shpejtë dhe efektiv të zgjidhjes së problemit. U përdor model i matematikor, joparametrik DEA, i bazuar në metodën e programimit linear (rasti 1 outpute, 5 inpute).

Outputi: Të ardhurat (000/lekë)

Inputet e përdorura: Shpenzimet për ushqime, shpenzimet për shërbime veterinarë, shpenzimet për medikamente, shpenzimet për transport dhe shpenzime të tjera (000/lekë).

Ky studim u mbështet në rishikimin e literaturave relevante, përdorimin e rezultateve të studimeve të tjera dhe raporteve të tyre statistikore. Citimi i referencave për burimet e informacionit të përdorur, kërkimi i informacioneve relevante të publikuara nga institucione si Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes Konsumatorit, si dhe analiza e të dhënave dytësore të marra nga këto institucione për periudhën 2009-2015 do të kontribuojnë për realizimin e qëllimit të studimit. Rezultatet e analizës korrelative dhe regresive paraqiten në tabelën nr 2.

Tabela nr 2. Rezultatet e analizës korrelative

	<i>Të ardhurat për fermë</i>	<i>Shpenzime për ushqime</i>	<i>Shpenzime për shërbime veterinare</i>	<i>Shpenzime për medikamente</i>	<i>Shpenzime transporti</i>	<i>Shpenzime të tjera</i>
<i>Të ardhurat për fermë</i>	1					
<i>Shpenzime për ushqime</i>	0.061	1				
<i>Shpenzime për shërbime veterinare</i>	-0.242	0.317	1			
<i>Shpenzime për medikamente</i>	-0.062	0.347	0.803	1		
<i>Shpenzime transporti</i>	0.014	0.484	0.678	0.776	1	
<i>Shpenzime të tjera</i>	0.285	0.282	0.178	0.388	0.177	1

Burimi: Rezultate të përfutuara nga autorët

Analiza korrelative, tregon shkallën e ndikimit të faktorëve të marrë në studim.

Koeficienti i përgjithshëm i korrelacionit $R^2=91.8\%$ tregon lidhjen e konsiderueshme ndërmjet të ardhurave dhe faktorëve të tjerë të marrë në këtë studim. $R \approx 0.96$ është një rezultat afër njëshit, e cila tregon se shkalla e varësisë ndërmjet output-it dhe inputeve është e madhe.

Sipas modelit DEA, efënca e njësisë që do të vlerësohet jepet me raportin:

$$h_0(\mu, v) = \frac{\text{shuma e outputeve të peshuara të njësisë në studim}}{\text{shuma e inputeve të peshuara të njësisë në studim}} = \frac{\sum_{r=1}^s y_{r0} \times \mu_r}{\sum_{i=1}^m x_{i0} \times v_i}$$

Ku μ_r është pesha (proporcioni) e outputit r dhe v_i është pesha (proporcioni) e inputit i ($i = 1,2,3, \dots, m$). Sipas modelit Charnes-Coope ($r = 1,2,3, \dots, s$) r-Rhodes (CCR) të DEA-s, μ_r dhe v_i trajtohen si variabla të panjohur. Modeli DEA cakton peshat e outputeve dhe inputeve të cilat zgjidhen në funksion të maksimizimit të outputeve duke përdorur sasi më të vogla inputesh.

Përcaktimi i objektivit:

$$\text{Max: } \sum_{r=1}^s y_{r0} \times \mu_r$$

Nëse h_0 është më i vogël se 1, njësia në studim është relativisht joeficiente. Zgjidhja e problemit me metodën e PL cakton peshat më të mira të mundshme për njësinë në studim.

Përcaktimi i kufizimeve:

Efënca e njësisë në studim nuk mund të jetë më e madhe se 100%. Shuma e peshave të outputeve të kësaj njësie të jetë më e vogël ose e barabartë me shumën e peshave të inputeve të saj (raporti i outputeve të peshuara me inputet e peshuara nuk e kalon 100%)

Kufizimi i parë:

$$\frac{\sum_{r=1}^s y_{r0} \mu_r}{\sum_{i=1}^m x_{i0} v_i} \leq 1 \quad \text{ose} \quad \sum_{r=1}^s y_{r0} \mu_r - \sum_{i=1}^m x_{i0} v_i \leq 0$$

Këto kufizime vendosen për të gjitha njësitë në studim.

Tabela nr 3. Analiza e efijencës DEA për qarkun e Lezhës

1	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L
2	Unit	Region	Output1	Input1	Input2	Input3	Input4	Input5	Weights	Weights	Diference	Efficiency
3	Nr.	Qarku	Të ardhurat për fermë	Shpenzime për ushqime	Shpenzime për shërbime veterinare	Shpenzime për medikamente	Shpenzime transporti	Shpenzime të tjera	Output	Inputs	≤ 0	Dea %
4	1	Berat	148669	122646	82491	88153	9489	10833	0.38	0.65	-0.27	58.3
5	2	Dibër	134805	251353	56737	23469	6516	18340	0.35	1.18	-0.83	44.5
6	3	Gjirokastrë	364888	87036	23777	19776	7912	19050	0.93	0.93	0.00	100
7	4	Lezhë	93663	109311	43627	61039	9510	19729	0.24	1.00	-0.76	24
8	5	Kukës	194128	208309	15099	18629	8389	6815	0.50	0.63	-0.13	100
9	6	Tiranë	174681	300022	82030	72271	19909	16821	0.45	1.20	-0.75	37.6
10	7	Vlorë	257593	303120	82895	133929	22525	30139	0.66	1.75	-1.09	37.7
11	8	Durrës	156196	40517	68616	62883	18318	21971	0.40	0.98	-0.58	82.8
12	9	Korçë	222520	271314	54560	43164	4210	38581	0.57	2.05	-1.48	100
13	10	Shkodër	161869	244591	70045	35071	14349	156	0.41	0.41	0.00	100
14	11	Elbasan	163298	71436	114642	81524	10357	14341	0.42	0.71	-0.30	58.6
15	12	Fier	192410	377277	135940	135362	31044	27286	0.49	1.76	-1.27	28
16	Weights		2.56E-06	1.7E-06	0	0	0	4.1E-05				
18	Unit	4	Max: C19									
19	Output	0.240	Ndryshoret: C16:H16									
20	Input	1	Kushtet: C16:H16≥0									
			K3:K14≤0									
			C20=1									

Burimi: Rezultate të përftuara nga autorët

Duke përdorur modelin DEA, jo vetëm u analizua efijenca e rajoneve të Republikës lidhur me të ardhurat nga produktet blegtorale të përpunuara, por u tregua edhe përmirësimi i efijencës së qarqeve joefijente. Tabela nr 5 ilustron shembullin e një njësie të përbërë, e cila vepron në mënyrën më të mirë të mundshme dhe ka efijencë më të lartë se njësia 4.

Për gjetjen e kompozimit (njësisë së përbërë) janë ndjekur këto hapa:

1. Zgjidhim problemin DEA për njësinë në studim (tabela nr 3).
2. Në kutinë e dialogut Solver Results, selektojmë opsionin Sensitivity Report (tabela nr 4).

Tabela nr 4. Analiza e ndjeshmërisë për rajonin e Lezhës.

Cell	Name	Final Value	Reduced Cost	Objective Coefficient	Allowable Increase	Allowable Decrease
\$C\$16	Weights Të ardhurat për fermë	2.6E-06	0.00E+00	93663	1E+30	93663
\$D\$16	Weights Shpenzime për ushqime	1.7E-06	0.00E+00	0	4752.08	786.3554594
\$E\$16	Weights Shpenzime për shërbime veterinare	0	-3.24E+03	0	3241.66	1E+30
\$F\$16	Weights Shpenzime për medikamente	0	-9.07E+03	0	9072.46	1E+30
\$G\$16	Weights Shpenzime transporti	0.00	+4.63E+01	0	46.31	1E+30
\$H\$16	Weights Shpenzime të tjera	4.1441E-05	0.00E+00	0	25453.57	297.3866326

Cell	Name	Final Value	Shadow Price	Constraint R.H. Side	Allowable Increase	Allowable Decrease
\$C\$20	Input Të ardhurat për fermë	1	0.240	1	1.0E+30	1
\$K\$4	Dibër ≤ 0	-0.83	0.00	0	1.0E+30	0.834
\$K\$5	Gjirokastrë ≤ 0	0.00	0.25	0	6.2E-01	0.948
\$K\$6	Lezhë ≤ 0	-0.76	0.00	0	1.0E+30	0.760
\$K\$7	Kukës ≤ 0	-0.13	0.00	0	1.0E+30	0.133
\$K\$8	Tiranë ≤ 0	-0.75	0.00	0	1.0E+30	0.750
\$K\$9	Vlorë ≤ 0	-1.09	0.00	0	1.0E+30	1.095
\$K\$10	Durrës ≤ 0	-0.58	0.00	0	1.0E+30	0.578
\$K\$11	Korçë ≤ 0	-1.48	0.00	0	1.0E+30	1.482
\$K\$12	Shkodër ≤ 0	0.00	0.02	0	1.9E-01	1.884
\$K\$13	Elbasan ≤ 0	-0.30	0.00	0	1.0E+30	0.295
\$K\$14	Fier ≤ 0	-1.27	0.00	0	1.0E+30	1.267

Burimi: Rezultate të përfutuara nga autorët

Në tabelën nr 4 jepet mesatarja e peshave rreth 2% për njësinë 10 (Shkodër), i shtohet 25% pesha e njësisë 3(Gjirokastrë), të cilat formojnë njësinë e përbërë. Vlera absolute e çmimeve hije (kolona Shadow Prices), janë peshat e njësisë së përbërë, e cila rezulton më efiçente se njësia në studim (rajoni Lezhë). Kjo njësi prodhon të njëjtin output me atë të njësisë 4, duke kërkuar sasi më të vogël ose të barabartë inputesh me ato të përdorura nga kjo njësi (tabela nr 5)

Tabela nr 5. Inputet shtesë të përdorura për njësinë në studim

	A	B	C	D	E	F	G	H	I
1	Unit	Region	Output1	Input1	Input2	Input3	Input4	Input5	Weights
2	Nr.	Qarku	Të ardhurat për fermë	Shpenzime për ushqime	Shpenzime për shërbime veterinare	Shpenzime për medikamente	Shpenzime transporti	Shpenzime të tjera	Value
3	1	Berat	148669	122646	82491	88153	9489	10833	0.00
4	2	Dibër	134805	251353	56737	23469	6516	18340	0.00
5	3	Gjirokastrë	364888	87036	23777	19776	7912	19050	0.25
6	4	Lezhë	93663	109311	43627	61039	9510	19729	0.00
7	5	Kukës	194128	208309	15099	18629	8389	6815	0.00
8	6	Tiranë	174681	300022	82030	72271	19909	16821	0.00
9	7	Vlorë	257593	303120	82895	133929	22525	30139	0.00
10	8	Durrës	156196	40517	68616	62883	18318	21971	0.00
11	9	Korçë	222520	271314	54560	43164	4210	38581	0.00
12	10	Shkodër	161869	244591	70045	35071	14349	156	0.02
13	11	Elbasan	163298	71436	114642	81524	10357	14341	0.00
14	12	Fier	192410	377277	135940	135362	31044	27286	0.00
15									
16	Vlerat e kompozimit		93663	26226	7226	5572	2235	4733	
17	Inputet shtesë		0	83085	36401	55467	7275	14996	
18	të përdorura								

Burimi: Rezultate të përfutuara nga autorët

Përmirësimi i efijencës DEA për rajonin e Lezhës, me peshat e gjetura nga Solveri, është treguar në tabelën nr 6. Me gjetjen e vlerave të kompozimit (njësia e përbërë e lartpërmendur) tregohet që, rajoni Lezhë ka efijencë DEA (100%) dhe ka gjetur rrugën më të mirë të mundshme të përdorimit të inputeve.

Tabela nr 6. Përmirësimi i efijencës DEA për qarkun e Lezhës

1	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L
2	Unit	Region	Output1	Input1	Input2	Input3	Input4	Input5	Weights	Weights	Diference	Efficiency
3	Nr.	Qarku	Të ardhurat për fermë	Shpenzime për ushqime	Shpenzime për shërbime veterinare	Shpenzime për medikamente	Shpenzime transporti	Shpenzime të tjera	Output	Inputs	≤ 0	Dea %
4	1	Berat	148669	122646	82491	88153	9489	10833	1.59	2.72	-1.14	58.3
5	2	Dibër	134805	251353	56737	23469	6516	18340	1.44	4.92	-3.48	44.5
6	3	Gjirokastër	364888	87036	23777	19776	7912	19050	3.90	3.90	0.00	100
7	4	Lezhë	93663	26226	7226	5572	2235	4733	1.00	1.00	0.00	100
8	5	Kukës	194128	208309	15099	18629	8389	6815	2.07	2.63	-0.55	100
9	6	Tiranë	174681	300022	82030	72271	19909	16821	1.86	4.99	-3.13	37.6
10	7	Vlorë	257593	303120	82895	133929	22525	30139	2.75	7.31	-4.56	37.7
11	8	Durrës	156196	40517	68616	62883	18318	21971	1.67	4.08	-2.41	82.8
12	9	Korçë	222520	271314	54560	43164	4210	38581	2.38	8.55	-6.18	100
13	10	Shkodër	161869	244591	70045	35071	14349	156	1.73	1.73	0.00	100
14	11	Elbasan	163298	71436	114642	81524	10357	14341	1.74	2.97	-1.23	58.6
15	12	Fier	192410	377277	135940	135362	31044	27286	2.05	7.34	-5.28	28
16	Weights		1.07E-05	7.0E-06	0	0	0	0.000173				
17	Unit		4	Max: C19								
18	Output		1.000	Ndryshoret: C16:H16								
19	Input		1	Kushtet: C16:H16<0								
20				K3:K14<0								
21				C20=1								
22												
23												

Burimi: Rezultate të përfutuara nga autorët

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Në vitet e fundit industria agrorshqimore ka një zhvillim gradual dhe të qëndrueshëm duke siguruar një rritje mesatare vjetore në masën mbi 12%. Gjatë vitit 2012 kemi pasur rritje të numrit të ndërmarrjeve agropërpunuese, sidomos në sektorët e konservave, fruta perime, prodhimi i vajit dhe yndyrnave të rafinuara, prodhimi i biskotave, prodhimi i ujit mineral dhe pijeve freskuese.
- Në këtë punim u analizua efijenca e fermave blegtorale të vendit në lidhje me produktet blegtorale të përpunuara. Për të realizuar qëllimin e studimit u përdor modeli matematikor joparametrik DEA. Analiza e lartpërmendur tregoi që: Gjirokastra, Korca, Shkodra dhe qarku i Kukësit janë efijente sipas DEA-s (100%), ndërsa njësitë e tjera janë më pak efijente në prodhimin e produkteve blegtorale të përpunuara. Për njësitë joefijente, ekziston një kombinim linear i njësive efijente që rezultojnë një njësi e përbërë, e cila prodhon të paktën të njëjtin output duke përdorur të njëjtat ose më pak inpute se njësia joefijente.
- Konkretisht, për rajonin e Lezhës i cili nga analiza konkludoi rajoni më pak efijent, për të marrë të njëjtat të ardhura nga produktet blegtorale të përpunuara, duhet të pakësohen shpenzimet për ushqime rreth 38085(mijë lekë), për shërbime veteriare 36401(mijë lekë), për medikamente 55467(mijë lekë), për transport 7275(mijë lekë) dhe për shpenzime të tjera 14996 (mijë lekë). Me këtë reduktim të shpenzimeve, rajoni i Lezhës rezultojnë me efijencë DEA 100%. Këto konkluzione janë ilustruar me figura të punuara në spridshitet e programi Excel duke dhënë një tablo të qartë të studimit të ndërmarrë. Kjo metodë mund të përdoret me efikasitet për të bërë analiza të ngjashme, në zgjidhjen e problemeve të ndryshme që hasen në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe prodhimit.

5. LITERATURA

1. A.I.Ali, Computational aspects of DEA, in A. Charnes, W.W.Cooper, A.Lewin, and L.M.Seiford, eds., Data Envelopment Analysis: Theory, Methodology and Applications, Kluwer Academic Publishers, Boston, 1994, 63-88.
companies. European Journal of Operational Research. Vol. 123, No.1, 105-124.
2. Cooper, W.W., Seiford, L.M. and Zhu, J., Data Envelopment Analysis: History, Models and Interpretations, in Handbook on Data Envelopment Analysis, eds W.W. Cooper, L.M. Seiford and J. Zhu, Issue 1, Kluwer Academic Publishers, 2004, 1-39
3. Fitzsimmons, J.A. and Fitzsimmons, M.J. (2006). Service Management. Issue 3, Supplement on DEA, McGraw-Hill.
4. INSTAT 2015, Vjetari Statistikor Rajonal.
5. K.J.Arrow, George Dantzing in the development of economic analysis, Discrete Optim., 5(2008), 159- 167.
6. M.Nikolla, M.Meço, E.Ozuni, M.Belegu. "Some alternatives of improvement the Agricultural Production Efficiency in Albania". BALWOIS 2012 Proceedings, International Scientific Conference on Water, Climate and Environment- Ohrid, Republic of Macedonia, 2 June, 2012, 1-12. Proceedings
7. Mikulas Luptacik. Mathematical Optimization and Economic Analysis. Vol. 36, Issue 5, 2009, 136-184.
8. Ragsdale, C.T. Spreadsheet Modeling and Decision Analysis, 5th Edition. South-Western, Thomson, 2008.
9. Sharma, K.R., Leung, P.S. and Zane, L. "Performance measurement of Hawaii state public libraries: An application of data envelopment analysis (DEA)," Agricultural and Resource Economics Review, 1999, Vol.28, No.2, 190-198.
10. W.W.Cooper, L. M. Seiford, and K. Tone. Data Envelopment Analysis: A Comprehensive Text with Models, Applications, References, and DEA- Solver Software, vol.2, Springer, New York, 2007.
11. Zhu, J., Multi-factor performance measure model with an application to Fortune 500 companies. European Journal of Operational Research, 2000, Vol. 123, No.1, 105-124.

PERCEPTIMI I KONSUMATORËVE NË KOSOVË PËR ATRIBUTET E SIGURISË SË USHQIMIT

THE KOSOVO CONSUMER PERCEPTION OF FOOD SAFETY ATTRIBUTES XHEVAT SOPI*, ENJELL SKRELI*, DRINI IMAMI*

*Fakulteti i Ekonomisë & Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

**Fakulteti Ekonomik, Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan, Kosovë

Komunikimi: xhsopi@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Shqetësimet për sigurinë e ushqimit po rriten çdo ditë e më shumë, jo vetëm në vendet e zhvilluar dhe në zhvillim. Hulumtime të ndryshme kanë gjetur që konsumatorët, sidomos në vendet e në zhvillim dhe ato të pazhvilluara, i ngatërrojnë atributet e sigurisë së ushqimit me ato të cilësisë, Kështu rezulton që mbi bazën e vlerësimit të attributeve të cilësisë ata të krijojnë edhe besimin për sigurinë.

Qëllimi i këtij punimi është të përcaktojmë se: (i) a i kanë të qarta konsumatorët e bulmetit në Kosovë dallimet mes attributeve të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit; (ii) cili është vlerësimi i tyre për sigurinë e ushqimit; dhe (iii) çfarë implikimesh prodhojnë të gjeturat. Po ashtu, përmes modelit logit binary do të testohet ndikimi i faktorëve socio-demografik, në qartësinë e dallimit mes këtyre dy lloj attributesh.

Rezultatet dalin nga një vëzhgim i realizuar me 303 konsumatorë të rrjetit të supermarketeve Viva Fresh Store, të cilët janë intervistuar në momentin e blerjes, brenda supermarketit.

Vëzhgimi është realizuar nga 1 prill deri 5 maj 2015, në tri qytete, të cilat përfaqësojnë tri grupe të qyteteve sipas numrit të banorëve të Kosovës, që janë Prishtina me mbi 100 mijë banorë, Gjilani me 50-100 mijë banorë dhe Viti me më pak se 50 mijë banorë.

Fjalë kyçe: siguria e ushqimit, atributet e cilësisë, faktorët socio-demografik, modeli logit binary

ABSTRACT

Concerns about food safety are growing every day more and more, not only in developed and developing countries. The different researchers have found that consumers, especially in developing countries and underdeveloped, are confused with the safety attributes with quality attributes. Thus, on the basis of quality assessment attributes they create the trust for food safety.

The purpose of this paper is to determine: (i) Does the Kosovo dairy consumers are clear about differences between the attributes of food safety and quality; (ii) what is their assessment of food safety; and (iii) what implications produce the findings? Also, through binary logit model, will test the impact of socio-demographic factors, to the clarity of the distinction between these two types of attributes.

The results come from a survey conducted with 303 customers Viva Fresh Store supermarket network, who were interviewed at the time of purchase, inside the supermarket. The survey was conducted from April 1 to May 5, 2015, in three cities, which represent three groups of cities by number of inhabitants, which include Prishtina, with over 100 thousand inhabitants, Gjilan in the group with 50-100 thousand inhabitants and Viti with less than 50 thousand residents.

Key words: Food safety, quality attributes, socio-demographic factors, binary logit model

HYRJE

Shqetësimet për sigurinë e ushqimit po rriten çdo ditë e më shumë, jo vetëm në vendet e zhvilluar dhe në zhvillim. Hulumtime te ndryshme kanë gjetur që konsumatorët kanë konfuzion për sa i përket perceptimit për konceptin siguri e ushqimit, i cili ende mbetet i paqartë për shkak të keqinterpretimit dhe interferimit të konceptit të cilësisë (Jabbar, Baker, & Fadiga, 2010). Ky konfuzion bënë që konsumatorët t'i japin rëndësi të lartë sigurisë së ushqimit edhe pse ata përdorin të njëjtit attribute në definimin e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit (Kealesitse & Kabama, 2012).

Konfuzioni i koncepteve cilësi dhe siguri e ushqimit, evidentohet më shumë të vendet në zhvillim se sa te ato të zhvilluara, për shkak se për dallim nga këto të fundit, në vendet në zhvillim konsumatorët janë pak të ekspozuar ndaj informacioneve dhe kështu kanë më pak njohuri për hazardet dhe rrezikun në zgjedhjen e ushqimit (Zhllima, Imami, & Canavari, 2015).

Kur këtyre konstatimeve u shtohet fakti se Kosova është një shtet i ri në fazë të konsolidimit të institucioneve shtetërore të cilat nuk kanë kapacitete dhe ekspertizë të dëshiruar, si dhe faktit që në opinionin publik dominojnë temat politike dhe fare pak flitet në media për sigurinë e ushqimit, atëherë, gjendja nuk premtion të jetë më e kënaqshme.

Megjithëkëtë edhe në Kosovë ekziston një shkallë e konsiderueshme e shqetësimit në aspektin e sigurisë së ushqimit (Canavari, Imami, Gjonbalaj, & Alishani, 2014). Sipas këtij studimi 2/3 e konsumatorëve të intervistuar deklarojnë të jenë mjaft të shqetësuar.

Objektivi kryesor i këtij punimi është të përcaktojmë se a i kanë të qarta konsumatorët e bulmetit në Kosove dallimet mes attributeve të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit dhe të testohet ndikimi i faktorëve socio-demografik, në qartësinë e dallimit mes këtyre dy lloj attributesh.

Objektiv dytësor është të matet se cili është vlerësimi i tyre për sigurinë e ushqimit.

METODAT DHE PROCEDURAT

Në funksion të realizimit të objektivave të kërkimit qasja metodologjike mbështetet në paradigmen post-pozitiviste, e cila bazohet në metoda te matjes sasiore te realitetit objektiv. Këtu do të përdoret metoda e statistikës përshkruese dhe modeli ekonometrik për testimin e lidhjes së ndikimit të faktorëve socio-demografik, në qartësinë e dallimit mes këtyre dy lloj attributesh.

TË DHËNAT

Punimi është pjesë nga një kërkim më i gjerë të cilin po e zhvillon autori parë në kërkim të gradës Dr. në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, prandaj të dhënat e përdorura për këtë punim janë pjesë projektit të doktoratës.

Të dhënat janë siguruar përmes vëzhgimit. Një pyetësor është përgatitur dhe është përdorë për të grumbulluar të dhënat për testimin tyre. Vëzhgimi është realizuar përmes intervistave me konsumatorët e marketeve të rrjetit Viva Fresh Store.

Anketimi është realizuar brenda objektit të marketit, te sektori i produkteve të qumështit, për shkak se: (i) konsumatori është intervistuar menjëherë pas kryerjes së veprimit të blerjes; (ii) gjatë intervistimit konsumatori ka pasur përpara të ekspozuara edhe produktet e tjera gjë që ndihmon në dhënien e mendimit më saktë për vendimin e tij duke mbajtur parasysht alternativat.

Në vëzhgimin i cili është zhvilluar nga 1 prill deri 5 maj 2015, janë përfshirë 303 konsumatorë të moshës mbi 18 vjeçare. Zgjedhja e konsumatorëve është bërë në mënyrë të rastësishme. Në kryeqytetin Prishtinë, si përfaqësuese e grupit të qyteteve me mbi 100 mijë banorë janë realizuar 153 anketa; në Gjilan, I cili bënë pjesë në grupin e qyteteve me popullsi

prej 50 -100 mijë banorë janë realizuar 110 anketa, dhe në Viti (më pak se 50 mijë banorë) janë realizuar 40 anketa.

Për objektivat konkret të punimit, sidomos nëse konsumatorët dallojnë atributet përkatësisht konceptet e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit, u përdor një pyetje e tërthortë ku krahas deklaratës: “kur them ushqim i sigurt mendoj:” u vendosen përshkrime për attribute të cilësisë dhe sigurisë. Kështu u krijua variabli dammy nëse konsumatori i ka ose jo të qarta konceptet.

Modeli

Meqë variabli i varuar që ka të bëjë me qartësinë për atributet është dammy(1-po; 0-jo), atëherë për të testuar lidhjet e qartësisë së koncepteve me faktorët socio-demografik si: mosha, gjinia, vendbanimi, të ardhurat dhe niveli i arsimit, është aplikuar fillimisht analiza korrelative përmes matricës së korrelacionit ku janë identifikuar lidhjet sinjifikate korrelative mes faktorëve. Pas kësaj përdoret modeli i regresionit logjistik për të testuar ndikimin e variablave shpjeguese në variablën e varur sipas ekuacionit të regresionit logjistik :

$$\log(\text{odds}) = a_i + b_i X + e_i$$

Për objektivin dytësor përdorim statistikën përshkruese.

REZULTATET DHE INTERPRETIMI

Përmbledhje e karakteristikave socio-demografike të mostrës

Nga tabela 1 shihet se ka një mospërputhje me të dhënat e regjistrimit të popullsisë, por që ka arsytet logjik nëse mbajmë parasysh faktin se në mostër janë përfshirë vetëm blerës të një rrjeti të supermarketeve, megjithëse supermarketet dhe minimarketet(grocery) janë vendet më të preferuara të blerësve të produkteve të bulmetit (Haas, Canavari, Imami, Gjonbalaj, & Gjokaj, 2015).

Kështu nga krahasimi me të dhënat e censusit 2011 shohim se 65% e blerësve në mostër janë nga qyteti kurse 62% e popullsisë jeton në zonat rurale (ASK, 2013b). Gjithashtu këtu mbajmë parasysh faktin se vend-intervistimet janë në zona urbane.


Tabela 1. Karakteristikat socio-demografike të mostrës – statistika përshkruese

Karakteristikat socio-demografike	Fi	Përqindja	Mesatarja	Dev. standard	Moda	Mediana
Vendbanimi:	n=302	100				
- Qytet	197	65.2 (38)				
- Fshat	105	34.8 (62)				
Gjinia	n=303	100				
- Meshkuj	197	65 (50.34)				
- Femra	106	35 (49.66)				
Nr.i anëtarëve në familje	n=303	100	4.89 (5.9)	1.834	4	5
Mosha	n=303	100	38.27	11.995	30	37(26.3)
Struktura e familjes:	n=303	100				
- Nr i pensionisteve:	215	71				
0	55	18.2				
1	33	10.9				
2	90	29.7				
- Nr i fëmijëve:	64	21.1				
0	95	31.4				
1	35	11.6				
2	14	4.6				
3	5	1.6				
4						
5-8						
Të ardhurat	n=300				900+	400-500
Niveli i arsimit:	n=302	100			I lartë	I lartë
- Pa arsim	3	1.0 (6.22)				
- Fillor	37	12.3 (50.27)				
- I mesëm	110	36.4 (34.17)				
- I lartë	152	50.3 (9.34)				

*- të dhënat brenda kllapave janë marrë nga regjistrimi i popullsisë 2011

Statistika përshkruese në lidhje e variablilit shpjeguese, është paraqitur në grafikun 1 në të cilin vetëm alternativa 5 dhe 6 përfaqësojnë attribute për konceptin siguri e ushqimit. Aty shihet se vetëm 10% (n=30) e konsumatorëve kanë të qartë se çfarë paraqet koncepti siguri e ushqimit.

Grafiku 1. Vlerësimi se a ka qartësi për konceptin siguri e ushqimit



Burimi: Anketa në terren

Ndikimi i faktorëve socio-demografik në qartësinë e konceptit

Rezultatet nga tabela 2 tregojnë se ka korrelacion mes variablit për qartësinë mes koncepteve cilësi dhe siguri me faktorët socio-demografik si: vendbanimi, niveli i arsimit dhe të ardhurat. Këto variabla u përdorën për të aplikuar modelin e regresionit logjistik por ky model nuk prodhoi rezultatet të besueshme për shkak të efektit i multikolinearitetit nga korrelacionet e forta mes variablave të pavarura (shiko për më shumë tabelën2).

Tabela 2. Matrica e korrelacionit

		A është i qarte koncepti siguri e ushqimit?	Gjinia	Vendbanimi	Mosha	Niveli i arsimit
Gjinia	Pearson Correlation	-,072				
	Sig. (2-tailed)	,211				
Vendbanimi	Pearson Correlation	,131*	-,112			
	Sig. (2-tailed)	,022	,051			
Mosha	Pearson Correlation	-,104	,285**	-,130*		
	Sig. (2-tailed)	,070	,000	,024		
Niveli i arsimit	Pearson Correlation	,143*	-,043	,320**	-,091	
	Sig. (2-tailed)	,013	,464	,000	,116	
Të ardhurat mesatare mujore/familje	Pearson Correlation	,135*	-,062	,284**	-,034	,496**
	Sig. (2-tailed)	,019	,285	,000	,552	,000

Burimi: Anketa në terren – përpunimi SPSS

Nga sa më lartë, jemi të shtrënguar që lidhjen mes variablave ta shpjegojmë vetëm përmes treguesit të korrelacionit. Sipas të dhënave në tabelën 2 del se:

- Për nivel sigurie 0.05, konsumatorët që jetojnë në qytet kanë gjasa më të mëdha që ta kenë të qartë dallimin mes dy koncepteve dhe anasjelltas;
- Për nivel sigurie 0.05, konsumatorët që kanë nivel më të lartë të arsimit kanë gjasa më të mëdha që ta kenë të qartë dallimin mes dy koncepteve dhe anasjelltas; dhe
- Për nivel sigurie 0.05, konsumatorët me nivel më të lartë të të ardhurave kanë gjasa më të mëdha që ta kenë të qartë dallimin mes dy koncepteve dhe anasjelltas.

Në tabelën 3 paraqitet statistika përshkruese për sa i takon perceptimit të konsumatorëve për sigurinë e ushqimit dhe ku bazohet ky perceptim. Për këtë qëllim u shtrua pyetja me shkallëzimin Likert. Më pas ata që e vlerësuan me 4 (e lartë) dhe 5 (shumë e lartë), u pyetën për arsytet e këtij vlerësimi.

Nga rezultatet shihet se rreth 48.83% e konsumatorëve vlerësojnë se produktet e bulmetit kanë siguri të lartë ose shumë të lartë, kurse pjesa tjetër e kanë vlerësuar se siguria është e nivelit mesatar e ulët ose shumë e ulët. Nga grupi i konsumatorëve që dhanë vlerësim të larta për sigurinë, arsye kryesore për këtë vlerësim është se e konsumojnë produktin për një kohë të gjatë (67.6%) një pjesë e vogël besojnë te prodhuesi (6.1%) dhe një pjesë simbolike (1.8%) besojnë të shteti. Edhe te ata që kanë përzgjedhur më shumë alternative dominojnë ato ku përfshihet alternativa e parë.

Tabela 3. Perceptimi i konsumatorëve për sigurinë e produkteve dhe arsyet – statistika përshkruese

E vlerësoj sigurinë si “të lartë” dhe “sh. të lartë”, sepse:	Qumësht			Djathë			Jogurt			*Mesatarja aritmetike në %
	Fr	%	% në total	Fr	%	% në total	Fr	%	% në total	
1. E konsumoj për kohe të gjata këto produkt	101	65,6	33,3	106	69,3	35,0	93	67,9	30,7	67,6
2. Kam besim te prodhuesi	10	6,5	3,3	8	5,2	2,6	9	6,6	3,0	6,1
3. Besoj se shteti nuk lejon produktet te pasigurt	1	,6	0,3	3	2,0	1,0	4	2,9	1,3	1,8
Alternativat :1 dhe 2	27	17,5	8,9	24	15,7	7,9	19	13,9	6,3	15,7
Alternativat: 1 dhe 3	3	1,9	1,0	3	2,0	1,0	2	1,5	0,7	1,8
Alternativat: 2 dhe 3	1	,6	0,3	1	0,7	0,3	1	0,7	0,3	0,7
Alternativat: 1, 2 dhe 3	11	7,1	3,6	8	5,2	2,6	9	6,6	3,0	6,3
Total	154	100	50,8	153	100	50,5	137	100	45,2	(50,8+50,5+45,2) 48,83
Vlerës. për sigurinë: “mesatar”, “e ulët” dhe “shumë e ulët”	149		49,2	150		49,5	166		54,8	51,17
TOTAL	303		100	303		100	303		100	100

*Rezultatet në rreshtat 2-8 janë të mestaret nga kolonat :” %”; kurse në rreshtat 9 -10 për kolonat: “% në total”. Burimi: Anketa në terren – përpunimi SPSS

KONKLUZIONE

Nga rezultatet e kërkimit mund të nxjerrim përfundimin që edhe konsumatorët e Kosovës, përgjithësisht (90% nga të anketuarit) I ngatërrojnë konceptin e sigurisë me atë të cilësisë së ushqimit. Pra edhe këta konsumatorë kur japin vlerësimin për sigurinë e ushqimit përdorin të njëjtattribute në definimin e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit (Kealesitse & Kabama, 2012). Në konfuzionin mes attributeve përkatësisht koncepteve cilësi dhe siguri e ushqimit, ndikim të konsiderueshëm kanë faktorët socio ekonomik më shumë se sa ata demografik. Siç u pa në analizën e korrelacionit, faktorë të tillë si: mosha, gjinia nuk tregojnë ndonjë lidhje sinjifikante korrelative, kurse niveli i arsimit, niveli i të ardhurave dhe vendbanimi kanë treguar korrelacion sinjifikant ($p < 0.05$).

Në këtë situatë, perceptimi për sigurinë e ushqimit, në një masë të konsiderueshme vlerësohet i lartë ose shumë i lartë (48.83%), dhe kjo kryesisht vjen si rezultat se produkti konsumohet për një kohë të gjatë, kurse një pjesë e vogël besojnë te prodhuesi dhe një pjesë simbolike besojnë të shteti.

Gjetjet implikojnë hulumtime të mëtejshme se si konfuzioni me koncepte ndikon në sjelljen e konsumatorëve dhe vlerësimin e tyre për atributet e sigurisë së ushqimit. Nga ana tjetër,

krahas politikave për rritjen e sigurisë së ushqimit, institucionet por edhe prodhuesit e ushqimit, në rastin tonë bulmetit, duhet të ndërmarrin fushata informuese për këtë problem.

REFERENCAT

1. Canavari, M., Imami, D., Gjonbalaj, M., & Alishani, A. (2014). Linking national support measures to local food production with consumer preferences in Kosovo. FAO Regional Office for Europe and Central Asia: TCP/KOS/3401.
2. Jabbar, M. A., Baker, D., & Fadiga, M. L. (2010). Demand for livestock products in developing countries with a focus on quality and safety attributes: evidence from Asia and Africa. ILRI (aka ILCA and ILRAD).
3. Kealesitse, B., & Kabama, I. O. (2012). Exploring the influence of quality and safety on consumers' food purchase decisions in Botswana. *International Journal of Business Administration* , 3(2), p90.
4. Zhllima, E., Imami, D., & Canavari, M. (2015). Consumer perceptions of food safety risk: Evidence from a segmentation study in Albania. *Journal of Integrative Agriculture* , 14(6), 1142-1152.

**PREFERENCAT E KONSUMATORËVE PËR PRODUKTET BUJQËSORE
RAJONALE/LOCALE NË SHQIPËRI**

ALBAN CELA¹, DRINI IMAMI²

¹Instituti i statistikave

²Universiteti Bujqësor i Tiranës

e-mail: acela@instat.gov.al drini.imami@ubt.edu.al

ABSTRAKT

Shqipëria ka potencial të madh për zhvillimin e *produkteve bujqësore* cilësore falë diversitetit kulturor, klimaterik dhe territorial. Skemat cilësore, përfshirë PDO dhe PGCI, janë opsionet e duhura për mirëmbajtjen e sektorit bujqësor në Shqipëri. Kuptimi i *preferencave të konsumatorit* dhe sjelljes së tyre është e rëndësishme për palët e interesuara në marrjen e vendimeve të lidhura me këtë sektor, të cilat mund të përfshijnë ndërtimin e një kuadri për politikat ndërhyrëse në të ardhmen (i cili gjithashtu është një nga qëllimet e këtij vrojtimi). Ky studim bazohet në vërtetimin të strukturuar me intervista të drejtpërdrejta në qytetin e Durrësit të cilat janë realizuar gjatë pranverës 2015. Pyetësi mbledh informacion mbi faktorët *social-demografik* të konsumatorëve, preferencat dhe *perceptimet* lidhur me *produktet tipike vendase*. Pyetësi është ndërtuar bazuar në rishikimin e literaturës, si dhe konsultave me ekonomistë bujqësor, akademik, etj. Një seri me elementë lidhur me perceptimin dhe sjelljen ndërmjet konsumatorëve Shqipëtar janë matur nëpërmjet përdorimit të analizave statistikore përshkruese, për të kuptuar qartë përgjigjet e dhëna nga kampioni nën vëzhgim. Bazuar në rezultatet e vërtetimit, “ku” një produkt është prodhuar ka tendencën të jetë një faktor i rëndësishëm për një pjesë të gjërë të konsumatorëve shqipëtar.

ABSTRACT

Albania has great potential to develop quality *agricultural products* given its cultural, climatic and territorial diversity. Quality schemes, including PDO and PGCI, are pertinent options for the maintenance of the agricultural sector in Albania. Understanding *consumer preferences* and behaviour is important for stakeholders when making relevant decisions, which may include the design of a policy intervention framework in the future (which is also the purpose of this survey). This study is based on a structured survey with face-to-face interviews in Durrës (one of the largest urban centers, and important market) which were conducted during spring 2015. The questionnaire covers information about consumer *socio-demographic* factors, preferences and *perceptions* regarding *typical local products*. The questionnaire was designed based on an extensive literature review, and consultations with agricultural economists, scholars and practitioners. A series of elements regarding perceptions and attitudes among Albanian consumers are measured using basic descriptive statistical analysis to describe the responses of the sample under study. According to the survey results, where a product is produced tends to be quite an important factor for most Albanian consumers.

HYRJE

Madhësia mesatare e fermës mbetet e vogël, rreth 1.2 ha, ndërsa madhësia e parcelës ka mbetur rreth 0.23 ha. Kjo nënkupton jo vetëm madhësi të vogël të fermës por dhe një nivel të lartë copëzimi (fragmentimi). Konsolidimi i madhësisë së fermës paraqet një prirje pozitive, por ai është i ngadalshëm. Duke pasur parasysh ritmin e ngadalhtë të procesit të konsolidimit, është e nevojshme që të shikohet për alternativa të tjera. Këto mund të përfshijnë bujqësinë organike (që nuk është objekt i këtij studimi) ose sisteme të tjera të cilësisë së prodhimit, si produktet tipike vendase.

Gjithashtu vlen të theksohet se madhësia mesatare e vogël e fermave pengon zhvillimin ekonomik (kur është e nevojshme që të jenë konkurrese në terma efijence).

Në këtë kontekst, një mundësi për rritjen e të ardhurave nga ferma është që të rritet vlera e shtuar e produkteve bujqësore dhe ushqimore duke i lidhur ato me territore të veçanta. (Barjolle D., Boisseaux S. and Dufour, 1998). Në Shqipëri si shumë vende të Mesdheut, konsumatorët kanë një prirje të fortë drejt origjinës së produktit. Në përgjithësi konsumatorët preferojnë produkte vendase (Imami viti 2011, Skreli dhe Imami 2012, Zhllima viti 2013 etj). Brenda kategorisë së produkteve me origjinë vendase ka dallime përsa i përket vendndodhjes së produkteve të ndryshme.

Origjina e produktit është parimi thelbësor drejt konceptit Evropian të mbrojtjes të emrit të produktit ku ai është prodhuar. Këto produkte tani kanë filluar të tërheqin vëmendjen për rolin që ata luajnë në zhvillimin rural dhe lokal dhe gjithashtu në krijimin e marrëdhënieve të barabarta midis prodhuesve dhe konsumatorëve. (Bérard L., Marchenay Ph., 2004).

Tre skemat e njohura si PDO (Vendi Mbrojtur i Origjinës), PGI (Pozicioni Gjeografik i Mbrojtur) dhe TSG (Specialitetet Tradicionale të Garantuara) promovojnë dhe mbrojnë emrat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore në BE . Skemat e mëposhtme të BE-së inkurajojnë prodhime të ndryshme bujqësore, mbrojnë emrat e produkteve nga keqpërdorimi dhe imitimi dhe ndihmojnë konsumatorët duke ju dhënë atyre informacion në lidhje me karakteret specifike të produkteve në fjalë:

PDO: për produkte bujqësore dhe ushqimore që janë prodhuar, përpunuar dhe përgatitur në një zonë të caktuar gjeografike duke përdorur knoë-hoë e njohur.

PGI: për produkte bujqësore dhe ushqimore të lidhura ngushtë me zonën gjeografike. Një nga fazat e prodhimit, përpunimit dhe përgatitjes zhvillohet në këtë zonë.

TSG: Thekson karakterin tradicional, si në kuptimin e përbërjes dhe të prodhimit.

PGI-ja është një mundësi e rëndësishme për fermerët në zonat malore. Sektori i bujqësisë në këto zona është i karakterizuar nga zinxhirët vlere vlere të shkurtër, përdorim intensive të fuqisë punëtore, metodat e prodhimit me intensitet të ulët teknologjik dhe ajo ofron një mundësi për zhvillimin e ushqimieve tipike. Ka pasur përpjekje të kufizuara nga ana e sektorit privat për të prezantuar etiketimin dhe standartet në lidhje me origjinën.

Të kuptosh preferencat dhe sjelljen konsumatore është një çështje e rëndësishme për aktorët kyç kur marrin vendime lidhur mbi çështjet që kanë lidhje me të, duke përfshirë ndërtimin e kuadrit të ndërhyrjes nëpërmjet politikave përkatëse. Perceptimi i konsumatorit do të jetë një pjesë e rëndësishme e këtij studimi. Objektivi i këtij studimi është të analizojë ndërgjegjësimin e konsumatorit, preferencat dhe gatishmërinë për të paguar për produktet me origjinë të veçantë rajonale.

METOGOLOGJIA

Ky material është bazuar në një vrojtim të strukturuar me konsumatorë në Durrës ky qytet përfaqësojnë tregun kryesor potencial për produktet me origjinë të veçantë rajonale, përveç tregut të Tiranës, për shkak të madhësisë së qytetit dhe fuqisë blerëse. Pyetëtori është hartuar në bazë të rishikimit të gjerë të literaturës. Pyetëtori është testuar me konsumatorë të zgjedhur në mënyrë rastësore. Qëllimi i pyetësit ishte të mbledhë informacion të faktorëve të konsumit socio-demografike si dhe preferencat dhe perceptimet për produktet tipike.


Janë zhvilluar 100 intervista te drejtpërdejtja. Këto të dhëna janë mbledhur nga vetë doktoranti duke e ndjekur nga afër këtë proces dhe më pas janë dërguar në SPSS për përpunim të mëtejshëm. Një seri e elementëve lidhur me perceptimet dhe qëndrimet e konsumatorëve shqipëtar është matur duke përdorur analizat deskriptive statistikore.

PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË ANKETËS

RËNDËSIA E ORIGJINËS

Origjina e produktit ka tendencë të jetë faktor i rëndësishëm për shumicën e konsumatorëve në Durrës. Sipas këtij studimi, shumica e konsumatorëve i zgjedhin produktet e tyre bazuar në faktin nëse produktet në fjalë janë të prodhuara në vend apo ato janë të importuara. (Figura 1). Sondazhet e ndryshme që janë kryer më parë kanë identifikuar se ka një preferencë të fortë të konsumatorëve për prodhimet vendase, veçanërisht në mish, perime, bulmet, fruta dhe vaj ulliri.


Figura 2: Unë i zgjedh produktet që konsumoj nisur nga origjina (vendi apo të importuara)



Burimi: anketa në terren

Duket se ka dallime të mëdha në perceptim bazuar nga cili rajon i Shqipërisë vijnë produktet vendase. Në mënyrë të veçantë 33.3 përqind deklaruan se rajoni i origjinës është shumë i rëndësishëm kur zgjedh për të blerë produkte Shqiptare dhe 28.2 përqind deklaruan se origjina është e rëndësishme.

Figura 3: Rëndësia e rajonit të origjinës (rrethi ose krahina) për produktet agro-ushqimore



Burimi: anketa në terren


PREFERENCAT PËR PRODUKTET RAJONALE

Ndërkohë që konsiderohet e rëndësishme që produkti bujqësor të jetë me origjinë vendi, është po aq e rëndësishme të kuptohet në terma relativë ndërmjet produkteve të ndryshme – konsumatorëve ju kërkua të zgjidhnin 3 produktet më të rëndësishme të cilat ato do të preferonin të ishin vendi. Nga rezultatet tregohet një interes më i madh lidhur me origjinën vendase për mishin, perimet dhe bylmetin, siç jepet dhe në tabelën 1 më poshtë

Tabela 1

Produkti	Frekuenca
Mish	95
Perime	99
Bylmet	89
Fruta	74
Vaj Ulliri	56

Figura 4: Ku do të preferonit të blini produkte bujqësore të freskëta



Burimi: Anketa në terren

GATISHMËRIA PËR TË PAGUAR

Studime të ndryshme për konsumin kanë treguar se konsumatorët shpesh tentojnë tek mbivlerësimi kur ju përgjigjen pyetësorëve në krahasim me realitetin që i rrethon si dhe në krahasim me përballjen në vendimet reale të jetës. Për më tepër, në këtë sondazh, gatishmëria për të paguar është shprehur në përqindje, por premisat e përqindjes ndryshojnë realisht nga çmimet mesatare. Është një gjë të paguash 50 përqind më shumë për mollë gjatë sezonit të prodhimit kur shiten me 60 lek/kg (çmimi arrin 90 lek/kg) dhe është tjetër gjë të blesh mollë kur çmimi është 150 lek/kg jashtë sezonit të prodhimit. Megjithatë informacioni i dhënë më poshtë është i dobishëm kur interpretohet si tregues i sjelljes dhe preferencave të konsumatorit. Pjesa më e madhe e konsumatorëve janë të gatshëm të paguajnë më shumë lidhur me produktet cilësore të vendit – përkatësisht 47 përqind e të anketuarve janë të gatshëm të paguajnë shtesë në çmim prej 10 përqind, 30 përqind e të anketuarve janë të gatshëm të paguajnë 11 – 30 përqind më shumë dhe 13 përqind e të anketuarve janë të gatshëm të paguajnë mbi 30 përqind shtesë në çmim (tabela 2)

Tabela 2: Gatishmëria për të paguar më shumë

Indikatori	Gatishmëria për të paguar më shumë (në përqindje)				
	0	1 - 10	11 - 30	31 - 50	51 - 100
Frekuenca	10	47	30	9	4

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE DHE POLITIKAT REKOMANDUESE

Shqipëria zotëron potencial të madh për prodhimin e produkteve ushqimore cilwsore, diversitetin klimaterik dhe territorial. Për më tepër, ndjeshmëria e konsumatorëve kundrejt origjinës së produkteve bujqësore, diversitetit të lartë të produkteve, integrimin në rritje të fermave në treg dhe konsolidimin e marrëveshjeve ligjore dhe institucionale në lidhje me regjistrimin e PGI , tregon që PGI është një opsion përkatës për mbarëvajtjen e sektorit bujqësor në Shqipëri dhe veçanërisht në zonat malore.

Origjina e prodhimit ka tendencë të bëhet një faktor i rëndësishëm për shumicën e konsumatorëve shqipëtar. Sipas këtij studimi, shumica e konsumatorëve i zgjedhin produktet e tyre bazuar në origjinën (vendase kundrejt importeve). Aktualisht, shumica e konsumatorëve blejnë nga fermerët ose “tregjet e gjelbra”. Ata i besojnë shitësit dhe nuk kërkojnë produkte të etiketuara. Forcimi i standarteve Europiane dhe zhvillimi i mëtejshëm social (familjet e vogla urbane) do të rrisë pjesën e shitur në supermarketete, ndërsa shitjet e fermës do të ulen kur kërkesa për sigurinë ushqimore nuk është përmbushur në prodhim. Megjithatë, fermerët, përpunuesit dhe konsumatorët duhet të shikojnë që tregu i ardhshëm do të jetë më profesional (TVSH, siguri ushqimore etj) dhe në këtë treg do jetë e rëndësishmë dallimi i një produkti nga tjetri. Zhvillimi i skemave pilot mund të jetë i nevojshëm.

BIBLIOGRAFIA

1. MZHBRAU, 2013, Strategjia Ndër Sektoriale Bujqësore dhe Zhvillit Rural 2014-2020.
2. Barjolle D., Boisseaux S., Dufour. 1998. Le lien au terroir. Bilan des travaux de recherche. Lausanne, Institut d’Economie Rurale.
3. Bérard, L., & Marchenay, P. (2004). Les produits de terroir. *Entre cultures et regalements. Paris: CNRS editions.*
4. Chan-Halbrendt, C., Zhllima, E., Sisior, G., Imami, D., Leonetti, L. (2010). Consumer Preference for Olive Oil: The Case of Albania, *IAMA World Symposium*, Boston, USA.
5. Civici, A., Guri, F., and Zhllima, E., (2004). Wine production and consumer behavior in Albania. *Albanian Bulletin of Agricultural Sciences*. 3(3):34-41.
6. Gabor, A., Granger, C.W.J. (1966). Price as an indicator of quality: report on an inquiry. *Economica*, 33:43-70.
7. Green, P.E., and Wind, Y. (1975). New Ways to Measure Consumers' Judgments. *Harvard Business Review*, 89-108.
8. Imami, D., Chan-Halbrendt, C., Quanguo, Zh., Zhllima, E. (2011). Conjoint analysis of consumer preferences for lamb meat in central and southwest urban Albania. *International Food and Agribusiness Management Review*,14(3).
9. Kupiec, B., & Revell, B. (2001). Measuring consumer quality judgements. *British Food Journal*, 103(1), 7-22.
10. Lancaster, K. J. (1966). A new approach to consumer theory. *The journal of political economy*, 74(2): 132-157.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Universiteti "Fan Noli" Fakulteti i Bujqësisë


Konferenca II ndërkombëtare e bujqësisë, ushqimit dhe mjedisit : 25 shtator 2015, Korçë, Shqipëri : libri i punimeve = Second international conference of agriculture, food and environment : September, 25-th, Korçë, Albania : proceedings book / Universiteti "Fan Noli". Fakulteti i Bujqësisë. – Korçë : Promo Print, 2016. Vol.2, Libri 1, 686 f. : me foto ; 21x29,7 cm [A4]. Bibliogr. në fund të kumtesave
ISBN 978-9928-146-41-0

1.Bujqësia 2.Ushqimi 3.Konferenca

63(496.5) (062) 6



International Conference of Agriculture Food Environment
Korça 2015

978-9928-146-41-0